MBRETNIJA SHQIPTARE
KËSHILLI I SHTETIT

LIGJE DEKRET LIGJE E RREGULLORE

TË VJETIT

1934

BKSH

BOTIMET E KËSHILLIT TË SHTETIT
VOL. 11 I PËRMBLEDHJES SË LIGJEVE
TIRANË, 1942

BKSH

BKSH

LIGJE
DEKRET LIGJE
RREGULLORE

BKSH

BKSH

MBRETNIJA SHQIPTARE
KËSHILLI I SHTETIT

LIGJE DEKRET LIGJE E RREGULLORE

TË VJETIT

1934

BKSH
BIBLIOTEKA KOMBETAR
TIRANE

BOTIMET E KËSHILLIT TË SHTETIT
VOL. 11 I PËRMBLEDHJES SË LIGJEVE
TIRANË, 1942

BKSH

Nr. 1.

LIGJË, 16 Dhetuer 1933.

Mbi shitjen e tokave rurale të çiflikut Gurez në qarkun e Krues Bujqeve tretar që i punojnë aktualisht ato toka dhe faljen e borxheve që i detyrohen financës per të tretat.

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 11 Kallnuer 1934, Nr. 1)

Neni 1.

Ministrija e Financavet autorizohet me u shitë bujqeve tretarë tokat që punojnë aktualisht në çiflikun Gurëz, me konditat e posht-shenueme:

a) Çdo bujkë tretarë ka të drejtë me ble nga financa tokat qi rezultojnë se ka aktualisht me të tretë; por gjithmonë gjansija e kësaj toke për çdo familje s'ka me kalue 40 hektar d. m. th. 400 dynym secili prej 1000 metro katrore;

b) Çmimi i shitjes asht baras për gjithë blesit dhe për gjithë llojet e tokave, 150 fr ari hektari ose 15 fr. ari dynymi (njimij metrash katrore) Fraksionet ma pak se nji dynym, llogariten në përpjestim perkatës.

Neni 2.

Pagimi ka me u ba mbrenda katër vjetëve dhe në 8 (tetë) këste të njishme, të cilat kanë me u pague mbrenda muejit Maj dhe Nanduer.

Neni 3.

Tokat qi do të teprojnë do t'u shiten po me këtë çmim bujqeve tretarë ose emigrandve qi nuk kanë toka të mjaftueshme dhe do të kenë krah dhe mjete për me i punue.

Neni 4.

Gjithë blesit detyrohen me ndihmue, në proporcion të tokave që kanë pervetumun, në kullimin e tokave, tue çel kanale dhe tue i qit këto në lumë ose me ndonji vend tjetër qi mund të rrjedhë.

Kullimi i tokave kësodore ka me u mbarue maksimum mbrenda katër vjetëve.

Neni 5.

Për me nda tokat që kanë me u shit tretarëve në konformitet me dispozitat e kësaj ligje, do t'emnohet nji Komision i posaçëm prej tre vetave: një agronom, nji ingjinier ose topagraf dhe një nëpunës i deleguem prej financës, komisioni në fjalë ka me shku në vend dhe mbasi të përmbushen formalitetet e shitjes ka me i dorëzue tokat bujqve tretarë në konformitet me nenin 1 të kësaj Ligje.

Proces-verbali do të nenshkruhet prej anëtarëve të Komisionit dhe prej blesit t'interesuem.

Neni 6.

Borxhet qi kanë blesit kundrejtë financës nga shkaku i së tretës të pa pagueme në natyrë ose në të hollat deri në ditën e shitjes, u falen dhe shlyhen në librat e financës.

Në qoftë se blesi i shmanget detyrimevet të rrjedhuna prej kësaj ligje, obligohet rishtas me pagimin e të tretave të grumbullume (akumullueme).

Neni 7.

Shitja do të bëhet me akt-publik në konformitet me ligjat e përgjithshme, tue u përjashtue palët nga taksa kontraktuale e nga taksa e transkriptimit.

Në kontraten relative të shitjes konform dispozitavet të Nenit 1398 të Kodit Civil, do të stipullohet që Shteti ruen zotnimin mbi tokat e shituna deri sa t'i paguhet çmimi i shitjes tanësisht dhe, në rasë të çartjes së shitjes për shkak të mos pagimit të tanë çmimit mbrenda katër vjetëve, kestet e pagueme i mbeten Shtetit si shpërblim, dhe financa në këtë rasë pa pasë nevojë as për ndonji formalitet rekursi merr në dorëzim tokën për me i a shitë ndonji personit tjetër.

Neni 8.

Këstet e pagueme, herë pas herë prej blesavet depozitohen në Bankën Kombëtare dhe shkojnë në favor të Bankës Bujqësore.

Neni 9.

Ministri i Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Neni 10.

Kjo ligjë hynë në fuqi që nga e nesërmja e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi shitjen e tokave rurale të Çiflikut Gurëz në qarkun e Kruës, bujqve tretarë që i punojnë aktualisht ato toka, dhe faljen e borxheve q'i detyrohen financës për të tretat, i votuem prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 23 datë 4-XII-1933 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 16 Dhetuer 1933. — ZOG

Kryeministri: P. EVANGJELI — *Ministri i Financavet:* A. DIBRA

Nr. 2.

LIGJË, 5 Kallnuer 934

Mbi disa ndryshime në Ligjën e Përmbarimit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 16 Kallnuer 934, Nr. 2).

KAPTINA I.

Ngritja e burgimit për disa kategori debitorësh Personat që nuk burgosen

Neni 1.

Nuk burgosen për dete private:

a) debitori që ndodhet në vobekësi të provueme;

b) femnat;

c) ata që kanë mbushun moshën e 70 vjetëve;

ç) të sëmurët, burgim'i të cilve rrezikon jetën e tyne për sa kohë vazhdon sëmundja;

d) Ata që mbrenda vitit, kanë përmbushun 91 ditë burgim për dete private.

Në çdo rast mbeten të rezervueme dispozitat e Nenit 35 të Ligjës së Përmbarimit.

dh) Për periudhën Korrik, Gusht, Shtatuer, Tetuer, ata që merren personalisht me punime bujqësore.

Neni 2.

Për efektet e nenit të nalt-treguem konsiderohet i ndodhur në vobeksi ay që nuk ka të holla, sende të tjera ose prona. Kjo gjendje duhet të vërtetohet prej Pleqsiës së katundit ose lagjes me dishmi të posaçme, përmbajtja e së cilës duhet të vërtetohet prej Komunes ose Bashkis.

Me gjithë këte kreditorit i njihet e drejta të provojë të kundërten me çdo mjet ligjuer përpara Kryesis së Përmbarimit. Gjith'ashtu të kundërtën mundet t'a provojë kreditori dhe në rastet c) ç) d) edhe dh) të nenit të ma sipërme.

Neni 3.

Ata nga personat e treguem në nenin 1, që ndodhen të burgosun ditën e hyemjes në fuqi të kësaj Ligje, lirohen nga burgu.

Neni 4.

Çdo dispozitë që vjen në kundreshtim me ketë ligjë, mbetet pa fuqi.

Neni 5.

Kjo Ligjë hyn në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 6.

Ministrija e Drejtësiës ngarkohet me zbatimin e saj.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi disa ndryshime në Ligjen e Permbarimit, i votuem prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 36/I datë 27-XII-1933 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 5 Kallnduer 1934. Z O G

Kryeministri: P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësiës V. AVRAMI

Nr. 3.

LIGJË, 5 Kallnuer 934

Mbi prerogativat e Klubit Turistik dhe Automobilistik Mbretnor (K. T. A. M.).

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Kallnuer 934, Nr. 3).

Art. 1.

Klubi Turistik dhe Automobilistik Mbretnor (K.T.A.M.) autorizohet të lëshojë në konformitet me rregulloren e tij të posaçme çertifikata ndrëkombëtare të quejtuna triptyques edhe karneta kalimi në doganë (carnet de passage en douane) per perjashtim të përkohshëm nga tagrat doganore t'automobilavet, motoçikletavet, biçikletavet etj., të hyeme me qëllim turizmi në tokën e Mbretnis

Art. 2.

Turistat që kan triptyques-a ase karneta kalimi në doganë dhe që hyejnë në tokën e Mbretnis me qëllim turizmi me automobila, autokarro, motoçikleta etj., nuk depozitojnë tager doganuer për mjetet e udhëtimit.

Triptyqueset dhe karnetat kalimi në doganë kanë vleftë vettëm për nji vjetë.

Art. 3.

Triptyques-a edhe karnet kalimi në doganë japin të drejtën e hymjes dhe të daljes së mjetevet t'udhëtimit të sipër-kujtuem mbrenda nji vjeti pa caktim numri të hyrjes e të daljes.

Art. 4.

Mënyra e lëshimit nga ana e K. T. A. M.-it të triptyques-vet edhe të karnetavet kalimi në doganë caktohet me Rregullore të tij të posaçme.

Art. 5.

Klubi Turistik dhe Automoblistik Mbretnor asht organ i autorizuem për lëshim dhe kontrollim të çertifikatavet ndërkombëtare të rrugës e të konduktimit, të njoftuna prej Mbretnis si mbas vendimit Nr. 191 datë 15 Mars 1930 të Këshillit Ministruer për adherimin në Konventen Ndërkombëtare me datë 24 Prillë 1926 mbi qarkullimin e autokarrovet.

Art. 6.

Ligja me datë 29 Prillë 1933 mbi prerogativat e Klubit Turistik Automobilistik Shqiptar (K. T. A. M.) me hyemjen në fuqi të kësaj Ligje, mbetet pa fuqi.

Art. 7.

Kjo Ligjë hynë në fuqi qysh prej datës që shpallet në Fletoren Zyrtare.

Art. 8.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e ksaj Ligje.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi prerogativat e Klubit

Turistik dhe Automobilstik Mbretnor, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 70/I datë 27-XII-1933 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 5 Kallnduer 1934.

Z O G

Kryeministri:
P. EVANGJELI

Ministri i P. të Jashtme
XHAFE VILA

Ministri i Financavet
A. DIBRA d. v.

Ministri i Punëvet Botore
S. SARAÇI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Mbrendëshme
Zav. Ministri i Ek. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Arësimit
M. IVANAJ

Nr. 4.

LIGJË, 5 Kallnuer 934

Mbi Preferimin ndër furnitura Shtetnore të prodhimeve Kombtare me çmime deri 15% (pesëmbëdhjetë për qind) ma të nalta se produktet e njejta t'importueme nga jashtë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Kallnuer 934, Nr. 3)

Art. 1.

Ndër kontratat qi lidhin dhe në ç'do blerje qi bajnë Administratat Shtetnore, me ankand publik, licitacjon privat e marrveshtje private, për të përballue forniturat qi u nevojiten, preferohen produktet Kombëtare edhe kuer çmimi i tyne në vende të jetë deri 15 % (pesëmbdhjetë për qind) ma i naltë se çmimi i mbrendëshëm i produkteve të njejta t'importueme nga jashtë.

Art. 2.

Pesëmbëdhjet për qind e lejueme me artikulin e sipërm nuk mund të merret për bazë për me caktue skeden e msheftë ose çmimin bazë kuer produkti Kombëtar kushton baras ose ma pak se asht çmimi i mbrendëshëm i produkteve të njejta t'importueme nga jashtë.

Art. 3.

Kontratarët (fornitorët) janë të detyruem me sjellë prova se produkti qi dorëzojnë në bazë të kontratës për produktet Kombëtare asht me të vërtetë i tillë.

Prova sjellet me fakturen e shitësit, mbi të cillen verteton

Dhoma Tregtare e qarkut të tij se, produkti asht i vendit si mbas mostres qi u vulos e qi ruhet për gjashtë muej prej sajë në dy pjesë të ndame.

Art. 4.

Kushdo qi mashtron o ndihmon me mashtrue administraten tue i dhanë produkt të jashtëm në vend të produktit Kombëtar të kontraktueme me çmim ma të naltë, si edhe ata qi janë bashkë-veprues të nji vepre të tillë, ndeshkohen si mbas dispozitave të Kodit Penal.

Art. 5.

Kjo Dekret-ligjë hyen në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare dhe, do t'i paraqitet Dhomës Legjislative për kembim në ligjë.

Art. 6.

Qeverija ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

Kryeministri:
P. EVANGJELI

V. AVRAMI
Ministri i Drejtësis

Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i P. të Mbrendëshme
Zav. Ministri i Ek. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
M. IVANAJ

Ministri i Punëvet Botore
S. SARAÇI

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 958/II datë 16-VI-933, Si ndigjoi dhe pelqejë vendimin e Kshillit Ministruer me datë 16-VI-1933,

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi preferimin ndër fornitura Shtetnore të prodhimeve Kombëtare me çmime deri 15% (pesëmbëdhet për qind) ma të nalta se produktet e njejta t'importueme nga jashtë.

Tiranë 3 Korrik 1933.

Z O G

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit me datë 3 Korrik 1933. i aprovuem prej Parlamentit, dhe urdhënon shtimin e tij në Kodet e Mbretnis si Ligjë.

Tiranë, me 5 Kallnduer 1934.

ZOG

Nr. 5.

LIGJË, 31 Kallnduer 934.

Për transferimin e një fondi prej fr. ari 6.000 nga kap. 1 «Rrogë personali» në kapitullin III «Shpenzime udhëtimi e djete» të budgetit të Ministris së P. Botore ushtërimi 1933-934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 6 Fruer 934, Nr. 4.)

Art. 1.

I Shtohet Kap. III. «Shpenzime udhtimi e djete» të budgetit të Ministris së P. Botore, ushtrim 1933-34, nji shumë prej fr. ari 6000 (gjashtëmijë).

Art. 2.

Shuma e permendun në Art. 1 të kësaj ligje merret nga fondi i Kap. I «Rrogë personeli» të budgetit të Ministris së P. Botore ushtrimi 1933-1934.

Art. 3.

Për zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministrija e P. Botore dhe, ajo e Financavet.

Art. 4.

Kjo ligjë hyn në fuqië prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi transferimin e nji fondi prej fr. ari 6.000 (gjashtëmijë) nga Kap. «Rrogë personeli». Kap. III

«Shpenzime udhtimi e djete» të budgetit 1933-934 të Ministriës së P. Botore, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 101/1 datë 26-I-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 31 Kallnuer 1934.
Z O G

Kryeministri:
P. EVANGJELI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Punëvet Botore
S. SARAÇI

Nr. 6.

LIGJË, 27 Kallnuer 934

Mbi ndryshimin e tagrave doganore të hyemit të disa zanave të Tarifës së Përgjithëshme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 6 Fruer 934, Nr. 4).

Neni 1.

Ad. Nr. 19 të Tarifës Doganore:

Germa c) e Nr. 19 të tarifës (Dhjamë shtazësh për industri a fr. ari 6 kuintalin) anulohet. Dhe dhjamët e perfshieme në ketë numer i shtrohen taksave të parapame në germat a) b) të Nr. 19, e si mbas llojit qi të jenë.

Neni 2.

Ad. Kategorija XVII e XVIII të Tarifës Doganore:

Ndermjet mëndafshit natural dhe mëndafshit artifiçial, për efekte të klasifikimit tyne dhe të taksimit, nuk bahet distinksion, prandaj të gjitha mallnat që përmenden në kategritë XVII e XVIII të përfshieme që nga Nr. 247 e deri Nr. 270 me gjith ndarjet a) b) c) ç) të këtij numri ku përmendet»....... prej artifiçiali ose prej artifiçiali të përziem, konsiderohen si prej mendafshi natyral ose të përziem, dhe tagrohen po me ato taksa që rendohen ato prej mëndafshit natyral ose të përzieme.

Neni 3.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Neni 4.

Kjo ligjë ka fuqi qysh prej datës 29 Mars 1933 datë në të cillen i asht paraqitë Dhomës Legjislative, në zarf të mbyllun si mbas nenit 142 të Statutit Themeltar.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi ndryshimin e Tagrave doganore të hyemit të disa zanave të Tarifës së Përgjithshme, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 66/I datë 17-XI-933 të Kryesis së Tij.

Durrës, me 21 Nanduer 1933. ZOG

Kryeministri: P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 6-bis.

DEKRET MBRETNOR, 27 Kallnuer 1927.

mbi zgjatimin e afatit të akordit tregtar midis Shqipnis e Greqisë

(botue në Fletoren Zyrtare, datë 6 Fruer 1934, Nr. 4).

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 510/3 datë 15-I-1934 të Ministris së Punëvet të Jashtme, paraqitë me shkresën Nr. 99 datë 23-I-1934 të Kryeministris.

Tue pamë dhe vendimin Nr. 24 datë 22-I-1934 të Këshillit Ministruer.

DEKRETON:

Zgjatimin e afatit t'akordit tregtarë me Greqinë që mbarojë me 15 të k. m. deri me 15 Fruer të këtij vjeti, për të vendosun mbrenda kësaj kohe modalitetet për zgjatimin definitiv të tij.

Tiranë, me 27 Kallnduer 1934.

ZOG

Kryeministri: P. EVANGJELI

Ministri i P. të Jashtme XH. VILA

Nr. 7.

LIGJË, 31 Kallnduer 934

Mbi ndryshimin e kuadrit budgetuer t'Oficerave të Gjindarmeris që nga data 1 Dhetuer 1933 deri me 31 Mars 934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Fruer 934, Nr 5).

Art. 1.

Kuadri budgetuer i Oficerave të Gjindarmeriës i ndryshuem me ligjën datë 21 Nanduer 1933, që nga data 1 Dhetuer 1933 i shtohet nji Nënkolonel e nji Kapiten i Klasës I-rë, tuj i u zbritë nji Major e nji Kapiten i Klasës së II-të, diferenca e rrogës së tyne ka me u përballue me fondin e aprovuem në kapitullin përkatës.

Art. 2.

Kjo ligjë hynë në fuqi që nga data 1 Dhetuer 1933.

Art. 3.

Për zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Trupi Ministruer, dhe Komanda e Përgjithëshme e Gjindarmeriës.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi ndryshimin e kuadrit budgetuer t'Oficerave të Gjindarmeriës që nga data 1 Dhetuer 1933 deri më 31 Mars 1934, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 105/I datë 26-I-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 31 Kallnduer 1934.

Z O G

Kryeministri:
P. EVANGJELI

Ministri i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 8.

DEKRET-MBRETNUER, 21 Nandor 1933.

Mbi kthimin në Ligje të Dekret-ligjës me dat 28 Korrik 1933 mbi shtesën e taksës së pullave, botue në Fletoren Zyrtare Nr. 47 datë 4 Gusht 1933

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Fruer 934, Nr. 5).

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës me datë 28 Korrik 1933 i aprovuem prej Parlamentit, dhe urdhënon shtimin e tij në Kodet e Mbretniës si Ligjë.

Durrës, me 21 Nanduer 1933.

ZOG

Nr. 9.

LIGJE, 31 Kallnduer 1934.

Mbi pranimin e Konventes Ndërkombtare të Telekomunikacioneve, dhe të Rregullores Telegrafike Nderkombtare, të hartueme prej konferencës Nderkombtare Telegrafike dhe Radiotelegrafike të mbajtun në Madrid me 1932

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Fruer 934, Nr. 5)

Art. 1.

Pranohet Konventa Ndërkombëtare e Telekomunikasioneve e përbame prej 40 Artikujsh, dhe Rregullorja Telegrafike Ndërkombëtare e përbame prej 98 artikujsh; të hartueme në Konferencën Ndërkombëtare Telegrafike dhe Radiotelegrafike të mbajtun në Madrid me 1932.

Art. 2.

Ministrija e Punve të Jashtme ngarkohet me plotësimin e formaliteteve mbi adhërimin, në Konventen dhe në Rregulloren Telegrafike Nderkombëtare të Madridit, nga ana e Qeveris Mbretnore, në konformitet me dispozitat e artikullit 3 të Konventes në fjalë.

Art. 3.

Vehen në veprim sherbimet e posaçme fakultative qi vijojnë:

a) gjuhët e pranueshme për përpilimin e telegramave private të jashtëm dhe, mbi taksatimin e telegramave të përpilluem në gjuhë të marrëveshtun, si mbas dispozitave t'artikujve 8, 9, 10 e 11 të Rregullores Ndërkombëtare;

b) telegramat private të jashtëm urgjentë dhe pjesërisht urgjentë me dispozitat dhe taksat e caktueme n'artikullin 55 të Rregullores në fjalë;

c) telegramat privatë të jashtem me shumë drejtime, në konformitet me dispozitat dhe taksat e caktueme n'artikullin 61 të Rregullores së permendun;

d) telegramat e shtypit të jashtëm, si mbas përshkrimeve t'artikujve 68, 69, 70, 71 e 72, të Rregullores në fjalë, me taksat e caktueme n'artikujt respektivë;

e) telegramat e diferuem, në konformitet me dispozitat dhe taksat e caktueme n'artikullin 75, të kësaj Rregullore;

f) telegramat-letër në bazë të pershkrimeve t'artikullit 76 dhe me taksat e caktueme po në ketë artikull;

g) telegramat urime me dispozitat dhe me taksat t'artikullit 77 të Rregullores në fjalë.

Art. 4.

Taksat lajmim marrrjeve telegrafike, në bazë të dispozitave t'artikullit 58 të Rregullores Ndërkombëtare, bahet baras me taksën e gjashtë fjalëve të llogarituna në bazë të vend-mrritjes së telegramit me lajmim-marrje dhe të vijës, së pranimit të këtij telegrami.

Art. 5.

Bajnë pjesë integrale të kësaj Ligje një eksemplar i Konventes Ndërkombëtare të Telekomunikacioneve dhe një eksemplar i Rregullores Telegrafike Ndërkombëtare, në gjuhë frengjishte.

Art. 6.

Kjo ligjë hynë në fuqi qysh prej 1 të Shkurtit njëmij e-nandëqind-e-tridhekatër.

Art. 7.

Ministrija e Punëve Botore dhe, Ministrija e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarvet
DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi pranimin e Konventes Ndërkombëtare të Telekomunikacioneve dhe të Rregullores Telegrafike Ndërkombëtare, të hartueme prej Konferencës ndërkombëtare Telegrafike dhe Radiotelegrafike të Mbajtun në Madrid me 1932, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 126-I datë 29-I-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 31 Kallnduer 1934. ZOG

Kryeministri: P. EVANGJELI

Ministri i Financavet: A. DIBRA

Ministri i P. Botore S. SARAÇI

Nr. 10.

LIGJË, 5 Fruer 934

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 18.000 në budgetin preventiv t'ushtrimit financjer 1933-934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 15 Fruer 934, Nr. 6).

Art. 1.

Në gejndjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit Financjarë 1933-34 paksohen fondet për Dikaster e kapituj si vijon :

Ministrija e Financavet:

Kap. 7 «Rrogë personali e alokacjon (shtëpia civile	fr. ari	2.600
Kap. 39 «Rrogë personali e alokacjon (K. Kontrollues)	«	4000
Kap. 68 «Këthim i huas vjetit 1920	«	3.400
Ministrija e P. të Mbrendshme:		
Kap. I «Rrogë personali e zavendësi etj.	«	3.000
Ministrija e Ekonomis Kombtare:		
Kap. I «Rrogë personali zavendsi etj	«	5.000
Gjithsejt:	Fr. ari	18.000

Art. 2.

Fondet prej fr. ari 18.000 (tetmbëdhjetmijë) paksue si mbas art. 1 të kësaj ligje, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjarë 1933-34 të Ministris së P. të Mbren-

dshme Kap. 7 «Shpenzime shtypi, propagande shtypi e shpenzime post-telegrafike».

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministri i Financavet, Ministri i P. të Mbrendshme e Ministri i Ekonomis Kombtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 18.000 në budgetin preventiv t'ushtrimit financjar 1933-34, e votueme prej parlamentit, si mbas shkresës Nr. 119-I datë 30-I 1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 5 Fruer 1934 Z O G

Kryeministri: P. EVANGJELI

Ministri i P. të Mbrendshme Zav. Ministri i Ek. Kombëtare MUSA JUKA

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 11.

LIGJE, 5 Fruer 934

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 20.500 në budgetin e ushtrimit 1933-34 të Ministris s'Ekonomis Kombtare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 21 Fruer 934, Nr. 7).

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris s'Ekonomis Kombtare paksohen fondet për kapituj si vijon:

Kap. 1 «Rrogë personeli zavendsije etj.»	fr. ari 1.000
Kap. 4 «Shpenzime Zyre»	« 1.000
Kap. 8 «Shpenzime gjithfarësh për aplikimin e Ligjës së Veterinarisë	« 7.500
Kap. 9 Shpenzime gjithfarësh për mbajtjen e Stacionit Zooteknik etj.	« 3.000
Kap. 12 «Shpenzime gjithfarësh për Shkollën e Bujqësis në Lushnje	« 8.000
Gjithsejt	« 20.500

Art. 2.

Fondet prej fr. ari 20.500 (njizetmijë e pesëqindë) pakësue si mbas art. 1 të kësaj ligjë, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-1934 të Ministris s'Ekonomis Kombëtare ndër kapituj si vijon:

Kap. 6 «Qira»	fr. ari	3.500
Kap. 7. «Shpenzime Bujqësore gjithfarësh»	«	15.500
Kap. 11 «Shpenzime gjithfarësh për industriën e zunkthave	«	1.500
Gjithsejt	«	20.500

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare dhe ajo e Financavet.

Art. 4.

Kjo ligjë hyn në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 20.500 në budgetin e ushtrimit financjar 1933-1934 të Ministrisë s'Ekonomis Kombëtare, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 127-I datë 30-I-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 5 Fruer 1934 Z O G

Kryeministri: P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Ministri i P. të Mbrendshme Zav. Ministri i Ekonomis Kombëtare MUSA JUKA

Nr. 12.

LIGJË, 13 Fruer 934

Mbi bartjen e disa fondeve mbrenda kapitujve të budgetit të Gjindarmeriës aprovue për ushtërimin financjar 1933-934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 21 Fruer 934, Nr. 7).

Art. 1.

Në kapitujt e gjendjes së parapamjeve të Gjindarmeris, apro-

vue për ushtrimin financjar 1933-934, bahen bartjet e fondeve si vijojnë:

Nga kapitulli 23 «Rrogë graduatësh e Gjindarmësh» pakësohen fr. ari 112.750, si edhe nga Kapitulli 33 «Bursa Studentash» pakësohen fr. ari 2.250, tue ju ngarkue:

Kap. 24	«Shpenzime udhtimi e djete»	fr. ari	6.000
« 26	«Shpenzime Zyre»	«	8.000
« 27	«Fond në dispozicion të Komandës për mbajtje automobilash e pagë shoferash	«	4.000
« 31	«Veshje-mbathje e pajim Gjindarmësh»	«	90.000
« 35	«Komunikacjone Blemje-mbajtje-telefonash etj»	«	7,000
	Gjithsejt	«	115.000

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi që nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Për zbatimin e kësaj Ligjë, ngarkohet Trupi Ministruer, dhe Komanda e Përgjithshme e Gjindarmeriës.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëvet
D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartjen e disa fondeve mbrenda kapitujve të budgetit të Gjindarmeriës, ushtrimi financjar 1933-1934, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 118/I datë 3-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 13 Fruer 1934 — Z O G

Kryeministri: P. EVANGJELI — *Ministri i P. të Mbrendshme* V. AVRAMI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 13.

LIGJË, 13 Fruer 934

Mbi transferim fondesh prej fr. ari 72.750 në budgetin e ushtrëimit 1933-934 të Ministris së Financavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 21 Fruer 934, Nr. 7).

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit finan-

BIBLIOTEKA KOMBETARE TIRANE

cjar 1933-934 të Ministris së Financavet, e të Komandës së P. të Gjindarmeris pakësohen fondet për kapitull si vijon:

Ministrija e Financavet

Kap. 30 «Blemje e mbajtje automobili e pagë shoferi (Kryeministri)	fr. ari	3.750
Kap. 44 «Rrogë personali zavendësije etj. (Ministri e Financavet)	«	45.000
Kap. 56 «Kthim tatimesh e taksash të marruna tepër etj.	«	12.000
Kap. 65 Shpenzime për të vue dorë në tokat e grabituna të Shtetit»	«	1.000
Kap. 68 «Kthim i huas së vjetit 1920	«	5.000
Komanda e P. e Gjindarmeris:		
Kap. 23 «Rrogë graduatësh e Gjindarmësh»	«	6.000
Gjithsejt	«	72.750

Art. 2.

Fondet prej fr. ari 72.750 (shtatdhetedymijë shtatëqindëepesdhetë) paksue si mbas Art. 1 të kësaj Ligje, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-1934 të Ministris së Financavet ndër kapituj si vijon:

Kap. 9 bis, «Qira (Shtepija Civile)	fr. ari	5.600
Kap. 15 «Shpenzime Zyreje (Adjutantura)	«	1.200
Kap. 27 «Rrogë personali (Kryeminitrija)	«	950
Kap. 38 «Shpenzime çdo natyre gjithfarësh për instalim emigrandash (Drejtorija e P. e Reformës Agrare)	«	38.000
Kap. 51 «Vertetim tatimesh e taksash»	«	20.000
Kap. 52 «Shkonto Pullash»	«	2.000
Kap. 58 «Shpenzime Gjyqi»	«	5.000
	«	72.750

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Trupi Ministruer.

Art. 4.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi transferime fondesh prej

fr. ari 72,750 në budgetin e ushtrimit financjar 1933-1934 të Ministris së Financavet, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 133/I datë 8-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 13 Fruer 1934 | Z O G

Kryeministri | *Ministri i Financavet*

P. EVANGJELI | A. DIBRA

Nr. 14.

LIGJE, 13 Fruer 934

Mbi bartje fondesh në budgetin preventiv t'ushtërimit financjar 1933-1934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 21 Fruer 934, Nr. 7).

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 pakësohen fondet për dikaster e kapitull si vijon:

Ministrija e P. të Mbrendëshme:	
Kap. I «Rrogë personali, zavendësije etj.»	fr. ari 2.000
Kap. 5 «Qira Zyreje»	« 1.300
Kap. 9 «Mbajtje Burgjesh»	« 1.700
Ministrija e Ekonomis Kombëtare:	
Kap. I «Rrogë personali, zavendësije etj.»	« 1.000
Kom. e Mbrojtjes Komb. e Gjindarmeriës	
Kap. 23 «Rroga graduatësh e Gjindarmësh»	« 19.000
Gjithsejt	« 25.000

Art. 2.

Fondi prej Fr. ari 25.000 (njizetepesëmij) pakësue mbas Art. 1 të kësaj Ligjë i shtohet Kap. 10 «Shpenzime të mëshefta» të gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934, të Ministris së P. të Mbrendëshme.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Trupi Ministruer.

Art. 4.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartje fondesh prej fr.

BRISH

ari 25.000 në budgetin preventiv t'ushtrimit Financjar 1933-1934, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 132/I datë 8-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 13 Fruer 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. të Mbrendshme
Zav. Ministri Ekonomis Kombtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 15.

LIGJË, 21 Fruer 934

Mbi autorizimin e Qeveris për lidhjen e Marrëveshtjeve (Akorde) provizore tregtije dhe rregullimin e tregtis së jashtme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Fruer 934, Nr. 8)

Art. 1.

Qeverija asht e autorizueme me lidhë marëveshtje tregëtije provizore, ose akorde suplementare me ato Shtete me të cilët ekziston nji traktat tregtarë, tue mbajtë prencipet dhe tarifat e caktueme me traktatet, e tue pasë për bazë kushtin e reciprocitetit, me konditë që importimi dhe eksportimi në Shtetet kontraktuese të vehet në nji proporcion të favorshëm të përshtatshëm me nevojën e me fuqin e ekonomis kombëtare të vendit.

Të tilla marrëveshtje mund të lidhen për nji kohë 6 muejsh e deri në dy vjet; këto mund të quhen të përserituna si mbas konditavet që do të caktohen ndër ta.

Akordet që ndryshojnë prencipet dhe ngarkojnë Shtetin ose shtetasit me barra të reja, duhet t'iparaqiten Parlamentit për aprovimin para se të vehet në zbatim (Art. 83 i Statutit Themeltarë).

Art. 2.

Për zbatimin e vuemjes në proporcion t'importimit me eksportim, si dhe për me rregullue çmimet e shitjes për exportim, Qeverija asht e autorizueme me krijue në rast nevoje nji o ma shumë organizata të pershtatëshme parastatale ose zyrtare për lejimin, rregullimin ose kufizimin e importimit të mallnave nga jashtë dhe për të ba të mundëshme exportimin e produkteve të vendit.

Art. 3.

Mënyra e organizimit dhe e funksionimit t'organizatave të përmenduna n'art. 2 të kësaj ligje, bahet me rregullore ose, kuer kanë formën e nji shoqnije, me Statut.

Art. 4.

Kjo Ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5.

Qeverija asht e ngarkueme me zbatimin e kësaj Ligje.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi autorizimin e Qeveris për lidhjen e Marrëveshtjeve (Akorde) provizore tregëtije dhe rregullimin e tregtis së jashtme, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 250/I datë 19-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 21 Fruer 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i P të Mbrendëshme
Zav. Ministri Ekonomis Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA d. v.

Ministri i Arësimit
M. IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 16.

LIGJË, 13 Fruer 934.

Për akordimin e një huaje prej fr .ari 405.000 Bashkis së Kryeqytetit.

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Fruer 934, Nr. 8).

Neni 1.

Qeverija autorizohet me i akordue Bashkis së Kryeqytetit, nji hua prej Fr. ari 405.000 (katerqindepesmijë) me konditat që caktohen në nenet që pasojnë:

Neni 2.

Huaja e përmendun në nenin e sipërmë, i akordohet Bashkis së Kryeqytetit pa interesë dhe për t'i a u kthye Qeveris, në pesë kiste vjetore tue fillue prej vjetit 1934.

Neni 3.

Në rastin se Bashkija e Kryeqytetit, në çdo vjet e mbrenda periudhës pesvjeçare, ka me kontraktue ndonji hua, ose ka me u vërtetue ndonji tepricë t'ardhunash jashtë parapamjevet të shpenzimevet ordinare vjetore të sajë; kjo detyrohet me i kthye Qeveris plotësisht ose pjesërisht, huan e detyrueme n'atë kohë, pa pritun afatet e kistevet të pa skadueme.

Neni 4.

Shuma e kësaj huaje përballohet prej të mbrapambetunave të ngeluna për t'u nxjerrë nga kapitujt «T'ardhuna nga monopolizimi i krypës» të gjendjes së parapamjevet t'ardhunavet t'ushtrimevet të kalueme.

Neni 5.

Ministri i Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Neni 6.

Kjo Ligjë hyn në fuqi qysh nga data e shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës autorizuese për akordimin e nji huaje prej fr. ari 405.000 Bashkis së Kryeqytetit, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 110-I datë 3-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 13 Fruer 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Financavet:
A. DIBRA

Nr. 17.

LIGJË, 21 Fruer 934

Mbi zgjatimin e afatit të Ligjës Ndëshkimore për faje Politike me datë 25-XII-1925.

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Fruer 934, Nr. 8 bis).

Neni 1.

Afati i Ligjës ndeshkimore për faje Politike, me gjithë ndryshimet dhe shtojcat e saja, zgjatohet deri me 29-XII-1936.

Neni 2.

Kjo Ligjë hyn në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Ministri i P. të Mbrendshme dhe ay i Drejtësis ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi zgjatimin e afatit të Ligjës Ndëshkimore për faje Politike me datë 25-XII-1925, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 111/I datë 14-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 21 Fruer 1934.   Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Nr. 18.

LIGJË, 21 Fruer 934

Mbi modifikimin e Art. 1 të Ligjës së Tarifës Doganore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 28 Fruer 1934, Nr. 9).

Art. 1.

Artikulli nji i ligjës së Tarifës Doganore në fuqi modifikohet si vijon:

«Të gjitha gjanat qi hyjnë në Shqipni paguejnë tagrin doganuer si mbas tarifës së kësaj ligje.

Gjanat qi nuk janë të përmenduna në tarifë e qi nuk gëzojnë ndonji lehtësim a perjashtim ligjuer të veçantë, i shtrohen tagrit doganuer 50% (pesëdhetë për qind) mbi vleftë (ad valorem) për veç artikujt e poshtë-shënuem, të cilët randohen me nji tager 20% (njizet për qind) ad-valorem:

a) Dyllli Karanauba, dylli i Japonis, dylli i mizave ose spermacetë bimësh, dylli Montana ose dylli prej lignitit (për veç çerezines) dyllë vegjetale të tjera: si dylli mirika, dylli i drunit, qumësht dylli Balanofora, dylli Okotiles, e dylli i Spartit qi perdoron sidomos për pregatitjen e qirinjve, të vernikëve e bojnave për këpucë.

b) Dhjami i quajtur «Degras» që përdoret për të majmunit e shullit ndër regjëset e lëkuravet;

c) Llom Sasami ose «Tahim» qi perdoret për berjen e Tahım Hallvasë».

Art. 2.

Fraza e parë e Artikullit 2 të ligjës së Tarifës Doganore në fuqi modifikohet si vijon:

«Vlefta e gjanave qi paguejnë 50 e 20% si mbas Art 1......»

Art. 3.

Kjo Ligjë hyn në fuqi ditën qi t'i komunikohet Parlamentit nga Kryesija e Këshillit Ministruer.

Art. 4.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi modifikimin e Art. 1 të Ligjës së Tarifës Doganore, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 139/I datë 19-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 21 Fruer 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 19.

LIGJË, 21 Fruer 934

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 12.000 në gjendjen e parapamjeve të shpenzimeve t'ushtrimit 1933-934 të Ministris së P. Botore «Degë Postë-Telegrafe»

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 28 Fruer 934, Nr. 9).

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Ministriës së P. Botore e të Drejtorisë P. të Post-Telegrafavet bahen ndryshimet si vijon:

Paksim:

Kap. Nr. 10 «Rrogë personeli, zavendësije etj.	fr. ari 4200
Kap. Nr. 11 «Rrogë personeli me kontratë»	« 4800
« « 14 «Qira»	« 3000
	fr. ari 12.000

Shtime:

Kap. Nr. 12. Shpenzime udhtimi e djete	fr. ari 2800
« « 15 «Bartje postash të jashtzakonshme»	« 3400
« « 16 «Bemje materjali postelegrafonik»	« 1500
« « 16 «Bartje materjali posteiegrafonik	« 1500
« « 17 «Ngrehje e mbajtje linjesh telegr.»	« 1500
« « 18 «Instalim e mirëmbajtje radiosh.	« 1000
« « 21 «Taksa aerore» (pjes' e huej).	« 1800
	12.000

Art. 2.

Kjo Ligj hynë në fuqië nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministrija e P. Botore.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 12.000 në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtri-

BKSH

mit 1933-1934 të Ministriës së P. Botore «Degë Post-Telegrafë» e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 112/I d. 3-2-1934 të Kryesiës së Tij.

Tiranë, me 21 Fruer 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. Botore S. SARAÇI

Nr. 20.

LIGJË, 21 Fruer 934

Mbi ndryshimin e paragrafit të dytë të Nenit III të Kodit Tregtar, dhe mbi konditat e funksionimit të Shoqënivet të Sigurimit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 28 Fruer 934, Nr. 9).

Neni 1.

Shoqëniët me aksione konsiderohen të kushtitueme ligjorisht mbasi të lejohet me Dekret-Mbretnuer funksionimi i tyne.

Kur Gjykata e Shk. së I. në bazë të nenit III të Kodit Tregtar vendosë konformitetin e aktit kushtitetues dhe të Statutit të Shoqënis me dispozitat ligjore me kujdesin e t'interesuemit kopja e vendimit i transmetohet Ministris s'Ekonomis Kombëtare.

Mbasi vendimi i Gjykatës së Shk. së I. të marrë formën e preme, ose në kalimet e afatit të rekurimit ose me renoncimin e Prokurorit dhe të Ministris s'Ekonomis Kombëtare prej së drejtës së kundërshtimti, Ministrija e Ekonomis Kombëtare ban propozim për dekretimin e lejimit të funksionimit të Shoqënis.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare lajmëron Gjyqtarin e Rregjistrit mbi dekretimin e lejimit të funksionimit të Shoqnis, i cili i transmeton Odës së Tregëtis bashkë me vistën e tij kopjen e aktit kushtitues dhe të Dekretit Mbretnuer, tue urdhnue transkriptimin në rregjistrin e Tregtis. Transkriptimi analog bahet dhe në rregjistrat e ndodhuna në Sekretarin e Gjykatës së Shk. së I.

Neni 2.

Shoqnijet e Sigurimit për me ushtrue objektin e tyne në Mbretnin me anën e qendrës kryesore ose sekondare, ose me agjenësi ose me përfaqësi, detyrohen me tregu pranë Ministris s'Ekonomis Kombëtare nji garanci në të holla ose bankare prej fr. ari 300.000 (treqindëmij) ose një garanci ipotekore prej

600.000, fr. ari (gjashtëqindëmij) konformë me ligjën e Kontabilitetit të Përgjithshëm të Shtetit.

Në rasë se veprimet e sigurimit të kryeme në Shqipni prej Shoqënive të huaja ose Shqiptare mrrijnë nji shumë garancije e të cilave mbetet si nji sasi ma e paktë nga 5% të shumave të sigurueme, Shoqënija detyrohet me plotësue garancin deri në 5%.

Neni 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 4.

Ministrıja e Drejtësis dhe ajo e Ekonomis Kombëtare ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve

D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi ndryshimin e paragrafit të dytë të Nenit 111 të Kodit Tregtarë dhe mbi konditat e funsionimit të Shoqënivet të Sigurimit, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 109/I datë 14-II-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, 21 Fruer 1934, Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P të Mbrendëshme *Zav. Ministri Ekonomis Kombëtare* MUSA JUKA

Ministri i Drejtësis V. AVRAMI

Nr. 21.

LIGJË, 21 Fruer 934

Mbi ndryshimin e disa dispozitave të Ligjës me datë 2 Qershor 1928, dhe të Ligjës me 25 Shkurt 1929 mbi pagesat e graduatve ushtarak

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 28 Fruer 934, Nr. 9).

Art. 1.

Art. 1 i Ligjës 2 Qershuer 1928 mbi paga graduatësh modifikohet si vijon:

«Pagë e graduatëve e ushtarakve rekruta asht ditore e si vijon:

Fr. ari 0.05 për ushtarë e Nentetarë
» » 0.10 » Tetar
» » 0.20 » Nenreshtera e Reshtera.

Kurrë-far ndryshimi! nuk i bahet Art. 1 të Ligjës së sypërme për ushtarakët rekruta në sherbim të Rojës Mbretnore Kufizore.

Art. 2.

Art. 4 i ligjës 2 Qershuer 1928 mbi pagesa graduatësh e ushtaraksh modifikohet si vijon:

«Për të përballue shpenzimet e lamjes e fijosjes së teshavet graduatëve e ushtarakëvet pranohet shpenzimi prej fr. ari 0.25 në muej për çdo ushtarak nen armë».

Art. 3.

Anulohet Art. 5 i Ligjës 2 Qershuer 1923 mbi pagë graduatësh e ushtarakësh e syprimohet shpërblimi i kualve prej fr. ari 10, në muej.

Art. 4.

Pasqyra «A» e Art. 35 të Ligjës 25 Fruer 1929 mbi rregullimin e Rojes Mbretnore të Kufinit modifikohet si vijon:

Kapterat	Fr.	ari	105
Reshterët	»	»	95
Nënreshterët e Tetarët	»	»	80
Rojët e vjetra	»	»	60
Rojët e reja	»	»	50

Art. 5.

Syprimohet shperblimi mujuer prej fr. ari 5. caktue për Tetarë në pasqyrën «B» t'Art. 35 të Ligjës 25 Fruer 1929 mbi regullimin e Rojës Mbretnore të Kufinit.

Art. 6.

Shperblimi i udhtimit për sherbim t'izoluem të pasqyrës III. t'Art. 1 të ligjës 10 Gusht 1928, mbi shperblime eventuale e shpenzime udhtimi zbritet për Nënoficera e ushtarakë trupet si vijon:

Kaptera	Fr.	ari	1.50
Reshterët e Nenreshterët	»	»	1.10
Ushtarët	»	»	0.60

Art. 7

Kjo Ligjë hynë në fuqi që prej 1 Tetuer 1933.

Art. 8.

Trupi Ministruer ngarkohet për ekzekutimin e kësaj Ligje.

BTSH

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi ndryshimin e disa dispozitave të Ligjës me 2 Qershuer 1928 dhe të ligjës me 25 Fruer 1929 e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 104/I datë 14-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 21 Fruer 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P të Mbrendëshme
Zav. Ministri Ekonomis Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i Arësimit
M. IVANAJ

Ministri i P. të Jashtme
XH. VILA

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 22.

MARREVESHTJE-SHTESE 28 Fruer 934

E traktatit të tregtisë dhe të lundrimit midis Mbretnis Shqiptare, dhe të Mbretnis Jugosllave i nënshkruem në Belgrad me 22 Qershuer 1926

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Mars 934, Nr. 11).

Nalt Madhnija e Tij Mbreti i Shqiptarve
d h e
Nalt Madhnija e Tij Mbreti i Jugosllavisë

Tue pa nevojën me i dhanë hov shkëmbimeve tregtare, kanë vendosun me përfrundue nji akord si shtesë të traktatit të tregëtisë dhe të lundrimit, midis Mbretnis Shqiptare dhe të Mbretnis Jugosllave i nënshkruem në Belgrad me 22 Qershuer 1926, si mbas artikullit 30 po të ktij traktati, dhe për ketë qëllim kanë emnue fuqi plotët e tyne përkatës, si vijon:

Nalt Madhnija e Tij Mbreti i Shqiptarve
Shkëlqesin e Tij Z. Minister Mehmed Konitza
Nalt Madhnija e Tij Mbreti i Jugosllavisë

Shkëlqesin e Tij Begoljub Jevtich, Ministri i Tij i P. të Jashtme.

Të cilët mbasi i komunikuen njani tjatrit letrat fuqiplotëse të Tyne, që u gjetën në formën e duhun, mbeten d'akord mbi dispozitat që vijojnë:

Neni 1.

Qeverija Jugosllave merr për sipër sigurimin, gjatë kohës së kësaj marrëveshtjeje, për importimin në Jugosllavië të nji kontigjenti prodhimesh nga Shqipnija, posaçërisht ullinjët' e njoma ose në shëllinë; voj ullini të rafinuem ose të pa-rrafinuem; bersij ullinjësh, lëkura shtazësh të holla dhe të trasha (të freskta, të krypuna, të njoma ose të thata); lëkura shtazësh t'egra; lesh dhe qime; peshk të freskët, të thatë, të krypun ose të tymosun, drithna.

Vlefta e kontigjentit vjetuer të prodhimeve të nalt-shenueme, që Qeverija Jugosllave ngarkohet me sigurue blemjen në Shqipni do të jetë të paktën e njejtë me mesataren vjetore të vleftës s'eksportimeve Jugosllave në Shqipni gjatë katër vjetve të fundit (1929-1932).

Neni 2.

Qeverija Shqiptare detyrohet me sigurue dhe me i dhanë hov importimit në Shqipni të prodhimeve nga Jugosllavija, mbrenda kufinit të nevojës, posaçërish dru ndertimi, çimento, prodhime kimike dhe farmaçeptikë që i përshtaten nevojave të tregut shqiptare, ashtu edhe një kontigjent sheqeri, hekura ndërtese, vegla dhe artikuj të tjerë hekuri, baker (fonte) etj.

Neni 3.

Prodhimet kombtare të nji Shteti që duhet me i eksportue në Shtetin tjetër, sa të jetë e mundun do të qendërzohen me anë të nji zyrje ose të nji instituti të veçantë, i cili njikohësisht do të ngarkohet edhe me dorëzimin e tyne institutit përkatës të vendit importues.

Me gjithë këte, podhuesit eksportues të njanës nga palët e Nalta kontraktuese do të jenë të lirë me shtij prodhime kombtare në tokën e anës tjetër, tue i u konformue dispozitave që do të caktohen së bashku me anë të zyrave të ngarkueme me rregullimin e shkëmbimeve tregtare në mes dy Shteteve.

Neni 4.

Në pesëmbdhjetë ditët e para të muejit që vjen, çdo trimujor gjatë kohës në fuqië të kësaj marrëveshtjeje, zyrat e ngarkueme me

drejtue shkëmbimet midis dy Shteteve kontraktuese do t'i komunikojnë njana tjetrës lajmet përkatse.

N'asht se vërtetohet nji ndryshim që nuk i përshtatet kushteve të neneve 1 dhe 2 të kësaj marrëveshtjeje, Qeverija, së cilës i përket, detyrohet të marri masat e duhuna për rregullimin e shkëmbimeve gjatë trimujorit vijues.

Neni 5.

Me qëllim të zhvillohet lëvizja e mallnave dhe e udhëtarve midis Mbretnis Shqiptare dhe të Mbretnis Jugosllave, të dy Qeverinat janë d'akord me ftue Shoqëninat ose të tjera sipërmarrje kombtare, t'interesuem me transportimet midis dy Shteteve, për me ra n'ujdij për krijimin e vijave të rregullta transportimi me anë automobilash në mes të lokaliteteve Jugosllave dhe Shqiptare ku trafiku asht i dendun (posaçërisht midis Manastirit — Korçës dhe Podgoricës — Shkodrës.

Qeverija Jugosllave pranon të marrë masat për të lehtësue, sa të jetë e mundun, transitin e udhëtarve ashtu dhe të mallnave nga Shqipnija (bagtij dhe prodhime bujqësore etj. etj.) për mes banovinës së Vardarit drejt Salonikut dhe trafikun e udhtarve nga Saloniku, për mes banovinës së Vardarit drejt Shqipnisë.

Neni 6.

Kalimi i kufinit me qëllim me i dhanë hov shkëmbimeve tregtare midis të dy Shteteve do t'u lejohet veglave bartëse që bajnë sherbimin e transportimit, me kusht të bajnë nji dekllaratë se do të kthehen prap, jashtë kufinit mbrenda dhjetë ditve.

Neni 7.

Kjo Marrëveshtje do të hyjnë në fuqi, pesmbdhet ditë mbas shkëmbimit t'instrumentave të ratifikimit.

Do të ketë fuqië për nji kohë prej dy vjetësh.

Mund të denoncohet me nji paralajmim dy muejsh dhe në mungesë të ktij, do të zgjatet vetvetiu për nji periudhë të ré dy vjetësh.

Në ketë besë fuqiëplotësit e nenshkruen ketë marrëveshtje dhe i vunë vulat e tyne.

Bamë në Belgrad, në dy ekzemplarë, me 20 Dhetuer njimij e nandëqind e tridhet e tre.

Mehmet Konitza *B. Jevtich*

Accord additionel au traité de Commerce et et Navigation entre le Royaume d'Albanie et le Royaume de Yougoslavie, signé à Belgrade le 22 Juin 1926

Sa Majesté le Roi des Albanais
e t
Sa Majesté le Roi de Yougoslavie

ayant reconnu la nécessité de stimuler les échanges cammerciaux, ont décidé de conclure un Accord additionnel au traité de Commerce et de Navigation entre le Royaume d'Albanie et le Royaume de Yougoslavie, signé à Belgrade le 22 juin 1926, conformément à l'article 30 de ce même Traité et ont, à cet effet, nommé leurs plénipotentiaires respectifs, savoir :

Sa Majesté le Roi des Albanais

S. Exc. Monsieur le Ministre Mehmed Konitza,

Sa Majesté le Roi de Yougoslavie

S. Exc. Bogoljub Jevtich, Son Ministre des Affaires Etrangères.

lesquels, aprés s'être communiqués leurs pleins pouvoirs trouvés en bonne et due forme, sont convenus des dispositions suivantes :

Article 1.

Le Gouvernement Yougoslave s'engage à assurer pendant l . durée de cet accord l'importation en Yougoslavie d'un contingent de produits de provenance albanaise, notamment olives fraîches ou en saumure; huile d'olive raffinée ou non raffinée; marcs d'olive; peaux de petit et de gros bétail (fraiches, salées, humides ou séchées); peaux d'animaux sauvages; laine et poils, poissons frais. séchés, salés au fumés, céréales.

La valeur du contingent annuel des produits susindiqués que le Gouvernement Yougoslave s'engage à faire acheter en Albanie sera au moins égale à la moyenne annuelle de la valeur des exportations yougoslaves en Albanie pendant les quatre dernières années (1929-1932).

Article 2.

Le Gouvernement Albanais s'engage à assurer et à encourager l'importation en Albanie des produits de provenance yougoslave dans la limite des besoins, notamment le bois de construction, le ciment, les produits chimiques et pharmaceutiques répondant aux besoins du marché albanais, ainsi qu' un contingent de

sucre, de fers de constructions, outils et autres articles en fer, fonte, etc...

Article 3.

Les produits nationaux d'un pays destinés à être exportés dans l'autre pays, seront autant que possible concentrés par les soins d'un office ou d'une institution spéciale qui sera, en même temps, chargé de les remettre à l'institution correspondante du pays importateur.

Toutefois, les producteurs exportateurs de l'une des hautes parties contractiantes seront libres d'introduire des produits nationaux sur le territoire de l'autre partie, en se conformant aux dispositions qui seront arrêtées de commun accord, par les offices chargés de régler les échanges commerciaux entre les deux pays.

Article 4.

Dans les quinze premiers jours du mois suivant, chaque trimestre durant la validité de cet accord, les offices chargés de diriger les échanges entre les deux pays contractants se communiqueront les données y relatives.

Si un écart non conforme aux stipulations des articles I-er et 2 du présent accord est constaté, le Gouvernement en cause s'engage d'aviser aux mesures propres à rajuster les échanges durant le trimestre en cours.

Article 5.

Dans le but de développer le mouvement des marchandises et des voyageurs entre le Royaume d'Albanie et le Royaume de Yougoslavie, les deux Gouvernements conviennent d'inviter les sociétés ou autres entreprises nationales, intéressées aux transports entre les deux pays, à se mettre d'accord pour établir des lignes régulières de transport par véhicules automobiles entre les localités yougoslaves ou le trafic est fréquent (notamment entre Bitolje-Korça et Podgorica-Shkodra).

Le Gouvernement yougoslave accepte ed prendre les dispositions pour faciliter, autant que possible, le transit des voyageurs de même que des marchandises de provenance albanaise (bétail et produits agricoles etc.) par la banovine du Vardar vers Salonique et le trafic des voyageurs de Salonique, par la banovine du Vardar, vers l'Albanie.

Article 6.

Le passage de la frontière — dans le but de stimuler l'échan-

ge commerciale entre les deux pays — sera accordé aux véhicules effectés aux transports, sous condition d'une déclaration qu'ils seront réintégrés, au delà de la frontière, dans un délai de dix jours.

Article 7.

Le présent accord entrera en viguer quinze jours après l'échange des instruments de ratification.

Il restera en vigueur pour une période de deux ans.

Il pourra être dénoncé avec un préavis le deux mois, faute de quoi il sera prolongé par tacite reconduction pour une nouvelle péeriode de deux ans.

En foi de quoi les plénipotentiaires ont signé le présent accord et y ont apposés leurs sceaux.

Fait à Belgrade, en double exemplaire, le 20 décembre mil neuf cent trente trois.

Mehmet Konitza *B. Jevtich*

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 218 datë 22-II-1934, të Kryeministris,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e marrëveshtjes Tregtare të nenshkrueme në Belgrad me 20 Dhetuer 933, shtesë e Traktati të tregtisë e të lindrimit me datë 22 Qershuer 1926 firmue në Belgrad midis Mbretnis s'onë e Mbretnis Jugosllave, si mbas kopjes të bashkangjituna:

Tiranë, me 28 Fruer 1934. ZOG

Kryeministri *Ministri i P. të Jashtme*
P. EVANGJELI XH. VILA

Nr. 23.

LIGJË, 13 Fruer 1934

Mbi prelevimin e një shume të hollash nga t'ardhunat e Bankës Bujqësore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Mars 934, Nr. 12).

Neni 1.

Për përballimin e nevojave të ngutëshme të saj, Qeverija au-

torizohet me prelevue shumën e fr. ari 1.800.000 (njimiljon e tetëqindmijë) nga t'ardhunat e Bankës Bujqësore, të depozitueme në Bankën Kombëtare.

Neni 2.

Shumën e sipërme Qeverija detyrohet t'a kthej nga t'ardhunat e përgjithshme të viteve financjare 1935-36 dhe 1936-37. Por gjatë vitit financjar 1934-35 në rast se rezulton nji suficit, kjo shkon kundrejt shlyemjes së prelevimit, ose gjatë po të këtij viti kontraktohet ndonji hua shtetnore, Qeverija detyrohet të paguej jo ma pak 25% prej huas që kontrakton kundrejt fr. ari 1.800.000, tue i shtue asaj dhe interesën 4% (katër për qind).

Neni 3.

Për këtë qëllim në gjëndjen e parapamjevet të shpenzimevet të buxhetevet t'ardhshme të Ministris së Financavet, do të krijohet nji kapitull n'emërtim «Kryegjaja dhe interesi 4% mbi shumën e prelevueme nga t'ardhunat e Bankës Bujqësore si mbas ligjës me datë.....»

Neni 4.

Kjo ligjë hyen në fuqi qysh nga dita e shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Neni 5.

Ministri i Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve
D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi prelevimin e nji shumë të hollash nga t'ardhunat e Bankës Bujqësore, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 106/I dt. 3-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 13 Fruer 1934. Z O G

Kryeministri — *Ministri i Financavet*
P. EVANGJELI — A. DIBRA

Nr. 24.

LIGJË, 16 Mars 934

Mbi forfeitizimin e tatimit të fitimit të Shoqënis «Agip»

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Mars 934, Nr. 13).

Art. 1.

Ministrija e financavet asht e autorizueme me forfeitizue në

bazë të dispozitave të kësaj Ligje, e në bazë të nji marrëveshtjes për t'u përfundue me Shoqënin «Agip» tatimin e fitimit që Shoqrija në fjalë do të paguente mbi fitimet e vjetve 1934, 1935, 1936. 1937 e 1938 në bazë të ligjës d. 9-6-1928 mbi tatimin e fitimit.

Forfeitizimi mund të përfshij vetëm fitimet që Shoqënija «Agip» realizon në Shqipni në bazë të kontratës datë 27 Korrik 1929, e në bazë të shtojcë-kontratës datë 19 Korrik 1932.

Art. 2.

Forfaitizimi i parapamë n'Art. 1 të kësaj ligje bahet si vijon:

Për ç'do kuintal netto të shitun vaj-guri,, benzinë, benzol, karbur i kalcit e për çdo 100 litër acetilenë të shkrimë, tue caktue nji tatim fiks prej fr. ari 0.70 (shtatëdhjet qindar) në vjetë:

Për çdo kuintal netto të shitun gasoil naftë, mazut e vaj-guri të parafinuem tue caktue nji tatim fiks prej fr. ari 0.35 tridhetepesë qindar në vjetë:

Tatimi fiks i caktuem në paragrafet 2 e 3 të këtij artikulli, kalkulohet pa marrë parasyshë në se karburantat përkatës janë shitë me ose pa taks monopoli.

Art. 3.

Likuidimi i tatimit të parapamë n'artikullin 1 të kësaj ligje, bahet mbrënda tre muejve të parë të vjetit që ndjek vjetin për të cillin vërtetohet tatimi i fitimit.

Art. 4.

Nga kjo ligjë nuk përfshihen Axhentat e Shoqënis «Agip» nëpunësit e shoqënis ose nëpunësit e axhentave të kësaj.

Art. 5.

Kjo Ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 6.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarëve

D E K R E T O N

Aprovimin e zbatimin e Ligjës mbi forfeitizimin e tatimit të

fitimit të Shoqënis «Agip», e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 214-I datë 15-III-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 16 Mars 1934. Z O G

Kryeministri — *Ministri i Financavet*

P. EVANGJELI — A. DIBRA

(Marrëveshtja e lidhun me Shoqnin AGIP është ribotue në botimet e ligjeve të Këshillit Shtetit në Volumin e vjetit 1929 faqe 499).

Nr. 25.

LIGJË, 14 Mars 934

Mbi shtytjen e regjistrimit të përgjithshëm të ndërtesavet për vjetin 937

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Mars 934, Nr. 15).

Neni 1.

Rregjistrimi i përgjithshëm i ndërtesavet e i tokë ndërtimit që përmendë neni I i ligjës së përkatëshme me datë 24 Mars 1931 shtyhet për në vjetin 1937.

Neni 2.

Për vjetin financjarë 1934-935 autorizohen veprimet e kontrollit ordinar të përvjetshëm që përmend neni 28 i ligjës së sipërme të kryhen mbrenda muejit fruer 1934, tue u zgjatë kontrollimi që nga 15 Fruer deri me 31 Mars 1934.

Neni 3.

Kontrollimet e sipërme përmbarohen prej komisionevet qi formohen si vijon: Në qendra të Prefekturavet e të Nënprefekturavet prej nji nëpunsit të Financës, nji antari të Bashkisë ose Ingjinjerit të P. Botore e prej nji eksperti të thirrun prej lagjes ku bahet kontrollimi; ndër katunde prej Kryetarit të Komunes, të Tagrambledhësit të Financës të rajonit ku bahet kontrollimi e prej nji eksperti të zgjedhun nga katundi.

Neni 4.

Ndryshimet e vertetueme nga kontrollimi i përmendun në nenin e ma parshëm për vjetën financjare 1934-935 i-u njoftohet t'interesuemvet me komunikatë të veçantë deri me 15 Prill 1934, dhe bashkëdhanasvet u mbetet shteg me kundërshtue vertetimin e të çmuemit të ndërtesavet e të tatimit përkatës mbrenda 15 ditëvet prej datës të komunikimit të sipërm.

BKSH

Neni 5.

Zyrat e tatimevet deri në fund të Majit 1934 janë të detyrueme me dhanë fund vertetimit të tatimit mbi ndërtesa e tokë ndërtimi me datë 24 Mars 1931.

Neni 7.

Kjo ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Neni 8.

Ministrija e Financavet, ajo e P. të Mbrendshme dhe ajo e P. Botore ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarvet

D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi shtytjen e rregjistrimit të përgjithshëm të ndërtesavet për në vjetin 1927, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 153-I datë 27-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Mars 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P të Mbrendëshme MUSA JUKA

Ministri i Financavet A. DIBRA

Ministri i P. Botore S. SARAÇI

Nr. 26.

LIGJE, 14 Mars 934

Mbi bartje fondesh prej fr .ari 4500 (katërmijepesëqind) në budgetin e ushtërimit 1933-934 të Ministris së Financavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare,, 23 Mars 934, Nr. 15).

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimeve t'ushtrimit financjar 1933-1934 të Ministris së Financavet paksohen fondet për kapitull si vijon:

Kap. 30 Blemje e mbajtje automobili e pagë shoferi (Kryeministri)	Fr. ari 1000
Kap. 56 Kthim tatimesh, tagresh e taksash etj.	« 2000
Kap. 62 Fond rezervë	« 1500
	Fr. ari 4500

Art. 2.

Fondet prej fr. ari 4500 (katërmijepesëqindë) paksue mbas Art. 1 të kësaj ligje, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934, të Ministris së Financavet në Kap. 28 «Shpenzime Zyrje» të Kryeministris.

Art. 3.

Kjo ligjë hyn në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministri i Financavet.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarvet

D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 4500, në budgetin 1933-1934 të Ministris së Financavet, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 149/I datë 27-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Mars 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 27.

LIGJE, 14 Mars 934

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 11.400 në Kap. 41 «Rrogë jetike e shpërblim për merita patriotike» të budgetit të ushtërimit financjar 1933-934 të Ministris së Financavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Mars 934, Nr. 15).

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-1934 paksohen fondet për dikaster e kapitull si vijon:

Ministrija e Financavet		
Kap. 17 Shpenzime Zyreje (Shtëpija Ushtarake)	Fr. ari	400.—
Kap. 53 Shtypje pullash bandrollash e ngjitje pullash për shkrepsa	»	1.000.—
Ministrija e Drejtësiës		
Kap. 1 Rrogë personali mbas kuadrit etj.	»	10.000.—
	Fr.ari	11.400.—

BKSH

Art. 2.

Fondet prej fr. ari 11.400 (njimbëdhjetmijekaterqind) paksue simbas art. 1. të kësaj Ligje, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1933-1934 të Ministris së Financavet në Kap. «41 rrogë jetike e shperblim për merita patriotike.»

Art. 3.

Kjo Ligje hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministri i Drejtësis e Ministri i Financavet.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarvet

D E K R E T O N :

Aprovimin e zbatimin e ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 11.400 në Kap. 41 «Rrogë jetike e shpërblim për merita patriotike». të budgetit t'ushtrimit financjar 1933-1934 të Ministris së Financavet, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 1 164/I datë 6-III-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Mars 1934. Z O G

Kryeministri — P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis — V. AVRAMI

Ministri i Financavet — A. DIBRA

Nr. 28

LIGJE, 14 Mars 1934

Mbi shtimin e Tagrit Doganuer të disa Zanave të Tarifës Doganore të të hyemit në fuqi

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Mars, 1934, Nr. 15)

Neni 1.

Zanat e posht-shënueme të Tarifës Doganore në fuqi modifikohen si vijon:

«Nr. 365 Revolvera që nuk janë të ndalueme dhe pjesët e tyne, nga 25% ad valorem bahen 50% ad valorem.

Nr. 366. Armë:

a) gjuetije, nga 12% ad valorem bahen 50% advalorem

b) Floberta, nga 25% ad-valorem bahen 50% advalorem

Nr. 407. Automobila gjithfarësh qofshin dhe pa karoceri qi peshon sejcili:

a) 400 kg. e poshtë, nga 50 fr. ari kuintalin bahet 100 fr. ari kuintali

b) mbi 400 kg. e deri 900 kg. nga 25 fr. ari kuintalin bahet 90 fr. ari kuintali.

c) mbi 900 kg. e deri 1600 kg. nga 23 fr. ari kuintali bahet 70 fr. ari kuintali.

ç) mbi 1.600 kg. e deri 2500 kg. nga 20 fr. ari kuintali bahet 60 fr. ari kuintali.

d) mbi 2.500 kg. e deri 4.000 kg. nga 15 fr. ari kuintali bahet 50 fr. ari kuintali.

dh) mbi 4.000 kg. nga 10 fr. ari kuintali bahet 30 fr. ari kuintali.

Nr. 427. Instrumenta muzikore:

c) bori pa çelsa e pa perde

c) borijat e instrumentat me çelsa o me perde:

1) krejt metali

2) prej drunit të përzime me metale.

d) Mandolina

dh) kitara

e) qemane (violinë) etj.

Nga 10% ad valoren që të gjitha bahen 25% ad valorem.

Nr. 485. Kosmetikë pudra, pomadë, brilantine etj. si këto të pa përmenduna, nga 25% në tarifën e përgjithshme bahet 50% ad valorem.

Neni 2.

Shtesë e tagravet të përmenduna me nenin e parë në bazë të dispozitës të Statutit Themeltar Art. 142 hyn në fuqi me njiherë mbasi këjo ligjë të jetë paraqitun prej Kryesis Këshillit Ministruer Dhomës Legjislative në zarfa të mbylluna.

Neni 3.

Të gjitha mallnat që si mbas nenit parë, i u shtohet taksi, eventualisht të ndolluna nepër dogana por të pa dekllarueme për zhdoganim, randohen me gjithë shtesat e impozueme me këtë ligjë.

Neni 4.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

BKSH

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi shtimin e tagrit doganuer të disa zanave të Tarifës Doganore të të hyemit në fuqi, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 154/1 datë 20-II-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Mars 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 29

LIGJE, 14 Mars 1934

mbi krijimin e Kap. 22-ter «Subvencion e shpenzime gjithfarësh për të damtuemit prej termetit në Qarkun e Durrsit» në buxhetin e ushtërimit 1933-934 të Ministris P të Mbrendëshme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Mars 1934, Nr. 15)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së P. të Mbrendëshme krijohet Kap. 22-ter «Subvencjon për shpenzime gjithfarësh për të damtuemit prej tërmetit në qarkun e Durrësit», me nji fond prej fr. ari 10.000 (dhjetmijë).

Art. 2.

Shtesa e fondit prej fr. ari 10.000 (dhjetmijë) si mbas Art. 1 të kësaj Ligje, përballohet me paksimin e fondevet në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së Financavet nga:

Kap. 17 Shpenzime Zyreje (Shpija Ushtarake)	fr. ari	1.100.—
Kap. 19 Shpërblim Paris e Trupit të Deputetvet (Parlament)	«	2.600.—
Kap. 21 Shpenzime Zyreje (Parlament)	»	3.000.—
Kap. 23 Shpenzime udhëtimi e djete (Parlament)	»	1.970.—
Kap. 53 Shtypje pullash e bandrodhash etj.	»	500.—
Kap. 62 Fond rezerv	»	830.—
	Fr. ari	10.000,—

Art. 3.

Kjo ligjë hyn në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministri i Financavet e Ministri i P. të Mbrendëshme.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi krijimin e Kap. 22-ter «Subvencjon e shpenzime gjithfarësh për të damtuemit prej tërmetit në qarkun e Durrësit, në budgetin e ushtrimit 1933-34 të Ministris së P. të Mbrendëshme, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 163/I datë 6-III-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Mars 1934. ZOG

Kryeministri — P. EVANGJELI

Ministri i P. të Mbrendëshme — MUSA JUKA

Ministri i Financavet — A. DIBRA

Nr. 30

LIGJE, 14 Mars 1934

mbi disa modifikime e shtime në Ligjen autorizuese me datë 6-6-1927 mbi mënyrën e administrimit të monopolit të krypës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Mars 1934, Nr. 15)

Art. 1.

Art. 2 i ligjës me datë 6 Qershuer 1927 modifikohet si vijon:

«Çmimet e shitjes së krypës që përdoren për konsumasion të vëndit janë këto:

Nji kuintal krypë të bardhë	Fr. ari	30
Nji kuintal krypë të zezë	»	25

Art. 2.

Art. 3 i ligjës autorizuese me datë 6 Qershuer 1927 mbi mënyrën e administrimit të monopolit të krypës modifikohet si vijon:

«Çmimet e shitjes së krypës së bardhë e të zezë që përdoret për industrin e djathit, të peshkut e të sendeve tjera që eksporto-

BKSh

hen asht fr. ari 12 (dymbëdhjet) kuintali: Gjith' ashtu çmimi i shitjes së krypës së bardhë e të zezë që denatyrohet e përdoret për industrin kimike asht fr. ari 10 (dhetë) kuintali.

Sipërmarrësi, në bazë të nji marrëveshtje të veçantë, që Qeverija asht e autorizueme me e ba, do të punojë dhe krypë lukse, çmimi i shitjes së të cillës nuk mund të kapërcejë fr. ari 65 (gjashtëdhjetepesë) kuintali.

Art. 3.

Shtohet nji artikull me tekst si vijon:

Qeverija autorizohet me lejue Shoqënin sipërmarrëse për eksportim të krypës tue caktue, me nji marrëveshtje të posaçme, kondital mbi pjesën e fitimit që mund t'i takojë financës së Shtetit.

Art. 4.

Ministrija e Financavet autorizohet të hyjë në marrëveshtje me shoqënin sipërmarrëse për të harmonizue kontratën në konformitet me këtë ligjë.

Art. 5.

Kjo Ligjë hynë në fuqi me 1 Prillë 1934.

Art. 6.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet
DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi disa modifikime e shtime në Ligjën autorizuese me datë 6-VI-1927, mbi mënyrën e administrimit të monopolit të krypës, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 130/I datë 23-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Mars 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI — *Ministri i Financavet* A. DIBRA

Nr. 31

LIGJE, 14 Mars 1934

Mbi modifikimin e Ligjës së Tregtis, Zejtariës dhe t'Industriës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Mars 1934, Nr. 15)

Art. 1.

Ushtrimi i tregtiës dhe i zejtariës në Mbretnin Shqiptare, për

nenshtetasit lihet i lirë; sa për të huajt kjo liri ushtrohet në bazë të reciprocitetit.

Art. 2.

Ushtrimi i një industrije të ré mbas këndej do të bahet në bazë të një leje të dhanun prej Ministris s'Ekonomis Kombëtare, mbasi ma parë të jetë marrë vendimi i Këshillit Ministruer.

Për marrjen e lejes për ngrefjen e një industrije t'interesuemit do t'i drejtohen Ministris s'Ekonomis Kombëtare me nji kërkesë me shkrim. Kërkesa duhet të përmbaj llojin e industriës, fuqinë e motorit ekuivalente në kuaj, vendin ku do të ngrihet si dhe nji studim mbi rentabilitetin e parashikuem, si dhe shpjegime të tjera që paraqet rasti ose që mund të kërkojë Ministrija.

Ministria e Ekonomis Kombëtare kërkesën në fjalë së bashku me mendimin e saj j'a përcjell Këshillit Ministruer për vendim.

Art. 3.

Në mendimin e saj Ministria e Ekonomis Kombëtare do të marrë parasysh këto kondita.

1) Në se industrija për t'u ngrefun u përshtatet qyshkeve natyrale të tokës dhe të nen-tokës së Mbretniës.

2) Në se industrija asht e përfaqësueme në Mbretninë dhe produkton mjaft ose ma shumë nga sa duhet për të përballue nevojat e vendit dhe se produktet e saj qarkullojnë në tregun shqiptar me çmime t'arsyeshme;

3) Në se produktet e industriës në fjalë kanë mundësi për eksportim;

4) Në se ngrefja e industriës në fjalë rezikon qenjen e sipërmarjeve të tjera të kësaj industrije.

Art. 4.

Për efekt të kësaj ligjë kuptohet si industri një vend ku punohet ose transformohet landa e parë ose landa gjysmë e punueme, dhe ku përdoren maqina ose vegla me fuqi motori të çdo fuqije që të jetë motori.

Art. 5.

Ata që veprojnë në kundërshtim të dispozitave të kësaj Ligjë dhe ngrefin nji industri pa marrun lejen përkatse, dënohen me nji gjobë të lehtë prej 100 deri në 1000 fr. ari dhe me mbylljen e fabrikës ose t'uzinës së tyne.

Kundravajtësit e kësaj ligjë dënohen me shpejtësinë ma të

madhe jo ma vonë se dhjetë ditë prej datës së paraqitjes së proçeseve gjykatave.

Kundravajtësit mund të dërgohen në gjyqë edhe me raportë të Kryetarit t'Odës së Tregtiës.

Art. 6.

Të gjitha dispozitat e ligjës mbi rregullimin e Tregtiës, Zejtariës dhe t'industriës me datë 23 Fruer 1932 mbeten pa fuqi.

Art. 7.

Me zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Këshilli Ministruer.

Art. 8.

Kjo Ligjë hyn në fuqi me shpalljen në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi modifikimin e Ligjës të Trègëtiës, Zejtariës dhe t'Industriës, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 108/I datë 6-III-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Mars 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i P. të Mbrendshme
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
M. IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 32.

DEKRET-MBRETNUER, 14 Mars 934

Mbi zgjatimin e afatit t'akordit tregtar me Greqinë

(i botuem në Fletoren Zyrtare, 23 Mars 1934, Nr. 15).

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 92-2 datë 12-3-1934 të Kryeministris.

DEKRETON:

Zgjatimin e afatit t'akordit tregtarë me Greqinë — që muer fund me 15 të muajit të kaluem — deri më 2 Prillë 1934, për të vendosun mbrënda kësaj kohje modalitetet për zgjatimin definitiv të tij.

Tiranë 14 Mars 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. të Jashtme XH. VILA

Nr. 33.

LIGJË, 21 Mars 934

Mbi kthimin e Entit Kombtar «Djelmnija Shqiptare» në një Seksion të Ministris s'Arësimit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Mars 934, Nr. 16).

Art. 1.

Enti Kombtar «Djelmënija Shqiptare», i themeluem me ligjën 29 Mars 1932, bahet nji Seksijon'i Ministriës s'Arësimit nën emnin Seksion «Djelmënija Shqiptare» për edukatën Kombtare, morale, fizike e artistike të djelmënis.

Art. 2.

Personeli i Seksionit «Djelmënija Shqiptare» përbahet prej: Shefit dhe dy Sekretarvet me rrogë të caktueme në buxhet të Ministris s'Arsimit.

Art. 3.

Organet e Entit Kombëtarë «Djelmënija Shqiptare» Këshilli i Administratës, Drejtorija e Përgjithëshme, Inspektori i Përgjithëshëm i Organizatavet për Djelmëni, Inspektori Qendruer i Edukatës Fizike, Komiteti Kombëtar për Edukatën Artistike, Federata Sportive Shqiptare dhe Besnikët e Entit suprimohen.

Patronazhi Artistik Kombtar dhe Patronazhi Sportiv Kombtar jesin të pa ndryshuem, me perjashtim të personelit me rrogë, që suprimohet.

Krye-instruktorët e Edukatës Fizike pranë Prefekturave, Shoqatat sportive krahinare dhe degët krahinore për Edukatën Artistike jesin të pa ndryshueshme dhe në lidhje direkte me Ministrin e Arsimit.

Art. 4.

Të gjitha detyrat dhe funksionet e ngarkueme Entit Kombëtar «Djelmënija Shqiptare» me ligjën 29 Mars 1932 i vishen Ministris s'Arsimit, e cila do t'i përmbushi me fondet e buxhetit të vet.

Art. 5.

Pasunija e tundëshme dhe e pa-tundëshme e Entit Kombëtar «Djelmënija Shqiptare», i dorëzohet Ministris s'Arsimit.

Të hollat e pa shpenzueme t'Entit Kombtar «Djelmënija Shqiptare» depozitohen në Bankën Kombëtare n'êmnin e Ministris s'Arsimit. Këto të holla kanë me muejtë me u përdor vetëm për ngrehjen e stadjumit Kombëtar.

Art. 6.

Kontributi i pervjetshëm në ngarkim të Bashkive dhe të Komuneve, i caktuem me nenin 1 të Ligjës «Mbi kontributin në favor t'Entit Kombëtar «Djelmënija Shqiptare» datë 28 Kallnduer 1932, zbritet prej 7 përqind në 4 përqind për Edukatën fizike e artistike.

Ky kontribut derdhet n'Arkën e Financës prej Ministris së P. të Mbrendëshme në katër kiste në muejt: Prill, Korrik, Tetuer dhe Kallnduer të çdo viti.

Art. 7.

Dispozitat e ligjëve në kundërshtim me ketë ligjë, mbeten pa fuqi.

Art. 8.

Kjo ligjë hynë në fuqi me 1 Prillë 1934.

Art. 9.

Ministrija e Arësimit, ajo e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptrvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi këthimin e Entit Kom-

BKSH

bëtar «Djelmënija Shqiptare» në nji Seksijon të Ministris s'Arsimit e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 160/I datë 28-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 21 Mars 1934 — Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI — *Ministri i P. të Mbrendshme* MUSA JUKA

Ministri i Financavet A. DIBRA — *Ministri i Arsimit* M. IVANAJ

Nr. 34.

LIGJË, 14 Mars 934

Mbi disa ndryshime në Ligjën Organike të Ministris P. të Jashtme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Mars 934, Nr. 16).

Neni 1.

Art. 42 modifikohet kështu:

A) Kuer titullari i një Përfaqësije largohet provizorisht, me urdhën a me leje të Ministrisë, nga vëndi i nëpunësiës së tij për çështje Zyrtare, dhe ky largim vazhdon ma shumë se 15 dit, atëhere alokasioniq'itakon ndahet në këtë mënyrë: Titullari merr 1/4, Sekretari zavendës merr 1/4 dhe 1/2 i mbetet Arkës së Shtetit.

Kuer Titullari përdorë lejen prej nji mueji në vit që akordon ligja, atëhere alokasioni ndahet kështu: 1/2 merr Titullari, 1/4 sekretari zavendës dhe 1/4 i mbetet Arkës së Shtetit.

Kuer përfaqësija mbetet pa titullarë, alokasioni i këtij ndahet kështu: 1/2 merr Sekretari zavendës dhe gjysma tjetër i mbetet Arkës së Shtetit. Po me konditë që alokasioni i sekretarit zavendës i grumbulluem me këtë mënyrë të mos kalojë alokasionin e titullarit të përfaqësisë.

B) Kuer Sekretari i përfaqësisë dhe i Konsullatave largohet provizorisht nga vendi i nëpunësis së tij, me leje a me urdhën të Ministris për ma tepër se 15 dit, mer gjysmën e alokasionit dhe gjysma tjetër i mbetet Arkës së Shtetit.

Kuer Sekretari i nji përfaqësije ose i konsullatave zavendëson sekretarin e nji tjetër përfaqësije, gjer me 15 dit, mer djeten ligjore. Kur zavendësimi ngjet ma tepër se 15 dit, atëhere shpërblehet në këtë mënyrë.

a) Kuer zavendësi asht sekretar përfaqësije, merr alokasionin e

tij të plotë si dhe gjysmën e alokasionit të Sekretarit që zavendëson;

b) Kuer Sekretarija e zavendësueme asht vakante, zavendësi merr gjysmën e alokasionit, dhe gjysmën tjetër e merr Arka e Shtetit.

c) Kuer zavendësi nuk ka alokasion të vet atëhere gjer më 15 dit, mer dieten q'i cakton Ministrija, pastaj mer alokasionin e Sekretarit që zavendëson, në qoftë nëpunësija vakante. Në mos qoftë vakante, mer gjysmën e atij alokasioni dhe gjysmën tjetër i-a plotson Ministrija si dietë.

Neni 2.

Kuer nëpunësi asht vue në disponibilitet për arësyena Shtetnore e jo nga arësyena të shkaktueme prej veprimeve të nëpunësit, atëhere nga budgeti i Ministris paguhet nji rrogë disponibiliteti baras me 2/3 e rrogës origjinale të fundit. E kuer vuemja në disponibilitet nuk ka rrjedhë nga arësyena Shtetnore, atëhere rroga e disponibilitetit caktohet si mbas ligjës së pensionevet.

Vuemja në disponibilitet bahet me vendimin e Këshillit Ministruer i aprovuem me Dekret Mbretnuer.

Neni 3.

Art. 50 modifikohet kështu:

Disponibiliteti si mbas paragrafit I-rë të Art. 2 të kësaj ligje kurrë nuk mund të zgjatet ma tepër se gjashtë muej.

Mbrënda këtyne gjashtë muejve, Ministri ka të drejtë t'a ngarkojë nëpunësin të vuem në disponibilitet me nji shërbim të posaçëm ose të zakonshëm në Qendër. Kuer shërbimi asht i zakonshëm, atëhere nëpunësi qi mban titullin Kryekonsull, Chargé d'Affaires a Ministër Resident mund t'i ngarkohet drejtimi i Sekretaris së Përgjithshme; nëpunsave qi mbajnë titullin Konsull e poshtë, mund t'u ngarkohet shërbimi qi puqet me gradën qi kan.

Neni 4.

Nëpunsit në dispozicion janë të detyruem për të gjithë kohën e disponibilitetit të qindrojnë në Ministrin e P. të Jashtme, tue vazhdue rregullisht si nëpunësit e tjerë dhe të kryejnë shërbimet që do t'i ngarkohen prej Ministrit.

Dispozitë transitore

Neni 5.

Për nëpunësit e Ministris së P. të Jashtme që janë vue në dispozicion para hymjes në fuqi të kësaj ligje, në qoftë se koha e mbetme për të përmbushur të dy vjetët si pas ligjës së ma-parshme, asht ma tepër se gjashtë muej, disponibiliteti i tyne vazhdon edhe gjashtë muej që ditën e hyemjes me fuqin të kësaj ligje, dhe kuer koha e mbetme asht ma pakë se gjashtë muej, disponibiliteti i tyne vazhdon deri sa të mbushen të dy vjetët.

Neni 6.

Kjo ligjë hynë në fuqi qysh nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare dhe, zbatohet edhe për ata qi sot ndodhen në disponibilitet.

Neni 7.

Ministri i P. të Jashtme dhe aj i Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi disa ndryshime në ligjën Organike të Ministris së Punve të Jashtme, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 86-I datë 23-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Mars 1934. Z O G

Kryeministri — P. EVANGJELI

Ministri i P. të Jashtme — XH. VILA

Ministri i Financavet — A. DIBRA

Nr. 35.

LIGJË, 14 Mars 934

Mbi disa modifikime të Ligjës mbi taksën e konsunmit të sheqerit e të kafes

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Prill 934, Nr. 17).

Neni 1.

Taksat e konsumit mbi sheqernat e përmenduna në germat

«c, ç, d» të zanit «89» të Tarifës doganore në fuqi e impozueme me ligjën dat. 22-12-1926 ngrihet në 29 (njizetenandë) fr. ari për kuintal.

Neni 2.

Taksa e konsumit për kafen e zanit 72 germat «a, b, c, ç» të tarifës doganore në fuqi e impozueme me ligjën datë 2-IV-926 ngrihet në 40 fr. ari për kuintal.

Neni 3.

Taksat e përmenduna në nenin 1 e 2, nxiren nga gjithë sheqernat e kafet që do të çdoganohen që prej ditës së hymjes në fuqi të kësaj ligje.

Diferenca midis sasive të taksës së vjetër dhe të resë që caktohet me ketë ligjë, nxiret edhe nga gjithë sasitë të sheqerit dhe të kafes të cilat gjenden ende të pa konsumueme ndër depo e nëpër vende të tjera të personave të ndryshme, kuer kalojnë sasitë e poshtë-shenueme:

Sheqeri kg. 10 e lart;
Kafja « 5 e lartë.

Neni 4.

Tregtarët e personat e tjerë që mbajnë në kohën e hyemjes në fuqi të kësaj ligje sasina të shdoganueme sheqeri prej 50 kg. e lart dhe, sasina kafje prej 25 kg. e nalt, janë të detyruem me deklarue në financën e vendit mbrenda dy ditëve prej datës që do të publikohet kjo ligjë në Fletoren Zyrtare, sasinë e sheqerit e të kafes që kanë respektivisht të depozitueme për llogari të tretëve dhe vendin ku e mbajnë.

Kush ka sheqer e kafe në sasinat e sipër-treguēme e naltë e nuk kanë deklarue, nuk mund të justifikohet se malli asht i shumë personavet, tue riferue shitjeve të ma-parëshme.

Deklarata asht e përjashtueme nga taksa e pullës.

Personat që banojnë largë qendrës së financës, kanë të drejtë me ba deklaratën me anën e nji letrës së porositun, drejtue financës së vendit, në të cilen rasë vlenë si kohë plotësimi data e dhanies së letrës në postë.

Ministrija e Financavet asht e autorizueme me caktue komisionet e nevojshme për rregjistrimin e kontrollimin që do të bahet për aplikimin e shtesës së taksës.

Tregtarët që bajnë shit-blerje sheqeri, o kafje, janë të detyruem, prej datës së hymjes në fuqi të kësaj Ligje e deri me 31

Mars 1934, me mbajtë nji evidencë nga e cila të shifen sasinat që kan ble dhe prej kujt dhe sasinat që shesin dhe kujt i-a shesin.

Përjashtohen nga ky detyrim tregtarët që shesin me pakicë drejt për drejt konsumatorve.

Neni 5.

Tregtarët o tjerë persona që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj ligje, konsiderohen se kanë pasë qëllim me përvetue taksën e parapame në nenin 2 të kësaj ligje ose me ndihmue pervetimin e sajë dhe ndeshkohen si vijon:

a) ata që zotnojnë sheqer në sasina prej 50 kg. e nalt ose kafe në sasina prej 25 kg. e nalt e nuk bajnë deklaratë, ndeshkohen me konfiskimin e mallit dhe me burgim deri në tre muej:

b) ata që mbajnë sheqer në sasina prej 50 kg. e nalt ose kafe në sasina prej 25 kg. e nalt për llogari të tretëve e nuk bajnë deklaratë, kur rezulton se kafja e sheqeri nuk asht deklarue as prej zotnuesit, konsiderohen ndihmues dhe ndëshkohen përveç zotnuesit që ndëshkohet si mbas paragrafit a) të këtij neni, me burgim gjysmën e kohës që i përket autorit principal (zotnuesit).

c) ata që banjë deklaratë kundra së vërtetës, ndëshkohen me konfiskimin e sasisë së pa-deklarueme, gjith'ashtu autorët principal me burgimin e shenjuem në parag. a), dhe ndihmuesit me burgimin e parapamë në paragrafin b) të këtij neni;

ç) ata që mbajnë sheqer prej 10 kg. e nalt por ma pak se 50 kg. si edhe ata që kanë kafe 5 kg. e nalt por jo 25 kg. dhe nuk i deklarojnë komisionit të rregjistrimit o të kontrollimit të vërtetën, gjobiten me dy fish shtesën e taksës veç taksës për t'u inkasue si mbas nenit 1);

d) ata që nuk shenojnë shit-blerjet e sheqerit e të kafes si mbas kësaj ligje, konsiderohen se kanë pasë qëllim me mbulue ndonji sasi malli të pa deklaruem, dhe gjobiten me fr. ari 50 deri 500 (pesqind).

Neni 6.

Procedura për zbatimin e kësaj ligje, asht ajo e caktueme me ligjën 17 Qershuer 1928 mbi ndalimin e kontrabandave.

Mallnat e konfiskueme si mbas kësaj Ligje, shiten me nji herë ndërmjet t'interesuemve si mbas nenit 34 të ligjës mbi ndalimin e kontrabandavet

Neni 7.

Ministrija e Drejtësis, e Financavet dhe e P. të Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

Neni 8.

Kjo Ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptrvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi disa modifikime të ligjës mbi taksën e konsumit të sheqerit e të kafes, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 144/I datë 27-II-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Mars 1934. ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 36.

LIGJE, 21 Mars 934

Mbi formimin e Trupit Gjykues të Gjykatës së Posaçme për faje Politike

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Prill 934, Nr. 17).

Neni 1.

Gjyqi i Posaçëm për Faje Politike, formohet prej një Kryetari Ushtarak me gradë jo ma t'ulët se Major, dy Antarë Ushtarak me gradë jo ma t'ultë se Kapiten i Kl. II-të dhe, dy antarë Civilë të zgjedhun midis funksionarëve të Drejtësis Civile dhe Ushtarake dhe Nëpunsave t'Administratës Qendrore që kanë gradë dhe rrogë jo ma pak se Ndihmës-Gjyqtari Filluer, të emruar që të gjithë me Dekret-Mbretnuer.

Neni 2.

Mbrënda një mueji, prej datës së hyemjes në fuqi të kësaj ligje, dhe në muejin Dhetuer të çdo viti, Ministrija e Drejtësiës, Ministrija e Punëve të Mbrendëshme dhe Komanda e Mbrojtjes Kombëtare, i proponojnë Mbretit për dekretim Gjyqtarët e zgjedhun si dhe një Antar Ushtarak dhe një Civil si Antarë suplementarë, për periudhën që me 1 Jenar deri më 31 Dhetor të çdo viti.

BPSH

Neni 3.

Detyra e personelit shkrues të gjyqit posaçëm, kryhen prej sekretarëve të asaj gjykate, dhe në rast nevoje dhe prej sekretarëve të gjykatës Ushtarake, ose prej ndo nji sekretari tjetër t'administratës qendrore, t'autorizuem prej Ministriës së P. të Mbrendëshme ose të Drejtësiës.

Neni 4.

Personeli Gjykues dhe Sekretarët e nalt-shënuem nuk kanë të drejtë shpërblimi të posaçëm posë rrogave origjinale të tyne.

Neni 5.

Dispozitat e ligjës mbi Faje Politike dhe Shtojca e saj që vijnë në kundërshtim me këtë ligjë, mbeten pa fuqië.

Neni 6.

Kjo ligjë hynë në fuqi me 1 Prillë 1934.

Neni 7.

Ministrija e Drejtësiës dhe ajo e P. të Mbrendëshme, ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptrvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi formimin e Trupit Gjykues të Gjykatës Posaçme për Faje Politike, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 172-I datë 12-3-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 21 Mars 1934 — ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 37.

LIGJË, 14 Mars 934

Mbi lidhjen e një rroge jetike familjes së Qamil Balës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Prill 934, Nr. 17).

Art. 1.

Pjestarve të familjes së Qamil Balës i lidhet nji rrogë jetike

prej fr. ari 150 (njiqindepesdhetë) në muej, pjestue për frymë si vijon:

Remzije e shoqja Fr. ari 70 — (shtatëdhetë)
Tomorri i biri d. l. 1932 « 40 — (dyzet)
Nimet e bija « 40 — (dyzet)

Art. 2.

Pagesa e rrogës jetike, lidhë me art. 1 të kësaj ligje, vazhdon për të shoqen e të bijën deri në ditën e martesës ose të vdekjes, e për të birin deri sa t'arrijë moshën madhore, e, në qoftë student, deri në përfrundimin e studimeve.

Në rasë se e shoqja humbë të drejtën e rrogës 50% (pesëdhetëpërqind) të pjesës së sajë shkojnë në favor t'Arkës së Shtetit e 50% (pesëdhetëpërqind) në favor të birit e të bijës në pjesë të njinjishme.

Kur i biri ose e bija humbë të drejtën e kësaj rroge, pjesa e tij ose e sajë shkon në favor t'Arkës së Shtetit.

Art. 3.

Kjo Ligjë hyn në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Ministri i Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligjë.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve
D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi lidhjen e nji rroge jetike familjes së Qamil Balës, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 159/I datë 6-III-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Mars 1934. Z O G

Kryeministri *Ministri i Financavet*
P. EVANGJELI A. DIBRA

Nr. 38.

LIGJË, 21 Mars 1934

Mbi interpretimin e Nenit 2 të Ligjës mbi krijimin e letrës me vleftë të Kryqit të Kuq

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Prill 1934, Nr. 18).

Neni 1.

Fjala «Kontratë», që përmbahet në nenin 2 të Ligjës mbi kri-

jimin e letrës me vleftë të Kryqit të Kuq me datë 12 Fruer 1929, ka kuptimin e kontratave të qirave mbi sendet e pa-lujtëshme.

Neni 2.

Ministrija e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e kësaj.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi interpretimin e nenit 2 të Ligjës mbi krijimin e letrës me vleftë të Kryqit të Kuq, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 170/I datë 12-III-1934 të Kryesis së Tij.

Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis V. AVRAMI

Nr. 39.

LIGJË, 21 Mars 1934

Mbi modifikimin e $ të I-rë të Nenit 107 të Ligjës mbi aktet e gjendjes Civile

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Prill 1934, Nr. 18).

Neni 1.

Verifikimet që përmenden në nenin 107 të ligjit mbi aktet e gjendjes civile, bahen vetëm një herë në vjetë.

Për t'u ba verifikimi, Kryetarët e Komuneve, detyrohen në muejin Janar të ç'do vjeti, të paraqesin radhorët dhe aktet në Gjykatën Paqtuese përkatëse.

Neni 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Ministrija e Drejtësis dhe ajo e P. të Mbrendëshme ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi modifikimin e $ të I-rë

të nenit 107 të ligjës mbi aktet e gjendjes civile, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 168/II dat. 12-III-1934 të Kryesisë së Tij.

Tiranë, me 21 Mars 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 40.

LIGJË, 21 Mars 1934

Mbi shpenzimet e udhetimit dhe diete e funksionarëve Gjyqsuer në çeshtje Civile

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 7 Prill 1934, Nr. 18).

Neni 1.

Funksionarët Gjyqsuer, Përmbaruësat dhe Sekretarët e Gjykatavet, kuer largohen nga Qendra për kqyrje direkte ose ekspertime ose eksekutim të vendimeve ose për çdo rast tjetër, kanë të drejtë shpenzimesh udhëtimi e djete konformë ligjës mbi shpenzimet e udhëtimit e diete të nëpunësavet të Shtetit, edhe sikur të kthehen mbrenda ditës në qendrën e tyne.

Neni 2.

Paragrafi i I-rë i nenit 23 të Ligjës mbi gjykimin e shpejtë të padinavet posedimore, si dhe çdo dispozitë tjetër që asht në kundërshtim me këtë ligjë, mbeten pa fuqië.

Neni 3

Kjo Ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 4.

Ministrija e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi shpenzimet e udhëtimit dhe dijete të Funksionarëve Gjyqsuer në çashtje Civile, e votueme

BKSH

prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 169/I datë 12-III-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 21 Mars 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Nr. 41.

LIGJË, 7 Prill 1934

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 12.750 në budgetin e ushtërimit 1933-934 të Ministriës së. P. Mbrendëshme (Drejtoria e P. e Shëndetsis)

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Prill 1934, Nr. 19).

Neni 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1933-934 të Ministris së P. të Mbrendëshme e të Drejtoriës së P. të Shëndetsis pakësohen fondet për kapitull si vijon:

Kap. 12. «Rrogë personeli zavendësije etj.	Fr. Ari 2.000
Kap. 19 «Dispanseri etj»	« 6.500
Kap. 20 «Instituti qëndruer Higjenik etj.»	« 3.500
Kap. 21 «Bursa për specializim mjekësh, etj.»	« 750
	Fr. Ari 12.750

Art. 2.

Fondet prej fr. ari 12.750 (dymdhjetëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë) pakësue si mbas art. 1 të kësaj ligje, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së P. të Mbrendëshme e të Drejtoris së P. të Shëndetsis nën:

Kap. 13 «Shpenzime udhëtimi e dijete»	Fr. Ari 750
Kap. 17 «Spital'i Përgj. ZOG i I-rë»	« 12.000
	Fr. ari 12.750

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministri i P. të Mbrendëshme dhe ay i Financavet.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptrvet
DEKRETON:

Aprovimin e zbatimin e Ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 12.750 në budgetin e ushtrimit 1933-934 të Ministris së P. të Mbrendëshme, Drejtoris së P. Shëndetsis, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 19/I datë 24-III-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 7 Prill 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. të Mbrendëshme MUSA JUKA

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 42.

LIGJË, 31 Kallnduer 1934

Për përjashtimin prej taksës doganore të farnave të seleksionueme të nevojëshme për përmirësimin e prodhimit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Prill 1934, Nr. 19).

Art. 1.

Përjashtohen nga taksat doganore e bashkiake: gruni, elbi, thekna, tërshana, misri, orizi dhe patatet e seleksionueme për farë qi Ministrija e Ekonomiës Kombëtare do të importojë për llogari të vet e të bujqëve.

Art. 2.

Farnat e treguara n'art. 1, shpërndahen pas si të denatyrohen prej Ministris s'Ekonomis Kombëtare me një solusion qi do të caktojë në marrëveshje me Ministrin e Financavet. Shpenzimet e denatyrimit u ngarkohen farë-marrësve dhe parapaguhen prej Ministris s'Ekonomis Kombëtare.

Art. 3.

Farnat e sjelluna pa taks doganuer, kuer nuk përdoren për farë, konsiderohen kontrabandë.

Art. 4.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare dhe ajo e Financavet kanë me caktue rregullat për zbatimin e kësaj ligje.

Art. 5.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministrija e Ekonomis Kombëtare, Ministrija e Financavet, Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Drejtësis.

Art. 6.

Kjo Ligjë hynë në fuqi prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi përjashtimin prej taksës doganore e të farnavet të seleksionueme të nevojshme për përmirësimin e prodhimit, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 107/I datë 26-I-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë me 31 Kallnduer 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Dretjësiës
V. AVRAMI

Ministri i P. të Mbrendëshme
Zav. Ministri Ekonomis Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 43.

LIGJË, 7 Prill 1934

Mbi bartjen e fondit prej fr. ari 3000 në budgetin e ushtrimit 1933-934 të Ministris së Drejtësis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 16 Prill 1934, Nr. 20).

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimeve t'ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së Drejtësis paksohet nji fond prej fr. ari 3000 (trimijë) në Kap. I «Rrogë personeli mbas kuadrit, rrogë zavendësije, etj».

Art. 2.

Fondi prej fr. ari 3000 (tremijë) paksue si mbas Art. 1 të kësaj Ligje, i shtohet Kap. 5 «Shpenzime hetimesh e dëshmitarësh dhe për beneficin e vobeksiës» të gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së Drejtësis.

Art. 3.

Këjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpaljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministri i Drejtësisë.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptrvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi transferimin e nji fondi prej fr. ari 3000 në budgetin e ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së Drejtësis, e votueme prej Parlamentit, simbas shkresës Nr. 212/I datë 24-3-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 7 Prillë 1934. Z O G

Zav. Kryeministri
Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 44.

LIGJË, 31 Kallnduer 1934

Mbi detyrat dhe të drejtat e personelit Nenoficer e Trup t'Armës së Gjindarmeris Mbretnore perkitas gjendjes së tij

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Prill 1934, Nr. 21).

KAPTINA I.

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Personeli Nënoficer'e Trupë i Armës së Gjindarmeris Mbretnore ndahet në: ushtarake me shërbim të përhershëm dhe ushtarak në lirim të pa kufizuem.

Janë të kategoris së përhershme ata që ndodhen efektivisht në shërbim t'Armës. Janë të kategoris në lirim ata që o me vullnet të tyne ose për mbas dispozitave ligjore janë largue nga shërbimi efektiv.

Neni 2.

Emnimet dhe gradimet e personelit Nenoficer' e Trupë t'Armës së Gjindarmeris Mbretnore, bahen me vendim të Komandës Përgjithshme t'Armës.

KAPTINA II.

PRANIM NË SHËRBIM T'ARMËS

Neni 3.

Grada gjindarmë n'Armë, katerogizohet në 3 klasë: nxanës gjindarmë, gjindarmë i kl. II-të dhe gjindarmë i kl. I-rë.

Neni 4.

Nxanës gjindarmë quhen kandidatët për gjindarmë që pranohen nga jeta civile në Kursin e gjindarmeve të Shkollës Gjindarmeris.

Nji shtetas, për t'u pranue në Kursin e Gjindarmëve të shkollës Gjindarmeris, duhet me pasë kushtet që vijojnë.

1) me kenë me moshë ma i madhë se 20 e ma i vogël se 30 vjeç;

2) të kenë nji naltësi shtati jo ma të vogël se m. 1.50 dhe gjansi krahnori jo ma pak se m. 0.80;

3) me dijtë me folë, me shkrue e me këndue mirë gjuhën shqipe;

4) me pasë krijesën fizike të shëndosht e të fortë dhe pa mungesë;

5) të mos kenë vuejt ndëshkime përlyese të karakterit e të nderit;

6) të jenë me sjelje morale e politike, të mira;

7) preferohen të pa martuemit ose ata që janë të vejë, por pa fëmijë të vegjël dhe në qoftë ndonji që të ketë shërbye si graduat ndër Armët e Trupat e tjera ushtarake, duhet me heq dorë nga ajo gradë.

Neni 5.

Në rast që vakancat e ç'faquna në kuadrin e përgjithshëm. nuk do të jetë e mundun të plotsohen me gjindarmë të kl. I-rë, rekrutohen gjindarmë të kl. II-të tue u pranue prej jetës civile direkt në shërbim të gjindarmeris nga shtetasit e pajosun me kushtet e tregueme në Nenin 4, por mbasi të kenë pasë krye shërbimin e detyruem ushtarak.

Neni 6.

Gjindarmët e Klasës I-rë, rekrutohen prej nxansave që kryejnë me sukses Kursin përkatës në shkollën e Gjindarmeris.

Neni 7.

Shtetasit dishruesa për n'Armën e gjindarmeris Mbretnore

duhet të bëjnë lutje me letër të taksueme e t'i a paraqesin Qark-Komandës së vend-lindjes a banimit tyne, e cila mandej duke i a drejtue autoriteteve përkatëse, ka m'u interesue për plotsimin e dokumentave që vijojnë me letër të pa taksueme:

1) Akt vertetimi mbi akt lindjen familjare dhe sjelljet lëshue nga ana e Kryetarit Bashkisë ose Katundaris së vend-lindjes ose të banimit përhershëm të tij;

2) Dishmi penaliteti lëshue prej Sekretaris të Gjyqit Shk. I-rë përkatës të juridiksionit në të cilin dishruesi ka lindun ose ka banimin e përhershëm të tij dhe e vistueme nga an'e Prokurorit të Shtetit;

3) Raport mjeksuer lëshue prej dy a ma tepër mjekësh ushtarakë, e në mungesë të këtyne, prej mjekësh zyrtarë a po të Bashkis ku për veç shënimeve mjeksore, kanë me tregue edhe naltësin e gjanësin e trupit të dishruesit, i cili ka me u marë me kambë zbathë e me krye e krahnuer të zbuluet.

4) Dishmi rekrutimi për dishruësit që nuk kanë pa shërbim ushtarak ose kuer i mungon dokumenti vërtetues për të kryemit e shërbimit ushtarak. Në rast që të kenë krye shërbimin ushtarak duhet t'i bashkanjitin lutjes së tyne letrën e lirimit;

5) Dorëshkrimi i përbam të pakën prej pesë rrjeshtash;

6) Raport mbi aftësin e përgjithshme morale, politike e fizike lëshue nga an'e Rreth Komandantit të vëndit.

Neni 8.

Dishruesit për n'Armën e Gjindarmeris, para se të meren në forcë, u bahet edhe nji vizitim mjeksuer i dytë. Në qoftë se në përfundim të këti vizitimi do të konstatohet ndonji mungesë ndër formalitete, do të plotsohen, por kuer ky plotsim nuk asht i mundëshëm dishruesi nuk pranohet. Në rast që vizitimi i dytë përfundon në favor të dishruesit, duhet që ky të kontraktojë nji qindresë në shërbim për tre vjet rresht, nëse nxanës gjindarmë, dhe për nji vit nëse gjindarmë i Kl. II-të, i till kontraktim kishte me u qujtë i pa fuqishëm për nxanës-gjindarmët, të cilët në mbarim të Kursit nëse kishin me u deklarue të pa aftë për në shërbim të gjindarmërisë.

Neni 9.

Në mbarim, akt-formalitetet që janë në rregull, i paraqitën Komandës Përgjithshme, e cila mbasi q'i regjistron me radhë kronologjike, i ruen në arshivën përkatse deri në përdorim të

tyne. Në rast që nji palë formalitete nuk vehen në përdorim, mbas nji vjeti rëzohen nga fuqija.

KAPTINA III.

PLOTSIM'I GRADUATVE

Neni 10.

Vakancat e çfaquna në gradën Tetar plotsohen vetëm prej gjindarmve të Kl. I-rë në Kurs; në gradën Reshter plotsohen vetëm prej Tetarve që kanë krye me sukses kursin prej nand-muejve të Nënoficerave në shkollën e Gjindarmëris Mbretnore, dhe ato në gradën Kapter II-të e Kapter I-rë plotsohen rispektivisht prej graduatve të nji gradës ma të vogël se ajo që paraqet vakanca.

Neni 11.

Me rastin e kalimit në nji gradë ma të naltë, tue zanë fillë prej datës së gradimit a t'emnimit, graduatët kanë me kontraktue qindresë të re.

KAPTINA IV.

PRANIMI NË SHKOLLËN E GJINDARMËRIS MBRETNORE

Neni 12.

Skholla e Gjindarmeris Mbretnore asht e përbame prej dy Kursash njani prej gjashtë muejsh për me përmbushë kuadrin e personelit Trupë, e tjetri prej nandë muejsh për me përmbushë kuadrin e personelit Nënoficerë t'Armës.

Neni 13.

Për veç sa asht thanë në nenin 4, me qëllim që t'emrohen gjindarmë të kl. I-rë e t'aftësohen për rritje në gradën Tetar, pranohen në Kursin e gjindarmëve edhe nga gjindarmët e Klasit parë e të dytë, që janë në shërbim e që s'kanë baëm ndonji kurs, por me kusht që të dinë me shkrue e me këndue mirë gjuhën Shqipe, gjatë shërbimit të kenë mbajt sjellje të mira të jenë në moshë ma të vogël se 30 vjeç dhe gjindarmët e klasit II-të duhet të kenë plotsue të pakën nji vit shërbim n'armë.

Për frekuentimin e Kursit të Gjindarmëve do të preferohen ma parë gjindarmët në shërbim, e në mungesë të këtyne, meren nga jeta civile nxanës gjindarmë. Midis gjindarmëve në shërbim do të preferohen ata me kulturë ma të madhe, ata që ndër armët e trupat e tjera kanë qënë graduatë dhe ata të cilët janë çpërblye

BKSH

për meritë speciale. Gjindarmët që për keq sjellje tre herë me radhë gjykohen të pa aftë për frekuentimin e kursit përkatës, qiten në lirim.

Neni 14.

Frekuentuesat e Kursit të Gjindarmëvet të kategoris të marrun prej jetës civile, në rast se në provimin e mbarimit të kursit nuk gjykohen t'aftë me u emnue gjindarmë të kl. I-rë nxiren nga shërbimi dhe ata të kategoris së marrun prej gjindarmëve të Kl. II-të në shërbim, lihen po në atë klasë në se do të premtojë kuadri i gjindarmve të Kl. II-të. Gjindarmët e Kl. I-rë që s'kanë pae kurs, nga provimi i fundit pranë shkollës në qoftë se gjykohen t'aftë për gradim, shtihen në kuadrin e arritjeve të vitit që u takon me u gradue, për atë që për t'u gjykue të pa aftë për gradim mbahet shënim në biografin e tyne me qëllim që t'u llogaritet nër të tri herët që kanë të drejtë me dhanë provim për gradim.

Pranimi në kursin e gjindarmve bahet për nji herë të vetme e nuk mund të përsritet.

Neni 15.

Edhe në Kursin e Nënoficerave të Shkollës Gjindarmërisë Mbretnore pranohen nxansa si për efekt gradimi ashtu dhe për efekt perfeksionimi.

Për efekt gradimi pranohen vetëm nga Tetarët e pajosun me kushtet që diftohen nër nenet e ma poshtme dhe, për efekt prefeksionimi nga Nënoficerat pa kurs qi gjinden në shërbim të përhershëm t'Armës

Neni 16.

Pranim'i Tetarve për efekt gradimi, në Kursin e Nënoficerave bahet me vjetërsi të gradës që mbajnë, e cila nuk duhet me kenë ma e ultë se nji vit. Të tillë Tetarë duhet të dijnë mirë me shkrue e me këndue gjuhën shqipe të kenë rrëfye zotsi në përmbushjen e detyrës në gradën Tetar dhe të jenë në moshë ma të vogël se 32 vjeç. Midis personelit kandidat për frekuentimin e kursit të Nënoficerave do të preferohen ata me kulturë ma të madhe, ata që kanë pasë mveshun grada të ndryshme ndër Trupat e armve tjera dhe ata të cilët janë çpërblye për merita speciale.

Kuadri numerik dhe emnuer i këtyne Tetarve caktohet prej Komandës Përgjithëshme t'Armës së pakut nji muej para çeljes së shkollës.

Neni 17.

Tetarët që, për çdo shkak dënohen disiplinarisht brënda nji vjeti me ma shumë se 25 dit burgim ose, që gjykohen të pa aftë nga an'e Komandës urdhënuese të tyne për frekuentimin e Kursit, përjashtohen nga kjo e drejtë për vitin që do të frekuetojnë shkollën.

Përjashtohen nga të marrunit pjesë në kurs edhe ata Tetarë të cilët gjinden në pritje të nji gjykimi penal.

Tetarët të cilët, për arysenat e ma sipërme, në qoftë se gjykohen të pa aftë për frekuentim të shkollës tri herë me radhë, përjashtohen prej shërbimit përhershëm t'Armës.

Neni 18.

Nënoficerat në shërbim e që s'kanë paë kurs, tue pasë konditat e përmenduna për Tetarët në Nenin 17, kanë me u dërgue me radhë në shkollë e me qëllim perfeksionimi.

Neni 19.

Frekuentuesit e kursit të Nënoficerave, për efekt perfeksionimi, nga provimet që do të japin në mbarim të Kursit në qoftë se gjykohen t'aftë për t'u ritë në gradë ma të naltë, shtihen n'kuadrin e ritjeve të vitit që si mbas vjetërsis tyne u takon m'u gradue, për ata të cilët kanë për t'u gjykue të pa aftë për t'u ritë me nji gradë ma të naltë, të cilët, qofshin edhe për efekt emnimi, kanë për t'u mbajtë shënim në biografin e tyne me qëllim që t'u llogaritet nër të tre herët që kanë të drejtë me dhanë provim për gradim.

Neni 20.

Pranimi në kursin e Nënoficerave bahet për nji herë të vetme dhe nuk mund të përsëritet.

KAPTINA V.

RIPRANIM NË SHËRBIM T'ARMËS

Neni 21.

Munden me u ripranue në shërbim t'Armës së Gjindarmëris Mbretnore vetëm ushtarakët e Armës Nënoficer'e Trupë lanë ma parë në lirim të pa kufizuem jo me fuqi ligjore e pa ndonji çpërblim të cilët të mos kenë tej kalue të 35-tën vjet të moshës së tyne, në se kanë krye shërbimin ushtarak, të paktën të kenë pasë shërbye n'Armë tri vjet rresht dhe të kontraktojnë qindresën për

tri ose nji vjet tuej zanë fill prej datës ripranimit në shërbim t'Armës.

Ushtaraku që ripranohet në shërbim të përhershëm i Armës, pa pasë të drejtë pretendimi mbi vjetërsiën absolute të ma parëshme, ka me i u njoftë këjo vjetërsi nga data e ripranimit dhe do të shtihet në fund të listës së shkallzimit të gradës së vet. Por kjo dispozitë nuk i cenon aspak vjetësiën e maparëshme për t'u llogarit nër vjetët e shërbimit të vlefshëm për pension.

Në kuadrin e gradës t'ushtarakut në lirim, kandidatët për ripranim në shërbim të përhershëm, në mos pastë vend të çelët dhe kandidati në qoftë se dëshiron, mund të pranohet me nji nga gradat ma të vogla kuer në kuadrin e këtyne të ketë vend të çelët.

Neni 22.

Lutjet e ripranimit bashkë me letrën e lirimit nga shërbimi i Armës, duhet t'u drejtohen Komandave të Qarkut që përshijnë vend-lindjen a banimin e përhershëm të tyne. Komandat në fjalë duke i u drejtue autoriteteve përkatëse, kanë m'u interesue për plotsimin e dokumentave që vijojnë:

a. — Kuer ushtaraku të ketë kalue vjetin në lirim:

1) dokumentat e parapame prej n. n. 1) 2(e 3) të Nenit 7;

2) dishmië aftësije dhe sjelljesh në detyrë;

3) nji akt-vërtetues mbi provimin e bamun vetëm për dëshiruesat për graduat, për me i kuptue në se ruejnë ende dijenin teknika profesionale t'Armës:

b. — Kuer ushtaraku të mos ketë kalue vjetin në lirim:

1) dokumentat e parapame prej n. 2 e 3 të Nenit 7:

2) dokumentin e parapaem prej n. 2 të germës a, të këti Neni.

KAPTINA VI.

SHKALLA E NËNRENDIMIT:

Neni 23.

Shkalla e nënrendimit gjerargjik n'Armën e Gjindarmëris Mbretnore në barazim me t'Armëve të tjera, ashtë si vijon:

1) Nx. gjind. dhe gjind. Kl.	II-të Usht.	Trupa
2) Gjindarmë i Kl. I-rë	Tetar	
3) Tetar	Nëntetar	
4) Reshtar	Reshtar	
5) Kapter i Kl. II-të	Kap. kl. I.	N-Oficer
6) Kapter Kl. I-rë	Kap. kl. II.	

KAPTINA VII.

QINDRESA E RIQINDRESA

Neni 24.

Kontraktimet në shërbim t'Armës bahen për mjet qindresash e riqindresash.

Qindres quhet kontraktim'i ushtarakut në shërbim t'armës me rastin e emnimit të gradimit, e cila përbahet prej tre vjet rresht për graduat e Gjindarmët e Kl. I-rë, e prej nji vjeti për gjindarmët e Kl. II-të.

Riqindresë quhet çdo kontratkim në shërbim t'Armës me rastin e plotësimit të qindresës. Edhe këto janë rispektivisht të trivjetshme dhe të përvjetëshme.

Si qindresat ashtu edhe ri-qindresat, autorizohen prej Komandës P. t'Armës.

Neni 25.

Nga ri-qindresat trivjetore përfitojnë vetëm graduatët e gjindarmët kursista pasi të kenë plotësue qindresën e trivjetëshme. Graduatët e gjindarmët e kësaj kategorije, mundën me u pranue në tri riqindresa suksesive pa as nji kufizim moshe.

Ushtarakët që paraqesin lutje për me ri-qindrue në shërbim t'Armës, duhet të kenë këto kondita:

1) Të kenë mbajtë sjellje të mira gjat kohës së shërbimit n'Armë;

2) Të kenë dhanë prova zotësije në detyrë dhe aftësije në dijeniën teknike-profesionale;

3) Të kenë aftësi fizike përshtatas mundimeve në shërbim t'Armës.

Neni 26.

Ushtarakve që përfitojnë nga riqindresat e trivjetshme, me rastin e kontraktimit të riqindresës parë, i u epet nji shtesë mbi rrogën e përmujshme origjinale të gradës prej fr. ari 5 (pesë) me rastin e kontraktimit të riqindresës dytë i'u epet nji shtes mbi rrogën e përmuejshme origjinale të gradës prej fr. ari 8 (tetë) dhe me rastin e kontraktimit të ri-qindresës tretë u epet nji shtes mbi rrogën e përmuejshme origjinale të gradës prej fr. ari 10 (dhetë).

Sa për kohën tjetër që të nalt-përmendunit kanë me vazhdue në shërbim si dhe ushtarakve pa kurs ose atyne që nuk kanë ka-

lue kursin me sukses e mbahen në sherbim me kontraktim të përvjetshëm, nuk u përket as nji shtesë rroge.

Neni 27.

Riqindresat e përvjetshme, për veç graduatve pa kurs e gjindarmëve të kl. II-të u lejohen edhe ushtarakve që kanë plotsue të tri ri-qindresat e trivjetëshme dhe, me titull përmirësimit të shëndetit, atyne që, në mbarim të qindresës e të riqindresës së parë e të dytë, nuk gjinden ndër kondital aq të mira shëndetsore për arësye sëmundjesh të marruna në shërbmi.

Neni 28.

Si qindresat ashtu dhe riqindresat munden me u anulue prej Komandës P. t'Armës, për shkaqe me randësi, si ligjore ashtu private t'ushtarakut kontraktues mbasi të jetë marrë vendimi i komisionit formuem në bazë të nenit 41 të kësaj ligjë.

Neni 29.

Ushtarakët që dëshirojnë me kontraktue riqindresë, duhet të paraqesin lutjet e tyne dy muej para mbarimit të qindresës riqindresës së parë e të dytë. Në rast se lutja i meret parasysh i Komunikohet pranimi dhe lutja që ka paraqit zën vëndin e dishmiës vetjake me të cilën detyrohet me shërbye si mbas rastit tri ose nji vjet shërbim të vazhdueshëm n'Armën e Gjindarmëris Mbretnore.

KAPTINA VIII.

VJETËRSIJA NË GRADË

Neni 30.

Vjetërsija asht absolute dhe relative.

Vjetërsija absolute quhet ngjatja e qindrimit në gradë, me përjashtim të shtim e paksimeve në bazë dispozitash ligjore.

Vjetërsija relative quhet ajo e cila cakton shkallëzimin po t'asaj grade.

Neni 31.

Për efekt gradimi dhe shkallëzimi të çdo grade Komanda e P. e Armës duhet të mbajë nji rregjistër të veçantë për secilën gradë.

Për me caktue shkallëzimin e çdo graduati ndër rregjistrat e vjetërsiës, meret për bazë vjetërsija absolute e gradës, për veç në qoftë disponue ndryshe në urdhënin e gradimit. Në njisi të vjetërsisë absolute, meret për bazë vjetërsija absolute e gradëve ma të përparëshme, në njisi të kësaj rregulle, merret për bazë klası-

fikimi i fituem në kurs, në rast që konkurentat do të jenë të nji kursi; në mungesë të klasifikimit merret për bazë mosha ma e madhe dhe në njisi të moshës, merret për bazë rendimi alfabetik i emnit e masandej i mbiemnit. Në këtë mënyrë mbërihet shkallëzimi i vjetërsiës relative.

Atëhere kurse vjetërsis absolute në gradë ka për t'i a ba nji shtim a paksim, dat'e vjetërsis shtyhet rispektivisht mbrapa ose para datës ma parëshme aq vjet, muej ose dit baras atyne të periudhës që duhet me u llogarit në shtim ose në paksim.

Neni 32.

Në llogarin e vjetërsis absolute duhen rrëzue:

1) Koha e pezullimit nga mungesa për efekt të nji dënimi penal;

2) Koha e kalueme në pritje të nji gjykimi penal ose disiplinuer që përfundon në dënim;

3) Koha e kalueme në vuajtjen e nji dënimi penal, i cili tej kalon muejin e nuk ka për efekt çrregjistrimin e të dënuemit;

4) Koha e kalueme në lirim të pa kufizuem;

5) Koha e kalueme në leje të pa kufizueme që tej kalon të gjashtë muejët vazhdimisht; për veç nëse leja të jetë dhanë për lezjon ose infirmitet të rrjedhun për shkaqe shërbimi;

6) Koha e kalueme në leje të jashtzakonshme për shkaqe vetjake.

KAPTINA IX.

RRITJA NË GRADË

Neni 33.

Rritja në gradë bahet me zgjedhje e me vjetërsi, po në të dyja rastet duhet që të ket vende të çelta në kuadro dhe kandidati t'i shtrohet nji provimit.

Ritja me zgjedhje u përket vetëm Tetarve e Gjindarmëve të klasit parë, të cilëve u jepet rasti provimit pa as nji caktim vjetërsiës dhe ata që gjykohen të aftë riten në bazë të listës shkallëzimit tyne.

Ritja me vjetërsi u përket vetëm Nënoficerave, të cilët kanë m'u ritë në bazë të listës shkallzimit të çdo grade dhe në bazë të vjetërsis që ka me caktue ma parë Komanda e Përgjithshme e Armës si mbas nevojës që asaj ka me i'u çfaq.

Neni 34.

Për me fitue të drejtën e provimit dhe gjykimit për gradim,

Tetarët dhe gjindarmët e klasit I. për veç që duhet të kenë krye me sukses kursin përkatës por duhet që të parët të kenë ushtrue, po me sukses komandën e nji postës dhe ty dytët detyrën e nji Ndihmës Post-komandanti për nji kohë jo ma pak se tre muej e kryeme vazhdimisht ose në dy perioda me nga 45 ditë.

Neni 35.

Provimi dhe gjykimi i kandidatve për rritje, ka me u mbështet:

I. Për Tetarët dhe gjindarmët e klasit I.

a) n'aftësi praktike morale;

b) në rezultatin e provimeve të dhanuna në mbarim të kursit përkatës;

c) në zhvillim të nji teme me shkrim.

II Për Nënoficera:

a) n'aftësi praktike morale;

b) në nji provim me goj mbi landët që caktohen ma poshtë;

c) në zhvillim të nji teme me shkrim.

Neni 36.

Për gjykimin e aftësiës praktike morale do të ekzaminohen dokumentat matrikullore e karakteristike duke marë për bazë:

a) stervitjen dhe edukatën elementare;

b) shkallën e zotësiës praktike në shërbim;

c) nëse ka pas shërbye si graduat ndër armë e trupa tjera;

ç) Inteligjencën;

d) Energjinë;

dh) sjelljet morale në përgjithësi.

Neni 37.

Landët mbi të cilat nji kandidat ka për t'u provue me gojë janë:

a) Profesjonale	Ligja organike e Armës Rregullore sherbimit t'Armes Rregullore shkresoris Armes.
b) Administrative	Ligja e Administratës Civile Ligja e Katundarive
c) Gjyqsore	Kodi Penal Komun Presendura Penale
ç) Ushtarake	Kodi Penal Ushtarak Rregullore disiplinës, sherbimit rrojes.

Ndër landet e ma sipërme duhet të merren për bazë vetëm ato pjesë të cilat kanë lidhje me ofiqin e nji Nenoficeri t'Armës.

Neni 38.

As kush prej ushtarakve Nenoficer e Trupë t'Armës, nuk mun-den me u gradue, në se:

1) nuk asht gjykue plotsisht i aftë në përmbushjen e detyrave të gradës ma të naltë;

2) nuk mban sjellje morale të plotë;

3) nuk zotnon nji stërvitje kulturore në përshtatësi të gradës që ka për të fitue me rastin e rritjes;

4) nuk ka njoftim të plotë mbi dispozitat e ligjëve dhe të rre-gulloreve të ndryshme që kanë lidhje me detyrat e nji Post-ko-mandanti.

5) Nuk zotnon cilësit fizike në përshtatësi me mundimet në shërbim t'Armës.

Neni 39.

Komanda e P. Gjindarmeris Mbretnore, duke u mbështetutun ner rrgjistrat e vjetërsiës, në fillim të muejt Tetuer të çdo viti ka me shpall listat emnore për ritjen e graduatve dhe të gjindarmve të Kl. I-rë në sasi që ajo ka me paë të nevojshme.

Mbrenda muejt Kallnuer të vitit suksesiv, Qark Komandat bashkë me gjykimin e tyne për secilin kandidat, do t'i paraqesin Komandës së Pergjithshme t'Armës listat e bame si mbas dispozi-tave të artikujve të përmendun sipër dhe me ato që ka për t'u folë ma pashtë.

Neni 40.

Gradimi i kandidatve të gjykuem t'aft, ka për t'u baë me nji Prill të çdo viti, me përjashtim të dispozitave të tjera të përmbaj-tuna me ketë ligjë.

Neni 41.

Nji graduat ose gjindarm i Kl. I-rë, për t'u çmue ose jo i aft për ritje duhen dy gjykime, njani mbas tjetrit, drejt të cilve i dyti ashtë i prem.

Gjykim' i parë ka për t'u bam prej nji komisionit të formuem nder qendrat e qarqeve nen kryesin e Qark-Komandantit me antar Ndihmësin e vet dhe nji nga Rreth-komandantat. Në shkollën e Gjin-darmeris për personelin efektiv të përhershëm ta'saj, ose për nxan-sit e marun nga sherbimi i Armës e që kanë mbushë vjetërsiën e duhun për gradim, formohet nen kryesin e Komandantit të saj me antarë Ndihmësin e nji nga Kompani komandantat.

Gjykim' i dytë bahet në Komandën e Përgjithshme t'Armës, prej nji Komisionit të formuem nën kryesin e Adjutantit Madhuer me antarë Kryetarin e Seksionit të parë dhe Komandantit e Shkollës së Gjindarmeris ose Qark komandantin e qendrës.

Neni 42.

Komisjonet për të cillat u fol ma sipër, kanë për të votue:

1) aftësi për gradim:

2) pa aftësi për gradim;

3) pezullimin e gradimit.

Votim' i gjykimit t'aftësis për ritje bahet me vota numrash nga 0.20. Kandidati deklarohet i afët kur të ketë fitue nji numur mesatare prej 10/20-ta e nalt në se për çdo gjykim të treguem në nenin 35 të ketë fitue nga 10/20-ta e naltë. Dhe kuer të ketë fitue nji numur mesatar 12/20-ta në se për çdo gjykim të treguem në nenin 35 të ketë fitue deri 8/20-ta.

Kandidati që, në çdo njanin nga gjykimet e tregueme në Nenin 35 nuk fiton 8/20 humbet të drejtën e gjykimit për gradim.

Rezultati i gjykimit të dytë, mbasi i komunikohet ç'do t'interesuemi duhet me u rregjistrue edhe ndër dokumentat vetjake të tij.

Neni 43.

Komisioni i gjykimit të parë, në mbarim të veprimeve të tija, ka me i paraqit atij të gjykimit dytë tri lista.

a) një me emnat e kandidatëve të gjykuem t'aftë;

b) një me emnat e kandidatëve të gjykuem të pa aftë;

c) një me emnat e kandidatve gjykimi të cilve asht lanë pezull.

Se e cila nga këto lilsta duhet me kenë e justifikueme me nga nji proces-verbal i nenshkruem prej të gjithë antarëve të Komisionit. Përveç këtyne kanë për t'i parqit edhe temat e shvillueme bashkë me raportat informative të së cilit kandidat të marrun me ekzaminim.

Që të gjitha këto dokumenta duhen dërgue me pliko të veçantë e të sigurueme me dyll të kuq, të cilat kanë për t'u çel prej Kryetarit të Komisionit përkatës në kohën e mbledhjes së tij.

Neni 44.

Temat që kan për të zhvillue kandidatët për ritje, pregatiten nga ana e Kom. P. Gjindarmeris dhe u dergohen komisioneve përkatës tue kenë të mbylluna nder pliko dhe të siguruem me dyllë të

kuq. Çelen prej kryetarit të Komisionit e në pranim e antarëve në datën që asht caktue prej Komandës P. t'Armës për zhvillimin e tyne.

Neni 45.

Kandidatët që për tri herë me radhë gjykohen të pa aftë për gradim përjashtohen nga sherbimi përhershem i Armës në mbarim të kontratës tyne.

Neni 46.

Ushtarakët Nënoficer e Trupë t'Armës që në kohën e gjykimeve për ritje ose mbasi të jenë gjykue t'aftë, në se i strohen nji procedimit ndeshkimuer a disiplinuer ose deklarohen të pa aftë për shkak sjelljesh të këqija, pezullohen prej gradimit ose hiqen nga kuadri i ritjeve.

Neni 47.

Pezullimi i gradimit dhe hekja prej kuadrit të ritjeve bahet për nji vjetë.

Deklarohen të pa meritueshem për gradim nga shkaqe sjelljesh të këqija kandidatët të cilët, brenda nji vjeti, të jenë dënue. Nënoficerat me sallë disipline, e personeli Trupe me burgim ma tepër se 25 ditë.

Neni 48.

Ushtarakët e deklaruem t'aftë për ritje, për veç sa asht thanë në nenin 40, në rast se çfaqen vakanca riten edhe gjatë vitit e gjithmonë tue i-u mbështet shkallzimit të se cilit që ka në regjistrin përkatës.

KAPTINA X.

TRAJTË EKONOMIKE

Neni 49.

Rrogat e ushtarakve Nenoficer e Trupë t'armës së gjindarmeris Mbretnore janë:

1) Nxanës gjindarmë	fr.	ari.	40	në	muej
2) Gjindarmë i Kl. II	»	»	60	»	»
3) Gjindarmë i Kl. I.	»	»	70	»	»
4) Tetarë	»	»	80	»	»
5) Reshtar	»	»	90	»	»
6) Kapter i Kl. II	»	»	110	»	»
7) Kapter i Kl. I.	»	»	120	»	»

Neni 50.

Rroga mujore fillon me ecë, në raste emnimi prej datës së pre-

BKSH

żantimit në krye të detyrës: në rast gradimi, prej datës së urdhërit të gradimit në qoftë se nuk asht disponue ndryshe në ket urdhën.

Këto rregulla vlejnë edhe për ritjen e rrogës me arstin e kontraktimit të riqindresave të trevjetëshme.

Neni 51.

Nënoficerat dhe personeli Trup t'Armës, që për çdo shkak përjashtohen prej sherbimit, rroga u pritet prej datës nga e cila urdhënohet zbritja nga forca, veç se në qoftë disponue ndryshe.

Në rast aratisjesh rroga pritet prej datës që ajo ndodhi, e në rast vdekjesh rroga pritet ditën e nesërme t'asaj që ndodhi vdekja. Por në qoftë se vdekja të ketë rrjedhur për shkaqe sherbimi, rroga paguhet e plotë për të gjithë muejin trashigimtarëve të tij.

Neni 52.

Nenoficerave dhe personelit Trupë, në raest të gradimit a ndryshimit të kategoris, por t'u takojë një rrogë ma e vogël se ajo që gëzojnë, ruejnë të drejtën e rrogës që kanë pasë deri sa të mrijnë nji të drejtë rroge ma të madhe.

Neni 53.

Rroga e Nënoficerave dhe e personelit Trupë, t'Armës së Gjindarmeris Mbretnore, munden me u zbritë ose me u ndalue krejt.

A) Zbriten:

1) Në gjysmë, rrogat e atyne që ndodhen në pritje të nji gjykimit penal tue kenë të pezulluem nga sherbimi por pa qënë të reshtun ose të nji gjykimit disiplinuer tue qenë të para ndaluem, por me konditë që t'u kthehet përsëri gjysma tjetër në rastë se gjykimi nuk përfundon me dënim.

2) Në dy të tretat, rrogat e atyne që ndodhen në shtrat nër stabilimenta shëndetsore për sëmundje e infirmitete të cillat nuk rrjedhin nga shkaqe të shërbimit dhe të personelit Trup që ndodhen në vuejtje të nji dënimi disiplinuer me burgim të randë.

B) Ndalohen krejtë:

1) Rrogat e atyne që ndodhen me leje të jashtzakonshme për shkaqe private dhe shëndetsore që nuk rrjedhin nga shërbimi.

2) Rrogat e atyne që pa shkaqe justifikuese, nuk paraqiten në kohën e duhun në krye të detyrës ose që largohen nga detyra pa ndonji autorizim.

3) Rrogat e të dënuemve me pezullim nga nëpunësija, për kohën sa që të vazhdojë nji i tillë dënim.

4) Rrogat e aytne që ndodhen në vuajtjen e nji dënimi penal i cili nuk sjell përjashtimin nga shërbimi.

5) Rrogat e atyne që aratisen.

Në rast ndalesash për shkaqet e tregueme në numurin 2, përjashtohen ditët e udhëtimit tue u llogaritur rruga ma e shkurtun. Në rast që largimi të ketë ndodhun pa ndonji autorzimi, nuk përjashtohen as ditët e udhëtimit.

Neni 54.

Nenoficerat dhe personeli Trupë i Armës së Gjindarmëris Mbretnore, kuer lëvizin për shkaqe shërbimi prej nji qarkut në tjetrin, kanë të drejtë për shpenzime udhëtimi, për dijetë dhe për transportim të teshave personale si mbas dispozitave në fuqi.

Nënoficerat e martuem kanë të drejtë edhe për shpenzimet e udhëtimit e të transportimit të teshave për secilin pjestar të familjes së tyne.

E drejta e djetës së përditëshme dhe e teshave për çdo pjestar të familjes së Nënoficerave, shpjegohet në Rregulloren e shpenzımeve t'udhëtimit për Armën e Gjindarmëris Mbretnore.

Neni 55.

Rroga dhe të gjitha indeminitetet që u përkasin ushtarakve t'Armës, nuk mund të falen, të lihen peng ose të sekuestrohen. Përjashtohen nga kjo dispozitë detyrimet kundrejtë Shtetit që mvaren nga ushtrimi i detyrës së tyne dhe për ushqim të detyrueshëm sı mbas ligjës.

Neni 56.

Ndalesa për çdo shkak, me përjashtim t'ushqimit, nuk mundet me shkapërxye nji të katërtën e rrogës së përmuejshme.

KAPTINA XI.

VESH-MATHJE E PAJIM

Neni 57.

Ç'do graduati e gjindarmi, vesh-mbathje e pajimi i sigurohet nga ana e Shtetit pa asnji detyrim pagese. Mënyra e përdorimit dhe afati i përsëritjes së vesh-mbathjes e pajimit, caktohen në Rregulloren përkatëse.

Neni 58.

Vesh-mbathja e pajimi janë gjithmonë pasuni Shtetnore. Në rast të përsëritjes së tyne dhe në rast të largimit nga shërbimi

i Armës, ushtarakët detyrohen me i a këthye këto Shtetit, qoftë dhe sikur të kenë kalue afatin e përdorimit.

KAPTINA XII.

NËNPUNËSIJA

Neni 59.

Kapterat e të dy klasave përdoren vetëm si Post-Komandanta. Por në rast nevoje, me autorizim të Komandës Përgjithshme t'Armës, mund të përdoren edhe ndër detyra të tjera.

Neni 60.

Reshtarët përdoren si Post-Komandanta në mungesë të kapterave, përdoren si ndihmësa nër Posta të komandueme prej kapterash dhe si shkruesa në zyrë nër komanda të drejtueme prej Oficerave.

Neni 61.

Tetarët përdoren ndihmës Post-Komandanta, shkruesa në Zyre dhe në mungesë të Nënoficerave ose për nevojë shërbimi, mund të përdoren si zëvëndës Post-Komandanta.

Neni 62.

Nga Gjindarmët e kl. I-rë me eksperiencë me gjendje kulturore të përshtatëshme, mund të përdoren si ndihmës Post-Komandanta ndër ato Posta ku nuk ka graduatë ndihmësa, përdoren dhe shkruesa ndër zyra; por as kurrë zavendës Post-Komandanta. Përjashtohet nga kjo dispozitë kuer ndonji rasë e ngutëshme shërbimi t'a bajë këtë të nevojshme për nji kohë fort të shkurtën ose deri në gjendjen e nji graduati.

Neni 63.

Gjindarmët e kl. II-të, me përjashtim të ndonji rasës së ngutëshme shërbimi për veç se në shërbim t'institutit t'Armës nuk mund të përdoren me as një detyrë tjetër nga ato që u përmendën ma naltë.

KAPTINA XIII.

MARTESA

Neni 64.

Nënoficerat dhe personeli Trupë i Armës Gjindarmëris Mbretnore që janë në shërbim të përhershëm, nuk munden me u martue në qoftë se nuk kanë marrë ma parë pëlqimin dhe autorizimin

e Komandës P. t'Armës. Nji ushtarak mundet me u lejue të kontraktojë martesë mbasi të ketë plotësue kohën e detyrueshme të qindresës në shërbim.

Neni 65.

Kushdo prej graduatve dhe gjindarmëve që kontrakton martesë pa autorizim të Komandës P. t'Armës përjashtohet nga shërbimi.

Neni 66.

Komanda e Përgjithëshme nuk mundet me autorizue kontraktim martese kuer femna nuk banë pjesë në nji familje dhe atëhere kuer dishruesi me sjelljet e provat që ka dhanë gjatë shërbimit në Gjindarmeri të jetë gjykue i pa zoti për me formue familje. Kjo rasë e fundit s'kishte me u marrë para syshë kuer prindërit e gjindarmit ose të femnës në të cilën ay ka kontraktue martesë të marrin përsipër sigurimin e kësaj të dytës për të gjithë kohën që ay ushtarak mund të mbahej në shërbim të përhershëm t'Armës.

KAPTINA XIV.

DORËHEKJA NGA SHËRBIMI I PËRHERSHËM

Neni 67.

Ushtaraku Nënoficer e Trupë i Armës së Gjindarmëris, mbasi të ketë plotësue kohën e qindresës ose të çdo riqindresës, në rast se nuk do të dishirojë me vazhdue ma në shërbim t'Armës, tue paraqit lutje për dorëhekje, qiten në lirim. Gjithënjë po në këtë mënyrë u pranohet dorëhekja edhe ushtarakëve që, pa pasë plotësue kohën e kontraktueme, u çfaqet ndonji ndryshim me rëndësi në gjendjen familjare të tyne. Por ky ndryshim duhet me kenë i vërtetuem me dokumenta legale, kështu që të mundet me u kuptue se i ka ndodh pas datës së pranimit në shërbim t'Armës.

Neni 68.

Nuk u pranohet dorëhekja e ushtarakëve që paraqesin lutje për nji nga shkaqet e përmenduna me Nenin e sipërmë, në rast se:

1) ndodhen të reshtuem në pritjen e nji gjykimit penal;

2) ndodhen në vuejtje të nji dënimit dishiplinuer me burgim a sallë disipline, ose të nji dënimit penal;

3) mbahen përkohësisht për nevojë shërbimi me rëndësi.

KAPTINA XV.

PENSIONIM

Neni 69.

Pensionimi i ushtarakëve t'Armës së Gjindarmëris bahet në bazë të ligjës së Pensioneve Ushtarake.

KAPTINA XVI.

PËRJASHTIM NGA SHËRBIMI I PËRHERSHËM

Neni 70.

Personeli Nënoficer e Trupë i Armës së Gjindarmëris përjashtohet nga shërbimi me fuqi ligjore për nji nga shkaqet qi vijojnë:

1) për shkak pa aftësije në shërbim;
2) për shkaqe shëndetsore;
3) me mrritjen e kufizimit të moshës;
4) për pakësim kuadri;
5) për shkaqe disiplinore.

Neni 71.

Ushtarakët Nënoficer e Trupë t'Armës që, nga shkaku i dobësimit të çilësinave intelektuale dhe të kulturës në dijeniën tekniko profesionale ose për paksim të vullnetit e të zellit në detyrë, shifen praktikisht të pa aftë për në shërbim të përhershëm t'Armës, qiten në lirim me fuqi ligjore për shkaqe shërbimi.

Neni 72.

Ushtaraku Nënoficer e trupë, që dobsim i kandidatve fizike shifen të pa aftë për nji shërbim të frutshëm n'Armën e Gjindarmëris qiten në lirim me fuqi ligjore për shkaqe shëndetsore.

Përjashtimi për kët shkak, bahet për mbas nji raportit mjekësuer të lëshuem prej nji Këshillit të përbashkët mjekësuer.

Ushtarakët e pa shëndetshëm në rast se, për mbas këshillash mjekësore, kanë posibilitet të përmirësohen, para se të përjashtohen dhe me kusht që t'u bahet edhe nji vizitim i dytë mjekësuer, u akordohet nga nji leje shëndetësije e cila mund t'u zgjatet deri në tre muaj për sëmundje të marrun jashtë shërbimit dhe deri në gjashtë muaj per ato të marruna në shërbim.

Neni 73.

Nënoficerat që mrrijnë në moshën 50 vjeç dhe Ushtarakët e

Trupës në moshën 45 vjeç përjashtohen nga shërbimi me fpqi ligjore.

Neni 74.

Në rast të pakësimit të kuadrit ushtarakët e ç'do grade duhet të përjashtohen në bazë të rendimit qi vijon:

1) Ushtarakët që brënda atij viti mrrijnë kufizimin e moshës,

2) Ushtarakët të cillët gjatë shërbimit tyne n'Armën e Gjindarmëris janë baem fizikisht të pa përshtatshëm për t'i ba ballë mundimeve të shërbimit ma të randë;

3) Ushtarakët që kanë sjellje dhe karakter ma të pa pëlqyeshëm;

4) Ushtarakët ma me pak dituni profesionale të cillët nuk e përmirësojnë dituniën e tyne;

5) në rastë se nuk do të ketë ushtarakë si ata të kategorive të kalueme duhen përjashtue ata me vjetërsi ma të pakë në gradë.

Neni 75.

Përjashtmi ushtarakëve Nënoficer e Trupë nga shërbimi i përhershëm për shkaqe dishiplinore bahet kuer ata gjykohen të pa meritueshëm për t'u mbajt nën armë për nji nga shkaqet qi vijojnë:

1) zakon e sjelljeve të këqija;

2) mungesa të randa disiplinore ;

3) kuer mbrënda nji vjeti të jetë dënue disipinarisht, nëse Nënoficer me 45 ditë sallë disipline, dhe nëse ushtarak i Trupës me 45 dit burgim.

Por të tilla shkaqe duhet të mos jenë nga ato që imponojnë prapsim në gradë.

Neni 76.

Kushdo nga personeli Nënoficer e Trupë i Armës që nuk ka mbushun kohën e duhun për pension dhe përjashtohet me fuqi ligjore për nji nga shkaqet e përmenduna nër paragrafet 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 70, përftojnë të drejtën e nji shpërblimi në mënyrë masën si vijon:

Ushtaraku që nuk ka plotësue gjasht vjet shërbim n'Armë, nuk përfiton as pak nga e drejta e këtij çbërblimi. Pasi të ketë plotësue gjashtë vjetët i epet nji shpërblim për çdo vit shërbimi rroga e nji mueji të gradës fundit.

Neni 77.

Ushtaraku që përjashtohet nga shërbimi i Gjindarmëris jo

për shkaqe shëndetsore, në qofshin të klasës që ndodhet nën armë, i dorëzohen Komandës Mbrojtjes Kombëtare për plotësimin e shërbimit ushtarak të detyrueshëm.

Neni 78.

Çdo veprim i nevojshëm në bazë të dispozitave të përmenduna në këtë kaptinë ka me u ba me vendim të Komisionit të parapame në Nenin 41 të kësaj Ligje.

KAPTINA XVII

PEZULLIM NGA GRADA E NGA NËPUNËSIJA

Neni 79.

Kur nji graduati ose gjindarmi në shërbim të përhershëm t'Armës i ngarkohen fakte për të cilat duhet t'i shtrohet nji procedimit ndëshkimuer ose dishiplinuer, për të kenë si masë paraprake, ay ushtarak pezullohet si nga grada ashtu dhe nga nëpunësija.

Kjo masë merret gjithmonë kuer ushtaraku në pritje të gjykimit paraburgoset për mbas nji letër rreshtimi ose atëhere kuer ushtaraku ndodhet në vuejtjen e nji dënimi penal i cili të mos ketë për efekt prapsimin në gradë, humbjen e gradës ose dëbimin nga Arma.

Neni 80.

Ushtaraku i Gjindarmëris që për shkaqe penale pezullohet nga grada e nga nëpunësija çrregjistrohet dhe për të gjithë kohën që mund të gjindet i paraburgosun në pritjen e gjykimit ose i burgosuni në vuejtjen e nji dënimit penal, humbet si rrogën ashtu dhe vjetrsinë.

Në rastë që pezullimi të ketë rrjedhun për shkaqe dishiplinore, ushtaraku me gjithë që mund të paraburgoset dishiplinarisht, por duhet që gjykimi tij mbrenda 45 ditëve të marrë fundë. Në raste të kundërtë duhet m'u lanë i lirë, por gjithmonë i pezulluem nga shërbimi.

Neni 81.

Pezullimi në kjoftë se pasohet me pa fajsi e po të ketë rrjedhun për shkaqe penale, i pezulluemi përfiton të drejtën e riparimit në shërbim po pa pretendue ndonji të drejtë për kohë gjatjen e pezullimit. Po të ketë rrjedhun për shkaqe dishiplinore duhet që t'i kthehen të gjitha të drejtat nga të cilat ka kenë privue gjatë kohës së pezullimit.

BKSH

Pezullimi, në qoftë se pasohet me dënim, ka me u veprue në bazë në Neneve 84, 85 e 86 të kësaj Ligje.

KAPTINA XVIII.

PRAPSIM NË GRADË

Neni 82.

Prapsimi në gradë ka për efekt hekjen e gradës të graduatit duke i zbrit në Gjindarmë të Kl. II-të, dhe e privon nga çdo e drejtë e autoritetet që ka pasë si graduat.

Neni 83.

Prapsimi në gradë mund të vendoset për nji nga shkaqet qi vijojnë:

1) me rastet e parapame prej Kodit Penal Ushtarak;

2) për mungesa shumë të randa dishiplinore:

3) kur dënohet në bazë të Kodit Penal Komun me burgim ose me burgim të lehtë ma tepër se nji vjet;

4) kur mer nji pozitë shoqnore të pa përshtatëshme me gjendjen si ushtarak i Armës së Gjindarmëris Mbretnore;

5) kur largohet nga detyra pa arsyena justifikuese.

Neni 84.

Dënimi me prapsim të gradës aplikohet me vendim të Komisionit të parapamë në nenin 41 të kësaj Ligje dhe me autorizimin e Komandës së Përgjithshme të Gjindarmeris. Ushtaraku i ndeshkuem me ketë dënim, nxiret në lirim pa as nji të drejtë.

KAPTINA XIX.

HUMBJA E GRADËS DHE DËBIMI NGA ARMA

Neni 85.

Humbja e grades dhe dëbimi nga Arma kanë për efekt dhe humbjen e nepunësiës, të drejtave për pensione, për çpërblim dhe për ripranim në sherbim të pëhershëm t'Armës.

Neni 86.

Humbja e gradës dhe dëbimi nga Arma mundë të vendoset për nji nga shkaqet që vijojnë:

1) Me rastet e parapame prej Kodit Penal Ushtarak;

2) Kuer ndeshkohet në bazë të Kodit Penal Komun me nji dënim me ndalim të liris vetjake për nji kohë ma të madhe se nji vjet.

3) Kuer ushtaraku dënohet me nji dënim me çdo kohë ngjatje që asht i kundërt me nderin e me prestigjin;

4) Kuer ushtaraku dënohet për çdo delikt me ndalim të liris vetjake e me çdo ngjatje, kuer t'u jetë shtue si dënim ose efekt penal ndalimi përjetshem ose përkohshem nga ofiqet publike ose të jetë shtue në bazë të ligjës vuemja e të dënuemit nen vrejtim të posaçem t'autoritetit Sigurimit publik.

5) Me humbjen e nenshtetësiës Shqiptare;

6) Kuer ushtaraku bahet i çdukshem.

Neni 87.

Dënimi me humbje të gradës dhe me dëbim nga Arma, aplikohet me autorizim të Komandës P. t'Armës, në mbështetje të vendimit të Komisionit që shënohet në nenin 41 të kësaj Ligje.

Neni 88.

Çdo dispozitë në kundërshtim me këtë ligjë, mbetet pa fuqi.

Neni 89.

Kjo Ligjë hynë në fuqi 15 ditë mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 90.

Këshilli Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve
D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi detyrat dhe të drejtat e personelit Nënoficer e Trupë t'Armës së Gjindarmëris Mbretnore, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 51/I dat. 26-I-1934 të Kryesiës së Tij.

Tiranë, me 31 Kallnduer 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Dretjësiës
V. AVRAMI

Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i P. të Mbrendëshme

Zav. Ministri Ekonomis Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arsimit
M. IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 45.

LIGJË, 14 Prill 934

Mbi rregullimin e Ushtëris Kombtare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 23 Prill 934, Nr. 23).

KRYE E I-rë

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

P e r s o n e l i

Neni 1.

Personeli i ushtrisë kombëtare dallohet në:

— personel ushtarak:

— personel civil

Neni 2.

Personeli ushtarak përfshinë:

1) Oficera

2) Nën-oficera

3) Trupa

1 — O F I C E R A

Jerarkija nër grada t'oficerit asht si vijon:

a) Oficera Generala

General Armate

General Divizioni

General

b) Oficera eprorë

Kolonel-Kapiten anije

Nen-Kolonel, Kapiten fregate, Nen-Kolonel Porti, Major-Kapiten korvete, Major Porti

c) Oficera depëror

Kapiten i Kl. I. — Toger anije Kl. I.

Kapiten makinist Kl. I.

Kapiten Porti i Kl. I.

Kapiten i Kl. II. — Toger anije i Kl. II.

Kapiten makinist i Kl. II.

Kapiten Porti i Kl. II.

BKSH

Oficera nen-depëror (subalternë)	Toger - Nëntoger anije - Toger makinist - Toger porti ; Nëntoger - flamurtar - Nëntoger makinist - Nëntoger porti ; Aspirant - Aspirant anije - Aspirant makinist - Aspirant porti.

2 — NËN-OFICERA

Jerarkija nër grada e Nën-oficerit asht si vijon:
Kapter i kl. I.
Kapter i kl. II.
Reshtar i vjetër (vetëm për Marinën)
Reshtar

Për Nën-Oficerat dallimi i gradës mund të ndjeket prej asaj të specialitetit në të cilin ata eventualisht bajnë pjesë.

3 — TRUPE

Jerarkija nër grada të Trupës asht si vijon:
Nënreshtar
Tetar
Nëntetar-Rojës kufinit
Ushtarë-nxanës - Rojës kufini - detar

Nënreshtarët, Tetarët e Nëntetarët e përbajnë graduatet e Trupës.

Për graduat e Trupës dallimi i gradës mundet m'u ndjekë prej asaj të specialitetit në të cilin ata eventualisht bajnë pjesë.

Neni 3.

Organikat e Oficeravet janë të caktueme prej kësaj ligje.

Organikat e Nën-oficeravet e të Trupës janë të caktuem me dispozita të veçanta.

Neni 4.

Jerarkija e organika e personelit civil janë të caktueme prej nji Ligjës së veçantë.

PËRBAËSIJA E USHTËRISË KOMBËTARE

Neni 5.

Ushtërija kombëtare përfshinë:
— Komandën e Mbrojtjes Kombëtare

BKSH

— Fuqitë toksore
— Fuqiët detare
— Fuqiët ajrore

Për mbrojtjen e Shtetit mundën me marë pjesë trupà vullndetarësh, që kanë m'u themelue me dekret Mbretnuer.

Kto trupa si në kohë paqe ashtu dhe në kohë lufte, vehen nën mvarësinë e Komandës së Mbrojtjes

KOMANDA E MBROJTJES KOMBËTARE

Neni 6.

Komanda e Mbrojtjes Kombëtare mbahet prej nji oficeri general.

Perbaësija e Komandës në fjalë asht caktue me dekret Mbretnuer.

Po kësaj Komande i shënohen oficera t'armve e trupave të ndryshme, të përfshiëm nër organikat e armeve e trupave përkatës.

KRYE I II-të

FUQIËT TOKSORE

Elementat e Fuqivet Toksore

Neni 7.

Fuqiët toksore janë të përbaëme prej elementavet që vijojnë:

a) Shkollat ushtarake
b) Arma e kambsorisë
c) Arma e artilerisë
ç) Arma e Xhenjos
d) Trupi Rojës Mbretnore të kufinit
dh) Trupi shëndetsuer
e) Trupi veterinar
ë) Trupi i Intendancës
f) Trupi i rekrutimit
g) Elementa të ndryshëm

Përpjestimi i elementavet të nalt-përmendun n'elementa ma të vogla, asht caktue prej neneve që vijojnë.

Formacjonet e elementave ma të vogla janë caktue, në hollësit e tyne, prej Komandës Mbrojtjes Kombëtare.

RREGULLIMI I FUQIVET TOKSORE

Neni 8.

Fuqiët toksore janë kshtu të përmbledhuna:
— 2 Divizione (gjithësejt 6 grupe të përziem)
— Trupat e shërbimit që nuk bajnë pjesë në Divizionet.
— 1 Trup i Rojës Mbretnore të kufinit.

DIVIZIONI

Neni 9.

Divizioni asht i përbaëm prej:
— Nji Komande
— Dy e ma tepër Grupesh të përziem
— Trupat e shërbimit divizionale.

Komanda e Divizionit mbahet prej nji Oficeri General.

Përbaësija e Komandës nalt-përmendun asht caktue prej Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Komandës së Divizionit i shënohen oficera t'armëve e trupave të ndryshme, të përfshieme nër organikat e armve e trapave përkatës.

Grupet e përziem, trupat dhe shërbimet divizionale që bajnë pjesë në se cilin Divizion, caktohen me dekret Mbretnuer.

OFICERA GENERALË

Neni 10.

Organika e Oficerave Generala asht si vijon:

— Generala Divizioni	1
— Generala	3
Shuma	4

GRUPI I PËRZIEM

Neni 11.

Grupi i përziem asht i përbaëm:
— Prej nji Komande
— Prej trupash e shërbimesh në masë të ndryshme.

Komanda e Grupit të përziem mbahet prej nji Koloneli ose Nënkoloneli kambsor.

Përbaësija e Komandës në fajlë asht caktue prej Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Komandës së Grupit të përziem i janë shënue oficera t'armve

e trupave të ndryshme të përfshiëm nër organikat e armve e trupave përkatse.

Trupat dhe shërbimet që bajnë pjesë në secilin Grup të përziem, janë caktue me dekret Mbretnuer.

SHKOLLA USHTARAKE

Neni 12.

Shkollat Ushtarake përfshijnë:

a) 1 Shkollë Mbretnore ushtarake
b) 1 Shkollë nxansa oficera plotsimi
c) 1 Shkollë perfeksionimi për oficera
ç) 1 Shkollë nxansa Nën-oficera.

Shkollave ushtarake i janë shënue oficera t'armëve e trupave të ndryshme, të përfshiëm nër organikat e armve e të trupave përkatse.

ARMA E KAMBËSORISË

Neni 13.

Arma e kambsorisë përfshinë:

a) 1 Bataljon të Gardës Mbretnore
b) 4 Bataljone efektivë
c) 23 Bataljone kuadër udhë-diftuese kalorse
d) 1 Eskadrilë autoblindë e tanks.

Neni 14.

Organika e Oficeravet të kambsorisë asht si vijon:

Kolonela	5
Nën-kolonela	8
Majora	18
Kapitena të kl. I.	41
Kapitena të kl. II.	116
Togera, Nëntogera e Aspiranta	865
Shuma	553

N'organikat e Oficeravet të kambsorisë janë përfshiё 10 oficera në shërbim të Shtatit Madhnuer.

ARMA E ARTILERISË

Neni 15.

Arma e Artilerisë përfshinë:

a) 1 Komandë artilerije

BKSH

b) 4 Komanda artilerije pozisioni
c) 2 Komanda artilerije divizioni
ç) 9 Bateriē kanona 65/17
d) 6 Bateriē obus 75/13
dh) 1 Grup kanona 75/27 auto-bartun (mbi 3 baterie)
e) 9 Bateriē kuadēr.

Neni 16.

Organika e Oficeravet t'Artilerisē asht si vijon:

Kolonela	1
Nen-Kolonela	2
Majora	4
Kapitena tē Kl. I.	13
Kapitena tē Kl. II.	28
Togera, Nentogera dhe Aspiranta	118
S h u m a	166

N'organikēn e Oficeravet t'Artilerisē janē tē pērfshiem 4 oficera nē sherbim tē Shtatit Madhnuer.

ARMA E XHENJOS

Neni 17.

Arma e xhenjos pērfshinē:
a) 1 Komandē ragrupimi tē xhenjos
b) 1 Drejtori xhenjo
c) 3 Kompaniē zapator-minator efektiv tē Grupit perziem
ç) 3 Kompaniē kuader zapator-minator tē grupit pērziem.
d) 2 Kompanie zapator-minator divizioni.
dh) 2 Kompani telegrafiste
e) 1 Kompani radio-telegrafiste
ē) 1 Kompani teleferiste
f) 1 Repart pompier

Neni 18.

Organika e Oficera tē Xhenjos asht si vijon:

Kolonela	1
Nen-Kolonela	2
Majora	3
Kapitena tē Kl. I-rē	6
Kapitena tē Kl. II-tē	10
Togera, Nentogera, Aspiranta	40
S h u m a	62

N'Organikën e Oficerave të Xhenjos asht përfshiё nji oficer në shërbim të Shtatit Madhnuer.

TRUPI I ROJËS MBRETNORE TË KUFINIT

Neni 19.

Trupi i Rojës Mbretnore të kufinit përfshinë:

a) 1 Komandë Trupit

b) 5 Bataljona

c) 1 Qendër stërvitjeje

Atributat dhe mvarësiet e Trupit, për sa i përket sherbimit t'institutit, janë të caktueme me ligjë të veçantë.

Neni 20.

Organika e Oficeravet të Rojës Mbretnore të kufinit asht si vijon:

Kolonela	1
Nenkolonela	2
Majora	4
Kapitena të Kl. I.	7
Kapitena të Kl. II.	14
Togera, Nentogera e Aspiranta	53
Shuma	81

TRUPI SHËNDETSUER

Neni 21.

Trupi shëndetsuer përfshinë:

a) Oficera mjek

b) Oficera kimikë farmacistë

c) 1 Kompanië shëndetsije.

Neni 22.

Organika e Oficeravet mjekë asht si vijon:

Kolonela	1
Nen-Kolonela	2
Majora	3
Kapitena të Kl. I.	6
Kapitena të Kl. II.	12
Togera	24
Shuma	48

BKSH

Organika e Oficeravet kimikë-farmacist asht si viojn:

Kapitena të Kl. I.	1
Kapitena të Kl. II.	2
Togera	4
Shuma	7

TRUPI VETERINARË

Neni 23.

Trupi veterinarë përfshinë:
a) Oficera veterinar
b) Nen-Oficera nallbana dhe infermier.

Neni 24.

Organika e Oficeravet veterinar asht si vijon:

Majora	1
Kapitena të Kl. I.	2
Kapitena të Kl. II.	3
Togera	4
Shuma	10

TRUPI I INTENDANCËS

Neni 25.

Trupi i Intendancës përfshinë:
a) Oficera t'intendancës
b) Kompani e intendancës

Neni 26.

Organika e Oficeravet t'intendancës asht si vijon:

Kolonela	1
Nen-kolonela	2
Majora	3
Kapitena të Kl. I.	6
Kapitena të Kl. II.	12
Togera, Nentogera e Aspiranta	56
Shuma	80

TRUPI I REKRUTIMIT

Neni 27.

Trupi i rekrutimit asht i perbaëm prej oficerash rekrutimi.

Neni 28

Organika e Oficeravet të rekrutimit asht si vijon:

Nen-Kolonela	1
Majora	3
Kapitena të Kl. I.	7
Kapitena të Kl. II.	12
Togera, Nentogera e Aspiranta	53
Shuma	76

ELEMENTA TË NDRYSHEM

Neni 29.

1 Spital usthارak
5 Revire garnizoni
1 Farmaci ushtarake
1 Bukë-pjekëse ushtarake
1 Puntori e Intendancës
1 Farkine (ofiqinë) qendrore ushtarake me seksion të detashueme
3 Revire kafshësh
1 Autogrup me farkinë automobilistike
1 Gjyq i Naltë Ushtarak
1 Gjyq Ushtarak i Përherëshem
4 Drejtorië Rekrutimi
35 Zyra Rekrutimi
Reparte garnizonesh (numri i tyne ka m'u caktue me dekret Mbretnuer)
1 Depo e përgjithshme
2 Magazina divizioni
1 Bandë ushtarake
1 Shtypshkronjë Ushtarake

Oficerat që shërbejnë pranë elementavet të naltë renduem janë të përfshiem n'Organikën e Oficeravet të Armve e Trupave të ndryshme.

KRYE I III-të

FUQIËT DETARE

Elementat e fuqivet detare

Neni 30.

Fuqiët detare janë të përbaeme prej elementavet që vijojnë:

a) Trupi i Marinës luftuese
b) Trupi i Kapitenërive Porti

Përpjestimi i elementavet të nalt-përmendun në elementa të vegjël ashtë caktue nga nenet që vijojn:

Veçoritë e formàcioneve t'elementavet ma të vegjël janë të caktueme prej Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

KOMANDA E MARINËS

Neni 31

Fuqitë detare mvaren prej nji Komandë Marine.

Komanda e Marinës mbahet prej oficerit ma të anltë me gradë të Trupit të Marinës Luftuese.

Përbaësija e Komandës në fjalë asht caktue prej Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Komandës Marinës i janë shënue oficera të përfshiem nër organika të Trupit Marinës Luftuese.

TRUPI I MARINËS LUFTUESE

Neni 32.

Trupi i Marinës Luftuese përfshinë:
a) 3 Baza detare
b) 1 Sekcjon Kanonjera Mbretnore
c) 1 Eskadrilë M. A. S.
ç) 3 Baterië kundra ajrore
d) 1 Baterië breg-detse.

Neni 33.

Oficerat e Marinës Luftuese dallohen në:
a) Oficera Anije
b) Oficera Makinista

Organika e oficeravet Anije asht si vijon:

Kapiten fregate	1
Kapiten korvete	2
Toger anije i Kl. I. dhe i Kl. II.	4
(Nëntoger anije	
Flamurtar)	
Aspiranta-anije)	6
Shuma	13

Organika e Oficeravet makinista asht si vijon:

Togera makinista	1
Nëntogera e Aspiranta makinista	3
Shuma	4

TRUPI I KAPITENERIVE PORTI

Neni 34.

Trupi i Kapitenerivet porti përfshinë:

a) 1 Inspektorat i Kapiterive porti
b) 4 Kapiteneri porti
c) 5 Zyre porti

Atributat dhe mvarësitë e Trupit, për sa i përket shërbimit t'institutit, janë të caktueme prej nji Ligjës të veçantë.

Neni 35.

Organika e Oficeravet porti asht si vijon:

Major porti	1
Kapitena porti të Kl. I. dhe të Kl. II.	4
Togera, Nëntogera e Aspiranta porti	6
Shuma	11

KRYE IV.

FUQIËT AJRORE

Neni 36.

Formimi i fuqive ajrore ka m'u caktue me ligjë të veçantë.

KRYE V.

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 37.

Oficerat për t'u shënue shtëpis ushtarake të N. M. së Tij Mbretit meren prej atyne që janë të përfshime nër organikat e armve e trupave të ndryshme të parapaëm prej kësaj ligje.

Neni 38.

Nër organikat t'oficeravet t'armve e trupave të ndryshme të caktuem prej kësaj ligje, nuk janë përfshië oficerat e plotsimit në shërbim t'emnimit parë.

Numri i oficeravet të plotsimit në shërbim t'emnimit parë

ndryshon për çdo vjet, në lidhje me numrin e djelmoshave me detyrim ushtarak që kanë cilësitë e kërkueme për pranim në kurse të rekrutimit për të tillë oficera.

Neni 39.—

Oficerat që meren në shërbim për një afat të catkuem me kontratë të veçantë si mbas nenit 185 të Statutit Themeltar, konsiderohen si Organizatorë t'armve e trupave t'ushtrisë, e prandej nuk janë të përfshiëm nër organikat e parapame nga kjo ligjë.

Neni 40.

Armët e kambsorisë Artilerisë e Xhenjos dhe trupat e Rojës Mbretnore të kufinit si dhe të Marinës Luftuese janë armë e trupa luftarake.

Neni 41.

Rajoni ushtarak toksuer dhe entet e ushtrisë që kanë juridiksion toksuer janë të caktueme me dekret Mbretnuer.

Neni 42.

Në rasë të nevojave të veçanta mundën m'u formue, me dekret Mbretnuer, përveç atyne të parapame prej kësaj ligje, komanda të tjera, njisina të armve e trupave të ndryshme si edhe elementa të shërbimeve.

KRYE VI.

DISPOZITA TË PËRKOHËSHME E TË FUNDIT

Neni 43.

Rregullimit t'Ushtrisë dhe organikës s'Oficerave të parapame prej kësaj ligje, do t'i arihet gradualisht, me dispozita të veçanta që kanë me u dhanë me Dekret Mbretnuer në bazë të mundësive të Buxhetit të çdo viti.

Duhet mandej në kohën e Buxhetit preventiv me u caktue për çdo vit me Dekret Mbretnuer numri i Oficerave të çdo grade.

Neni 44.

Për deri sa mos t'i arrihet organikës t'Oficeravet që asht parapaë në kët ligjë për armët e trupat e ndryshme, me dekret Mbretnuer mundet t'u besohet oficeravet detyra e gradës ma e nalte prej asaj që ata mveshin.

Neni 45.

Kjo ligjë hynë në fuqië prej ditës që ajo ka m'u shpallë në **Fletoren Zyrtare të Mbretnisë.**

Po prej kësaj datë duhet të kuptohet e abrogueme ligja e rregullimit të Fuqive Armate me datë 30 Qershuer 1931.

Neni 46.

Këshilli Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi rregullimin e Ushtris Kombëtare, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 213/I ex 33 datë 24-II-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Prill 1934. Z O G

Kryeministri:
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i P. të Mbrendëshme
Zav. Ministri i Ek. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA d. v.

Ministri i Arësimit
M. IVANAJ

Ministri i Punëvet Botore
S. SARAÇI

Nr. 46

LIGJE, 14 Prill 1934.

Mbi transferimin e nji fondi prej fr. ari 2000 (Dymij) prej Kap. 10 në Kap. 12 të bugetit t'ushtrimit financjar 1933-1934 të Ministris së Punvet Botore (Degë Post-Telegrafë)

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 25 Prill 1934 Nr. 24).

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-1934 të Ministris së P. Botore (Drejtorija e P. e Post-Telegrafave), pakësohet nga Kap. 10 «Rrogë personeli, zavendësije etj. nji fondë prej fr. ari 2000 (dymij).

Art. 2.

Fondi prej fr. ari 2000 paksue si mbas Art. 1 të kësaj ligje, i

shtohet Kap. Nr. 12 «shpenzime udhëtimi e djetë» tëgjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-1934 të Ministris së P. Botore (Drejtorija e Përgjithshme e Post-Telegrafave).

Art. 3.

Kjo ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministri i P. Botore.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi transferimin e nji fondi prej fr. ari 2000 në budgetin e ushtrimit 1933-934 të Ministriës së P. Botore (Degë Postë-Telegrafe) e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 185/I datë 24-3-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 14 Prill 1934. ZOG

Kryeministri: P. EVANGJELI
Ministri i P. Botore S. SARAÇI
Ministri i Drejtësis V. AVRAMI
Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 47.

LIGJE, 23 Prill 1934.

Mbi ngushtimin e Bulevardeve të shenueme në planin e Tiranës së Ré

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 25 Prill 1934, Nr. 24)

Art. 1.

Bulevardet të cilat në planin e Tiranës së Ré kan pasun nji gjanësi prej 30 m., ngushtohen në 20 m.

Art. 2.

Bulevard ZOG i I-rë, në lagjen Tirana e Ré, ngushtohet nga dy anët përgjithësisht 24 metro d.m.th. nga 12 metro për secilen anë.

Art. 3.

Pjesët qi rezultojnë nga ngushtimi i rrugëvet, si mbas nenit I, si edhe pjesët qi rrjedhin nga ngushtimi i Bulevardit ZOG i I-rë

si mbas nenil 2, i jepen pronarve qi kufizojnë këto pjesa me çmimin e caktuem me ligjën e posaçme datë 13 Maj 1927.

Mbi paraqitjen e diftëses së pagimit të çmimit, Ministrija e Financavet i lëshon t'interesuemit nji akt transferimi të zotënimit të tokës përkatëse; ky akt transkriptohet në Zyrën e Ipotekave pa taksë.

Neni 4.

Ç'do dispozitë Ligjore në kundërshtim me ketë ligjë mbetet pa fuqi.

Neni 5.

Ministrija e P. Botore, Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe, Ministrija e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Neni 6.

Kjo ligjë hynë në fuqi me shpalljen e sajë në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi ngushtimin e Bulevardëve të shenjuem në planin e Tiranës së Ré e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 222/I datë 5-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 23 Prillë 1934.

Z O G

Zav. Kryeministri
Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Punëvet Botore
S. SARAÇI

Nr. 48.

LIGJË, 7 Prill 1934

Mbi transferim fondesh në buxhetin 1933-934 të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 25 Prill 1934, Nr. 24)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare për ushtrimin financjar 1933-934 paksohen fondet për kapitull si vijon;

Kap. 3. Shpenzime udhtimi e shpërblime të posaçme fr. ari 10.000
Kap. 9. Ushqim oficjerash, nxanësash, graduatësh, ushtarësh « 30.000
Kap. 10. Haesa e kashtës për kafshë, rrogë personeli civil në shërbim të kafshëvet, shpenzime për mjekime e vegla veterinarije, shpenzime të ndryshme për shpërblim ipik e veteriner, shpenzime për mbathjen e kafshëvet « 20.000
Kap. 13. Blemje e mirëmbajtje e materialit t'Artileris « 15.000
Kap. 14. Punime, mirëmbajtje përmirësime e smadhime të ndërtesave ushtarake, mirëmbajtje e persëritje e materialit të lujtshëm të Xhenjos e t'Artileris, ushtrim e mirëmbajtje të vijave telefonike ushtarake, funksjonimi i ofiçinavet, shpërblim damesh të bamuna pronësinavet private prej ushtrimeve, transport materjali ndërtimi e shpenzime të ndryshme të Xhenjos fr. ari 13.000

S h u m a fr. ari 88.800

Art. 2.

Fondet prej fr. ari 88.800 (tetëdhetetemijë e tetëqind) paksue si mbas Art. I të kësaj ligje, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Komandës së Mbrotjes Kombëtare ndër kapitujt e në sasi si vijon:

Kap. 5. Shpenzime për mbajtjen e nxanësavet ndër shkolla Ushtarake, rrogë personeli civil të shkollave, shpenzime e shpërblime për mbajtjen e nxanësavet civila e ushtarakë për jashta, shpenzime për kurse instruksjoni fr. ari 2.000
Kap. 7. Blemje e përsëritje e mirëmbajtja e vesh-mbathjes e pajimti të trupavet « 6.000
Kap. 15. Shpenzime për transportime ushtarake, blemje e mirëmbajtje automjetesh të ndryshme për shërbimin e autotransportimevet, shpenzime për funksionimin e autorepartit t'oficinës s'automobilave, shpenzime për transportim dhe mjete private « 52.000
Kap. 16. Qira ushtarake « 10.800
Kap. 36. Ndertime të reja ushtarake, transformime të mëdhaja të gjanave të pa tundëshme në përdorim ushtarak, instalim vijash telefonike të përhershme « 18.000

S h u m a fr. ari 88.800

Art. 3.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Art. 4.

Kjo Ligjë hyn në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi transferim fondesh në budgetin 1933-934 të Komandës Mbrojtjes Kombëtare, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 189-I datë 24-III-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 7 Prill 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P të Mbrendëshme MUSA JUKA

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 49.

LIGJE, 20 Prill 934

Mbi krijimin e Ofiqit të Nën Ministrit në Ministrin e Ekonomis Kombtare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Prill 934, Nr. 25.)

Art. 1.

Në Ministrin e Ekonomis Kombtare krijohet ofiqi i Nën-Ministrit me të drejtat e caktueme në këtë ligjë.

Art. 2.

Nën-Ministri emnohet me Dekret Mbretnuer në bazë të propozimit të bamun prej Kryeministris mbasi të jetë marrë edhe mendimi i Ministrit t'Ekonomis Kombtare.

Nën-Ministri duhet të ketë kompetencë së-paku në njenën nga degët q'i përmbledhë Ministria e Ekonomis Kombtare. Aj duhet të ketë cilsit e Ministrit.

Rroga e Nën-Ministrit caktohet në budget.

Art. 3.

Nën-Ministri ka për detyrë të dirizhoj shërbimet q'i përkasin kompetencës së tij. Aj asht Keshilltari responsabël i Ministrit dhe vepron si i deleguemi i tij tue, marrë vendime ndër çështje q'i përkasin kompetencës së tij, ose ndër çështje q'i referohen prej Ministrit.

Vendimet e tij nuk mund të refuzohen prej Ministrit pa çfaqë arsyena justifikuese me shkrim. Në këtë rast vendimi definitiv merret nga Këshilli Minstruer në bazë të drejtimit të Ministrit ose të Nën-Ministrit.

Art. 4.

Çdo akt që komunikohet prej Ministris s'Ekonomis Kombtare duhet të ketë edhe kundër-firmën e Nën-Ministrit.

Art. 5.

Nën-Ministri merrë pejsë ndër bisedimet e Këshillit Ministruer vetëm për çështjet që i përkasin detyrës së tij ose kur thëritet; në Këshillë Ministruer aj ka vetëm votë konsultative.

Art. 6.

Nën-Ministri heq fatin e Ministrit t'Ekonomis Kombëtare dhe, pra, me dorhekjen ose rëximin, për çdo shkak qoftë, të Ministrit vetiu rrëxohet edhe Nën-Ministri.

Art. 7.

Për fajet e rrjedhuna nga detyra ose në detyrë e sipër Nën-Ministri, akuzohet dhe gjykohet në bazë të proçedurës së caktueme për Ministra.

Art. 8.

Kjo Ligjë hyn në fuqi prej datës së shpalljes ën Fletoren Zyrtare.

Art. 9.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi krijimin e ofiqit të Nën-Ministrit në Ministrin e Ekonomis Kombtare, e votueme prej Par-

lamentit si mbas shkresës Nr. 248-I, datë 17-4-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, më 20 Prill 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i P. të Mbrendëshme
Zav. Ministri i Ek. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
M. IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 50.

LIGJE, 23 Prill 1934

Shtojcë-e ligjës së pyjeve e kullosave mbi përjashtimin e disa prodhimeve pyjore, nga çmimi e taksa

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Prill 934, Nr. 25)

Art. 1.

Në modifikim të artikujve 72, 75, 76, 77, 94, e 97 të ligjës së Pyjeve e kullosave sot në fuqi, përjashtohen nga çmimi ose nga taksa:

a) Vadhanidhi (lendë) mazija (goglat e lisit) frytet e pishës si edhe çdo fryt tjetër qi nxjerret nga drujt e egrë pyjore, si dhe lulet, gjethet e lëvoret e këtyne lloj druve, gjith ashtu rrëshinat, sekeznat e peshkevja (katrani) kallamat, zhuka, si edhe pjesët ajrore të druve të shqemes (somaku) qi mbledhin e pregadisin nga pyjet shtetnore Komunale e private dhe transportojnë nëdr qytetet katundarët tuej përdorë në këtë rasë vetëm fuqin familjare të tyne e mjetet bartse qi disponojnë (me krah ose me kafshë) pa kurrnji tjetër ndërhyrje ndihme.

b) Druët qi i epen popullit për ndonji përmirsim bujqsije, industrije të landës së vendit ose të zotnuesve të sharrave për ndrëtim a rindreqje të këtyne nga Pyjet Shtetnore Komunale e private.

c) Deri në 50 kuintal qymyr qi u epet atyne katundarve qi sigurojnë gjallnimin e tyne vetëm në tregti të druve e të qymyrit të nxjerrun nga Pyjet Shtetnore.

BKSH

ç) Drujt e shpërndamë ndër ara e kopshtije private të dokumentueme me dishmi të Pleqësis së katundit ose të lagjes.

d) Drujt e çdo lande kombustibel qi nxjerret nga pyjet private e komunale e qi përdoren në shumicë për punim të çdo lloj fabrike, të furrave të gëlqeres e të tjerave industrina baltnore.

dh) Të gjith landa. druët e zjarmit e qymyrit qi nxjerret nga pyjet private e qi eksportohen jashtë Shtetit.

Në këte rasë taksa përkatse nxjerret e mbahet si depozitë dhe u kthehet t'interesuemit mbasi, ky të paraqesë nji akt doganuer qi të dishmojë eksportimin.

Art. 2.

Në modifikim t'artikujve 15 e 16 të ligjës mbi shitjen e landës pa shpallje, dekretue me 29-V-926 përjashtohen nga çdo çmim a taksë të gjith prodhimet e industrinave të vogla druesore si edhe landës që pregadisin e sjellin në treg katundarët me krah ose me shtazët bartëse të vetat si ç'emertohen në artikujt në fjalë.

Art. 3.

Përjashtimi nga çmimi ose nga taksa nuk do të shkaktojë kurrnji ndryshim o përjashtim të detyrave qi cakton Ligja e Pyjeve e kullosave për sa i përket marrjes së lejes, damkimit, kontrollimit e tjera formalitete.

Art. 4.

Ministrija e Ekonomis Kombtare, Ministrija e Financavet dhe ajo e Drejtsis ngarkohen me zbatimin e kësaj Shtojcë-Ligje, e cila hyn në fuqi me shpalljen e saj në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Shtojcë-Ligjës së pyjeve e Kullosave mbi përjashtimin e disa prodhimeve pyjore nga çmimi e taksa, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 168/I datë 20-III-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 23 Prill 1934. ZOG

Zav. Kryeministri — *Ministri i P të Mbrendëshme*

Ministri i Drejtsisë — *Zav. Ministri Ekonomis Kombëtare*

V. AVRAMI — MUSA JUKA

Ministri i Financavet

A. DIBRA

Nr. 51.

LIGJË, 23 Prill 1934

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 219.000 në buxhetin e ushtrimit 1933-934 të Ministris s'Arësimit e të Komandës Mbrojtjes Kombtare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Prill 1934, Nr. 25.)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjeve të shpenzimeve të ushtrimit financjar 1933-934 paksohen fondet për dikaster e kapitull si vijon:

Ministrija e Arësimit:

Kap. 4. «Shpenzime Zyreje» Fr. ari 5.000

Kap. 8. «Subvencjon Entit Kombtar «Djelmnija Shqiptare» për shpenzime «Edukatës Fizike» « 50.000

Kap. 9. «Bursa studentash të mbrendshëm e të jashtëm» « 61.000

Kap. 10. «Kerkime dokumentash historike e shbërblime për përkthimin e tyne» « 1.000

Kap. 11. «Taksa Shtetnore doganore për landët e nevojshme për shkolla të ndryshme etj» « 13.000

Komanda e Mbrojtjes Kombtare:

Kap. 4. «Shpenzime për mbajtjen e të smundëvet ndër Spitale e ndër infermierina garnizonit, ushqim i posaçëm për të shtruem, rrogë personeli civil të spitalevet, blemje e mirë mbathje e shpërndamje barnash e materjal shëndetsuer, shpenzime të ndryshme shëndetsije, shpenzime ndër Spitale civile të Shtetit, shpenzime për vorrime, shpenzime për oficera qi dërgohen për shërim ndër spitale të jashtme për sëmundje të marrun në sherbim Fr. ari 5.100

Kap. 8. «Blemje e përsëritje si e mirëmbajtje e mobilave e materjalit të kazermave, kashtë për shtresë ushtarësh, zjarm e dritë « 20.000

Kap. 12. «Blemje kafshësh, shpenzime për rekruizime kafshësh, shpërblim oficjerave për humbje kafshësh « 900

Kap. 14. «Punime, mirëmbajtje, përmirësime e s'madhime të ndërtesavet ushtarake, mirëmbajtje e përsëritje e materjalit të lujtëshëm të Xhenjos e të Artileris, ushtrime e mirëmbajtje të vijave telefonike ushtarake, funksionim' i oficerave, shperblim damesh

të bamuna pronësinavet private prej ushtrimeve ushtarake, transport materiali ndertimi e shpenzime të ndryshme të Xhenios » 20.200
Kap. 17 «Dhurata për ushtrime, gare e konkurse« « 1.500
Kap. 19. «Shpenzime të veçanta për Milicin Para-Ushtarake» « 9.000
Kap. 21. «Fond dispozicioni si mbas Art. 14 të ligjës mbi Organizimin e Intendancës së Përgjithshme « 32.300

Art. 2. Fr. ari 219.000

Fondet prej fr. ari 219.000 (dyqind e nandëmbëdhetë mijë) paksue si mbas Art. 1 të kësaj Ligje, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1933-1934 të Ministris s'Arësimit nder kapitujt si vijon:

Kap. 1. «Rrogë personeli zavendësije, alokasion, rrogë për nëpunsa n'udhtim e në rasë dorëzim zyreje, e rrogë për nëpunësa të mbetun jashta kuadrit Fr. ari 195.000
Kap. 2. «Rrogë personeli me kontratë, qira e shpenzime udhëtimi e shpërblime» « 2.500
Kap. 3. «Shpenzime udhëtimi e djete» » 11.500
Kap. 6. «Qira lokalesh e qira për tokat e Shkollës Teknike» « 10.000

Art. 3. Fr. ari 219.000

Kjo ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Trupi Ministruer.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 219.000 në budgetin e ushtrimit 1933-934 të Ministris s'Arësimit e të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 229/I datë 19-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 23 Prillë 1934. Z O G

Kryeministri: *Ministri i Financavet:*
P. EVANGJELI A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Nr. 52.

RREGULLORE 14 Prill 1934,

Për zbatimin e ligjës mbi shërbimin Veteriner

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Prill 1934, Nr. 25).

Neni 1. — Infermier-Veterinerët që sot ndodhen në shërbim, detyrohen të vazhdojnë në kursin e posaçëm të çelur prej Ministris s'Ekonomis Kombtare. Në këtë kurs mund të vazhdojnë dhe persona nga jashtë, aq sa do të caktojnë Ministrija.

Neni 2. — Kursi i posaçëm vazhdon tre semestra, ata infermier qi kan ba kurs përpara se hyn në fuqi kjo Rregulore, janë të detyruem të bajnë edhe dy semestra të tjerë. Ata Infermier që kan ba kurs në degën speciale Veterinerë në ndonji institut zyrtarë jasht Shtetit, i njifet ky si nji semestër. Çdo semestër fillon me dy Shtator dhe mbaron në fund të Kallndorit. Çdo semestër në rast të nji epidemie shtazësh ose nevojës së randë, me urdhënin e Ministris s'Ekonomis Kombëtare mund të vonohet ndryshohet e të zavendësohet me tjetër.

Neni 3. — Infermier-Veterinerët qi ndodhen në shërbimin e Shtetit ose të Bashkive dhe mbi ftimin e Ministris s'Ekonomis Kombëtare vazhdojnë në kursë, marrin vetëm rrogën e plotë të nëpunësis. Ata qi pa ndonji arësye justifikuese nuk marrin pjesë në kursin e përmendun pushohen nga puna.

Neni 4. — Ata qi vërtetojnë arësyet justifikuese me raportin e mjekut ose me akte të tjera të vlefshme, përjashtohen nga kursi i semestrit të parë dhe lihen për semestrin e dytë. Gjith'ashtu, ata qi me arësye justifikuese nuk mund të vazhdojnë ma tepër se dy muej rresht në kurs, lejohen për me marrë pjesë në kursin e ardheshëm.

Neni 5. — Personat nga jasht që dëshirojnë me marrë pjesë në kursin e përmendun në nenin 1, nuk duhet të jenë në nji moshë ma të vogël se 16 dhe ma të madhe se 19 vje, dhe lypset të tregojnë çertifikatat e poshtë-shënueme mbi cilësiënat vijuse:

a) Letër-njoftimin Shqiptar;

b) nji dëshmi qi të vërtetojë se kandidati ka mbarue nji shkollë plotore;

c) Nji dëshmi të Bashkis ose të Komunës ose të Këshillës të Administratës së vëndit, me të cillën të vërtetohen sjelljet e mira dhe morale;

BKSh

ç) Nji raport i mjekut qi të vërtetojë shëndetin e plotë të kandidatit e sidomos mos pasjen e ndonji sëmundjes ngjitëse;

d) Një çertifikatë e dhanun prej Ministriës s'Ekonomis Kombëtare me të cillën të tregohet kapaciteti trupor i kandidatit për Infermier-Veterinar.

Neni. 6. — Kuer prezantohen ma shumë kandidat nga sasia e caktueme prej Ministris s'Ekonomis Kombëtare, midis atyne që kanë cillësi të njejta përpara nji Komisioni t'emnuem prej sajë, çelet nji konkurs dhe zgjidhen fituesit e duhun.

Nxanësit e degave të bujqësis të Shkollës Bujqësore të Lushnjës, të shkollës Shqiptaro-Amerikane të Kavajës dhe të shkollës Teknike të Tiranës, kuer nuk janë ma shumë nga sasia e caktuar preferohen pa kurs.

Neni. 7. — Mësimet qi do të ndiqen në kurs do të ndahen në katër pjesë dhe do të caktohen hollësisht me instruksione të posaçme të Ministris së Ekonomis Kombëtare mbi fiziologji, zootekni, anatomo-eksteriore, alimentasion, higjenië, smundje ngjitse, kontroll i mishnave bakteriologji, mbathmeni, anatomie pathologjike, parasitologji dhe mësime për lidhje plagësh.

Neni 8. — Në fund të ç'do semestri para nji komisioni veterinarësh qi do t'emnojë Ministria e Ekonomis Kombëtare, do të bahet nji provim.

Ata qi nuk fitojnë në këtë provim, përjashtohen nga vazhdimi në kurs dhe nëpunësit pushohen nga puna.

Neni 9. — Në fund të çdo kursi bahet provimi i përgjithshëm. Numri i plotë asht 20. Ata qi fitojnë në tre semestra nji numër mesatar prej 15 - 20 marrin titullin Infermier Veterinar i klasit të parë.

Ata qi fitojnë nji mesatarë prej 10 - 14, marrin titullin Infermier Veteriner i klasit II-të. Kush merr nji mesatar prej 1 - 9 mund të emnohet gardian.

Mos fitimi nga nji mësim 10 numra, shkakton përsëritjen e provimit. Kuer nuk fiton nga dy ose ma shumë mësime 10 numura, nuk mund të fitojë titullin Infermier-veteriner.

Neni 10. — Infermier-veterinerët e klasit të parë kan të drejtë t'emnohen edhe n'ato vende qi nuk ka veterinerë edhe, si mbas nenit 13 të kësaj rregullore, të veprojnë kryesisht.

Infermier-veterinerët e klasit të II-të nuk mund t'emnohen ose të vazhdojnë nëpër ato vende qi nuk ka nji Doktor veterinerë.

Neni. 11. — Infermier-veterinerët që me hymjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shërbejnë kryesisht nëpër qendra të Prefekturave ose të Nënprefekturave në të cilat nuk ndodhet Doktor veteriner, kuer nuk fitojnë në kurs titullin e klasit të parë, transferohen në vende të caktueme për klasat e dytë ose për gardian, si mbas numrave që do të kenë fitue.

Neni 12. — Kuer për nji shërbim të Infermier-veterinerve qi i takon klasit të parë gjënden ma tepër kandidatë nga ay klasë; ashtu edhe në klasën e dytë ndodhen ma shumë, preferohen ata qi kan fitue numra ma të mira në kursin katër vjetor, në raste të njetja pëlqehen ata qi dijnë nji nga gjuhët Italisht, Frëngjisht, Gjermanisht ose Inglisht.

Me gjithë këto, Ministrija e Ekonomis Kombëtare ka kompetencë me gradue direkt ata qi shquhen në sherbim e sipër.

Neni 13. — Infermier-veterinerët e klasit të parë, kuer mungon veterineri kanë kompetencë:

a) Me kontrollue mishin dhe prodhimet blegtorale kuer i ngarkon e i detyron Shteti;

b) Me aplikue vaksinasionin nëpër katunde;

c) Me tredhë me dambordizzo e me përdorue trokar;

ç) Me korespondue direkt me Ministrin;

d) Me shërbye si kontrollor i zooteknikës;

dh) Me u ndodh si ndihmës Veterineri n'operacione n'otopsira;

e) Me marrë pjesë në kurs të posaçëm qi do të çelë Ministrija për specializim.

Kuer ka veterinerë si Kryetarë Zyre, veprojnë në bazë t'urdhnave dhe t'instruksioneve të veterinerit, dhe plotësojnë detyrat që i ngarkon ay.

Neni 14. — Infermier Veterinerët e klasit të II-të kan kompetencat qi vijojnë;

a) Me ushtrue profesionin e tyne kurdoherë nën urdhërin e drejtimin dhe kontrollimin e veterinerit;

b) Me ba vaksinacione në prezencen e veterinerit;

c) Për çështje teknike e administrative me korespondue me zyrën ku mvaren.

Neni 15. — Gjithë Infermier-veterinarët jan të ndaluem me ba diagnosti, me shkrue receta, me ba kure, me ba otopsi, operacion, me pregatitë raporta teknike, me ba kontrollim kafshësh nëpër dogana, me mbajtë barna shërimi dhe me bamë veprime të tjera teknike që nuk u caktohen në këtë Rregullore.

BKSH

Neni 16. — Në fundë të pesë vjetve, nga data e mbarimit të kursit tre vjetor, ç'do Infermier-Veteriner, detyrohet t'i shtrohet nji provimit në landë qi do të caktojë e do të lajmëroj nji mot ma parë Ministrija e Ekonomis Kombëtare. Infermierët e klasit të parë qi nuk fitojnë nji numur mesatar të paktën 15, zbriten në klasin e dytë dhe, të klasit dytë qi nuk fitojnë nji mesatare 12 degradohen gardian.

Ky provim bahet për çdo infermier-vetëm nji herë. Të shmangunit nga provimi në fjalë shkakton pushimin nga puna.

Neni 17. — Infermier Veterinerët jan të ndaluem me mjekue shtazët private dhe zyrtarë.

Neni 18. — Infermier-Veterinerët që gjënden në shërbim e vazhdojnë në kurs para se të pranohen, duhet të tregojnë nji dorëzani mbi detyrimin e tyne për me shërbye gjatë nji kohe prej 8 vjeç, dhe në shmangjen nga shërbimi, me pagimin e gjithë rrogave qi ka marrë në kohën e kursit dhe të pjesës së shpenzimeve qi ka ba Shteti për vazhdimin e kursit.

Neni 19. — Kush vepron kundra dispozitave të kësaj Rregulloreje pushohet nga puna dhe ndeshkohet si mbas Kodit Penal.

Neni 20. — Kjo Rregullore hynë në fuqi pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 21. Ministrija e Ekonomis Kombëtare ngarkohet me zbatimin e kësaj Rregullorje.

Zav. Kryeministri
Ministri i Drejtsis
V. AVRAMI

Zav. Ministri i Ek. Kombëtare
Ministri i P. Mbrendëshme e
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i P. të Jashtme
XH. VILA

Ministri i Arësimit
M. IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 398 datë 7-4-1934 të Kryeministris.

Si ndigjojë dhe pëlqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 20-3-1934,

D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e Rregullores për zbatimin e Ligjës mbi shërbimin Veterinerë.

Tiranë, me 14 Prillë 1934. Z O G

Nr. 53.

LIGJË, 30 Prill 1934

Ligja e Bashkive

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Maj 1934, Nr. 26.)

KAPTINA E PARË

ADMINISTRATA E BASHKIËS

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.

Bashkia asht person juridik i ngarkuem me rregullimin e plotsimin e nevojave lokale të përbashkëta të qytetit dhe të banorve të tij.

Neni 2.

Nër qendrat e Prefekturave dhe të Nënprefekturave, ku popullsia kalon 2500 frymë, organizimi i Bashkiës asht i detyrueshëm.

Bashkit e Prefekturave dhe të Nënprefekturave që gjinden të formueme vazhdojnë të jenë në funksjonim.

Kur nji popullsië, qoft edhe në sasinë e frymve të caktuem në kët Nen, çfaq nevojën për të formue nji Bashkië, kjo krijohet me propozimin e Ministriës së P. të Mbrendshme, me Vendimin e Këshillit Ministruer dhe me Dekret Mbretnuer.

Neni 3.

Organet e Bashkiës janë: Kuvendi, Këshilli dhe Kryetari.

Neni 4.

Kufit e çdo Bashkije, për veç asaj të Tiranës, caktohen me nji skicë e cila duhet t'aprovohet me vendim të përbashkët të Këshilave Bashkiake e Administrative. Këto kufi marrin formën e preme mbasi vendimi në fjalë të pëlqehet prej Ministriës së P. të Mbrendëshme dhe t'aprovohet prej Këshillit Ministruer.

Çdo Bashkië detyrohet që skicën e kufive të veta t'a pregatitë mbrënda nji vjeti qysh prej datës së shpalljes së kësaj Ligje.

Kufitë e Bashkiës së Tiranës janë:

1) Nga ana e rrugës së Durrësit (Nana Mbretneshë) mbarojnë në fillim të sheshit t'Aerodromit tue mbetur ky shesh jashtë kufinit ;

2) nga ana e rrugës së Kavajës (Bulevard Mussolini) mbarojnë 200 metra larg prej ndërtesës së Konviktit Nëna Mbretneshë :

3) nga ana e jug-lindjes mbarojnë 200 metra larg prej kufinit të caktuem për lagjen e Nëpunsave (Tirana e Ré);

4) nga rruga e Elbasanit mbarojnë 700 metra larg prej rrapit të Njumës;

5) nga rruga e Bamit marrin fund në mbarimin e vorrezave tue mbetun vorrezat mbrënda kufinit të qytetit;

6) nga ana e rrugës së Dibrës (Xhemal Pashë Zogu) mbarojnë në mbarimin e vëndit të caktuem për Spitalet, tue mbetun jashta kufinit të qytetit Kazermat e Xhenjos;

7) nga ana e veriut të qytetit mbarojnë në mbarimin e vëndit të caktuem për Stadiumin në nji largësië prej 550 metrash nga Xhamija e Haxhi Jasës.

Neni 5.

Me Vendimin e Këshillit të Bashkiës formohen, suprimohen ose bashkohen lagje, bahen ndryshime në kufijt e tyne dhe pagzohen lagje ose rruga, por vendimi në fjalë duhet t'aprovohet prej Ministriës së P. të Mbrendëshme.

Sa për ndryshimin e emnit të Bashkiës nevojitet mendimi i Këshillit të Shtetit bashkë me vendimin e Këshillit Ministruer dhe me Dekretin Mbretnuer.

Neni 6.

Çdo Shqiptar asht qytetar i asaj Bashkije ku asht rregjistrue vendas dhe gëzon të gjitha të drejtat e akordueme. Si Shqiptarët ashtu edhe të huejt përfitojnë njisisht nga sherbimet bashkijake. tue u shtrue detyrimeve të parashikueme në kët ligjë.

DISPOZITË E POSAÇME

Neni 7.

Bashkia e Tiranës për çdo çështje do të jetë e lidhun drejt për drejt me Ministrin e P. të Mbrendëshme.

DETYRAT E BASHKIVE

Neni 8.

Për veç detyrave të ngarkueme me Ligje e Rregullore të veçantë detyrat principale të çdo Bashkije janë këto ;

1) Të veshtrojë e të sigurojë pastrimin dhe rregullimin e vendeve q'i janë të hapur publikut;

2) të kontrollojë sendet që hahen, pihen dhe çdo gja q'i për-ket e përdoret për shëndetin publik si mbas ligjëve, rregulloreve dhe instruksjoneve perkatse;

3) të kujdesohet për pastrimin, higjenin, soliditetin e forcën e lokaleve ku publiku ha dhe pi, flê e ngrihet, lahet e pastrohet, zbavitet e shkon kohën si gjelltore, birrari, gazino, kafene, klub, pijetore, han, hotel, hamam, banjo, cinema, theatro, bar, dansing etj. Gjith' ashtu të kontrollojë çdo gjë që shitet e përdoret ndër këto lokale të jetë e pastër e higjenike, për ushtrimin e veprimit ndër këto lokale natën ose ditën — si mbas arësyeve të sigurimit — duke ndarë në kategorina — të caktojë klasin e pagesat e tyne dhe t'u japë leje ushtrimi, mbasi të marrë dhe mendimin e Administratës lokale, të caktojë orët që këto lokale duhet të jenë të hapur e mbyllur; të shqyrtojë tarifat e çmimeve të këtyne e t'i vërtetojë, t'u japë leje atyne personave që punojnë ndër këto lokale në qoft se zotsija dhe shëndeti i tyne asht i plotë dhe në rast të kundërt t'i ndalojë; të caktoj ditët dhe orët e pushimit të dyqanve të tregtarëve dhe të zejtarëve në festat zyrtare dhe në stinat e ndryshme;

4) t'u presë hovin dhe të ndalojë përhapjen e sëmundjeve epidemike, dhe ngjitse në njerëz e në káfshë dhe për këta, si mbas ligjës, rregullores ose instruksioneve, të vendosë masat e të bashkëveprojë me Qeveriën;

5) të kqyrë të vdekurit dhe të japë leje vorrimi; të ndalojë që kurrkush të mos varroset në vend tjetër për veç se në vorrezat e Bashkiës, të plotësojë në mënyrë shkencore pastrimin, vendosjen, bartjen e të vdekurve, varrimin e tyne, të ngrehë e t'administrojë vorreza të Bashkiës dhe vende të posaçme shkencore për të larë e pastruar të vdekurit; të djegë ose të mbulojë kafshët e shpezat e ngordhuna;

6) të mos lejojë të theren bagtië e kafsh në vend tjetër veç se n'abatoarin e Bashkiës që duhet të ketë kushtet higjenike;

7) të mos lerë sende ndezse dhe eksplozive n'asnji lokal për veç se depove të Bashkiës. Në këto depo do të lehen sasia e caktueme në ligjë, rregullore e instruksjone;

8) të shtrojë në vizitë medikale e shkencore gjithë gjell-baë-sit që ushtrojnë mjeshtërinë ndër lokale publike, hamajt, shoferët, karocierët, kaikçit, berberët, ata që shesin plaçka të vjetra

dhe ndohtësira, ata që shërbejnë ndëpër qumështoret, ata që shesin qumësht, dhe çdo person tjetër të ksaj kategorije dhe ata puntorë që, në rast të shërbimit, janë në kontakt me populin; prej këtyne ata që marrin çertifikat aftësije dhe shëndeti t'u japë leje punimi dhe këta, duke i rregjistruar, kuerdoherë ata që nuk janë rregjistruar t'i ndalojë. Për të caktuar aftësinë e kaikçive do të merret mendimi i Kapitenerisë së Portit ku shërben, dhe për aftësiën e shoferave i Komisjonit të posaçëm;

9) të kujdesohet për forcën dhe për pastrimin e gjithë mjeteve të transportit detar që të lëvrijnë mbrënda kufinit të Bashkiës si në detë, në liqên e lumë. Këto mjete transporti që lëvrijnë në juridiksjonin e Bashkiës si stimbot, motorbot, çdo lloj kaike, maune, sallapura, e që përdoren si mjet transportimi dhe kaiket e vogla e sandallet private dhe mjetet e transportimit toksor q'ushtrojnë mjeshtërinë e tyne në vendet publike si karroca për të hipur a për ngarkim, kafshët e tyne, autobusat, automobilat dhe gjithë mjetet e tjera i shtrohen këtij kontrollimi; të kontrollojë gjithë mjetet e transportit që punojnë mbrenda kufive të Bashkiës për me qenë këto në gjendje të mirë.

Bashkija ka për detyrë edhe mjeteve të transportit në fjalë t'u caktojë maksimumin e shkalles së fuqiës okupuese (sa veta mbajnë) dhe të durimit, kategorinë e numrin e mjetit, dhe të kontrollojë aftësiën dhe shëndetsiën e atyne që i punojnë.

Bashkija detyrohet edhe të caktojë tarifen maksimale të pagesës për këto mjete dhe të marrë masa për respektimin e ksaj tarife dhe në rast nevoje këto t'i sigurojë e t'i administrojë vetë dhe të kontrollojë her pas here si dokumentat e aftësiës të mjetit ashtu edhe t'atij q'e punon. Në caktimin e fuqiës mbrënda kufive të Bashkive tarifa e pagesës mund të plotsohet dhe me taksimetra. Për caktim të fuqiës okupuese dhe forcën e mjeteve detare duhet të merret mendimi i Kapiteneriës së Portit;

10) të zhdukë nga vendet publike çdo gja që pengon kalimin e njerzve ose qarkullimin e punimin e mjeteve të komunikacionit ose që damton ata që kalojnë ose kta i mërzit ose që mund të provokojë aksidente; gjith'ashtu të heqi dhe çdo gja që prish pastertinë e përgjithshme të qytetit. Të caktojë, si mbas llojit të tyne, maksimumin e minimumin e shpejtësiës që do t'ecin mjetet e komunikacionit mbrënda në qytet, vëndet ku këto mjete do të punojnë e ku jo, ku do të qëndrojnë ku do t'ecin me ngadalë dhe të

përpilojë tarifën e çmimeve dhe këtë t'a shpallë; të sigurojë rregullin e pergjithshëm.

Përshtatë rregullores internacionale të qarkullimit t'automobilave mbrënda kufinit të Bashkiës të verë shenjat e duhura për qarkullimin dhe të kontrollojë automobilat dhe shoferat në qoft se i kanë cilsiët e lypuna prej ligjës.

Nër vendet që gjenden breg detit duhet të meret mendimi i Kapiteneriës së Portit;

11) t'u japë leje për t'okupuar nji pjesë nga vendet publike si rrugë shesh, pazar, skele, urë, lumë, liqên, dét, në mënyrë që të mos pengohet kalimi, gjith'ashtu, provizorisht, të japë leje për çdo punim që të bahet t'okupohen ose të përdoren vendet e destinueme për publikun. Bashkija e ka për detyrë të ndalojë çdo person a institut që okupon vend pa lejen e sajë;

12) t'i japë leje, si mbas pjesës përkatse të ksaj ligje, për gjithë konstruksjonet, meremetimet dhe për shtojcat e tyne. Konstruksjonet e filluara jasht ligjës ose pa lejen e Bashkiës me nji herë rrëzohen edhe kondra guximtarit zbatohen dispozitat e posaçme të kësaj ligjë;

Bashkija ka për detyrë edhe të shembë ndërtesat gati në rrënim dhe muret, të mbyllë puset e ndodhuna nëpër troje ose në vendet e djeguna ose të çdukë rrezikun e tyne;

13) të caktojë vendet e punimeve (fabrika, uzina, garazhe) të prodhimeve, të depozitimeve, të ndërtimeve që mund t'efektojnë prerjen e shëndetit publik, gjith kështu të veprojë për lemejt, vorrezet, pazaret, depot e vajgurit, depot e qymyrit, dhe vendet e plehrave dhe mbas kësaj të lëshoj lejen. Bashkija vendin e katojve publike, të kashtorve e të barit publik që do të goditen rishtas, e cakton vetë dhe ata që ndodhen sot i transformon dhe i shtron në mënyrë që të ruhen konditat e pastrimit;

14) të caktojë vendet ku mund të mblidhen dhe të shpërndahen dhe udhët nga ku duhet të kalojë kafshët e bagtiët; të caktojë dhe të vendosë gjoba për të zotët e kafshëve, të bagtive, të shtazëve dhe të shpezave që lehen me shetitë pa zot nëpër rrugat dhe sheshet e qytetit, tue veprue si mbas dispozitave ligjore në fuqië për ato kafsh e bagtië e shpezë të cilat nuk kanë zot;

15) të kontrollojë shitsit jo zyrtarë që shesin me adjudikatë të çelur, të peshojë e të matë çdo gja që shitet enblok në vendet publike si mbas pjesës përkatse të kësaj ligje, të damkos e të vulos gjithë mjetet e veglat e peshimit e të matjes;

16) të sigurojë respektimin e zbatimin e tarifave të çmimeve dhe të pagesave maksimale dhe herë pas here të pregatitë e të shpallë këto çmime;

17) të ndalojë dhe të marrë çdo masë ndalimi për lypësit;

18) të kujdeset, t'i mbledhë e t'i vështrojë fëmijt e lanun, e të gjetun nëpër rrugë, të marrët, të çmendunit dhe të tërbuarit, ata që bien vilanije nëpër udhët, ata që pësojnë ndonji aksident ose katastrofë;

19) të ruaj nga damet pyjet, arat, lumejt, kopshtijet, vneshtat, korrijet, livadhet, meratë, burimet e ujnave dhe të gjithë tokët që ndodhen mbrenda kufinit të Bashkiës;

20) të marrë çdo masë ndaluese kur bje zjarrë, të caktojë të shpallë, të pregatitë dhe të sigurojë gjithë mjetet rezerve kundra zjarrit që duhet të ndodhen në vendet publike, nër vendet e punimeve dhe ndër fabrika dhe në çdo dyqan, për të parë, për të marë vesht e për të lajmëruar zjarr, të bajë organizimie e të ngrehë institutet e nevojshme për çdo eventualitet kuer doherë të ketë gati dhe në nji gjendje të mirë e të profitueshme tullumbat, automobilat zjarrfikëse me gjithë personalin e mjetet e plota, kundrejt zjarrëve të pyjeve që mund të rrezikojnë qytetin të ketë gati në depo, si kazma qyrek, spata dhe çdo vegël tjetër zjarrfikëse: në lagjet e ndryshme të qytetit të ngrehë e të goditë kanze, sarniça etj. për depozitim uji;

21) të mbaj pastër në mënyrë permanente, të lajë me ujë të pastër e të vaditë gjithë vendet publike, si rrugët, sheshet, skelet, urat, pazaret, panairet në dimër të ngrerë baltrat dëborën e akujt e ktyre dhe të sigurojë të mos shkasin ata që kalojnë nëpër te;

22) të mbledhë, të heqë dhe të çdukë me veglat e rregullshme e shkencore të gjitha plehrat e lëmizhdat e vendeve publike e private;

23) të sjellë ujë, ujrat t'i mbajë të pastërta higjenike si mbas projekteve të pregatituna prej autoritetit teknik ma të naltë në Shqipnië;

24) të pastrojë vijat e ujit të përbashkta që ndodhen mbrenda kufinit të Bashkiës për të vaditur vneshtat, kopshtijet, arat, dhe bostanet e përbashkta. Të mermetojë vijën e rrugat e ktyne dhe të nxjerrë gjithë shpenzimet e pastrimit e të meremetimit prej t'interesuemvet.

Të thajë dhe të detyrojë t'i thajnë t'interesuemit pellgjet e ujnave të kopshtijeve, t'arave, të bostaneve dhe të gjithë vendeve

publike herë pas here, në mënyrë shkencore të ndërrojë e të pastrojë ujrat hauzet publike e private ose të detyrojë t'interesuemit për ketë veprim;

25) të ngrehë si mbas nevojës, nevojtore publike, me pagesa e pa pagesa, të sigurojë që nevojtoret që janë të detyrueshme për t'u bërë në ndërtesat publike e private të goditen duke patur konditat higjenike;

26) të sigurojë që vendet ku shiten e ku mbulohen sendet që do të hajë e do të pijë e do të përdorë publiku të kenë konditat higjenike, gjith'ashtu vendet ku mbrenda do të banojë, do të flejë. do të rrijë, do të punojë e do të veprojë publiku ose do të vendosen bagtiët e kafshët duhet të kenë konditat higjenike;

27) të bajë, me pagesa dhe pa pagesa, vizita mjeksore, veterinare, shkencore dhe analizime kimike baktriologjike për njerëz. kafshë, plaçka dhe pasurijë, dhe t'i japë raporta mbi konditat higjenike. Këto bahen në raste që ligjët ose vendimet detyrojnë Bashkiën, ose kur i drejtohen ksaj fakultativisht;

28) të pregatitë hartat, kadastron dhe planet e forcës s'ardhshme të qytetit dhe të caktojë e të zbatojë nji program punimi për lulëzimin të paktën pesë vjeçor;

29) të rregullojë dhe të përmirsojë rrugat e lagjeve të qytetit përshtat planit dhe programit të punimit; të caktojë klasat emrat dhe numrat e ktyre dhe, si mbas ksaj, t'i pyllëzojë (të verë pemë) t'i shtrojë, t'i ndriçojë, e t'i zbukurojë; të bëjë vende të posaçme për të qëndruar për të denjur, për t'u çlodhur, dhe këto t'i mbajë në gjendje të mirë;

30) të bëjë kanalet dhe gropat tue u përshtat planit rregullues të qytetit dhe programit të punimit dhe si mbas planeve të pregatituna prej autoritetit teknik e si mbas ksaj ligje e kto kanale e gropa t'i meremetoj vetë ose të detyrojë t'interesuemit;

31) të hapë bibliotheka dhe sallone këndimi për popullin, të godisë kopshte, fidanishte, kopshte foshnjore, vende për lodra e sport, të rritë korrije të Bashkiës, këto t'i ruaj e t'i punojë. Për këto vepra, ndër ato Bashkië ku nuk ka specialista të mjaftë. Administrata lokale detyrohet t'u japë ketë personel e t'u ndihmojë;

32) t'u ndihmojë fëmijve binjakë, familjeve të varfëra me gjithë fëminë binjak, të vobektë, dhe ate pa njeri, ktyre t'u ndihmojë me të holla, me mjekë dhe barna, për të ngranë, për të pirë, për të veshur, për të fjetur, për të vizituar këto, të vizitojnë gratis të sëmurët e vobekët, t'u japë barna, të ngrerë gratis të vdekurit

të vobektë, t'i kujdesohet e t'i ushqejë invalidet ata që nuk janë të zotët për punë kuer këto nuk kanë njeri tjetër për t'u kujdesuar për ta;

33) të rregullojë dhe të mbajë në gjendje të vazhduarshme gjithë ujrat, çesmet, hauzet vendet ku pjestohen ujrat, depot burimet e ktyre që i përkasin Bashkiës;

34) të ngrerë e të mbajë për publikun mbrenda kufinit të Bashkiës, skele, moll (riktim) dhe ura si mbas planit;

35) të rregullojë e t'i lulzojë, si mbas ligjës vendet e djeguna dhe vendet që do të bahen lagje; si mbas kësaj ligje të shqyrtojë e të zbatojë planet për meremetim e shtesa ndërtesash;

36) të kontrollojë si në fillim t'instalimit ashtu edhe herë pas here rregullisht e pa pushim në mënyrë teknike instalacionin e elektrikut, të ndriçimit, kazanat, oxhaqet, bazhat, maqinat, motorat, ibikat e të gjithë instituteve industriale dhe të fabrikave; të studjoj në qoftë se këto institute bajnë efekt të keq mbi shëndetin, prehjen dhe pasurinë e atyre që ndodhen përqark dhe në rast nevoje të ndalojë damin e ktyre;

37) të jape raporta për vizitë teknike dhe dëshmië për çdo konstruksion dhe instalasion në rast kur ligja e detyron Bashkiën dhe në rastet fakultative kur i interesuemi detyrohet. por në qoftë se nuk ka institute për të bërë studimet në fjalë këto veprime Bashkiake i siguron me anën e institutit ma t'afërm:

38) të lerë n'abatoarët në mënyrë teknike e higjenike të gjitha aksesoret e nevojshme për punim;

39) të ngrerë depo për vaj-guri, benzin e për çdo send eksplosiv;

40) të bajë sheshe, parqe dhe vende pazari;

41) të caktojë çmime maksimale, të mishit dhe të bukës drejtë për drejtë dhe në rast nevoje gjithë sendeve ushqimore. Ky çmim viret në zbatim mbasi të jetë marrë edhe vendimi i Këshillit Administrativ të vendit;

Në rast nevoje Bashkia për t'i prerë hovin spekullimit të sendeve ushqimore dhe për të siguruar lirsinë e jetesës të bëjë vetë veprimet e shitjes dhe të blerjes së stokut. Të sigurojë që qumështrat që shiten në qytet të jenë të pastërta, të thjeshta dhe të pa përzime me sende të tjera. Për t'i arritur këtij qellimi, Bashkiët kanë të drejtë t'i detyrojnë shitsit që t'a sjellin qumështin në zyrën e shëndetsiës të Bashkiës për analizimin pa pagesë;

42) të rregullojë e t'administrojë veprimet e shpalljeve ndë-

për sheshe, parqe, rrugë, udhë, e në çdo vend tjetër publik;

43) të ngrehë e t'organizojë strehën vorfnore, azile, shtëpië për të lindur për të dhenë sisë, të ngrehë e të mbajë, mbasi të jetë marë mendimi i autoritetit shëndetsuer lokal, çmendina e stacione dizinfektimi;

44) të bajë vende për kurse;

45) të kontrollojë sahatat dhe veglat që tregojnë konsumin e vajgurit, t'ujit, t'elektrikut ose taksimetrat, si mbas ligjës, drejtë për drejtë ose mbi drejtimin e t'interesuemit;

46) t'u gjejë punë atyne që janë pa banim e pa mbështetje dhe në gjendje mizore. Ata që nuk munden të punojnë ose që Bashkia nuk mundet t'u gjejë punë, t'i dërgojë ndër vendet e tyre me shpenzimet e Bashkiës.

Të mbrojë e të përkrahë gratë e fëmijt pa njeri;

47) të mbledhë t'ardhunat e Bashkiës;

48) të paguaj shpenzimet e nevojitura për shërbimet e Bashkiës;

49) të rregullojë pasunit e tundëshme dhe të pa tundëshme;

50) të bajë qendra për ndihmë shëndetsore dhe për përkujdesje;

51) të ngrehë e të mbajë me pagesë e pa pagesë spitale, si mbas planit të pëlqyem dhe prej autoritetit ma të naltë të Shëndetsiës e të Ministriës P. Botore, përshtat nevojave të Bashkiës;

Të ngrehë e të mbajë spitale kafshësh për sherimin e kafshve shtëpijake;

52) të ngrehë e të mbajë stadiume për brezin e ri, në proporcion të nevojave lokale;

53) t'inspektojë banjat edhe çdo godinë për t'u larë;

54) të sigurojë hapjen e nji farmacie ku nuk ka. T'u japë të vorfënve barna pa të holla ose me çmime të lira. Të hapin vende medikale ose dispenserina dhe të mbajë në shërbim mamina;

55) të ngrehë merkato ose vende të posaçme për shitje-blerjen e sendeve ushqimore, si mish, peshk, zarzavate e pemë, që i shtrohen kontrollimit dhe konditave higjenike, tue detyrue shitsit e ktyre sendevet të vendosen në këto merkato;

56) të caktojë pazare për drue e qymyr;

57) të ngrehë e të punojë sergjië, panaire e muzera për prodhimet dhe punimet e industriës kombtare, mbasi të merret leja e Ministriës s'Ekonomiës Kombëtare;

58) të hapë e t'i punojë salla adjudikatash;

59) të bëjë vende fjetjeje për të varfërit e këto t'i administrojë ;

60) të bajë në mënyrë shkencore e higjenike për larje e pastrim lëveresh publike ose të japë leje për ngrehjen e ktyne dhe mbas ngrehjes t'i kontrollojë këto; dhe

61) të bajë inspektime higjenike të fabrikave dhe të shtëpive te punës, të puntorve dhe të banuesve të ktyne.

Neni 9.

Nga detyrat e Bashkive të përmenduna në nenin 8, janë të detyrueshme paragrafet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 14, 15, 16, 18, 19, 20, 21, 22, 25, 26, 29, 32, 36, 39, 40, 41, 47. 48. 49. 53. 55 dhe 61.

Janë fakultative paragrafet 11, 12, 13, 17, 23, 24, 27, 28, 30, 31, 33, 34, 35, 37, 38, 42, 43, 44, 45, 46, 50, 51, 52. 54, 56, 57, 58, 59, 60.

Çdo Bashkië asht e detyrueme ma parë të plotsojë detyrat obligatore të përmenduna në paragrafin e parë të këtij neni, e masandaj të përmbushin detyrat fakultative të permenduna në paragrafin e dytë të këtij neni, për veç kuer për arsye të justifikueshme çfaqet ma parë nevoja me përmbush ndo nji prej detyrave fakultative,, por në këto raste merret pëlqimi i Ministriës së P. të Mbrendëshme.

Detyrat obligatore do të përmbushen tue u preferue ma parë ato të randësishme, dhe këto plotsohen gradualisht, si mbas fuqiës financjare të secilës Bashkië.

ORGANIZIMI I BASHKIVE

Neni 10.

Bashkia përbahet prej :

1. Kuvendit të Bashkiës;
2. Këshillit të Bashkiës;
3. Kryetarit të Bashkiës; dhe
4. Personelit të shënuem në kuadron e çdo Bashkije, si mbas nenit 208.

KUVENDI I BASHKIËS

Neni 11.

Kuvendi i Bashkiës formohet prej :

1) Gjashtë Antarve, ndër ato Bashkië që kanë nji popullsi prej 2501 deri në 5000 frymë;

2) dhjetë antarve ndër ato Bashkië që kanë nji popullsië prej 5001 deri 10.000 frymë.

3) katërmbëdhet antarve ndër ato Bashkië që kanë nji popullsië prej 10.001 deri 20.000 frymë;

4) gjashtëmbëdhetë antarve ndër ato Bashkië që kanë nji popullsië prej 20.001 deri në 30.000 frymë.

Në qoftë se nji Bashkië ka ma tepër se 30.000 frymë, për çdo 5000 shtohet nji antar.

Për ato Bashkië që janë në funksjonim përpara shpalljes së ksaj ligje, e që kanë ma pak se 2500 frymë, veprohet si për ato Bashkië që kanë 2501 frymë.

MËNYRA E ZGJEDHJES DHE E FUNKSJONIMIT T'ANTARVE TË KUVENDIT

Neni 12.

Zgjedhja e antarve të kuvendit bahet prej popullit me votim direkt nji muej pas hymjes në fuqië të ksaj ligje dhe do të përsëritet në çdo katër vjet nji herë.

Kuvendi nis në detyrë 15 ditë pas mbarimit të zgjedhjeve.

Zgjidhen antarë ata që gëzojnë cilsit e tregueme në këte ligjë dhe fitojnë shumicën e votave.

Antarët plotsues janë ata që kanë fitue të paktën nji të dhetën e votave të hedhuna.

Neni 13.

Votuesit duhet të kenë këto cilsië:

1) të jenë nënshtetas Shqiptarë;

2) të jenë qytetarë ose të kenë nji qendresë të paktën 6 muajsh;

3) të kenë mbushë moshën 20 vjeç;

4) të mos jenë rrëzue nga të drejtat civile; të mos jenë ndalue nga ofiqet publike;

5) të mos jenë nën tytorië, kujdestarië ose të falimentuem dhe të mos jenë lypes, ushtarë ose gjindarmë në sherbim aktiv.

Neni 14.

Antarët e Kuvendit, për veç cilsive të parapame në nenin e ma sipërmë, duhet:

1) të mos jenë të dënuem me një delikt çnderues ose kundra zakonit të mirë;

2) të mos jenë sipërmarrës i punve të Bashkiës ose shok a

BKSH

dorëzanës i këtyne. Të mos jenë nëpunës Shteti ose nëpunës i shoqrive koncesjonare të Bashkiës;

3) të mos jenë antarë të Këshillit t'Administratës Shtetnore;

4) të mos marrin ndonji ndihmë nga arka e Bashkiës;

5) të mos jenë në gjyq me Bashkiën;

6) të mos kenë n'administrimin e tyne ndonji pasunië të tundëshme ose të pa tundëshme;

7) të mos jenë debitorë të Bashkiës;

8) të mos jenë funksjonarë fetarë;

9) të dijnë të shkruajnë dhe të këndojnë gjuhën zyrtare.

Neni 15.

Nuk mundet njikohësisht të marrin pjesë në kuvendin e nji Bashkije at e bir, ungj e nip, gjysh e sternip, vjerrë e dhander. ose dy vllazën; në qoft se votohen dy veta të kësaj kategorie, quhet i zgjedhur ay që ka marrë ma shumë vota se tjetri; në rast njisije votash hidhet short.

Neni 16.

Votimi për zgjedhjen e antarve të Kuvendit të Bashkiës, bahet drejtë për drejtë dhe përmbarohet botnisht nën kujdesjen e një Komisioni, i përbamë prej dy antarve të zgjedhur të Këshillit Administrativ të qarkut të Prefekturës, ose të Nënprefekturës, nga e cila mvaret Bashkia. Komisioni mblidhet nën Kryesinë e Gjyqtarit Paqtues në qendrat e Prefekturave dhe të Ndihmës Gjyqtarit Paqtues ose të nji nëpunsi të Drejtësiës të deleguem prej Gjyqit Kolegjal, në Nenprefekturat.

Neni 17.

Komisioni para se të proçedojë në veprimet e zgjedhjes, do të kërkojë prej zyrës së Gjendjes Civile nji listë që të përmbajë emnat e mashkujve 20 vjeç e naltë, tue kerkue edhe nga Prokuroria emnat e të burgosunve ose të dënuemve me fajet e caktueme prej ksaj ligje, si edhe nga Bashkia listën e atyneve, të cilët nuk mund të zgjidhen.

Lista e shqyrtueme, mbrenda 10 ditve nga data në të cilën i kanë marrë në dorëzim, do të varen në vende publike dhe para zyrës së Bashkiës.

Neni 18.

T'interesuemit që nuk i binden shqyrtimit të Komisjonit prej datës së njoftimit mbrenda 5 ditve kanë të drejtë t'apelojnë ven-

BKSH

dimin e Komisioni për para Gjyqit Kolegjal në Prefektura dhe para Gjyqit Paqtues ndër Nënprefektura, autoritete këto që japin vendimin definitiv, në bazë të cilit veprohet.

Neni 19.

Pesë ditë para varjes së listave, Komisioni detyrohet me anë shpalljesh të posaçme nder vise publike dhe me anë kasneci, të lajmëroj qytetarët mbi pikat e posht-shenueme:

1) Ditën e varjes së listave;

2) Afatin e 10 ditve;

3) Afatin e kundërshtimit dhe t'apelimit;

4) Caktimin e lagjeve dhe t'orëve, në të cilat do të bahet votimi.

Neni 20.—

Ditën e caktueme për zgjedhje, para procedimit të hedhjes së votave Komisioni publikisht kqyrë rregullsinë e arkës, e cila, mbasi të jetë vulosë me dyll të kuq dhe me vulen e Bashkiës, mbyllet me dy çelsa prej të cilave njanin e mban Kryetari i Komisionit dhe tjetrin Bashkia.

Votimi fillon në lindjen e diellit dhe merr funt n'orën 5 mbas drekre mbasi të konstatohet se nuk ka votuesa të tjerë.

Neni 21.

Çdo votues detyrohet t'i shkruajë vetë ose ku të dëshirojë, në nji biletë të bardhë, emnat e aq personave sa do të zgjidhen për Antarë të Kuvendit.

Emnat që nuk shkruhen në gjuhë zyrtare nuk merern parasysh.

Neni 22.

Kryetari i Komisionit ose nji nga antarët e këtij këndon nji nga nji emnat me za të naltë dhe dy pjestarë të Komisionit i rregjistrojnë në dy lista të ndryshme. Biletat e rregullshme, bashke me ato që nuk kuptohen, mbasi të mbahet proces-verbali ruhen tue u vulos n'arkë.

Neni 23.

Kur votat janë aq sa që shqyrtimi nuk mund të kryhet në nji ditë, arka mbyllet rregullisht dhe shqyrtimi shtyhet për të nesërmen, mbasi listat e formulueme të nënshkruhen prej Komisionit.

Neni 24.

Komisioni në libër të posaçëm asht i detyruem të shenojë të

gjitha proces-verbalet dhe ankimet deri në mbarimin e veprimeve.

Neni 25.

Në përfundimin e shqyrtimit do të shënohen në nji listë të gjithë të votuemit me votat e tyne përkatse.

Neni 26.

Komisioni mban nji proces-verbal për antarët fitues, kopjen e të cilit i a dergon Prefektit ose N/Prefektit për plotsimin e formaliteteve të dekretimit.

Neni 27.

Nër rast njisije votash hidhet short.

Kur njani të jetë zgjedhë në dy ose ma tepër Bashkië, mbrenda dy ditve prej datës së njoftimit, ka të drejtë obtimi. Në rast heshtjeje, në mbarim të këtij afati, konsiderohet antarë definitiv i Bashkiës që ka popullsinë ma të vogël.

Neni 28.

Antari i Kuvendit rrëzohet ipso-jure prej këtij ofiqi në qoftë se:

1) Dënohet me faje kundra zakoneve të mira, ose me një faj që sjell ndalimin nga ofiqet publike;

2) i shtrohet ndonji ndalimi ose pa-aftësimi ligjuer;

3) hynë me rrogë në sherbimet qeveritare, bashkiake ose të ndonji shoqnije sipërmarrëse t'asaj Bashkije;

4) bahet sipërmarrës i nji taksi të Bashkiës ose shok a po dorzanës i ktyneve.

Mbrenda 5 ditve nga data e njoftimit mbi rrëzimin e tij, antari ka të drejtën e kundërshtimit në Këshillin Administrativ të Prefekturës ndër Nënprefektura, dhe në Këshillin e Shtetit nder Prefetkura, vendimet e të cilave janë të preme.

Neni 29.

Si votuesit ashtu edhe të votuemit për çdo pretendim ilegaliteti, mbrenda pesë ditve, nga data e përfundimit të zgjedhjeve, kanë të drejtë me kundershtue për Bashkitë e Nënprefekturave përpara Gjyqtarit Paqtues dhe për Bashkitë e Prefekturave përpara Gjyqit Kolegjal.

Si Gjykatës Paqtues ashtu edhe Gjyqi Kolegjial të shumtën mbrenda 5 ditve prej datës s'ankimit, thërresin ndergjygjësit dhe mbrenda nji muaji janë të detyruem të japin vendimin e tyne të premë.

Neni 30.

Antarët e Kuvendit të kundershtuem si mbas nenit të ma sipërm, mbeten në detyrë deri sa gjyqi kompetent, me vendimin e tij, të mos ketë vendosun anulimin e zgjedhjes.

Në qoft se numuri i antarve të rrëzuem për ilegalitet dhe shpërdorim nuk kalon nji të katerten, këta zavendësohen me antarë plotsues dhe në rasë se janë ma tepër se nji e katerta, zgjedhja përsëritet për ata që janë rrëzuem për ilegalitet.

Në qoft se gjyqi konstaton se votat ilegale ose të shpërdorueme nuk efektojnë rezultatin e zgjedhjes së kandidatit, ky nuk ka me u deklarue i rrëzuem.

Në qoftë se gjyqi konstaton se ilegalitetet ose shpërdorimet e pretendueme nuk efektojnë rezultatin e zgjedhjes së kandidatit, ky nuk deklarohet i rrëzuem.

Neni 31.

Periudha e Kuvendeve bashkiake vazhdon për 4 vjet edhe si kuer mbrenda ksaj periudhe të bahen zgjedhje plotsuese.

Neni 32.

Në arst mungese t'antarve të Kuvendit gjer në tre të katerta të tyne dhe në qoft se Kuvendi nuk mund të plotsohet dhe me Antarët plotsues numuri që mungon plotësohet me zgjedhje të reja.

Neni 33.

Kuvendi para mbarimit të periudhës, mund të shpërndahet me Dekret Mbretnuer i provokuem me vendimin justifikativ të Këshillit Ministruer në bazë të propozimit të Ministriës P. të Mbrendëshme, kur veprimet e tij ndalojnë mbarëvajtjen e punve bashkijake, damtojnë interesat e Bashkiës ose cenojnë interesat e nalta shtetnore. Dekreti i shpërndamjes shpallet në Fletoren Zyrtare.

Neni 34.

Ministrija e P. të Mbrendëshme për shkaqe me randësi dhe mbasi të marrin pëlqimin e Këshillit Ministruer, mund ta'zhurnojë mbledhjet e nji Kuvendi për nji afat jo ma tepër se nji muej.

Neni 35.

Mbrënda dy muejve nga data e shpërndamjes ose dorëheqjes së Kuvendit kanë me u përfundue zgjedhje të rea.

BKSH

Neni 36.

Sesionet ordinare të mbledhjes të Kuvendit janë katërmujore dhe për me fillue në periudhën e parë antarët e Kuvendit ftohen prej Kryetarit të Bashkiës.

Çdo sesion vazhdon gjer më 15 ditë por, në rast nevoje të çfaqun prej Kuvendit, ky afat mund të zgjatet me autorizimin e Prefektit për Bashkiën e Nënprefekturave dhe të Ministriës së P. të Mbrendëshme për Bashkiët e Prefekturave.

Neni 37.

Kuvendi i Bashkiës në sesionin e Nendorit shqyrton dhe aprovon budgetin preventiv me të gjitha hollsinat dhe cakton konstruksjonet dhe punimet që kanë me u ba në vitin financjar t'ardhëshëm.

Budgetet t'aprovueme prej Kuvendit, vehen në zbatim mbasi t'aprovohen, ato të Bashkive të Nënprefekturave prej Këshillit t'Administratës së Prefekturës dhe ato të Prefekturave dhe e Kryeqytetit prej Ministriës së P. të Mbrendëshme. Në rast që Ministrija e P. të Mbrendëshme kërkon ndryshim, çështjen i a referon Këshillit Minitruer, i cili vendos definitivisht.

Në rast se Këshillat e Prefekturave nuk aprovojnë budgetet e Nënprefekturave, detyrohen, bashkë me shqyrtimet e vërejtjet të justifikueme, t'i a referojnë budgetin për aprovim Ministriës së P. të Mbrendëshme, e cila vendos definitivisht.

Budgetet e Bashkive në çdo rast duhet të jenë t'aprovueme përpara hymjes së vitit ri.

Neni 38.

Kuvendi i Bashkiës në sesionin e Majit, shqyrton dhe kontrollon të gjitha punët e Bashkiës të bame n'atë kohë.

Në rast nevoje Kuvendi pëlqen propozimet për transferime kredinash dhe voton shpenzime dhe kredina të jasht-zakonshme ose të pa-parapame, por këto para se të vihen në zbatim paraqiten, për aprovim, Ministriës së P. të Mbrendëshme, për Bashkiët e Prefekturave dhe të Kryeqytetit, dhe për Bashkiët e Nënprefekturave transferimet marrin aprovimin e Prefekturave.

Neni 39.

Kuvendi i Bashkiës në sesionin e Gushtit shqyrton dhe aprovon budgetin konsumtiv të referuem prej Këshillit si dhe të gjitha projektet dhe aktet justifikuese të veprimit të vitit të kalu-

mun dhe ka të drejtë të kerkojë çdo far shpiegimi e çkoqitje mbi çdo çështje.

Në rast që konstaton çrregullim, abuzim, me nji vendim lajmëron autoritetin kompetent për t'u marrë masat ligjore.

Buxheti konsumtiv bashkë me vendimet e Kuvendit i parashtrohen Këshillit Kontrolues për vendim definitiv.

Neni 40.

Kuvendi, me kërkimin e Kryetarit të Bashkiës ose të Këshillit, mbasi të merret autorizimi i Ministriës së P. të Mbrendëshme, mund të thëritet në sesion të jasht-zakonshëm i cili nuk mund të vazhdojë ma tepër se 10 ditë dhe bisedon vetëm mbi pikat për të cilat asht thërritë.

Neni 41.

Kuvendi si në mbledhjet e zakonshme ashtu dhe n'ato të jasht-zakonshmet kryesohet nga Kryetari i zgjedhun prej gjinit të tij.

Kryetar' i Kuvendit zgjidhet me vota të fshehta në mbledhjen e parë të çdo sesioni.

Neni 42.

Çdo çështje që i paraqitet Kuvendit bisedohet botnisht dhe vendimet merren me shumicë votash.

Kuer ka njisië votash paravlen ana e Kryetarit. Kuer Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Bashkiës ose nji e aktërta e antarve të Kuvendit proponojnë që nji çështje të bisedohet me dyer të mbylluna kjo vendoset prej shumicës s'antarve të Kuvendit.

Neni 43.

Shumica formohet prej nji ma tepër se gjysma.

Ftesat bahen me shkresë tue u marë nënshkrimet, në rast se shumica nuk mrrihet, në nji ditë tjetër mbledhjet bahen me sa të ndodhen por jo ma pakë se nji e treta e antarve dhe kuer mos të arrihet as ky numër antarët e lajmëruem regullisht që pa ndo nji shkak të justifikueshëm nuk muerrën pjesë, quhen të rrëzuem dhe, në vend të tyne, merren plotsuesit.

Në rast zgjedhjesh të ra për shkaqet e sipër-tregueme, antarët e rrëzuem nuk mund të rizgjidhen për atë periudhë katër vjetore.

Neni 44.

Kryetari i Bashkiës ka të drejtë të marë pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe merr fjalë sa herë që t'a kërkojë pa të drejtë vote.

Kryetari i Bashkiës i paraqet Kryesiës së Kuvendit të gjitha çështjet e cila përpilon rendin e ditës.

Gjithashtu mund t'asistojnë në mbledhjet e Kuvendit Kryetari i Bashkiës dhe antarët e Këshillit të maparshëm, kur bisedohen llogaritë ose veprimet që i përkasin kohës së tyne, por duhet të largohen në kohën e votimit.

Neni 45.

Vendimet e sesioneve të zakonshme dhe të jasht-zakonshme. mbrënda 8 ditve shpallen në portën e Bashkiës dhe në viset të tjera publike.

Neni 46.

Kuvendi i Bashkiës, për veç detyravet të caktueme në kët ligjë, ka edhe këto:

1) të vendosë mbi nevojën e shitjes, të çkëmbimit ose të blemjes së pronave si dhe mbi kushtet e tyne. Për shitjen e çkëmbimin ose blemjen e nji prone që kalon vleften e dy mijë franga ari, merret autorizimi i Ministriës së P. të Mbrendëshme;

2) të vendosë mbi nevojën për të marrë hua, të caktojë dhe t'aprovojë budgetin e sajë. Huaja që kalon 1/10 e t'ardhunave budgetore, kontraktohet mbasi t'aprovohet prej Këshillit Ministruer ;

3) të caktojë punimet për sipërmarrje tue tregue dhe fondet përkatse;

4) të zgjedhë Antarët e Këshillit të Bashkiës, antarët e enteve bamirse bashkiake dhe të rregullojë administrimin e tyne;

5) të vendosë mbi dhanje me qira të pronave të Bashkiës për nji kohë ma tepër se dy vjetë deri në pesë vjetë, tue studjue dhe kushtet; por kjo shumë nuk mund të kapërcejë dhjetë mijë franga ari. Të vendosë mbi dhanje me qira për ma tepër se pesë vjetë ose për nji shumë ma tepër se 10.000 fr. ari (dhetëmijë), por në kët rast merret autorizimi i Ministriës së P. të Mbrendëshme;

6) të vendosë mbi marrjen pjesë të Bashkiës me kapitalet e saja në shoqnina anonime të cilat kanë marrë për sipër vepra ose shërbime Bashkiake, si për shembëll: ndriçimin, komunikacjonin, sejlljen e ujit e tjera, por vendimi për marrjen pjesë të Bashkiës në kët rastë duhet, t'aprovohet edhe prej Ministriës së P. të Mbrendëshme, dhe prej asaj të Botores;

7) të kujdesohet që të zbatohen veprat për sjelljen e ujit dhe të bahen kanalizimet pa përjashtim për të gjitha lagjet e jurisdiksjonit të Bashkiës;

8) të vendosë çpronësimin e vendeve të nevojshme për hapje ose zgjanim rrugash, sheshesh, për ngrehje shkollash, banjash, spitalesh, vorrezash dhe stabilimentesh bamirse;

9) të vendosë shpërblimet për shërbimet e kryeme nga Bashkia si mbas kërkesës së privatve;

10) të vendosë ndryshimin e përdorimit të nji pasunije të patundëshme bashkiake;

11) të vendosë mbi pranimin e dhuratave dhe të legëve;

12) të vendosë mbi paqësimin për padinat bashkiake, shuma e të cilave nuk aklon katërmijë fr. ari, por kuer shuma kalon të katërmijë fr. ari paqësimi bahet mbasi të merret pëlqimi i Këshillit Ministruer;

13) të vendosë mbi lidhjet e konçesjoneve bashkijake tue marrë pëlqimin e Këshillit Ministruer;

14) të shqyrtojë dhe të vërtetojë Rregulloren e Policiës bashkiake.

Neni 47.

Kundërshtimet e Kryetarit të Bashkiës dhe ankimet e privatëve mbi sa i përket vendimeve të Kuvendit të përmendun në Nenin 46 të kësaj ligje, mbrënda 8 ditve nga data e komunikimti të vendimeve, i shtrohen shqyrtimit të Këshillit Administrativ të Prefekturës për Bashkiët e Nënprefekturave, dhe shqyrtimit të Ministriës së P. të Mbrendëshme për Bashkiët e Prefekturave. Në qoft se këto dy autoritete mbrënda nji muji nga data e paraqitjes s'akteve, nuk japin nji vendim, vendimet në fajlë konsiderohen të pëlqyeshme nënë përgjegjsinë e atyre autoriteteve.

Neni 48.

Kryetari i Bashkiës në fillim të çdo sesioni asht i detyruem t'i paraqesi Kuvendit nji raport me hollsina mbi veprimet e shkueme dhe mbi masat që duhen marrë në të pritmen.

Autoritetet ma të nalta t'Administratës, kuerdoherë që t'a shofin të nevojshme, mund të marrin mendimin konsultativ të Kuvendit.

KËSHILLI I BASHKIËS

Neni 49.

Këshilli i Bashkiës perbahet prej Kryetarit dhe prej dy antarve.

Kryeqyteti do të ketë katër antarë.

Kuvendi zgjedh prej gjinit të tij katër kandidatë nër Prefek-

tura dhe Nënprefektura, dhe tetë (8) në Kryeqytet, prej të cilëve gjysma pëlqehet dhe dekretohet prej Ministriës së P. të Mbrendëshme.

Neni 50.

Detyrat e Këshillit të Bashkiës janë:

1) të zbatojë vendimet e Kuvendit dhe të hartojë budgetin e pregatitun prej Kryetarit të Bashkiës;

2) të shqyrtojë dhe të kontrollojë llogaritë e përmujshme, konditat e adjudikatave dhe të leçitjeve;

3) të vendosi marrjen e masave lokale mbi objektet, të cilat ligja i a lenë në kujdesjen dhe mbikqyrjen e tij;

4) të caktojë tarifat e transportit dhe çmimet e sendeve ushqimore;

5) të caktojë gjobat tue u mbështet në dispozitat e ksaj ligje;

6) mbi propozimet e Kryetarit të Bashkiës të vendosë për emnim, pushim dhe masa dishiplinore të nëpunsave të Bashkiës.

Për ata nëpunës që kanë nji rrogë ma shumë se 120 fr. ari e deri 200 merret pëlqimi i Prefektit ose i Nënprefektit ku mvaret Bashkia; dhe për ata që kanë ma shumë se 200 fr. ari merret pëlqimi i Ministriës së P. të Mbrendëshme.

Për nëpunsit e Shëndetsiës dhe të Veterinariës duhet të kërkohet, ma parë, pelqimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetsiës dhe të Ministriës s'Ekonomiës Kombtare;

7) të zbatojë të gjitha detyrat që i ngarkohen me ketë dhe me ligjët e tjera të Shtetit;

8) të vendosi mbi taksat e Bashkiës mbrenda kufive të caktuem prej kësaj ligje;

9) të propozojë transferimin e fondeve prej nji kaptine ose nji artikull në nji tjetër ose të propozojë ndonji shtesë fondi duke i berë ballë me fondin rezervë apo me t'ardhuna të reja. Këto proponime i parashtrohen Kuvendit për aprovim.

Neni 51.

Këshilli i Bashkiës merrë në bisedim çeshtjet e referueme prej Kryetarit. Çeshtjet e pa referueshme vihen në bisedim në rast që kërkohen prej dy antarve.

Neni 52.

Këshilli mblidhet nën Kryesin e Kryetarit ose të zevendsit të deleguem prej tij.

Vendimet merren me shumicë votash.

Në rast mungese të nji antari merret nji antar i Këshillit Administrativ i zgjedhun prej Prefektit ose Nënprefektit.

Në mbledhjen e Këshillit kanë të drejtë të marrin pjesë me votë konsultative Mjeku, Veterineri i Bashkiës dhe Drejtori i Zyrës Teknike kuer të bisedohen çeshtje që u përkasin.

Këshilli në mbledhjen e tij të parë cakton ditët në të cilat do mblidhet rregullisht.

Aktet që i referohen Këshillit detyrisht bisedohen dhe vendosen mbrenda nji jave prej datës së paraqitjes së tyne.

Antarët e Këshillit të Bashkiës marrin si shpërblim sejcili nga fr. ari 5 (pesë) për çdo mbledhje tue u paguar jo ma tepër se dy mbledhje në javë.

Neni 53.

Antarët e Këshillit nuk mund të marrin pjesë n'ato mbledhje në të cilat bisedohet nji çeshtje ku janë t'interesuem vetë. Vendin e tyne, në raste ksodore, e xanë Antarët e Këshilit Administrativ.

Neni 54.

Antarët që për tri herë me radhë nuk marrin pjesë në mbledhjet e rregullshme të Këshillit, pa ndonji shkak të justifikuem, konsiderohen dorëheqës.

Neni 55.

Në rastë që Këshilli i Bashkiës jep dorheqjen ose, për çdo arrsye tjetër, nuk mblidhet, Ministrija e P. të Mbrendëshme urdhnon, mbrenda dhjet ditve, zgjedhjen të tjerësh prej gjirit të Kuvendit. Deri sa të zgjidhen këta, Kryetari i Bashkiës, në vend të ktyne, kërkon prej autoritetit kompetent dy antarë të Këshillit Administrativ.

Neni 56.

Vendimet e Këshillit të Bashkiës nuk zbatohen para se të marrin njoftim t'interesuemit, me shpallje kuer kanë karakter të përgjithshëm dhe me komunikim individual kuer u përkasin privatve.

Komunikimi personal vertetohet me deftesë-komunikimi të bamun si mbas rregullave të përgjithshme me anë të Policiës ose të Tagrambledhsit të Bashkiës dhe në mungesë, me anë t'Administratës.

KRYETARI I BASHKIËS

Neni 57.

Kryetarët e Bashkive emnohen me Dekret Mbretnuer në bazë të

propozimit të Ministris së P. të Mbrendëshme dhe me Vendim të Këshillit Ministruer.

Për arsye ekonomie, zavendësija e Kryësis së nji Bashkije mund t'i ngarkohet, me Dekret Mbretnuer, Prefektit ose Nënprefektit.

Në ketë rast, kundershtimet e vendimeve të Bashkiës, për të cilat bajnë fjalë nenet e ma-sipërme, për Nënprefekturat paraqiten në Prefekturë dhe për Prefekturat në Ministrin e P. të Mbrendëshme.

Neni 58.

Për t'u emnue Kryetar Bashkie duhet të ketë mbushun 25 vjeç dhe të ketë çilsinat të lypuna për nëpunsit e Shtetit.

Neni 59.

Kryetarët e Bashkive, para se të fillojnë në detyrën e tyne, betohen përpara autoritetit administrativ ma të naltë të vendit, në formën e caktueme në Ligjën e Nëpunsave.

Neni 60.

Kryetari i Bashkiës, posë detyrave të ngarkueme me ketë ose të tjera ligjë, duhet:

1) t'ekzekutojë vendimet e marruna prej Kuvendit, si edhe ata të maruna prej Këshillit;

2) të marrë gjithë masat e nevojshme për përmbajtjen e detyrave të Bashkiës të caktueme me ketë ligjë;

3) të kqyrë dhe të përkujdeset për administrimin e pasunive Bashkijake të tundëshme dhe të patundëshme;

4) të mbikqyrë dhe të kontrollojë nëpunsat e Bashkiës në përmbushjen e detyrave të tyne;

5) të hartojë dhe t'i propozojë Këshillit budgetin preventiv;

6) të drejtojë të gjitha veprimet e Bashkiës ;

7) të kujdeset për mirëmbajtjen e rrugave dhe të kanaleve, e vorrezave;

8) të çpallë tarifat e çmimeve dhe të përkujdeset për mirëzbatimin e adjudikatave dhe të çdo punimi tjetër bashkiak;

9) të përfaqsojnë juridikisht dhe administrativisht Bashkinë, vetë ose me anë të Përfaqsuesit;

10) të kontrollojë e të vezhgojë të gjitha veprimet e personelit të Bashkiës dhe të përkujdeset për nxjerrjen e taksave bashkiake.

Neni 61.

Kryetari i Bashkiës, asht i ngarkue me policiën bashkiake.

Neni 62.

Kryetari i Bashkiës ka të drejtë të pezullojë, tue i a referue autoritetit ma të naltë Administrativ të vendit, për kompetencë dhe veprim, ato Vendime të Këshillit që i konsiderohen kundra ligjës ose kundër interesave të përgjithshme.

Në rast kësodore veprohet në bazë t'urdhnit t'autoritetit në fjalë, i bazuem me Vendimin e Këshillit Administrativ.

NËPUNSIT E TJERË TË BASHKIËS

Neni 63.

Personeli tjetër i Bashkiës përbahet si mbas kuadros së nëpunsavet të caktuem në nenin 208 të ksaj ligje.

Neni 64.

Nëpunsit e Bashkiës duhet të kenë cilsiët e caktueme për nëpunsit e Shtetit; sa për Mjekët, Ingjenjerët dhe Veterinerët këta duhet të kenë diplomë Universiteti.

Bashkiët me pëlqimin e Ministriës së P. të Mbrendshme, e cila duhet të marrë dhe mendimin e zyrave kompetente, kanë tagrin të marrin në sherbim me kontratë edhe mjekë, Ingjenjera dhe Veterinerë të huaj.

Neni 65.

Nëpunsit e Bashkive konsiderohen nëpunës Shteti dhe gëzojnë të drejtat e pensjonit po si këta.

Për efektet e pensionit të nëpunsave të Bashkive dhe të trashigimtarve të tyne, aplikohen dispozitat e Ligjës mbi Pensionet e nëpunsave Civil të Shtetit.

Në kohën e lypun si mbas ligjës për pensionim llogaritet edhe koha e sherbimit të tyne që kanë patur para hymjes në fuqië të ksaj ligje, si nëpunsa Shteti ose Bashkie.

Ndalesat që do t'u bahen nga ana e Bashkive mbi rrogat, shperblimet e pensijonet e nëpunsave të tyne i dërgohen arkës së Pensjoneve të nëpunsave të Bashkive, që krijohet në bazë të ksaj ligje pranë Bashkiës së Tiranës, dhe fondet e ksaj arke mbahen të depozitueme në Bankën Kombtare të Shqipniës. Prelevimi i fondeve nga Banka Kombtare e Shqipniës bahet me nënshkrimin e Shefit kontabël e t'Arkëtarit ose në mungesë të njenit prej ty-

në, me nënshkrimin e zavendësit të gjithcilit nën përgjegjësiën solidare të tyne.

Pensionet e nëpunsave të pensjonuem i dergohen drejt për drejt nga Arka e Pensjoneve të Bashkive me postë o me çek banket.

Në rast deficiti në pensionimin e nëpunsave të Bashkivet, ky plotsohet tue kontribue gjithë Bashkitë proporcionalisht me t'ardhunat e buxhetit të tyne.

Kamatat aktive që mund të rrjedhin nga fondi i arkës së Pensjoneve shtojnë ket fond, dhe kamatat pasive eventuale paksojnë ketë fond.

Shpenzimet për dergesat e ndalesave të ndryshme dhe për dergimin e pensjoneve randojnë mbi nëpunsit o mbi përfituesit e pensjonit. Fondi i pensjonuem nuk mund të randohet me as nji shpeznim.

Çdo veprim për caktimin e pensjonit të nëpunsave të Bashkive kryhet nga Drejtoria e Pensjoneve si mbas ligjës përkatse. Dokumentat e nevojshme për pensionim i dërgohen ksaj Drejtorije drejt për drejt me anën e Bashkiës nga e cila pensjonohet nëpunsi.

Në rast se nji nëpunës ka qenë në sherbim të shtetit dhe n'atë të Bashkiës, pensjoni likuidohet tue u marrë për bazë e gjithë koha e sherbimit të tij të vlefshëm për pension dhe paguhet në proporcion të vjetve të sherbimit nga Arka e Përgjithshme e Pensjoneve dhe nga fondi i Arkës së Pensjoneve të nëpunsave të Bashkive.

Autorizohet Ministrija e P. të Mbrendëshme të përpliojë nji Rregullore për palikimin e mirë të këtij neini.

Neni 66.

Kryetarët ashtu edhe nëpunsit e tjerë të Bashkiës për fajet e rrjedhuna nga detyra ose në detyrë e sipër, i shtrohen, Ligjës mbi gjykimin e nëpunsave të Shtetit.

Në rast nevoje, Kryetari i Zyrës për hetimet paraprake mund të delegojë nji prej nëpunsave kompetent me pëlqimin e Titullarit të dikasterit përkatës.

Sa për hetimet paraprake për Kryetarin e Bashkiës këto bahen prej nji nëpunsi të deleguem prej Ministriës së P. të Mbrendëshme.

Neni 67.

Inspektorët e Bashkiës dhe Poloicia janë nën urdhnin e Kryetarit të Bashkiës.

Neni 68.

Detyrat e Policiës së Bashkiës janë:

1) të sigurojë rregullin, qetsinë, mirëkalimin, kondital higjenike, pastrimin dhe ndriçimin e vendeve publike;

2) t'i raportojë Kryetarit nevojën e prishjes ose të meremetimit të godinave gati në rrënim dhe të çduki çdo dam dhe pengim që mund t'u ndodhë udhtarve;

3) t'inspektojë shitjen pa spekullim dhe në mënyrë higjenike të sendeve ushqimore dhe t'atyne që janë në rangun e nevojës së parë;

4) të përkujdeset, pa as nji vonesë, me marrë dhe me shpejtue të gjithë ato masa që kanë të bajnë me rrezikun dhe mjerimin e qytetarve ose me rrenimin e godinave,

5) të kujdesohet për mirëzbatimin e Ligjëve dhe të Rregulloreve bashkijake.

Neni 69.

Policija e Bashkiës ka të drejtë me hyë në të gjitha viset publike dhe ndër tregtore për me ushtrue detyrat e parashikueme prej ksaj ligje.

Neni 70.

Mbrenda jurisdiksijonit të sajë, Policija e Bashkiës, zbaton urdhnat e dhanuna si mbas ligjeve dhe rregulloreve në fuqië, dhe ndjekë e gjurmon të gjitha fajet që janë në kompetencën e Bashkive tue mbajtë proces-verbal.

Neni 71.

Këshillli i Bashkiës detyrohet të bisedojë në mbledhjen e parë të caktueme proçes-verbalin e Policiës.

Vendimi i Këshillit ekzekutohet me nji herë por i interesuemi ka të drejt apeli në Gjyqin kompetent mbrenda 10 (dhetë) ditëve prej së nesërmes së komunikimit të vendimit, me konditë që të ketë paguar ma parë gjobën e caktueme.

Neni 72.

Proçes-verbalet e Policiës së Bashkiës janë të vleftëshme kundrejt çdo autoriteti gjer sa të mos provohet e kunderta.

Neni 73.

Personeli i Policiës, për veç konditave të përgjithëshme që kërkohen për nëpunsit e shtetit, duhet të ketë trup të shëndoshë nji shtat 1.65 m. të paktën dhe të jenë të zotët me kompozue nji proçes-verbal.

Neni 74.

Policia e Bashkiës ka të drejtë t'armatoset si policija e Sigurimit Publik.

Armët dhe municionet e policiës së Bashkiës jepen prej Ministriës së P. të Mbrendëshme dhe, mbeten si pasunië bashkijake tue respektue ligjët dhe rregulloret në fuqië.

Neni 75.

Uniforma e Policiës së Bashkiës caktohet prej Ministriës së P. të Mbrendëshme.

Neni 76.

Administrata ose Gjindarmeria, në rast nevoje dhe mbi kërkimin e Kryetarit të Bashkiës, detyrohen t'i japin Policiës së Bashkiës ndihmën e tyre.

KAPTINË E DYTË

FINANCAT DHE KONTABILITETI I BASHKIVE

1) T'ARDHUNAT E BASHKIVET

Neni 77.

T'ardhunat e Bashkive përbahen:

a) Prej t'ardhunave të pasunive të tundëshme e të pa-tundëshme të Bashkiës;

b) prej çmimeve të pasunive që mund të shiten ose të shkëmbehen tue u plotsue formalitetet e urdhnueme prej kësaj ligje;

c) prej dhuratave dhe legëve;

ç) prej ç'mimeve të pjesës së tokave të mbetuna nga rrugat;

d) prej taksave, gjobave dhe pagesave të shënueme në këtë ligjë dhe në ligjët e tjera.

Neni 78.

Për Bashkiët merret nji taksë 11% mbi taksat doganore nga të gjitha sendet që importohen në Shqipnië. Prej ksaj takse 1% (njipërqind) i përket Bashkiës së Kryeqytetit e cila ka me e përdor ekskluzivisht për «Tiranën e Ré», dhe taksa 10% u ndahet Bashkive në bazë të proporcionit dhe të kategorizimit që caktohen këtu ma poshtë:

Kategorië e posaçme	25%	(njizetepesëpërqindë)
Kategoria e I-rë	29%	(njizetenandëpërqind)
Kategoria e II-të	15%	(pesmbëdhetpërqind)
Kategoria e III-të	25%	(njizetepesëpërqindë)
Kategira e IV-të	6%	(gjashtëpërqindë)

Neni 79.

Kategorinat e Bashkive janë:

Kategoria e posaçme: Tirana.

Kategoria e I-rë: Durrsi, Korça, Shkodra.

Kategoria e II-të: Berati, Elbasani, Gjinokastra, Vlora.

Kategoria e III-të, Bilishti, Bureli, Delvina, Fieri, Kavaja, Kruja, Kuksi, Leshi,, Lushnja, Përmeti, Peshkopia, Pogradeci Saranda, Shijaku.

Kategoria e IV-të: Ballshi, Erseka, Leskoviku, Libohova, Peqini, Tepelena, Zerqani.

Neni 80.

Merret nji taksë lulzimi 1% (njipërqindë) mbi vleftën e mallit mbi të gjitha sendet që importohen në Shqipnië.

Kjo taksë i përket Bashkiës së Kryeqytetit e cila ka me e përdor ekskluzivisht për «Tiranën e Ré».

Neni 81.

Nëpunsit e Doganave janë të detyruem me nxjerrë taksat e shënueme në nënet 78 dhe 89, me i rregjistrue si depozitë dhe në fund të çdo muji me i depozitue në Bankën Kombëtare në Tiranë, n'emën të Ministriës së P. të Mbrendëshme.

Neni 82.

Prej t'ardhunave që merr çdo Bashkië prej taksit doganuer zbriten prej secilës Bashkië 6% (gjashtëpërqindë) dhe shuma që rezulton do t'i jepet për katër vjet me rradhë Bashkiës së Sarandës.

Neni 83.

Ministrija e P. të Mbrendëshme në fund të çdo tre muejve cakton, si mbas proporcionit të përmendun në ketë ligjë, pjesën për çdo Bashkië dhe u a dërgon me anë të Bankës ose me mjete të tjera.

Neni 84.

Çdo urdhën në kundërshtim me dispozitat e neneve të ma sipërme për sa i përket ndaljes së pjesave që u takojnë Bashkive, nuk shpëton zbatuesin prej përgjegjësiës.

Neni 85.

Bashkitë e qyteteve, që ndodhen në breg të detit dhe anës së liqênit e lumit që kanë skele ku lëvrojnë barka e avullore, marrin nji përqindë (1%) mbi taksin doganuer.

Neni 86.

Për Bashkiët që përmenden në nenin 79 merret prej alkoolit thjeshtë 30% (tridhjetëpërqindë) dhe prej cigareve 15% (pesëmbëdhetëpërqindë) për mbi taksën që merr Financa e Shtetit.

Cigaret që eksportohen përjashtohen nga kjo taksë.

Këto të dy taksa nxjerrjen drejt për drejtë prej nëpunsave të Shtetit bashkë me taksat Shtetnore dhe rregjistrohen si dopozitë n'arkat e financavet, dhe në fund të çdo muji këto arka i derdhin të hollat në Bankën Kombëtare n'emnin e Ministriës së P. të Mbrendëshme.

Shuma e depozitueme në Bankën prej të dy ktyne taksave u ndahen, mbrenda tre mujve, Bashkive si mbas proporcionit e kategorive përkatëse të përmenduna në këtë ligjë.

Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet, për njehsinë e Bashkive, detyrohen me pregatitjen e pullave të banderollit bashkijak për taksin e cigareve, të cilat përdoren nga nëpunsat e Ministriës së Financavet.

Neni 87.

Therja e kafshve dhe e bagtive bahet n'abatuarin e Bashkiës e cila merr taksin e abatuarit dhe të konsumit si ma poshtë:

	Taksë Abatuari Fr. ari	*Taksë Konsumi* Fr. ari
a) Për ká, lopë, buall, e buallica	2	3
b) Për mëzat, mushqerrë, dem dhe derra që peshojnë në 30 klg. e sipër	1	2
c) Për viçat dhe derrat gjer më klg. 30	1	1
ç) Për dash, dele, sjep, dhí, milore dhe ftue	0.50	0.50
d) Për qingja dhe keça	0.20	0.30

Për kafshët dhe bagtiët që nuk janë nga këto që përmenden ma sipër, zbatohen taksat e kategoriës anallloge.

Përjashtohen nga taksat e abatoarit dhe të konsumit dhe lejohen therjet jashtë abatoarit dhe në shtëpia private, të kafshve dhe të baksive që theren prej privatve për Bajram, Kështnella, Pashkë dhe për nevoja shtëpijake.

Kafshët dhe bagtiët e theruna, që sillen prej së jashtmi për me u shit ose konsumue në nji qytet i shtrohen taksave t'abatoarit dhe të konsumit, por kuer me dëftesa të rregullta provohet se

taksa e abatoarit asht pague në nji Bashkië ose Komune tjatër, atëherë paguhet vetëm taksa e konsumit.

Kafshët e bagtiët e theruna që shiten në nji qytet pa u pague taksa përkatse, quhen kondrabandë, dhe në kët rast paguhet pesë fish taksa përkatse.

Neni 88.

Për kafshët dhe gjatë e gjalla që shiten mbrenda kufinit të Bashkiës dhe për ata që blehen ndër katunde dhe sillen në qytet pa u pague taksa relative atje ku janë blerë, Bashkia ka të drejtë të marri nji taksë 2½ % (dyegjysmëpërqindë) mbi çëmimin e shit-bleries.

Kjo taksë nxirret prej shitsit kuer shit-blerja bahet mbrenda jurisdiksjonit të Bashkiës, dhe kuer bahet jashtë jurisdiksjonit dhe gjaja e gajllë sillet në qytet, taksa nxirret prej blerësit, në qoft se ky nuk provon se këtë taksë e ka pague vetë ose shitsi në vendin ku asht bamë shit-blerja.

Në rast shkëmbimi të gjasë së gjallë taksa 2½% merret mbi vleftën e dy sendeve të shkëmbyeme dhe paguhet për gjysmë prej të dy palve.

Çdo konflikt mbi caktimin e vleftës zgjidhet prej nji ekspertit të Bashkiës.

Taksa e 2½ % (dyegjysmëpërqindë) nxirret sa herë që përsëritet shit-blerja ose shkëmbimi.

Në rast sjelljeje të gjasë së gajllë të bleme ose të shkëmbyeme prej jurisdiksjonit të nji Bashkie ose Komuneje në nji tjetër, sjellsi detyrohet me paraqit dëftesën e pagimit të taksës relative të vendit të shit-blerjes.

Në rast të kundërtë paguen plotsisht taksën në fjalë.

Dëftesat e lëshueme për pagesën e taksës së shit-blerjes duhet të jenë në tri kopje, prej të cilave njena i jepet shitsit, tjetra blerësit dhe e treta mbetet në zyren përkatse ose i jepet sipërmarrsit.

Këto dispozita aplikohn edhe për shit-blerjet që bahen ndër Komuna.

Përjashtohen nga taksa 2½ % (dyegjysmëpërqindë) gjaja e gjallë që kalon kufinin për me dimnue ose verue.

Gjith'ashtu përjashtohen nga kjo taksë si edhe nga taksa e okupimit të vendit ato që sillen për me u shit dhe nuk shiten.

Neni 89.

Në kryeqytet dhe në qytetet e kategoriës së parë lejohet mbajtja e bagtive e kafshve, pa u marrë ndo nji taksë e veçantë bashkiake, vetëm se duhen të mbahen jashta banimeve ose në lokale të mbylluna, tue u rujtun kondital e pastrimit.

Ndër qytetet e Bashkive të kategorive të tjera lejohet mbajtja e bagtive dhe e kafshve pa u marrë ndo nji taksë e veçantë bashkiake por vetëm tue u rujtun kondital e pastrimit.

Neni 90.

Gjithë sendet që produktohen në vend kur shiten në vende publike e në tregje (pazare), si edhe para dyqaneve peshohen dhe maten me peshat dhe masat e Bashkiës tue i u shtrue taksës së peshimit.

Taksa e peshimit asht 1% (njipërqindë) mbi çëmimin e mallit që shitet dhe paguhet prej shitsit.

Kësaj takse i shtrohen gjithë produktet e vendit që blehen prej tregtarve ose fabrikantave edhe kuer dorëzimi dhe peshimi ose matja e tyne bahet në lokalet tregtare, qoftë edhe kuer peshimi ose matja nuk bahen me veglat e Bashkiës.

Përjashtohen nga kjo taksë produktet që blehen për nevoja shtëpijake, kur dorzimi i tyne bahet drejt për drejtë në banesë të blêrësit.

Gjith' ashtu nuk i shtrohen ksaj takse edhe shit-blerjet midis tregtarve të nji qyteti por tregtarët e juridiksjonit të ndryshëm bashkiake për shit-blerjet që ngjasin midis tyreve, i shtrohen pagesës së kësaj takse, e cila paguhet prej shitsit në vendin e dorzimit, dhe në mungesë të shitsit, do të paguhen prej blerësit, për veç kur provohet se kjo taksë asht paguar në ndo nji vend tjetër.

Asht fakultativ peshimi ose matja me peshat e Bashkiës t'atyne sendeve që nuk kalojnë 7 kilogram.

Neni 91.

Shitsit që okupojnë vendet publike të jurisdiksjonit të Bashkiës në ditët e pazareve paguejnë një taksë vendi, tarifa e së cilës për çdo artikull pregatitet prej Këshilit të Bashkiës nji mujë para fillimit të vitit.

Kjo tarifë para se të shpallet ndër vende publike duhet t'aprovohet edhe prej Këshillit të Administratës së vendit.

Nga gjithë ekspozisionet dhe panairet për veç taksës për o-

kupimin e vendit merret edhe 1% (njipërqindë) mbi shumën e pergjithëshme të shitjes.

Neni 92.

Zejtarët dhe tregtarët që për herën e parë çelin lokale me qëllim tregtije si edhe ata që i kanë të çeluna por dëshrojnë me ndryshue zejen ose tregtinë e tyre, detyrohen t'i paguajnë Bashkiës së vendit nji taks prej 10 deri 500 fr. ari.

Kjo taksë mund të caktohet në maksimum deri në 1000 fr. ari kur i interesuemi ka nji kapital ma tepër se 500.000 fr. ari.

Përveç kësaj takse të njihershme Bashkia merr edhe nji tjatër prej 2 (dy) deri në 50 (pesdhetë) fr. ari për ushtrimin e përvitshëm të zejeve dhe kur konstatohet nji ndryshim në përmbajtjen e zejes së ma-parshme çeshtja i referohet Këshillit të Bashkiës për rregullimin e taksës.

Ata që pa patur ma parë lejen e rregulltë të Bashkiës çelin lokale me qëllim tregtije, industrije e tjera, u mbyllen dhe ju vulosen lokalet me anën e Policiës së Bashkiës, dhe në rast se më vonë mbi drejtimin e t'interesuemit u akordohet leja e nevojshme, taksa e lejes merret pesë fish, si gjobë. Në rasë prishje të vulës aplikohen dispozitat përkatse të Kodit Penal.

Neni 93.

Nga të gjithë lokalet që çelen për dëfrim ose zbavitje me qëllim përftimi merret nji taksë çeljeje e njihershme prej 10 (dhjet) gjer më 700 (shtatëqindë) fr. ari.

Kuer këto qëndrojnë të çeluna deri në mes të natës, për veç taksit të çeljes merret edhe nji taks i përditshëm prej 5 deri në 40 fr. ari që caktohet prej Këshillit të Bashkiës.

Kjo taksë merret prej atyne që ushtrojnë profesjonin e zbavitjeve dhe të dëfrimeve për nji kohë të kufizueme pa pasun ndo nji qendër të ngulun. Gjith'ashtu prej lokaleve të zbavitjevet dhe të dëfrimit, të cilat qëndrojnë të çeluna edhe pas mezit të natës, përveç taksës së çeljes së parë dhe asaj të dëfrimit që merret deri në mes të natës, merret edhe nji taksë tjetër baras me atë që është caktuar për deri në mes të natës.

Për ushtrimin pas mesit natës është e doemosdoshme edhe leja e Policiës.

PKSH

Nër vendet e zbavitjes dhe të dëfrimit asht e ndalueme mbledhja të hollash prej popullit.

Në rast që t'interesuemit taksat e sipërpërmenduna i parapaguajnë tanësisht në fillim të çdo mujit, u bahet nji zbritje 10% (dhetëpërqindë) dhe në rastë se taksën nuk e paguajnë me rregull dhe mbrenda javës, që nga dita të cilës i përket pagesa e taksës, taksës në fajlë i shtohen edhe 10% (dhjetëpërqindë) si gjobë; dhe në rast se mbrenda dy javëve nuk paguhet shuma e taksës së ditve të kalueme, leja e çeljes quhet e anulueme dhe mbyllet lokali nga ana e Policis së Bashkiës.

Neni 94.

Për me okupue trotuarët ose çdo vend tjetër përpara dyqaneve asht e detyrueshme me kërkue lejen nga Bashkia. Kjo leje jepet mbasi të konstatohet se okupimi i trotuarvet nuk pengon kalimin.

Kundra kësaj leje, Bashkia ka të drejtë të marri nji taksë deri me 10% (dhetë për qind) mbi qiran e lokalit përkatës në proporcion të kohës për të cilen kerkohet leja.

Në rast mungese kontrate të regjistrueme për caktimin e qiras, kjo vendoset prej nji eksperti të Bashkiës.

Neni 95.

Hotelxhinjtë detyrohen me i pague Bashkiës 5% (pesëpërqind) mbi çmimin e fjetjeve, këta detyrohen të mbajnë rregjistra të regullta të vertetueme prej Bashkiës.

Administratorët ose pronarët e restaurantave dhe të gjelltorevet detyrohen m'i pague Bashkiës 5% (pesë për qind) mbi çmimin e ngrenjes. Kjo taksë nxjerret me ngjitje pullash që u jepen pronarve ose administratorve të restaurantave dhe të gjelltorëve prej Bashkiës, të cilat pulla do t'i ngjiten çdo fakture shpenzimi për ngranje.

Në rast se konstatohet ndonji mbëshehje shpenzimesh, pronari ose administratori gjobitet me vendimin e Këshillit të Bashkiës me pagesë dhjetë fish.

Neni 96.

Për gjith mjetet e transportit, për veç atyne qi i përkasin Shtetit, Bashkiës dhe të Trupit dipllomatik, detyrohet pagesa e taksës së rregjistrimit, si vijon:

			Fr. ari
a)	Për karroca me dy kuaj	në muej	5
b)	Për karroca me nji kalë	» »	2.50
c)	Për qerret me kuaj e me qé	» »	1
ç)	Për karrot me dy kuaj	» »	2
d)	Për karrot me nji kalë	» »	1
dh)	Për karrot me gomar	» »	0.50
e)	Për kamionat deri 1500 kg.	» »	30
ë)	Për kamionat ma shum se 1500 kg.	» »	50
f)	Për automobilat gjer me katër vetë	» »	10
g)	Për automobilat që marrin ma tepër se 4 veta	» »	15
gj)	Për automobilat që marrin gjer më 10 veta	» »	15
h)	Për automobilat që marrin ma tepër se 10 veta	» »	25
i)	Për motoçikletat	» »	10
j)	Për biçikletat	» »	1

Kjo taksë parapaguhet në kiste tre mujore ose gjashtë mujore. Mjetet e transportit që nuk janë të rregjistrueme rregullisht në Bashkië o Komune ose nuk asht përsëritun rregjistrimi i tyre brenda tre ose gjashtë muejvet, ndalohen prej ushtrimit dhe të zotët e tyne detyrohen me pague taksën dy fish.

Neni 97.

		Fr. ari	
a)	Për karrocat		1 (nji)
b)	Për karrot	»	1 (nji)
c)	Pr qerret e rregjistrueme mbrenda jurisdiksjonit të Bashkiës	»	1 (nji)
ç)	Për automobilat, kamionet, autobuset	»	5 (pesë)
d)	Për motoçikletat dhe biçikletat	»	1 (nji)
dh)	motorrat, barkat, dhe çdo mjet tjetër lundrimi	»	5 (pesë)
e)	Për hamajt	»	1 (nji)
ë)	Për llustrat	»	0.50 (pesdhetqin.)

Neni 98.

Mbasi shoferët të kenë të gjitha konditat e tregueme në ligjën me datë 19-X-1926 mbi sherbimin dhe perdorimin e automobilave, kundrejt nji takse 20 (njizet) fr. ari marrin lejen nga Bashkia ku kanë qendren e tyne.

BKSH

Bashkiët detyrohen me kontrollimin e qereve me fuqi motori si dhe për çilësit e shoferave në konformitet me ligjen datë 19-X-926 mbi sherbimin dhe perdorimin e automobilave dhe, në rastë se konstatohet se, qerret janë në gjendje të çkatërrueme si dhe shoferat humbasin cilsit e lypuna prej Rregullores me datë 19-X-1927, mbi përdorimin e mbajtjen e automobilave, qerret ndalohen nga qarkullimin dhe shoferave këso-dore u tërhiqet leja. .

Shoferat detyrohen me pasë me vehte lejen me fotografin përkatse si dhe lejen e veprimit të maqinës që drejtojnë.

Neni 99.

Për ushtrimin e mjeshtris së tyne, kundrejt nji takse nji fr. ari Bashkija u lëshon leje identiteti hamajve, barkarve, drejtuësve të barkave, me motor dhe karrocjerve, tue e përsërit pa të holla kontrollimin e tyne në fillim të çdo viti.

Neni 100.

Gjithë mjeshtrit, profesjonistët, zejtarët dhe sherbëtorët ose garsonët, që kanë të bajnë me sende ushqimore ose me gjendje shëndetsore të popullit në stabilimentet publike, në fillim të çdo viti detyrohen me i u shtrue vizitës mjeksore.

Të vizituemve në gjendje shëndetsore të mirë, kundrejt nji takse nji deri në pesë fr. ari, u lëshohet leje për ushtrim ose për vazhdimin e ushtrimit të zejes ose profesjonit të tyne.

Në rast konstatimi sëmundjesh, lejet e lëshueme mund të tërhiqen edhe mbrenda vitit.

Ata të cilve u refuzohet leja pas vizitës mjeksore, kanë të drejtë mbrenda tetë ditve të kërkojnë rivizitimin mjeksuer përpara nji komisioni mjekësh të zgjedhun prej Bashkiës me përjashtimin e mjekut që ka bamë viziten e parë.

Neni 101.

Gjithë institutet, viset e defrimit dhe çdo lokal tjetër me qëllim tregtije ose bamirësije, detyrohen të venë në gjuhë Shqipe nji tabelë e cila do të përmbajë emnin dhe punën e atij që e ushtron.

Tue marrë parasysh randësinë e rrugës dhe të punës si dhe taksën e pagueme pa lejen e ushtrimit, Kësbilli i Bashkiës merr nji taksë tabele të pervitëshme 1 (nji) gjerë në 10 (dhetë) fr. ari.

Në rastë se gjatësija dhe gjanësija kalojnë 2×1.40 m. taksa dyfishohet.

Në qoftë se tabelat zgjaten drejt rrugës gjer në 1 metër, taksa e naltpërmendun merret tre fish, dhe kuer zgjatet ma tepër se nji metër i shtrohet taksës së reklamës, si mbas nenit 102 të kësaj ligje; por për çdo rast naltësije e këtyne tabellave prej rrugës nuk do të jetë ma pak se tre metra.

Tabellat mund të përmbajnë edhe shkronja në gjuhë të huaj me konditë që këto të jenë nën shkronjat Shqipe dhe të mos kalojnë gjysmën e dimensionit të këtyne. Për pjesën e shkrueme në gjuhë të huej taksa ashtë 50 (pesëdhjet) fish ma tepër.

Për shkronjat që bahen ndër mure ose vitrina zbatohet taksa e reklamës.

Neni 102.

Çdo zadhanje e shpërndame ose e varun me qëllim reklame i shtrohet taksës së Bashkiës:

a) Zadhanjet në letër semple të shpërndame, 1 (nji) santim ari për copë;

b) zadhanjet me letër semple të varuna ose të ngjituna 5 (pesë) sentim ari për copë;

c) zadhanjet me letër semple ma të mbëdha se 40X30 cm. dhe në karton 30X20 cm. 10 (dhjetë) sentim ari për copë;

ç) çdo zadhanje e shkrueme në kartë dhe e mbulueme me çdo material mbrojtës si dhe ato të shkrueme në landë të fortë, për çdo metër katrore i shtrohet nji takse të përvitshme prej 10 (dhjetë) fr .ari.

Për zadhanjet e lëvizshme që i shetisin nëpër rrugë qofshin në letër ose pëlhurë, merret nji taksë e përvitshme prej 2 (dy) fr. ari për copë;

Zadhanjet e Cinematografave dhe të Theatrove të cillat tue qenë në dimensjone ma se 40X30 cm. ndryshohen dita ditës ose në dy o tri dit nji herë, paguajnë nji taksë mujorë fr. ari 3 (tre) për çdo m² qoftë dhe sikuer zadhanjet mos të vazhdojnë gjithë muejin;

d) për zadhanjet e ndriçueme me projektor merret nji taksë e përvitshme prej 50 (pesëdhetë) fr. ari;

dh) për zadhanjet e shkrueme ndër perdet e çdo lokali çfaqjesh merret nji taksë e përmujshme prej 3 (tre) fr. ari për çdo metre katrore;

e) për germat në vitrinë paguhet taksë bashkiake dy fish në barabitje të çdo dimensjoni sentimetrarë. Për germat nëpër mure

taksa asht 20 (njizet) fish në proporcion të dimensionit të këtyne germave.

Taksa e zadhanjeve ndër letra paguhet me anë pullash, për llojet e tjera taksa parapaguhet.

Kundravajtsit gjobiten nga Këshilli i Bashkiës me 2 (dy) gjerë në 5 (pesë) fish të taksës përkatse.

Zadhanjet lejohet të varen vetëm ndër vise të caktueme prej Bashkis. Nuk mund të vihen dy zadhanje njena sipër tjetërs brenda asaj kohe në të cillën asht parapague taksa rellative.

Zadhanjet do të jenë në gjuhë Shqipe dhe në rast se do të përmbajnë dhe fraza në gjuhë të huej, taksa, merret pesëdhjet fish ma tepër.

Zadhanjet e autoriteteve Shtetnore dhe të Instituteve bamirse përjashtohen nga taksa bashkijake të parashikueme në ket nen.

Neni 103.

Për çdo instalim motori përm aqina industrije në vise të lejueme parapaguhet vetëm për nji herë taksa e poshtë-shënueme:

a) Nga motorat e maqinave industriale që do të ngrihen gjer në 5 (pesë) kuaj fuqi fr. ari 20 (njizet);

b) nga motorat e maqinat industriale që do të ngrihen gjer më 10 (dhet) kuaj fr. ari 50 (pesëdhetë);

c) nga motorat e maqinat industriale gjerë më 50 (pesdhjetë) kuaj fr. ari 100 (njiqind);

ç) nga motorat e maqinat industriale gjer më 100 (njiqind) kuaj fr .ari 250 (dyqind e pesëdhjetë);

d) nga motorat e maqinat industriale gjer më 200 (dyqind) kuaj fr. ari 500 (pesëqind).

Kuer janë ma tepër se 200 (dyqind) kuaj merret 100 (njiqind) fr. ari shtesë për çdo 50 (pesëdhjetë) kuaj.

Neni 104.

Gjithë veglat e peshimit dhe të matjes do të jenë në bazë të sistemit metrik dhe, kundrejt veprimit të vulosjes së detyrueshme nga ana e Bashkiës, i shtrohen kësaj takse:

a) Nga çdo copë e veçantë peshimi që randon gjer më 1000 (njimij) gram fr. ari 0.50 (pesëdhjetë qindar);

b) nga çdo copë e veçantë peshimi që randon gjer më 10 (dhjetë) kilo fr .ari 1 (nji);

c) nga çdo copë e veçantë peshimi që randon ma tepër se 10 (dhjet) kilo fr. ari 3 (tre);

ç) nga çdo kandar, ziq, kapan që peshon prej nji gjer në 25 (njizet e pesë) kilo fr. ari 2.50 (dy e pesëdhjet qindari);

d) nga çdo kandar, ziq, kapan që peshon prej 25 (njizet e pesë) gjer në 50 (pesëdhjet) kilo fr. ari 5 (pesë);

dh) për çdo kandar, ziq, kapan që peshon ma tepër se 50 (pesëdhjetë) kilo fr. ari 10 (dhjetë);

e) nga çdo terezi e qendrueshme ose dore fr. ari 1.50 (nji e pesdhet);

ë) nga paskulet, çekitë, balancat dhe të tjera pesha këso dore fr. ari 10 (dhjetë);

f) nga çdo peshë ose matës likuidi 0.50 fr. ari (pesëdhjetë qindari);

g) nga çdo matës për drith, fr. ari 1 (nji).

gj) nga çdo copë metre fr. ari 0.50 (pesëdhjetë qindar).

Neni 105.

Mjetet e matjes dhe të peshimit i shtrohen taksës së nji të pestës t'asaj të vulosjes për kontrollimin e tyne të përvitshëm.

Përjashtohen nga kjo taksë veglat e matjes dhe të peshimit që tregohen në paragrafët, a, b, c, dhe gj, të nenit ma sipërm.

Mjetet e matjes së barnatorve përjashtohen si nga kjo taksë ashtu edhe nga taksa e vulosjes.

Neni 106.

Prej banuësve të çdo lloj ndërtese, për veç atyne Shtetnore, merret nji taksë e përmuejshme pastrimi si mbas vleftës së rregjistrimit të sajë në zyrën e Financës;

Prej 1001 gjer në 2000 fr. ari 0.20 (njizet qind.)
Prej 2001 gjer në 4000 fr. ari 0.40 (dyzet qind.)
Prej 4001 gjer në 6000 fr. ari 0.60 (gjashtëdhjet qindar.)
Prej 6001 gjer në 8000 fr. ari 0.80 (tetëdhjetë qindar)
Prej 8001 gjer në 10000 fr. ari 1.20 (nji e njizet qindar)
Prej 10001 gjer në 20000 fr. ari 2 (dy)
Prej 20001 gjer në 40000 fr. ari 2.40 (dy e dyzet qindar.)
Prej 40001 gjer në 60000 fr. ari 3 (tre)
Prej 60001 gjer në 80000 fr. ari 4 (katër)

Në rast që vlefta e ndërtesës asht ma tepër se 80000 (tetëdhjet mij) fr. ari për çdo 2000 (dymijë) fr. ari dhe për fraksionet merret nji shtesë prej 1 (nji) fr. ari në muaj. Kjo taksë merret prej çdo banuesi qoftë Shqiptar ose i huej.

Gjithashtu taksa në fjalë nxiret prej pronarit kur nuk ka lajmërue Bashkinë se ndërtsat i ka të mbylluna.

Neni 107.

Për lokalet me qëllim tregtije ose vazhdim profesjoni, taksa e ma sipërme dyfishohet dhe nxirret prej qiramarrsit i cili detyrohet t'a lajmërojë me shkresë Bashkinë në rast largimi.

Neni 108.

Pronarët e çdo lloj ndërtese, për veç atyne shtenore, paguajnë si taksë ndriçimi të përmujshëm gjysmën e taksës së pastrimit, të përmendun në nenin 106.

Kjo taksë merret vetëm për ato godina qi ndodhen në rrugat e ndriçueme prej Bashkiës.

Taksa në jalë merret në dy ose ma tepër kiste si mbas zakonit të qytetit, dhe si mbas vendimit të Këshillit të Bashkiës.

Por në rastin që rrugat e qytetit ndriçohen nga ana e Bashkiës ose sipërmarrsit të sajë, taksa e ndriçimit merret mbi bazën e konsumit të dritës elektrike me përqindjen e poshtshenueme dhe në bazë të kategoriës së rrugës që ndodhen godina:

Në rrugat e kategorisë së I-rë 10%

« « « « « II-të 8%

« « « « « III-të 5% mbi çmimin e konsumit.

Kategorizimi i rrugave bahet me vendim të Këshillit të Bashkiës. Kjo taksë mblidhet njikohësishtë me çmimin e konsumit dhe prej atij që arkton ketë çmim. Në rast që i detyruemi refuzon pagimin e kësaj takse Bashkia ose, me urdhnin e kësaj sipërmarrsi ka të drejtë të presë korrentin duke mbetun të rezervuara të drejtat e Bashkiës të caktueme me ligjë për mbledhjen e taksave Bashkiake.

Taksa e ndriçimit në fjalë paguhet nga ana e banuesit ose e përdoruesit të godinës.

Taksës së ndriçimit të parapame në ketë nen i shtrohen edhe nenshtetasit e huaj.

Neni 109.

Nga gjithë adjudikatat, licitacionet, ose lëshimet e bamuna në marrëveshtje private ose a forfait (qesim) dhe nga çdo lloj paksimi, qoftë dhe me anë kasneci, Bashkia mer nji taksë 2% (dy përqind) mbi shumën totale të shitjes ose të blerjes, dhe në rast mungesë të një shume totale merret mbi situacjonet provizore

dhe, në fund të likuidimit të llogarive definitive, taksa llogaritet në bazë të këtyne.

Në këtë mënyrë veprohet dhe për çështjet ushqimore.

Gjith zyrat publike detyrohen t'i komunikojnë Bashkiës përkatse shumën e kontratave të lidhuna me emrat e kontraktuesvet. Në rast se këto nuk përmbajnë shuma të caktueme, në fund të çdo tremuejve, duhet të komunikojë llogarin e pagesave të bame sipërmarrsëve deri sa të marrë fund kontrata.

Taksa 2% merret nga an'e Bashkiës, edhe sikur të mos rezulltojë ose të mos parashifet në pikat e kontratës.

Kjo taksë merret prej asaj Bashkije ku ashtë bërë shitja definitive çdo veprim që i shtrohet kësaj takse i njoftohet Bashkiës përkatëse për t'u bërë veprimet që i përkasin taksës në fjalë.

Neni 110.

Gjithë qirat e ndërtesavet, dhe të pronave i shtrohen taksës së rregjistrimi prej $1\frac{1}{2}$% (nji e gjysmë për qind) mbi shumën e përgjithshme të kontratës.

Në rast përsëritjeje qoftë dhe heshtësisht, qiradhansi detyrohet me ripagimin e taksës.

Në qoftë se qiradhansi, mbrenda nji mueji nga data e lidhjes së kontratës ose përsëritjes, nuk paraqitet për regjistrimin e kontratës ose për pagesën e taksës, gjobitet me tri fish të taksës në fjalë.

Paditë që u përkasin qirave të çdo lloj godine ose prone janë të pa digjueshme përpara gjyqeve gjer sa të paguhet taksa tre fish e rregjistrimit të kontratës.

Neni 111.

Gjithë Bashkiët detyrohen të kenë jasht qytetit nji depo për mbajtjen e sendeve ndezse të cillat paguajnë këto taksa:

a) Vajguri, naftë, benzinë, benzole, gazoile, mazut, karbonit, kalçit, acetilene dhe kompozicionet e tyne fr. ari 2 (dy) për kuintal.

b) Alkooli i thjeshtë fr. ari 3 (tre) për kuintal;

c) Spirto e denatyrueme fr. ari 2 (dy) për kuintal;

ç) Për çdo teste shkrepsash (njiqind kuti) fr. ari 0.50 (pesëdhjetë qindari).

Perjashtohen nga detyrimi për me depozitue në depot e Bashkiës dhe nga pagesa e taksës sendet ndezëse të monopolizueme prej Shtetit.

Neni 112.

Jasht qytetit dhe larg depos së sendevet ndezëse Bashkia do të ketë nji depo për sendet explosive, për të cilat paguajnë këto taksa:

a) barut i çdo lloji qoftë fr. ari 10 (dhetë) për kuintal;
b) dinamit i çdo lloji qoftë fr. ari 6 (gjasht) për kuintal;
c) kapsolla krisëse për mina fr. ari (0.25) për kuintal;
ç) fitila sigurimi për mina fr. ari (0.50) për njiqnd copë;
d) fishek për gjueti fr. ari (1) për njiqnd copë;
dh) Municjon për mbrojtje fr. ari (2) për njiqind copë;
e) kapsolla për pushkë fr. ari (0.50) për çdo kilogram.

Kur sendet e rreshtueme ma sipër janë ma pak sa peshat ose sasinat e copave të shënueme ma sipër, paguejnë taksën plotësisht, por kuer fraksionet janë ma të vogla se gjysma e peshave dhe të sasiës copavet, atëhere paguhet vetëm gjysma e taksës.

Neni 113.

Taksat e përmenduna në nenet 111 e 112, janë për nji afat maksimum tre muejve dhe po të qindrojnë ma tepër, taksa përsëritet.

Kur sendet ndezse dhe eksplosive janë të destinueme për nji qytet tjetër quhen transit dhe përjashtohen prej taksës me këto kondita;

a) Nji deklaratë nga ana e tregtarit;
b) veç forcës madhore, nuk mund të vonohen ma tepër se dhjetë ditë;
c) sendet e deklarueme për transit, në rast që shiten tinzisht në qytet gjobiten shitsit me dhjetë fish të taksës, gjysma e së cillës i jepet si shpërblim zbuluesit.

Neni 114.

Në rast çeljeje rrugash të rea ose zgjanimi të rrugave që ekzistojnë, ose në rast sistematizimi të gjanësiës ose të drejtimit të tyne, merret prej pronarvet të godinave ose të pronarve, nji taksë vleftësimi 25% mbi diferencën midis vleftës së vjetër dhe vleftës së ré.

Kjo taksë paguhet në gjashtë kiste të njishme në krye të gjashtë muejve pas caktimit të vleftës së ré. Por në rast se pronarit i shpronsohet prej Bashkiës ndonji pjesë e trullit, të kopshtit ose të godinës, nga vlefta e shpronsimit i ndalet nji e treta për sigurimin

e pagesës së diferencës së vleftës që ka me marrë prona e tij nga çelja ose zgjanimi i rrugës ose i sheshit në fjalë.

Nga kjo taksë përjashtohet «Tirana e Ré»

Kësaj takse i shtrohen gjith kunditat ose pronat e çdo lloj Instituti ose Komuniteti, për veç godinave Shtetnore dhe faltoreve.

Për caktimin e taksës së vleftësimit formohet nji komisjon i përbam prej nji antari t'Këshillit t'Administratës, dhe prej nji antari t'Odës së Tregtiës, nën kryesin e Gjyqtarit Paqtuës, të cilët veprojnë me ndihmen e ekspertave.

N'ato vise ku nuk ekzistojnë Oda Tregtare, në vend t'antarit të kësaj, zgjidhet nji prej popullit me vendimin e Këshillit Administrativ.

Vendimet e dhanuna prej Komisjonit në fjalë janë të kundërshtueshme në Gjykatoren Kolegjiale, e cila detyrohet ta përfundojë çeshtjen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditve. Vendimi i kësaj asht i premë.

Neni 115.

Për gjithë lojnat e lejueme që lohen ndër lokale ku e hymja dhe veshgimi i Policiës asht i lirë, merret nji taksë e përmuejshme prej 10 (dhjet) deri 100 (njiqind) fr. ari si pas randësis së lokalit.

Neni 116.

Për qent që mbahen për luks ose për gjueti merret nji taksë e përvitshme prej 5 fr. ari kundrejtë numrit që do të vihet në rrypin e qafës.

Kjo taksë parapaguhet.

Në rast mos rregjistrimi, ata konsiderohen si qen rrugash dhe helmohen si të damshëm për shëndetin publik.

Përjashtohen nga kjo taksë qent e barijve.

Neni 117.

Furrat, oxhaqet, fabrikat, gurorет dhe çdo stabiliment tjetër që vepron mbrenda kufirit të Bashkiës dhe djegë ose nxjerrë gurë, gëlqere, tulla, tjegulla, qerpiçe dhe gjith llojet e permenduna në nenin 1 të ligjës së gurorëve në fuqi, i shtrohen taksës së Bashkiës 1% (nji për qind) mbi vleftën e produktit.

Taksa e nxjerrun në këtë mënyrë nuk mund të merret edhe prej autoriteteve Shtetnore.

Neni 118.

Lundrat që ndodhen mbrenda juridiksjonit të Bashkiës dhe që shërbejnë si mjet kalimi nëpër lumenj, brenda kufinit të Ba-

shkiës, janë pasuni bashkijake, dhe Bashkija merr nji taksë kalimi në bazë të tarifës që ka me caktue Këshilli i saj.

Bashkitë që janë bregdeti ose liqeni, kanë të drejtë të regullojnë shërbimin e ngarkim-shkarkimit dhe për këte marrin nji shpërblim të caktuem me nji tarifë të posaçme, e cila pregatitet prej Këshillit të Bashkiës, Odës së Tregtiës dhe Këshillit t'Administratës, e vehet në zbatim mbas aprovimit të Këshillit Ministruer.

Bashkitë janë t'autorizueme që shërbimin e ngarkim-shkarkimit t'a kryejnë direkt vetë ose me anë sipërmarrësash.

Taksa e eksportimit duhet të caktohet ma e pakë nga ajo e importimit.

Neni 119.

Ç'do i interesuem ka të drejtë të kërkoj komunikimin e vendimeve nga çdo Bashkië tue marrë kopje të përgjithëshme ose pjesë të proces-verbaleve të budgeteve, dhe të llogarive dhe të çdo vendimit tjetër. Këto kopje i shtrohen taksës mbi gjendjen civile, të timbrës si dhe taksës të caktueme në këtë ligjë.

Nga kjo dispozitë përjashtohen proçes-verbalet e mbledhjeve që bahen me dyer të mbylluna.

Neni 120.

Për tabellat e ndërtesave dhe të rrugave Bashkia ka të drejtë të marë një taksë si mbas ligjës së numratazhit të ndërtesave dhe të rrugave me datë 3 Prill 1929.

Neni 121.

Gjithë tendet e lëvizshme të tregtoreve i pagujnë Bashkiës nji taksë prej 1 deri 3 fr. ari për çdo meter katrore.

Tendat e levizëshme do të jenë të paktën dy metra e gjysëm të nalta nga sipërfaqja e trotuarit, tue mos kapërcye gjansin e tij.

Tendat e qendrueshme janë të ndalueme, për veç atyne që ndertohen si mbas sistemit të quejtun «Marquise» të pëlqyem prej Bashkiës dhe me konditë që të mos të pengojnë me as nji menyrë qarkullimin nepër rrugë, tue qenë pjesa ma e ulët jo ma pak se 2.50 metro e naltë.

Neni 122.

Lejet e gjuetis nuk mund të lëshohen nga Zyrat Shtetnore kompetente ma parë se të provohet me diftesë t'arkës së Bashkiës se asht pague taksa përkatse (2) fr. ari.

Neni 123.

Bashkitë detyrohen të kenë vegla disinfektimi dhe Këshilli i Bashkiës cakton pagesën prej 5 (pesë) gjer në 25 (njizet e pesë) fr. ari për çdo shërbim disinfektimi. Përjashtohen nga kjo taksë banesat dhe sendet e të vobektëvet.

Neni 124.

Bashkitë, mbrënda tre muejve prej hyemjes në fuqi të kësaj ligje, janë të detyrueme të bajnë klasifikimin e rrugëve në pesë kategori.

Për Kryeqytetin, ndërtesat që do të ngrehen në rrugat e kategoris së parë paguajnë nji taksë 5 (pesë) për mij mbi preventivin e kushtimit, ato të kategoris së dytë 4 (katër) për mij, ato të kategoris së tretë 3 (tre) për mij, ato të kategoris së katërtë 2 (dy) për mij, dhe ato të kategoris së pestë 1 (nji) për mij.

Bashkitë e tjera të kategoriës së parë do të marrin taksat e shënueme ma sipër me 15% (pesëmdhet për qint) ma poshtë; ato të kategoriës së dytë me 20% (njizet për qind) ma posht; ato të kategoriës të tretë me 30% (tridhet për qint) ma poshtë, ato të kategoriës së katërtë me 40% (dyzet për qind) ma poshtë.

Në rast mungese të preventivit të kushtimit, vlefta caktohet prej tre ekspertash t'emnuem, nji nga Bashkia, nji nga zyra Botore dhe nji nga t'interesuemit. Në vendet ku mungojnë nji ose të dyja zyrat e sipër-përmenduna vlefta caktohet me anë kallfash të zgjedhun prej Këshillit administrativ.

«Tirana e Ré» përjashtohet nga këto takse.

Neni 125.

Meremetimet e llojit të parë, si mbas nenit 190, që do të bahen ndër ndërtesat nuk i shtrohen taksës së meremetimit. Për meremetimet e llojit të dytë, si mbas randësis së tyne, merret një taksë prej 5 deri 50 fr. ari. Shumën midis minimumit e maksimumit e cakton Këshilli i Bashkiës.

Meremetimet e llojit të tretë që do të bahen nëpër ndërtesat në mënyrë që të ndryshojnë klasin përkatës të ktyne, i shtrohen një takse në këtë sasi: si mbas nenit 183, llogariten shpenzimet e konstruksionit dhe mbi shumën e këtyne nxirret taksa $^1/_2$% (gjysëm për qind) e cila asht taksë meremetimi.

Në qoftë se në një ndërtesë ndodhen nji a ma shumë dyqane ose magaze, meremetimi i këtyne nuk mund të bahet me lejen

e meremetimit të marrun për nji ndërtesë, por duhet për se cillin veç e veç të paguhet taksa e meremetimit e të merren lejet e nevojshme.

Neni 126.

Nga mbajtësit e lokaleve të destinueme për konsumimin e pijeve alkoloike, merret nji taksë 10% (dhjetë për qind) mbi qiran e lokalit; dhe nga lokalet, ku vetëm shtien pije pa u konsumue në vend, merret gjysma e taksës së ma sipërme.

Në rasë mungese kontrate mbi qiran e lokalit, Bashkia e cakton këte në bazë të vendimit të komisionit, të formuem prej nji antarit të Bashkiës nji t'administratës dhe nji t'Odës së Tregtiës.

Neni 127.

Caktimi i taksave direkte që shënohen në nenet e ndryshme të kësaj ligje bahet prej Këshillit të Bashkiës mbrenda dy muejve të parë të vitit financjar dhe, listat emnore me taksat përkatëse për se cilin kontribuent shpallen në vendet ma të dukshme të qytetit.

T'interesuemit kontribuentë mbrënda pesë ditve, prej datës së shpalljes së listave, kanë të drejtë kundërshtimi në Këshillin e Admninstratës së vendit i cili mbrenda 15 ditve vendos definitivisht.

2) KONTABILITETI I BASHKIËS

Neni 128.

Në çdo Bashki duhet të mbahet nji inventar për gjithë pasunit të lujtshme dhe të pa lujtshme në përdorim publik, ose patrimoniale. Gjithashtu mbahet dhe nji inventar i titujve, akteve, hartave dhe shkresave q'i përkasin pasunis bashkiake, si dhe administratimit të tyne.

Këto inventare kontrollohen me rastin e ndërrimit të Kryetarve.

Kopja e inventarve i dërgohet dhe Prefekturës ose Nënprefekturës së vendit.

Neni 129.

Pasunitë bashkijake të pa tundshme rregullisht duhet të çfrytzohen tue u dhanë me qira ose në sipërmarrje, për veç kur kondita të veçanta të vendit e imponojnë përdorimin e tyne prej banuësve të vendit.

Neni 130.

Kapitalet e disponueme duhet të jenë në përdorim, por blerja e titujve Shtetnore të huej asht e ndalueme.

Neni 131.

Inventarët e pasunisë së lujtshme dhe të pa lujtshme nënshkruhen prej Kryetarit dhe Sekretarit, të cillët janë përgjegjësa për ruejtjen dhe mirë-mbajtjen e tyne.

Neni 132.

Kontrata për shitje, blerje, pajtime, sipërmarrje dhe transportime të gjanave dhe të pasunive bashkiake duhet të bahen me adiudikatë publike, si mbas formaliteteve të caktueme për gjanat e Shtetit, për veç rasteve të posht-shënueme:

a) Kur i përket nji shpenzimi të përvjetshëm që nuk kalon shumën fr. ari 100 dhe me konditë që Bashkija të mos jetë e obligueme për atë shumë për nji kohë ma tepër se pesë vjet, dhe që për atë objekt të mos jetë lidhë ndonji tjetër kontratë me llogaritjen e së cilës të kalohet shuma e sipërshënueme;

b) Kur bahet fjalë për nji kontratë vlefta e përgjithshme e së cilës nuk kalon shumën fr. ari 200;

c) Për pajtimin e pasunive bujqësore, të godinave dhe sendeve të pa lujtëshme kur t'ardhunat e tyne nuk kalojnë shumën e fr. ari 100 në vjetë dhe koha e pajtimit të mos jetë ma tepër se 5 vjet por me konditë që të mos jetë pajtue ndonji pjesë me kontratë tjetër të veçantë për nji shumë dhe për nji kohë, e cila tue u llogaritë së bashku me kontratën e ré të kaloj shumën dhe kohën e sipërshënueme.

Neni 133.

Projekt-kontratat që kalojnë shumën prej fr. ari 2000 i paraqiten Këshillit të Prefekturës ose të N-Prefekturës së vëndit për të çfaqë mendimin, aq mbi rregullaritetin sa edhe mbi dobinë administrative të kontratës, dhe për këtë qëllim paraqiten dhe dokumentat, justifikimet dhe spjegimet që mund të kërkohen prej Këshillit.

Neni 134.

Kontratat për fornitura, transportime dhe punime të ndryshme nuk mund të përmbajnë kondita për detyrimin e nji pagese në llogari anticipasion (paradhanie) për veç në proporcion të punës së bame ose të gjanave të dorëzueme.

Neni 135.

Për kontratat për të cilat asht marrë mendimi i Këshillit administrativ të Prefekturës ose të Nënprefekturës, në rast se çfaqet

BKSH

nevoja t'anulohen ose të bahen ndryshime për shkaqe të pa parapame duhet ma parë të merret edhe mendimi i këshillit në fjalë.

Neni 136.

Në raste specjale dhe të ngutëshme, me lejimin e Prefektit mund të lidhen kontrata me liçitasion ose marëveshtje private, po në të tilla raste shuma e tyne nuk mund të kalojë fr. ari 1000 (njimij).

Neni 137.

Adjudikatat publike, licitasionet ose marëveshtjet private për lidhjen e kontratave bahen gjithmonë prej Këshillit bashkiak. paqëtimet që bahen për prona bashkijake, për të cilat flitet në nenin 46, i komunikohen Kuvendit bashkijak për pëlqim.

Neni 138.

Kontratat që kalojnë shumën fr. ari 2000 për të cilat asht marrë dhe mendimi i Këshilit Administrativ të Prefekturës ose të N/Prefekturës, si mbas nenit 133, nuk mund të vihen në zbatim pa marrë pëlqimin definitiv të Prefektit ose të N/Prefektit.

Neni 139.

Për të marrë pjesë n'adjudikata bashkijake t'interesuemit duhet të japin dorzanije si mbas ligjës dhe rregullores për kontratat e Shtetit.

Neni 140.

Bashkiët nuk munt të kontraktojnë huana veç se në kondital që pasojnë:

a) të jetë marrë vendimi prej Kuvendit bashkijak me shumicë votash t'antarve në shërbim dhe me pëlqimin e Këshillit të Shtetit dhe të Këshillit Ministruer;

b) që huanat të kenë për qellim përballimin e shërbimeve ose të punimeve të caktueme dhe të një natyres të jashtzakonshme, dhe me kondité që për këto punime, para vendimit, të jenë pregatitë tipet, projektet dhe studimet rregulisht t'aprovueme prej Ministris së P. Botore, edhe të kenë bashkangjitur nji raport ekspertash të rregulltë;

c) të kenë për qëllim pagimin e detyrimeve të skadúeme para votimit të kësaj ligje;

ç) të jetë sigurue amortizimi i huas me caktimin e mënyrave për t'i ba ballë pagesës së kapitalit dhe kamatave relative.

Aplikohen rregullat dhe kondital e sipër-shënuara dhe për kontratat, pagesa e shumës e të cilave bahet për nji kohë ma tepër se pesë vjet me ose pa kamatë.

Neni 141.

Për veç rasteve të parapame në ligjë, asnjë hua nuk mund të kontraktohet në rast se kamata e sajë, tue u bashkue me kamatat e huanave të lidhuna ma parë, kalon shumën e nji të pestës të ardhunave ordinare të budgetit tue marrë për bazë, për llogaritje për ketë qëllim, konsumtivin e fundit.

Neni 142.

Vjeti financjar fillon me 1 Kallnuer dhe mbaron me 31 Dhjetuer t'atij vjeti. Kontabiliteti i vjetit financjarë përfshin llogarin e budgetit dhe llogarin e përgjithshme të pasunisë patrimoniale. Me 31 Dhejtuer vjeti financjar mbyllet dhe nuk mund të zgjatet.

Neni 143.

Në muejin e Nandorit, Këshilli bashkijak pregatitë budgetin preventiv për vjetin e ardhshëm dhe ja parashtron kuvendit.

Budgeti preventiv përbahet prej t'ardhunave dhe shpenzimeve të parapame për t'u vërtetue ose për t'u pague mbrenda ushtrimit financjar.

Neni 144.

T'ardhunat e budgetit klasifikohen në dy tituj:

a) T'ardhuna efektive dhe b) shndrim kryegjanash.

T'ardhunat efektive përfaqësojnë t'ardhunat e vërteta, dhe ndahen me t'ardhuna të zakonshme dhe të jashtzakonshme.

Në titullin shndrim kryegjanash përmblidhen operasionet që kanë lidhje me pasunin aktive të Bashkiës, p. sh. shitja e pasunive të lujtshme ose të pa lujtshme, marja e huanave etj.

Neni 145.

Shpenzimet e parapame ndahen në dy titulla:

a) Shpenzime efektive; b) shndrrim kryegjanash.

Shpenzimet efektive përfaqsojnë shpenzimet e vërteta, ndahen në shpenzime të detyrueshme të zakonshme ose të jashtzakonshme dhe shpenzime fakultative.

Janë shpenzime të detyrueshme, ato që janë në ngarkim të Bashkive me ligjë të posaçme, dhe fakultative të gjithë të tjetrat.

Titulli shndrim kryegjanash përmbledhë, operasionet që kanë lidhje me pasuniën pasive bashkijake, p. sh. blemje pasunish të pa lujtshme, ose të lujtshme, pagesë e huanave etj.

Neni 146.

Në budgetin preventiv krijohet nji fond i rezervës për Bashkinë e Kryeqytetit prej fr. ari 10.000, për Bashkitë e Prefekturave prej fr. ari 5000 dhe për ato të Nënprefekturave prej fr. ari 2000 për t'i ba ballë shpenzimeve të ma tepërta ose të pa parapame.

Prelevimet prej fondit të rezervës bahen me vendim të Këshillit bashkijak dhe i parashtrohen Kuvendit për pëlqim në mbledhjen e parë.

Neni 147.

Për shpenzime të reja të pa parapame ose për shpenzime të ma tepërme për të cilat nuk mjafton fond i rezervës mund t'i u bahet ballë me paksime fondesh ose me t'ardhunat të rea ose t'ardhuna të vërtetueme ma tepër.

Propozimet për shtesat e fondeve bahen prej Këshillit Bashkijak dhe i parashtrohen Kuvendit për aprovimin si edhe Ministris së P. të Mbrendëshme për pëlqimin definitiv.

Neni 148.

Pagesa e shpenzimeve bahet prej arkëtarit në bazë të mandatave direkte të lëshueme në favor të kreditorve dhe të nëshkrueme prej Kryetarit të Bashkiës, nji antarit të Këshillit dhe Sekretarit ose Llogaritarit.

Neni 149.

Para se të lëshohet nji mandat duhet të vërtetohet prej nëpunsave kompetentë shkaku ligjor dhe justifikimi i shpenzimit; të jetë likuidue logarija dhe të jetë vërtetue se nuk asht shkelë ndonji dispozitë ligjore; që shuma që është për t'u pague të jetë e parapame në budgetin dhe e përshtatëshme me artikullin e shpenzimit të budgetit q'i përket atij artikulli dhe në se i përket kompetencës së vjetit ose të mbrapambetunave, tue shënue mbi çdo mandat kategorinë dhe artikullin që i përket shpenzimit.

Neni 150

Lëshimi dhe pagesa e mandatave provizore asht krejt e ndalueme. As nji mandat nuk mund të lëshohet pa patur fondin e budgetit dhe para se të ketë skadue afati i pagesës së shpenzimit.

Neni 151.

Forma e budgeteve, e llogarive dhe e akteve të tjera caktohet me Rregullore të posaçme.

Neni 152.

Nxjerrja e taksave e t'ardhunave të ndryshme dhe e gjobave bahet prej arktarit dhe tagrambledhsave në bazë të kontratave të pajtimit të listave emnore të taksave direkte të vërtetueme rregullisht dhe të proçes verbaleve për caktimin e gjobave tue ndjekë proçedurën e caktueme në ligjën mbi nxjerrjen e t'ardhunave të Shtetit.

Neni 153.

Arktari, llogaritari dhe tagrambledhsit e Bashkive duhet të japin nji dorzanië si mbas ligjës që cakton dorzanitë e nëpunsave të Shtetit.

Sasija e dorzaniës dhe natyra ka me u caktue prej Këshillit bashkiak me pëlqimin e Kuvendit.

Neni 154.

Për çkapërcimet e fondeve të caktueme në budget nëpunsat kompetent si dhe urdhnuesat e pagesës janë solidarisht pergjegjës për damet që mund t'i kenë rrjedhun Bashkiës.

Vendimet mbi ngarkimet e pergjegjsiës merren prej Kuvendit bashkijak dhe me pelqimin e Prefektit ose të Nenprefektit të vendit.

Ngarkimet personale të bame prej Kuvendit nxirren nga nëpunsat ose personat pergjegjës si mbas formaliteteve të caktueme për t'ardhunat bashkiake.

Neni 155.

Dy muej mbas mbarimit të vjetit financjar nëpunsat kompetentë pregatisin llogarin e budgetit konsumtiv, si edhe llogarinë patrimoniale konsumative të cillat i paraqiten Këshillit bashkijak për vertetim dhe mandej i parashtrohen Kuvendit për aprovim.

Budgeti konsumtiv i parashtrohet edhe Këshillit Kontrollues për të dhanë vendimin definitiv mbi mirë zbatimin ose jo të tij.

Neni 156.

Arkëtarët dhe tagrambledhsit mbrenda nji mueji nga mbarimi i vitit financjar japin llogari mbi taksat e nxjerruna prej tyne dhe mbi ato të mbrapambetuna si dhe mbi pagesat e bame në bazë të mandatave të regulta. Kjo llogari i parashtrohet Këshillit bashkijak, i cili vendos ngarkimin ose shkarkimin e tyne.

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 157.

Ndreqja dhe meremetimi i trotuarëve i perket kryesisht Bashkiës.

Neni 158.

Kanalet e pergjithshme bahen me shpenzimet e Bashkiës në bazë të planit teknik, t'aprovuem nga Ministrija e P. Botore, dhe kanalet private që lidhen me kanalet e përgjithshme të bamuna, kryhen nga pronarët, qoftë Shteti, privati ose personi juridike.

Në rast se këta nuk e permbushin këtë detyrë, Bashkija i ban tue nxjerrë prej tyne shpenzimet përkatse në bazë të ligjës mbi nxjerrjen e taksave shtetnore.

Neni 159.

Ujnat që burojnë në vende publike dhe mbrenda juridiksionit të Bashkiës ato që rrjedhin nga krojet e pergjithshme, ato të mbledhuna dhe të rregullueme prej Bashkiës, ato që vijnë prej së jashtmi, dhe kur mbi këto nuk ekziston nji e drejët e fitueme, konsiderohen në zotnimin e Bashkiës.

Ato ujna që gjinden në jurisdiksjonin e Bashkiës dhe që në to ekziston nji e drejtë e fitueme prej tjetrit, Bashkia i çpronson për dobi publike e shëndetsore, mbasi për ket çpronsim të merret vendimi i Këshillit të Shtetit dhe aprovimi i Këshillit Ministruer.

Kur Bashkia nuk e shef t'arsyshme eksprojimin e ujnave të sipërtregueme dhe, kur këto ujna janë në dam të shëndetsiës publike ose në dam të rrugave ose të zbukurimit të qytetit, Bashkia detyron pronarët e atyne ujnave me i u konformue masave për çdukjen e dameve të sipër-tregueme, në rast që pronarët nuk i konformohen kësaj nevoje, Bashkia vepron me shpenzimet e veta për t'i regullue ujnat si mbas nevojës së nalt-tregueme dhe shpenzimet e bamuna i ngarkohen pronarit t'ujnave.

Neni 160.

Ata që nuk respektojnë urdhnat e Bashkiës të dhanuna në bazë të kësaj ligje, me vendimin e Këshillit të Bashkiës gjobiten prej 5 deri 100 fr. ari, dhe në rast persëritjeje gjoba dyfishohet, si në minimumin asht dhe në maksimumin.

Të gjobuemit gëzojnë të drejtën e kundërshtimit para Gjyqit të Paqit. Vendimi i këtij Gjyqi asht i premë.

Neni 161.

Bashkitë konsiderohen si gjithë institutet dhe personat private për sa u perket pagimit të deteve të tyne.

Për ekzekutimin e vendimeve të sekuestrimit mbi t'ardhunat e Bashkiës, ose mbi çdo lloj pasunije Bashkijake, aplikohen rregullat proçedurjale dhe ligjet e pergjithmshme pa ndonji perjashtim, siç veprohet për privatët.

Për pagimin e detave të prapambetuna deri në kohen e hyrjes në fuqi të kësaj ligje, Bashkitë detyrohen me caktue në budgetin e tyne vjetuer 25% mbi gjithë t'ardhunat. Prej kësaj shume proporcionalisht kanë me u pague gjithë kreditorët deri në shlyemjen e plotë të këtyne deteve.

Për Bashkitë që nuk paguajnë në ketë mënyrë detat e mbrapambetuna, mund të bahen veprimet e sekuestrimit për sa i përket proporcionit të borxhit.

KAPTINA E TRETË

MBI RRUGAT E NDËRTESAT

PLANET

Neni 162.

Bashkitë janë të detyrueme me pregatitë dy plane rregulluese për qytetin, prej të cilëve njeni do të shërbejë për kanalizimin dhe tjetri për sipërfaqen dhe nivelementin.

Shkalla e tyne do të caktohet prej kompetenve, si mbas nevojave dhe pozitës së qytetit.

Neni 163.

Plani i kanalizimeve do të tregojë kanalet kryesore dhe degët e tyne, së bashku me pendencat perkatse. Në rast që kanali kryesuer nuk do të mundet të desharzohet në ndonji lum ose vijë, do të tregohet vendi ku do të derdhet.

Ky plan merr formën definitive mbasi të plotsohen të gjitha ato dispozita që kerkohen për planin e qytetit.

Neni 164.

Plani rregullues i qytetit do të përmbajë gjendjen e këtij dhe vijat e rrugavet që do të çelën ose do të zgjanohen, bashkë me gjansit e tyne dhe me pendencat, të cilat nuk do të kapërcejnë gjashtë për qind.

Në rast nevoje, do të tregohen edhe rrugat me shkallë.
Mbi këtë plan duhet hartue edhe nivelimenti.

Neni 165.

Plani rregulues i qytetit duhet hartue dhe pregatitë me anën e specialistave. Në hartimin e këtij plani duhen marrë parasysh nevojat e qytetit, si mbas konditave shkencore dhe hygjenike.

Neni 166.

Planet e siper-tregueme, mbasi të japin mendimin mbi to Këshilli i Bashkiës edhe i Administratës, mbasi të shqyrtohen prej Zyrës Teknike të vendit, mbasi të kontrolohen në vend dhe prej Zyrës Teknike të Ministris P. Botore, marrin formën definitive dhe të pa cenueshme me aprovimin e Këshillit Ministruer dhe me Dekret-Mbretnuer.

Në rast nevoje të domosdoshme të nji interesi të përgjithshëm, ndryshimi i planit rregullues do të bahet me ligjë.

Neni 167.

Për me grarantuem mos ndryshimin e planit që ka marrë formën definitive, do të vihen shenja të dallueshme në drejtimet e rrugave kryesore.

Neni 168.

Origjinali i planit rregullues, mbasi të nxirren prej këtij kopjet e nevojshme, do të mbyllet në arkën e Bashkiës përpara nji komisioni i përbam prej Prefektit ose N/Prefektit, prej Kryetarit të Bashkiës edhe prej nji kompetenti të zyrës teknike, tue u mbajtë nji proçes verbal i rregullshëm.

Në rast kontestimi, kur shifet nevoja e krahasimit me origjinalin ky mund të nxirret, tue u respektue formalitetet e ma sipërme.

Neni 169.

Planet rregullues të qyteteve të pregatituna prej Ingjenjerve kompetenta dhe t'aprovuem rregullisht si prej Këshillit Teknik ashtu edhe prej Këshillit Ministruer, mbeten në fuqi, planet e tjera janë t'anulueme.

Neni 170.

Zbatimi i planit të kanalizimit do të fillojë piksëpari me ndreqjen e kanaleve kryesore, në të cilat do të derdhen kanalet e dyta dhe në këto kanalet e treta.

Bashkë me kanalet duhet bamë njikohsisht dhe ndreqja e rrugave.

RRUGAT

Neni 171.

Rrugat e qyteteve ndahen në pesë kategorië: të kategoriës së parë janë ato gjansija e të cilave asht gjer në 25 metro e sipër të kategoriës së dytë janë ato, gjanësia e së cilavet ësht 12 gjer në 25 metra, të kategoris së tretë janë ato gjansija e të cilave asht 8 gjer 12 metra, të kategoriës së katërtë janë ato që gjansija e tyne asht nen 8 metra, dhe të kategoriës së pestë rrugat e verbta (pa dalje).

Neni 172.

Asht i ndaluem rreptësisht krijimi rrugash pa dalje si dhe zgjanimi i tyne në ketë mënyrë.

Në rast që për arsye ekonomike asht e pa mundun çelja e rrugëve pa krye q'ekzistojnë, Bashkitë janë të detyrueme t'i mbyllin me portë për të mos u dukun ekzistimi i tyne.

Neni 173.

Në bashkimin e rrugëve, në qoftë se brylet janë ma pakë se 60° priten me nji vijë të drejtë me gjatësi të paktën dy metra e gjysëm, e cila duhet të jetë përpendikularë e bisektrisit të brylit.

Neni 174.

Në rast çeljeje rrugash të rea dhe zgjanimi ose mbylljeje t'atyne që eksistojnë, ndërtesat ose trojet që mbeten pa dalje ose prej të cilavet nuk mund të përfitohet, do të çpronësohen prej Bashkiës me dëshirën dhe si pas kërkesës së pronarit.

NDËRTESAT

Neni 175.

Ndërtesat janë tre llojësh:

1) Banesat private;

2) Zyrat Qeveritare, ndërtesat shkollore, hotelet, apartamentet, spitalet, theatrot, dyqanet, magazinat, tregtoret etj.;

3) fabrikat, uzinat dhe furrat që kanë të bajnë me përdorjen e zjarit si edhe vendet ku ruhen ose shiten sendet eksplosive.

Neni 176.

Kushdo që ngrehë ndërtesa asht i detyruem me pregatitë planin e truelit dhe të ndërtesës. Ky plan duhet të jetë hartue pikrisht

BKSH

si mbas regullores që ka me u pregatitë prej Bashkiës, dhe duhet me u aprovue prej zyres teknike të Bashkiës në se kjo ekziston. Planet duhet të jenë të nëshkruem prej nji Arshitekti ose Ingjenjeri.

Neni 177.

Për ndërtesat e lejueme nuk mundet me u ba as nji ndryshim principal pa u marrë leja e Bashkiës.

Neni 178.

Arshitektët, Ingjinerët ose kallfat të lejueme prej Bashkiës për ushtrimin e profesjonit të tyne, që kanë marrë për sipër përgjegjësinë dhe mbi-kqyrjen e konstruksjoneve, detyrohen me lajmërue Bashkiën në rast largimit të tyne. Në rastin e kundërt nuk shpëtojnë nga pergjegjësija ligjore deri në mbarim të konstruksionit. Arshitektët, Ingjinjerët apo kallfët që merren rishtas prej pronarit nuk munden me vazhdue mbikqyrjen e konstruksioneve pa u lajmërue Bashkia.

Neni 179.

Në rastë që një ndërtesë ndodhet në rrezik për banuesit e saj ose për udhtarët, pas nji raporti t'ingjenjerit të vendit ose të nji tekniku t'autorizuem prej Bashkiës, mbrënda nji afati të caktuem prej teknikut të Bashkiës, pronari asht i detyruem me e shprazë. Vendimi i Ingjenjerit mund t'apelohet mbrënda një jave përpara Gjyqit të Paqit të vendit, vendimi i të cillit asht definitiv.

Në rast se gjyqi verteton ekzistencën e rrezikut, pronarit i shembet shtëpija nga ana e Bashkiës tue nxjerrë shpenzimet si mbas ligjës mbi nxjerrjen e taksave shtetnore.

Në rast që vendimi i gjyqit refuzon qënien e rrezikut, i interesuemi ka të drejtë padije kundrë Ingjenjerit për të nxjerrë shpërblimin e damit që ka pësue.

Neni 180.

Kur pronari nuk konformohet me planin q'i ka paraqitun Bashkiës si mbas nenit 176, dhe me dispozitat ligjore mbi ndërtesat, gjobitet prej gjyqit kompetent me fr. ari 100 deri në 500 në favor të Bashkiës dhe detyrohet mbrënda dy muejve të plotsojë të metat. Pas kalimit të këtij afati kompletimi i këtyne i vihet n'ankant nga ana e Bashkiës me shpenzimet e pronarit.

Dispozitat e këtij neni nuk përfshijnë godinat e «Tiranës së Ré» të cilat rregullohen me ligjën e posaçme.

Neni 181.

Ndërtesat e kategoriës së llojit të parë dhe të dytë do të jenë të paktën dy pate, për veç bodrumeve në rasë se ka, ato të kategoriës së tretë të shumtën me dy pate.

Ndërtesat ndër copa të rrugave me gjansi të ndryshme i shtrohen konditave të shënujeme në këtë ligjë për rrugët ma të gjana.

Neni 182.

Në hartimin e planit rregullues të qyteteve do të shënjohet drejtimi i vijës, mbi të cilën kanë me u rreshtue facadat kundrejtë rrugave, simbas nevojës së vëndit dhe të teknikës së parashikueme prej Ingjenjerit.

Ndër vise në të cilat eksiston nji plan definitiv, drejtimet e facadavet do të caktohen prej nji komisioni teknikësh të zgjedhun nga Bashkia.

Godinat që do të ngrehen në «Tiranën e Ré» përjashtohen nga kjo dispozitë.

Neni 183.

Bashkitë për ndërtesat që dotë ngrihen me tulla, me gur, me beton, etj. do të kërkojnë prej t'interesuemit që, bashkë me planin do të paraqesin dhe preventivin e kushtimit, i cili ka me u shqyrtue prej teknikve të Bashkiës dhe në bazë të tij ka me u marrë taksa përkatse.

Neni 184.

Naltësilja e xhumbave dhe e ballkoneve prej sipërfaqes së tokës duhet të jetë jo ma pak se dy metra e gysëm.

Gjanësija dhe gjatësija e tyne do të caktohet në Rregulloren që do të pregatitet prej Bashkiës.

Neni 185.

Përpara ndërtesave që ndodhen mbi rrugë n'asnji mënyrë nuk mund të goditen shkallë, basamakë, dritore, dritore të nëndhezës (sous-sol) mbi trotuarin, si dhe çdo send që sjell pengim.

Neni 186.

Ujnat e shiut e të gjithë ndërtesave që ndodhen në rrugë duhet të mblidhen me anën e borijave. Ujnat në fjalë deri në trotuarin e rrugës duhet të zbrazen me borija të cingullta që mbështeten në mur dhe të derdhen në kanale tue kalue nën trotuaret. Gjithashtu asht e ndalueme derdhja dhe hedhja e ujnave jashtë, qoftë prej çatis qoftë

prej çdo naltsije tjetër si dhe prej sipërfaqes së trotuarit. Borijat e ndërtesave që janë vendosë ose do të ngrihen në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, prishen dhe goditen drejt për drejt prej Bashkiës, e cilla kushtimin e tyne dy fish e nxjerrë prej proprietarit të ndertesës, si gjithë gjobat e taksat bashkijake. Të dalmet e këtyne borijave, prej sipërfaqes së jashtme të ndërtesës makimum mund të jenë deri 16 sentimetra.

Neni 187.

Në rast ndreqjeje ndërtesash në buzë të rrugëve publike, vendi i destinuem për konstruksion duhet me u rethuem, dhe po t'okupohet me material nji pjesë ose i tanë trotuari, Bashkija ka të drejtë me kërkue prej pronarit nji shpërblim të caktuem prej Këshillit të sajë.

Neni 188.

Në rast rrenimi të nji ndërtese, pronari asht i detyruem mbrënda 15 ditve prej datës së njoftimit t'a ngrejë materjalin e rrëzuem dhe; në rast mos bindjeje Bashkija e ngren vetë tue i nxjerrë shpenzimet në bazë të ligjës mbi nxjerrjen e taksave Shtetnore.

Neni 189.

Në vendet e posaçme për mbledhje publike, si theatro, cinema, vend akrobatazhi dhe gjith vendet për zbavitje dhe kafenet të mbëdha, për me lehtësue daljen e popullit duhet me doemos të goditen disa dyer me distanca të largta njera me tjerën dhe shkallët e mbrendshme duhet të jenë të bashkueme me këtë.

Gjerësia e shkallave duhet të jetë metro 2.50 për çdo 100 frymë që do të shkojë drejtë për drejtë nga shkallët.

MEREMETIMET

Neni 190.

Meremetimet janë tre llojësh:

1) Meremetimi i faqes së dyshemes së patit në bodrum të ndërtesës: gjithë meremetimet e suvasë, badanaja, boja, depot e ujit, pusi, depoja, panxhurat, penxheret e parmaklleqet, kafazat të nderuesit e qiramidheve, gjith muret e avllisë e ndarjet me dërrasa, baxhat, oxhaqët etj;

2) meremetimi i bamun në ndërtesa pa ndryshue klasin respektiv, si mbas nenit 175 të kësaj ligjë;

3) modifikimet e meremetimet e bamuna në ndërtesë në mënyrë që të ndryshojë klasin rispektive të treguem në nenin 175 të ndërtesavet.

Neni 191.

Prej meremetimevet të tregueme në nenin e ma sipërm ato që tregohen në paragrafin e parë janë të përjashtueme nga leja, por për meremetimet e llojit të dytë dhe të tretë duhet të merret leja zyrtare.

Neni 192.

Landa e mbetun e ndërtesave, të rrezikshme që nuk kanë zot shitet n'adujdikatë nga ana e Bashkiës dhe të hollat mbeten n'arkën e sajë si depozitë.

Neni 193.

Mbikqyrsit përgjegjës të ndërtesave duhet të jenë me doemos ja Ingjinjer, ja Arshitekt të diplomuem prej nji Universiteti ose kallfë të lejuem prej Bashkiës.

Neni 194.

Gjitha faltoret, kazermat, shkollat, spitalet dhe çdo ndertes shtetnore si edhe godinat e ngrehuna për qëllim bamirësije përjashtohen prej taksës së lejes për ndërtim dhe detyrohen vetëm me paraqitjen e planit si mbas nenit 176.

Neni 195.

Muret që goditen për me rujtë bostanet ose trojet, nuk i shtrohen taksit të ndërtimit dhe meremetimit, por i zoti detyrohet me marrë lejen e regullshme të Bashkiës.

Neni 196.

Ata që hedhin themelet e nji ndërtese pa marrë lejen e Bashkiës, ndalohen nga puna prej organeve të Bashkiës dhe gjobiten prej gjyqit kompetent me fr. ari 50 deri 1000, në favor të Bashkiës, sasija e gjobës dyfishohet n'asht se ndërtsa asht e mbarueme.

Por në qoftë se ndërteesa asht ngrehun kundra planit rregullues të qytetit dhe kundra ligjës së ndërtesave, me kërkimin e Bashkiës dhe me vendimin e gjyqit kompetent, ndërtesa rrëxohet tue, ingarkue gjith shpenzimet për rrëxim pronarit të ndërtesës.

Neni 197.

Në qoftë se në ndërtesat, pa marrë ma parë lejen e duhun,

BKSH

bahen shtesa ose modoifikime jasht planit të paraqitun të ndërtesës, dhe n'asht se këta shtesa ose modifikime janë bamë si mbas ligjës e teknikës, nga i interesuemi nxiret nji gjobë prej dy fish të taksit q'i përket patit ku asht ba ndryshimi, si mbas nenit përkatës të kësaj ligje.

Në rast se shtesat dhe modifikimet janë ba kundra ligjës së ndërtesave dhe teknikës, atëhere aplikohen dispozitat e paragrafit të fundit të nenit 196.

Neni 198.

Ndërtesat e ngrehuna ma parë se të vehet në zbatim kjo ligjë nuk mund të meremetohen pa u plotsue kondilat e tregueme në këtë ligjë.

Neni 199.

Në qoftë se meremetimet e bame pa lejen e duhun kanë të gjitha cilsiët dhe kondilat ligjore dhe teknike meret prej kundravajtësit nji gjobë pesë fish ma tepër se taksa e caktueme si mbas nenit përkatës.

Në rast që meremetimet e bamuna nuk kanë kondilat teknike, pronari i ndërtesës gjobitet me fr. ari 50 deri 500 prej gjyqit kompetent dhe, meremtimet e bamuna prishen me shpenzimet e pronarit.

KAPTINA E KATERTE

ÇPRONSIMI DHE VLEFTSIMI I TOKAVE DHE I GODINAVE

Neni 200.

Për çdo send q'i përket dobiës dhe interesit të përgjithshëm dhe për nevojat e posht shenjueme, Bashkitë janë t'autorizueme me çpronsue troje dhe ndërtesa:

a) për me hapë rruga të rea;

b) për me zgjanue rrugat që ndodhen;

c) për me goditë kanale e sheshe të përgjithshme;

ç) për me ngrehë spitale, strehë për të vorfnit dhe jetimët;

d) për me krijue e zgjanue vende tregu, abatoare, porte, kopshtije dhe parqe, vende shetitjeje, vija për sjellje uji, pellgje dhe kroje për raste zjarmi;

dh) për me goditë, si mbas kondilave hygjenike, vorreza ose për me transferue ato që ndodhen;

e) për me mirsue e rregulue vijat e ujnave natyrale dhe për transformimin e tyne në mënyrë të përfitueshme;

ë) për konstruksione e punime q'i përkasin hygjeniës;

f) për me goditun e çelë rishtazi ose për me zgjanue depot e sendevet ndezëse dhe për Stadium e fusha sportive.

Neni 201.

Gjithë shpronsimet nuk mund të vehen në veprim para se të merret mendimi i Këshillit Administrativ të Prefekturave ose të Nënprefekturave edhe aprovimi i Ministris së P. të Mbrendëshme, i cili u jep çpronsimeve formen definitive.

Neni 202.

Vlefta e truellit ose e godinave që do të çpronsohen caktohet prej nji komisioni i përbaëm prej nji përfaqsuësi të Financës së vëndit si kryetar, prej nji Tekniku, prej një Këshilltari të Bashkiës dhe prej dy Përfaqsuësve të pronarit.

Vendimi i këtij komisjoni mund të kundërshtohet mbrënda 15 ditve prej pronarit ose prej Bashkiës përpara gjyqit të Paqit të vendit, i cili vendos me ngutësi, vendimi i dhanun prej këtij gjyqi asht definitiv.

Neni 203.

Në rast që pronari nuk emnon përfaqsuesin e tij për formimin e komisionit në fjalë, mbrenda nji jave nga data e komunikimit ose, në rast që përfaqësonjësi i tij nuk mer pjesë në mbledhjet e komisjonit, Bashkija mer dy nga antarët e pleqësiës t'asaj lagje ku ndodhet prona për çpronsimin.

Neni 204.

Nji komision i posaçëm i përbaëm prej nji përaqësuesi të Ministris së P. të Mbrendëshme, të Drejtësiës dhe të P. Botore për Kryeqytetin dhe prej këshillit të përbashkët t'administratës dhe të Bashkiës, për Prefekturat e Nenprefekturat vendos dhe cakton çka asht për t'u bërë me tepricat e rrugëve dhe të trojeve t'eksproprijuëshme.

Në rrugat e klasit të I-rë e të II-të, kuer për shkak çelje ose zgjanimi të tyne mbeten vende të pa mjaftueshme për ngrehje cakgodinash në mënyrë të përshtatshme planit dhe rregullave të caktueme prej Bashkiës, si dhe konditave të kerkueme prej kësaj ligje, pronari i tokës ma të gjanë kufizore detyrohet me ble këtë vend të vogël me çmim që do të caktohet prej ekspertave të Bashkiës.

Në qoftë se pronari në fjalë refuzon t'i bindet këtij obligimi, ky detyrohet me i shitë me çmimin që caktohet si ma sipër pronarit të vendit të pa mjaftueshëm nji pjesë nga toka e tij në madhni të mjaftueshme për zbatimin e dispozitës së sipër-shenueme për ngrehjen e nji godinës.

Në qoftë se edhe pronari i tokës së vogël refuzon të blejë pjesën e nevojshme nga pronari i tokës kufizore, vendi bashk me pjesën në fjalë çpronsohet nga ana e Bashkiës dhe shitet n'adjudikatë si mbas dispozitave të kësaj ligje.

Këto dispozita aplikohen edhe mbi ato troje që ndodhen ngjit ose mbrapa trojeve të ndodhuna në kl. e I-rë e të II-të dhe të mjaftueshme për ngrehje godinash a po edhe ngjit ose mbrapa godinash të ndodhuna në rrugët e Kl. I-rë e II-të, në qoftë se ato troje formojnë nji rryp, nji kand ose nji hundë në truellin e tjetrit që gjindet në kl. e I-rë e të II-të, dhe të cilat nuk janë të mjaftueshme me as nji mënyrë me ngrehë mbi ta çfarëdo godine.

Neni 205.

Tre muej përpara do t'u komunikohet t'interesuemve pjesa e planit për t'u zbatuem, sasija e pronës që nevojitet për ç'pronsim dhe çmimet e caktueme.

Neni 206.

Nuk mund të vihet dorë mbi pronat e çpronsueme në qoftë se pronarët nuk paguhen plotsisht, përveç rasteve të parapame në nenin 114.

Në rast që pronarët refuzojnë marrjen e vleftës të çpronsimit të hollat depozitohen në Bankë në dispozision të tyne, dhe ky depozitim konsiderohet si pagesë e bame personalisht.

Neni 207.

Trojet dhe ndërtesat që vendosen të eksproprijohen për kopshitje publike, parqe, sheshe të përgjithshme, fusha sportive, si dhe ato që çpronsohen për ngrehje spitalesh, strehësh vorfënore, tregjesh e institutesh të tjera, për dobi publike, kur çmimi i caktuem për çpronsimin e këtyne nuk u paguhet pronarve mbrenda vitit, qysh prej ditës së përmbushjes së gjith formaliteteve të caktuem në nenet e ma sipërme, atëherë veprimet e çpronsimit quhen të pa vleftëshme dhe pronarët mbeten të lirë në zotnimin e pasunive të tyne.

KAPTINA E PESTË

PASQYRA E KUADROS TË NËPUNSAVE TË BASHKIVE

Neni 208.

Pasqyra e Kuadros së Bashkiës së Tiranës

Administrata

Kryetari i Bashkiës së Tiranës merr rrogë mujore sa ajo e Prefektit të klasit I-rë dhe, alokasjon të caktuar prej Kuvendit të Bashkiës.

				Fr. ari
Nji sekretar	me rrogë	mujore		250
Nji sekretar i dytë	»	»	»	160
Nji protokolist-arshivist	»	»	»	140
Nji kopist	»	»	»	120

Zyra e Inspektoriës

Nji Inspektor	me rrogë	mujore		220
Nji ndihmës inspektori	»	»	»	200
Deri 20 policë	»	»	»	120

Zyra e Financës

Nji kryellogaritar	me rrogë	mujore		250
Nji llogaritar	»	»	»	190
Nji ndihmës llogaritar	»	»	»	160
Nji arkëtar	»	»	»	160
Nji nëpunës i kontratave	»	»	»	140
Nji vertetuës	»	»	»	160
Nji nëpunës i depos sendeve ndezëse	»	»	»	120
Katër tagrambledhsa se i cilli	»	»	»	110
Dy rojtar depoje se i cilli	»	»	»	90
Tre rojtar vorreze se i cilli	»	»	»	90
Nji rojtar i abatoarit dhe i vulosjes	»	»	»	90
Dy rojtar të burgut të qenve dhe të shtëpis së vobekëve se i cilli	»	»	»	90
Dy rojtarë të vulosjes s'ujit të pishëm se i cilli	»	»	»	90
Nji kasnec	»	»	»	90

BKSH

Zyra Teknike

Nji ingjenjer	me rrogë mujore	400
Nji ingjenjer-arshitekt:		
1) n'asht vetëm arshitekt	» » »	320
2) n'asht ingjenjer-arshitekt	» » »	400
Nji ingjenjer kanalesh e ujnash	» » »	320-400
Nji gjeometër	» » »	240
Nji disenjator-sekretar	» » »	160
Dy konduktora	» » »	160

Zyra e Shëndetsiës

Nji mjek (Shef i Zryës)	me rrogë mujore	320
Tre mjekë se i cili	» » »	240
Nji veterinar	» » »	320
Tre mami se e cila	» » »	160

Zyra e Gjendjes Civile

Nji nëpunës i Gjendjes Civile	me rrogë mujore	200
Nji ndihmës nëpunës i Gjendjes civile	» » »	160
Nji nepunës i kunorëzimit	» » »	160

Për veç nëpunsave të permendun, në zyrat e ndryshme, mund të shtohen si mbas nevojës dhe gjendjes së budgetit, edhe sherbtorë, shofer lulishtar, personel spitalesh e ambulancash etj.

Pasqyra e Kuadros së Bashkive Durrës, Korçë, Shkodër

A d m i n i s t r a t a

		Fr. Ari
Nji Kryetar	me rrogë mujore	360
Nji sekretar	» » »	200
Nji protokolist, arshivist-kopist	» » »	100

Zyra e Inspektoriës

Nji inspektor	me rrogë mujore	140
Deri 10 polic: se i cili	» » »	90

Zyra e Financës

Nji llogaritar	me rrogë mujore	180
Nji ndihmës llogaritar	» » »	140
Nji arkëtar	» » »	140
Tre tagrambledhsa: se i cili	» » »	90

Zyra Teknike

Nji ingjenjer ose arshitekt	me rrogë muejore	240-320
Nji kondoktor	» » »	160

Zyra e Shëndetsiës

Dy mjekë se i cili	me rrogë muejore	240
Dy mami » » »	» » «	160

Zyra e Gjendjes Civile

Nji nëpunës i Gjendjes Civile	me rrogë muejore	190
Nji ndihmës nëpunës i Gjendjes Civile	» » »	125

Për veç nëpunsave të permendun në zyrat e ndryshme, mund të shtohen, si mbas nevojës dhe budgetit, edhe sherbëtorë, shofer, lulishtar, personal spitalesh e ambulancash etj.

Pasqyra e Kuadros së Bashkivet Berat, Elbasan, Gjinokastër, Vlonë

Administrata

		Fr. Ari
Nji kryetar	me rrogë muejore	320
Nji sekretar	» » »	180
Nji protokolist-arshivist, kopist	» » »	100

Zyra e Inspektoriës

Nji inspektor	me rrogë muejore	120
Deri gjashtë polic	» » »	90

Zyra e Financës

Nji llogaritar	me rrogë muejore	170
Nji arktar	» » »	120
Dy tagrambledhësa se i cili	» » »	90

Zyra Teknike

Nji ingjenjer ose arshitekt	me rrogë muejore	240
Nji konduktor	» » »	120

Zyra e Shëndetsiës

Dy mjekë se i cili	me rrogë muejore	240
Dy mami » » »	» » «	160

Zyra e Gjendjes Civile

Nji nëpunës i Gjendjes Civile	me rrogë muejore	170
Nji ndihmës nëpunës i Gjendjes Civile	» » »	100

Për veç nëpunsave të permendun në zyrat e ndryshme, mund të shtohen, si mbas nevojës dhe budgetit, edhe sherbtorë, shofer, lulishtar, personal spitalesh e ambulanca etj.

Pasqyra e Kuadros së Bashkivet Burrel, Kukës, Peshkopi

Administrata

		Fr. Ari
Nji kryetar	me rrogë muejore	250
Nji sekretar-llogaritar	» » »	160
Nji arkëtar	» » »	100
Nji polic me detyrë tagrambledhësi	» » »	90

Zyra Teknike

Nji konduktor	me rrogë muejore	120

Zyra e Shëndetsiës

Nji mami	me rrogë mujore	160

Zyra e Gjendjes Civile

Nji nëpunës i Gjendjes Civile	me rrogë mujore	160

Për veç nëpunsave të permendun në zyrat e ndryshme mund të shtohen, si mbas nevojës dhe budgetit, sherbtorë, shofer, lulishtar, personal spitalesh e ambulancash etj.

Pasqyra e Kuadros së Bashkive Bilisht, Delvinë, Fier, Kavajë, Krujë, Lushnje, Përmet, Pogradec, Tepelenë, Sarandë

Administrata e Financa

		Fr. Ari
Nji Kryetar	me rrogë mujore	220
Nji sekretar-llogaritar	» » »	120
Nji arkëtar	» » »	100
Nji polic me detyrë tagrambledhsi	» » »	90

Zyra e Shëndetsiës

Nga nji mjek në gjith qytetet e kësaj pasqyre, për veç në Tepelenë,	me rrogë mujore	240
Nga nji mami në gjith qytetet e kësaj pasqyre, për veç në Tepelenë,	me rrogë mujore	160

Zyra e Gjendjes Civilie

Nji nëpunës i Gjendjes Civile	me rrogë mujore	140

Për veç nëpunsave që përmenden në seksionet e ndryshme mundet të shtohen, si mbas budgetit dhe nevojës, edhe shërbtorë, shofer, lulishtar personal spitalesh e ambulancash etj.

Pasqyra e Kuadros së Bashkivet Ballsh, Ersekë, Lesh, Leskovik, Libohovë, Peqin, Shijak, Zerqan

Administrata e Financa

		Fr. Ari
Nji Kryetar	me rrogë mujore	200
Nji sekretar-llogaritar	» » »	120
Nji Arkëtar	» » »	100
Nji polic me detyrë tagrambledhsi	» » »	90

Zyra e Shëndetsiës

Nji mjek në Lesh e në Shijak	me rrogë mujore	240
Nji mami në Lesh e në Shijak	» »	160

Zyra e Gjendjes Civile

Nji nëpunës i Gjendjes Civile	me rrogë mujore	140

Neni 209.

Në gjithë Prefekturat ose Nënprefekturat, Bashkitë po të jetë nevojë kanë për të patur nji nënpunës depoje me 90 fr. ari rrogë mujore.

Neni 210.

Gjith personali që figuron në pasqyrat e sipërtregueme të Bashkive asht në shkallën maksimale, dhe Ministrija e P. të Mbrendëshme në shqyrtimin definitiv të budgeteve bashkijake ka të drejtë t'i zbresë si mbas nevojës.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 211.

Me të hyrë në fuqi kjo ligjë, Ligjët e poshtë shenjueme, shtojcat dhe modifikimet e tyne dhe çdo ligjë tjetër në kundërshtim me këtë, janë të abrogueme.

Ligjat e abrogueme janë këto:

1) Ligjat mbi Bashkinë e Stambolit dhe të Vilajeteve me d. 23 Vjesht 1293 disa modifikime të kësaj ligje me d. 2 Korrik 1328;

2) Shtojcat e ligjës me d. 3 Tetor 1302 dhe me 3 Vjesht 1306, dhe ligja provizore e organizimit të Bashkiës së Stambollit me 17 Dhjetuer 1328;

3) Ligja e ndërtesave me datë 1293, me gjithë tre shtojcat e saja ;

4) Ligja e shpronsimit me 24 vjesht e tretë 1925, edhe shtojcat e saja me 1298, dhe me 14 Shkurt 1328, dhe me 25 Qershuer 1328 dhe gjith shtojcat e tyne;

5) Ligja e Bashkive me datë 25-XII-1921;

6) Ligja mbi zgjedhjet e Këshilave të Bashkiës me datë 14-2-1922;

7) Ligja mbi financat e Bashkive me d. 26-V-1923 dhe me 7-6-1926, dhe shtojcat e kësaj me d. 22-IV-1927;

8) Shtojca e Ligjës mbi të drejtat e Bashkive me datë 6-6-1927;

9) Ligja mbi Bashkiën e Kryeqytetit me datë 27 Maj 1928;

10) Ligja mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkive me 1 Dhetuer 1928;

11) Dekret-Ligja mbi taksin e Lulzimit me d. 15-XII-1926, dhe shtojca e ktij me 21 Qershuer 1929, dhe Dekret ligja po mbi këtë taksë me 10 Maj 1929;

12) Ligja mbi ekspropriijimin në Kryeqytet me 23-12-1925;

13) Dekret-ligja me datë 31 Maj 1930, e këthyeme në Ligjë me d. 30 Maj 1931, mbi bashkimin e ofiqit të Kryetarit të Bashkiës se Kryeqytetit me ato të Prefektit të Kryeqytetit;

14) Dekret-ligja mbi modifikimin e neneve 1 e 2 të Dekret-ligjës mbi suprimimin e titullit të Prefektit të Kryeqytetit me d. 10 Shtatuer 1933.

Neni 212.

Taksa e lulzimit e shitun prej Bashkiës së Tiranës me kontratë në bazë të ligjës së ma parshme vashdon të nxirret prej sipërmarrsve në bazë t'asaj ligje deri në mbarimin e afatit të kontratës së lidhun në mes të Bashkiës së Tiranës e të sipërmarrsit. Në mbarimin e këtij afati, veprohet në bazë të kësaj ligje.

Neni 213.

Kjo ligjë hyn në fuqi 15 dit pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 214.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës së Bashkive, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 251 datë 24-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 30 Prill 1934.

ZOG

Kryeministri
PANDELI EVANGJELI
Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA
Ministri i Financavet
A. DIBRA
Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI
Ministri P. Mbrendëshme e Zav.
Ministri Ekonomis Kombëtare
MUSA JUKA
Ministri i Arësimit
MIRASH IVANAJ

Nr. 54

LIGJE, 28 Prill 934

Mbi taksimin e miellit të grunit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Maj 1934, Nr. 27)

Art. 1.

Mielli i grunit, që fabrikohet në mullinj që funksionojnë me forcë motori, si dhe miellnat e grunit q'importohen nga jashtë i shtrohen nji takse konsumi si vijon:

Kualitet Luks	3	Fr. ari për kuintal
» 0	2	Fr. ari për kujntal
» I	1.50	Fr. ari për kujntal

II dhe ata që janëma poshtë se ky kalitet me nji fr. ari për kuintal.

Taksa e miellit t'importuem paguhet prej importuesit së bashku dhe njikohësisht me tagrin doganuer, dhe taksa e mjellit që produktohet në vendë, paguhet prej pronarit ose sipër-marrësit të mullinit kuer mielli del jashtë nga magazina e mullinit.

Kuer mielli nuk asht mall tregtije e fabrikatorit, por asht siellë grunë në mulli për t'u blue me qirà, fabrikatori detyrohet me e pa-

gue edhe taksen e këtij lloji dhe me i-a kerkue të zot miellit atë taksë. Pa u dorëzue kjo taksë, nuk mundë t'i dorëzohet mielli te zotit.

Art. 2.

Ministrija e Financavet, tue emnue nëpunësa të posaçëm ose me anen e atyne që ka në sherbim, rregullon mënyren e vertetimit dhe të nxjerrjes së taksës si dhe kontrollimin e fabrikave.

Nëpunësat e ngarkuem me ketë detyrë, mbajnë nji rregjister të posaçëm për këtë punë si mbas instruksioneve të Ministris së Financavet.

Art. 3.

Nëpunësat e Financës të permendun n'Art. 2 të kësaj ligje, para se të prelevojnë taksen e konsumit dhe të lëshojnë diftesën e miellit të vumë në thasë, dhe në peshë kuintali, $^3/_4$ (tre të katërta) ose $^1/_2$ (gjymsen) kuintali, në grykë do t'i ngjisi nji markë plumbi ku me nji anë do të shenohet data e nxjerrjes së taksës dhe e kontrollimit.

Art. 4.

Miellnat që dalin nga fabrikat që funksionojnë me motor, të çdo kapaciteti, detyrohen me pasë, perveç markës së fabrikës, edhe damkën e plumbit në gryken e thesit me sinjalet e datës së kontrollimit; për ndryshe mielli konsiderohet kontrabandë dhe pëson efektet e ligjës për sa i përket gjobitjes dhe të konfiskimit. Ata që falsifikojnë damkën e plumbit përveç dënimeve të nalt-permenduna ndjeken si mbas nenit 294 të Kodit Penal.

Art. 5.

Gjith fabrikatorët e mullijve me motor qysh prej hymjes në fuqi të kësa ligje detyrohen me deklarue në Financen e vendit sasin e grunit, të miellit e të krundeve që kanë në fabrikë ose në depo. Përveç kësaj janë të detyruem me mbajtë edhe nji inventar e nji rregjister.

Inventari ka me permbajtë gjendjen e mullinit dhe të magazinës anekse mbi sasitë e grunit të blemun prej fabrikatorit ose të sjellun prej të tretëve për m'u blue, sasin e miellit prej çdo kualiteti kjoftë, që ndodhet në magaze ose në depon e mullinit, ashtu edhe sasinë e krundeve që ndodhen në ditën e hymjes në fuqi të kësaj ligje.

Inventari në fund të pershkrimeve, ka me qenë i firmuem prej

Drejtorit të Fabrikës, dhe ka me pasë edhe datën e hymjes në fuqi të ligjës.

Rregjistri asht vjetuer dhe ka me qenë i numurtuem, i kontrolluem prej Zyres së Financës, tue vue vulen në të dy anët e çdo fletës dhe tue pas përshkrimin me shkresë së rregjistrit prej sa faqesh perbahet. Ky notim do të jetë i vulosun me vulen e Zyres së Financës të vendit dhe me nenshkrimin e nëpunësit.

Art. 6.

Në rregjistrin e permendun në nenin e ma sipërme dita ditës do të rregjistrohen gruni qi hynë, mielli qi bluhet ay që del jashtë fabrikës dhe magazinës, vendi i dergesës ose i shitjes, taksa e pagueme dhe data e numri i diftesës që tregon pagesën, si dhe emni i nëpunësit që ka prelevue taksen.

Rregjistri në fjalë nuk do të ketë as gervishtje, as shylmje, për ndryshe këta shenja konsiderohen shenja falsifikimi.

Në çdo rastë kontrollimi si diferencë ndermjet të gjendjes që rezulton kurdoherë nga rregjistrimi dhe asaj që rezulton në peshim, pranohet nji firo deri 2 (dy) për qindë.

Neni 7.

Tregtarët dhe kushdo tjetër që, diten e hymjes në fuqi të kësaj ligje me qellim shitjeje, kanë në dispozitë miell gruni ma tepër se 5 kuintal, detyrohen me ja deklarue Financës së vendit, jo ma vonë se tre ditë, dhe me pague me nji herë taksen perkatëse.

Ata që nuk respektojnë ketë dispozitë ose bajnë deklarata të rrema konsiderohen kondrabandista dhe do të ndeshkohen si mbas kësaj ligje, dhe të Ligjës mbi ndalimin e kondrabandavet.

Art. 8.

Fabrikatori që bluen, tregton nxjerrje nga magazina e transporton mjellë pa pague taksen e konsumnit ose mashtrojnë autoritetin tue mbajtë libra të rrema, konsiderohet kontrabandist dhe për heren e parë gjobitet më 500-5000 fr. ari dhe mielli pa taksë u konfiskohet. Në rastë persëritjeje gjoba dyfishohet dhe guximtari dënohet me 1 (nji) deri në 6 muej burg. Për heren e tretë përveç dyfish gjobës dhe burgut mund t'i mbyllet edhe mullini deri në 6 muej.

Art. 9.

Gjith'ata që ndihmojnë për mëshefjen e miellit, për shitjen dhe

bartje pa taksë konsumi, konsiderohen bashkë-veprues me fabrikatorin dhe dënohen si të tillë në konformitet me Kodin Penal.

Art. 10.

Nëpunësat që abuzojnë detyren e tyne, dhe lehtësojnë veprimin e kondrabandës pushohen me një herë dhe merren nen gjyqë si bashkë-veprues.

Art. 11.

Procedura për aplikimin e dispozitave penale të kësaj asht e caktueme në ligjen mbi ndalimin e kondrabandavet.

Art. 12.

Kjo ligjë hynë në fuqi 7 dit mbas shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Art. 13.

Ministri i Financavet dhe ay i Drejtësis ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi taksimin e miellit të grunit, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 184/I datë 5-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 28 Prillë 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis V. AVRAMI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 55.

LIGJE, 4 Maj 1934

Mbi bartjen e fondit prej fr. ari 2.900 nga kapitulli 32 në Kap. 28 të budgetit 1933-34 të Gjindarmeris

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Maj 1934, Nr. 27)

Art. 1.

Nga kapitulli 32 «Indemnitet e shpërblim për aksidentat» të

gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Gjindarmëris, paksohen fr. ari 2.900 e i ngarkohen Kap. 28 «Qira».

Art. 2.

Kjo ligjë hyn në fuqi që nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Trupi Ministruer dhe Komanda e Përgjithshme e Gjindarmëris.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi bartjen e nji fondi prej fr. ari 2.900, në budgetin 1933-34 të Gjindarmëris, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 233-I- datë 25-IV-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, më 4 Maj 1934. ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 56.

LIGJË, 30 Prill 1934

Mbi pranimin e Konventës Tregtare lidhun ndërmjet Mbretnis Shqiptare dhe të Republikës Çekosllavake

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Maj 1934, Nr. 27)

Art. 1.

Pranohet Konventa Tregëtare e lidhun ndërmjet Mbretnisë Shqiptare edhe Republikës Çekosllovake me datë 9 Prill 1934 nënshkruar në Praha, prej Zotit Dhimitër Berati, Ministër Fuqiplotë Sekretar' i Përgjithshëm i Ministrisë së P. të Jashtme, për Shqipërinë dhe Zotit Dr. Kamil Krofta, i Dërguar i Jashtzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë i Çekosllovakisë, mbi eksportimin dhe impor-

timin e mallravet në të dy Shtetet, si mbas tekstit këtu bashkëngjitur.

Art. 2.

Kjo ligjë hynë në fuqi qysh prej shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Ministrija e P. të Jashtme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi pranimin e Konventës Tregëtare lidhun ndërmjet Mbretënisë Shqiptare dhe Republikës Çekosllovake, me datë 9 Prill 1934 në Praha, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 247/1 datë 24-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 30 Prill 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Konventë tregtije ndërmjet Mbretnisë Shqiptare dhe Republikës Çekosllovake

Lart Madhëri e Tij Mbreti i Shqiptarëvet dhe Kryetari i Republikës Çekosllovake, njësisht të frymëzuar nga dëshira të forcojnë marrëdhanjet miqësore që lidhin të dy Shtetet ndërmjet tyre edhe të vendosin marrëdhënjet tregëtare mbi baza, gjithashtu të kënaqëshme, vendosën të lidhin një Konventë tregtare edhe, për t'i mbritun këtij qëllimi, emëruan fuqiplotë të tyre:

Lartë Madhëria e Tij Mbreti i Shqipëtarëvet
Zoti Dhimitër Beratti
Ministër Fuqiplotë, Sekretar i Përgj. i Ministrisë Mbretnore të P. Jashtme,

Kryetari i Republikës Çekosllovake:
Zotin Dr. Kamil Krofta
I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë,

të cilët, mbasi i paraqitën njeri-tjetrit letrat e tyre fuqiplote,

BKSH

të cilat u-gjetën në formën dhe në përmbajtjen e duhur, përfunduan marrëveshtjen e tyre në dispozitat që vijojnë:

Neni 1.

Prodhimet e tokës dhe t'industrisë origjinare të njerit nga të dy Shtetet t'importuara në tokën e tjetrit do të gëzojnë trajtimin e kombit më të favorizuar nga çdo pikpamje edhe veçanërisht përsa u përket të drejtavet, vleftësimevet (coefficient) taksave ose detyrimeve të tjera çdo lloj qofshin.

Neni 2.

Prodhimet e tokës dhe t'industrisë origjinare të njenit nga të dy Shtetet e caktuara për t'u-eksportuar në tjetrin, nuk do të barrohen (grevér) me taksa, me vleftësime ose të drejta të tjera prej çdo lloj qofshin, as më të larta, as tjetër soj se ato që merren mbi eksportimet po t'atyne mallravet në Shtetin më të favorizuar nga kjo pikpamje.

Neni 3.

Në qoftë se një prej të dy Qeverivet do t'a shohë të nevojshme mbajtjen ose venjen e ndonjë ndalimit ose kufizimit mbi importimin ose eksportimin të nonjë malli, duhet të merret vesht mbi këte pikë me tjetrin në qoftë se një marrëveshje paraprake nuk është bërë midis tyre.

Neni 4.

Shtetasit, personat fizike dhe juridike të çdo njerit prej të dy Shtetevet, do të gëzojnë, në tokën e njeri-tjetrit, trajtimin e kombit më të favorizuar nga çdo pikpamje dhe veçanërisht për sa i përket situatës së tyre juridike, t'udhëtimevet, ndenjës, të vendosjes dhe t'ushtrimit të tregëtiës, t'industris edhe të çdo tjetrë mjeshtërisë, dhe të çdo të drejtës dhe interesit që rjedh prej këtyre, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me Ligjet e Rregulloret dhe urdhnimet e vendimet.

Neni 5.

Trajtimi i kombit ma 'të favorizuar, i parapaem në nenet e sipërme, nuk përfshinë:

1) privilegjet që janë akorduar ose mund t'akordohen prej njerës nga të dy palët Kontraktuese, për të lehtësuar trafikun në kufi me Shtetet fqinj.

2) Të drejtat dhe privilegjet që rjedhin nga një bashkim doganor.

3) Të drejtat dhe privilegjt që mund t'akordohen, në kohën e ardhme prej njerës nga të dy Palët Kontraktuese një Shteti të tretë, me anë Konventash të shumë anëshme (pluriletérales) në të cilat nuk do të merrte pjesë Pala tjetër, edhe në qoftë se këto të drejta dhe privilegje janë të stipoluara ndër konventa të shumë anëshme të lidhura nën hijen e Lidhjes së Kombeve, ose të regjistruara n'atë dhe të çelura për pjesë marrje e të gjithë Shteteve. Me gjith këtë, përfitimi nga të drejtat ose nga privilegjet e parashikuara mund të kërkohen prej Pales Kontraktuese t'interesuar, në qoftë se këto të drejta ose privilegje janë të stipuluara gjithashtu nër konventa të tjera që nuk janë kolektive e që i u përgjegjen konditavet të mësipërme ose veçanërisht në qoftë se Pala që kërkon përfitimin e lart-përmendur është gati t'akordojë trajtimin në bazë të reciprocitetit.

Neni 6.

Shënohen veçanërisht se konditat që do të regullojnë shkëmbimin e mallrave ndërmjet të dy Shteteve, sikundër është parapamë në nenet 1 dhe 2 të kësaj Konvente, do të caktohen në marrëveshtje të përbashkët midis të dy Qeverivet, prej një shtese ujdije të kësaj Konvente.

Neni 7.

1) Këjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentat e ratifikimit do të çkëmbehen sa më parë që të jetë e mundur.

2) Do të hyjë në fuqi 15 ditë pas çkëmbimit të ratifikimit.

3) Por, të dy Qeveritë mund të merren vesht edhe për t'a vënë në veprim me përpara, në qoftë se ligjët e tyre përkatëse i lejojnë.

4) Këjo Konventë ka një vleftë vashdimi prej dy vjetve, duke filluar nga dita e hyrjes së sajë në fuqi.

5). në qoftë se njera nga Palet Kontraktuese nuk e denoncon këtë Konventë tre muaj përpara mbarimit të saj, atëhere këjo Konvente do të vashdojë të jetë në fuqi, me heshtje, sa që njera nga Palët kontraktuese nuk do t'a ketë denoncuar. Efekti i denoncimit do të hyjë në veprim tre muaj mbas datës së denoncimit.

Me besim të sa më lart, Fuqiplotët e të dy Palëvet nënshkruan këtë Konventë dhe e vulosën me myhyret e tyre.

Shkruar në dy eksempare, në Praha, me 9 Prill njëmijëenëntëqindëtridhjetekatër.

D. Beratti *Dr. Kamil Krofta*

Protokoll përfundus

I Konventës Tregëtare ndërmjet Mbretniës Shqipëtare dhe Republikës Çekosllovake

Në çastin e nënshkrimit të Konventës Tregëtare lidhur nërmjet Mbretniës Shqiptare dhe Republikës Çekosllovake, me datë të sotme, të nënshkruarit Fuqiplotë shtuan deklaratat që vijojnë, të cilët përbajnë pjesë të pa ndarë të kësaj Konvente.

1) Në rast se një nga të dy Palët Kontraktuese do të ketë mendimin të këmbejë ose do të kembejë taksat që barrojnë (greveri) importimin ose eksportimin e produkteve.. Pala tjetër Kontraktuese do të ketë të drejtën të kërkojë rifillimin e bisedimevet mbi këtë pikë, brënda një afati prej gjashtëmbëdhjetë ditë;

2) Në rast se këto bisedime nuk do të përfundojnë në një marrëveshje midis të dy Palevet brënda pesëdmbëdhjetë ditëve që vijojnë edhe njëra prej Palevet Kontraktuese ka vënë me gjith këtë në zbatim tagrat e reja, Pala tjetër do të ketë të drejtë të denoncojë këtë Konventë në përfundim të një afati prej tridhjetë ditë, të cilat do të llogariten qysh nga mbarimi i afatit të dytë prej 15 ditësh.

Praha, 8 Prill 1934.

D. Beratti *Dr. Kamil Krofta*

Convention de Commerce entre Le Royaume d'Albanie et la République Tchécoslovaque.

Sa Majesté le Roi des Albanais et le Président de la République Tchécoslovaque, également animés du désir de resserrer les liens d'amitié qui unissent les deux pays et de placer dans des conditions également satisfaisantes les relation commerciale entre les deux pays, ont décidé de conclure une Convention de commerce et ont, à effet, nommé pour leurs plénipotentaires respectifs:

Sa Majesté le Roi des Albanais:
Monsieur Démètre Beratti,
Ministre Plénipotentiaire, Secrétaire Général du Ministère Royal des Affaires Etrangéres.

Le Président de la République Tchécoslovaque:
Monsieur le Docteur Kamil Krofta,

BKSH

Envoyé Extraordinaire et Ministre Plénipotentiaire;

lesquels, aprés s'être communiqué leurs pleins-pouvoirs, trouvés en bonne et due forme, sont convenus des dispositions suivantes :

Article 1.

Les produits du sol et de l'industrie originaires de l'un des Etats, importés sur le territoire de l'autre jouiront du traitement de la nation la plus favorisée sous tous les rapports et notamment en ce qui concerne les droits, coefficients, taxes ou autres redevances quelconques.

Article 2.

Les produits du sol et l'industrie originaires de l'un des Etats, destinés à être exportés dans l'autre, ne seront pas grevés des droits, coefficients, taxes ou autres redevances quelconques, autres ni plus élevés que ceux perçus à l'exportation des mêmes objets dans le pays le plus favorisé à cet égard.

Article 3.

Si l'un des deux Gouvernements considérait comme nécessaire de maintenir ou d'introduire pour certaines marchandises des prohibitions ou restrictions d'importation ou d'exportation, il s'entendra à ce sujet avec l'autre, à moins qu' un accord préalable ne soit déjà intervenu.

Article 4.

Les ressortissants, les personnes physiques et juridiques de chacun des deux Etats jouiront, sur le territoire de l'autre, du traitement de la nation la plus favorisée sous tous les rapports et notamment en ce qui concerne leur situation juridique, le voyage, le séjour, l'établissement et l'exercice du commerce, de l'industrie ou de toute autre profession et tous droits et intérêts en découlant, sans préjudice aux lois, réglements et ordonnances du pays.

Article 5.

Le traitement de la nation la plus favorisée, prévu aux articles précédents, ne comprendra pas :

1. Les privilèges qui sont ou pourraient être accordés par l'une des Partires Contractantes, pour fuciliter le trafic de frontière avec les pays limitrophes.

2. Les droits et privilèges résultant d'une union douanière.

3. Les droits et privilèges qui seraient accordés, à l'avenir,

par l'une des Parties Contractantes à des Etats tiers, dans des conventions plurilatérales auxquelles l'autre Partie ne participerait pas, et si ces droits et privilèges sont stipulés dans des conventions plurilatérales conclues sous les auspices de la Société des Nations ou enregistrées par elle et ouvertes à l'adhésion de tous les Etats. Toutefois, le bénéfice des droits et. privilèges envisagès, pourra être revendiqué par la Partie Contractante intéressée, si lesdits droits ou privilèges sont stipulés également dans des conventions autres que les conventions collectives répondant aux conditions ci dessus ou encore si la Partie qui en réclame la jouissance est disposée à accorder la reciprocité de traitement.

Article 6.

Il est entendu que les conditions réglant l'échange des marchandises entre les deux Pays, tel qu' il est prévu par les articles 1 et 2 de la présente Convention, seront arrêtés, d'un commun accord entre les deux Gouvernements, par un arrangement additionnel à cette Convention.

Article 7.

1. La présente Convention sera ratifiée et les instruments de ratification en seront échangés aussitôt que faire se pourra.

2. Il entrera en vigueur quinze jours aprés l'échange des ratifications.

3. Toutefois, les deux Gouvernements pourront s'entendre pour sa mise en vigueur anticipée si leurs législations respectives les y autorisent.

4. La présente Convention aura une durée de deux années à partir du jour de son entrée en vigueur.

5. Si la dénonciation par l'une des Parties Contractantes n'a pas eu lieu trois mois avant l'expiration dudit délai, la présente Convention sera prorogée par tacite reconduction et restera en vigueur tant qu'il n'aura pas été dénancée, la dénonciation devant produire ses effets trois mois aprés la date de sa notification.

En foi de quoi, les Plénipotentaires respectifs ont signé la présente Convention et y ont apposé leurs cachets.

Fait en double exemplaire à Praha le neuf avril mil neufcent trentequatre.

D. Beratti *Dr. Kamil Krofta*

Protocole Final

à la Convention de Commerce entre le Royaume d'Albanie et la République Tchécoslovaque

Au moment de la signature de la Convention de Commerce entre le Royaume d'Albanie, et la République Tchécoslovaque, conclue à la date de ce jour, les Plénipotentaires soussignés ont fait les déclarations suivantes qui formeront partie intégrante de la Convention même :

1. Dans le cas où l'une des Parties Contractantes aurait l'intention de changer ou changerait les charges grevant l'importation ou l'exportation des produits, l'autre Partie Contractante aura le droit de demander l'ouverture des négociations à ce sujet dans un délai de quinze jours.

2. En cas aù ces négociations ne seraient pas terminées par un accord des deux Parties dans les quinze jours suivants et l'une des Parties Contractantes aurait néanmoins appliqué les nouvelles charges, l'autre Partie aura le droit de dénoncer la présente Convention avec un délai de trente jours à compter depuis l'expiration du second délai de quinze jours.

Praha, le 9 Avrril 1934.

D. Beratti *Dr. Kamil Krofta*

Nr. 57.

LIGJË, 4 Maj 1934

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 2500 prej budgetit 1933-934 të Ministris së P. Botore (Degë Post Telegrafe) n'ate të Ministris së P. të Mbrendëshme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Maj 1934, Nr. 27).

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së Punëve Botore Degë (Post-Telegrafe) paksohet nji fond prej fr. ari 2.500 (dymijepesëqind) nga Kap. 10 «Rrogë personeli zavendësije etj.

Art. 2.

Fondi prej fr. ari 2.500 (dymijepesëqind) paksue si mbas art. 1 të kësaj ligje, i shtohet Kap. II «Rrogë personeli, shperblim,

shpenzime gjithfarësh etj.» të gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1933-934 të Ministris së P. të Mbrendëshme .

Art. 3.

Kjo ligjë hyn në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministri i P. të Mbrendëshme, Ministri i P. Botore.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 2.500 në budgetin 1933-1934 të Ministris së P. Botore Degë (Post-Telegrafe) n'ate të Ministris së P. të Mbrendëshme, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 230/I datë 24-IV-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë me 4 Maj 1934. ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 58.

LIGJE, 30 Prill 934

Mbi disa ndryshime të Traktatit tregtar Shqiptaro-Grek, të lidhun me 13 Tetuer 1926

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Maj 1934, Nr. 27).

Neni 1.

Qeverija Mbretnore autorizohet me vue në zbatim marrëveshtjen e bamun midis saj dhe, Qeverisë së Republikës Greke, si mbas notave të shkëmbyeme nën Nr. 924 datë 6 Fruer 1934 dhe Nr. 236 datë 24 Mars 1934 për disa ndryshime në Traktatin tregtar Shqiptaro-Grek me datë 13 Tetuer 1926, e në menyrën që përshkruhet në notat e nalt-përmenduna.

Neni 2.

Kjo ligjë hyn në fuqi qysh prej datës së shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare dhe, zbatohet dhetë ditë mbas datës në të cilën të dy Qeverinat kanë me i komunikue njana tjetrës ratifikimin e marrëveshtjes nga ana e Dhomavet Legjislative respektive të dy Shtetevet.

Neni 3

Ministrija e Financavet dhe ajo e P. të Jashtme ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptrvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi disa ndryshime të Traktatit tregtarë Shqiptaro-Grek të lidhun me 13 Tetuer 1926, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 2325/I d. 21-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 30 Prill 1934 — Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

MINISTRIJA E P. TË JASHTME
DREJTORIJA KONSULLORE
Nr. 924-40 F. VII.

Në gjegje të notës Nr. 236 që Ekselenca e Juaj patët mirësinë me më drejtue me datë 24 Mars 1934 teksti i se cilës asht cituar këtu poshtë, kam nderin të sjellë në dijeniën Tuej se Qeveria Mbretnore Shqiptare asht plotsisht d'akord me përmbajtjen e sajë.

Nr. 236 — Tiranë, me 14 Mars 1934

Zotni Ministër,

Tue i-u referue notës Nr. 924 që Ekselenca e Juaj patët mirësinë të më drejtoni me datë 6 Fruer 1934, kam nderin të sjellë në dijenin Tuaj se Qeveria jeme, tue dishrue me lehtësue shkëmbimet tregtare në mes të dy shteteve, pranon marrëveshtjen që përmban nota e juej e naltëshënueme d. m. th.:

1) Për sa i përket peshkut me prejardhje Shqipëtare, Qeve-

BKSH

rija Helenike pranon modifikimin që vijon të tarifës në dergim t'aneksit B të traktatit të tregtis Greko-Shqiptar të 13tit Tetuer 1926.

Nr. i tarifës greke 4-a
Emertim i mallit . . . . . peshku i freskët
Sasia . . . . 100 kg.
Tagri në fr. ari 1.80

Kuptohet se taksat komunale, mbi taksa ose tjera që mund t'i ngarkohen peshkut të freskët me prejardhje Shqiptare, janë përshië në tagrin e nalt shënuem prej fr. ari 1.80 për nji qind kilogram ;

2) Për sa i përket përjashtimit nga tarifa prej të cilit gëzojnë kononet e mëndafshit me prejardhje Shqiptare si mbas traktatit të tregtis Greko-Shqiptare të 13tit Tetuer 1926 (lista B. Nr. 5 i tarifës greke). Qeveria Shqiptare pranon të heqi dorë.

3) Kjo Marrëveshtje hynë në fuqi dhjetë ditë mbas datës në të cilën të dy Qeverinat do t'i komunikojnë njena-tjetrës aprovimin e përmbajtjes nga ana e Parlamenteve respektive të dy Shteteve.

Ju lutem, Zotni Ministër, të keni mirësinë me më njoftue pelqimin Tuaj të plotë mbi përmbajtjen e kësaj note dhe, të pranoni sigurimet e konsideratës s'eme mâ të naltë.

C. Diamantopulos

Pranoni, Zotni Ministër, sigurimet e konsideratës s'eme mâ të naltë.

Ministri i P. të Jashtme
Djafer Villa

LEGATA E GREQIËS NË SHQIPNIË
Tiranë me 24 Mars 1934
Nr. 236

Zotni Minister,

Tue i-u referue notën Nr. 924 që Ekselenca e Juej patët mirësinë të më drejtoni me datë 6 Fruer 1934, kam nderin të sjellë në dijenin Tuej se Qeveria jeme, tue dishrue me lehtësue shkëmbimet tregtare në mes të dy shteteve, pranon marrëveshtjen që përmban nota e Juej e nalt shënueme, d. m. th.

1) Për sa i përket peshkut me prejardhje Shqiptare Qeveria Helenike pranon modifikimin që vijon të tarifës në dergim t'a-

neksit B të traktatit të Tregtis Greko-Shqiptare të 13tit Tetuer 1926.

Nr. i tarifës greke	4-a
Emertim i mallit	peshku i freskët
Sasia	100 kg.
Tagri në fr. ari	1.80

Kuptohet se taksat komunale, mbi taksa ose tjera që mund t'i ngarkohen peshkut të freskët me prejardhje Shqiptare si mbas traktatit të Tregtis Greko-Shqiptare të 13tit Tetuer 1926 (lista B. Nr. 5 i tarifës greke) Qeveria Shqiptare pranon të heqi dorë.

3) Kjo marrëveshtje hynë në fuqi dhjetë ditë mbas datës në të cilën të dy Qeverinat do t'i komunikojnë njena-tjetrës aprovimin e përmbajtjes nga ana e Parlamenteve respektive të dy Shteteve.

Ju lutem Zoti Ministër, të keni mirësinë me më njoftue pëlqimin Tuej të plotë, mbi përmbajtjen e kësaj note dhe, të pranoni sigurimet e konsideratës s'eme mâ të naltë.

C. Diamantopulos

Ekselencës së Tij
Z. Djafer Villa, Ministër i P. të Jashtme
Ect. ect. Tiranë.

Nr. 59

LIGJE, 4 MAJ 1934.

Mbi bartje fondesh në budgetin e ushtrimit financjarë 1933 - 1934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Maj 1934, Nr. 27).

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimeve të ushtrimit financjarë 1933-1934 paksohen fondet për Dikaster e Kapitull si vijon:

Ministrija e P. të Mbrendëshme			
Kap. 5 Qira Zyreje	Fr.	ari	280
Min. P. Botore dhe Drejt. P. Post-Telegrafave			
Kap. 10 Rrogë personeli (Post-Telegrafë)	»	»	2.450
Komanda e Mbrojtjes Kombtare dhe e Gjindarmeriës			
Kap. 32 Indemnitet e shpërblim për aksidenta etj.	»	»	1.170
Kap. 34 Shëndetësi e mjektim gjindarmësh	»	»	330
	Fr.	ari	4.230

Art. 2.

Fondet prej fr. ari 4.230 (katërmij e dyqindetridhjet) pakësue si mbas Art. 1 të kësaj ligje, i shtohen gjendjes së parapamjeve të shpenzimevet të ushtrimit 1933-1934 të Ministris së P. të Mbrendshme:

nen Kap. 1 «Rrogë personeli, zavendësije	Fr. ari	2.000
nen Kap. 2 «Shpenzime udhëtimi e djete»	» »	2.230
	Fr. ari	4.230

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Trupi Ministruer.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 4.230 në budgetin e ushtrimit 1933-1934, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 234/I datë 25-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 4 Maj 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 60.

LIGJË, 4 Maj 1934.

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 1.700 në budgetin e ushtrimit 1933 - 1934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Maj 1934, Nr. 27)

Art. 1.

Në gjendjen e parpamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-1934 paksohen fondet si vijon:

Ministrija e Financavet:

Kap. 56 kthim tatimesh, tagrash e taksash të marruna tepër prej eksportimit të duhanit Fr. ari 1.000

Ministrija e Drejtësis:

Kap. 1 «Rrogë personeli mbas kuadrit etj.» » » 700

Fr. ari 1.700

Art. 2.

Fondi prej fr. ari 1.700 (njimijeshtatqind) paksue si mbas Art. 1 të kësaj Ligje, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1933-34 të Ministris s'Ekonomis Kombëtare në Kap. 13 «Shpenzime gjithfarësh për Panairin e Barit e të Selanikut».

Art. 3.

Kjo Ligjë hyn në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministri i Financavet, Ministri i Drejtësis e Ministri i Ekonomis Kombëtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 1.700 në budgetin e ushtrimit 1933-34, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 231/I datë 25-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 4 Maj 1934. Z O G

Kryeministri *Ministri i Drejtësis*

P. EVANGJELI V. AVRAMI

Ministri i Financavet

A. DIBRA

Nr. 61.

LIGJË, 4 Maj 1934.

Mbi përjashtimin e Bashkiës së Kryeqytetit nga pagesa e disa taksave kontraktore mbi dy akt-obligime

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Maj 1934, Nr. 27)

Neni 1.

Bashkija e Kryeqytetit për huan prej fr. ari 405.000 që i

ashtë akordue prej Qeveris si mbas Ligjës autorizueme me datë 13 Fruer 1934, si dhe për grumbullimin e unifikimin në nji të vetmin akt-obligimi, (si mbas vendimit Nr. 110 datë 5 Mars 1934 të Kshillit Ministruer) të gjithë huanavet të ndryshme që i janë akordue kohë pas kohe nga Arka e Pensjoneve Civile, përjashtohet nga pagesa e taksavet kontraktore, nga e drejta e arkivit, nga pullat e ndryshme, nga taksat ipotekore dhe nga mbi-taksi 2% i Arësimit.

Neni 2.

Përjashtimi ka fuqi vetëm për sa i-u takon të dy akt-obligimevet të përmenduna në nenin e sipërm.

Neni 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi qysh nga dita e shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Ministrija e Financavet dhe ajo e Drejtësis ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve
D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi përjashtimin e Bashkis së Kryeqytetit nga pagesa e disa taksave kontraktore mbi dy akt-obligime, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 239/I datë 27-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 4 Maj 1934. Z O G

Kryeministri — *Ministri i Drejtësis*
P. EVANGJELI — V. AVRAMI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 62.

LIGJË, 23 Prill 1934.

Mbi ndryshimin e paragrafit I të nenit 4, dhe të nenit 21 të ligjës mbi themelimin e Odave të Tregtis me datë 30 Prill 1932

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Maj 1934, Nr. 27)

Neni 1.

Fraz' e parë e Nenit 4 të Ligjës mbi themelimin e Odave të Tregtis modifikohet si vijon;

«Misat e Këshillit t'Odës së Tregtis, zgjidhen me vota direkte dhe me shumicë relative të votuesve në qendrat e Prefekturave deri me krijimin e Dhomave të parapame në Nenin 1 të Ligjës mbi Themelimin e Odave të Tregtis».

Neni 2.

Neni 21 ndryshohet si vijon:

«Sekretari merr nji rrogë mujore prej fr. ari 200.

Neni 3.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje

Neni 4.

Kjo Ligjë hyn në fuqi me shpalljen në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve
D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi ndryshimin e paragrafit parë të Nenit 4 dhe të nenit 21 të Ligjës mbi themelimin e Odave të Tregtis me datë 30 Prillë 1932, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 165/I dt. 20-III-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 23 Prill 1934. Z O G

Zav. Kryeministri :
Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Min. i P. Mbrendëshme e Zav.
Ministri i Ekon. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 63.

LIGJË, 23 Prill 1934.

Mbi shpërndamjen e veglave e maqinave bujqësore me çmime të njinjishme me ato të tregut

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Maj 1934, Nr. 27)

Art. 1.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare autorizohet me ba zbritjen e çmimit të veglave e maqinave bujqësore që ndodhen ndër Depot e ndryshme të sajë baras me çmimet e tregut,

Për ato vegla e maqina që nuk ndodhen në treg, çmimi i tyne, do të caktohet, tue marrë për bazë çmimin e shitjes së tyne ndër fabrikat e jashtme tue i shtue shpenzimet e transportit deri në Skelet e Shqipnis.

Art. 2.

Caktimi i çmimeve si ma nalt bahet me vendimin e Këshillit Ministruer.

Art. 3.

Pagesa dhe mënyra e vjeljes së vleftës së veglave bahet si mbas dispozitave të Ligjës mbi detyrimin e punimit me vegla moderne bujqësore të Dekretueme me datë 18-IV-1929.

Art. 4.

Kjo Ligjë hyn në fuqi që nga data e shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare dhe, ka fuqi deri në shitjen e plotë të veglave të depozitueme.

Art. 5.

Për zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Trupi Ministruer.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi shpërndamjen e veglave e maqinave bujqësore me çmime të njinjishme me ato të tregut, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 187/I datë 16-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 23 Prill 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Min. i P. të Mbrendëshme e Zav.
Ministri i Ekon. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 64.

LIGJË, 23 Prill 934.

Mbi tregtimin e miellnave dhe mbi caktimin e çmimeve të tyne dhe të çmimit të bukës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Maj 1934, Nr. 28)

Art. 1.

Tregtia e miellnave asht e lirë mbrenda dispozitave të kësaj Ligje.

Art. 2.

Për caktimin e çmimeve dhe të kualiteteve të ndryshme të miellnave formohet në qendrat e ç'do Prefekture dhe N/Prefekture nën Kryesin e Prefektit ose të Nënprefektit, nji komision me dy antarë prej Këshillit t'Administratës, dy antarve prej Këshillit të Bashkis nga ata që të jenë tregtarë, dhe me dy antarë në vend ku ka, prej Këshillit t'Odës së Tregtis. Në vende ku s'ka Oda Tregtije, merren dy tregtar të zgjedhun prej Këshillit t'Administratës. Ky Komision para se të caktojë çmimet e miellnave ndigjon mendimin këshillues të fabrikantave të miellit.

Art. 3.

Çmimet e miellnave caktohen si mbas kualitetit të tyne në bazë të çmimeve të drithnave në treg të lirë duke u lënë mullijve nji shperblim t'arsyshëm për bluerjen e tyne.

Art. 4.

Fabrikat e miellnave detyrohen të bluajnë në ç'do rast, pas 24 orëve drithna që çon Qeverija ose Bashkitë, kundrejt një shpërblimi për bluarjen i cili, do të caktohet prej komisionit të formuem si mbas Art. 2 të kësaj ligje, për ç'do kuintal. Komisioni në fjalë do të caktojë edhe shpërblimin në të holla ose në natyrë për bluarjen e drithnave në mullinjtë që zakonisht kanë bluarë për banorët e qyteteve; këta mullinj nuk mundet të refuzojnë blurjen e drithnave të banorëve të qyteteve; mbi kundravajtësit aplikohen dispozitat e Art. 11 e 12 të kësaj Ligje.

Art. 5.

Fabrikat e miellnave nuk mund të bluajnë qoftë për llogari te tyne qoftë për llogari të të tretëve ma shumë se tre lloje miellnash për bukë tregtije. Këto miellna do të përmbajnë të gjitha karakteristikat e caktueme ma poshtë:

Emërtimi		*Humiditet maksimum*	*Përmbajtje Hi Maksimum*	*Gluten minimun*
Kalitet	0	14%	0.40%	7%
»	I.	14%	0.70%	9%
»	II.	14%	0.95%	10%

Mielli luks nuk do të mundet të fabrikohet përveç se në proporcjon maksimum 10% nga çdo kuintal grunë do të jenë i një cilësije superiore dhe, do të përmbajë karakteristikat e caktueme për miellin Nr. 0.

Mielli i kalitetit të parë, nuk mund të fabrikohet përveç se në proporcjon maksimum 75% nga çdo kuintal grunë, do të përmbajë të gjitha elementat e grunit tanësi dhe karakteristikat e miellit Nr. 1.

Mielli ordiner edhe ky nuk mund të fabrikohet përveç se në proporcjon maksimum 80% nga çdo kuintal grunë po mbasi të jetë nxjerrun 10% mielli luks në mënyrë që nga nji kuintal grunë do të nxiret 10 kg. miell luks dhe, 70 kg. miell ordinar. Mielli ordinar do të përmbajë karakteristikat e miellit Nr. 2.

Bluerja dhe tregtija e miellnave luks të nji kualiteti ma superior nga mielli i kualitetit «0», i caktuem në këte Ligjë, lihen të lira.

Art. 6.

Miellnat porsa që dalin prej mullimit dhe deri në momentin e përdorimit të tyne duhet të mbahen në thasë të vulosun me plumb dhe të kenë nji karton që të përmbajë emërin e firmës bluese dhe tipin e miellit.

Art. 7

Tregtarët dhe fabrikatorët e miellnave kuer kanë depozitë miellnash dhe kuer pregatitja e miellnave prej Qeveris e Bashkive asht e pa mundëshme, detyrohen t'u shesin furxhive miellnat që kanë në depozitë me çmimet e caktueme prej Komisionit.

Kundravajtësit dënohen në bazë të nenit 323 të Kodit Penal.

Art. 8.

Çmimet e bukës do të caktohen prej Bashkive të vendit duke marrë për bazë çmimin e miellnave.

Art. 9.

Kontrollimi i çmimeve dhe i kualiteteve të miellnave dhe të bukës do të bahet nga ana e Bashkive.

Art. 10.

Grumbullimi i drithnave dhe i miellnave dhe mos shitja e tyne nga ana e fabrikatorëve dhe të tregtarëve të këtyne sendeve me çmimet e caktueme me qëllim që të shkaktojnë naltësimin e çmimeve të tyne, quhen spekulim dhe dënohen si mbas dispozitave në nenit 323 të Kodit Penal.

Përjashtohen nga kjo dispozitë bujqët dhe personat që kanë drithna nga pronat e veta.

Art. 11.

Fabrikat e miellit nuk mundet të pushojnë nga funksionimi i tyne dhe nga blurja e kualitetit si mbas kapacitetit të tyne pa lajmërue tre muej ma parë Ministrinë e Ekonomis Kombëtare. Kundravajtësit dënohen me nji gjobë prej 1000 deri në 5000 fr. ari.

Art 12.

Fabrikantët e mjellit që nuk konformohen me dispozitat e Art. 4 të kësaj ligje ose që pushojnë funksionimin e fabrikës së tyne, fabrikat u merren me qira prej administratës publike ose u mbyllën prej nji kohe gjashtë mujshe deri në dy vjet.

Caktimi i qirave në rasë mos marrëveshtjeje bahet prej Gjyqtarit ma të naltë të vendit.

Art. 13.

Personeli teknik i fabrikave nuk mundet të lanë shërbimin e tyne pa lajmëruar dy muej ma parë administratën e fabrikës, në rast mos bindjeje mbi proponimin e Ministris s'Ekonomis Kombëtare, Komanda e Mbrojtjes provokon thirrjen nën armë të personelit teknik që nuk konformohet dispozitave të kësaj ligje.

Art. 14.

Furxhit nuk mundet të mbylin furrat e tyne pa lajmërue Bashkin e vendit të paktën nji muej ma parë dhe, detyrohen që mbrenda çdo ditë të pjekin dhe të shesin bukën e zakonshme.

Kundërvajtësit dënohen me gjobë prej 100 deri në 500 fr.ari.

Art. 15.

Tregtarët, furxhijtë dhe çdo tjetër person që shet miell buke tregtie dhe bukë, me çmimet ma të nalta ose të nji kualitetit ma të dobët nga ajo që cakton kjo ligjë n'Art. 5, ndëshkohen me ndëshkimet e parashikueme në nenin 323 të Kodit Penal.

Art. 16.

Kur spekulimet kryhen prej shoqninavet përgjegjësija pena-

le i takon administratorit dhe për nxjerrjen e gjobës asht përgjegjës dhe shoqnija.

Art. 17.

Komisioni në caktimin e çmimeve të miellnave të bukës do të bazohet në dispozitat e Art. 3 të kësaj Ligje. Në vende ku nuk ka fabrika mielli, çmimi i miellit do të caktohet duke marrë për bazë çmimin e miellit të fabrikës ma të afërme tue u llogaritë dhe shpenzimet e transportit.

Art. 18.

Shpërblimi i fabrikavet për bluarjen e grunave do të caktohet prej Komisjonit të formuem si mbas dispozitave t'Art. 2 të kësaj Ligje për çdo kuintal grunë duke marrë për bazë veprimet e deritanishme të fabrikave në bluarjen e grunave për të tretët, dhe duke modifikuar këte pas kohës në bazë të provave.

Art. 19.

Kjo Ligjë ka fuqi vetëm për sa u përket miellnave që pregatiten për gatuarjen e bukës për qëllim tregtije mbrenda kufijve të Mbretnis.

Miellnat e destinueme për eksportim lihen të lira si lihet e lirë dhe bluerja e miellnave për konsum shtëpijak.

Mbi ambalazhet e miellnave të destinueme për eksportim duhet të shkruhet në mënyrë të këndueshme fraza «Për eksportim» dhe këta amballazhe duhet të jenë të vulosuna me plumb mbi të cilin të shënohet emni i firmës.

Shitja e këtyne miellnave mbrenda shtetit, po të jetë se nuk u konformohen kualiteteve të caktuem prej kësaj Ligje, ndalohet dhe kundravajtësit dënohen me nga nji deri në tre muej burgim dhe me një gjobë nga 500 deri 2000 fr. ari.

Art. 20.

Komisioni i formuem në bazë të dispozitave të kësaj Ligje ka të drejtë t'urdhënojë inspektime për kontrollimin e kualiteteve të miellnave në për fabrikat e ndryshme të qarkut të tij kurdoherë që t'a gjejë të nevojshme.

Art. 21.

Kundra vendimeve të Komisionit të formuem si mbas dispozitave t'Art. 2 të kësaj Ligje, t'interesuemit si edhe Ministrija e Ekonomis Kombëtare brenda nji jave prej Komunikimit të vendimit kanë të drejtë rekurimi para Këshillit Ministruer, i cili vendos definitivisht mbrenda nji jave.

BKSH

Rekurimi nuk ndalon zbatimin e vendimit të Komisionit.

Art. 22.

Fajet e parashikueme prej kësaj Ligje, gjykohen mbrenda 15 ditëve prej referimit t'akteve në gjyqë.

Art. 23.

Çdo dispozitë në kundërshtim me këtë Ligjë, mbetet pa fuqi.

Art. 24.

Për zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Këshilli Ministruer.

Art. 25.

Kjo Ligjë hyn në fuqi dy javë mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi tregëtimin e miellnave dhe mbi caktimin e çmimeve të bukës, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr.156/1 datë 16-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 23 Prill 1934. Z O G

Kryeministri	*Ministri i Drejtësis*
P. EVANGJELI	V. AVRAMI
Ministri i P. të Jashtme	*Min. i P. të Mbrendëshme e Zav.*
XHAFER VILA	*Ministri i Ekon. Kombëtare*
Ministri i Financavet	MUSA JUKA
A. DIBRA	*Ministri i Arësimit*
Ministri i P. Botore	M. IVANAJ
S. SARAÇI	

Nr. 65.

LIGJE, 4 Maj 1934.

Mbi zbritjen 40% të taksës postare për fletoret dhe të shtypunat perjodike që dërgohen përjashta Shtetit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Maj 1934, Nr. 28)

Art. 1.

Taksa postare për fletoret dhe të shtypunat perjodike që dërgohen përjashta Shtetit prej editorve ose përfaqësuesve të tyne, e

BKSH

cilla, në bazë t'Art. 33 paragraf 1) të Konvencionit postarë Ndërkombëtarë të Londrës 1929, asht sot për sot 5 (pesë) qindar arit për nji peshë deri në 50 (pesëdhetë) gram dhe, për çdo fraksion të 50 (pesëdhetë) gramve, zbritet 40% (dyzet për qind) d.m.th. ka me kenë 3 (tre) qindar arit për nji peshë deri në 50 (pesëdhet) gram dhe për çdo fraksion të 50 (pesëdhet) gramve.

Art. 2.

Ministri i Punve Botore ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Art. 3.

Kjo Ligjë hyn në fuqi qysh nga dita e shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptrvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi zbritjen 40% të taksës postare për fletoret dhe të shtypunat perjodike që dërgohen përjashta Shtetit, e votueme prej Parlamentit. si mbas shkresës Nr. 249/I datë 27-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 4 Maj 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI — *Ministri i P. Botore* S. SARAÇI

Nr. 66.

LIGJE, 23 Prill 1934.

Mbi aplikimin e të drejtave të Statistikës mbi tregtin e jashtme të Mbretnis

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 14 Maj 1934, Nr. 28)

Neni 1.

Mbi gjithë mallnat që hyjnë ose dalin nga Mbretnija pa u marrun parasyshë gjendja e tyne e me përjashtim të rasteve që përmenden në nenet që vijojnë, vihet (impozohet) një e drejtë statistike në masën e tregueme në nenin 2.

Neni 2.

a) n'Importim :

1) për çdo krenë fr. ari 0.05 po qe se edhe tagri doganur nxirret mbi krenë;

2) për çdo copë fr. ari 0.05 po qe se edhe tagri doganuer nxjerret mbi copë;

3) për çdo nji pako poste fr. ari 0.05;

4) për ç'do 100 kilogram brutto ose, fraksion fr. ari 0.10 për të gjitha mallnat e tjera.

b) n'Eksportim :

1) për ç'do krenë fr. ari 0.02;

2) për ç'do 100 kilogram brutto, ose fraksion fr. ari 0.02 për të gjitha mallnat e tjera.

Neni 3.

Përjashtohen nga e drejta e statistikës së caktueme në nenin 2,

1) gjanat e përjashtueme nga tagri doganuer për efekte t'urdhnimeve paraprake të Ligjës së tarifës në nenin 4 cifra 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 17, 18, 21, 22, 23, 24, 26 a, b, 27, 28 dhe në nenin 5, 6-a-1, 2, 4, b, c, dhe ato të nenit 8;

2) lëvizje e kabotazhit;

3) lëvizja e transitit;

4) lëvizja e trànsbordeve;

5) trafiku i zonës së kufinit;

6) mallnat e importueme përkohësisht qofshin edhe të destinueme për Panaire ose për Ekspozicione përmanente;!

7) mjetet e transportit të turistave;

8) mjetet që shërbejnë për transportimin e mallnave dhe t'udhtarve, me konditë që të kthehen prapë;

9) mallnat e mbledhuna nga «naufrage-et» e të shkarkueme për shkak fuqije madhore, por që nuk konsumohen në vend;

10) mallnat e importueme nga Komanda rispektive për nevojat e Ushtris, t'Entit Kombëtar dhe të Gjindarmëris.

Neni 4.

Për mallnat që importohen ose eksportohen përkohësisht, si dhe për ato të jashtmet që dërgohen në transit o në nji doganë tjetër, duhet të garantohen të drejtat përkatëse të statistikës; ndërsa, për mallnat e vëndit që dërgohen në kabotazh garancija do të jepet vetëm kuer e drejta e statistikës, në përgjithësi, të kapërcejë fr. ari 10 (dhjetë).

Si për dhanjen, si për çlirimin e garancis vlejnë urdhnimet e Ligjës dhe të Rregullores doganore.

Neni 5.

E drejta e statistikës randon importatorin dhe eksportatorin;

likuidohet e nxjerret si nji e ardhun doganore dhe, llogaritet në nji kapitull të veçantë nën emëritmin «Taksë Statistike».

Neni 6.

Për fraksione qindarkash që dalin në llogaritje e sipër të të drejtës së statistikës, taksa nxjerret duke aplikuar pullë monopoli.

Neni 7.

Kjo Ligjë hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Neni 8.

Ministrija e Financave ngarkohet me zbatimin e kësajë Ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve
D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi aplikimin e të drejtës së statistikës mbi tregtin e jashtme të Mbretnis, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 175/I datë 19-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 23 Prill 1934.

Kryeministri P. EVANGJELI — *Ministri i Financavet* A. DIBRA

Nr. 67

LIGJË, 30 Prill 1934.

Mbi disa ndryshime të ligjës së Komuneve
(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Maj 1934, Nr. 29)

Neni 1.

Komunet: Goran, Spolatë, Dukat dhe Graçan në Prefekturën e Beratit, Sahadoll, Bazë, Patin, Selitë dhe Klenjë në Prefekturën e Dibrës; Golemas në Prefekturën e Durrsit; Zenelaj, Deshnicë, Cerje dhe Kolonjë në Prefekturën e Gjinokastrës; Moglicë, Panarit, Mokërr, Bezhan dhe Podë në Prefekturën e Korçës; Tej-Drin në Prefekturën e Kosovës; Qendër Shkodër, Hot, Rrjollë, Vukël, Vau-Dejës, Malësi e Lezhës, Shalë, Pult, Orosh i Poshtëm, Spaç' i II-të, Millë dhe Dardhë në Prefekturën e Shkodrës; Zall-Herraj në Prefekturën e Tiranës,

suprimohen dhe, katundet e tyne bashkohen me Komunet fqinjë si mbas aneksit A bashkanjitun kësaj Ligje.

Neni 2.

Kryetarët e Komuneve të qendrave në Prefektura si edhe ata të Nënprefekturave ku nuk ka Bashkië, suprimohen, dhe detyrat e tyne u ngarkohen në Prefektura, Kryetarve të Bashkive, dhe në Nënprefektura, Nenprefektave.

Neni 3.

Komunet e qendrave të Nënprefeturave ku ka Bashkië suprimohen dhe katundet e tyne u lidhen Bashkive, të cilat për qytetin, zbatojnë Ligjen e Bashkive, dhe për katundet atê të Komuneve.

Detyra e Kryetarit të Komunsë i ngarkohet Kryetarit të Bashkiës dhe ajo e Sekretarit nëpunsave të tjerë të Bashkive, si mbas llojit të veprimeve, gjith' ashtu detyra e policiës Komunale i ngarkohet Policiës së Bashkiës.

Kompetencat dhe atributat e Këshillit Komunes i ngarkohen Kuvendit të Bashkiës, i cili zgjidhet bashkarisht prej banorëve të qytetit e të katundeve. .

Kompetencat gjyqësore në çështjet penale, të parapame në Ligjën e Komuneve, i ngarkohen Këshillit të Bashkiës.

T'ardhunat që mblidhen në bazë të Ligjës së Komuneve do të shpenzohen për vepra Komunale ndër katunde dhe, do të shënohen veçanërisht në budgetin e Bashkiës.

Neni 4.

Komunet e qendrave në Prefektura e Nënprefektura nuk kanë kompetencë gjyqësore në çështje civile.

Neni 5.

Katundet e shënueme n'aneksin B të kësaj ligje bashkohen me Komunet e tregueme po në këtë aneks.

Neni 6.

Qendra dhe emni i disa Komuneve ndryshohet simbas aneksit C të kësaj Ligje.

Neni 7.

Vendimet e Këshillave Komunale të Prefekturave dhe ato të Këshillavet të Bashkive të Nënprefekturavet mbi çështje Komunale, ashtu edhe vendimet që apin Kryetarët e Bashkive me cilësin e Kryetarit të Komunes, mund t'anullohen prej Këshillit Ad-

ministrativ të Prefekturës ose të Nënprefekturës respektive, në konformitet me Nenin 60 të Ligjës së Komuneve.

Gjithashtu vendimet që apin Këshillat Komunale në Nënprefekturat, ku nuk ka Bashkië, si dhe vendimet që apin Nënprefektat me cilësin e Kryetarit të Komunes mund t'anulohen prej Këshillit Administrativ të Prefekturës.

Neni 8.

Radhorët e popullsiës së Komuneve që suprimohen si edhe Radhorët e popullsiës së katundeve që lidhen me një Komune tjetër, i dorëzohen Komunes ku bashkohen Komunet ose katundet.

Radhorët e akteve të gjendjes civile, që ndodhen n'arshivën e një Komunës që suprimohet, depozitohen n'arshivën e Komunës në të cilën aneksohet ma e shumta e popullsiës dhe ajo, sa ma parë, por jo ma vonë se gjashtë muaj prej hymjes në fuqi të kësaj ligje, detyrohet t'u dërgojë Komuneve përkatse kopje autentike të transkriptuara në radhorë të posaçem të gjitha akteve që i përkasin popullsiës së katundeve t'aneksueme.

Gjithë në këtë mënyrë do të veprojnë edhe komunet prej të cilave shkëputen disa katunde.

Neni 9.

Nënprefektave dhe Kryetarve të Bashkive që, simbas dispozitave të kësaj ligje, marrin përsipër dhe detyra nëpunësash komunale nuk do t'u paguhet rrogë ose shpërblim i veçantë.

Neni 10.

Këshillat e Komuneve që, si mbas dispozitave të kësaj ligje pësojnë ndryshim në sasin e katundeve (shtim ose pakësim) me hymjen në fuqi të kësaj ligje, bien nga fuqija dhe mbrënda 15 ditëve fillojnë zgjedhje të reja.

Neni 11.

Çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me këtë Ligjë mbetet pa fuqi.

Neni 12.

Ministrija e P. të Mbrendshme dhe ajo e Drejtësiës ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

Neni 13.

Kjo ligjë hyn në fuqi me 1 Prill 1934.

ANEKSI A.

QË TREGON KOMUNET QË SUPRIMOHEN DHE BASHKIMIN E KATUNDEVE TË TYNE ME KOMUNET E TJERA FQINJË

Në Prefekturën e Beratit :

1. Komuna e Goranit (Berat) suprimohet dhe katundet e sajë pjestohen me këtë mënyrë - Tetë katunde: Dy Vodezat, Krekza, Koritëza, Kostreni, Qereshniku, Sheqëza, Balibardha e Zelevishta, i lidhën Komunes së Qendrës Berat, Katërmbëdhetë katunde: Driza, Frashëri, Gegallari, Gorani, Hajdarbejasi, Katundasi, Kuçova, Lumasi, Luzani, Pashtrani, Perhundia, Polovina, Zamuranji dhe Velagoshti, i lidhen Komunës s'Urës së Hasan Beut.

2. Komuna e Spolatës (Lushnjë) suprimohet dhe katundet e saj pjestohen në këtë mënyrë: Tetë katunde Ferras-Nacej, Goriçani, Kermishtani, Mertishi Sopëza, Shakulla, Shenapremtja e Elemazit dhe Zajmasi i lidhen Komunës së Qendrës Lushnje. Nimbëdhetë katunde: Çakajazi, Dushk, Ramadanaj, Grabiani, Gurri, Allvaxhijasi, Kamenica, Kryekuqi, Pelmereja, Shenkollasi. Zharneci, dhe Spolati i lidhen Komunes së Divjakësk Shtatë katunde: Babunja, Fier, Semani, Gradishti, Gungasi, Karavasta, Muçijasi, dhe Remasi-Pervas i lidhen Komunës së Libofshës.

3. — Komuna e Dukatit (Fier) suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Komunës së Qendrës Fier.

4. — Komuna e Graçanit (Mallakastër) suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Bashkiës së Ballshit.

Në Prefekturën e Dibrës:

1. — Komuna e Sahadollit (Dibër) suprimohet. Katundet Brexhdan, Shimshan dhe Vakuf i lidhen Komunes së Qendrës Dibër; Cidhna e posht, Grykë-Ndokaj dhe Mustafaj i lidhen Komunes së Reçit; Sinaj dhe Arrës i lidhen Komunes Muhurit, dhe të gjithë katundet e tjerë i lidhen Komunes së Trojakut.

2. — Komuna e Bazës suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Komunës së Gurrës së Madhe.

3. — Komuna e Patinit (Mat) suprimohet. Katundet: Bejni, Patini dhe Plesha i lidhen Komunës së Klos-it. Katundi Kurdari i lidhet Bashkiës së Matit.

4. — Komuna e Selitës (Mat) suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Komunës së Perlatit.

5. — Komuna e Klenjës (Zerqan) suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Komunës s'Ostrenit të Vogël.

Në Prefektuën e Durrësit :

1. — Komuna e Golemasit (Kavajë) suprimohet dhe të gjith katundet e saj i lidhen Komunes së Qendrës Kavajë, përveç katundit Habilej që i lidhet Komunës së Gorës.

Në Prefekturën e Gjinokastrës :

1. — Komuna e Zenelajt suprimohet dhe të shtatë katundet e saj i lidhen Komunës Qendër Gjinokastër.

2. — Komuna e Deshnicës (Përmet) suprimohet dhe të pesëmbëdhjetë katundet e saj i lidhen Komunës Këlcyrës.

3. — Komuna e Cerjes (Përmet) suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Bashkiës së Përmetit, përveç katundit Borockë, i cili bashkohet me Komunën e Frashërit.

4. — Komuna e Kolonjës (Kurvelesh) suprimohet dhe të tre katundet e saj i lidhen Komunes së Qendres Gusmar.

Në Prefekturën e Korçës :

1. — Komuna e Moglicës (Korçë) suprimohet dhe të nandë katundet e saj i lidhen Komunës së Oparit.

2. — Komuna e Panaritit (Korçë) suprimohet dhe të gjashtë katundet e saj i lidhen Komunes së Vithkuqit.

3. — Komuna e Mokrës (Pogradec) suprimohet dhe të njëmbëdhjetë katundet e saj i lidhen Komunes së Trebinjës.

4. — Komuna e Bezhanit (Kolonjë) suprimohet dhe të njëmbëdhjetë katundet e saja i lidhen Bashkiës s'Ersekës.

5. — Komuna e Podës (Leskovik) suprimohet dhe të pesë katundet e saja i idhen Bashkiës së Leskovikut.

Në Prefekturën e Kosovës :

1. — Komuna e Tej-Drinit (Lumë) suprimohet dhe të katër katundet e saja i lidhen Bashkiës së Leskovikut.

Në Prefekturën e Shkodres :

1. — Komuna e Qendrës Shkodër suprimohet dhe katundet e saj pjestohen në këtë mënyrë : Bardhaj, Kuçi dhe Vukatan, i lidhen Komunes së Gurit të Zi; Berdicë e Sipërme dhe Berdicë e Poshtme i lidhen Komunes së Bushatit; Zogaj, Zues dhe Shirokë i lidhen Komunes s'Anës së Malit dhe katundet Dobraç e Golem i lidhen Komunes së Vrakës.

2. — Komuna e Shalës (Dukagjin) suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Komunes së Shoshit.

3. — Komuna e Pulatit (Dukagjin) suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Komunes së Shllakut.

4. — Komuna e Hotit (Koplik) suprimohet dhe të gjitha katundet e saj i lidhen Komunes së Kastratit.

5. — Komuna e Rrjolit (Koplik) suprimohet dhe katundet e saj pjestohen në këtë mënyrë: Egerçi, Gruemira, Kurtë, Lepuroshi, dhe Linaj i lidhen Komunes së Postribës: Koka, Kutaj, Luga e Rrjollit, Papaj dhe Repishti i lidhen Komunes së Shkrelit.

6. — Komuna e Vuklit (Koplik) suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Komunes së Vermoshit.

7. — Komuna e Vaut të Dêjës (Lesh) suprimohet dhe të nandë katundet e saj i lidhen Komunes së Zadrimës.

8. — Komuna e Malsiës së Lezhës (Lesh) suprimohet dhe katundet e saj pjestohen në këtë mënyrë: Kryezez, Lalmi, Manatija, Patalaj, dhe Vela e Vendit i lidhen Bashkiës së Lezhës; të gjithë të tjerat i lidhen Komunes së Bregut të Matës.

9. — Komuna e Oroshit të Poshtëm (Mirditë) suprimohet dhe katundet e saj pjestohen në këtë mënyrë: Gëziqi, Gusmeni, Munega, Nderfana, Nderfushazi, Simoni dhe Shperthaza i lidhen Komunes s'Oroshit. Katundet: Kukmira, Kaçinari, Kalori dhe Livadhasi i lidhen Komunes së Dibrit.

10. — Komuna e Spaçit të II-të suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Komunes së Spaçit të I-rë.

11. — Komuna e Milës (Pukë) suprimohet dhe katundet e saj pjestohen në këtë mënyrë: Bushneshi, Milla, Buzhali, Ukthi Levrushku dhe Qelza i lidhen Komunes së Qendrës Pukë. Katundi Berishë e Poshtme i lidhet Komunes s'Iballës.

12. — Komuna e Dardhës (Pukë) suprimohet dhe katundet e saj pjestohen në këtë mënyrë: Arrsti, Meziu, dhe Miliska, i lidhen Komunes s'Iballës.

Katundet: Dardha, Fleti, Truni, Sakak-Kullumbria dhe Xathi i lidhen Komunes së Dukagjinit.

Në Prefekturën e Tiranës :

1. — Komuna e Zall Herrit, suprimohet dhe të gjithë katundet e saj i lidhen Komunes së Qendrës Tiranës.

ANEKSI B.

QË TREGON SHKËPUTJEN E DISA KATUNDEVE PREJ NJI KOMUNE DHE LIDHJEN E TYNE ME NJË KOMUNE TJETËR

Në Prefekturën e Beratit

1. — Tre katunde; Malinati, Sinja dhe Zgrubonja shkëputen prej Komunes së Molishtit dhe i lidhen Komunes së Qendres Berat.

2. — Tre katunde: Mimias, Vojnik, dhe Roshnik shkëputen prej Komunes së Peshtanit dhe i lidhen Komunes së Qendres Berat.

3. — Pesë katunde: Çerma-Biçakaj, Çerma-Proshkaj, Gramshi, Çerma. Pashaj dhe Zhama shkëputen prej Komunes së Divjakës dhe i lidhen Komunes së Qendres Lushnje.

4. — Shtat katunde: Mamili, Haveleasi, Kryegjati, Matka-Dhespoti, Pojani, Senan-belliu dhe Zhavari shkëputen prej Komunes së Qendres Fier; dy nga këta: Kryegjati dhe Pojani i lidhen Komunes së Levanit, pesë të tjerët i lidhen Komunes së Semanit.

5. — Katundi Krapsa shkëputet prej komunes së Levanit dhe i lidhet Komunes së Qendrës Fier.

6. — Katundi Klos shkëputet prej Komunes së Fratarit dhe i lidhet Bashkiës së Ballshit.

Në Prefekturën e Dibrës:

1. — Tre katunde: Pjeça, Pejka, dhe Trepçja shkëputen prej Komunes së Qendrës Dibrës dhe i lidhen Komunes së Maqellarës

2. — Katundi German shkëputet prej Komunes së Qendrës Burrel dhe i lidhet Komunës së Gurrës së Madhe.

3. — Kater katunde të Komunes së Gurrës së Madhe: Beli, Fulqeti, Darsi dhe Unjatëja i lidhen Komunës së Klosit.

4. — Katundi Lublesh shkëputet prej Komunes së Qendrës Zerqan dhe i lidhet Komunes s'Ostrenit të vogël.

5. — Katundi Ternovë shkëputet prej Komunes s'Ostrenit dhe i lidhet Bashkiës së Zerqanit.

Në Prefekturën e Durrësit :

1. — Dy katunde Bagos e Karpë shkëputen prej Komunes së Kryevidhit (Kavajë) dhe i lidhen Bashkiës së Kavajës.

2. — Katundi Shemri shkëputet prej Komunes së Qendrës Krujë dhe i lidhet Komunes së Mamurasit.

Në Prefekturën e Elbasanit

1. — Kater katunde: Lunik, Preval, Nesht, dhe Kostenj shkëputen prej Komunes së Çermenikës së I-rë; dy të parët Lunik e Preval i lidhen Komunes së Librazhit dhe dy të tjerët Kostenj e Nesht i lidhen Komunes së Çermenikës së II-të.

2. — Katundi Gjyral shkëputet prej Komunes së Dumres dhe i lidhet Komunes së Shpatit të II-të (Elbasan).

3. — Dy katunde Shalësi e Çerriku shkëputen prej Komunes së Shpatit të II-të dhe i lidhen Komunes së Dumres.

4. — Dy katunde Fush-Bull dhe Polis shkëputen prej Komunes së Shpatit të Irë dhe i lidhen i pari Komunes së Qendrës Elbasan dhe i dyti Komunes së Librazhdit.

5. — Katër katunde të Komunes së Dragotit: Kukuçova,, Seraseli, Sulti dhe Zgjuba i lidhen Komunës së Kushovës.

6. — Gjashtë katunde: Fillballja, Met-Hasanej, Rogozhina, Rozej, Sinaballej, dhe Sheshaj shkëputen prej Komunës, së Qëndrës Peqin dhe i lidhen i pari Komunës së Vrapit dhe pesë të tjerët Komunës së Mlikës.

7. — Pesë katunde të Komunes së Mlikës: Ballshemi, Cikallëshi, Mlika, Pojanej dhe Rostenj i lidhen Komunes së Vrapit.

8. — Dy katundet: Sallbegaj dhe Thanasaj shkëputen prej Komunes së Darsis dhe i lidhen Komunes së Mlikës.

Në Prefekturën e Gjinokastrësg

1. — Katërmbëdhjetë katunde: Badelonja, Leshica, Gjinkar, Petran, Trebozishtë, Lipivan, Mesukar, Dardhës, Leshnje, Ogduman, Grabovë, Benjë, Vinjan, dhe Malibardhë shkëputen prej Komunes së Qendres Përmetit dhe i lidhen komunes së Bazës.

2. — Katundi Vagalat hiqet prej Komunes së Qendres Konispol dhe i lidhet Komunes së Pandelejmonit.

3. — Katundet Karrocaj dhe Perdhikar shkëputen prej Komunes së Pandelejmonit dhe i lidhen komunes së Qendrës Konispol.

Në Prefekturën e Korçës :

1. — Katundi Osoja shkëputet prej Komunes së Voskopojës dhe i lidhet Komunes s'Oparit.

2. — Tre katunde: Lozhani, Tresova, dhe Zvarishti shkëputen prej Komunes së Maliqit dhe i lidhen Komunes së Voskopojës.

3. — Dy katunde: Borshi e Kurilla shkëputen prej komunes së Qendrs Bilisht dhe i lidhen Komunes së Bozhigradit.

4. — Katundi Gjonç shkëputet prej Komunes së Qendres Ersekë dhe i lidhet Komunes së Barmashit.

5. — Dy katunde: Iliarë e Munishtir shkëputen prej Komunes së Qendrës Leskovik dhe i lidhen Komunes së Kovaçishtit.

Në Prefekturën e Shkodrës :

1. — Katundi Pentari shkëputet prej Komunes s'Anës së Malit dhe i lidhet Komunes së Pulajt.

2. — Katundi Prekal shkëputet prej Komunes së Shoshit (Dukagjin) dhe i lidhet Komunes së Shllakut.

3. — Tre katunde Aliaj, Gradeci dhe Petrushani shkëputen prej Komunes Koplik dhe i lidhen Komunes së Kastratit.

4. —Katundi Goraj shkëputet prej Komunes së Shkrelit dhe i lidhet Komunes së Kastratit.

5. Tre katunde të Komunes së Zadrimës Kallmeti, Merqija dhe Rraboshta i lidhen Bashkiës së Lezhës.

6. — Tre katunde të Komunes së Bregut të Matës: Fildana, Ishull i Lezhës dhe Treçi i lidhen Bashkiës së Lezhës.

7. — Dy katundet Qerreti i Epërmë dhe Qerreti i Poshtem shkëputen prej Komunes së Karmës dhe i lidhen Komunes së Qendres Pukë.

Në Prefekturën e Vlonës :

1. — Tre katunde të Komunes të Treblovës: Matrova, Kropishti dhe Peshkëpia, i lidhen Komunes së Kaninës.

2. — Dy katunde të Komunes së Kaninës: Kanina dhe Babica e Madhe, i lidhen Bashkiës së Vlonës.

Gjith'ashtu i lidhen Bashkiës së Vlonës dhe katundet Babicë e Vogël që shkëputet prej Komunes së Nartës.

Në Prefekturën e Tiranës :

— Dy katundet Manik e Pezë-Helmas shkëputen prej Komunes së Vorres dhe i lidhen Komunes së Qendres Tiranë.

ANEKSI C.

QË TREGON NDRYSHIMIN E QENDRËS DHE T'EMNIT TË DISA KOMUNEVE

Në Prefekturën e Dibrës :

1. — Qendra e Komunes së Trojakut prej katundit Sllatin shperngulet në Katundin Kastriot dhe Komuna merr emnin «Komuna e Kastriotit».

2. — Qendra e Komunes së Luzniës prej katundit Luzni shperngulet në katundin Muhur dhe kështu Komuna merr emnin «Komuna e Muhurit».

3. — Qendra e Komunes së Gurrës së Madhe (Mat) prej katundit Gurra e Madhe shperngulet në katundin German dhe kështu Komuna merr emnin «Komuna e Germanit»

4. — Qendra e Komunes s'Ostrenit të Math shperngulet prej katundit Ostren i Math në katundin Ostren i Vogël dhe Komuna merr emnin «Komuna e Ostrenit»

Në Prefekturën e Durrësit :

1. — Qendra e Komunes së Qendres së Durrësit shperngulet në katundin Shënavlash dhe Komuna merr emnin «Komuna e Shënavlashit».

2. — Qendra e Komunes së Gosës prej katundit Gosë shperngulet në katundin Harizaj dhe kështu Komuna merr emnin «Komuna e Harizajt»

Në Prefekturën e Elbasanit :

1. — Komuna e Çermënikës së I-rë që mbetet vetem me katundin Martanesh merr emnin «Komuna e Martaneshit».

2. — Qendra e Komunes së Dragotit prej katundit Dragot shperngulet në katundin Mollas dhe kështu Komuna merr emnin «Komuna e Mollasit».

3. — Qendra e Komunes së Kushovës prej katundit Kushovë shperngulet në katudin Tunjë dhe kështu Komuna merr emnin «Komuna e Tunjës».

4. — Qendra e Komunes së Mlikës shperngulet prej katundit Mlikë në katundin Rogozhinë dhe komuna merr emnin «Komuna e Rogozhinës».

5. — Qendra e Komunes së Darsit shperngulet prej katundit Gjyzaj në katundin Ballajgat.

6. — Qendra e Komunes së Vrapit shperngulet prej katundit Vrap në katundin Garunja e Madhe dhe Komuna merr emnin «Komuna e Garunjës së Madhe».

Në Prefekturën e Gjinokastrës :

1. — Qendra e Komunës së Rezës (Përmet) shpërngulet prej katundit Dravocë në katundin Petran.

2. — Qendra e Komunës së Lap-Martallonit (Tepelenës) shpërngulet prej katundit Lap-Martallon në katundin Sinanaj dhe Komuna merr emnin «Komuna e Sinanajt».

3. — Qendra e Komunes së Jermës (Delvinë) prej katundit Ymerefendi shpërngulet në katundin Dhivër dhe komuna merr emnin «Komuna e Dhivrit».

Në Prefekturën e Shkodrës :

1. — Qendra e Komunes së Shllakut prej katundit Lekgjekaj shpërngulet në katundin Prekal dhe Komuna merr emnin «Komuna e Prekalit».

2. — Qendra e Komunës së Shoshit (Dukagjin) prej katundit Nicaj shpërngulet në katundin Kodra-Shëngjergj dhe komuna merr emnin «Komuna e Qendres Dukagjin».

3. — Qendra e Komunës së Zadrimës prej katundit Dajç shpërngulet në katundin Hajmel.

4. — Qendra e Kmunes së Bregut të Matës shpërngulet prej katundit Gajush në katundin Pllanë.

5. — Qendra e Komunes së Vermoshit shpërngulet prej katundit Selcë në katundin Tamarë.

6. — Qendra e Komunes së Dibrit (Mirditë) shperngulet prej katundit Vigu në Katundin Kalivaç.

7. Qendra e Komunes së Spaçit të I-rë shpërngulet prej katundit Arrës në katundin Bregu dhe Komuna merr emnin «Komuna e Spaçit».

8. — Qendra e Komunës së Karmës (Pukë) shpërngulet prej katundit Karmë në katundin Dushi i Epërmë dhe komuna merr emnin «Komuna e Dushit».

9. — Qendra e Komunes së Dukagjinit (Pukë) shpërngulet prej katundit Dukagjin në katundin Spas dhe komuna merr emnin «Komuna e Spasit».

Në Prefekturën e Korçës :

1. — Qendra e Komunës së Trebinjës shperngulet prej katundit Trebinje në katundin Pleshishtë dhe Komuna merr emnin «Komuna e Pleshishtës».

2. — Qendra e Komunes së Derdushës (Pogradec) shpërngulet prej katundit Gribec në katundin Moçan.

3. — Qendra e Komunes së Pretushës shpërngulet prej katundit Pretushë në katundin Çeravë dhe komuna merr emnin «Komuna e Çeravës».

Në Prefekturën e Vlonës :

1. — Qendra e Komunes së Kaninës shpërngulet prej katundit Kaninë në katundin Drashovicë dhe komuna merr emnin «Komuna e Drashovicës».

2. — Qendra e Komunes së Topalltis shpërngulet prej katundit Trevëllazën në katundin Mifol.

Në Prefekturën e Tiranës :

1. — Qendra e Komunes së Priskës shpërngulet prej katundit Priskë në katundin Gurë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi disa ndryshime të Ligjës së Komuneve, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 190/I datë 21-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 30 Prill 1934. ZOG

Ministri i Drejtësis V. AVRAMI

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme MUSA JUKA

Nr. 68.

LIGJE, 20 Prill 1934.

Mbi vuemjen në dispozicion të Ministris së P. Botore 3049 kuintal miser dhe 3969 kuintal grunë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Maj 1934, Nr. 29)

Neni 1.

Nga gruni dhe misri i të dhetavet të mbetun n'ekonomi në vjetin financjar 1933-34, ashtu edhe nga misri e gruni të shpërndamë për farë në vjetin 1931-32 dhe i mbledhun ose që do të mblidhet, Minitsria e Financavet asht e autorizueme me i dorëzue Ministris së P. Botore nepër qendrat e caktueme në këtë ligjë, sasina e poshtë shenueme ;

			Misri	Grunë
Shkodër	kuint.	845	kuint.	94
Lesh	«	707	«	195
Kukës	«	—	«	272
Vlonë	«	—	«	1010
Berat	«	196	«	98
Fier	«	1048	«	949
Gjinokastër	«	—	«	499
Delvinë	«	253	«	685
Lushnje	«	—	«	167
		3049		3969

Neni 2.

Misri dhe gruni që dorëzohet në këtë mënyrë, Ministria e P. Botore do t'u a shpërndajë gratis banorve të vobektë të viseve të Prefekturave Shkodër, Vlonë, Gjinokastër, Berat e Kukës, tue i shtië ata, kundrejt kësaj, ndër punime të rrugave botore e komunale, në bazë të rregullores në fuqi.

Neni 3.

Mbi mënyrën e shpërndamjes së misrit dhe të grunit të vobektëve, vlejnë dispozitat e neneve 2, 3, 4, 5 e 6 të Ligjës mbi shpërndamjen e misrit gratis të vobektëve Shqiptar me datë 10 Nanduer 1931, botue në Fletoren Zyrtare Nr. 72 datë 18 Nanduer 1931. Caktimi i sasis së misrit dhe të grunit për t'u shpërnda ç'do personit të vobektë, mbetet në fakultet të Komisionit të formuem si mbas Nenit 2 të Ligjës së përmendun mâ sipër, me konditë që, sasija e caktueme kësodore të jetë uniformë për të gjithë personat përfitues.

Neni 4.

Për efekte budgetore, misri dhe gruni i caktuem në Nenin 1 të kësaj Ligje, do të vleftësohet prej Këshillit t'Administratës përkatse dhe, shuma e vleftës që do të rezultojë, do të llogaritet në budget si e ardhun nëpër kapitujt relativ.

Shuma e vleftës së rezultueme në këtë mënyrë i shtohet Kap. 7 «ndertime e miratime rrugash e urash» të budgetit udhtues të Ministris së P. Botore.

Për likuidimin e këtij fondi, vlejnë dispozitat përkatse të ligjës mbi Administrimin e pasunis dhe Kontabilitetin e Përgjithshëm të Shtetit.

BKSH

Neni 5.

Ministri i Financavet dhe Ministri i P. Botore ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Neni 6.

Këjo ligjë hynë në fuqi dy javë mbasi të shpallet në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi vuemjen në dispozicion të M. B. Botore 3049 kuintal misër dhe 3960 kuintal grunë, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 193/I datë 16-IV-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 20 Prill 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Ministri i P. Botore S. SARAÇI

Nr. 69.

LIGJE, 23 Prill 1934.

Mbi rregullimin e fejesave

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Maj 1934, Nr. 29)

Neni 1.

Ndalohet fejesa e të mitunit që nuk kanë mbushun moshën e 16 vjetëve kur asht mashkull, dhe atë të 14 vjetëve kur asht femën.

Fejesa e të mitunve të nalt-treguem konsiderohet e pa qenun.

Neni 2.

Ushtruësi i pushtetit atnor ose çdo person tjetër që ka nën kujdesin e tij një të mitun që nuk ka mbushun moshën e tregueme në nenin e ma sipërmë dhe lidh fejesë n'emnin e të mitunit, dënohet me burgim nga nji muaj deri 6 muaj, ose me internim nga 2 muaj deri nji vjet.

Në qoftë se personat e nalt-tregueme kanë veprue me qëllim fitimi, dënimi nuk mundet të jetë ma pak se gjysma e maksimumit.

Neni 3.

Ushtruësi i pushtetit atnor ose çdo person tjetër që ka nën kujdesiën e tij një të mitun që ka mbushun moshën e tregueme në nenin e parë dhe lidh fejesë n'emën e të mitunit pa hirin e tij, ndeshkohet me burgim dy muaj deri nji vjet ose me internim nga katër muaj deri dy vjet, dhe në qoftë se kanë vepruar me qëllim fitimi, dënimi nuk mundet të jetë ma pak se gjysma e maksimumit.

Neni 4.

Të parëlindunit dhe çdo person tjetër që ka nën kujdesiën e tij një të fejuem dhe sikur ky të jetë madhor, dhe me qëllim fitimi ose vendet e determinojnë ose e eksistojnë për mos me eksekutue premtimin e martesës, ndeshkohen me burgim nga dy deri 12 muaj ose me internim nga 4 muaj deri 2 vjet.

Neni 5.

Ay që dëshiron me çart fejesën, detyrohet të lajmëroi anën e interesueme me ndërmjetsiën e kryetarit të Komunes i cili mban një proces-verbal dhe nji kopje të këtij-proces-verbali i a komunikon anës tjetër.

Neni 6.

Padinat, lajmërimet për çartje dhe komunikimet bahen prej t'interesuemvet personalisht ose prej përfaqsuësvet të tyne ose prej atynëve të cillëve u kërkohet pëlqimi me rastin e martesës.

Neni 7.

I interesuemi në rast se nuk pranon çartjen mbrenda 20 ditvet prej datës së komunikimit të lajmërimit, i drejtohet Gjyqtarit Paqtuës për me procedue në konformitet të kësaj ligje tue parashtrue dhe pretendimet e tija.

Mos drejtimi mbrenda afatit të sipërmë, konsiderohet pranimi i çartjes.

Neni 8.

Gjyqtari Paqtuës para se të procedoj në gjykimin e çashtjes formon një Komision prej katër antarësh nga paria e vendit dhe sa të jet'e mundun dy prej fisit të secilës anë.

Neni 9.

Antarët e Komisionit të ma sipërmë që mrrijnë të përjashtojnë vehten nga prezantimi, tue vumun pretekste të rrema, ose, tue qenë të prezantuem rrefuzojnë të marrin pjesë në Komisionin, dënohen me sanksionet e nenit 239 të Kodit Penal.

Neni 10.

Komisioni i formuem si mbas nenit 8 mblidhet nën kryesin e Gjyqtarit Paqtues, thërret edhe ndigjon palët ose përfaqësuësit e tyne dhe, në rasë nevoje, edhe përdhunisht dhe kujdeset me i paqësue, dhe në qoftë se paqësimi asht i pa mundun Gjyqtari vetëm prcedon në gjykimin e çashtjes me shpejti ma të madhe.

Neni 11.

Kur në përfundim të gjykimit Gjyqtari konstaton se ka shkaqe t'arësyeshme për çartjen e fejesës, detyron anën që ka marrë të hollat, sendet dhe çdo dhuratë tjetër me rastin e fejesës t'ja këthej anës tjetër, dhe në qoftë se nuk eksistojnë shkaqe t'arësyeshme aplikon kur ka vend sanksionet e kësaj ligje.

Neni 12.

Kur çartësi i fejesës pa shak t'arësyeshëm asht ay që ka marrë të hollat, sendet ose dhuratat detyrohet me këthimin e tyne dhe nuk mundet me celebrue martesë me person tjetër pa këthye të gjitha ç'ka ka marrë me rastin e fejesës.

Çartësi i përmendun në paragrafin e sipërmë nuk ka të drejtë të kërkojë këthimin, të ç'ka ka dhanë me rastin e fejesës.

Në ç'do rast ndalohet me celebrue martesë me person tjetër për një kohë jo ma pak se 6 muaj dhe jo më tepër se dy vjet.

Neni 13.

Dhuratat e dhanuna me rastin e fejesës, provohen me ç'do mjet ligjor, gjith'ashtu provohet me ç'do mjet ligjor dhe sasia e të hollave të dhanuna si mbas zakonit të vendit për pregatitjen e martesës kur kjo nuk kalon cakun e zakonëshëm.

Neni 14.

I fejuemi që ka mbushun moshën ligjore dhe pa krye formalitetet e përshkrueme në nenet e ma sipërme për çartjen e fejesës, martohet me një person tjetër ndëshkohet me burgim nga 2 deri 6 muaj, ose me internim nga 4 muaj deri një vjet dhe, detyrohet me këthimin e gjith ç'ka ka marrë me rastain e fejesës.

Po me ndëshkimet e sipërme ndëshkhet dhe ay që ka dhanë pëlqimin në celebrimin e një martese të tillë kur të martuemit të jenë të mitun, pa krye formalitetet e çartjes.

Neni 15.

I fejuemi dhe personat e përmenduna në Kaptinën e Vtë të Titullit VII të Librit I-rë të Kodit Civil, kanë të drejtë me kundërshtue martesën para Gjyqtarit Paqtuës dhe për shkak të çartjes të fejesës dhe, nuk mundet me u celebrue martesa me person tjetër pa u zgjidhun kundërshtimi nga Gjyqtari Paqtuës dhe para se t'ekzekutohet vendimi i Gjyqtarit kondra shkaktarit të çartjes.

Neni 16.

Ndjekjet ashtu dhe eksekutimi i vendimit për gjith fajtorët e nalt-treguem, pushojnë në qoftë se personat që kanë qenë të fejuem, kontraktojnë martesën.

Neni 17.

Fajet e tregueme në nenet e ma sipërmë, posë atyne të parapame prej nenit 2 të kësaj ligje, ndiqen mbi kërkimin e anës së damtueme.

Vendin e këtij kërkimi e zen edhe drejtimi pranë Gjyqtarit Paqtuës në konformitet me nenin 7 të kësaj ligje.

Neni 18.

Dispozitat e kësaj ligje kanë m'u aplikue vetëm në viset e caktueme me Dekret Mbretnuer dhe për fejesat e lidhuna n'ato vise midis personash banuësa dhe prej origjine nga ato vende, dhe për një kohë prej 5 vjetësh prej hymjes në fuqi të kësaj ligje, e cila mund të zgjatohet me Dekret Mbretnuer deri 5 vjet të tjera.

Neni 19.

Ç'do dispozitë që asht në kundërshtim me këtë ligjë mbetet pa fuqi.

Neni 20.

Ministrija e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi rregulimin e fejesave, e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 142/I datë 15-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 23 Prillë 1934. Z O G

Zav. Kryeministri :
Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Nr. 70.

LIGJË, 30 Prill 1934.

Mbi modifikimin e nenit 2 të ligjës datë 3 Maj 1930 mbi formimin dhe qëllimin e Bankës Bujqësore Kombtare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Maj 1934, Nr. 29)

Art. 1.

Paragrafi ç) i nenit 2 të ligjës datë 3 Maj 1930 mbi formimin dhe qëllimin e Bankës Bujqësore Kombëtare, modifikohet si vijon:

Shtesës së taksit prej fr. ari 0.70 (shtatëdhetë qindar) mbi alkool, për ç'do kilogram alkool anhyder.

Art. 2.

Kjo ligjë hyn në fuqi prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptrvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi modifikimin e nenit 2 të ligjës me datë 3 Majë 1930 mbi formimin dhe qëllimin e Bankës Bujqësore Kombëtare, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 177/I datë 21-IV-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 30 Prill 1934. ZOG

Kryeministri — P. EVANGJELI

Ministri i Financavet — A. DIBRA

Nr. 71.

LIGJË, 4 Maj 1934.

Mbi transferimin e një fondi prej fr. ari 3200 (trimijedyqind) nga Kap. I «Rrogë personeli» në Kap. II «Rrogë personeli me kontrate» të buxhetit të Ministris P. Botore ushtërimi 1933-934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Maj 1934, Nr. 29)

Art. 1.

I shtohet Kap. II «Rrogë personeli me kontratë,» të buxhe-

tit të Ministriës së P. Botore ushtrim 1933-1934 nji shumë prej fr. ari 3.200 (trimijedyqind).

Art. 2.

Shuma e permendun n'Art. 1 të kësaj Ligje merret nga fondi i Kap. I «Rrogë personeli» të buxhetit të Ministriës së P. Botore, ushtrimi 1933-1934.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj ligje, ngarkohet Ministrija e Financavet dhe ajo e P. Botore.

Art. 4.

Kjo ligjë hynë në fuqië prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aproimin dhe zbatimin e Ligjës mbi transferimin e nji fondi prej Fr. ari 3.200, në buxhetin e Ministriës së Punve Botore e votueme prej Parlamentit si mbas shkresës Nr. 244/I datë 25-IV-934 të Kryesiës së Tij.

Tiranë, me 4 Maj 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Ministri i P. Botore S. SARAÇI

Nr. 72.

LIGJË, 30 Prill 1934.

Mbi interpretimin e Nenit I të Ligjës mbi Tatimin e Fitimit me datë 9 Qershuer 1928

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 19 Maj 1934, Nr. 29)

Art. 1.

Deri sa me një dispozitë ligjore, nëpunësit e Bashkivet të konsiderohen si nëpunës Shteti, i shtrohen tatim fitimit.

Art. 2.

Ky interpretim zbatohet qysh prej datës së hymjes në fuqi të ligjës relative.

Art. 3.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi interpretimin e nenit 1 të ligjës mbi tatimin e fitimit me datë 9 Qershuer 1928, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 183/I datë 21-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 30 Prill 1934. ZOG

Ministri i Financavet A. DIBRA

Kryeministri P. EVANGJELI

Nr. 73.

SHTOJCE-LIGJE, 19 Maj 1934.

Mbi vendosjen e Emigrandave
(e botueme në Fletoren Zyrtare, 26 Maj 1934, Nr. 30).

Art. 1.

Nenit 1 të ligjës mbi vendosjen e Emigrandave i shtohet fraza qi vijon:

«Gjith'ashtu instalohen si Emigranda në toka Shtetnore e në konformitet me dispozitat ligjore edhe gjithë ata Shqiptarë, qi për arësyena trazimesh e tjera janë shpërngulun familisht prej Shqipnije që nga viti 1912 e deri në Kongresin e Lushnjes, e për ngushticë jetese dhe për shkaqe të tjera qi bajnë të pa mundun qëndrimin e tyne atje, kthehen përsëri në Shqipni.

Art. 2.

Neni 4 i ligjës modifikohet si vijon:

Emigrantave qi nuk kanë mjete ushqimi, deri sa të mbërrijnë në vendin e destinuem për instalim, autoritetet administrative, të cilave u janë drejtue emigrandat, kuer kanë kredië relative në dispozicjon si mbas nevojës qi u çfaqet detyrohen me u pague shpenzimet e udhtimit si mbas rastit me kalë ose me automobilë dhe për ushqim e fjetje u jepen nga fr. ari 0.50% deri në 1 për ç'do frymë.

Art. 3.

Nen 6 i Ligjës modifikohet si vijon:

Zyrat e Emigrantave ose nëpunësat qi përfaqësojnë këto Zyra në Prefektura ose në Nenprefekura, që nga data e hyemjes t'emigrandave në Shqipnië, detyrohen me u dhanë për ç'do frymë fr. ari 0.20% në ditë. Kjo ndihmë vazhdon nji vjetë, tue u pague në katër kiste të njinjishme.

Art. 4.

Kuer në nji tokë ku janë instalue emigranda, ndodhet ndonji Kënetë o moçal i vogël, dhe kjo prish ajrin dhe klimën dhe, damton shëndetin e banorëve ose pengon kultivimin e tokavet, Drejtoria e P. e Reformës Agrare, mbasi ë ketë bâ studimet me anën e teknikëve të sajë dhe të jetë autorizue me vendim të Këshillit Ministruer, mund të marrë masat për tharjen ose kanalizimin e kënetës a të moçalit, me fondet qi disponon për shpenzime instalimi Emigrandash.

Gjith'ashtu kuër në tokat ku janë vendosun Emigranda, mungon uji, i cili me inicjativën dhe me punimin direkt t'Emigrandave nuk ka mundësi të sigurohet, Drejtorija e P. e Reformës Agrare, mbasi të ketë ba studimet e rastit në vend me organet e sajë Teknike, me fondet qi disponon për shpenzime emigrandash u siguron ujin e duhun tue sjellë burime e me çelje pusash, si mbas gjendjes e pozitës së vendit.

Art. 5.

Kuer ndodhë qi me vdekjen e prindëve Emigrandat mbesin fëmij jetima (djem ose vajza) pa mbrojtës, Drejtorija e P. Reformës Agrare si kujdestare i tyne detyrohet me administrue punimin e tokave qi trashigojnë dhe me t'ardhunat e prodhimit qi do të realizojnë të sigurojnë jetesën e ritjen e të përmendunve.

Në rastë se t'ardhunat qi rrjedhin nga prodhimi i tokave nuk janë të mjafta për sigurimin e jetesës së tyne, Drejtorija e P. Reformës Agrare, mbasi të jetë autorizue me vendim të Këshillit Ministruer, u akordon edhe nji ndihmë t'arësyeshme nga fondet qi disponon për shpenzime emigrandash.

Po kje se kta kanë me u pranue në ndonji Institut Shtetnuer e bamirës ku do të rriten e do t'u sigurohet jetesa, atëhere t'ardhunat qi do të reqizohen nga prodhimi i tokës së punueme për ta për sa kohë qi kanë me qindrue në Institut, shkojnë në favor të Institutit përkatës.

Art. 6.

Emigrandat qi zotënojnë tokë të mjaftueshme mbrenda kufinit të Mbretnis s'kanë të drejtë të marrin tokë, por këtyne u akordohen vetëm ndihmat bujqësore për ndreqje shtëpije e blemje veglash bujqësore si mbas § 1 të Nenit 23 të Ligjës.

Kuer Emigrandat zotënojnë nji sasië tokë mbrenda kufinit të Shqipniës, por jo të mjaftueshme për nevojat e tyne, u plotësohet kjo në sasië ligjore deri në përmbushjen e pesë dynymevet për frymë, tuej ju dhanë pjesa plotësuese nga tokat Shtetnore. Në rastë se aty afër nuk gjindet tokë Shteti, i plotësohet nga tokat qi disponohen për instalim Emigrandash, në nji vend tjetër.

Po qe se emigrandi me hirin e vetë dëshiron t'a ketë në nji vend krejt tokën, instalohet atje ku ka tokë Shteti tuej ju akordue pjesë e plotë nga tokat shtetnore disponibel për instalim, dhe toka e tij i lehet në dispozicjon Zyrës Reformës Agrare lokale, për me e përdorë për instalimin ose për plotësimin e ndonji tjetrit.

Art. 7.

Nenit 13 të Ligjës mbi vendosjen e Emigrandave i shtohet fraza qi vijon:

«Përjashtohen edhe nga taksat e pullavet q'i përkasin çashtjevet të natyrës s'instalimit, si lutjet, dëshmi, fletë shpërnguljet e gjendjes civile dhe diftesë detyrimet për ndihma e ushqim q'i u akordohen nga Shteti».

Art. 8.

Kuer Zyrës së Shëndetësiës i mungojnë barnat e nevojëshme për mjekimin e Emigrandave, në bazë të reçetave të mjekut blehen këto barna ndër farmacië private dhe, paguhen nga fondi qi Drejtorija e P. e Reformës Agrare disponon për shpenzime emigrantash.

Art. 9.

Kuer emigrandat vijnë me shumicë dhe formojnë katunde të veçantë, Drejtorija e P. Reformës Agrare, në themel të nji vendimit të Komisjonit instalimit të vendit e me pëlqimin e Këshillit Ministruer, nga fondet qi disponin për shpenzime emigrandash u ndihmon me nji sasië të hollash për ngrehjen e Shkollavet.

Art. 10.

Paragrafi II të nenit 23 të ligjës i bahet shtesa qi vijon:

«Tokat e shtëpiat qi u janë akordue emigrandavet veç qi nuk mund të jetërsohen pa mbushë afatin e caktuem as edhe nuk mund të ipotekohen, a të ngarkohen me ndonji obligim tjetër».

Ata qi tue veprue në kundërshtim me këtë paragraf jetërsojnë tokën ose shtëpinë, jetërsimi konsiderohet nul, e sendeve të jetërsueme me nji herë i vihet dorë nga ana e Zyrës Agrare dhe veprucsi i jepet Gjyqit për nxjerrjen e ndihmavet qi ka marrë prej Shtetit.

Në rast se ipotekohen ose ngarkohen me ndonji barrë tjetër, veprimi quhet si i pa qenë e pa asnji efekt.

Art. 11.

Emigrandat e instaluem në toka bujqësore detyrohen të banojnë familisht pranë tokës, ndryshe veprohet për ta si vijon:

a) Emigrandat qi instalohen në konformitet me dispozitat ligjore vetëm me qëllim qi të përfitojnë prej ndihmash dhe ushqimit e nuk shkojnë fare në vëndin e insatlimit, në bazë të Vendimit të Komisjonit instalimit lokal, u merret toka e me njiherë ç'rregjistrohen nga librat e Emigrancionit, dhe i epen Gjyqit për nxjerrjen e ndihmavet qi kanë marrë e për ndjekje ligjore si mashtruesa e spekulues ndaj Shtetit.

b) Atyne emigrandave t'instaluem qi kanë marrë ndihma e ushqim dhe kanë ngrehë shtëpië, e para se të ketë mbushë kohën e caktueme në paragrafin e dytë dhe të pestë t'Art. 23 të Ligjës, largohen prej tokës e merren me profesione të tjera, tue punue tokën me anë bujqësh me Vendim të Komisjonit instalimit u merret toka. Në këtë rastë emigrandi ka të drejtë apelimi në Këshillin e Shtetit mbrenda 15 ditëvet nga data e komunikimit të Vendimit dhe, në mbarim të afatit Vendimi merrë formën e preme dhe ekzekutohet prej organevet të Gjindarmëriës, mbi kërkimin të Drejtoriës P. të Reformës Agrare.

Art. 12.

Kjo Shtojcë-Ligjë hynë në fuqië ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 13.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Shtojcë-Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Shtojcë-Ligjës mbi Vendosjen e Emigrantave, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 151 datë 5-5-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 19 Maj 1934. ZOG

Kryeministri
PANDELI EVANGJELI

Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri P. Mbrendëshme e Zav.
Ministri i Ekon. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Ñ, 74.

DEKRET-RREGULLORE, 19 Maj 1934.

Mbi aplikimin e dispozitave të Kodit Tregtar që u përkasin Shoqërive me aksione

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 26 Maj 1934, Nr. 30)

Neni 1. — Noterët që redaktojnë akte kushtituese të shoqërive me aksione, detyrohen mbrenda tre ditëve prej redaktimit t'aktit me u dorëzue administratorëve të shoqërive, kundrejt nji diftese kopjen autentike të tyne për t'i depozitue në Seksionin e Tregtis të Ministris s'Ekonomis Kombëtare bashkë me kopjen të Statutit të Shoqëris dhe të akteve të tjera përkatëse kur ka; që permenden në Kap. IV të Tit. II të Pjesës II. të Kod. Tregtar.

Ministrija e Ekonomis Kombtare, kundrejt këtij depozitimi. i lëshon depozituesit një dërftesë.

Neni 2—Administratorët, nen kujdesin dhe përgjegjësin e Noterit, mbrenda afatit të nenit 111 të Kod. Treg., me një lutje tjetër, tue bashkangjitun vertetesen e lëshueme prej Ministris s'Ekonomiës Kombëtare dhe aktet kushtituese të permenduna ma nalt, në dy kopje, kanë me ju drejtue Gjykatës së Shk. së I. në qarkun

e të cilës ka me pasë qendren Shoqënija, dhe kanë me lypë përmbushjen e formaliteteve ligjore.

Lutja do të jetë e datueme dhe duhet të përmbajë:

a) nenshkrimet e kerkuesave, banesën dhe qindresën e tyne, dhe, në se administratorët janë të huej, shtetsin e tyne;

b) shenimin me datë e me numur t'aktit që tregon kompetencën e administratorëve për me kerkue permbushjen e formaliteteve ligjore;

c) shenim t'akteve të paraqituna në dy eksemplare;

ç) në rasë se veprimet i përkasin një Shoqërije të Sigurimit nga ato që tregtohen në nenin 2 të Ligjës me datë 21-II-1934, me shenim se asht bashkangjitun dhe akt-garancija e lypun prej nenit 2 të Ligjës së nalt-përmendun;

d) titullin dhe objektin si dhe qendren ku ka me veprue Shoqënija ose Agjencija.

Neni 3—Shoqënit e hueja me aksione, që kanë me funksionue në Shqipni, janë të detyrueme të konformohen me nenet e ma sipërme, tue bashkangjitë të gjitha aktet e shenueme në nenit 7 të Ligjës mbi aplikimin e Kod. Tregtar.

Shoqënit e hueja, që veprojnë aktualisht në Shoqni, janë të detyrueme me u konformue me dispozitat e tregueme në paragrafin e fundit të nenit 7 t'asaj Ligje.

Neni 4 — Kur paraqiten në gjyq aktet e nalt-tregueme, këto mbasi të protokollohen prej Kryesekretarit të Gjykatës së Shk. së I. në një protokoll të veçantë, i dorëzohet depozituesave një vertetesë ku shënohet emni e mbiemni i depozituesve, emni i Shoqënis, numri i akteve, objekti i kerkimit dhe data e depozitimit, dhe aktet i referohen gjyqtarit të rregjistrit për me çfaqë mendimin e tij mbi regullaritetin e kushtituimit të Shoqënis mbrenda 15 ditëve nga data e referimit t'akteve.

Neni 5 — Në muejin Dhetuer të ç'do viti, Gjykata e Shk. së I. emnon gjyqtar të rregjistrit një nga Ndihmës Gjyqtarët Filluer i cili ushtron funksionet e tij si Gjyqtar i rregjistrit që me 1 Kallnduer dhe deri në mbarim të Dhetorit t'atij viti.

Për vitin në vazhdim, gjyqtari i rregjistrit emnohet mbrenda një jave prej hymjes në fuqi të kësaj Rregulloreje dhe vazhdon deri në mbarim të këtij.

Kur gjyqtari i rregjistrit mungon ose pengohet emnohet prej

Gjykatës së Shk. së I. një nga gjyqtarët ose ndihmësat që si mbas Ligjës mbi Organizimin e Drejtësis zavendëson Ndihmës Gjyqtarin në Gjykatën Kolegjale.

Neni 6—Kur Gjyqtari i rregjistrit, shef mungesa ose të meta formalitetesh nder akte, urdhnon plotësimin e tyne para se t'i paraqesë aktet gjykatores për vendim.

Neni 7—Gjykata Kolegjiale mbrenda 15 ditëve prej paraqitjes t'akteve e mbledhun në Këshillë dhe në prani të Prokurorit këndon raportin e gjyqtarit të rregjistrit, ndigjon kundershtimet eventuale të Ministris së Ekonomis Kombëtare dhe mendimin e Prokurorit dhe, mbrenda tre ditëve shqypton në prani të Prokurorit vendimin relativ me anën e të cilit, si mbas rastit, verteton përmbushjen e konditave të nevojshme për kushtituimin e Shoqnis dhe konformitetin e aktit kushtitues dhe të statutit me dispozitat e ligjës, ose urdhnon plotësimin e të metave që konstaton mbrenda një afati të caktuem, ose refuzon lutjen e kerkuesave.

Neni 8—Kuer gjykata deklaron konformitetin e aktit kushtitues dhe të Statutit të Shoqënis me dispozitat ligjore, vendimi i komunikohet t'interesuemit dhe një kopje e këtij i dërgohet prej gjyqtarit të rregjistrit me ndermjetësin e Prokuroris së Shtetit, Ministris s'Ekonomis Kombëtare.

Ministrija e Ekonomis Kombëtare, mbasi vendimi të marrë formën e preme konformë § III, të nenit I të ligjës me datë 21-2-1934, i propozon Kryeministris me i-a parashtrue Mbretit dekretimin e lejimit të funksionimit të Shoqënis.

Neni 9—Kuer dekretohet lejimi i funksionimit të Shoqënis Ministrija e Ekonomis Kombëtare, kopjen e këtij Dekreti i'a referon Gjyqtarit të rregjistrit, i cili procedon në transkriptimin e aktit kushtitues dhe të dekretit në rregjistrin e ndodhun në Sekretarin e Gjykatës së Shk. së I. dhe njëkohësisht i transmeton Odës së Tregtis bashkë me visten e tij, kopjen e aktit kushtitues dhe të Dekretit Mbretnuer tue urdhnue transkriptimin në rregjistrin e Tregtis.

Neni 10—Në qoftë se në qarkun e gjykatës ku asht themelue Shoqënija nuk ka Odë Tregtije, kopja e aktit kushtitues dhe e Dekretit Mbretnuer të vistuem do t'i transmetohen Odës ës Tregtis së Tiranës për transkriptim në rregjistrin e posaçëm.

Neni 11—Kur gjykata vendosë refuzimin e kerkessë, kopja e vendimit i komunikohet administratorëve të Shoqënis.

Neni 12—Kundra vendimit të Gjykatës së Shk. I. që ka deklarue konformitetin e aktit kushtitues dhe të statutit të Shoqënis me dispozitat ligjore, si Prokuroria ashtu dhe Ministrija e Ekonomis Kombëtare kanë të drejtë kundërshtimi para gjykatës që ka dhanë vendimin, mbrenda tre muejve që nga data e komunikimit të vendimit, për Ministrin, dhe që nga data e shqyptimit të vendimit për Prokurorin e Shtetit, (shif § I dhe II të nenit 112 të Kod. Treg.)

Vendimi që ka me udhanë mbi kët kundërshtim asht i diktueshëm si mbas Procedurës Civile me perjashtim të konditës të akt-dorëzanis.

Neni 13—Kundra vendimit që refuzon konformitetin e aktit kushtetues dhe të Statutit të Shoqënis me dipsozitat ligjore, i interesuemi ka të drejtë rekurimi para Gjykatës së Diktimit mbrenda një vjeti që nga data e komunikimit të vendimit, si mbas rregullave të Proc. Civile.

Neni 14—Rregjistri i transkriptimit të Shoqënive para përdorimit duhet të jetë i numertuem dhe i vistuem prej Gjyqtarit të rregjistrit. Në ket regijster do të shënohet numri renduer, data e transkriptimit, emni dhe lloji i Shoqnis, qëllimi i shoqnis, emni e mbiemni, banesen ose qendresen administratorve e të Drejtorit, kapitali, kohë-vazhdimi, qendra e Shoqënis, shkurtimi i vendimit që aprovon konformitetin e aktit kushtetues dhe të Statutit me dispozitat ligjore dhe numrin dhe datën e tij, dhe tekstin e Dekretittit Mbretnuer.

Për ç'do Shoqëni do të mbahet një fletë e veçantë për me shënue gjithë ndryshimet që kanë me u ba si mbas paragrafit II, të nenit 113 dhe 189 të Kod. Tregtar.

Kur fleta e reservueme për një Shoqëni asht mbushë me notimet e bame, tue ba shenim përfund asaj faqeje mbartën në një fletë tjetër po me atë numur.

Neni 15—Rregjister i njëllojshëm me atë që shënohet në nenet e ma sipërme do të mbahet edhe n'Odën e Tregtis, dhe, n'atë të Kryeqytetit do të mbahen dy rregjistra të tillë që do të shërbejnë njani për qarkun e juridikcionit të Tiranës dhe tjetri për qarqet ku s'ka Oda të Tregtis.

Neni 16—Statuti, akti kushtetues, Dekreti Mbretnuer dhe buletini ose Fletorja Zyrtare ku asht botue, dhe aktet e tjera formojnë fashikullin e veçantë, tue pasë po atë numer renduer që ka Shoqnija në rregjistrin e posaçëm.

Neni 17—Mbasi të kryhen formalitetet e permenduna të transkriptimit, shkurtimi i këtij, në bazë të neneve 123 dhe 124 të Kodit Tregtar, duhet të botohet me gjithë hollësinat që lypin ato nene, mbrenda një mueji nga data e transkriptimit.

Kur botimi me anën e buletinit t'Odës së Tregtis nuk asht e mundun, si mbas paragrafit të mbramë të nenit 124 të Kodit Tregtar, bahet me anën e Fletores Zyrtare, nji eksemplar i së cilës bashkohet në fashikullin përkatës.

Neni 18—Aplikimi i sanksioneve të përmenduna në nenet 305 e 307 të Kodit Tregtar bahet prej Gjyqtarit të rregjistrit mbi denonsimin e Odës së Tregtis të qarkut ose të Ministris s'Ekonomis Kombëtare ose me kerkimin e Prokurorit.

Neni 19—Kur një Shoqni don me krijue një ose ma shum dega, agjensi ose përfaqësi, jashta jurisdiksionit të Gjykatores ku asht transkriptue Statuti i Shoqënis, i drejtohet Gjyqtarit të rregjistrit të vëndit ku asht transkriptue Shoqënija, tue tregue vendet ku kanë me u çelë degat, agjencinat ose përfaqsinat.

Gjyqtari i Rregjistrit, mbasi të bëjë notimet në rregjistrin përkatës, një përmbledhje të shënimeve të rregjistrit i a transmeton Gjyqtarit të Rregjistrit të qarkut ku do të çelet dega ose agjensija ose përfaqësija dhe ky ban rregjistrimin e duhun në rregjistrin e Shoqënive.

Gjyqtarët e Rregjistrit (i qendrës dhe i degave), lajmërojnë edhe Odat e Tregtis për me ba shënimet përkatëse.

Neni 20—Kur në rastin e paraqitjes së bilancavet të Shoqënive të Sigurimit ose ma parë, Gjyqtari i Rregjistrit konstaton se garancija ka mbetë ma pak se ajo e shënueme në § II të nenit 2, të Ligjës me datë 21-II-1934, fton Shoqënin me plotsue garancin mbrënda një mueji, dhe në rast mos-bindjeje, çështja i parashtrohet Gjykatës së Shk. së I., e cila vendosë ndalimin e Shoqënis në funksionimin deri në përmbushjen e garancis dhe ky ndalim shpallet në Fletoren Zyrtare dhe në fletoret e vendit.

Neni 21—-Gjyqtari i Rregijstrit aplikon ndeshkime kundra organeve shoqënore konforme Titullit IX të pjesës së dytë të Librit të parë të Kod. Tregtar, urdhnon dhe plotsimin e të mbetave pa vonesë.

Neni 22—Administratorët e Shoqënive Anonime dhe t'atyne me aksione të formueme para hyemjes në fuqi të Kod. Tregtar të Ri, detyrohen të paraqesin Dekretin Mbretnuer, i cili formon bazë për trankriptimin e tyne në radhorin e shoqënive.

Paraqitja e Statutit dhe t'akteve të tjera asht e nevojshme për të marrë shënimet që lypen për transkriptimin e tyne në rregjisrin përkatës.

Gjyqtari i rregjistrit përmbledhjen e këtij rregjistrimi i'a dergon edhe Odës së Tregtis për me ba rregjistrimin dhe shënimet e nevojshme.

Neni 23—Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Drejtësis dhe ay i Ekonomis Kombëtare, ngarkohen me zbatimin e kësaj Rregulloreje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 310/II datë 8-V-1934 të Kryeministrisë.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 8-V-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret Rregullores mbi aplikimin e dispozitave të Kodit Tregëtar që u përkasin Shoqënive me aksione.

Tiranë, me 19 Maj 1934.

ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Min. i P. të Mbrendëshme e Zar.
Ministri i Ekon. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 75

LIGJË, 19 Maj 1934.

Mbi disa ndryshime të Ligjës së Komuneve
(e botueme në Fletoren Zyrtare, 31 Maj 1934, Nr. 31)

Neni 1.

Nenit 11 të Ligjës së Komuneve i shtohet ky pargraf :

«Ndryshimet e parapame në paragrafin e ma sipërme, kurdoherë vihen në zbatim vetëm në fillim të Kallndorit të çdo vjeti.

Neni 2.

Neni 13 i Ligjës së Komuneve ndryshohet si vijon :

«Kur dy Komune bashkohen me nji, pasunija Komunale e secilës bashkohen dhe formojnë pasunin e Komunes së riformueme, tue respektue paragrafin e dytë të nenit 16».

«Viceversa, kur nji Komune ndahet në dy Komune, ose nji apo disa Katunde çkëputen nga Komunja ku kan ken lidh ma parë. dhe i aneksohen nji Komuneje tjetër, si në rastin e parë dhe në të të dytin ndamja e pasunis Komunale bahet si vijon :

Këshilli i Komunes së parë, me Këshillin e Komunes së krijueme rishtas, bashkohen nën kryesin e Kryetarit të Komunes ma të motçëm marin parasyshë kreditë dhe detat e Komunës së ma parshme dhe, në rast që kreditë i kalojnë detat, shuma e rezultueme ndahet në proporcion të dy popullsive që çkëputen nga njana tjetra.

Sa për pasunin komunale të pa-lujtëshme, këshilli i mbledhun si ma sipër në proporcjon të popullsis i ndanë këto dhe kur këto pasuni të pa lujtshme janë të pa ndarshme, komuna që merr pasuni ma tepër ja shpërblen komunes tjetër në të holla si pas çmimit të caktuem nga kjo mbledhje.

Mënyra e ndamjes së pasunis rreshtohet në nji proces-varbal dhe homollogohet në këshillin administrativ të Nënprefekturës ose të Prefekturës ku mvaret.

Në rast kontestimi; Këshilli administrativ vendos në mënyrë të preme».

Neni 3.

Nenit 16 të Ligjës së Komuneve i shtohet pas paragrafit të parë ky paragraf :

«Kryetari i Komunes përfaqëson pranë autoriteteve gjyqsore këtë person juridik».

Neni 4.

Nenit 18 të Ligjës së Komuneve i ndryshohen këto paragrafe :

Paragrafi i dytë i numrit 16 ndryshohet si vijon :

«Hapja e rrugave të ngushta mbrënda lagjes dhe katundeve edhe goditja, meremetimi, mirëmabjtjta dhe rregullimi i tyne, bahet si mbas planit të caktuem.»

Numri 18 ndryshohet si vijon:

«18) Për me largue rreziqet që rrjedhin nga inondatat e ujnave, rregullimin e projeve, vijave, dhe të kanaleve si dhe forci-

min e brigjeve me anë gardhiqesh ose muresh dhe, në rast kalamiteti kësodore, ndrrimi i rrjedhjes s'ujnave në bashkëpunim të popullsis s'interesueme.»

Neni 5.

Pas nenit 19 shtohet nji nen i ri me numrin përkatës a) «Ata që nuk kryejnë drejtë për së drejti punimet e detyrueme në paragrafin 16) të nenit 18 të Ligjës së Komuneve, mund të dërgojnë në kambën e tyne bedela, dhe në rast të kundërt si mbas sasis së ditëve të caktueme prej Ligjës për punim detyrohen me pagesë. Çmimin e nji ditë pune e cakton Këshilli i Komunes. Pagesat në fjalë mund të shpenzohen vetëm e vetëm për punimet e projektueme.

Neni 6.

Pas nenit 20 të Ligjës së Komuneve shtohet nji kaptinë e ré bashkë mê nene të reja :

TITULL III.

MËNYRA E RREGULLIMIT TË SHPENZIMEVE QË RRJEDHIN NGA PUNIMET E PËRBASHKËTA MIDIS DY OSE MA SHUMË KOMUNESH

Neni 7.

«Dy ose ma shumë Komune mbasi të meren vesht në mes të tyne me anën e Këshillave Komunale respektive, me aprovimin e këshillave administrative superiore, mund të shoqrojnë dhe të bashkpëunojnë për veprat vijuese:

a) për të ngrehun institute mirëbaese e shëndetsore;

b) për të ba udhët që të përfitojnë bashkarisht dhe t'i lidhin me skele, stacione ose me çdo qender tregtije tjetër;

c) për të pastrue e për të qerue prrojet e perbashkëta dhe për tharje moçalesh;

ç) për të përdorun Mjekë, Mami, Barnatore, Veterinarë, konduktorë e tjerë;

d) për të ble vegla bujqësore, për të sigurue dema, kuaj, desh, tjera race për seleksionim dhe për çdo veprim tjetër për interesa të përbashkëta.

Neni 8.

«Për kryemjen e veprimeve të përmenduna në nenin e masipërme, këshillat komunale të bashkë interesueme, me vota të mshefta zgjedhin secila Komune dy antarë që do të formojnë komisionin, i cili me ftesën e Prefektit ose të Nënprefektit dhe nën

kryesin e këtyne mblidhet me datë 1 Dhetuer të vjetit përkatës dhe caktojnë sasin e punimeve proporcionalisht me interesa përkatëse, ndajnë pjesen që i takon çdo komune si mbas shpalljes të përfitimit. Pjesa që i takon çdo komuneje, hyn në shpenzimet e domosdoshme të këtij.

Komisioni në fjalë mbasi vendos mënyrën e kryemjes së veprimeve, për vëzhgimin dhe mënyrën e administrimit të tyne, emnon dhe nëpunsat e nevojshem. Ky vendim me anën e Kryetarit të Komunes, i njoftohet këshillave komunale të bashkë interesueme».

Neni 9.

Vendimet e Komisjonit mikst, si mbas nenit të ma sipërme, merren me shumicë votash dhe i shtrohen aporvimit të Këshillit administrativ epruer.

Neni 10.

«Vendimet e Këshillit mikst i shtrohen apelimit mbrënda 10 ditëve që nga data e njoftimit pranë këshillave administrative eprore, ose, kur komisioni mikst kryesohet prej Prefektit, pranë Ministris P. Mbrendshme.

Vendimet e kundërshtueme që aprovohen, janë t'ekzetueme.

Neni 11.

Në qoftë se në komision mbetet ndonji vend akant, ky plotësohet me zgjedhjen e një antari tjetër; sa herë që rizgjidhet këshilli i Komunes, aqë herë duhet të rizgjidhen edhe anëtarët e Komisionit. Antarët e vjetër të komisionit deri sa të zgjidhen antarët e ri vazhdojnë në detyrën e tyne.

Neni 12.

Prefekti ose Nënprefekti ven në zbatim vendimin e komisionit, në qoftë se mbas vendimit të komisionit vepra do të kryhet me sipërmarrje, Prefekti ose Nënprefekti, në bashkëpunim me dy antarë të zgjedhun prej Komisionit mikst, kryen veprimet e adjudikatës; gjithashtu pregatitë kontratat e nevojshme të konstruksionit dhe nga buxheti i përbashkët siguron shpenzimet.

Neni 13.

Mbasi mbarohen punimet dhe veprimet e përbashkëta, Komisioni mikst i formuem si mbas nenit 8 të kësaj Ligje, likuidon llogaritë dhe ndan veglat e tjera si mbas proporcionit dhe përfitimin sejcilës komune t'interesueme, dhe kësisoj, shoqnimi midis Komuneve për ato vepra merr fund.

Vendimet e likuidimit mund të kundërshtohen prej Komuneve t'interesueme përpara këshillave administrative, të cilat vendosin definitivisht.

Neni 14.

Paragrafi i dytë i nenit 25 të Ligjës së Komuneve ndryshohet si vijon :

Numri i antarve për komunet që kanë nji popullsi deri në 4000 (katërmijë) frymë, asht katër, (4) dhe për çdo mijë frymë ose fraksion të sajë shtohet dhe nji antar, por numri i ktyne n'asnji rast nuk mund të kalojë numrin tetë (8).

Neni 15.

Nenit 29 të Ligjës së Komuneve i ndryshohet paragrafi ç) dhe i shtohet nji paragraf i ri e) si dhe dy paragrafe të tjera:

ç) të mos jenë Deputet, Antar'i këshillit administrativ të Prefekturës a të Nënprefekturës ose të Bashkis;

e) të ketë mbush moshën 25 vjeç.

Nji person me cilësitë e përmenduna në paragrafin ç) që zgjidhet antar komunal, ka të drejtë optimi. Në rast se nuk përdor këtë të drejtë në afatin e caktuem, konsiderohet dorëheqës nga antarija komunale.

Nji person që zgjidhet antar njikohësisht në ma shumë se një komune, që nga dita e rezultatit të zgjidhjes mbrënda tri ditëve detyrohet të deklarojë cilën komune preferon, për ndryshe konsiderohet antar i kmunes ku ka marrë ma shumë vota.

Neni 16.

Nenit 33 të Ligjës së Komuneve, i shtohet ky paragraf :

Lista duhet të përmbajë shënimet që vijojnë:

a) emnin dhe mbiemnin e atyne që kanë të drejtë votimi;

b) mjeshtrin ose profesionin e tyne;

c) moshen;

ç) në se din të këndojë dhe të shkruej dhe në se ka diplloma prej ndonji shkolle;

d) vendin e banimit.

Neni 17.

Nenit 36 të Ligjës së Komuneve i shtohet edhe ky paragraf:

Biletat e tregueme ma poshtë, konsiderohen si të pa qenë:

a) votat që nuk janë shkrue në biletat e ndame prej komisionit;

b) biletat e bardha;

c) biletat e pa-këndueshme;

ç) biletat që përmbajnë emna persona që nuk kanë të drejt të zgjidhen;

d) biletat që nuk përmbajnë identitetin e të zgjedhunve;

dh) biletat që përmbajnë emna ma shumë se numri i caktuem, tue fillue nga emni i parë deri në numurin e duhun, konsiderohen si të vlefshem, të tjerat quhen t'anullueme.

Neni 18.

Nenit 38 të Ligjës së Komuneve i shtohet ky paragraf :

Proces-verbali duhet të permbajë:

a) ditën dhe vendin e zgjedhjes;

b) emnin dhe mbiemnin e kryetarit dhe t'antarve të komisionit dhe kur janë emnue shqyrtues, emnat e këtyne;

c) numri i zgjedhësve të shënuem në listë;

ç) numri i votuesve;

d) numri i biletave të shpërndame, sasija e biletave të hedhuna n'arkë dhe numri i biletave t'anullueme;

dh) emni dhe mbiemni i të zgjedhunve dhe numri i votave të fitueme për sejcilin person».

Neni 19.

Pas nenit 40 të Ligjës së Komuneve shtohet nji kaptinë e ré me nenet që vijojnë :

TITULLI V.

DISPOZITA NDESHKIMORE

Neni 20.

Nëpunsat që tue përfitue nga influenca e nëpunsis së tyne drejtë për së drejti ose tërthurazi, shtyjnë ose friksojnë zgjedhësit për votimin e këtij ose të atij, përveç që pushohen nga detyra me një herë, ndeshkohen edhe prej tre muej deri në nji vjetë burgim.

Neni 21.

Kushdo që për të humbun të drejtën legjitime të votës të nji personi, ose për t'i akordue këtë personit që nuk e ka, vjedh, mëshef ose shdukë listat e votimit a çdo dokument tjetër, dënohet nga tre deri në gjashtë muej burgim.

Në qoftë se ky delikt asht krye prej një nëpunësi të ngarkuem me veprimin e zgjedhjeve, dënimi dyfishohet.

Neni 22.

Pa ndonji shkak të arësyeshem dhe të justifikuem Kryetari dhe anëtarët e komisionit të zgjedhjeve që nuk vinë në krye të detyrës së tyne diten e votimit n'orën e caktueme, ose mbasi vijnë largohen pa ndonji shkak, ndeshkohen me 20 deri 100 fr. ari gjobë.

Neni 23.

Kushdo që guxon me ba që të reshtohet emni i tij në listën e votimit tue tregue nji emën ose një cillësi falso, ose tue mëshef gjendjen civile të vërtetë, don me fitue të drejtën e votimit me këtë mënyrë, ndeshkohet me një gjobë që nga 20 deri në 100 fr. ari dhe deri në tre muej burgim.

Neni 24.

Kushdo që korrupton me të holla zgjedhësit për të fitue vota vetë, ose për personat që dëshëron ose për me ndalue votën në favorin e tjetrit, dënohet me dy deri në gjashtë muej burgim. Po me këtë ndeshkim dënohen edhe ata që pranojnë propozimin e votimit me të holla.

Neni 25.

Kushdo që në rast votimi shduk, vjedh, ose shumzon ose ndryshon tekstin e biletave të votimit, ndeshkohet që nga nji deri 3 muaj burgim. Në qoftë se faji i sipërmë asht krye prej një personi të ngarkuem me zgjedhje, ndeshkimi dyfishohet.

Neni 26.

Ndeshkimet e caktueme për fajet e tregueme në këtë titull, vendosen pa u marrë parasysh anullimi i zgjedhjeve.

Neni 27.

Deliktet që nuk janë parapa në dispozitat e këtij titulli i shtrohen dispozitave të Kodit Penal.

Neni 28.

Padinat që u përkasin fajeve që përshihen në këtë titull, ngrehen prej t'interesuemve ose mbi ankimin e komisionit të zgjedhjeve ose drejt për së drejti prej Prokurorit të qarkut ku shvillohen zgjedhjet.

Padinat kësodore parashkruhen pas dy muejve që nga data e përfundimit të zgjedhjeve.

BKSH

Neni 29.

Nenit 42 të Ligjës së Komuneve i shtohen dhe paragrafe të tjerë të cilat marrin numrat vijues si vijon :

17) Të ruajë vijat e ujit dhe kur të ndodhin ngjarje të rezikshme si inondacjon, zjarm, termet, renim shtëpijash e tjerë duke marrë masa të shpejta e efikace të lajmërojë me një herë edhe autoritetin epruer. .

18) Me anën e policis komunale të ruajë ndërtesat, kasollet, stanet, bimët e tjera, nga zjarmi;

19) të kontrollojë kafet, magazinat, restaurantat, hotelet, hanet, furrat, kasapët, banjat, tregun dhe gjithë vendet publike dhe ndër këto të zbatojnë rregullat e higjenis;

20) të ketë kujdes që mjetet e transportit të jenë në rregull dhe të forta dhe të mos transportojnë ma tepër pasagjer ose barrë nga fuqia e tyne dhe kështu t'evitojë çdo aksident;

21) të mbulojë jashtë fshatrave me gropa të hapuna në thellësin e duhun kafshë të ngordhuna dhe shpenzimet t'i nxjerrë nga të zotët;

22) të ndalojë çdo çfaqje theatrale, cinimatografike dhe çdo pamje veprimi e botimi tjetër që asht kundra moralit publik.

Neni 30.

Nenit 43 të Ligjës së Komuneve i shtohen dhe paragrafe të reja të cilat marrin numrat rënduer si vijon:

14) të kontrollojë e të vezhgojë gjithë punimet, konstruksionet, miratimet e kryeme n'emen të komunes drejt për së drejti prej kësaj ose në sipërmarrje;

15) Kryetari mbasi të ketë marrë aprovimin e autoritetit epruer pranon dhurimet dhe testamentet që janë ba në favor të komuneve dhe detyrohen me i realizue këto;

16) të plotësojë pikërisht të gjitha detyrat e ngarkueme për Arësimin filluer të komunes së tij;

17) të mbajë e të ruaj mirë gjithë ndërtesat e veprat që kanë një vleftë historike dhe arkeollogjike;

18) të mbledhë fëmijt me prindë të pa njoftun të lemë aty këtu, e të kujdesohet për këto.

Neni 31.

Paragrafe të rea që i shtohen nenit 55 të ligjës së komuneve:

19) Caktimi i çmimit të sendeve ushqimore;

20) Kur qendra e komunes ka formën e nji qyteti në mbrendësin e tokës, ose në breg të detit dhe për qarkullimin e popullsis nevojiten mjete tranpsortimi të mbrendshme: si karro, qerre, kaike, dhe barka, Komuna detyrohet në tre ose në gjashtë muej nji herë të përpilojë një tarifë për këto sherbime qytetore.

Neni 32.

Paragrafet 2) 9), 12), e 13 të nenit 10 të ligjës së Komuneve ndryshohen si vijon:

2) T'ardhunat nga tokat, pyjet, kullosat e pasunit e tjera të Komunes që si mbas ligjëve në fuqi formojnë pasunin e saj.

9) Taksa e gjakut dhe e konsumit që do të merret prej bagtive e gjasë së gjallë që theren për t'u shitun.

Kjo taksë nxiret në ketë mënyrë:

	Taksë gjaku fr. ari	Taksë konsumi fr. ari
a) Për ka, lopë, buall e buallicë	2	3
b) Për muzat, mushqerre, dem dhe derra që peshojnë në 30 kg. e sipër	1	3
c) Për viçat dhe derrat deri 30 kg.	1	1
ç) Për desh, dele, cjepë dhe milore dhe ftuja	0.50	0.50
d) Për kingja dhe keça	0.20	0.30

Për kafshët e bagtit që nuk janë nga këto, zbatohen taksat e kategoris analloge.

Kafshët dhe bagtit e theruna që sillen prej së jashtmi për me u shitë ose konsumue në rrethin e një Komune i shtrohen taksës së gjakut dhe të konsumit; por kur, me deftesë të rregulltë provohet se taksa e gjakut asht pague me një Komune ose Bashki tjetër, atëherë paguhet vetëm taksa e konsumit.

Kafshët dhe bagtit e theruna që shiten në rrethin e një Komune pa pague taksat përkatëse, quhen kontrabantë dhe në ketë rast paguhet pesë fish taksa perkatëse.

10) Numri 10 i Nenit 110 i Ligjës së Komuneve abrogohet dhe, shit-blerjet e gjasë së gjallë nepër katunde zbatohet Neni 88 i Ligjës së Bashkis.

12) Zejtarët dhe tregtarët që, për heren e parë çelin lokale me qëllim tregtije, si edhe ata që i kanë të çeluna por deshërojnë me ndryshue zejen ose tregëtin e tyne, detyrohen t'i paguejnë Komunes një taksë leje prej 2 deri 20 fr. ari.

Për veç takses të njiherëshme, Komuna merr edhe nji taksë tjetër prej 1, deri në 5 fr. ari në vjet për ushtrimin e zejes dhe, kur konstatohet një ndryshim në përmbajtjen e zejes së maparshme, çeshtja i referohet Këshillit Komunal për regullimin e taksës.

13) Të gjitha mjetet e transportit, përveç ato që i përkasin Shtetit ose Komunes detyrohen të paguejnë taksen e rregjistrimit si vijon:

a)	Për karrocat me dy kuaj	Fr. ari	5	në muej
b)	Për karocat me nji kalë	»	2.50	» »
c)	Për qerret me buej e me qé	»	1	» »
ç)	Për karrot me dy kuaj	»	2	» »
d)	Për karrot me nji kalë	»	1	» »
dh)	Për karrot me gomar	»	0.50	» »
e)	Për kamionet deri me 1500 kilo	»	30	» »
ë)	Për kamionet deri me ma shumë se 1500 kilo	»	50	» »
f)	Për automobilat deri me katër veta	»	10	» »
g)	Për automobilat që marrin ma se katër veta	»	15	» »
gj)	Për autobuset që marin deri në 10 veta	»	15	» »
h)	Për autobuset që marrin ma se dhjetë veta	»	25	» »
i)	Për motorçikletat	»	10	» »
i)	Për biçikletat	»	1	» »

Kjo taksë parapaguhet në këste tremujore ose gjashtëmujore.

Mjetet e transportit që nuk janë të rregjistrueme rregullisht në Komune ose nuk asht përsëritur rregjistrimi i tyre brenda tre ose gjashtë muejve, ndalohen prej ushtrimit dhe të zotët e tyne detyrohen me pague taksen dyfish.

Karrot dhe qerret për të hypun me buaj, me qé, ose gomar dhe që përdoren eksklyzivisht për nevojat e bujqëve përjashtohen nga taksa.

Mjetet e sipër-tregueme që përdoren për bartje teshash tregtare ose bujqësore me qira për llogari të tjetrit, i shtrohen taksit që tregohet në rubrikën c), ç) dhe dh).

Kushdo që mjetet e sipër-tregueme do me i përdorë për bartje me qira, detyrohet me i denoncue dhe rregijstrue në Komune tue i ngjitë një numur si dhe shenja «B» dhe «Q» (bartje me qira).

Në rast që karot dhe qeret kësodore të dekllarueme për nevojat bujqësore përdoren për bartje me qira gjobiten me 20 fr. ari.

Gjithashtu për numrat e tabellave që Komuna asht e detyrueme me i vue mjeteve të transportit merren këto taksa :

a) Për karrocat	Fr. ari	1
b) Për karrot	» »	1
c) Për qerret e rregjistrueme mbrenda jurisdiksionit të Komunes	» »	1
ç) Për qerret automob, kamionet e autobuzet	» »	5
d) Për motorçikletat dhe biçikletat	» »	1
dh) Për motorat barkat dhe çdo mjet tjetër lundrimi	» »	5

Për ushtrimin e mjeshtris së tyne kundrejt një taksi një fr. ari. Komuna u lëshon leje identitet barkarëve, drejtusve të barkave dhe karocierëve tue përsëritë pa të holla kontrollimin e tyne në fillim të çdo vjeti.

Neni 33.

Numri 7 i Nenit 110 i Ligjës së Komuneve abrogohet

Neni 34.

Nenit 110 të Ligjës së Komuneve i shtohen dhe paragrafe të reja të cilat marrin numurat renduer si vijon :

T'ardhunat ordinare të Komunës janë :

23) Banuesit e qarkut komunal për çdo leje gjutie që marrin nga Zyrat e Financës detyrohen me i pague arkës Komunale të vendit të tyne fr. ari 2 (dy);

24) Nga çdo adjudikatë publike që bahet në qarkun e Komunës mbi sende të lujtëshme e të palujtëshme, sipërmarrje, konstruktimi, reparimi të çdo lloji qofshin. Komuna merr 2% përveç ankandeve që bahen për nxjerrjen e kontributave jo të bazueme në konvencionet mbi shumën totale të çmimit që ka me rezultue n'adjudikatë.

25) Komuna ka të drejtë të marrë një taks konstruktimi që nga 5 deri 20 fr. ari si mbas randësis së ndërtesës si shtëpi, magazinë, han dhe gazino;

26) Komuna ka të drejtë të marrë nji taks të përvjetshme mbi mullit drithi, voj-ullini, orizi, si edhe mbi distilat e shajakut ose tirqe që nga 5 deri 20 fr. ari dhe për mullit kësodore që punojnë me motor, si mbas fuqis së kuajve, për çdo fuqi kali 2 fr. ari.

27) Komuna ka të drejtë me marrë një taks leje ushtrimi për vendet e defrimit kur çelen për herën e parë që nga 5 deri 25 fr. ari;

28) Në zevendsim të takës së tepricës së kullotes, Komuna ka të drejtë me marrë një taksë 0,03 fr. ari për krye mbi të gjitha kaf-

shët e bagtit e trasha e t'imta përveç qingjave, keçave, shtazëve të trash që përdoren për pendë dhe atyne që nuk kanë mbushun moshën motake, dhe thijve deri në gjashtë muaja.

E drejta e kësaj takse i takon Komunës ku asht rregjistrue i zoti i gjas dhe, nxiret në bazë të rregjistrimit të xhelepit.

Neni 35.

Caktimi i taksave direkte që shënohen në nenet e ndryshme te kësaj Ligje dhe të Ligjës së Komuneve, bahet prej Këshillit Komunal brenda dy muejve të parë të vitit financjar dhe listat emnore me taksat përkatëse për sejcilin kontribuent çpallen në vendet ma të dukëshme të katundit.

T'interesuemit kontribuentë mbrenda 15 ditve prej datës së shpalljes së listave kanë të drejtë kundershtimi me gojë ose me shkresë në Këshillin Administrativ të vendit, i cili mbrenda 15 ditëve prej datës së kundershtimit vendos definitivisht.

Neni 36.

Nxjerrja e taksave e t'ardhunave të ndryshme dhe të gjobave bahet prej sekretarit të Kmunës ose tagrambledhsit, atje ku ka të tillë, në bazë të kontratave të pajtimit dhe të listave emnore të taksave direkte të vertetueme rregullisht dhe të vendimeve që caktojnë gjobat, tue ndjekun proceduren e caktueme në ligjen mbi nxjerrjen e t'ardhunavet të Shtetit.

Neni 37.

Nenit 110 të Ligjës së Komuneve i shtohet ky paragraf me numrat renduer si vijojnë:

T'ardhunat e jashtëzakonshme të Komunes janë këto:

1. — Vlefta e pasunis komunale e shitun ose e shkembyeme;
2. — Dhuratat e destinueme për Komune në mënyrë faljeje a testamenti;
3. — Të hollat e huat e kontraktueme;
4. — Shuma e të hollave t'akordueme Komunes prej Arkës së Shtetit si ndihmë subvencioni;
5. — Çdo ndihmë tjetër e dhanun Komunes;
6. — Tepërica e t'ardhunave ordinare;
7. — Çdo e ardhun tjetër povizore dhe e parapame e Komunes.

Neni 38.

Nenit 111 të Ligjës së Komuneve i ndryshohet paragrafi i parë si vijon;

Shpenzimet e Komunes janë:
a) Shpenzime ordinare ose të domosdoshme;
b) Shpenzime të jashtëzakonshme.

Neni 39.

Nenit 111 të Ligjës së Komuneve i shtohen dhe disa paragrafe të reja të cilët marrin numrat renduer si vijon:

15) Fondi i posaçem per formimin e kapitullit të nevojshëm për ngrehjen e ndertesës së ré për Komunen;

16) Shpenzime për pajtimin e Fletores Zyrtare;

17) Fond për qira të ndertesave dhe të pasunive të zanuna prej Komunes;

18) Shpenzime për ushqim e mjekim për rritjen e fëmijve të lanun, per dergimin e të sëmurve në spital, për dërgimin e të kafshuemve nga qent e terbuar në stasione antirabike kur këta janë të vorfen dhe për varrimin e të vobegtëve.

19) Shpenzime për demostracicne e zbukurime të tjera në të kremte Kombëtare;

20) Shpenzime për zgjedhje komunale;

21) Shpenzime për permirsimin e racës të kafsheve e të bagtive dhe për shtimin e këtyne, blerje kafshe race, pregatitjen e vendit për këto, ushqimi i këtyne; shpenzime për vepra përmirësimi që do të kryhen në shoqërim me një ose ma shumë komune tjera;

22) Shpenzime për përhapjen e kultivimit të tokave në mënyrë sjentifike seleksionim e dizinfektim fare, blemje maqinash për me shimë, për të korr e tjera, blemje pompash për çperkatje vneshtash në mënyrë sjentifike e me mjete kimike.

Neni 40.

Nenit 111 i shtohet edhe nji paragraf i ri:

Shpenzimet e jashtëzakonshme janë:

1) shpenzime për konstruksione e ngrehje ndertesash të reja;

2) shpenzime provizore të pa parapame.

Neni 41.

Pas nenit 113 të Ligjës së Komuneve shtohen dhe dy nene të ri:

Pasunija komunale në pikpamje mbrojtjeje e imuniteti, konsiderohet pasuni e Shtetit.

Neni 42.

Pasunit e Komuneve janë:

1) Patrimoniale;

2) domaniale.

Të parat janë ato pasuni që nuk janë të destinueme për sherbimin e popullit; këto pasuni mund të sekuestrohen t'ipotekohen ose të shiten për detat e Komunes.

Pasunitë që janë destinue për utilitet publik, nuk munden as të shiten as t'ipotekohen as dhe të sekuestrohen.

Neni 43.

Pas Nenit 137 të ligjës së Komuneve shtohen dhe këto nene të rea

Për sa asht e mundun çdo katund do të përpilojë një plan për rrugat e tij dhe mbi mënyrën e konstruktimit të shtëpive.

Plani pregatitet prej një tekniku dhe me ndermjetësin e Prefekturës ose të Nenprefekturës përkatëse i referohet Këshillit Administrativ të Prefekturës, i cili e aprovon definitivisht mbasi të ketë marrë ma parë dhe mendimin e Ministris së P. të Mbrendshme.

Plani do të jetë në katër kopje. Njena mbetet në pleqësin e katundit, e dyta i paraqitet Komunes, e treta Prefektit ose Nenprefektit dhe e katerta Ministris së P. të Mbrendshme.

Ndertimi i shtëpive dhe i godinave do të bahet në konformitet me këto plane.

Neni 44.

Kur e lyp nevoja e sherbimeve të Komuneve të parapame prej kësaj ligje, Komuna ka të drejtë shpronsimi për dobi publike si mbas ligjëve në veprim.

Neni 45.

Tokat që do të lypen për sherbimin e treguem në nenin e masipërmë në rast që janë pasuni Shtetnore i koncedohen Komunes gratis.

Godinat që okupojnë aktualisht Komunat në rast që ndodhen godina Shtetnore i transferohen gratis n'emen të Komunes.

Neni 46.

Për punët të cilat simbas kësaj ligje janë konsiderue të detyrueme, gjith mashkujt e popullsis të qarkut të Komunes që nga mosha 18 ekslusiv deri në 58 vjeç inklusiv detyrohen me prestim

punimi. Detyrimi me punë, sido qoftë nuk do të kalojë 10 ditë në vjetë dhe do të kryhet mbrenda qarkut kudo që të shenohet prej Komunes.

Perjashtohen nga ky detyrim:

Sakatët, të burgosurit, ushtarët, e gjindarmët të çdo arme qofshin nxânësit e shkollave, për perjudhën e vazhdimit në shkollë. funksionarë fetarë si dhe ata banorët e Komunes për atë vjetë mbrenda të cilit banojnë ma pak se 6 muej në Shqipni.

Kur nji detyrues qendron në Shqipni jashtë komunes ku asht rregjistrue, obligimin e tij me punë, me bedel ose me të holla, e kryen në Komunen ku asht rregjistrue.

Neni 47.

Paragrafi i dytë i nenit 144 i ligjës së Komuneve ndryshohet si vijon:

Rroga e Kryetarit të Komunes zbritet në 200 fr. ari dhe ajo e Sekretarit në 150 fr. ari në muej.

Neni 48.

Ministrija e P. të Mbrendëshme, e Drejtësis dhe e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Neni 49.

Kjo ligjë hyn në fuqi 15 ditë mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi disa ndryshime të ligjës së Komuneve, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 186-I datë 4-V-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 19 Majë 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

BKSH

Nr. 76.

LIGJË, 23 Maj 1934.

Mbi krijimin e disa taksave në favor të Komuneve

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 31 Maj 1934, Nr. 31).

Neni 1.

Mbi gjithë sendet që importohen në Shqipnië merret nji taksë 4% (katër për qindë) mbi taksën doganore në favor të Komuneve.

Neni 2.

Shtesa 10% mbi taksën doganore që merret dhe u ndahet Bashkive në konformitet me nenin 78 të Ligjës së Bashkive, zbritet me 9% (nandë për qindë) për Bashkitë dhe rresti 1% (nji për qind) disponohet për Komunet.

Neni 3.

Mbi taksën e tatim fitimeve, dhe ato noterjale, gjyqsore dhe ipotekore, shtohen 10% (dhetë për qind) në favor të Komuneve.

Neni 4.

Taksat e përmenduna në nenet 1 e 2 nxirren në menyrën e caktueme në nenin 81 të Ligjës së Bashkive.

Ministrija e Punve të Mbrendëshme në fund të gjashtë mujeve cakton pjesën që i takon çdo Komune, si mbas nevojës së çfaqun e t'aprovueme në budgetin e sejcilës dhe a u dërgon këtyne me anë të Bankës Kombtare ose me mjete të tjera.

Neni 5.

Mbi taksat e parapame në nenin 3 vërtetohen dhe nxirren njikohësisht me taksat Shtetnore.

Për t'ardhunat nga këto mbi taksa, krijohet nji kapitull i posaçëm në pjesën e parapamjevet të buxhetit preventiv Shtetnor, gjithashtu krijohet edhe nji kapitull tjetër në pjesën e shpenzimeve të buxhetit të Ministris së P. të Mbrendëshme.

Prelevimi i t'ardhunave nga Arka e Shtetit bahet me anë mandatash direkte të lëshueme në favor të Komuneve prej Ministris së P. të Mbrendëshme mbi kapitullin përkatës të buxhetit të saië e në kufi të nxjerrjeve që kanë me i u njoftue prej Ministris së Financavet kaq Ministri së P. Mbrendëshme sa, edhe Këshillit Kontrollues në mbarim të çdo tremujori financjar.

Neni 6.

Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj ligje.

Neni 7.

Kjo Ligjë hyn në fuqi qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e ligjës mbi krijimin e disa taksave në favor të Komuneve, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 166-1 datë 21-4-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 23 Majë 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme MUSA JUKA

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 77.

LIGJË, 19 Maj 1934.

Kundra mashtrimeve në pregatitjen e në tregtimin e pijeve alkoolike dhe t'uthllave

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 4 Qershuer 1934, Nr. 32).

T I T U L L I I.
Vena

Neni 1.

Quhet venë, vetëm prodhimi i rrjedhun nga vlimi (fermentacjoni alkoolik i langut të rrushit të freskët o pak i thatë, i bashkuem ose damas prej bërsivet.

Gjithë venat qi nuk i përshtaten përshkrimit të sipërmë, konsiderohen jo të thjeshta. Gjitheashtu konsiderohen jo të thjeshta venat e pregatituna, tue përdorun nji pjesë rrushi të thatë ose langu i rrushit i holluem me ujë, ose i perzimë me vena të dyta ose me ujë të mbetun nga të lamet e bërsive.

Neni 2.

Asht e ndalueme pregatitja dhe tregëtimi i venave jo të thjeshta. Ky ndalim përfshinë edhe venat me gradë alkoolike ma t'ulët se 8% në volum.

Neni 3.

Mushtave e venave u asht e lejueme vetëm shtesa e këtyne landëve: tharmë (acido) thartarike, tharmë citrike, tanin, anydride sulfurose, bisolfit e metebisolfit potasik, karbonat e fosfat ammonike, (këto dy të fundit vetëm ndër mushte me qellim lehtësimi të vluemit alkoolik), karbonat potasik, karbonat kalçik, tërtrat neuter potassik enoçianin e nxjerrun nga lëkurat e rushit të zi.

Asht e ndalueme me shtue ndër mushta e ndër vena ç'do landë tjetër qi nuk asht përshkrue në ketë nen; mushtat e venat qi përmbajnë landë të tjera, konsiderohen jo të thjeshta.

Neni 4.

Landët e lejueme për të cilat banë fjalë neni i ma sipërmë, duhet të jenë produkte të tregtueshme e kimikisht të thjeshta. Do të konsiderohen jo të thjeshta gjithë ato vena të cilave u asht shtue landë e lejueshme, por qi përmbajnë edhe landë të tjera, të cilat mund t'i ndryshojnë kompozicionin kimik ose karakteret vehtjake të venës.

Neni 5.

Në pregatitjen dhe ruejtjen e venës, janë të lejueme përdorimi i sendve të poshtë-shenueme:

a) Kthjellime me të bardhë veje, me albumin të thjeshtë, me osteokolla dhe ihtiokolla e me dhé Spanjet;

b) vojit bimuer e voj vazelinit pa ngjarje, me qelim çdukje i të metave të shijes e t'erës në vendë ose për me mprojtë venat nga të vlumit (fermentacjonet) e damshme;

c) thingjillit bimuer ose kockash me qellim çdukjeje i të metave qi mund të ketë dhe për t'i hjekë ngjyrën;

ç) të rivluemit (fermentacjon) prej të cilit shkaktohet të vluemit prej rrushit të freskët ose pak të thatë;

e) çdukja e thartinave (acidite) me sistemin e pastorit dhe rifreskimi i venës;

ë) shkumzimin e venës tue përdor anidrit carbonik të thjeshtë.

f) përdorimi i fermentave të selekcjonueme.

Neni 6.

Asht e ndalueme shitja e mushtave ose e venave qi përmbajnë ma shumë se 200 m]m gram për litër anidrid solforos të plotë (totale) ose ma shumë se 20 m]m gram për litër anidrid solforos të lirë.

Nuk mundë të vehen në tregti për konsumin, venat qi përmbajnë ma shumë se gr. 2.50 për litër tharmë fluruese (acidità volatile) e cila matet si tharmë acetike; gjith'ashtu asht e ndalueme shitja e venave të prishuna për shkak sëmundjeje si: të këthyemit e shitjes naturale në majhosh, formimi i penjeve si konsekuencë sëmundjejej etj. ose që e paraqesin të meta se pse kanë marrë shije e erna të tjera të neveritshme si erë myku, erë druje, erë kalbësine e tjera.

Neni 7.

Asht e ndalueme pregatitja dhe tregëtimi i venave të dyta e të venave të rrjedhuna nga të lamit e bërsive.

Neni 8.

Cilado venë e prodhueme në Shqipni, ose e importueme që përmban ma shumë se 2% sulftata (si sulfat potasik), konsiderohet jo e thjeshtë.

Neni 9.

Për pregatitjen e venave të veçanta shkumuese t'ambëla, të sheqerueme liquoroze, ose të venave mjeksore me përjashtim t'atyne të përshkrueme me porosi mjeku, ose të mushtave të pa vluešhme etj. si mbas lutjes qi do të paraqesi i interesuemi, Ministrija e Ekonomis Kombëtare mundet me lejue përdorimin e sakarosit, t'alkoolit etilik të raktifikuem, e të konjakut, me konditë qi përdorimi i tyne të bahet për sasinë e parapame ndër parime racionale të enologjisë.

TITULLI II.

Uthullat

Neni 10.

Quhet uthull vetëm produkti qi del nga të vluemit uthulluer i venës së thjeshtë (fermentacjon).

Konsiderohen jo të thjeshta gjithë uthullat qi nuk i gjegjen përshkrimit të ma sipërmë, uthulla, e vueme në tregti duhet të përmbajnë së paku 4% tharmë acetike në peshë.

Neni 11.

Asht e ndalueme pregatitja e tregtija e uthullave jo të thjeshta.

Neni 12.

Asht e ndalueme me perdorë për pregatitjen e uthullave gjithë ato vena që nuk janë të thjeshta, ose qi janë të sëmuta tue u këthye (girato) në shije majhosh (thartë-ambël) (agro-dolce) etj., ose qi kan të meta shije, si dhe ato qi përmbajnë erna të këqija.

Neni 13.

Në pregatitjen e uthullës janë të lejueme përdorimi i këtyne sendeve:

a) të holluemit e venës me ujë, i bamë vetëm ndër lokale të caktueme për pregatitjen e uthullës kuer ky hollim nevojitet për pregatitjen e rregullt të sajë;

b) për kthjellimin e uthullës, lejohet vetëm përdorimi i qumështit dhe i landëve të tjera kthjelluese qi janë të lejueme për vena në ketë ligjë;

c) përdorimi i bojës qi quhet enocianin e cila del nga lëkura e kokrave të rushit, ose përdorimi i sheqerit të djegun me qellim qi t'i shtojë ngjyrjen.

Neni 14.

Asht e ndalueme me i shtue uthullave tharmë acetike. Tharmi acetik qi gjindet ndër lokale ku punohet uthulla, konsiderohet si e shenueme për pregatitjen e për forcimin e sajë; dhe prandaj quhet nji kundra-veprim i dispozitave, të kësaj ligjë.

Neni 15.

Asht e ndalueme shitja e uthullave të prishuna; me erna kalbësinash, me gjymëza (anguillule) ose qi kanë marrë shije dhe erna të tjera të neveritshme.

Neni 16.

Në pregatitjen e turshinave të vueme n'uthull, asht e lejueme vetëm përdorimi i uthullës së thjeshtë.

TITULLI III.

Pijet alkoolike të rrjedhuna nga destilimi.

Neni 17.

Gjithë pijet alkoolike për me u vue në tregti, duhet të kenë nji gradacjon alkoolik të pakten 30 gradë % në volum g. lusak. Këto

prodhime qi vehen në tregti me nji gradacjon ma t'ulët se sa asht caktue, konsiderohen të nxjerrun në tregti në kundërshtim me ketë ligjë.

Neni 18.

Quhet konjak vetëm prodhimi qi merret nga distilimi i venës i konservuem dhe i ndejtun nji kohë pak a shumë të gjatë në fuçija prej lisi pa shtesë landësh aromatike, asencash ose landë ngjyrjesh, ose sheqer të djegun.

Neni 19.

Quhet raki vetëm prodhimi qi nxirret nga distilimi i pemëve të freskëta të fermentueme ose nga distilimi i bërsive ose i venës pa shtesë landësh të tjera t'afta për me shkaktue vluemjen.

Neni 20.

Për me i dhanë ngjyrje rakies, lejohet vetëm përdorimi i gjethëve bimësh.

Neni 21.

Për pregatitjen e mastikës asht e lejueme vetëm me i shtue prodhimit të distiluem, esencë anasoni (anices) ose lang farësh të bimës qi quhet anisum pimpinella stelatum.

I vetmi alkool i ratifikuem që lejohet për me ba mastikë me vaj anasoni, asht alkool etilik.

Neni 22.

Në pregatitjen e skropit (bërsi e lang bashkë) të pemëve bërsive të rushit dhe të venës të destinueme për destilim, asht e ndalueme shtesa e landeve të sheqerta si: sakarozi-melase, mjalti, rushi i thatë e të tjera.

Pijet alkoolike të nxjerruna me anë të distilimit, duhet të jenë të nxjerruna nga skropi i pemëve, nga bërsinat e venës dhe nga venat.

Neni 23.

Pijeve të prodhueme nga distilimi i pemëve, asht e ndalueme me u shtue landë-ngjyrje, aromatike o esenca, me përjashtim të rakies si mbas përshkrimit të Nenit 20.

TITULLI IV

Liquorët

Neni 24.

Pijet e idhta e liquoret, me përjashtim t'atyre të parapaeme në

BKSH

Nenin 2, dhe ato të prodhueme nga distilimi i pemëve, duhet të jenë të pregatituna vetëm me alkool itilik e ratifikueme në 94-95 gradė G. L.

Neni 25.

Kush don me punue e me qellim tregtije, pijet alkoolike të përshkrueme me nenin e ma sipërmë, duhet t'i paraqesi nji lutje Ministris s'Ekonomiës Kombëtare, tue cilësue landët dhe sasinë e tyne qi don me përdorë në pregatitjen e pijeve, si dhe emnin qi don me i udhanë këtyne. Pasi të kenë marrë pelqimin e Drejtoris së P. Shëndetsiës dhe të Laboratorit Kimik, Ministrija e Ekonomis Kombëtare mundet me dhanë leje për punimin dhe shitjen e këtyne pijeve.

TITULLI V.

Mbi kqyrjet dhe masat përkatëse:

Neni 26.

Cilido që pregatit me qellim shitjeje, qe shet ose tregton prodhime të shënueme në ketë ligjë, asht i detyruem, kudo qi të ndodhet malli i tij me dhanë kampjon, mbi kërkimin e Prokurorit e Oficerave dhe t'Agjentave të Rojes Kufizore, të Kryetarëve të Komuneve, Graduatëve dhe t'Agjentave të Policis ose të Gjindarmeris, ose të Delegatëve të Ministris s'Ekonomiës Kombëtare si dhe të gjithë nëpunësave të financavet.

Kur pregatitësi, shitësi, tregëtuesi ose përfaqësuesi i tyne, nuk ndodhet prezent ose nuk konformohet në dispozitën e sipërme, i ngarkuemi për marrjen e kampjonit vepron në prezencën e Kryeplakut të lagjes ose të katundit ose të zavendësit të tyne.

Neni 27.

Marrja e kampjoneve do të bahet veçanërisht për çdo lloj prodhimi ose për lloje të ndryeshme të nji prodhimi. Seicili kampjon duhet të ndahet në katër pjesë, tue mbushun katër shishe me nji përmbajtje jo ma pak se gjymës kilogrami secila, për pijet e ndryshme, dhe nji kilogram për venë. Seicili kampjon duhet të mbyllet me nji tapë të shëndoshtë dhe e vulosun me dyll të kuq e me vulë të zyrës qi merr kampjonin. I interesuemi, për sigurim të vet mundet me vue edhe vulen e tij.

Shishet duhet të jenë krejt të pastërta.

Seicili kampjon do t'i ngjitet nji etiketë e fiksueme me dyll e vulë, në mënyrë qi mos të jetë e mundun heqja, mbi të cilen do të shenohen: data e numri i proces verbalit q'i përket kampjonit,

emni dhe mbiemni i pronarit, ose i përsonit qi asht gjetun malli, natyra e mallit, firma e nëpunësit dhe e përsonit t'interesuem.

Për çdo nxjerrje kampjoni duhet të mbahet nga nji proces-verbal në dy kopje origjinale, prej të cilëve njeni i lëshohet t'interesuemit së bashku me nji nga katër pjesët e kampjonit të nxjerrun q'i referohet.

Kampjonet e nxjerruna do të paguhen në çmimin e ditës, me përjashtim të rasteve ndër të cilat nxjerrja bahet nga ana e nëpunsave të dërguem nga Ministrija e Ekonomis Kombëtare dhe ajo e Financavet.

Neni 28.

Kampjonet e nxjerruna së bashku me proçes-verbalet, i paraqiten Ministris s'Ekonomis Kombëtare, ose në rastë qi në qendrën e Prefekturës ndodhet ndonji institut analizimi, sendet e sipër-tregueme do t'i çohen Prefekturës. Ministrija e Ekonomis Kombëtare, ose si mbas rastit Prefektura, pa vonesë ja paraqet kampjonet Laboratorit Kimik të Shtetit ose Institutit analizues të Prefekturës për analizim.

Veprimet e analizimit duhet të mbarohen të shumtën mbrenda 10 ditëve ç'prej datës së marrjes në dorëzim të kampjonit.

Rezultati i analizimit, me nji raportë të shkurtër shpjegues do t'i këthehet sa ma shpejtë autoritetit dërgues, i cili në rastë qi konstaton, në bazë të rezultatit t'analizimit dhe të raportit, se eksistojnë elementat e kondravajtjes, si mbas përshkrimeve të kësaj ligjë, do t'i a referojë Prokurorit të Shtetit të qarkut ku asht marrë kampjoni për me ba ndjekjet ligjore të rastit.

Kuer raporti i analizimit del pozitiv, autoritetet e sipër-përmenduna kan tagër me dhanë urdhën për nji sekuestrim provizuer të produkteve qi formojnë objektin e analizimit.

Sekuestrimi në fjalë mund të konformohet ose të ngrihet me nji vendim ndërmjetsuer të ngutëshëm, të gjykatës qi shikon çashtjen.

Laboratoari Kimik deri sa çeshtja të përfundohet gjyqsisht në mënyrë të preme, duhet të ruejë të pa prekun nji nga kampjonet qi janë paraqit per analizim.

Neni 29.

T'intresuemit, munden me kundërshtue përfundimet e analizimit mbrenda 20 ditëve nga data e sekuestrimit.

Mbi kërkimin e t'interesuemit, rianalizimi i kampjonit, mund të bahet edhe prej nji komisioni të formuem prej kimistëve të she-

nuem nga ana e autoritetit gjyqësuer kompetent. Në rastë mungese të këtyne kimistëve, kampjonet mund të dërgohen për analizim në nji tjetër institut të besueshëm, të cilin gjyqi ka me e pa t'arsyeshëm.

Neni 30.

Kushdo qi përgatit me qëllim shitje ose tue ditë shet prodhime të përmenduna në kët ligjë, të cilat nuk i gjegjin nga çdo pikpamje konditave të caktueme, dënohen si vijon:

Kuer produktet në fjalë nuk janë konfeksionue si mbas konditave të kësaj ligjë, por nuk damtojnë shëndetin, guximtaërt dënohen si mbas Nenit 353 të Kodit Penal.

Në raste qi produktet e përmenduna përveç qi nuk janë konformë me konditat e kësaj ligjë, por janë edhe të damshme për shëndetin e publikut, për guximtarët ndeshkohen si mbas Nenit 351 të Kodit Penal.

Neni 31.

Kushdo qi pregatitet me qellim shitje ose shet tue ditë landë dhe lang qi nuk kan origjinen e tyne nga rushi, dhe qi janë të destinueme për fabrikimin e pijeve të falsifikueme qi përmenden në ketë ligjë, dënohen me gjobë që nga 100-500 fr. ari.

Neni 32.

Ata qi hartojnë me qellim shpërndamje, ose botojnë me qellim titimi formula kimike ose shenime të tjera qi shërbejnë për pregatitjen e venave, uthullave ose pijeve alkoolike jo të thjeshta, dënohen me nji gjobë qe nga 100-1000 fr. ari.

Përjashtohen nga ky ndalim librat e shkencës qi bahen prej akademistave ose profesorave me qëllim mësimi.

Neni 33.

Në rastet e parapame në Nenet 30, 31 malli konfiskohet.

Neni 34.

Ndeshkimet e parapame në ketë ligjë, nuk ndalojn aplikimin e dispozitave penale të përshime në Kodin Penal dhe në Ligjët e tjera, kuer nga pijet e falsifikueme rezultojnë dame ma të mëdha përsonave ose kafshëve.

Neni 35.

Gjysma e shumës së gjobave të nxjerruna me aplikimin e kësaj ligjë, ka me u nda në pjesë të njinjishme ndërmjet të nëpunësit ose agjentit qi tërheqë kampjonin, të lajmuesit dhe t'atyne qi kryen analizimin relativ.

Neni 36.

Ministrija e Financavet, e Ekonomis Kombëtare, e P. Mbrendshme dhe ajo e Drejtësiës, ngarkohen me zbatimin e kësaj ligjë.

Neni 37.

Kjo Ligjë hynë në fuqi prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptrvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës kundra mashtrimeve në pregatitjen e në tregëtimin e pijeve alkoolike dhe t'uthullave, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 195-I datë 7-V-934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 19 Maj 1934.

ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI
Min. i P. të Mbrendëshme e Zav.

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i Ekon. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 78.

LIGJË, 18 Prill 1934.

Mbi taksimin e konsumit të Birrës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 4 Qershuer 1934, Nr. 32).

Neni 1.

Birra qi produktohet në vend, ajo qi importohet si edhe ajo qi do të gjendet e depozitueme në magazinat e tregëtarëve ditën e hymjes në fuqi të kësaj Dekret-Ligjë, i shtrohet taksës së konsumit qi përmendet në nenin 2.

Neni 2.

Taksa e konsumit për çdo kilogram birrë si ndër fuçija ashtu dhe ndër shishe asht fr. ari 0.30 (tridhetë santim ari).

Neni 3.

Për birrën që produktohet në vënd, taksa e konsumit nxjerret kur del nga fabrika dhe si mbas neneve 14 dhe 17 të ligjës me datë 27-4-1928 mbi taksimin e alkoolit.

BKSH

Neni 4.

Taksa e konsumit për birrën që importohet, nxjerret nga dogana së bashku me tagrin doganuer.

Neni 5.

Për birrën që do të gjindet depozitë ndër tregëtarë etj. ditën e hymjes në fuqi të kësaj Dekret-Ligje, taksa e konsumit nxiret në dy kiste të njinjishme, si mbas ligjës mbi nxjerrjen e t'ardhunave Shtetnore.

1) me t'u regjistrue malli:

2) mbrënda nji mueji prej datës së rregjistrimit.

Neni 6.

Taksa e konsumit, e nxjerrun mbi birrën e produktueme në vend, në rasë se kjo eksportohet, këthehet në bazë të dishmis doganore që vërteton eksportimin e birrës, dhe veprimet e këthimit të taksës së konsumit kryhen si mbas ligjës mbi administrimin e pasuniës dhe Kontabilitetin e Përgjithshëm të Shtetit.

Neni 7.

Për kundra-vajtje të dispozitave të kësaj Dekret-Ligje aplikohet Ligja mbi taksimin e alkoolit, si dhe Ligja mbi ndalimin e kondrabandavet.

Neni 8.

Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi 7 ditë mbas shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Neni 9.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Min. i P. Mbrendëshme e Zav.
Ministri i Ekon. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e Kryministris Nr. 1182-2 datë 26-7-1933.

Si ndigjojë dhe pëlqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 26-7-1933;

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi taksën e Konsumit të Birrës.

Durrës, me 28 Korrik 1933. ZOG

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës me datë 28 Korrik 1933, e aprovueme prej Parlamentit dhe Urdhnon zbatimin e tij në Kodet e Mbretnis si Ligjë.

Tiranë, me 18-4-1934. ZOG

Nr. 79.

LIGJË, 19 Maj 1934.

Mbi disa shtime e ndryshime në Ligjën e Gurorëve
(e botueme në Fletoren Zyrtare, 4 Qershuer 1934, Nr. 32).

Neni 1.

Neni i posaçëm i Lgijës Otomane mbi gurore me datë 5 Tetuer 1318 ndryshohet si vijon:

Kur guroret punohen për nevoja private leja jepet për nji vjet dhe merret taksë vetëm 5 (pesë) fr. ari.

Neni 2.

Paragrafi i dytë i nenit 13 ndryshohet në këtë mënyrë:

Kryetari i Komunës ose i ngarkuemi i tij, kur do të shkojë në vend për me bâ hetime, ka të drejtë të kërkojë prej t'interesuemve vetëm mjetin e udhtimit.

Neni 3.

Kur nji furrë a po kumi hapet e ré do të matet prej Kryetrit të Komunes ose të ngarkuemit të tij.

Gjithashtu Komuna që prelevon taksën duhet të kontrollojë se kumija ose nji furrë, me nji herë të djegme, sa kuintal gëlqere ose sa mija tulla, tjegulla ose poçerina produkton.

Neni 4.

I zoti i gurores, sa herë që do të djegë furrën apo kuminë duhet të lajmërojë Komunen, e cila do t'i apë një lejë të posaçme që quhet leje-djegëje. Leje djegëja epet gratis dhe në të shenohet sasia dhe lloji i materjalit që do të digjet dhe data e vuemjes së zjarmit.

Neni 5.

Përjashtimet e taksave të guroreve për emigrantët, të parashikueme në nenin 18 të ligjës mbi Vendosjen e Emigrandave, kanë fuqi vetëm për ngrehjen e një shtëpije për banimin e tyne privat bashkë me aksesorët e nevojshme, po jo dhe në rast rindërtime punimesh e ndërtimesh e tjera.

Neni 6.

Masat ndeshkimore të parashikueme në nenet 29, 30, 31 të Ligjës së Guroreve mbeten në fuqi pa u prekun prej dispozitave të ligjës së Minierevе.

Neni 7.

Për zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministria e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Drejtësis.

Neni 8.

Kjo ligjë hyn në fuqi 15 ditë mbas shpaljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi disa shtime e ndryshime në Ligjën e Guroreve, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 236/I datë 27-4-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 19 Maj 1934. Z O G

Ministri i Drejtësis — *Kryeministri*

V. AVRAMI — P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme

MUSA JUKA

BKSH

Nr. 80.

LIGJË, 6 Qershuer 1934.

Për aprovimin e parapamjevet të t'ardhunavet dhe të shpenzimevet për ushtrimin financjar 1934-935.

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Qershuer 1934, Nr. 33).

Neni 1.

Qeverija Mbretnore autorizohet:

a) me vërtetue dhe me nxjerrë, simbas ligjëvet në fuqì tatimet dhe taksat të ç'do lloji e t'ardhunavet të ç'do natyre që i përkasin për ushtrimin financjar qysh prej 1 Prill 1934 e deri më 31 Mars 1935, në konformitet me gjendjen e parapamjevet të t'ardhunavet të lejueme me këtë ligjë:

b) me pengue dhe me pague shpenzimet e rëndshme dhe të pa-rëndshme të Ministrinavet të ndryshme dhe të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, për ushtrimin financjar qysh prej 1 Prill 1934 deri më 31 Mars 1935, në konformitet me gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet të lejueme me këtë ligjë.

Neni 2.

Aprovohet përmbledhja e bashkalidhun prej së cilës shifet shuma e përgjithshme e t'ardhunavet dhe ajo e shpenzimevet të parapamuna për ushtrimin financjar qysh prej 1 Prill 1934 e deri më 31 Mars 1935 si pason:

T'ardhuna e shpenzime efektive të rëndshme dhe të pa-rëndëshme:

T'ardhuna	Fr. ari	18.506.500
Shpenzime . . . . «	«	18.888.192
Tepricë passive	Fr. ari	381.692

Neni 3.

Ndalohet dhanja e paradhanjevet mbi rroga dhe mbi shpërblime që i-u përaksin nëpunsavet të Shtetit, me përjashtimin e rrogavet dhe të shpërblimeve që i përkasin personalit që ushtron detyrën e tij jashtë Shtetit, si dhe të bursave për studime.

Neni 4.

Kurkush nuk mund të marri dy rroga për dy nëpunsina të ndryshme, me përjashtim të mësuesave të shkollavet.

Rroga zavendsije i jepen:

1) Kryeministrit, kur asht Titullar ose zavendës i nji dikasteri tjetër si dhe Ministrave kur ngarkohen me zavendsue nji Ministër tjetër;

2) personavet që ngarkohen me ushtrue përkohësisht nji funksion ose nji nëpunsì.

Në rasën e përmendun në pikën 1, Kryeministrit e Ministrit që zavëndëson u jepet një shumë baras 1/4 e rrogës së vëndit vakant.

Në rasën e përmendun në pikën 2, kur i ngarkuemi me zavendsì nuk asht nëpunës, ka të drejtë të marri 2/3 (dy të tretat) e rrogës së titullarit të vëndit që zavëndson; kur asht nëpunës Shteti, dhe ngarkohet me zavëndsue nji nëpunës të nji dikasteri tjetër, por në qendrën e shërbimit të tij, ka të drejtë të marri 1/6 (nji të gjashtën) e rrogës qi ka titullari i zavendsuem; kur asht nëpunës Shteti, dhe ngarkohet me zavendsue nji nëpunës jashta qarkut të shërbimit të tij, i akordohen shpnzimet e udhtimit dhe djeta e plotë kur misjoni nuk kalon nji muej, dhe gjysma e djetave për të gjithë kohën qi kalon nji muej.

Neni 5.

Mbi shpërlbimin e N. M. Tij Mbretit, si mbas dëshirës së shfaqun prej Tij, shënohet nji zbritje prej 40% (dyzet për qind) për ushtrimin financjar 1934-35.

Mbi shpërblimet e N. M. së Saj Nanës Mbretneshë, mbi shpërblimin e Deputetvet, mbi rrogat e Ministravet dhe të personelit civil e ushtarak të Shtetit që janë ma të nalta se 20 fr. ari në muej, për ushtrimin 1934-35, caktohet nji ndalje e jasht-zakonshme në masën që pason:

Deri në fr. ari 150 në muej 17% (shtatembëdhetë për qind).

Deri në fr. ari 250 në muej 21% (njizetenji për qind).

Deri në fr. ari 350 në muaj 24% (njizetekatër për qind)..

Mâ nalt se fr .ari 350 në muej 26% (njizetegjashtë për qind).

Për Gjindarmët, ushtarët dhe graduatët të çdo kategorije e grade, ndalja e jasht-zakonshme caktohet 16% (gjashtëmbëdhetë për qind) të rrogës origjinale.

Ndalja e sipërme randon mbi pagesat e personalit provizor si dhe mbi ato ditore të cilat, ndonse të caktueme për nji ditë, kanë karakter periodik dhe të vazhdueshëm dhe i mbrrijnë nji shumës muejore ma të naltë se fr. ari 20.

Alokacjonet, shpërblimet dhe indemnitetet e çdo lloje, që jepen për çdo natyrë të veçantë, i shtrohen ndaljes prej 25% (njizetepesë për qind) cila do qoftë shuma e tyne.

Neni 6.

Në rasë se, për efekt të zbritjes së caktueme si mbas nenit të sipërm, rroga ose pagesa rezulton mâ e ultë se fr. ari 20, jepet kjo shumë e fundit.

Në rasë se, për efekt të ndaljes së jashtzakonshme — në bazë të përqindjevet të caktueme — rroga e nji nëpunsi të nji shkallës ma të naltë, rezulton mâ e vogël nga maksimumi i shkallës tjetër s'afërme ma të ultë, at-herë këtij i likuidohet rroga e thjeshtë e kësaj (e shkallës ma t'ultë).

Neni 7.

Ndaljet e zakonshme të pensjonit, të caktueme me ligjët në fuqì, llogariten si ma parë mbi rrogën bazë të seicilit nëpunës civil e ushtarak, pa marrun parasysh ndaljen e jashtzakonshme të parapamun në nenin 5.

Neni 8.

Ndalja e jasht-zakonshme e caktueme në nenin 5, zbatohet dhe mbi pensjonet civile e ushtarake, mbi rrogat jetike, mbi shpërblimet për merita patriotike dhe mbi rrogat e disponibilitetit.

Neni 9.

Këshilli Kontrollues, mbrênda kufive të caktuem nga dispozitat e Kontabilitetit, ngarkohet me mbikqyrjen e paradhenjevet të fondevet, mbi mandate për çelje krediti, që i-u akordohen nëpunsavet t'autorizuem me ba materialisht disa shpenzime.

Për ketë qëllim, administrata qendrore duhet t'i njoftojnë Këshillit Kontrollues gjeneralitetet e nëpunsavet të deleguem prej tyne si dhe sasìn e fondeve që këta munden të prelevojnë. Po nji të tillë detyrë kanë edhe Drejtorinat e Nën-Drejtorinat Financjare kurdoherë që të disponojnë pagesa materiale shpenzimesh, ktyne nëpunsavet.

Neni 10.

Llogarija dhe dokumentat justifikuese të shpenzimevet për të cilat flasin nenet 140 dhe 178 të Rregullores së Kontabilitetit,

do t'i paraqiten Këshilit Kontrollues, nga an'e Administratavet përkatse, jo ma vonë se tre muej mbas mbarimit t'ushtrimit financjar.

Neni 11.

Nga pjesa e ngarkueme ushtrimit financjar 1934-35, si mbas ligjës me datë 14 Prill 1933 për t'u pague prej arkës së Shtetit kundrejt të shlyemit të detyrimevet ndaj Xhidikçivet, Xhamis së Madhe të Korçës dhe pjestarvet të familjes së Alltunvet, paguhet vetëm 50% (pesëdhetë për qind) në këtë ushtrim.

Neni 12.

Me përjashtimin e funksionarvet të Ministris së P. të Jashtme, që shërbejnë jashtë Shtetit, ndër Legata e Konsulata të Mbretnis, si dhe t'atyne Oficerave që dërgohen jashtë Shtetit, për studime, gjith alokacjonet, shpërblimet, indemnitetet të përmuejshme që u janë pague deri tash nëpunsave civil e ushtarakë, tue fillue qysh prej ushtrimit financjar 1934-35, ngrihen.

Neni 13.

Komandantit të Mbrojtjes Kombëtare, Kryetarit të Shtatit Madhuer si dhe Komandantit të P. të Gjindarmeris, u jepet nji shtesë rroge, dhe Adjutantave t'Oborrit Mbretnuer, tue përfshidhe Komandantin e Gardës Mbretnore, u jepet nga nji shpërblim muejuer me emnin e «drejtë kordoni», në masën që vijon:

1) Komandantit të Mbrojtjes Kombëtare dhe Kryetarit të Shtatit Madhuer seicilit nga fr. ari 300 (treqind), në muej;

2) Komandantit të P. të Gjindarmeris fr .ari 200 (dyqind), në muej;

3) Krye-adjutantit t'Oborrit Mbretnuer fr. ari 200 (dyqind) në muej;

4) Gjithë Adjutantave të tjerë dhe Komandantit të Gardës Mbretnore, nga fr. ari 150 (njiqindepesëdhetë) në muej.

Neni 14.

Shtesat e shpërblimet e përmenduna në nenin 13 të kësaj ligje, nuk llogariten për efektet e pensionit, por u shtrohen ndaljevet të jashtzakonshme si mbas nenit 5 të kësaj ligje.

Neni 15.

Shpërblimet e posaçme të përmuejshme të pagueme deri tash oficeravet, graduatve të Rojës Mbretnore të Kufinit do t'i paguhen edhe mbas këndej po n'atë masë, por nën emnin «shpezime fikse për udhtime e djete». Këto nuk' shtrohen ndaljeve të jasht-zakonshme qi flet neni 5 i kësaj ligje.

Neni 16.

Gjithë nëpunsavet civil të Shtetit tue përshimë edhe ata të Ministris së P. të Jashtme qi me budgetin t'ushtrimit financjar 1934-35, dhe gjith nëpunsave të Komuneve që me ligjën datë 30 Prill 1934 ngelin jashtë kuadrit për shkak suprimimi të vendeve të tyne, si dhe nëpunsave t'Arkës së pensjoneve të mbetun jashta kuadrit për shkak të suprimimit t'arkës në fjalë, u paguhet nji rrogë muejore në masën e nën kushtet e poshtë-shënueme:

1. — Atyne që kanë mbushun 10 vjet shërbim u jepet nji rrogë disponibiliteti si mbas Ligjës Pensjoneve me datë 17-X-1927; kjo rrogë nuk mund të jetë ma pak se 2/5 (dy të pestat) e rrogës origjinale të nëpunsit.

2) Atyne që kanë ma pak se 10 vjet shërbim, u paguhet nji rrogë mujore baras me 2/5 (dy të pestat) e rrogës origjinale të tyne; kjo rrogë paguhet vetëm për aq muej sa janë vjetët e shërbimit të nëpunsit po ja ma pak se katër muej;

3) Rrogat e përmenduna në paragrafin 1 e 2 të këtij neni, nuk u shtrohen ndaljevet të jasht-zakonshme të përmenduna në nenin 5 të kësaj ligje; vetëm i shtrohen përqindjes së pensjonit tue u llogaritë kjo kohë si sherbim i vlefshëm për pensjon.

Neni 17.

Rrogat e përmenduna në nenin 16 të kësaj ligje, paguhen nga fondi i posaçem i krijuem për këtë qëllim në budgetin e Ministris së Financavet.

Pagesa fillon qysh prej datës largimit të nëpunsit nga detyra.

Neni 18.

Nëpunsave civil të ngelun jashta kuadrit deri sa largohen nga detyra, u paguhen rrogat dhe sphërblimet e alokacjonet e tyne, në bazë të kuadrit t'ushtrimit financjar 1933-34, tue i u shtrumun ndaljeve të jasht-zakonshme si mbas nenit 5 të kësaj ligje.

Neni 19.

Këshilli Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj ligje, e cila hynë në fuqì qysh prej 1 Prill 1934.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 303-V datë 1-VI-1934 të Kryeminstris

DEKRETON:

Aprovimin e budgetit preventiv për vjetin financjar 1934-1935 me nji gjëndje të parapame të hymesh prej 18.506.500 (tetëmbëdhetmilion e pesëqindegjashtemijë e pesëqind) fr. ari e të shpenzimeve 18.888.192 (tetëmbëdhetëmilion e tetëqind e tetëdhetë e tetëmijë e njiqindenandëdhetedy) fr. ari bashkë me ligjën relative, të votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 174/I datë 1-VI-1934 të Kryesis së Tij, dhe urdhënon zbatimin e tyne.

Tiranë, më 6 Qershuer 1934. ZOG

Kryeministri	*Ministri i Drejtësis*
P. EVANGJELI	V. AVRAMI
Min. i P. të Mbrendëshme e Zav.	*Ministri P. të Jashtme*
Ministri i Ekon. Kombëtare	XHAFER VILA
MUSA JUKA	
Ministri i Financavet	*Ministri i Arësimit*
A. DIBRA	Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PARAPAMJEVE PËR T'ARDHUNA E SHPENZIME EFEKTIVE REALE PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1934 - 35

	2	3	4
	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1933-34	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1934-35 (shtylla 2+3)
	Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
T'ardhuna reale	24,527,000	— 6,020,500	18,506,500
Shpenzime reale.	27,527,000	— 8,638,808	18,888,192
Diferenca	—3,000,000	— 2,618,30	— 381.692

BKSH

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PARAPAMJEVE PËR T'ARDHUNA E SHPENZIME EFEKTIVE TË RENDSHME PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1934 - 35

	2	3	4
	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1933-34	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1934-35 (shtylla 2+3)
	Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
Kategori I.			
T'Ardhuna e Shpenzime Efektive			
PJESË E RENDSHME			
Shpenzime:			
Institute të Nalta e Ministrí e Finanancavet	4.416.807	— 1.416.543	3.000.264
Ministrí e Derjtsís	1 097.792	— 314.827	782.964
Ministrí e P. të Mbrendshme e Drejt. e P. e Shndetsís	2.482.439	— 929.979	1.552.460
	748.729	— 266.379	432.350
Ministrí e P. Botore e Derjt. e P. e Postë-Telegrafavet	1.961.913	— 740.491	1.221.422
Ministrí e Ekonomís Kombtare . . .	652.058	— 204.122	447.936
Ministrí e Arsimit	3.250,147	— 236.812	3.013.335
Kom. e Mbrojtjes Kombtare dhe e Gjindarmerís	12.478.951	— 4.679.826	7.799.125
	27.088.836	— 8.788.980	18.299.856
T' ardhuna	24.437.000	— 5.976.500	18.460.500
Diferenca	—2.651.836	+ 2.812.480	+ 160.644

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PARAPAMJEVE PËR T'ARDHUNA E SHPENZIME EFEKTIVE TË PA-RENDËSHME PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1934 - 35

	2	3	4
	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1933-34	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1934-35 (shtylla 2+3)
	Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
Kategori I.			
T'Ardhuna e Shpenzime Efektive			
PJESË E PA RENDSHME			
Shpenzime:			
Institute të Nalta e Ministrí e Financavet	60.740	+ 467.760	528.500
Ministrí e Drejtsís	33.424	— 23.508	9.916
Ministri e P. të Mbrendshme e Drejt. P. Shndetsís	47.000	— 12.000	35.000
Ministrí e P. Jashtme	—	—	—
Ministrí e P. Botore e Drejt. e Përgj. e Postë-Telegrafavet	—	—	—
Ministri e Ekonomis Kombtare . . .	—	—	—
Ministrí e Arsimit	—	—	—
Kom. e Mbrojtjes Kombtare dhe e Gjindarmeris	297.000	— 282.080	14.920
	438.164	+ 150.172	588.336
T'ardhuna	90.000	— 44.000	46.000
Diferenca	— 348.164	— 194.172	— 542.336

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E PARAPAMJEVE PËR T'ARDHUNA SHPENZIME EFEKTIVE TË RENDSHME E TË PA-RENDSHME PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1934 - 35

	2	3	4
	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1933-34	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1934-35 (shtylla 2+3)
	Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
Kategori I.			
T'Ardhuna e Shpenzime Efektive			
PJESË E RENDSHME DHE E PA-RENDSHME			
Shpenzime:			
Institute të Nalta e Ministrí e Financavet	4.477.547	— 948.783	3.528.764
Ministrí e Drejtsís	1.131.216	— 338.336	792.880
Ministri e P. të Mbrendshme e Drejt. P. Shndetsís	2.529.459	— 941.979	1.587.460
Ministrí e P. Jashtme	748.729	— 266.379	482.350
Ministrí e P. Botore e Drejt. e Përgj. e Postë-Telegrafavet	1.961.913	— 740.491	1.221.422
Ministri e Ekonomis Kombtare . .	652.058	204.122	447.936
Ministrí e Arsimit	3.250.147	— 236.812	3.013.335
Kom. e Mbrojtjes Kombtare dhe e Gjindarmeris	12.775.951	— 4.961.906	7.814.045
	27.527.000	— 8.638.808	18.888.192
T'ardhuna	24.527.000	— 6.020.500	18.506.500
Diferenca	—3.000.000	— 2.618.308	— 381.692

GJENDJE E PARAPAMJEVET E T'ARDHUNAVET

Gjendja e parapamjevet e t'ardhunavet për ushtrimin financjar 1934-1935 e vume në përballim me atë t'ushtrimit 1933-1934, paraqet rezultatet e shtrime në prospektin që vazhdon.

BKSH

	T'ARDHUNA TË RENDËSHME			T'ARDHUNA TË PA-RENDËSHME			TOTALE		
	SHUMA			SHUMA			SHUMA		
	të parapame për ushtrimin 1933-34	të parapame për ushtrimin 1934-35	Diferenca	të parapame për ushtrimin 1933-34	të parapame për ushtrimin 1934-35	Diferenca	të parapame për ushtrimin 1933-34	të parapame për ushtrimin 1934-35	Diferenca
KATEG. I T' ardhuna efektive	24,437,000	18.460.500	— 5.976.500	90.000	46.000	— 44.000	24.527.000	18.506.500	—6.020'500
Total i t'ardhunavet efektive	24,437,000	18.460.500	— 5.976.500	90.000	46.000	— 44.000	24.527.000	18.506.500	—6.020.500

BKSH

GJENDJA E PARAPAMJEVET E T'ARDHUNAVET

PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1934 - 35

1	2	3	4	5	6
Nr. i ushtr. 1933-34	1934-35	KAPITUJ EMERTIM	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1933-34 Fr. ari	Ndryshime qi propozohen Fr. ari	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1934-35 (shtylla 4+5) Fr. ari
		Titull I. **T'ARDHUNA TË RENDSHME**			
		KAT. I. T'ARDHUNA EFEKTIVE			
		T'ardhuna prej pasunis së Shtetit			
1	1	T'ardhuna tokash, kullotash dhe ndertesash shtetnore	45,000	— 25.000	20.000
2	2	Të tretëta	180,000	— 90.000	90.000
3	3	T'ardhuna peshku	350,000	— 150.000	200.000
4	4	T'ardhuna prej konçesjonevet dhe prej eksploatimevet të ndryshme të pyjevet shtetnore	80.000	— 40.000	40.000
5	5	T'ardhuna prej konçesjonevet miniere prej karjeravet dhe të ndryshme të pronavet shtetnore	240,000	— 40.000	200.000
6	6	Interes mbi Kontin-Korent të fondevet të Trezorerís në depozitë . . .	pro memoria	—	pro memoria
		Total	895.000	— 345.000	550.000
		Tatime të drejta			
7	7	Tatime mbi ndertesa e tokë ndertimi dhe 5% e kontrollimeve periodhike .	1.000.000	— 400.000	600.000
8	8	Tatime mbi prodhime pyjesh e guroresh nder prona private	50.000	— 20.000	30.000
9	9	Të dheta mbi drithna, pemë, bár, ullij, e zhugë	2.800.000	— 1.300.000	1.500.000
10	10	Tatim (xheelp) mbi berra, thij e shtazë të trasha	1.000.000	+ 100.000	1.100.000
11	11	Tatim mbi t'ardhuna e mbi trashigime	50.000	— 25.000	25.000
		p. b.	4.900.000	— 1.645.000	3.255.000

BKSH

GJENDJA E PARAPAMJEVET
PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1934 - 35 **T'ARDHUNA**

1 Nr. i ushtr. 1933-34	2 Nr. i ushtr. 1934-35	3 KAPITUJ — EMERTIM	4 Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1933-34 Fr. ari	5 Ndryshime qi propozohen Fr. ari	6 Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1934-35 (shtylla 4+5) Fr. ari
		u bartë	4.900.000	— 1.645.000	3.255.000
12	12	Detyrime personale pagesash kundrejt punimeve të ndryshme të rrugave	30.000	— 15.000	15.000
13	13	Tatim mbi fitime	500.000	— 100.000	400'000
		Total	5.430.000	— 1.760.000	3.670.000
		Tatim mbi konsum			
14	14	Tager mbi importim, eksportim, entrepots, shtypshkrime dhe të ndryshme	7.500.000	— 2.500.000	5.000.000
—	15	Tager statistike mbi importacjon e eksportacjon	—	+ 40.000	40.000
15	16	Tatim mbi sheqer e kafe	1.300.000	—	1.300.000
16	17	Tatim mbi shitje, bandrollim e konsumim duhani	1.300'000	— 300.000	1.000.000
17	18	Tatim mbi pije alkoolike	300.000	— 150.000	150.000
—	19	Taksë mbi oknsumin e birës	—	+ 90.000	90.000
—	20	Taksë konsumi mbi miell	—	+ 150.000	150.000
		Total	10.400.000	— 2.670.000	7.730.000
		Taksa mbi shndrrime			
18	21	Taksa pullash	320.000	+ 80.000	400.000
19	22	Taksa mbi akte të Gjykatave, të Noterive dhe t'Ipotekavet	640.000	— 40.000	600.000
		Total	960.000	+ 40.000	1.000.000

BKSh

1	2	3	4	5	6
Nr. i ushtr. 1933-34	1934-35	KAPITUJ / EMERTIM	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1933-34	Ndryshime qi propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1934-35 (shtylla 4+5)
			Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
		Lejime Qeveritare			
20	23	Të drejta për lëshim pas aportash .	55,000	— 15,000	40,000
21	24	Taksa mbi lëkura egersinash etj., leje për shitje pijnash, për gjuetije në tokë e n'ujë dhe për ushtrim profesjoni	70,000	— 10,000	60,000
22	25	T'ardhuna të ndryshme nga Legatat e Konsullatat, per rregjistrime passaportash e të ndryshme	30,000	—	30,000
		Total	155,000	— 25,000	130,000
		Monopole			
23	26	T'ardhuna nga monopolizim' i krypës	1,700,000	— 800,000	900,000
24	27	T'ardhuna nga monopolizim' i shkrepsavet, leter-cingarevet e leter-lojevet	2,000,000	— 350,000	1,650,000
25	28	T'ardhuna nga monopolizim' i vojugrit, benzinës e të naftës	1,400,000	—	1,400,000
26	29	T'ardhuna nga gjanat eksplosive . .	20,000	— 10,000	10,000
		Total	5,120,000	— 1,160,000	3,960,000
		T'ardhuna prej sherbimit botuer			
27	30	T'ardhuna poste, telegrafe e telefoni	800,000	— 150,000	650,000
28	—	T'ardhuna nga Laboratuari Kimik .	2,000	— 2,000	suprimue
29	31	T'ardhuna limanesh, fenerësh, karantinash dhe të ndryshme	180,000	— 60,000	120,000
30	32	T'ardhuna prej monedhash	pro memoria	—	pro memoria
		Total	982,000	— 212,000	770,000

BKSH

GJENDJA E PARAPAMJEVET
PËR USHTRIMIN FINANCJAR 1934 - 35

T'ARDHUNA

1	2	3	4	5	6
Nr. i ushtr. 1933-34	Nr. i ushtr. 1934-35	KAPITUJ – EMERTIM	Kompetenca si mbas gjendjes së parapamjeve për ushtrimin financjar 1933-34	Ndryshime që propozohen	Kompetenca rrjedhse për ushtrimin financjar 1934-35 (shtylla 4+5)
			Fr. ari	Fr. ari	Fr. ari
		T'ardhuna të ndryshme			
31	33	T'ardhuna të rasëshme të ndryshme dhe interesa mbi kredita të vonuem	110,000	— 10,000	100,000
—	34	Versim nga ana' e «A.G.I.P.-it» të rrogave të personelit të caktuem për mbi-kqyrjen e shitjes së karburantavet (Vend. Këshill. Ministruer Nr. 546 d. 13-VII-1932)	—	+ 18,000	18,000
32	35	T'ardhuna dhe ndihma spitalesh . .	20,000	+ 10,000	30,000
33	36	T'ardhuna nga shitje sendesh jashta perdorimit dhe nga gjana të konfiskueme	20,000	—	20,000
34	37	T'ardhuna nga gjoba të ndryshme. .	30,000	— 10,000	20,000
35	38	T'ardhuna nga Zyra e Shtypit dhe nga shitja e librave, kodeve e tjera botime shtetnore	10,000	+ 5,000	15,000
36	39	Kthim shpenzimesh	20,000	—	20,000
37	40	Mbi taksë 2% për Arsim	260,000	— 60,000	200,000
38	41	T'ardhuna nga 10% mbi fitimet e thjeshta vjetore të realizueme nga Banka Kombëtare.	25,000	—	25,000
39	42	T'ardhuna nga markat e hueja . . .	pro memoria	+ 2,500	2,500
—	43	T'ardhuna nga taksat shkollore e nga versim' i pagesavet në ngarkim të studentavet që ndjekin studiemet nder Gjymnaze, Lyce, Normale, Shkolla Teknike e Tiranës e Konviktet	—	+ 100,000	100,000
a) ipotekuesi, për nji arsye ose tjetër, nuk ka marrë pjesë n'adjudikatë;

b) ofertuesi në përfundim t'adjudikatës nuk ka dalë adjudikatar fitues.

Ipoteka dlirohet mbi shkresën e Zyrës qi ka lidhun kontratën kuer ofertuesi, tue dalë fitues n'ankand, ka përmbushë gjith obligimet qi ka marrë përsipër në bazë të kontratës qi asht lidhë ndërmjet atij dhe Zyrës qi ka ba ankandin e ka lidhë kontratën.

Neni 4.

Kuer i interesuemi nuk dliron ipoteken dhe në raste të përmenduna në nenin 3, ipoteka ka vleftë mbrenda atij vjeti për me marrë pjesë zotnuesi i pronës dhe n'adjudikata të tjera.

Neni 5.

Konstituimi dhe inskriptimi i ipotekës ashtu edhe dlirimi i sajë si mbas paragrafit a) dhe b) të nenit 3, përjashtohen nga çdo lloj takse ipotekore dhe noteriale, për veç nji shpërblimi fiks prej fr. ari 5 (pesë) në favorin e noterit, dhe fr. ari 0.50 (pesëdhet qindar)

për çdo inskriptim në favorin e nëpunësit t'ipotekës qi ka ba veprimin.

Shpërblimet e përmenduna në paragrafin e sipërme, paguhen prej adjudikatarit, kuer lidhet kontrata definitive me administratën përkatëse.

Neni 6.

Dispozitat e kësaj Ligjë aplikohen dhe në shitjen e të dhjetave.

Neni 7.

Ç'do dispozitë ligjore në kundërshtim me këte mbetet pa fuqië.

Neni 8.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 9.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve
DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi garancitë Ipotekore ndër ankande Shtetnore ose Para-shtetnore, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 238/I datë 27-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 31 Maj 1934. ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Min. P. Mbrendëshme e Zav.
Ministri i Ekon. Kombëtare
P. EVANGJELI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 86.

DEKRET-RREGULLARE, 31 Maj 1934.

E Mamive në bazë t'artikullit 10 të Ligjës mbi ushtrimin e profesioneve mjeksore me datë 16-6-1927.

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Qershor 1934, Nr. 34).

Neni 1.

Çdo mami duhet të ketë me vedi nji çantë që do të përmbajë të

gjitha mjetet e nevojituna për me i ardhë në ndihmë një grueje me barrë ose me ndalue emorragjinë në rasa të ngutshme.

I. — Sendet e nevojituna janë:

a) Nji irrigator i kompletuem tue pasë kanule vaxhinale e rektal;
b) nji katater metalik për gra;
c) nji palë gershanë për me pré kerthizen;
ç) dy pince emostotike;
d) nji stethoskop;
dh) nji termometer;
e) s'paku nji palë dorëza gomet dhe disa gishta gomet;
ë) nji furçe me la duert, gershanë e limë për thonj;
f) nji këmishë të bardhë me mangë të shkurta.

II. — Mjete dizinfektuese:

a) sapun;
b) nji shishe për 200 gr. alkohol;
c) nji shishe të murme që të permbajë 25 gr. teinture d'yode;
ç) nji shishe me lizoforme;
d) nji shishe të murme me 10 gr. solucion prej Nitrate d'argent 1% me uj të distiluem, ose orgirol 5% për kolirio;
dh) koton idrofil 200 gr.;
e) nji paketë me garze sterile;
ë) pê mëndafshi për me lidhë kerthizen;
f) nji shiringë 3 cc. dhe nji 5 cc.;
g) Ergotine deri në tre ampule.

Neni 2.

Mamija, porsa të mbrijë në shtëpinë ku thirret, do të kujdesohet sidomos për dhomën ku do të pritet fëmija tue kerkue pastertinë e duhun. Ka me lypë të vlohet sa ma shumë ujë që të jet' e mundun e në një ênë në vlim e sipër ka me qitë instrumentat që i lipsen, tue i lanë së paku pes minuta (brusha, gershanë, dorëza, pice. mendafshi etj...)

Teshat e grues duhet të jenë të lame ashtu dhe çdo lëvere që do të përdoret mbas lindjes së foshnjes. Mandej si të jetë përveshë deri në bryl, të hjekë unazat dhe çdo send tjetër, ka me pre thonjtë sa ma shkurt, dhe ka me la duert me ujë të ngroftë e sapun. Si të veshi këmishën, pregatit nji enë e mbasi t'a sterilizojë tuj e djegë me alkohol, ka me pregatit nji solusion me dy tri litrash me

lysoform dhe me ujë të vluem, tue e mbulue ênen me nji pecetë të pastër. Fillon pastaj me ekzaminue gruen prej së jashtmi tue u kujdesue me vrejtë pozicionin e foshnjes dhe gjendjen shëndetsore të saj, tue e perkitë dhe tue ndigjue. Pastaj ka me la duert rishtazi tue i ferkue me furçe deri te brylat dhe do të ketë kujdes që nji njeri tjetër t'i lëshojë ujë të ngroftë. Si të hapet paketa e pamukut prej nji tjetrit merr pambukun e lëshon në solusionin e lysoformit dhe me nji copë pambuk tjetër të lagun n'alkohol ferkon duertë, sidomos pranë thonjve tue i sheprla pastaj me solusionin prej lysofornit të pregatitun. Do të kujdesohet me la pjesët e jashtme xhenitale të grues së parit me ujë të ngroftë e sapun e pastaj me pambuk të lagun në solucion të lysoformit. Si të ketë dizinfektue duert rishtazi me alkohol veshë dorëzat e sterilizueme e ban eksplorimin për me kuptue paraqitjen e foshnjes. Në rast mungese dorëzash ose gishtash prej gome duhet që gishtin eksplorues t'a dizinfektoj tue e fërkue me pak pambuk të lagun në një solucion të jodiose me alkool.

Neni 3.

Ka m'u kujdesue m'i shtrue grues nji çarçaf të pastër e të palosun, me vue përbri gjenitaleve pambuk të lagun në solucion te lysoformit tue e pasë shtrydhë përpara; dhe kështu pret lindjen e foshnjes. Mbasi të lindi foshnja mbledh plaçenten por sa të shkoqet.

Neni 4.

Mamija asht e detyrueme me thirrë mjekun çdo herë që paraqitet ndoj send i pa rregulltë në lindjen e fëmisë ose mbas lindjes. Asht e detyrueme me vrejt metodikisht nxehtësinë tuj lanë termometrin nji të katert t'orës në sqetull.

Neni 5.

Në rast se mungon mjeku, mamija porsa të kujtohet se nxehtësija asht 38° gradë do të lajmërojë menjiherë Kryetarin e Bashkiës i cili do të kujdesohet me kerkue nji mjek.

Neni 6.

Për në çdo rast mamitë janë të ndalueme me përdorë vegla kirurgjikale.

Neni 7.

Asht e ndalueme kryemja e çdo operacioni me duer mbi foshnje n'utero; përmetohet vetem në rasa me ngutsi e kur asht e pa-

mundun ndihma e shpejtë e mjekut; ky operacion kryhet nen përgjegjësinë e mamisë.

Neni 8.

Çdo mami duhet të ketë nji rregjistër të lindjeve që ka me ju dhanë prej Bashkiës e detyrohet për çdo lindje me plotsue me shpejtësi.

Neni 9.

Mamivet duhet t'ju nepet gratis antiseptikët e materiali tjetër i nevojitun për me ju ardhë në ndihmë të vobektëve.

Neni 10.

Mamija asht e ndalueme:

a) Me provokue deshtim ose lindje para kohe;

b) me terhjekë me gishta vezen deshtuese;

c) me vendosë pesari n'anzën e zbrazet;

ç) me u përpjekë me ndryshue pozicionin e foshnjes në distosi;

d) me asnjë mënyrë me hapë gryken e anzës;

dh) mos me tërhjekë foshnjen nga krahu (kur paraqitja asht me krahë;

e) në rasë se shtrati krejtësisht ose pjesërisht ka ngelë mbrenda anzës me asnjë mënyrë nuk duhet me shti doren mbrenda m'e nxjerrë;

ë) me bê irrigasione endouterine edhe në kjofshin t'urdhënueme prej mjekut.

Neni 11.

Mamija mundet të veprojë si pason:

a) Kateterizem veshikal;

b) klisteret;

c) premjen dhe lidhjen e kerthizës;

ç) shtrydhjen e anzës për qitjen e shtratit e të ngrimet e gjakut;

d) irrigasionet vagjinale kur të jenë të pershkrueme prej mjekut;

dh) inzheksionet ipodermike me ergotinë mbasi të jenë lirue anza prej shtrtatit e të ngrimet e gjakut në rasa emoraxhie të konsiderueshme.

Neni 12.

Si të jetë krye lindja, do të lahen me ujë të vluem përpara e

me sapun gjenitalet e jashtme tue i fshië pastaj me pambuk të lagun me solucion të lysoformit e tue vue përsipër nji copë pambuk ose gazë. Ka me ndrue teshat e ndyeta me të tjera të pasterta, ka me kontrollue shtratin e në rasë se nuk asht e plotë ka me ruejtë për me ja kallzue mjekut.

Për 5 ditë rresht mamija ka me vizitue nji herë në ditë lehonen tue matë herë-mbas here temperaturen e tue vrejtë me kujdesi gjendjen e saj.

Në 5 ditë të para ka m'u kujdesue m'e i a la gjenitalet e jashtme me ujë e sapun dita me ditë tue i fshi pastaj me pak pambuk të lagun në një solusion të lysoformit, dhe mandej ka me i mbulue gjenitalet përherë me pakë pambuk ose gazë të sterilizuem.

Ka me vrejtë me kujdesi sytë e foshnjes e në rasë se paraqitet inflamasion edhe i lehtë qoftë duhet me njiherë me thirrë mjekun.

Në çdo lindje foshnjes duhet me i lëshue nji pikë në secilin sy të nji solucioni Nitrate d'argente 1% tue u kujdesue që pika e solucionit të perhapet në konxhontiven.

Që mos t'infektohet kerthiza duhet të ketë kujdesinë me e fshië me pak pambuk të lagun me alkool.

Të gjitha veglat e përdoruna prej Mamisë në se-cillen lindje duhet herë-pas-here të pastrohen e të fshihen me kujdesi përpara se të shtihen në çantë.

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 13.

Mamija, për çdo ftesë, duhet të shkojë sa ma parë tue i dhanë ndihmën e vet me dijeni, ndergjegje e urtësi grues për të cilen thëritet. Ka të drejtë me dijtë drejtimin e grues ku ësht e thirrun, në qoftë se thirrja asht naten ka të drejtë me kenë e përcjellun, dhe në qoftë se asht larg me pasë mjetin e transporit.

Në rasa të ngutshme ashtë e detyrueme me shkue pa ndonji kundërshtim, vetëm në provohet pa-mundësija e saj at-herë kjo mund të këshillojë drejtimin e ndonji mamisë tjetër për t'i ardhë në ndihmë grues me barrë.

Neni 14.

Mamitë detyrohen në fund të çdo mueji t'i përcjellin zyrës

shëndetsore pranë Bashkiës listën e lindjeve të muajit dhe, ajo ja paraqit Drejtoris së Përgjithëshme të Shëndetsis bashkë me raportin mujor.

Neni 15.

Mamija nuk do të pranojë në asnji mënyrë ndihmën e atyne grave të vet-quejtuna të praktikueme.

Neni 16.

Mamija nuk duhet të përflasi me të tjerë mbi gjendjen shëndetsohe të gruas që ajo kuron. Vetëm mjeku i thirrun me i ardhë në ndihmë mund t'i napi shkoqitjet e konstatueme.

Neni 17.

Çdo Mami e thirrun me ngutësi të nji gruës që gjindet nën kurën e nji mamis tjetër, do t'i napi ndihmat ma të ngutëshmet, tue mos kritikue veprimet e maparshme të kolegës, të cilën do t'a lajmërojë porsa të mbarojë veprimin e saj të ngutshëm.

Neni 18.

Çdo herë që grueja ose familja dëshëron të thrrasi mjekun, Mamija duhet të kujdesohet për thirrjen e tij me njëherë.

Neni 19.

Mjeku duhet thirrë në çdo rasë që parashifet interesi i grues ose i foshnjes për me kthjellue diagnostikun, për me urdhënue barna, me krye ndonji operacion të cilën mamija nuk ashtë e autorizueme ose nuk e shef vehten t'aftë m'e krye.

Neni 20.

Nji Mami me ndërgjegje lypset të kërkojë mejtimin e një mjeku kur ekzaminonn baqthin e grues, kur dyshon mbi gjendjen e foshnjës, kur fëmijës i reh zemra, kur vazhdon hapja e anzës, grueja ndjen dhëmbie të forta edhe kurdoherë që mamia sjell dyshim mbi gjendjen shëndetsore të lehonës.

Neni 21.

Kur Mamija shef nevojë me thirr mjekun, ka për detyrë me i ba të njoftun gjendjen e grues me shkresë, në mënyrë që mjeku të mundet të pregatitet për çdo ndërhyrje obstetrike. Me t'ardhunit e mjekut, mamia ka me i dhanë shkoqitjet mbi shenjat q'ajo ka avërejt, mbi diagnostikun e sëmundjes edhe mbi fenomenët që ka pa gjat kohës q'e ka pasë gruanë nënë vërejtjen.

Neni 22.

Mamija ka me vue në zbatim urdhënat e mjekut, tue i marë në shënim në qoftë se janë të shumta e ka me u gjend pranë në çdo vizitë të mjekut për me i dhanë shkoqitjet e nevojshme.

Art. 23.

Në vënde ku nuk ka ambulanca foshnjore mamitë detyrohen t'u japin listën e lindjeve për çdo 48 orë me gjithë karakteristikat e nevojshme.

Art. 24.

Mamija nuk ka të drejtë me lyp shpërblim prej të gjithë shtëpive që do t'i shënohen nga Bashkia si të vobekta.

Neni 25.

Mamija ka të drejtë me kërkue shpërblimin përkatës prej familjeve që nuk janë shënue në listën e dhanë prej Bashkiës si të vobekta.

Neni 26.

Në çdo kërkesë shpërblimesh mamija do të bazohet në randësin e ndihmës dhe në gjendjen e gruas së ndihmueme, por me gjithë këtë, mamija nuk duhet t'insistojë në plotësimin e shpërblimit të caktuem në këtë Rregullore në rastë se lëhona nuk asht në gjendje m'e plotësue.

Neni 27.

Shpërblimet e Mamive:

a) Nji vizitë në shtëpinë e gruas me barrë 10 lekë nër pasanikë dhe për klasa mesatare 7, kjo vizitë dyfishohet në rasa të ngutshme natën;

b) përmbledhja e gjithë vizitave para e mbas lindjes dhe me esistencën e lindjes; për pasanikët 200 lekë dhe për klasën mesatar 100 lek.

Neni 28

Inspektor' i Shëndetsis dhe Mjekët e Bashkive ngarkohen me kontrollimin e veglave dhe të mjeteve që përmenden në këtë Rregullore.

Neni 29.

Ministrija e P. të Mbrendëshme ngarkohet me zbatimin e kësaj Rregullore.

Neni 30.

Kjo Rregullore hynë në fuqi qysh nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptrvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 732 datë 25-5-1934 të Kryeministris.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 23-5-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Rregullores mbi detyrat e Mamive.

Tiranë, me 31 Maj 1934. ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Min. i P. Mbrendëshme e Zav.
Ministri i Ekon. Kombëtare
P. EVANGJELI

Nr. 87.

DEKRET-LIGJË, 15 Qershor 1934.

Mbi pranimin në pagesë të grunit e të misërit për të dhetat e ushtrimit financjar 1934-35, për të dhetat e mbrapambetuna nga ushtrimet e ma parëshëm dhe mbi blemjen e grunit dhe të misërit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Qershor 1934, Nr. 35)

TITULLI I.

MBI PAGESËN NË NATYRË

Art. 1.

Ministrija e Financavet ka me pranue në pagesë për të dhetat e ushtrimit financjar 1934-35, si dhe për të dhetat e të mbrapambetunave t'ushtrimeve të ma parëshme, grunë ose misër, në kjoftë se dhetarët dishrojnë me pague në natyrë në bazë të dispozitave të caktueme në këtë Dekret-Ligje.

Për të dhetat e të lashtave t'ushtrimit 1934-35 dhe, për të mbrapambetunat nga ushtrimet e maparëshme, pranohet në pagesë vetëm grunë; për të dhetat e të vonave t'ushtrimit financjar 1934-35 pranohet në pagesë grunë ose misër si mbas kërkesës së debitorit.

Art. 2.

Pagesa në grunë ose misër plotësohet prej t'interesuemit qi përfiton nga dispozitat e art. 1 të kësaj Dekret-Ligje, tue dorëzue pranë depove në kohën e caktueme me çmimin e fiksuem a-j grunë ose misër sa t'i korispondonjë kistit përkatës që ka me pague në skadencë për të dhetat e ushtrimit 1934-35 ose për të mbrapambetunat.

Art. 3.

T'interesuemit munden me dhanë grunë ose misër në pagesë pranë depove që ndodhen mbrënda rajonit të Prefekturës ku asht shitun e dheta.

Depot hapen ndër këto qendra: në Shkodër, në Kukës, në Durrës, në Tiranë, në Lushnjë, në Berat, në Vlonë, në Delvinë, në Këlcyrë, në Korçë, në Peshkopi e n'Elbasan.

Art. 4.

Çmimi bazë i grunit të dorëzuem pranë se cillës do prej depove të përmenduna n''art. 3 të kësaj Dekret-Ligje, kundrejt të dhetave t'ushtrimit financjar 1934-35, asht fr. ari 12. (dymbëdhjetë) kuintal.

Art. 5.

Çmimi bazë prej fr. ari 12 (dymbëdhjetë) për kuintal caktue n'artikullin e sipërme, vlen për grunë në peshë specifike prej kg. 76 (shtatdhjetegjashtë) e lart për ç'do hektolitër, grun i cilli konsiderohet i kualitetit të parë.

Gruni në peshë specifike ma t'ultë se 76 kg. deri në kg. 73 (shtatdhejtetri) për hektolitër konsiderohet i kualitetit të dytë dhe, pranohet në nji zbritje prej 5 % (pesë për qindë) në peshë.

Gruni me peshë specifike më t'ultë se kg. 73 por jo dhe ma pak se 71 (shtatdhjetenji) kg. për hektolitër, konsiderohet grun i kualitetit të tretë, dhe pranohet me nji zbritje prej 9% (nandë për qindë) në peshë.

Art. 6.

Përveç kualiteteve të caktueme n'art 5 të kësaj Dekret-Ligje, gruni qi mund të pranohet në pagesa përgjithsisht prej depove duhet, me pasë edhe këto cillësina: të jetë i saktë, i thatë, kokër plotë, dhe pa ndonji, edhe i pa prekun prej ndonji smundjeje: i pa prekun prej mize dhe nuk duhet të kenë ma shumë se 3% (tre për qindë) landë të hueja.

Art. 7

Dhetarët q'i deytrohen Arkës së Shtetit shuma për të dhetat e mbrapambetuna, të cillat u shtrohen pastrimit si mbas Ligjës datë 29 Nanduer 1933 mbi pastrimin e të mbrapambetunave aktive të Shtetit mund të përfitojnë edhe nga kjo Dekret-Ligje, tue parapague me grunë shumat që do të paguejshin në katër kiste si mbas ligjës mbi pastrimin e të mbrapambetunavet.

Parapagimi në grunë bahet me dorëzue n'afatin e caktuem për këtë qëllim pranë depove të caktueme n'art. 3 të kësaj Dekret-Ligje, grunë të kualitetit të parë, të dytë ose të tretë si mbas përshkrimit t'Art. 5 të kësaj Dekret-Ligje dhe, me cilësin e konditat e caktueme n'Art. 6 po të kësaj Dekret-Ligje.

Art. 8.

Për të dhetat e ushtrimit financjar 1934-35 dorëzimi i grunit në pagesë duhet të bahet minimum deri në fund të Tetorit 1934. dhe i misërit deri në fund të Prillit 1935 si mbas kisteve të caktueme n'adjudikatë: dhe për të mbrapambetunat dorëzim'i grunit do të bahet së pakut për gjysmën e borxhit deri më 31 Korrik 1934, dhe për pjesën qi mbetet deri më 30 Shtatuer 1934.

Debitorët e të dhetave të mbrapambetuna që nuk paguejnë tanësisht ose pejsërisht deri në datën e caktueme ma sipër, mbas skadimit t'afatit detyrohen me pague në të holla të gjithë borxhin ose pejsën e pa-pagueme në datat e caktueme në Ligjën e pastrimit të mbrapambetunave aktive të Shtetit.

Art. 9.

Gruni i kualitetit të parë pranohet në pagesë për kistin e parë (deri më 31 Korrik 1934) të dhetave të mbrapambetunave me çmimin bazë fr. ari 10 (dhjetë) për kuintal pranë ç'do depoje, dhe për kistin e dytë (1 Gusht deri 30 Shtatuer 1934) me çmimin qi ka me caktue Këshilli Administrativ i Institutit i formuem në bazë të kësaj Dekret-Ligje.

Për kualitetin e dytë dhe të tretë aplikohet zbritja e parapame n'art. 5 të kësaj Dekret-Ligje.

Art. 10.

Dhetarët t'ushtrimit financjar 1933-1934 të cillët nuk kanë plotësue pagesat n'afatet e caktueme, u lejohet me pague borxhin e tyne nga e dheta si dhe kamatat e randimit e caktueme me

Ligjen datë 29 Mars 1932 mbi nxjerrjen e t'ardhunavet shtetnore, me grunë në bazë të çmimeve, kualitetit, konditave e n'afatet e lejuem si mbas art. 8 për debitorët e të mbrapambetunave.

Art. 11.

Për të dhetat e të vonave t'ushtrimit financjar 1934-35 pranohet në pagesë edhe misri me çmimin unitar fr. ari 8 (tetë) kuintali, të dorëzuem ndër depo të caktueme n'art. 3 të kësaj Dekret-Ligje n'afatet e caktueme si mbas art. 8.

Misri duhet të jetë i kualitetit të mirë, i thatë, pa pluhun ose miza, pa erë të keqe, i pastër dhe jo ma shumë se 2% landë të huej .

TITULLI II.

FORMIMI I INSTITUTIT DHE DETYRAT E TIJ

Art 12.

Formohet në bazë të kësaj Dekret-Ligje Instituti Shtetnuer për influencimin e çmimit të grunit e të misrit.

Art. 13.

Institutit i ngarkohen në bazë të kësaj Dekret-Ligje detyrat që vijojnë: 1) sigurimi dhe administrimi i depove të përmendunan'Art. 3 të kësaj Dekret-Ligje; 2) pranimi në pagesë i grunit e i misrit për llogari të Financës si dhe mbajtja e ktyne produkteve në gjendje të mirë konformë me dispozitat e kësaj Dekret-Ligje; 3) emnimi i personelit pranë depove si edhe i personave qi ngarkohen për inspektimin e depove; 4) marrja në shërbim e personelit të përkohshëm që nevojitet për zbatimin e kësaj Dekret-Ligje, si dhe blerja ose marrja me qira e materialeve e të veglave që mund të nevojiten për pastrimin e grunit ose të misrit si dhe për matjen, mbajtjen e tyne në gjendje të mirë; 5) misjon me influencue çmimet e grunit e të misrit në treg tue kërkue me arrijtë që çmimi i grunit të bahet fr. 12.— dhe çmimi i misrit fr. ari 8 për kuintal, m'anë tjetër tue qit në treg për shitje grunë ose misër kur çmimi i grunit t'arrijnë fr. ari 14.— (katërmbëdhjet) dhe, çmimi i misrit fr. ari 10.— (dhetë) për kuintal.

Art. 14.

Për plotësimin e detyrimit të caktuem në pikën 5 t'Art. 13, Instituti me autorizimin e Këshillit Ministruer ka të drejtë të

marri hua deri në fr. ari 500.000.— me nji kamatë t'arësyeshme t'aprovueme prej Këshillit Ministruer, hua e cila në bazë të kësaj Dekret-Ligje kionsiderohet e garantueme prej Shtetit.

Instituti prapë me autorizimin e Këshillit Ministruer ka gjith' ashtu tagër me depozitue, pjesërisht ose tanësisht, grunin ose misrin që ndodhet ndëpër depo pranë Bankave që veprojn në Shqipni, kundrejt paradhanjeje që akordojnë magazinat e përgjithshme të Bankave.

Instituti në fjalë vepron në bazë të nji preventivit të përpiluem prej Këshillit Administrativ dhe, i aprovuem prej Këshillit Ministruer. Qeverija mund t'i akordojë nji paradhanje deri në 250.000 fr. ari për t'i u këthye mbrënda një vjeti.

Art. 15.

Instituti formohet për nji kohë prej dy vjetësh, koha e vashdimit të tij mund të zgjatet me Vendim të Këshillit Ministruer mbi nevojat e çfaquna prej Këshillit Administrativ t'Institutit vetë.

Instituti funksionon pranë Ministris së Financavet dhe administrohet prej nji Këshilli administrativ të përbamë: prej Ministrit të Financavet (i cilli asht dhe Kryetar i Komisionit), prej Nën-Ministrit t'Ekonomis Kombëtare, prej Kryetarit të Këshillit Kontrollues dhe prej nga dy përfaqësuesave të Ministrisë Financavet dhe t'E.okonomis Kombëtare që do t'emnohen me vendim të Këshillit Ministruer në mes të shefave të Ministrinave në fjalë. Këshilli administrativ zgjeth në mes të tij dy Këshilltarë delegat që meret me gjestjonin teknik t'Institutit.

Në mungesën e Kryetarit vendin e tij e zen Nën-Ministri e në mungesën e tij Kryetari i Këshillit Kontrollues.

Këshilli asht i formuem kur me gjithë Kryetarin ose zavendësin e tij janë prezent së pakut 4 antarë.

Këshilli mblidhet së paku nji herë në javë si dhe çdo herë Kryetari ose Këshilltarët e deleguem t'a kërkojnë.

Vendimet e këshillit merren me shumicë votash. Në rast pariteti fiton ana për të cillën ka votue Kryetari ose zavendësi i tij.

Art. 16.

Këshilli Administrativ asht organi ma i naltë i Institutit dhe kolektivisht asht përgjegjës për veprimet që i ngarkohen me këtë ligjë.

Art. 17.

Për influencimin e çmimeve të grunit e të misrit konformë me pikën 5 t'Art. 13 Instituti ka me caktue herë pas here në mënyrë sekrete çmimet e grunit e të misrit për t'u ble ndër tregje të depove direkt prej prodhuesave.

Çmimet e caktueme në mënyrë sekrete u komunikohen degave t'Institutit pranë depove në mënyrë sekrete që, të konsiderohet ma e volitëshme për me evitue spekulasionet.

Art. 18.

Për administrimin e mirë-mbajtjen e depove si dhe për blemjen e grunit e të misrit, për pranimin e tij në pagesë dhe për caktimin e kualitetit dhe ruajtjen e tij konform me dispozitat e kësaj Dekret-Ligje pranë ç'do depoje caktuem n'art 3 të kësaj Dekret-Ligje. Instituti ka me delegue nji Agronom dhe nji nëpunës të Financës, të dy të zgjedhun në mes të nëpunsave në shërbim, depot si dhe nëpunësit përkatës mbi kqyren prej Drejtorit të Financës në juridiksionin financjar të së cilës ndodhet depoja. Për veç kësaj mbi kqyrjeje, Këshilli Administrativ i Institutit ka me disponue së paku dy herë në muej nga nji Inmspektim në ç'do depo pej anës Organeve dhe të Inspektorave të Financës.

Art. 19.

Instituti asht i detyruemë me mbajtë libra nga të cillët shifen kjarisht të hymet e të ndalunat; gjithashtu asht i detyruem me ruejtë gjithë dokumentat përkatës t'aktivitetit të tij.

Shpenzimet e ndryshme për qira, për personelin e nevojshëm për manipulacjon dhe gjith ç'ka nevojitet për mirë-funksjonimin e këtij Instituti, caktohen nga Këshilli Administrativ.

Instituti ka me përdorë kryesisht nëpunës Shtetit për të gjitha shërbimet e depove të cilët i vehen në dispozicjon nga Ministrija përkatse përkohësisht si mbas nevojës e mundësis.

Nëpunsit që mund të merren përkohësisht nga jashtë nuk konsiderohen nëpunës Shtetit për as nji efekt, vetëm për abuzim detyre.

Nëpunsave të Shtetit që merren në misjon prej Institutit u paguhet rroga nga Budgeti i Shtetit, por shpenzimet e udhtimit e djeta eventuale u paguhen nga Instituti, por jo ma naltë se ato të lejueme me ligjën përkatëse për nëpunësit e Shtetit.

Art. 20.

Çmimet e caktueme për blerjen e grunit prej Këshillit Administrativ t'Institutit konformë me art. 17 të kësaj Dekret-Ligje formojnë çmimin bazë për grunë të kualitetit të parë për t'u rregullue për kualitetin e dytë e të tretë konforme me art. 5 të ksaj Dekret-Ligje.

Art. 21.

Kuer për zbatimin e kësaj Dekret-Ligje nuk ndodhen depo të përshtatëshme në vendet e caktueme n'art. 3, Qeverija, mbi kërkesën t'administratës, ka të drejtë të marri me qira t'arsyeshme të caktueme prej Këshillit t'Administratës së vëndit dhe pa konsantimentin e pronarit, hambarët e privatëve që mund të ndodhen të shprazda ose, që mund të shprazen pa i sjellë ndonji dam të randë pronarit.

Art. 22.

Për efekte të taksave të shërbimit botuer, të Postërs, të Telegrafave, të telefonit e tjerë, Instituti bashkë me degat e tija konsiderohet si Zyrë shtetnore dhe nuk paguan asnji taksë ose pagesë që Zyrat shtetnore nuk janë të detyrueme me pagimin e tyne. Gjith'ashtu aktet dhe librat e Institutit janë të përjashtueme nga pullat e monopolit dhe të Kryqit të Kuq. Gjith'ashtu huanat, blemjet dhe shitjet e Institutit janë të përjashtueme nga taksat shtetnore, bashkijake e komunale.

T I T U L L' I III-të

DISPOZITA TË NDRYSHME

Art. 23.

Dhjetarët që bajnë pagesën në grunë ose në misër kjoftë për të lashta e të vona t'ushtrimit financjar 1934-35, qoftë për të mbrapambetunat e ushtrimevet të ma-parshme, dhe për ato t'ushtrimit 1933-34 tue depozitue grunë ose misër pranë depove, konforme me dispozitat e kësaj Dekret-Ligje, konsiderohen për të gjitha efektet ligjore e fiskale se e kan shllye detyrimin e tyne. Për kët arësye Financa e vendit ka me kundra-firmue dorën që depoja përkatëse asht e detyrueme t'i lëshojnë paguesit. Për veprimet e sipër-përmenduna do të hapet nji llogari rrjedhëse (konto-korent) ndërmjet Financës së vëndit dhe nëpunsit të depos.

Art. 24.

Fondet e huanave që mundet me kontraktue Instituti si dhe paradhanjet që mundet me marrë nga magazinat e përgjithëshme për grunë ose misër të depozituem pranë tyne, si edhe fondet që Shteti i ven në dispozicjon këtij konform me dispozitat e kësaj Dekret-Ligje, administrohen prej Këshillit Administrativ t'Institutit dhe përdoren eksklusivisht për qëllimet e caktueme në këtë Dekret-Ligjë.

Këshilli Administrativ i Institutit ka me delegue në mest të tij personat që janë t'autorizuem me pengue ose me disponue fondet e Institutit, tue caktue gjith herë së paku dy persona, nder të cillët njeni duhet me kenë nji prej Këshilltarve të deleguem.

Këshilli Administrativ depoziton, herë mbas here, pranë Zyrës financjare ose degave të Bankës Kombëtare të Shqypnis shumat që i konsideron të nevojshme me i vue në dispozicjon personelit të ngarkuem me mbikqyrjen e depove, të cillët delegohen për blerjen e grunit e të misrit.

Art. 25.

Në rasë se çmimet e grunit e të misrit në tregun e mbrendëshem influencohen në mënyrë që lejon shitjen prej anës së Institutit të grunit ose të misrit, Instituti detyrohet me ja këthye të hollat Arkës së Shtetit për gjithë grunin e misrin të shitun në këtë mënyrë.

Kuer tendenca e çmimeve të grunit e të misrit nuk lejojnë shitjen në vend, Instituti ja parashtron çështjen Këshillit Ministruer, i cili mbasi të ketë shqyrtue prognozen e produkcionit për vjetin e ardhëshem, mundet me vendue shitjen e grunit e të misrit ose përjashta me çmimet e tregut botnuer, në të cillën rasë, Instituti kundra vleftën ja dorëzon Ministrisë së Financavet.

Art. 26.

Marrëdhanjet ndërmjet Shtetit e t'Institutit rregullohen prej Ministris së Financavet e Këshillit Administrativ t'Institutit.

Art. 27.

Për efekte budgetore t'ardhunat shtetnore nga të dhetat e vona e të lashta t'ushtrimit financjar 1934-35 vërtetohen e nxjerren me versimet e bame nga Instituti.

Dhanja e grunit në pagesë për të dheta të mbrapambetuna e

për të dhetat e ushtrimit 1933-34 nga ana e dhtarve, konsiderohet si nxjerrje definitive për të gjitha efektet.

Defiçiti qi mund të rezultojnë ndermjet vertetimit e nxjerrjes së dhetave të mbrapambetuna, si edhe që mund t'i rrjedhin Institutit nga blerja e shitja e grunit e të misrit e nga shpenzimet e ndryshme, paksojnë t'ardhunat e të dhetave t'ushtrimit financjar 1934.35.

Art. 28.

Shteti rezervon të gjitha të drejtat e evidencës e t'inspektimit për të gjith gestjonin e Institutit e të degave të tij.

Budgeti konsumtiv i Institutit i referohet Këshillit Kontrollues për shqyrtim.

TITULLI IV.

Art. 29.

Për çështjet që Këshilli Administrativ i Institutit i konsideron me rëndësi të posaçme e qi nga kjo Dekret-Ligjë nuk rezulton se, i janë rezervue kompetencës së tij, asht kompetent Këshilli Ministruer.

Art. 30.

Veprimet që nuk janë të përmenduna shprehimisht në ketë Dekret-Ligjë, rregullohen me Ligjët Shtetnore në fuqi për të gjitha efektet.

Art. 31.

Instruksionet për zbatimin e dispozitave të kësaj Dekret-Ligje, i takojnë Ministris së Financavet d'akord me Këshillin Administrativ t'Institutit.

Art. 32.

Dispozitat për mirë zbatimin e kësaj Dekret-Ligje caktohen me Rregullore të posaçme.

Art. 33.

Kjo Dekret-Ligjë, hynë në fuqi qysh nga dita e shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Art. 34

Qeverija ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 854/I d. 11-VI-1934 të Kryeministris

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 9-VI-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi pranimin në pagesë të grunit e të misrit për të dhetat e ushtrimit financjar 1934-35, e për të dhetat e mbrapa-mbetuna nga ushtrimet e mâ parëshme dhe mbi blemjen e grunit dhe të misrit.

Tiranë, me 15 Qershuer 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Min. i P. të Mbrendëshme e Zav.
Ministri i Ekon. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 88.

DEKRET-LIGJË, 23 Qershor 1934.

Mbi bartje fondesh në budgetin e ushtrimit financjar 1933-1934 të Ministris së Financavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Qershor 1934, Nr. 35)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-34 të Ministris së Financavet, paksohen fondet për kapitull si vijon:

Kap. 50	Qira	fr. ari.	11.310
Kap. 51	Vërtetim tatimesh e taksash	»	5.400
Kap. 53	Shtypje pullash	»	1.400
Kap. 57	Ndertime e miratime	»	1.500
Kap. 58	Shpenzime gjyqi	»	11.000
		Fr. ari	30.610

Art. 2.

Fondet e paksueme si mbas art. 1 të kësaj Dekret-Ligjë, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-34 të Ministris së Financavet ndër kapituj si vijon;

Kap. 17 Shpenzime zyreje (Shpija Ushtarake)	Fr. ari	110
Kap. 41 Rrogë Jetike e shpërblim për merita Patriotike	»	23.100
Kap. 44 Rrogë personeli	»	1.200
Kap. 47 Shpenzime udhëtimi e djete	»	3.500
Kap. 52 Skonto pullash	»	2.500
	Fr. ari	30.610

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Dekret-ligje, ngarkohet Ministr' i Financavet.

Art. 4.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 858 datë 7-6-1934 të Kryeministris.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 5-6-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi bartje fondesh në budgetin e ushtrimit financjar 1933-34 të Ministris së Financavet.

Tiranë, me 23 Qershuer 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 89.

DEKRET-LIGJE, 15 Qershor 1934.

Për bartje të fondeve të Huas (S.V.E.A.)

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Qershor 1934, Nr. 35)

Art. 1.

Fondet e Huas SVEA të radhueme në këtë artikull e të caktueme nder kapituj të veçantë me Dekret-Ligjen 25 Qershuer 1929 dhe 20 Gusht 1930, që nuk janë pague e që përmbajnë shumën Fr. ari 5.893.809,52% barten të gjitha në fondin e Rezervës së Përgjithshme.

Kap.	I. Rruga	Fr. ari	600.000
Kap.	II. Ura	»	80.000
Kap.	IV. Hekur-udhë	»	1.555.566,10
Kap.	V. Ndertesa	»	360.000
Kap.	VI. Irrigacjone e Kanalizim	»	1.298.243,42
Kaj.	VII. Permirësim bakti e Bujqësi	»	1.000.000
Fond Rezervë për Irrigacjon e Kanalizim		»	1.000.000
		Fr. ari	5.893.809,52

Art. 2.

Me vendim të Këshillit Ministruer barten prej këtij fondi shumat e nevojshme për ndertime veprash botore të parapame në kapitujt relativ të Dekret-Ligjës me datë 25-VI-1929 si mbas nevojave që do të parashifen prej Qeveris.

Art. 3.

Mbas likuidimit të çdo vepre që do të bahet këtej e tutje fondi i tepruem baret në fondin e rezervës të Përgjithshme.

Art. 4.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5.

Ministrija e Punve Botore dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 459/III d. 6-VI-934 të Kryeministriës.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 4-6-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi bartjen e fondeve të Huas «S.V.E.A.».

Tiranë, me 15 Qershor 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Ministri i P. Botore S. SARAÇI

Draft

Nr. 90.

DEKRET-LIGJË, 13 Qershor 1934.

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 2600 në budgetin e ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së P. Mbrendëshme (Degë e Shëndetsis)

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Qershor 1934, Nr. 35)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-34 të Ministris së P. të Mbrendshme e të Drejtoriës P. të Shëndetsiës bartet nji fond prej fr. ari 2600 (dymij-e-gjashtëqind) prej Kap. 12 «Rrogë personeli etj.» në Kap. 17 «Spital' i Përgjithshem ZOGU. I-rë».

Art. 2.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministri i P. të Mbrendëshme.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 856 d. 7-VI-1934 të Kryeministriës

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 5-VI-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 2600 në budgetin e ushtrimit financiar 1933-1934, të Ministris P. të Mbrendëshme «Degë e Shëndetsiës».

Tiranë, me 13 Qershor 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme MUSA JUKA

BKSH

Nr. 91.

DEKRET-LIGJË, 15 Qershor 1934.

Mbi krijimin e Komuneve në qendrat e Nenprefekturave që u suprimuan me budgetin shtetnuer të vjetit 1934-935

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Qershor 1934, Nr. 35)

Neni 1.

Në qendrat e ish Nënprefekturave Gramsh, Kurvelesh e Konispol krijohen Kryetarë Komunesh të klasit I-rë me rrogë 220 fr ari në muej.

Neni 2.

Në qendrat e ish Nënprefekturave Libohovë, Kolonje, Mailakaster, Shijak e Zerqan, Bashkija merr titullin Komune, e cila ka atë personel dhe me atë rrogë që caktohet në Ligjën e Bashkive dhe, në qytet (qendër) vepron si Bashki e, në katunde, si Komune.

Kryetarët e Bashkive të këtyne qendrave syprimohen dhe detyra e tyne u ngarkohet Kryetarëve të Komuneve që krijohen në ato kryevende, të cilët janë të klasit I-rë dhe marrin rrogë nga t'ardhunat e Bashkis 220 fr. në muej.

Kuvendi dhe Këshilli i Bashkis zgjidhen dhe veprojnë në bazë të Ligjës së Bashkivet vetem në qytet (qender).

Katundet përfaqsohen prej Këshillit Komunal, i cili zgjidhet dhe vepron në bazë të Ligjës së Komuneve.

Neni 3.

Kryetarët e Komuneve të qendrave t'ish Nënprefekturave që përmenden në nenin 1 e 2 të kësaj Dekret-Ligje, kryejnë të gjitha detyrat që i janë ngarkue Nënprefektit me Ligjët në fuqi. Kompetenca e tyne në këtë cillësi zgjatet në të gjithë juridiksionin administrativ të Nënprefekturës. Ata kryesojnë Këshillin Administrativ dhe për çdo çeshtje korespondojnë direkt me Prefekturen e Qarkut.

Neni 4.

Për zbatimin e kësaj Dekret-Ligje ngarkohet Trupi Ministruer.

Neni 5.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr.427/V datë 2-6-1934 të Kryeministriës.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 4-6-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi krijimin Komuneve në qendrat e Nënprefekturave që u suprimuen me budgetin Shtetnuer të vjetit 1934-35.

Tiranë, me 15 Qershor 1934. ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri P. Mbrendëshme e Zar.

Ministri i Ekon. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 92

DEKRET-LIGJË, 20 Qershor 1934.

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 34.410 në budgetin e ushtrimit 1933-934 të Ministris s'Arësimit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Korrik 1934, Nr. 37)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit Financjar 1933-34 të Ministris s'Arësimit pakësohen fondet për kapituj si vijon:

Kap. 1. «Rrogë personeli, zavendësije etj.»	Fr. ari	20.000
Kap. 2 «Rrogë personeli me kontratë	»	1.259
Kap. 3 «Shpenzime udhëtimi e djete»	»	3.200
Kap. 4 «Shpenzime Zyreje»	»	5.853
Kap. 6 «Qira lokalesh e qira për tokat e Shkollës Teknike»	»	1.543
Kap. 9 «Bursa studentash të mbrendëshme e të jashtme»	»	2.555
	Fr. ari	34.410

Art. 2.

Fondet prej fr. ari 34.410 (tridhjetekatër mijë e katërqindedhjetë) pakësue si mbas Art. 1 të kësaj Dekret-Ligje, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1933-34 të Ministris së Arësimit nën Kap. 7 «Shpenzime

për mbajtje konviktesh etj.»	Fr. ari 33.800
Kap. 11 «Taksa Shtetnore e Doganore etj»	» 610
	Fr. ari 34.410

Art. 3.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë, ngarkohet Ministri i Arsimit.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 938 datë 19-6-1934 të Kryeministris.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 18-6-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi bartje fondesh prej fr. ari 34.410 në budgetin e ushtrimit 1933-34 të Ministris s'Arësimit.

Tiranë, me 20 Qershuer 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Arësimit Dr. MIRASH IVANAJ

Nr. 93.

DEKRET-LIGJË, 15 Qershor 1934.

Mbi akordin plotësuer t'aneksës C të Traktatit të Tregëtisë dhe të Lundrimit i përfunduem midis Mbretnis Shqiptare dhe Mbretnis Jugosllave me 22 Qershuer 1926, për trafikun që i përket tregut të Shkodrës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Korrik 1934, Nr. 37)

Neni 1.

Pranohet akordi plotësuer i anekses C të Traktatit të Tregëtisë

dhe të Lundrimit i bamë midis Mbretnies Shqiptare dhe Mbretnies Jugosllave me 22 Qershuer 1926, për trafikun kufizor që i përket tregut të Shkodrës, si mbas tekstit të bashkangjitun.

Neni 2.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi si mbas kushteve të caktueme n'akordin e nalt-përmendun.

Neni 3.

Ministrija e P. të Jashtme, Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi prpopozimin e bamun me shkresën Nr. 218/IV dat 6-VI-934 të Kryeministris.

Si ndigjojë e pëlqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 4-VI-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi pranimin e Akordit Plotësuer t'Anekses C të Traktatit të Tregëtisë dhe të Lundrimit, i përfunduem midis Mbretnis Shqiptare, dhe Mbretnis Jugosllave me 22 Qershuer 1926, për trafikun kufizuer që i përket tregut të Shkodrës, bamë në Belgrad me 5 Maj 1934.

Tiranë, me 15 Qershor 1934. ZOG

Kryeministri	*Ministri i P. të Jashtme*
P. EVANGJELI	XHAFER VILA
Ministri i P. Mbrendëshme	*Ministri i Financavet*
MUSA JUKA	A. DIBRA

ACORD PLOTËSUER I ANEKSES C. TË TRAKTATIT TË TREGËTISË DHE TË LUNDRIMIT I PËRFUNDUEM MIDIS MBRETNIS SHQIPTARE DHE MBRETNISË JUGOSLLAVE ME 22 QERSHUER 1926

TRAFIKU KUFIZOR QË I PËRKET TREGUT TË SHKODRËS

Akord-plotësuer i anekses C

(«Dispozita që i përkasin trafikut kifizor»)

të Traktatit të Tregëtisë dhe të lundrimit i përfunduem me 22 Qershor 1926 në Belgrad midis Mbretnisë Shqiptare dhe Mbretnis Jugosllave.

Tue dishrue me zhvillue trafikun kufizor dhe me lehtësue marrëdhanjet tregëtare të banorve të zonës kufizore,

Mbretnija Shqiptare dhe Mbretnija Jugosllave, tue dasht me bamë nji akord-plotësuer t'aneksës C të Traktatit të Tregëtisë dhe të Lundrimit i përfunduem me 22 Qershor 1926, kanë emnue për ketë qëllim si fuqiplotet e tyre:

Nalt-Madhënija e Tij Mbreti i Shqiptarëve :

Ekselencën e tij Zotin Rauf Fico, I Dërguem i Jashtzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë pranë Nalt Madhënisë së Tij Mbretit të Jugosllavis.

Ekselencen e tij Zotin Dhimitër Beratti, Ministër Fuqiplotë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëvet të Jashtme të Mbretnisë Shqiptare;

Nalt Madhënija e Tij Mbreti i Jugosllavisë :

Ekselencen e tij Zotin Juraj Demetrovic, Ministër i Tregëtisë dhe i Industrisë.

Ekselencën e tij Zotin Bogoljub Jevtic, Ministër i Punëvet të Jashtme ;

të cilët, mbassi shkembyen letrat-fuqiplote të tyne që u gjetën në formen e mirë dhe të duhun, u-kuptuan mbi sa vijon:

Artikulli 1.

Banorët e nji tog katundesh të zonës kufizore jugosllave që gjinden në jug të liqenit të Shkodrës, munden me shkue në treg të Shkodrës për me shitë atje produktet dhe të blejnë aq sa u duhet për nevojat e tyne tue gëzue po nga ato lirime e privilegje të njohuna banorëve të zonës kufizore shqiptare, që shkojnë në tregjet Jugosllave dhe të parpaeme prej artikujve 2 e 3 t'anekses C të Traktatit të Tregëtisë dhe të Lundrimit.

Hollësinat që i përkasin interpretimit dhe zbatimit të këtij akordi plotësuer do të caktohen në kuptim të përbashkët midis dy Qeverinave po me atë rrugë qi asht marrë ose që do mund të merret për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave t'anekses C.

Artikulli 2.

Ky akord plotësuer do të hyjë në veprim ditën e shkembimit të ratifikimeve dhe, do të ketë një afat 3 vjetsh që nga dita e hymjes së tij në fuqi.

Në rast se njana nga Palët e Nalta Kontraktuese, 6 muej para mbarimit të periudhës në fjalë, nuk do të ketë njoftue qëllimin e sajë që të pushojnë efektet e tij, ky ka për t'u zgjatue në heshtje për një afat të pa-caktuem dhe, mundet me u denoncue në ç'do rast, me kusht që të mbesi në fuqi gjashtë muej që nga data e denoncimit.

Në rast të një denoncimi të tillë nga ana e njerës prej Palëve të Nalta Kontraktuese, gjatë afatit që ka vleftë Aneksa C, Traktatit të Tregëtisë dhe të Lundrimit të përfunduem me 22 Qershor 1926, Pala e Naltë Kontraktuese tjetër rezervon të drejtën me denoncue aneksen në fjalë.

Ky denoncim i fundit do të ketë efekt gjasht muaj, tue filiue nga data e njoftimit.

Dy Palët e Nalta Kontraktuese rezervojnë të drejtën me vue në fuqi ketë akord-plotësuer provizorisht para këmbimit të ratifikimeve me anë të një shkembimi notash.

Në ketë besë, fuqiplotët e nalpërmendun e kanë nenshkrue ketë akord-plotësuer.

Baem në Belgrad, me 5 Maj njimijenandëqindetridhjetekatër.

Për Mbretninë Shqiptare
Fauf Fico
Dhimiter Beratti

Për Mbretnin Jugosllave
Juraj Demetrovic
Bogoljub Jevlic

AKORD TREGTAR MBI IMPORTIMIN NË JUGOSLLAVIJË TË PESHKUT NGA PJESA SHQIPTARE E LIQENIT TË SHKODRËS

Akord suplementar

Tue pasë parasysh zbatimin plotësisht t'akordit suplementar të Traktatit të Tregëtisë dhe të Lundrimit të përfunduem në Belgrad me 20 Dhetuer 1933, dhe të frymëzuem nga dëshira të lehtësohet në masen e mundëshme zhvillimi i trafikut kufizor në mes të dy Shteteve, Qeveria e Mbretnisë Jugosllave dhe Qeveria e Mbretnis Shqiptare janë marrë vesht mbi sa vijon :

1) «Prizad», ose një tjetër sipërmarrje tregtare, do të ngarkohet me blerjen e peshqve të pjesës shqiptare të liqenit të Shkodres. Këto blerje do të bahen me ndermjetësinë e një sipërmarrjeje shqiptare që do të shënohet nga Qeveria Shqiptare.

2) Të dy sipërmarrjet do të merren vesht mbi mënyrën e caktimit të çmimit mesatar të blerjes.

3) Blerjet e sipërthanuna, do të bahen mbrenda rethit të kushteve t'Akordit Tregëtar' i bamë me 20 Dhetuer 1933.

4) Ky akord suplementar do t'i parashtrohet për aprovim Qeverinave përkatëse. Do të hyjë në fuqie ditën në të cilen ky aprovim do të konstatohet me një shkëmbim notash që do të bahet në Tiranë sa ma parë që të jetë e mundur. Do të ketë po atë afat që ka Akordi Tregëtar i bamun në Belgrad me 20 Dhetuer 1933. Do të denoncohet, zgjatohet ose ndryshohet po n'ato kondita që janë parapaem prej artikullit 7 t'atij akordi.

Në ketë besë, fuqiplotët e kanë nenshkrue ketë akord suplementar dhe i vunë vulat e tyne.

Bamë në Belgrad, në dy origjinale, frengjisht me 8 Maj 1934.

Fauf Fico
Dhimiter Beratti

Juraj Demetrovic
Bogoljub Jevtic

ACCORD ADDITIONNEL À L'ANNEXE C. DU TRAITÉ DE COMMERCE ET DE NAVIGATION CONCLU ENTRE LE ROYAUME D'ALBANIE ET LE ROYAUME DE YOUGOSLAVIE LE 22 JUIN 1926

TRAFIC FRONTIÈRE RELATIF AU MARCHÉ DE SHKODRA

Accord additionnel à l'Annexe C

(«Dispositions concernant le trafic de frontière»)

du Traité de Commerce et de Navigation conclu le 22 Juin 1926 à Béograd entre le Royaume d'Albanie et le Royaume de Yougoslavie.

Désireux de développer le trafic de frontière et de faciliter les relations commerciales des habitants de la zone frontière,

Le Royaume d'Albanie et le Royaume de Yougoslavie voulant conclure un accord additionnel à l'Annexe C du Traité de Commerce et de Navigation conclu le 22 Juin 1926 ont nommé à cet effet, pour leurs Plénipotentiaires :

Sa Majesté le Roi des Albanais

Son Excellence Monsieur Raouf Fico, Envoyé Extraordinaire et Ministre Plénipotentiaire auprès de Sa Majesté le Roi de Yougoslavie.

Son Excellence Monsieur Démètre Beratti, Ministre Plénipotentiaire, Secrétaire Général du Ministère des Affaires Etrangères du Royaume d'Albanie;

Sa Majesté le Roi des Yougoslavie

Son Excellence Monsieur Juraj Demetrovic, Ministre du Commerce et de l'Industrie.

Son Excellence Monsieur Bogoljub Jevtic, Ministre des Affaires Etrangères ;

Lesquels, après avoir èchangé leurs pleins-pouvoirs trouvé: en bonne et due forme sont convenus de ce qui suit :

Article 1

Les habitants d'un certain nombre de villages de la zone frontiere Yougoslave située au sud du lac de Scutari pourront se rendre au marché de Shkodra pour y vendre leurs produits et s'approvisionner dans la mesure de stricte nécessité en jouissant des mêmes franchises et privilèges que ceux reconnus aux habitants de la zone frontière Albanaise se rendant aux marchés Yougoslaves et prévus aux articles 2 et 3 de l'Annexe C du Traité de Commerce et de Navigation.

Les détails relatifs à l'interprétation et à l'application du présent Accord additionnel seront fixés d'un commun accord entre les deux Gouvernements par la même voie que celle qui est suivie au qui pourra être suivie pour l'interprétation et l'application des dispositions de l'Annexe C.

Article 2

Le présent Accord additionnel entrera en vigueur le jour de l'échange des ratifications et aura une durée de trois années à partir du jour de son entrée en vigueur.

Dans le cas où une des Hautes Parties Contractantes n'aurait notifié, six mois avant la fin de ladite période, son intention d'en cesser les effets, il sera tacitement prolongé pour une durée indéterminée et pourra être dénoncé à chaque instant, à condition de rester en vigueur six mois à partir de la date de la dénonciation.

En cas d'une telle dânonciation de la part de l'une des Hautes Partie Contractantes pendant la durée de la validité de l'annex C du Traité de Commerce et de Navigation conclu le 22 Juin 1926, l'autre Haute Partie Contractante se réserve le droit de denoncer ladite Annexe.

Cette dernière dénonciation produira effet six mois à compter de la date de la communication.

Les deux Hautes Parties Contractantes se réservent le droit de mettre le présent Accord Additionnel en vigueur provisoire avant l'échange des ratifications au moyen d'un échange de notes.

En Foi de quoi les Plénipotentiaires susnommés ont signé le présent Accord Additionnel.

Fait à Béograd, le 5 Mai mil neuf cent trente quatre.

Pour le Royaume d'Albanie :

Rauf Fico

Démètre Beratti

Pour le Royaume de Yougoslavie :

Juraj Demetrovic

Bogoljub Jevtic

ACCORD COMMERCIAL CONCERNANT L'IMPORTATION EN YOUGOSLAVIE DU POISSON DE LA PARTIE ALBANAISE DU LAC DE SCUTARI

Accord Supplementaire

Ayant en vue l'application intégrale de l'Accord Additionnel au Traité de Commerce et de Navigation conclu à Béograd le 20 Décembre 1933, et inspirés du désir de faciliter dans la mesure du possible le développement du trafic frontière entre les deux Pays, le Gouvernement du Royaume d'Albanie et le Gouvernement du Royaume de Yougoslavie sont tombés d'accord sur ce qui suit :

1) «Prizad», au une autre entreprise commerciale, sera chargé de l'achat des poissons de la partie albanaise du Lac de Scutari. Ces achats seront effectués par l'intermédiaire d'une entreprise albanaise qui sera désignée par le Gouvernement Albanais.

2) Les deux entreprises se mettront d'accord sur la façon de fixer les prix moyens d'achat.

3) Les achats ci-dessus seront réalisés dans le cadre des dispositions de l'accord commercial du 20 Décembre 1933.

4) Le présent Accord Supplémentaire sera soumis à l'approbation des Gouvernements respectifs. Il entrera en vigueur le jour où cette approbation sera constatée par un échange de notes qui aura lieu à Tirana aussitôt que faire se pourra. Il aurra la même durée que l'accord commercial conclu à Béograd le 20 Décembre 1933. Il sera dénoncé, prolongé, au modifié dans les mêmes conditions que celles prévues à l'article 7 du dit Accord.

En foi de quoi les Plénipotentiaires ont singné le présent Accord Suplémentaire et y ont apposé leurs sceaux.

Fait à Béograd, en double original, en français, le huit Mai 1934.

Rauf Fico
Démètre Beratti

Juraj Demetrovic
Bogoljub Jevtic

Nr. 94.

DEKRET-LIGJË, 15 Qershor 1934.

Mbi Ujidin-Shtojcë të Konventës Tregtare dhe të Protokollit përfundues të sajë të bamë midis Shqipnis dhe Çekosllavakisë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Korrik 1934, Nr. 37)

Neni 1.

Pranohet Ujdija-Shtojcë e Konventës Tregtare ashtu dhe protokoli përfundues i sajë të nënshkruem në Pragë me 17 Prill 1934 midis Përfaqësuesve të Mbretnis Shqiptare dhe të Republikës Çekosllovake, simbas teksteve që shoqnojnë këtë Dekret-Ligjë.

Neni 2.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqij qysh prej shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Ministrija e Punve të Jashtme e Ekonomis Kombëtare dhe ajo e Financavet, ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi propomimin e bamun me shkresën Nr. 446/7 datë 6-6-1934 të Kryeministrisë.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 29-5-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi pranimin e U;-

dije Shtojce së Konventes Tregëtare dhe të protokolit përfundues të saj të bame midis Shqipnis dhe Çekosllovakisë.

Tiranë, me 15 Qershor 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri P. Mbrendshme e Zav.
Ministri i Ekonomis Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

UJDIE-SHTOJCE E KONVENTËS TREGTARE NË MES TË SHQIPNIS DHE ÇEKOSLLOVAKIËS E NËNSHKRUEME NË PRAHA ME 9 PRILL 1934

Qeverinat e Mbretnisë Shqiptare dhe e Republikës Çekosllovake, të frymëzueme që të dyja nga dëshira me i ba ma të ngushta e me i zhvillue marëdhanjet tregëtare dhe me lehtësue shkëmbimet në mes të dy Shtetevet në rethanat e sotshme të jashtzakonëshme në zbatim të Konventës Tregëtare të 9-tit Prill 1934, janë marrë vesht mbi dispozitat vijuese:

Artikulli 1.

Qeveria Shqiptare merr për-sipër të sigurojë dhe të përkrahë importimin në Shqipnië të mallnave origjinare nga Çekosllovakia. Importimi i tyne do të lejohet pa asnji lloj ndalimi ose kufizimi, përveç produkteve që eventualisht, në t'ardhmen, do t'i shtrohen ndonji regjimi që do t'ushtrojë kontrollin e tregëtisë së jashtme. Këto produkte, n'atë rast, do të lejohen me u-importue mbrënda kufinit të kontigjenteve që do të caktohen në bashkë-kuptim në mes të dy Qeverinave.

Artikulli 2.

1.) Qeveria Çekosllovake merr për sipër të sigurojë dhe të përkrahi importimin në Çekosllovakië të produkteve origjinare nga Shqipnia që shënohen në listën Nr. 1 ngjitun në këtë marrëveshtje, dhe këtë mbrënda kufinit të sasinave vjetore që janë treguar në të.

2) Importimi në Çekosllovakië të produkteve shqiptare të shënueme në listën Nr. 2 e ngjitun në këtë marrëveshje, dhe për të cilët nuk janë diftue kontingjente të caktueme, do të lejohet për sa i përket grupit të parë të kësaj liste, pa ndonji kufizim ose ndalim, dhe për grupin e dytë me mirë-dashje.

3) Në rast se do të bahet ndryshim për sa i përket, zbatimit të regjimit që rregullon tani importimin e këtyne produkteve në Çekosllovakië, të dy Qeverinat do të kuptohen mbi masat që duhen marrë për të mënjanue çdo damtim eventual për importimin në Çekosllovakië të produkteve me origjinë Shqiptare.

Artikulli 3.

Formalitetet për importimin në një nga të dy Shtetet të mallnave origjinare nga Shteti tjetër do të rregullohen me masat që janë në fuqië.

Artikull 4.

Për rregullimin e shkëmbimeve tregëtare të bame në bazë të kësaj Ujdije, do të lëshohen (t'epen) devisa që mund të përdoren dhe të transformohen lirisht, kështu që pagesa e mallnave të bahet drejt-përdrejt në mes t'eskportatorit dhe importatorit.

Artikull 5.

Aprovimi i kësaj Ujdije nga Qeverinat përkatëse do të vërtetohet me një shkëmbim notash që do të bahet në Tiranë. Do të hyjë në veprim 15 ditë mbas datës së këtyne notave dhe, do të ketë fuqië një vjet.

Mbi një parlajmërim prej nji muaji para daljes nga fuqia të kësaj ujdije, të dy Qeverinat rezervohen të filllojnë bisedimet për me vendosë kushtet me të cilët do të mund të përsëritet. .

Në këtë besë, fuqi plotët e nënshkruen këtë ujdije dhe vunë vulat e tyne.

Baem në Praha, në dy copë, me shtatëmbëdhetë Prill njimijënandëqintetridhetekatër.

Për Qeverinë e Mbretniës Shqiptare:

D. Beratti

Për Qeverinë e Republikës Çekoslovake

Dr. J. Skorkovsky

LISTA Nr. 1.

Produktet origjinare nga Shqipnija, importimi vjetuer i të cilëve në Çekosllovakië asht sigurue mbrënda kufinit të sasinave të posht-shënueme: 1)

BKSH

Grupi 1.

Nr. tarifës

ex	22	Duhan brutto, d.m.th. fletë duhani të pa punuem
ex	31	Groshë (fasule) të thata
ex	79/a	Vezë

Grupi 2.

	11	Citrona, limona, qitra
	86	Fshike dhe zorra, të njoma, të krypuna ose të thata
ex	156	Dru shqiptar (i verdhë)
ex	159	Shqeme, vallanidhe

1) Mbi sasinat e produkteve të shënuem në listën Nr. 1, mund të merren informata nga zyrat përkatëse.

LISTA Nr. 2.

A.

Produkte origjinare nga Shqipnija importimi i të cilëve në Çekosllovakië nuk i shtrohet ndonjë kufizimi ose ndalimi.

Nr. tarifës		*Lloji i produktve*
ex	17	Ullinj të freskët, të thatë ose të krypuna
	61	Zhuk. Rogoza etj
	83	Lëkura brutte etj.
	138	Brinje etj.
	220	Lesh delje etj.

B.

Produkte origjinare nga Shqipnija importimi i të cilëve në Çekosllovakië do të lejohet me mirë-dashje.

Nr. tarifës		*Lloji i produktve*
ex	31	Fjorza; bezele (rilla)
	68	Dhen e dhi
	69	qengja e keça
ex	75/a	Peshk deti
ex	75/b	Ngjalë dhe trofte
ex	104	Voj ullini
ex	106	Voj ullini
ex	134/a	1.: Landë ndërtese landë punimi
ex	134/a	2.:

PROTOKOL PËRFUNDUES
I UJDIES-SHTOJCË TË KONVENTËS TREGËTARE
NË MES TË SHQIPËRISË DHE ÇEKOSLLOVAKIËS

Në rastin e nënshkrimit t'Ujdisë shtojcë të Konventës tregëtare

BKSH

në mes të Mbretniës Shqiptare dhe të Republikës Çekosllovake e nënshkrueme në Praha me 9 Prill 1934, fuqiplotët e nënshkruemun u-kuptuan mbi pikat që vijojnë:

I.

1. — Të dy Qeverinat tue njohur se gjendja e eksportimeve shqiptare nuk ka dhënë, deri tani, përfundimet e dishrueme nga Qeveria e Mbretniës Shqiptare, d.m.th. equilibrin e balancës tregëtare në mes të dy Shteteve, u kuptuan t'a shqyrtojnë gjendjen e balancës së shkëmbimeve reciproke në bazë të tregimeve statistikore.

2. Në rast se do të konstatohet që, mbrënda nji afati 4 muejsh të zbatimit të kësaj Ujdije, masat e vendueme me këtë ujdij në favor t'eksportimeve të nalt-përmenduna, nuk e kanë ba të mundëshme afrimin e dishruem t'ekportimeve reciproke, të dy Qeverinat marrin përsipër me shqyrtue me nji shpirt miqsije dhe mirë-dashje masat e tjera që duhen marrë me kuptimin e përbashkët për t'a përmirësue sa ma tepër gjendjen e importimit të produkteve shqiptare në Çekosllovakie.

3. Midies masave tjera asht menduar të merret parasysh dhe, vendosja e një sistemi clearing që të regullojë transferimet, në mes të dy Shteteve dhe likuidimin e pagesave tregëtare reciproke.

II.

1. Për t'a shtrue shkëmbimin e mallnave midis tyne, të dy Qeverinat njohin dobijnë e funksionimit të regulltë të një institutı tregëtarë të përshtatshmë në Pragë (Odë tregëtare mikste, zyre ose shoqnie) dhe u-muarrnë vesht me dhanë ndihmën e tyre të dobishme për krijimin e sajë. Po ashtu kuptohen me favorizue aktivitetin e çdo firme ose shoqnije që, përgjithësisht, merret me tregëtinë e eksportimit midis Shqipnis dhe Çekosllovakisë, ose veçanërisht, me kompensimet private të prodhimeve kombëtare në mes të dy shteteve.

2. Qeveria Çekosllovake pranon me ndërhye ndaj qarqeve t'interesuem të Shtetit, n'asht se ndihet nevoja, për të sigurue krijimin dhe funksionimin e institutes të parapaeme në pikën e ma-parëshme.

III.

1. N'asht se për arësyena të randësishme të politikës tregëtare njera nga të dy Qeverinat do t'a gjykojë të nevojshme, ajo mundet me kërkue që mallnat origjinare nga Shteti tjetër të jenë

të shoqërueme, në çastin e importimit të tyne, prej një certifikate t'origjinës e lëshueme prej organeve kompetente ku, të tregohet kryeparë origjina, sasija dhe vlefta e mallit.

2. Në çdo rast, n'asht se sistemi i certifikatave do të tregohet i pa-zbatueshëm, statistikat e cilitdo nga këto dy Shtete, do të merren parasysh respektivisht, për importimet që vijnë nga Shteti tjetër.

IV.

1. Qeveria Çekosllovake merr përsipër të bajë çka duhet që të blejë Regjia e Duhaneve, gjatë kohës që ka vleftë kjo ujdij, sasinat e duhanit të treguem në listën Nr. 1.

2. Asht e marrun vesht se cilësinat e ndryshme që përdoren prej Regjisë do t'ofrohen në sasina të mjaftueshme dhe, me çmime që u-përgjigjen atyne duhaneve të Shteteve të tjerë, po të nji cilësije

3. Çmimet do të caktohen mbi bazën e ofertave që bahen prej shtëpijave tregëtare shqiptare dhe tjerave që do të marrin pjesë në ankandet ose në kërkesat e Regjisë Çekosllovake për duhanin shqiptar.

4. Eksportimi i duhaneve të blemun nga Regjia e Duhaneve Çekosllovake nuk do t'i shtrohet ndonji ndalimi, formaliteti, ose çdo lloj takse qoftë, përveç atyneve që janë të vendueme për duhanin e eksportuem në çdo tjetër Shtet.

5. Asht marrun vesht se, para caktimit të datës s'ankandeve, të kërkesave ose furniturave, Qeveria Çekosllovake do t'informohet pranë Qeverisë Shqiptare mbi afatet që u leverdisin produktorve shqiptarë ose organizimit të ngarkueme në Shqipnië me eksportimin e duhanit. Gjithashtu asht e marrun vesht se dorëzimet e duhanit shqiptar mund të bëhen me afate të ndryshme, me kuptim të përbashkët, tue marrë parasysh nevojat e Regjisë së duhaneve Çekosllovake dhe mundësinat e tregut shqiptar në mënyrë që, të bahet efektivisht importimi në Çekosllovakië e sasinave të caktueme të duhanit.

V.

Sejcila nga të dy Qeverinat detyrohet të shqyrtojë me mirëdashje ofertat që vijnë nga firmat e Shtetit tjetër dhe, të paraqituna me rastin e furniturave që do të bahen për Shtetin ose për institutet botore.

Baem në Praha, në dy copë me 17 Prill 1934.

D. Beratti *Dr. J. Skorkovsky*

ARRANGEMENT ADDITIONNEL
À LA CONVENTION DE COMMERCE ENTRE LA TCHÉCOSLOVAQUIE ET L'ALBANIE SIGNÉ À PRAHA LE 9 AVRIL 1934

Les Gouvernement de la République Tchécoslovaque et du Royaume d'Albanaie, également animés du désir de resserrer et de développer les relations commerciales et de faciliter les échanges entre les deux Pays dans les présentes circonstances exceptionnelles, sont convenus, en exécution de la Convention Commerciale du 9 Avril 1934, des disposition suivantes :

Article 1.

Le Gouvernement albanais s'engage à assurer et à encourager l'importation en Albanie des produits originaires de Tchécoslavaquie. Leur importation sera admise sans aucune sorte de restriction ni limitation, sauf les produits qui éventuellement seraient soumis, à l'avenir, à un régime quelconque comportant le contrôle du commerce extérieur. Ces produits, le cas échéant, seront admis à l'importation dans la limite des contingents à fixer, d'un commun accord entre les deux Gouvernements.

Article 2.

1) Le Gouvernement Tchécoslovaque s'engage à assurer et à encourager l'importation en Tchécoslovaquie des produits originaires d'Albanie figurant sur la liste Nr. 1 jointe à cet Arrangement, et ce dans la limite des quantités annuelles y indiquées. .

2) L'importation en Tchécoslovaquie des produits albanais figurant sur la liste Nr. 2 jointe au présent Arrangement et pour lesquels des contingents précis n'ont pas été fixés, sera accordée, en ce qui concerne le premier groupe de cette Liste, sans limitâtions ou restriction quelconque, et pour le deuxième groupe, avec bienveillance.

3)Dans le cas où un changement interviendrait en ce qui concerne l'application du régime réglant actuellement l'importation de ces produits en Tchécoslovaquie, les deux Gouvernements se mettront d'accord sur les mesures à prendre en vue de prévenir tout préjudice éventuel pour l'importation en Tchécoslovaquie des produits originaires d'Albanie.

Article 3.

Les formalités pour l'importation dans l'un des deux Pays des marchandises originaires de l'autre Pays seront régies par les prescriptions en vigueur.

BKSH

Article 4.

Pour le règlement des échanges commerciaux effectués sur la base de cet Arrangement seront accordées des devises librement utilisables et transférables, afin que le paiement des marchandises puisses avoir lieu directement entre exportateur et importateur.

Article 5.

L'approbation du présent Arrangement par les Gouvernements respectifs sera constatée par un échange de Notes qui aura lieu à Tirana. Il entrera en vigueur 15 jours après la date de ces Notes et restera en vigueur pour une période d'une année.

Sur préavis d'un mois avant l'expiration de la validité du présent Arrangement, les deux Gouvernements se réservent d'entamer des négociations en vue d'établir les conditions dans lesquelles il pourra être renouvelé.

En foi de quoi, les Plénipotentiaires ont revêtu le présent Arrangement de leurs signatures et sceaux.

Fait à Praha, en double exemplaire, le dix sept Avril mil neuf cent trente quatre.

Pour le Gouvernement de Royaume d'Albanie:

D. Beratti

Pour le Gouvernement de la République Tchécoslovaque:

Dr. J. Skorkovsky

LISTE Nr. 1.

Produits originaires d'Albanie dont l'importation annuelle en Tchécoslovaquie est assurée dans la limite des quantités sous indiquêes. 1)

Groupe I.

Nr. du tarif	
ex 22	Tabac brut, c'est à dire feuilles de tabac non travaillés
ex 31	Haricots secs
ex 79/a	Oeufs de volaille

Groupe II.

11	Citrons, limons, cédrats
86	Vessies et boyaux, frais, salés ou séchés
ex 156	Bois albanais (bois jaune)
ex 159	Sumac, vallonées

1) N. B. Sur les quantités des produits indiqués dans la liste N° 1. on peut prendre des informations auprès des bureaux compétents.

BKSH

LISTE Nr. 2.

A.

Produits originaires d'Albanie dont l'importation en Tchécoslovaquie n'est pas soumise à une limitation ou restriction quelconque.

N°. du tarif	*Désignation des produits*
ex 17	Olives fraîches, sèches ou salées
61	Varech, sparte etc.
83	Peaux et cuirs, bruts etc.
138	Cornes etc.
220	Laine de mouton etc.

B.

Produits originaires d'Albanie dont l'importation en Tchécoslovaquie sera accordée avec bienveillance.

N°. du tarif	*Désignation des produits*
ex 31	Lentille, pois
68	Brebis et chèvres
69	Agneaux et chevreaux
ex 75/a	Poissons de mer
ex 75/b	Anguille et truite
ex 104	Huile d'olive
ex 106	Huille d'olive
ex 134/a	1. :Bois de construction et bois d'oeuvre
ex 134/a	2. :Bois de construction et bois d'oeuvre.

PROTOCOLE FINAL
À L'ARRANGEMENT ADDITIONNEL À LA CONVENTION DE COMMERCE ENTRE L'ALBANIE ET LA TCHÉCOSLOVAQUIE -

Au moment de procéder à la signature de l'Arrangement Additionnel à la Convention de Commerce entre le Royaume d'Albanie et la République Tchécoslovaquie singé à Praha le 17 Avril 1934 les Plénipotentiaires soussignés sont tombés d'accord sur les points suivants :

I.

1. Les deux Gouvernements reconnaissant que l'état des exportations Albanaises en Tchécoslovaquie n'a pas donné, jusqu'à présent, les résultats désirés par le Gouvernement du Royaume d'Albanie, c'est-à-dire l'equilibre de la balance commerciale entre

BKSH

les deux Pays, sont convenus d'examiner, sur la base des données statisques, la situation de la balance des échanges réciproques.

2. Dans le cas où on contaterait, que, dans un delai de 4 mois d'application du présent Arrangement, les mesures convenues par cet Arrangement en faveur desdites exportations n'ont pas rendu possible le rapprochement désirable des exportations réciproques, les deux Gouvernements s'engagent à examiner, dans un esprit d'amitié et de bienveillance, les mesures ultérieures à prendre d'un commun accord pour améliorer davantage la situation de l'importation des produits albanais en Tchécoslovaquie.

3. Parmi les mesures ultérieures on a envisagé aussi de prendre en considération l'établissement d'un système de clearing réglant les transferts entre les deux Pays et la liquidation des créances commerciales réciproques.

II.

1. En vue de stimuler l'echange réciproque de marchandises, les deux Gouvernements reconnaissant l'utilité du fonctionnement régulier à Praha d'une institution commerciale appropriée (Chambre de Commerce mixte, Office ou Société) et conviennent de prêter leur appui efficace pour sa création. Il conviennent également de favoriser l'activité de toute firme ou société s'occupant, en général, du commerce d'exportation entre l'Albanie et la Tchécoslovaquie, ou, en particulier, des compensations privées de produits nationaux entre les deux Pays.

2. Le Gouvernement Tchécoslovaque accepte d'intervenir auprès des milieux intéressés du pays, si le besoin se faisait sentir, afin d'assurer la création et le fonctionnement de l'institution envisagée par l'alinéa précédent.

III.

1. Si pour des raisons sériuses de politique commerciale, l'un des deux Gouvernements le jugera nécessaire, il pourra demander que les marchandises originaires de l'autre pays soient accompagnées au moment de leur importation, d'un certificat d'origine délivré par les organes compétents et indiquant notamment l'origine ,la quantité et la valeur de la marchandise.

2. En tous cas, si le système des certificats se montrerait inapplicable, la statistique de chacun des deux Pays fera foi, respectivement, pour les importations venant de l'autre Pays.

IV.

1. Le Gouvernement Tchécoslovaque s'engage à faire le nécessaire à ce que la Régie des Tabacs, pendant la durée de la validité de cet Arrangement, achète les quantités de tabac indiquées sur la liste N° 1.

2. Il est entendu que les différentes qualités employées par ladite Régie se trouvent offertes en quantitées suffisantes et à des prix correspondant à ceux des tabacs de qualité analogue des autres pays.

3. Les prix seront déterminés sur la base des offres faites par les maisons de commerce Albanaises et autres qui participeront aux adjudications ou aux demandes de la Régie Tchécoslovaque pour le tabac Albanais.

4. L'exportation des tabacs achetés par la Régie des Tabacs Tchécoslovaque ne sera soumise à d'autres réstrictions, formalités ou taxes quelconques, que celles fixées pour le tabac exporté dans un autre pays quelconque.

5. Il est entendu que, avant de fixer les dates des adjudications, des demandes ou des fournitures, le Gouvrnement Tchécoslovaque s'informera auprès du Gouvernement albanais au sujet des délais qui conviendraient aux produkcteurs albanais ou à l'organisme chargé en Albanie de l'exportation du tabac. Il est également entendu que les livraisons de tabac albanais pourront être échelonnées, d'un commun accord, en tenant compte des besoins de la Régie des Tabacs Tchécoslovaque et des possibilités du marché albanais, de façon à rendre effective l'importation en Tchécoslovaquie des quantités de tabac convenues.

V.

Chacun des deux Gouvernements s'engage à considesér avec bienveillance les offres venant des maisons de l'autre Pays et présentées à l'occasion des fournitures destinées à l'Etat ou aux institutions publiques.

Fait à Praha, en double exemplaire, le 17 Avril 1934.

D. Beratti *Dr. J. Skorkovsky*

BKSH

Nr. 95.

DEKRET-LIGJË, 13 Qershor 1934.

Mbi Modifikimin e Ligjës datë 5-II-1923 mbi pensjonet Ushtarake e të Ligjës datë 2-VI-1932, mbi ndryshimin e disa dispozitave të Ligjës së Pensjoneve Ushtarake

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Korrik 1934, Nr. 37)

Neni 1.

Neni 1 i Ligjës datë 2 Qershor 1932 me të cilen bahen ndryshimet mbi Ligjen datë 5 Fruer 1923, të pensjoneve ushtarake, modifikohet si vijon:

«Oficerët e të gjithë armevet dhe trupevet në sherbimin t'Ushtris e të Gjindarmeris, qofshin në sherbim të përhershëm plotësimi, ose rezervë, po të thirren në sherbim u ndalohen 6% (gjashtë per qind) prej rogës muejore në favor t'Arkës së pensjoneve».

Po kësaj ndalese i shtrohen edhe oficjerët e pensionuem, gjith' ashtu edhe trashëguesat e Oficeravet qi marrin pensjon.

Neni 2.

Ministrija e Financavet autorizohet me transferue shumen qi rezulton nga shtesa e përqindjes, nga kapitulli relativ i buxhetit të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, dhe atij të Gjindarmeris n'ate të Ministris së Financavet qi, përmbledh fondin në favor t'arkës së pensioneve.

Neni 3.

Paragrafi b) c) dhe e) i art. 33 të Ligjës së Pensjoneve Civime datë 28-X-1927 qi bajnë fjalë mbi ndaljen në favor t'arkës së pensjoneve të gjysmës së rrogës së parë, të shtesës në rast gradimi, si dhe 5% mbi djetat indemnitetet dhe përfaqsimet, zbatohet edhe për oficerat të ç'do arme.

Neni 4.

Nga pjesa ma e madhe se Fr. ari 200 (dyqind) në muaj, e të gjitha pensjonet ushtarake qi janë lidhë ose qi do të lidhen mbas hymjes në fuqi të kësaj Dekret-Ligjë, në bazë të «Shtojcës mbi Ligjen e Pensjoneve t'ushtris» me datë 5-II-1923, në se nuk ka ndërhye ndonji rasë q'i jep të drejtë per nji pensjon të jashtzakonëshem si mbas art. 19 të Ligjës datë 5-II-1923, dhe nenit 4 të Ligjës datë 2-VI-1932, bahet nji zbritje prej 50% (pesdhjet për qind) në favor t'Arkës së Pensjoneve.

Neni 5.

Abrogohen të gjitha dispozitat në kundërshtim me këtë Dekret-Ligjë, zbatim' i të cilës fillon qysh me 1 Qershuer 1933.

Neni 6.

Me zbatimin e kësaj Ligjë ngarkohet Trupi Ministruer.

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri P. Mbrendshme e Zav.
Ministri i Ekonomis Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 928/II datë 12.VI-1933, si ndigjoj dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 9-VI-1933.

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi modifikimin e Ligjës me datë 5-II-1923 mbi pensjonet ushtarake e të Ligjës me datë 2-VI-1932 mbi ndryshimin e disa dispozitave të Ligjës së Pensjoneve Ushtarake.

Durrës, me 3 Korrik 1933. Z O G

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve

D E K R E T O N

Aprovimin e zbatimin e Dekret-Ligjës me datë 3 Korrik 1933, e aprovueme prej Parlamentit, dhe urdhënon shtimin e tij në kodet e Mbretnis si Ligjë

Tiranë, me 13 Qershuer 1934 Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri P. Mbrendshme e Zav.
Ministri i Ekonomis Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 96.

DEKRET-LIGJË, 13 Qershuer 1934.

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 2.000 në budgetin e ushtrimit 1933-34 të Ministris së P. Botore (Degë Post-telegrafave)

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Korrik 1934, Nr. 37)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933.34 të Ministris së P. Botore (Drejtorija e Përgjithshme e P. T. T.) paksohen nga Kap. «Qira» fr. ari 1.000 e nga kap. 21 «Taksa aerore» (pjes' e huej) fr. ari 1.000, gjithësejt fr. ari 2.000.

Art. 2.

Shuma e paksueme si mbas art. 1 të kësaj Dekret-Ligje, fr. ari 2.00 i shtohet kap. Nr. 15 «Bartje postash, të jasht-zakonëshme» të gjendjes së parpamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-34, të Ministris së P. Botore (Drejtorija e Përgjithshme e P. T. T.)

Art. 3.

Kjo Dekret-Ligje, hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Dekert-Ligje ngarkohet Ministr' i P. Botore.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptrvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 857 datë 7-6-1934 të Kryeministris,

Si studjojë dhe pëlqejë vendimin e Kshillit Ministruer me datë 5-6-1934.

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 2.000, në budgetin e ushtrimit 1933-34 të Ministris së P. Botore «Degë Post-Telegrafave».

Tiranë, me 13 Qershuer 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 97.

LIGJË, 20 Qershuer 1934.

E Pensioneve Civile dhe Ushtarake

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Korrik 1934, Nr. 38 bis)

Titulli I.

DISPOZITA TË ZAKONËSHME

KAPTINA I.

Personat që kanë të drejtë pensioni dhe kondita.t e përgjithshme për njoftjen e së drejtës së tyne

Neni 1.

Në bazë të normave të caktueme me ketë Ligjë, kan të drejtë pensioni të regullt ose shpërblimi të njihershëm:

a) nëpunësit civil t'emnuem me Dekret-Mbretnuer, me Dekret ose urdhën Ministerjal e që marin nga Arka e Shtetit nji rrogë muejore të caktueme me Ligjët në fuqi;

b) ushtarakët e Ushtris Kombëtare;

c) personeli i Armës së Gjindarmeris.

Art. 2.

Për me fitue të drejtën e pensionit të rregulltë ose të shperblitë njihershëm duhet që i interesuemi të jetë largue nga sherbimi me Dekret-Mbretnuer, Ministerjal ose me nji tjetër masë ose të drejtë ligjore si mbas rasave të parapame me ligjët e Shtetit dhe të jenë vertetue konditat e caktueme prej kësaj Ligje.

Përjashtohen nga e drejta e pensionit të rregulltë ose e shpërblimit të njihershëm personat e marrun në sherbim me kontratë.

Art. 3.

Kanë të drejtë për pension të privilegjuem, sa do kjoftë koha e sherbimit, nepunësit civil, ushtarakt e gjindarmt që nga nji sëmundje, plagosje ose çfarëdo lezioni të marrun për shkak eksklusiv t'ushtrimit të funksioneve të tyne, bahen të pa aftë per herësisht me vazhdue në sherbim, e si të tillë janë largue nga sherbimi me Dekret-Mbretnuer, Ministerial, me nji tjetër masë ose të drejtë ligjore.

Ay që merr nji sëmundje, plagosje o lezion që nuk shkaktojnë pa-mundësin e vazhdimit të tij në detyrë, mbahet në sherbim si mbas dispozitave të nenit 26.

BKSH

Kërkesa për konstatimin e sëmundjes, plagosjes ose të lezionit të përmendun në dy paragrafet e para të këtij neni, duhet të bahet nga i interesuemi pranë autoritetit nga i cili mvaret mbrenda gjashtë muejsh që nga data në të cillen asht vertetue ngjarja. Mos kërkesa e konstatimit mbrenda kësaj kohe, shkakton humbjen e ç'do të drejtës së pensionit të privilegjuem përveç rasteve të forcës madhore të provueme.

Sëmundja e marrun në raste epidemije ose endemije në vende ku ka ra ose asht përhapë kjo, nuk konsiderohet se asht marrë për shkak sherbimi, përveç kuer provohet se i interesuemi sëmundjen në fjalë e ka marrë se ka ushtrue nji detyrë të posaçme në vendin e epidemis, ose tue qenë në nji vend të shëndoshtë asht urdhnue me shkue në vendin e epidemis edhe, në këtë mënyrë u ekspozue në rrezik dhe ka marrë sëmundjen.

Mjekët privat qi merren në sherbim të jashtzakonshem në raste epidemije, si kolerë, murtajë, li, tyfus-ekzantematik, etj...., dhe që sëmuhen nga shkaku i shërbimit të posaçem dhe, bahen të pa aftë për punë, fitojnë të drejtën e pensionit të privilegjuem në bazë të rrogës që marrin kolegët e tyne në sherbim.

Mënyra e konstatimit administrativ dhe shëndetsuer e smundjes caktohet në Rregulloren e aplikimit të kësaj Ligjë.

KAPTINA II.

Llogaritja e sherbimevet dhe baza e likuidimit të pensionit të rregulltë dhe shpërblimit të njiherëshëm

Neni 4.

Janë të vlefshme për efektet e të drejtës për pension gjithë sherbimet e bame ndër nëpunësinat dhe çilësinat të shenueme në Nenin 1, edhe sikur të jenë bamë nder nëpunësina dhe cilësina të ndryshme, qoftë dhe me nderpremje midis tyne.

Neni 5.

Sherbimet e bame ndër nëpunësinat e cilësinat e përmenduna ma naltë, llogariten që prej datës së fillimit në detyrë, por nuk asht e vlefshme, për civilët, koha e shërbimit të bamë pa mbushë moshen 20 vjeç, dhe për ushtarakët koha e sherbimit të bamë pa mbushë moshën 18 vjeç.

Neni 6.

Nuk llogaritet si sherbim i vlefshëm për pension:

a) koha që écë ndermjet të largimit nga sherbimi deri në kohën e rimarrjes ose të fillimit në nji detyrë të ré;

b) koha e vuajtjes së nji ndeshkimi penal kundra liris personale, si dhe ajo e pezullimit që përfundon me nji ndeshkim penal:

c) koha e kalueme në pritmeni për arësyena private;

ç) sherbimi ushtarak i kryem para dënimit me degradim ose dënimit për arati në kohë paqe ose lufte, por i aratisuni në kohë lufte nuk përfiton as nga amninistia as nga falja, as nga ri-aftësimi në llogaritjen e kohës së pensionit;

d) koha e kalueme në pezullim disiplinuer të gradës ose të nëpunësis, kurdoherë që pezullimi asht ma tepër se nji muej;

dh) koha që ushtaraku e personeli i Armës së Gjindarmeris e kalojnë në lirim të pa-caktuem.

Neni 7.

Llogaritet për gjysë në sherbimin e dobishëm për pensjon, koha e kalueme në pritmeni për sëmundje që nuk rrjedhin nga sherbimi si mbas Ligjës mbi Gjendjen juridike të nëpunësave.

Llogaritet plotësisht si shërbim efektiv i dobishëm për pension koha e kalueme:

a) në pritmeni, për shkak sëmundjeje, plagosjeje ose lezione që rrjedhin nga sherbimi;

b) në robni lufte si mbas nenit 10 të kësaj Ligjë ose n'internim prej fuqive okupuese të hueja.

Neni 8.

Nëpunësave ose ushtarakëve që rimerren në sherbim passi kanë dalë në pension, u ndalet pensioni për sa vazhdon sherbimi i ri.

Sherbimi i ri bashkohet me të ma-parshmin për likuidimin e pensionit që mund t'i përkasë eventualisht passi del nga shërbimi për herën e dytë.

N'asnji rast pensioni, i ri nuk mund të jetë ma i vogël se i pari.

Ushtaraku ose nëpunësi që nuk fiton të drejtën e nji pensioni të ri për ç'do shkak që të jetë, rifiton të drejtën me marrë pensionin e ma-parshem.

Rimarrje në sherbim të nji pensionisti bahet me Vendimin e Këshillit Ministruer.

Neni 9.

Kuer nëpunësi ose ushtaraku, pasi ka marrë nji shpërblim të njihershëm për sherbimet e maparëshme hyen persërij në detyrë, mund t'i bashkohen dy periudhat e shërbimit tue këthye shperbli-

met me kiste mbrenda dy vjetëve ç'prej datës së rimarrjes në shërbim. Këthimi mund të bahet me anë të ndalesave muejore mbi rrogë.

Në raste që nëpunësi ose ushtaraku nuk do me bashkue dy periudhat e sherbimit, mund të mbajë shpërblimin e marrun ma parë dhe, atëherë ka të drejtë vetëm për pensionin ose shpërblimin e njiherëshem që, eventualisht mund t'i përkasi, në bazë të sherbimit të ri.

Po këto dispozita zbatohen dhe për ata qi trashigojnë pensjonin o shpërblimin e njihershëm të nëpunësit, t'ushtarakut ose të gjindarmit qi gjindet në gjendjen e parapame në paragrafin 1 (nji) të këtij neni.

Neni 10.

Perjudha e sherbimit të bamë në luftë si ushtarak, gjindarm ose nepunës civil i mobilizuem pranë trupavet, komandave ose reparteve të mobilizueme, llogaritet dy fish dhe nuk mund të filiojë para fillimit të luftës, dhe nuk mund të vazhdojnë mbas mbarimit të sajë.

Për ata që kan dalë nga sherbimi i trupavet, komandave o reparteve të mobilizueme për shkak sëmundjeje, plagosjeje ose lezioni, koha e aklueme deri sa të riaftësohen për shërbim të plotë konsiderohet sikuer kohë shërbimi pranë enteve të mobilizueme të sipër-tregueme, por jo mbas mbarimit të luftës. Po nji e tillë dispozitë zbatohet për personat e nalt-përmenduna kuer zehen rob në luftë, tue përjashtue kohën që abuzivisht ose pa justifikim e kan kalue me nji gjendje të tillë.

Koha e shtueme e shërbimit të përmendun, ajo e caktueme me Dekret Mbretnuer d. 1 Tetuer 1928, si edhe ato tjerat që mund t'akordohen me masë ligjore, shtojnë shumen e pensionit ose të shpërblimit, por nuk kan vleftë për me plotësue perjudhen minimale që lypet për me fitue të drejtën e pensionit ose të shpërblimit.

Neni 11.

Në llogaritjen e kohës së përgjithshme të sherbimeve të bame pjesa e kohës që kalon të gjasht muejt llogaritet nji vjetë i tanë, kuerse ajo që nuk i kalon nuk meret parasyshë.

Po kjo dispozitë zbatohet për llogaritjen e moshës së kerkueme prej nëpunësit ose ushtarakut për të fitue të drejtën e daljes **në pension.**

Neni 12.

Shpërblimet e njihershme likuidohen mbi rrogën mujore të fundit që asht marrë prej nëpunsit, ushtarak ose gjindarmit para daljes nga shërbimi.

Pensionet likuidohen në bazë të mesatares së rrogave të marruna në tri vjetët e mbrame në shërbim, tue marrun parasyshë perjudhen për të cillen asht marrë ç'do rrogë ose ç'do pagesë.

Në qoftë se gjatë tri vjetëve të fundit ndonji nga rrogat për ç'fardo arsye asht pezullue për nji perjudhë ma të madhe se nji muej, kjo kohë nuk ka me u llogaritë, por për të mbushun trivjetorin kan me u marrë parasyshë rrogat që janë marrë për kohën koresponduese imedjatisht ma parë.

Nuk llogariten në mesataren: shperblimet eventuale, alokasionet dhe shpërblimet e tjera fikse o të ndryeshme që mos të jenë rroga përveç se, kur me dispozita të veçanta ligjore, jan të deklarueme të llogaritëshme për efektet e pensionit.

KAPTINA III.

Kondita të posaçme për të drejtën e pensionit të rregullt të personelit të ndryshëm

§ I. — Për nëpunsat civil

Neni 13.

Nepunësit civil që kan mbushun moshën 65 vjetësh, largohen vetiu nga sherbimi, me të drejtë pensioni ose shpërblimi të njihershëm si mbas dispozitave të kësaj Ligjë.

Neni 14.

Marrin pension të rregullt:

a) nëpunësit Civil që kan plotësue moshën 65 vjeç bashkë me të pakten 15 vjet serbim të vleftshem për pension;

b) nëpunësit Civil që kan plotësue së paku 15 vjet sherbim të vlefshëm për pension dhe për shkak sëmundjeje janë ba të pa aftë perherësisht me vazhdue në shërbim;

c) nepunësit civilë që kanë plotësue 30 (tridhjet) vjet shërbim të vlefshëm për pension dhe, që vullnetarisht, largohen nga shërbimi.

Neni 15.

Kan të drejtë për shpërblim të njihershëm:

a) personat që sado të jenë numuri i vjetëve të sherbimit të vlefshëm për pension, pa pasë plotësue 15 vjet shërbim, për shkak se kanë plotësue moshen 65 vjeç;

b) personat që mbas pes vjetëve dhe pa plotësue 15 vjet sherbim të vlefshëm për pensjon, për shkak sëmundjeje janë ba të pa-aftë perherësisht për me vazhdue në shërbim;

c) personat që mbas 10 vjetëve dhe pa plotësuem 30 vjet shërbim të vlefshëm për pension, janë përjashtue nga shërbimi për shkaqe që nuk sjellin humbjen e të drejtës për pension.

§ 2. — Për Oficjerat

Neni 16.

Oficjerat kan të drejtë me kërkue daljen në pensjon dhe me marrë pensjonin e rregulltë kur të kenë ndonji nga konditat e posht-shenueme:

a) të kenë mbushun 50 vjet moshë por që së pakut të kenë 20 vjet sherbim efektiv të vlefshëm për pensjon;

b) të kenë mbushun 15 vjet shërbim efektiv të vlefshëm për pensjon e të jenë ba, për shkak sëmundjeje, të pa aftë perherësisht për me vazhdue ma gjatë në sherbim.

Si do kjoftë, duhet të largohen nga shërbimi oficjerat që kan mbushë moshën e caktueme me Ligjën mbi gjendjen e oficjerave të fuqive t'armatosuna.

Neni 17.

Oficjeri që ka kryemun pesë vjet e nalt dhe jo 15 vjet sherbim efektiv të vlefshëm për pension, kuer bahet i pa-aftë përherësisht me vazhdue në shërbim për shkaqe që nuk rrjedhin nga detyra, ka të drejtë të marrë një shpërblim të njihershëm.

Neni 18.

Oficerat që qiten në lirim për shkaqe të parapame prej ligjëvet, shkaqe të cilat nuk sjellin humbjen e të drejtës së pensjonit, kan të drejtë shpërblimi të njihershëm në kjoftë se kanë plotësue 8 vjet dhe jo 15 vjet sherbim efektiv të vlefshëm për pensjon..

Kuer oficeri ka plotësue 15 vjet shërbim efektiv të vlefshëm për pension, fiton të drejtën e pensionit të rregullt.

Neni 19.

Ka të drejtë me kërkue daljen në pension dhe të marrë pension të rregullt oficeri që, edhe pa arritun moshën 50 vjetsh, ka mbushun 25 vjet sherbim të vlefshëm për pension.

§ 3. — Për Oficerat, graduatët, ushtarakët dhe gjindarmët

Neni 20.

Nen-oficerat, graduatët, ushtaraktë dhe gjindarmët me rrogë kanë të drejtë me kerkue daljen në pension dhe me pas pensionin e rregullitë kuer të kenë ndonji nga kondital që pasojnë:

a) të kenë mbushun 25 vjet sherbim të vlefshem per pension;

b) të kenë mbushun 15 vjet sherbim të vlefshëm per pension dhe, të jenë ba të pa-aftë perherësisht me vazhdue në shërbim për shkak sëmundjeje.

Dalja nga shërbimi asht i detyrueshem kuer vertetohet se i interesuemi ka mbushë moshen 50 vjeç.

Neni 21.

Nen oficjerat, graduatët, ushtarët dhe gjindarmët me rrogë që largohen nga sherbimi me vendim t'autoritetit, ose që u mohohet rivendosja në shërbim për shkaqe të ndryshme nga ato që nuk sjellin humbjen e së drejtës së pensionit, kan të drejtë të likuidojnë pensionin në qoftë se kan së pakut 15 vjet shërbim efektiv të vlefshëm për pension, dhe të marrin shpërblim të njihershëm në qoftë se kan plotësue 8 vjet dhe jo 15 vjet sherbim efektiv të vlefshëm për pension.

KAPTINA IV.

Masa e pensjonit të rregullt dhe të shpërblimit të njihershëm

Neni 22.

Pensjoni i rregullt për të gjith nëpunësit civil, për oficerat, nenoficerat, graduatët, ushtarët dhe gjindarmët me rrogë, asht baras me të dyzetepesten pjesë të rrogës mesatare vjetore që rezulton si mbas Art. 12 të shumëzueme për vjetët e shërbimit të vlefshëm për pensjon. Por në çdo rast pensioni nuk mund të kalojë 8/10-tën, e rrogës së fundit.

Neni 23.

Shpërblimi i njihershëm që i përket nëpunësit civil, ushtarakut e gjindarmit me rrogë përbahet prej shifres që rezulton tue, shumzue rrogen e muejit të fundit me vjetët e shërbimit të vlefshëm për pension.

KAPTINA E V.

Masa e Pensjonit të Privilegjuem

Neni 24.

Pensioni i privilegjuem që u përket nënpunsavet civil, oficeravet, nën-oficeravet, graduatvet, ushtarve dhe gjindarmve për infermitete o lezione që i përshtaten kategorisë së parë të tabelës A ngjitun kësaj Ligje, asht baras me mesataren e rrogës muejore të vjetit të fundit.

Për nen-oficjerat, graduatët, ushtarët dhe gjindarmët pa rrogë në shërbim aktiv të detyruem, merret për bazë rroga vjetore që i përket nji gjindarmit të klasës së parë me rrogë. .

Neni 25.

Për nëpunësat civil, oficerat, nën-oficerat, graduatët, ushtararët dhe gjindarmët, pensioni i privilegjuem për infermitetet ose lezionet që përfshihen në të dytën kategori të tabelës A. asht baras me 8/10 e mesatares të rrogës muejore të vjetit të fundit.

Nënoficjerat, graduatët, ushtarët dhe gjindarmët pa rrogë në shërbim aktiv të detyruem, marrin nji pension të privilegjuem baras me 8/10 (tet të dhetat) e mesatares së rrogës së nji gjindarmit të klasës së parë me rrogë.

Neni 26.

Nëpunësavet civil, oficeravet, nënoficeravet, ushtarëve dhe gjindarmëve me rrogë, të cilët për shkak të kryemjes së detyrës së tyne marrin lezione, plaga, ose infermitete të parapame në tabelën B. në kohën e largimit të tyne nga shërbimi, pensioni i rregullt ose shpërblimi i nijhershëm që u takon në bazë të vjetevet të shërbimit të vlefshëm për pensjon, u shtohet me 1/10 (nji të dhetën).

Neni 27.

Ushtarit dhe gjindarmit pa rrogë në shërbim aktiv të detyruem që, për shkak të vetëm të kryemjes së detyrave të tija, ka pësue ose ka marrë lezione, plaga ose infermitete të parapame në tabelën B., ka të drejtë për nji shpërblim të njihershëm baras me 8/10 e rrogës vjetore të nji gjindarmit të klasit të parë me rrogë.

BKSH

Neni 28.

Në qoftë se, si mbas gjykimit të komisjonit mjeksuer, infermitetit, plaga ose lezioni prej të cilit nëpunsi, ushtaraku ose gjindarmi asht ba i pa aftë për shërbim me të drejtë pensioni të privilegjuem, mund të modifikohet me përmirësim ose keqësim në mënyrë që mund të ndrrojnë klasifikimin e kategoris, pensjoni caktohet provizorisht për periudhën e tregueme prej komisjonit mjeksuer. Kjo periudhë nuk mund të jetë n'asnji trasë ma e pakët se nji vejt dhe ma e naltë se katër, dhe pensjoni definitiv ka me u caktue në bazë të mendimit mjeksuer që do të jepet në rasë të nji vizitës të re kolegjale.

Gjith ashtu ka të drejtë rishikimi nëpunësi, ushtaraku ose gjindarmi që kujton se infermiteti i tij asht keqësue në mënyrë që lejon ndrrimin e kategoris, mjaft që t'a paraqesi kërkesën mbrenda nji vjeti që prej ditës që komisjoni mjeksuer ka vertetue infermitetin e tij. Në rast se i njifet nji ndryshim i klasifikimit të kategoris, pensjonit ma e nalt që mund t'i përkasin fillon që nga mueji i parë që vjen mbas paraqitjes së kërkesës së rishikimit.

KAPTINA VI.

Pensjonet dhe shperblimet që u takojnë bashkëshorteve të vêja, fëmive dhe personave të tjera të familjes së nëpunësit ose t'ushtarakut

Neni 29.

Gruaja e vejë e nëpunësi civil, e ushtarakut ose gjindarmit ka të drejtë mbi nji pjesë të caktueme të pensjonit të rregullt që do t'i takonte burrit në bazë të vjetëve të shërbimit të vlefshëm për pensjon ose, të pensjonit që i ishte likuidue burrit me rasën e largimit të tij nga shërbimi:

a) kuer martesa asht lidhë gjatë kohës që burri ka vazhdue në shërbim;

b) kuer burri të ketë bashkëjetue të paktën nji vjetë;

c) përgjithësisht, kuer nga nji martesë kan lindun fëmij ose janë legjitimue fëmijt e lindun përpara martesës.

Kuer nëpunësi, ushtaraku ose gjindarmi vdes në shërbim e sipër ose për shkak shërbimi, grueja e vejë ka të drejtë mbi nji përqindje të caktueme të pensjonit të privilegjuem për t'u likuidue pa mvarësisht prej kohës së shërbimit në bazë të drejtave të njoftuna kategoris së parë të tabelës A, por me konditë që martesa të jetë lidhë përpara ngjarjes që ka shkaktue vdekjen.

E veja nuk ka të drejtë pensioni në qoftë se, në kohën e vdekjes së burrit, jetonte e veçueme në bazë të nji akt-gjykimi që ka marrë formën e preme dhanun për faj të sajë ose të dy palëve. N'asht se veçimi nuk u shkaktue për faj të bashkëshortes, kjo ka të drejtë pensioni.

Bashkëshortja e vé humb të drejtën e pensionit tue u martue përsëri.

Neni 30.

Grueja e vé e nëpunësit civil e ushtarakut ose gjindarmit ka të drejtë mbi shpërblimin e njihershëm qi do t'i takonte burrit në bazë të kohës së shërbimit të vlefshëm për pension në qoftë se i ka kondita e kërkueme prej nenit 29 të kësaj Ligjë.

Neni 31.

Të drejtat e caktueme me nenet 29 e 30 të kësaj Ligje për gruen e vé i njifen edhe burrit të vé. Por burri i humbet këto të drejta kuer rimartohet.

Neni 32.

Pos së vejës kan të drejtë pensjoni ose shpërblimi të njihershëm fëmijt legjitim ose të ligjitimuem kjofshin edhe prej nji martese të maparshme të nëpunësit, t'ushtarakut ose të gjindarmit me konditë dhe deri sa djelmët të jenë të mitun ose tue vazhdue në studime me mjetet e tyne, por jo mbi 25 vjeç, për veç kuer janë invalid, dhe vajzat të pa-martueme ose të çkunorëzueme.

Neni 33.

Kan të drejtë pensjoni ose shpërblimi të njihershëm përveç së vés dhe fëmive të nëpunësit, t'ushtarakut ose të gjindarmit të vdekun në vazhdim shërbimi e të qitun në pensjon:

a) nana deri sa të jetë e vé dhe kuer nuk ka mjet tjetër për jetesë;

b) baba që fizikisht nuk mund të bajnë kurrë farë punë, dhe nuk ka mjet tjetër për jetesë;

c) motra e pa martueme dhe vëllaj i mitun kuer e deri sa nuk kanë tjetër mjet jetese.

Neni 34.

Masa e pensjonit që i përket vetëm bashkëshortit të vé, ose fëmis, nanës ose babës që gijnden ndër kondital e parapame nga nenet 29 e 31 asht baras me 50% të pensjonit të gëzuem ma parë prej nëpunësit civil, ushtarakut ose gjindarmit ose t'atij pensjoni

që do t'i u likuidohesh në bazë të vjetëvet të sherbimit të vlefshëm për pension.

Kuer ka ma shumë se nji person nga ata që përmendën në paragrafin e parë, përqindja e caktueme ma naltë ndryshohet si vijon:

kuer ka nji person ma tepër	60%
kuer ka dy person ma tepër	65%
kuer ka tre persona ma tepër	70%
kuer ka katër persona ma tepër e nalt	75%

Pensjoni ndryshohet në proporcjonet e sipër-tregueme gjithë sa herë që numri i atyne që kan të drejtë pensjoni paksohet për shkak vdekjeje, mbritje në moshën madhore, përfundimi të studimeve, martese, ose kuer në rastet e nenit 33 konstatohet nji mjet jetese.

Kuer personat e treguem në paragrafin e parë të këtij neni jetojnë veças e 50% e pensionit i caktohet bashkëshortit të vé, në qoftë se konkuron me nanë ose babë, me motra ose vllazën të mitun, dhe teprica ndahet në pjesë të njeshme midis gjithë të tjerëve; e kur përveç këtyne konkuruesave, ndodhen edhe fëmijë, athere pensjoni ndahet në pjesë të njinjishme. Në qoftë se bashkëshorti i vé nuk ka të drejtë pensjoni ose humbë atë të drejtë pensjoni ndahet në pjesë të njinjishme, në mes të gjithë personavet të tjera, tue marrë parasyshë paksimin e caktuem nga paragrafi i ma-sipërm i këtij neni.

Pensjonistat ose tutorët e tyne janë të detyruem me deklarue me nji herë ndodhjen e atyne rasave që pas-sjellin ndryshimin e proporcionit të pensjonit si mbas paragrafeve 3 e 4 të këtij neni.

Mënyra e kontrollimit të ndryshimeve të parapame si ma sipër, ka me u caktue me Rregulloren e posaçme të kësaj Ligje.

Neni 35.

Në qoftë se vdekja e nëpunësit, e ushtarakut ose gjindarmit njifet se ka rrjedhun për shkak shërbimi, personave që kan të drejtë u likuidohet pensioni në bazë të pensjonit që do t'i përkiste të vdekunit me zbritjet e përqindjeve të caktueme në nenin e masipërme.

Familjeve të mjekvet privat të marrun në shërbim të jasht-zakonshëm për shërimin e sëmundjeve ngjitse (kolerë, murtajë, li, tifus ekzantematik, etj.) të cillët vdesin nga shkaku i marrjes së sëmundjeve të tilla në kryemjen e shërbimit, u nepet pensjoni në

bazë të dispozitave të caktueme në këtë Ligjë mbi bazën e rrogës së tregueme në paragrafin e parafundit të nenit 3 të kësaj Ligje.

Neni 36.

Shpërblimi i njihershëm që u përket personave të tregueme ndër nenet që prej 29 deri 33 asht baras me 3/4-tat e atij që do t'i përkiste nëpunësit, ushtarakut ose gjindarmit të vdekun.

Kuer personat që kan të drejtë të jetojnë veças, e 50-ta e shpërblimit që, likuidohet si ma sipër i caktohet bashkëshortit të vé dhe, gjysma tjetër ndahet si pas kritereve të caktueme në paragrafin e parë të nenitt 34 të kësaj Ligje. Në mungesë të bashkëshortit të vé, shpërblimi ndahet në pjesë të njejta ndërmjet gjith'atyne që kanë të drejtë.

KAPTINA VII.

Bashkimi i pensjonit me rrogë ose me pensjon tjetër

Neni 37.

Nuk mund të bashkohen dy ose ma shumë pensjone në ngarkim t'Arkës por, i interesuemi ka të drejtë me marë pensjonin ma të naltë.

Me gjith këtë në rasë se me Ligjë të posaçme asht e lejueme që nji pensjonist të ketë nji tjetër detyrë shtetnore, me rrogë ose me shpërblim, asht e lejueme me bashkue me pensionin edhe rrogën ose shpërblimin e detyrës së ré.

Kuer mandej pensjonisti ka të drejtë pensjoni edhe për detyrën e dytë, pensjoni i tij llogaritet si mbas nenit 8 të kësaj Ligje.

KAPTINA VIII.

Humbja, ndalimi dhe rifitesa e të drejtës me pasun shpërblimin ose pensjonin

Zbritja e pensjonit

Neni 38.

Nëpunësi, ushtaraku, ose gjindarmi i çdo grade humbë të drejtën e pensjonit ose të shpërblimit:

a) me humbjen e shtetsis Shqiptare;

b) për shkak deliktesh kundra Atdheut, kundra Sovranit Nanës Mbretneshë e Mbretneshës si edhe trashigimtarit të Fronit ose fuqivet Shtetnore, që sjellin dënim ma shumë se tre vjet;

c) për dënime që përmbajnë ose pas-sjellin ndalimin e përhershëm nga ofiqet publike;

shëm nëpunsit, ushtarakut ose gjindarmit që asht largue nga sherbimi tue dhanë dorëheqjen vullnetarisht ose, asht dekllaruem si i tillë nga ana e zyrës; me gjith ketë e drejta e pensjonit ose e shperblimit të njihershëm i njifet familjes vetem mbas vdekjes së nëpunësit dorëheqës.

Kjo dispozitë nuk aplikohet për Ministrat e Shtetit (Anëtarët e Kabinetit).

Neni 42.

Përjashtohen në mënyrë të pa-revokueme nga e drejta e pensjonit personat e familjes që për faje kundra jetës së nëpunësit ose t'ushtarakut a të gjindarmit, janë ba të pa meritueshëm me e trashigue si mbas dispozitave të nenit 459 të Kodit Civil.

Neni 43.

Në qoftë se kundra nëpunësit, ushtarakut ose gjindarmit të pensjonuem vazhdon nji gjyq penal, nga përfundimi i të cilit mund të rrjedhi humbja ose zbritja e pensjonit, dhe i pandehuni ndodhet i burgosun, pensjoni pezullohet për të pensionuemit dhe u paguhet atyne të familjes që kanë të drejtën e pensionimit si mbas kësaj Ligje.

KAPTINA IX.

Ndaljet mbi rroga dhe mbi pensione
Pagesa, parashkrimi, cedimi, sekuestrimi e të vuemit peng të pensjonevet

Neni 44.

Nga rroga e atyne që tregohen në nenin 1 të kësaj Ligje tue u përshi edhe Ministrat e Shtetit (Antarët e Kabinetit) por me përjashtim t'ushtarakve dhe të gjindarmve në sherbim aktiv të detyruem ndalohet 8% (tet përqind) dhe mbi të tana pensjonet e pagueme si mbas kësaj Ligje 6% (gjasht për qind).

Ndalohet gjysma e rrogës mujore të parë e atyne që emnohen për heren e parë në shërbim. Por kjo ndalje ndahet në dy keste në të dy muejt vazhdues.

Nga çdo shtim rroge për çdo shkak qoftë, ndalohet shtesa për muejin e parë,

Nga dietet, çdo lloji qofshin, si dhe nga alokasionet, shpërblimet e perfaqësinave e të tilla ndalohen 5% (pesë për qind).

Neni 45.

Pensionet paguhen në mbarim të çdo mueji, në konformitet me dispozitat e kontabilitetit të Shtetit.

Pensjonet për pensionistat fillojnë nga dita që vjen mbas asaj që merr fund sherbimi, dhe për personat e tjera që heqin të drejtat të pensionistit fillojnë mbas vdekjes së nëpunësit ose pensionistit.

Neni 46.

Shumat mujore të pensionevet dhe kistet e tyne që s'kerkokohen mbrenda tri vjetve që nga data e skadimit të tyne, parashkruhen.

Të gjith ata që nuk kerkojnë të drejtat e pensionit mbrenda kohës së tri vjetëve që nga dalja prej sherbimit ose nga vdekja e trashigim-lanësit bijnë në parashkrim për sa i përket kisteve të kalueme.

Neni 47.

Kushdo që pretendon se ka të drejë pensjoni ose shperblimi të njihershëm, në qoftë se len të kalojë ma tepër se nji vjet prej ditës në të cilën do t'i fillonte përfitimi, pa bamë kerkesën ose pa paraqitun dokumentat përkatëse justifikuese, nuk mund të pranohet të gëzojë prej kësaj të drejtë veç se, në ditën e parë të muejit vazhdues t'atij kur ka bamun kerkesën ose ka paraqitun dokumentat.

Janë të përjashtuem prej kësaj dispozite të mitunit dhe të çmendunit.

Neni 48.

Pensjonet dhe shperblimet e njihershme janë të cedueshme deri në nji të tretën e shumës së tyne; janë të sekuesrueshme e të pengueshme deri në nji të katerten e shumës së tyne.

Pensionet dhe shperblimet e njëhershme munden me u sekuestrue si mbas Ligjës ose me u pengue deri në gjysmën e shumës së tyne vetëm për ushqim.

KAPTINA X.

Dispozita për Likuidimin e pensjonevet e të shperblimit të njihershem dhe për rekurimet kundra masavet të likuidimit

Neni 49.

Shërbimi i likuidimit i të gjitha pensjonevet dhe i shpërblimeve të parapame prej kësaj Ligje, përmblidhet në Ministrin e Financavet, e cila do të kryjnë ket sherbim me anën e nji Drejtorije të veçantë.

BKSH

ç) për dënim spekulimi si mbas neneve 184 dhe 185 të Kodit Penal për mitë e dhuntimi;

d) për dënime me çfarëdo ndeshkimi në bazë të Kodit Penal Ushtarak që sjellin me vehte degradimin, prapsimin ose dëbimin nga Fuqit e Armatosuna.

Nëpunësi, ushtaraku, gjindarmi dhe personat e familjes së tyne humbasin pensjonin e fituem ma parë në rastet e parapame në germat a) b) c) të këtij neni, ashtu dhe nëpunësi, ushtaraku ose gjindarmi humbasin atë të drejtë për shkak të dënimeve të parapame në germat ç) d) kuer fajet përkatëse janë ba në kohen e sherbimit për të cilin asht koncedue pensioni.

Personat që kanë të drejtë pensjoni nga nëpunësi, ushtaraku ose gjindarmi që, në kohen e vdekjes së nëpunësit, ushtarakut ose gjindarmit, ndodhen të dënuem me nji nga ndeshkimet e parapame në germat b, dhe c, nuk kanë të drejtë për shpërblim ose pension.

Neni 39.

Kuer nëpunësi, ushtaraku ose gjindarmi humbë të drejtën e pensjonit, personave që kanë të drejtë u likuidohet pensjoni tue, u konsiderue sikur nëpunësi, ushtaraku ose gjindarmi t'ish i vdekun.

Në rast humbjeje të së drejtës së pensjonit ose të shpërblimit nga ana e nji ose ma shum personave të familjes të nji nëpunësi, ushtaraku e gjindarmi, pensjoni u nepet të tjerëvet që kanë të drejtë; dhe nga shperblimi u jepet vetëm pjesa proporcjonale.

Neni 40.

E drejta e pensjonit, ose ajo e shperblimit të humbuna për shkak dënimi në bazë të nenit 38, rifitohet përsëri kuer del nji vendim gjyqi.

Pensjoni i rifituem fillon t'eci që prej ditës së parë të muejit që vjen pas atij në të cillin asht dhanë vendimi i rifitimit, po në ket datë pushon pensjoni që u asht dhanë personave të tjerë që kanë të drejtë.

Personit të familjes të cilit i asht dhanë rishtazi e drejta e shperblimit, i takon vetëm ajo pjesë e shperblimit që nuk u asht dhanë të tjerëvet që kan pasë të drejtë si mbas paragrafit të mbramë të nenit 39.

Neni 41.

Nuk i përket e drejta e pensjonit ose e shperblimit të njiher-

Neni 50.

Kërkesat për likuidimin e pensjoeve ose të shpërblimeve të njihershme të funksionarëve dhe të personave të vdekun n'aktivitet sherbimi, i paraqiten Ministris së Financavet me anë t'Administratës pranë të çilës funksjonari civil, ushtaraku ose gjindarmi ka ba shebimin e fundit.

Kerkesa për likuidimin e pensjonit të personavet të familjes së nji të pensjonuemit duhet t'i paraqitet drejtazi Ministris së Financavet prej t'interesuemve.

Neni 51.

Me përjashtim të kërkesave, të gjith dokumentat e duhuna për likuidimin e pensjonevet ose të shperblimevet, janë të përjashtueme nga çdo taksë ose pullë.

Neni 52.

Likuidimet e pensjonevet ose të shperblimevet bahen prej Drejtoris së Pensjonevet dhe, u komunikohen t'interesuemvet me ndërmjetësin e kryetarit të Komunës të vend qendrimit të tyne, tue u mbajtë data e njoftimit në dishmitë e perndasit të komunës, e cila duhet t'i kthehet Drejtoris së Pensjonevet.

Drejtorija në fjalë detyrohet me ja referue aktet përkatëse bashkë me dishmin e komunikimit komisjonit të pensjoneve, i formuem si mbas dispozitavet të nenit 54 të kësaj Ligje.

Neni 53.

Mbrënda nji mueji prej datës së njoftimit të përmendun në paragrafin e parë të nenit ma-sipërmë, t'interesuemit mund të rekurojnë në Komisionin e Pensionevet tue, parashtrue çdo pretendim ose kerkesë të tyne.

Neni 54.

Për kontrollimin e likuidimeve dhe shqyrtimeve e rekurimeve Komisjoni i pensjoneve krijohet nën kryesin e Kryetarit të Këshillit Kontrollues i përbamë pre nji përfaqësuesi të Diktimit, të Këshillit të Shtetit, të Komandës së Mbrojtjes Kombëare, të Ministris së Financavet dhe prej Drejorit të Pensjonevet.

Antarët e Komisjonit të pensjoneve proponohen prej titullarit të dikasterit përkatës, emnohen me Dekret Mbretnuer për nji kohë prej dy vjetësh dhe janë të riemnueshëm.

Si për Kryetarin ashtu për antarët po me Dekret-Mbretnuer emnohet dhe nga nji zavendës, të cillët veprojnë në mungesë t'atij që shprehimisht kanë tagër me zavendësue.

Kryetar' i Komisjonit e propozon vetë zavendësin e tij; zavendësit e tjerë propozohen prej Titullarit të Dikasterit përkatës.

Komisioni vendon me shumicë zanesh; në rasë pariteti, fiton ana me të cillen bashkohet zani i Kryetarit.

Komisjoni nuk mund të vendojë kuer mungon ma shumë se një antar, o zavendës antari. Zavendës antarë nuk mund të jenë ma tepër se dy.

Detyrat e Sekretarit i garkohen nji nëpunësit të Drejoris së Pensjoneve.

Neni 55.

Komnsjoni i pensjoneve, mbas kalimit t'afatit për rekurim vendosë në mënyrë të preme mbi të gjitha likuidimet e bame prej Drejtoris së Pensioneve.

Vendimet e Komisjonit në fajlë paraqiten për Dekretim Mbretnuer.

KAPTINA XI.

Dispozita të veçanta për nëpunësit e Komunevet

Neni 56.

Nëpunësit e katundarive të (Komuneve) i shtrohen dispozitave të kësaj Ligje, dhe pensjoni i likuidohet këtyne o personave që kanë të drejtë të tyne nga Drejtorija e Pensjoneve e i paguhet nga Financa e Shtetit.

Me qëllim që të mbulohet deficiti vjetuer që do të rezultojë ndërmjet përqindjeve që do bajnë të gjithë nëpunësit komunal në bazë të kësaj Ligje, dhe të pensjoneve për t'u likuidue po në bazë të kësaj Ligje në favor të nëpunsave komunal ose të personavet që heqin të drejtat prej tyne ç'prej datës së hymjes në fuqi të sajë, çdo komune ka me parapa në pjesën e shpenzimeve të budgetit të asjë një fond që, do të caktohet nga Seksjon' i komuneve pranë Ministris së P. të Mbrendëshme tue, pjestue deficitin e përgjithshem në proporcion me budgetin e Komuneve përgjithësisht.

Seksioni i komuneve pranë Ministris së P. të Mbrendëshme asht i detyruem që nëpunësit komunal të derdhin puntualisht përqindjet e ndalesat e parapame me ket Ligjë.

Mënyra e pjestimit të fondeve për çdo Komune dhe ajo e kontrollimit të versimeve ka me u caktue me Rregullore të posaçme.

Titulli II.

DISPOZITA TRANSITORE

Neni 57.

Nëpunsavet civil e ushtarakë si dhe gjindarmëve që kanë qenë në shërbim në tokën e Shqipnis indipendente e që kan vazhdue të jenë në shërbim ose qi kanë ardhë e janë pranue në shërbim të Shtetit që nga data 28 Nanduer 1912 deri me 31 Dhetuer 1920, si edhe ata që janë emnue në këtë perjudhë prej fuqive okupuese, të cilët kanë vazhdue në shërbim në tokën Shqiptare, nën Qeveri Kombëtare ose nenë okupacione të hueja që kanë njoftë eksistencën e një Qeverie ose Administrate Shqiptare, u njifet krejtësisht si shërbim efektiv koha e shërbimit të kësaj periudhe.

Gjith' ashtu u njifet si kohë shërbimi efektiv nëpunësave civil dhe ushtarakë që, për shkaqe politike dhe të pamvaruna nga vullnet' i tyne kanë qenë të shtrënguem me u largue nga detyra mbrenda periudhës, 28 Nanduer 1912 deri me 31 Dhetuer 1920.

Prej datës 31 Dhetuer 1920 e tëhu, koha e shërbimit llogaritet si mbas dispozitave të kësaj Ligje.

Neni 58.

Nëpunësit civil, ushtarakë e gjindarmt, o personat që heqin të drejtat prej tyne të cilve në bazë të dispozitave të kësaj Ligje, u njifet si kohë e vlefshme për pensjon, nji kohe në të cilën nuk kanë sherbye ose në të cilën kan sherbye, por nuk kanë lënë përqindje për pension, paguajn, përveç përqindjeve e pagesave të tjera, edhe 5% mbi pensjonin që u likuidohet dhe këtë për aq vjet sa i janë njoftë të vlefshme për pensjon pa lanë përqindjet në fjalë.

Prej ndalesave 5% mbi pensjonin e parapamë në paragrafin e ma sipërmë përjashtohen për gjith kohën deri në datën e hymjes në fuqi të kësaj Ligje nenoficerat, graduatët dhe ushtarët e Ushtrisë dhe ata t'Armës së Gjindarmeris, të cillët në bazë të Ligjës me datë 5 Fruer 1920 mbi pensjonet ushtarake, ishin të përjashtuem nga ndalesa e perqindjeve për Arkën e Pensjoneve.

Kjo dispozitë vlen për oficerat vetëm për efektet e kohës kur kan qenë nenoficera, graduatë ose ushtarë me rrogë.

Neni 59.

Nëpunësit civil ose ushtarakë, kuer, tue qenë n'aktivitet ose tue qenë të pensjonuem, vdesin dhe lanë mbas, midis personave

që kanë të drejtë për pensjon, ma shumë se nji grue, atëherë pjesa që do t'i takojë si mbas kësaj Ligje u ndahet grave për krye, në mënyrë të njëshme.

Neni 60.

Arka e P. e Pensjoneve krijue në Ligjen datë 28 Tetuer 1927, suprimohet.

Aktivitetiet patrimoniale dhe financjare si dhe pasivitetet e çdo natyre që i përkasin Arkës së Përgjithshme të sipër-përmendun transferohen pranë Ministris së Financavet. Në gjendjen vjetore të parapamjevet të shpezimevet të Ministris së Financave caktohet një fond i nevojshëm për pagesën e pensjoneve që bante ma parë Arka e Përgjithshme e Pensjoneve dhe t'atyne që do të likuidohen në bazë të kësaj Ligje.

Titulli III.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE TË FUNDSHME

Neni 61.

Me dispozitat e kësaj Ligje janë të rregullueme definitivisht të gjitha të drejtat që nji nëpunës, ushtarak o gjindarm ose ata që gëzojnë të drejtat e tyne mund të kenë kundrejt Shtetit për plagosje, lezione dhe infermitetë të marrme për shkaqe sherbimi, kjoftë se kanë sjellë edhe vdekjen e tij.

Neni 62.

Pensjonet e lidhuna deri në hymjen në fuqi të kësaj Ligje mbeten të pa ndryshueme.

Neni 63.

Pensjonohen në bazë të Ligjëve të vjetra, nëpunësit civil, ushtarakë dhe gjindarmët që janë largue nga sherbimi shtetnuer ose kanë vdekun prpara datës së hymjes në fuqi të kësaj Ligje.

Ligja me datë 29 Nanduer 1933, për të përjashtuemit deri në dy vjet sherbimi, mbetet në fuqi. Pensjoni i tyne do të rregullohet në bazë të dispozitavet të Ligjës së maparëshme të pensjoneve.

Neni 64.

Pensjonohen në konformitet me këtë Ligjë, nëpunësit civil, ushtarakët dhe gjindarmët që janë largue nga sherbimi së paku tre vjet ma parë dhe që, për arësye të ndryshme, nuk u asht akordue ndonji shperblim ose pensjon deri në hymjen në fuqi të kësaj Ligje.

Rrogat e disponibilitetit, t'akorduеme deri në hymjen në fuqi të kësaj Ligjë nëpunësave civil, ushtarakve dhe gjindarmvet me Ligjët e maparëshme të penjsoneve, mbeten të pa cenueshme edhe për nji periudhë dy vjetësh ç'prej hymjes në fuqi të kësaj Ligje. Këto paguhen nga fond' i shenuem në buxhetin e Ministris së Financavet. Në mbarim të këtij afati, rrogat në fjalë konvertohen në pensjon ose në shpërblim të njihershem, si mbas dispozitavet të kësaj Ligje. .

Koha e disponibilitetit konsiderohet e vlefshme për pensjon.

Neni 65.

Kryeministrave, mbasi të largohen nga pozita e tyne dhe deri sa nuk kanë ose nuk marrin ndonji ofiq tjetër shtetnuer, me rrogë ose shpërblim, sa do që të jetë koha e sherbimit dhe mosha e tyne, u jepet nji rrogë disponibiliteti shuma e së cilës caktohet si mbas rregulave të tregueme në nenin 22 të kësaj Ligje, tue marrë parasysh sherbimet e tyne të vlefshme për pensjon, por, n'asnji rast, rroga në fjalë nuk mund të jetë ma pak se 400 fr. ari.

Gjithashtu edhe Ministrat e Shtetit (Antarët e Kabinetit) kur gjenden në konditat e shënueme në paragrafin e sipërm në qoftë se kanë mbushun së paku dhjet vjet shërbim të vlefshëm për pensjon, kanë të drejtë të marrin nji rrogë disponibiletit, e cila catkohet si mbas rergullave të tregueme në nenin 22 të kësaj Ligje; por n'asnji rast, rroga në fjalë nuk mund të jetë ma pak se 300 fr. ari.

Këto rroga paguhen prej fondit të pensioneve të shënuem në budgetin e Ministris së Financavet.

Ish Kryeministrat dhe ish Ministrat e Shtetit (Antarët e Kabinetit) përfitojnë nga kjo dispozitë vetëm kur, në kohën e hymjes në fuqi të kësaj Ligje, ndodhen në shërbim të Shtetit ose Deputet.

Koha që kalohet në disponibilitet llogaritet e vlefshme për pensjon.

Neni 66.

Shërbimet që, me Ligjën e ma-parëshme kanë qenë të vlefshme për pensjon dhe që në këtë Ligjë nuk konsiderohen si t'atillë, për efektet e pensjonit konsiderohen të vlefshme dhe llogaritet koha e shërbimit në ato ofiqe ose nëpunësi deri në datën e hymjes në fuqi të kësaj Ligje.

Gjith'ashtu ato shërbime ndër ofiqe ose nëpunsina të ndryshme që me Ligjën e ré konsiderohen të vlefshme për pensjon llogariten edhe sikur të jenë bamun para hymjes në fuqi të kësajë Ligje.

BKSH

U njifet si shërbim i vlefshëm për pensjon edhe koha e deputetsis që ka vazhdue deri në hymjen në fuqi të kësaj Ligje, atyne që kanë qenë nëpunës ma parë dhe janë zgjedhur Deputetë dhe pas hymjes në fuqi të kësaj Ligje marrin prapë nëpunësi ose ofiq Shtetnuer të vlefshëm për pension.

Këto dispozita vlejnë edhe për ata që kanë qenë Senator, Kryetar Bashkije, e të etj.... shërbimet e të cilve si mbas Ligjës së vjetër konsideroeshin të vlefshme për pensjon me konditë rimarrje në shërbim të Shtetit.

Neni 67.

Kjo Ligjë hyenë në fuqi që prej ditës së shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare dhe, po në kët datë abrogohen të gjitha dispozitat e Ligjeve të maparëshme mbi pensione e nëpunësave civil e ushtarakë, me përjashtim të zbritjes së caktueme me nenin 4 të Dekret-Ligjës datë 3 Korik 1933.

Neni 68.

Dispozitat e nevojshme për zbatimin e kësaj do të caktohen prej Rregullores.

Neni 69.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

TABELA «A»

Kategoria e I-rë

(Neni 3 e 24 i Ligjës)

1. — Humbja e ansinave të sipërme e të poshtme (të dy krahëve edhe të dy kofsheve) kjoftë edhe e kufizueme vetëm në humbjen e dy duerve e të dy kambëve;

2. — Humbja e tri ansinave kjoftë edhe vetëm dy duart edhe nji kambë;

3. — Prishjet organike e të pashërueshme të dy syve që kanë shkaktue verbësi të dy anëshme, absolute e të përhershme;

4. — Prishjet organike e të pa shërueshme të dy syve me nji zbritje të tillë të shiqimit sa me muejt vetëm me njohë gjishtat në largësi të shiqimit të rregullt për s'afërmi;

5. — Humbja e të dy ansinave të sipërme (të dy kraheve kjoftë edhe e kufizueme vetëm në humbjen e dy duerve);

6. — Prishjet e zotësive mendore të përhershme, të pa-shërueshme dhe aq të randa sa me shkaktue pa-zotësiën e personës për çfardo pune të dobishme ose me e ba të rezikëshme për vedi ose për të tjerët;

7. — Lezionet e sistemit nervos qendros (encefalo, midolo spinale) me përfundime të randa e të përhershme në nji gradë të tillë sa me shkaktue veças ose së bashkut turbullime të thella e të pa-shërueshme për veprimet ma të nevojshme të jetës organike e shoqnore;

8. — Humbja e të dy ansinave të poshtë (dizartikulacjone ose amputimi i kofsheve);

9. — Humbja e nji ansines së sipërme (krahë) edhe nji të poshtme (kofshë) dizartikullimi ose amputimi i krahut ose i kofshës;

10. — Humbja e plotë e nji dore e të dy kambëve;

11. — Humbja e plotë e nji dore o e nji kambe;

22. — Humbja e plotë e të gjith gishtinjve të dy duerve; ose humbja e plotë e dy gishtinjve të mëdhaj (Police) e të tetë gishtinjve të tjerë të dorës;

13. — Humbja e plotë e nji gishtit të math (Police) e të tetë gishtave të tjera;

14. — Humbja e plotë e të dy gishtave të parë (tue filiue nga gishti i math) të dy duerve;

15. — Humbja e plotë e të dy kambeve;

16. — Gachexia e marasma që nuk shërohen me asnji kurë;

17. — Prishjet polmonare o extra-polmonare me natyrë turbekuloze e të gjitha sëmundjet e të tjera ose lezionet organike e funksionale të përhershme o të randa aq sa me shkaktue nji pa-aftësi absolute për punë të vlefshme;

18. — Prishja e eshtnavet të fytyrës, sidomos të nofllave e të gjitha përfundimet lezionesh të randa në fytyrë e në gojë aq sa me shkaktue pengim të randë për përtypje e për përcjellje (perdie) ose që shtërngon me marrë nji ushqim të posaçëm, me debulim organik të math.

TABELLA «A»

Kategoria e II-të

(Neni 3 e 25 i Ligjës)

1. — Prishjet organike e të pa shërueshme e të dy syve që

paksojnë zotësin veshtruese të dy syve mes 1/4 dhe 2/3 prej pamjes së zakonëshme;

2. — Humbja e njanës prej koqeve;

3. — Shurdhësia absolute, e përherëshme; të nji anshëm;

4. — Humbja e plotë e dy gishtave prej të fundit të njenës ose të dy duerve;

5. — Ngushtësimet cikatrisiale të kanalit digjues përjashtueme të përherëshme, të dy anshme ose të nji anshme ose humbja e plotë e dy anshme ose të të nji anëshme të llapës së veshit, ose lezione të tjera të përherëshme të llapës në fjalë që formojnë deformitete me randësië;

6. — Humbja e plotë e njenit prej gishtinjve diftues, e shoqnueme ose jo prej humbjes të njenit prej tre gishtinjve të fundit të dorës tjetër;

7. — Humbja e dy fallangave të fundit të njenit prej gishtinjve diftues e t'atyneve të dy gishtinjve të tjerë të dy duerve me konditë që, të mos jenë ata të gishtinjve të mëdhaj ose të gishtit diftues tjetër; ose humbja e nji atyne fallangave të tre gishtinjve të fundit të nji dorës ose të katër gishtinjve mes të dy duerve;

8. — Humbja e plotë e dy fallangave të fundit e të dy gishtinjve diftues;

9. — Humbja e fallagnave të thonit e të dy gishtinjve të mëdhaj;

10. — Humbja e fallangës së thojit të njenit prej gishtinjve të mëdhaj bashkë me fallangën e thonit të njenit prej gishtinjve të nxjerrë prej duerve;

11. — Humbja e fallangës së njenit thojit të gjashtë ose pesë gishtinjve mes dy duerve që të mos jenë gishtat e mëdhaj ose po të asaj fallange të katër gishtinjve në mes të dy duerve tue kenë edhe njeni prej gishtinjve diftues;

12. — Humbja e njenit prej gishtinjve të mëdhaj të kambeve bashkë me humbjen e eshtnës metatarsale të perkatëshme.

13. — Humbja e plotë e tre ose dy gishtinjve e njenës ose dy kambëve me konditë që të ndodhet njeni prej gishtinjve, të mëdhaj (me tansin e eshtnës metatarsale të përkatëshme) ose humbja e plotë e katër gishtinjve e të dy kambeve me konditë që të mos jenë gishtijt e mëdhej;

14. — Humbja e plotë e të dy gishtinjve të mëdhaj të kambës sheshueme ose jo me humbjen e fallangës së thojit të njenit ose të gishtinjve t'asaj kambe ose të kambës tjetër;

BKSH

15. — Humbja e njanit prej gishtinjve të mëdhaj të kambëve ose të fallangës së thojit e të dy gishtinjve të mëdhaj bashkë me humbjen e plotë të fallangës së thojit të katër ose tre gishtinjve të tjerë mes dy kambëve;

16. — Humbja e plotë e fallangës së thojit e tet ose shtatë gishtinjve mes dy kambëve tue mos u ndodhë mes atyne gishtinjt e mëdhej;

17. — Shkurtimi i njenës prej ansinave të poshtme me ma tepër se dy a ma pak se katër centimetra;

18. — Nervozat e pa shërueshëm që shkaktojnë paksimin e zotsis së punimit jo ma tepër se 20% për qind.

(N. B.) Infermitetet e kësaj tabele me vehten e tyne nuk shkaktojnë pazotësin për punë të nëpunsit civil.

TABELA «B»

(Neni 3, 26, 27 i Ligjës)

1. — Prishjet Organike e të pa-ndreqëshme të nji syni që të kenë shkaktue verbësi absolute e të përhershme me fuqi shiquese të synit tjetër të zbritun ndërmjet 1/50 e 1/25 të pamjes normale;

2. — Shurdhësia e dy anëshme organike e përhershme;

3. — Prishje eshtnash të ftyrës, sidomos të nofllave e të gjitha përfundimeve të tjera të lezioneve të randa në fytyrë e në gojë aqë sa me pengue përtypje, përcjelljen, të (përdiemit) ose foljen ose që bjen deformitete të mbëdhaja me gjith se kanë proteze por që nuk hyjnë në Nr. 18 të kategoris së I-rë.

4. — Ankilozi tamporo mascelare e përhershme, e tanëshme ose si e tanëshme (quasi),

5. — Lezione të randa e të përhershme të veglave frymë-marrëse e të tjerave vegla e sisteme organike, të shkaktueme nga gaze o avuj të damtushëm.

6. — Të gjitha lezionet e tjera ose sëmundjet organike të fytit, të gurmazit (trahea) ose të mushkënive që shkaktojnë të përherëshme e të randa të funksjonimit frymë-marrës;

7. — Sëmundjet e randa të zemrës me shejë të dukëshme dekompansimi e keqsimet e randa të përherëshme të pericardit kur për rëndësin e tyne nuk hyjnë në Nr. 17 të kategoris së I-rë

8. — Sëmundjet e mushknivet ose jashtë mushknivet (extra polmonari) me natyrë tuberkoloze, të vërtetueme klinikisht, radiologjikisht ose bakteriologjikisht ose me të gjitha mjetet e tje-

ra shkencore që për rëndësin e tyne nuk hyjnë në Nr. 17 të kategoris së I-rë;

9. — Lezionet ose smundjet e gypit gastro-anterik të gjëndrave të të pranshme me dobsim të randë të përhershëm të konstitucjonit;

10. — Lezionet e sëmundjet e sistemit nervoz qendror (encefalo e midolle spinale) që kanë shkaktue afazzi e të tjera përfundime të randa të përherëshme, por jo aq sa me arrijtun në gradën e tregueme në Nr. 6 e 7 të kotegoris së I-rë;

11. — Palujtësija e kokës në flexion o enstansion të plotë nga nji shkak të pa-largueshëm ose të griemit e tanshëm dhe i përhershëm ose përkulja e madhe dhe e përherëshme të kurizit;

12. — Paralize të perherëshme kjoftë origjini qendror kjoftë periferik që damtojnë musklat e grupa musklash të domosdoshem për funksjonet esenciale të jetës që për llojin e vazhdimin e tyne janë të pa-shërueshme;

13. — Zgjanimet (aneurisma) e dejve të mëdhaj arterike të trunkut e të qafës;

14. — Lezionet e sëmundjet e randa e të përherëshme, t'organeve (emopoitike) gjak base;

15. — Lezionet e sëmndjet e randa të përherëshme t'aparatit genito-uriner (pjellës shuror);

16. — Eviracjon (tredhja ose humbja e tanshme e penisit);

17. — Anus preteruaturalin, mos ndalimi i dalmjes jashtë, fistola rettoves cicale, fistola-uretrale posteriore e fistolat e putica, pancreatica, splonika, gastrica e intestinale që nuk sherohen;

18. — Artrit kronik qi për shumësiën ë randësiën e gjymtyrve që ka kapun ka paksue randësisht veprimin e dy ose ma tepër ansinave;

19. — Humbja e krahut ose të parakrahut të djathtë (dizartikulacjon ose amputacjon në të treten e sipërme të njenit ose tjetrit);

20. — Humbja e tanshme e pesë gishtave të dorës së djathtë e të dy nga katër të fundit të dorës së majtë;

21. — Humbja e tanshme e tetë gishtave të duarve i përfshiem ose jo njeni nga gishtat e mëdhaj (Police);

22. — Anchiloze komplete të belit ose të gjunit me fleksion të randë;

23. — Humbja e nji kofshe në të treten e sipërme;

24. — Amputasioni modic tarnice ose sotto-astragalica e dy kambëve.

V. O.

Bashkimi i dy ose ma shumë sëmundjeve në të dytën kategori nep të drejtë për m'u shenue në të paren kategori.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës së Pensioneve Civile dhe Ushtarake, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr.176/1 datë 17-IV-1934 të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 20 Qershuer 1934.

ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri P. Mbrendshme e Zav.
Ministri i Ekon. Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Nr. 98.

DEKRET-RREGULLORE, 23 Qershuer 1934.

Për kalimin e sherbimit t'Arkës së Përgjithëshme të Pensionevet për nëpunësat Civil në Ministrin e Financavet në bazë të Ligjës datë 20 Qershuer 1934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 5 Korrik 1934, Nr. 38 bis)

Neni 1.

Ministrija e Financavet autorizohet me marrë në dorëzim gjithëshka përmban objekt të shërbimit, të Zyrës dhe t'aktiviteteve dhe të pasiviteteve patrimoniale e financjare që i përkasin Arkës së Përgjithshme të Pensioneve për nëpunësat Civil, krijue me Ligjën datë 26 Tetuer 1927 dhe, suprimue me Ligjën datë 20 Qershuer 1934.

Neni 2.

Dorëzimi si mbas nenit të ma sipërme do të bahet në prani të nji perfaqësis së Ministris së Financavet e përbame prej Sekretarit të Përgjithshëm dhe të Drejtorit të Kontabilitetit dhe, të nji përfaqesis t'Arkës së Pensioneve e perbame prej Kryetarit të Këshillit t'Administratës ose të nji delegati të tij dhe prej Drejtorit të Përgjithshëm.

Në rast se nevojitet ndihma e shërbimit të funkcjonarëve të tjerë, Ministri i Financavet dhe Kryetari i Arkës së Pensioneve, munden të japin urdhnat e duhuna për ket ndihmë shërbimi.

Neni 3.

Për veprimet e dorëzimit do të mbahet nji proces-verbal i posaçëm në të cilin do të shënohen, në tekstin vetë ose ndër bashkëlidhjet:

a) gjendja e arkës dhe saldo, me datë të ditës, i depozitës në kont-kurrent pranë Bankës Kombëtare të Shqipnis;

b) elementat e ndryshme që përbajnë të gjitha aktivitetet dhe pasivitetet të tjera si ato financjare sa dhe ato patrimoniale t'Arkës së Pensionevet;

c) shumën, për seicillin të pensionuem, e pensionit përkatës dhe pensionin e muejit të fundit të paguem;

d) rregjistrat, llogarinat, partinat, rregjistrimet, praktika e zyrës që i jepen Ministris së Financavet për me vazhdue shërbimin.

Proces-verbali ka me u mbajtë në dy origjinale dhe do të nenshkruhet prej katër delegatvet; nji origjinal ka me i u dorëzue Ministrit të Financavet; tjetri Kryetarit të Këshillit t'Administratës t'Arkës së Pensjonevet.

Neni 4

Fondi i Arkës që eventualisht gjindet sot pranë Arkës së Pensionevet ka me u versue n'Arkën e Qendrës së Ministris së Financavet, e cila do të lëshojë kuitancë në mëveshje të kapitullit t'ardhunavet krijue si mbas dispoiztës së nenit 7 të kësaj Rregullore.

Për saldin e kont-kurrentit që gjindet pranë Bankës Kombëtare të Shqipnis n'emën t'Arkës së Pensionevet, Arka e Qendrës e Ministris së Financavet do të lëshojë prapë nji kuitancë t'ardhunash me mëveshje të kapitullit të sipër-treguem tue shënue at shumë në librin e arkës. Njikohësisht kjo shumë ka me u shënue në dalje të kont-kurrentit po n'at libër arke, sikur se Arka e Qendrës

të ketë ba po ajo vetë versimin pranë Bankës Kombëtare të Shqipnis.

Ministrija e Financavet ka me i njoftue Bankës Kombëtare të Shqipnis modifikimin që do të bahet mbi intestimin e kontkurentit.

Neni 5.

Kredinat e çfardo natyre që rezultojnë nga gjendja financjare e patrimoniale e Arkës së Pensjonevet kanë me u shënue në kapitullin e t'ardhunavet krijue si mbas dispozitës së nenit 7 të kësaj Rregullore, dhe nxjerrja e tyne ka me u ba në format e zakonshme për të gjitha t'ardhunat e Shtetit.

Neni 6.

Pagesat e shpenzimevet përsa i përkasin funksionimit të zakonshëm t'Arkës së Pensionevet dhe ngelin pa u pague në kohen e kalimit të shërbimit, kan me u ba me fondet e zakonshme të budgetit passiv të Ministris së Financavet.

Borxhet që eventualisht mund të ketë Arka e Pensioneve për arësyena të tjera, kan me u pague me anë fondesh të veçanta per t'u caktue në budget, pagesa këto që do t'autorizohen si mbas formave të caktueme prej Ligjës së kontabilitetit, por gjithëherë tue vleftsue dhe tue vërtetue ma parë ndodhjen dhe legalitetin e tyne.

Neni 7.

Në gjendjen e parapamjeve t'ardhunavet për ushtrimin financjar 1934-35, ndër t'ardhunat efektive të pjesës së rendëshme, krijohet kapitulli 34-bis. «Nxjerrje e fondit t'Arkës, të saldit të kontitkorent që gjindet pranë Bankës Kombëtare të Shqipnis dhe e kredinavet që i përkasin Arkës së Përgjithshme të Pensjonevet për nëpunësat civil të Shtetit.

Neni 8.

Mandat-pagesat e lëshueme prej adminitratave qeveritare në favor t'Arkës së Përgjithshme të pensjonevet për ndaljet e pensjonevet mbi rrogat e funksionarëvet civil e ushtarak dhe për çdo arësye tjetër, që gjindet pranë Arkës së Qendrës së Ministris së Financavet dhe pranë Arkave të qarqevet, anulohen.

Mandat-pagesat e shlyeme pjesërisht, kan me u zbritun dhe kan me u llogaritun për shumat e pagueme efektivisht.

Neni 9.

Kredinat e Arkës së Përgjithshme të Pensioneve që rezultojnë

nga kont-kurentet të shënueme pranë Arkës së Përgjithshme të Ministris së Financavet ose pranë Arkave të Drejtorinavet, e të Nen-Drejtorinavet Financjare, anulohen me masë të Ministris së Financavet si mbas dispozitës së nenit 101 të Rregullores së kontabilitetit datë 7 Fruer 1930.

Neni 10.

Me vendime të Ministrit të Financavet kan me u marrë edhe masat për sistemimin kontablë të gjitha marrëdhanjeve të borxhit dhe të kreditit, që kanë gjamë në mes t'Administratavet qeveritare dhe t'Arkës së Pensioneve si në lidhje të veprimeve jasht budgetit, sa dhe ndër veprimet e budgetit të vetë, veprime këto që nuk janë parapa ndër nenet 8 e 9 të kësaj Rregullore.

Neni 11.

Pagesat e pensjoneve që gjinden me datë 1 Prill 1934 dhe, t'atyne që do të likuidohen në kohën e ardhshme bahet si zakonisht me mandat-pagesa direkte për t'a pague pranë Drejtorivet e Nen-Drejtorinavet financjare.

Për pensjonet që kapin nji shumë ma t'ultë se fr. ari 10 në muej, mandat-pagesa mund të lëshohet për tre muej pensjon; për pensjonet që kapin nji shumë në mes fr. ari 10 e fr. ari 20 në muej, mund të lëshohen mandat-pagesa për dy muej së bashku.

Neni 12.

Pagesa e pensjonevet për pensjonistat që banojnë ndër vende ku nuk gjinden zyra financjare mund të bahet në mëyrën dhe si mbas dispozitave të parapame në nenin 142, të Rregullores së kontabilitetit datë 7 Fruer 1930.

Për ket qëllim Ministri i Financavet ka me i dhanë një funkcjonari në shërbim të pensjonevet të drejtën me prelevue fondet e duhuna nga mandat-pagesa për çelje krediti që ka me u lëshue pranë Dretjoris Financjare të Tiranës.

Funksjonari i sipër-treguem, me fondet që do të prelevojnë, do të përkujdeset për lëshimin e mandat-postave të nevojshme që do t'i dërgohen t'interesuemvet.

Shpenzimet për lëshimin e mandat-postavet janë në ngarkim të pensjonistavet.

Neni 13.

Justifikimi i pagesavet të bame prej funksjonarit delegues përbahet prej nji listës që do të ketë të shenueme të gjitha pikat kryesore të pensioneve të pagueme, e cila mban për bashkëlidhje do-

rëlamjet e lëshueme prej Zyrës postare të Tiranës.

Këto dokumenta duhet t'i bashkalidhen amzës t'urdhun-pagesës së lëshueme mbi mandat-pagesën për çelje krediti lëshue si mbas dispozitës së nenit 12 paragr. 2 të kësajë Rregullorjeje.

Neni 14.

Ministri i Financavet autorizohet me dhanë instruksjonet që eventualisht nevojiten për zbatimin e kësaj Rregulloreje; e cilla hyën në fuqi në diten e botimit të saj në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 301-I datë 19-4-935 të Kryeministris.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 16-4-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Rregullores për kalimin e shërbimit t'Arkës së Përgjithshme të Pensjoneve për Nepunësat Civilë, në Ministrin e Financavet.

Tiranë, me 23 Qershuer 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 99.

LIGJE, 13 Qershuer 1934.

Mbi disa ndryshime ne buxhetin preventiv t'ushtrimit Financjar 1933-34

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Korrik 1934, Nr. 40)

Neni 1.

Për përballimin e deficitit të konstatuem gjatë zbatimit të buxhetit preventiv t'ushtrimit financjar 1933-34, në gjendjen e parapamjevet t'ardhunavet si dhe n'ate të shpenzimevet, bahen ndryshimet që pasojnë:

a) në gjendjen e parapamjevet t'ardhunavet shtohet shuma komplesive prej fr. ari 36.040, e cila rezulton nga kontribucjoni i përmendun në nenin 4;

b) nga gjendja e parapamjevet të shpenzimevet pakësohet shuma komplesive prej fr. ari 3.694.707.

c) Gjendja e parapamjevet të shpenzimevet të buxhetit Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, ndryshohet në shumën komplesive prej fr. ari 6,917.370.

Paksimet që shënohen në shkronjen b) si dhe ndryshimet që shënohen në shkronjen c) të dallueshme për ç'do dikaster e për ç'do kapitull të buxhetit, tregohen në pasqyrën përkatëse Nr. 1 e 2 qi i bashkalidhet kësaj Dekret-Ligjë.

Neni 2.

Përveç ndaljes së jasht-zakonëshme të caktueme në nenin 6 të Ligjës s'aprovimit të buxhetit preventiv t'ushtrimit 1933-34, zbatohet edhe nji ndalje 12¹/₂% (dymbëdhjet e gjysëm për qind) mbi caktimet buxhetore origjinale (brutto) mujore të rrogavet, alokacjonevet e shperblimevet të çdo natyre të Ministrivet, të Paris së Parlamentit e të Trupit të Deputetvet, të gjithë nëpunësavet e të personelit sherbyes civil, t'Oficeravet t'ushtris e të Gjindarmeris, të Graduatvet, t'ushtarëve e të Gjindarmëvet qi paguhen prej Arkës së Shtetit e qi kompetenca e tyne muejore kalon të 20 fr. ari.

Neni 3.

Caktohet nji ndalje prej 10% (dhjet për qindë) mbi caktimet origjinale buxhetore muejore të personavet ose të familjevet qi i-u paguhen nga Arka e Shtetit rroga jetike e shpërblime patriotike ma tepër se, 20 fr. ari në muej.

Neni 4.

Përveç kontribucjonit të caktuem në Dekret-Ligjën me datë 28 Korrik 1933 mbi caktimet origjinale buxhetore muejore të rrogavet të nëpunësavet t'Arkës së Pensjonevet Civile, meret nji kontribucjon prej 12¹/₂% (dymbëdhjet e gjysmë për qind) në favorin e Arkës së Shtetit.

Gjith'ashtu merret nji kontribucjon 10% (dhjet për qindë) mbi gjithë pensjonet personale të lidhuna pensjonistave Civil e Ushtarak, familjeve ose misave të familjevet të tyne në rastin se pensjonet janë të caktueme individualisht; si dhe mbi gjithë rrogat e disponibilitetit t'ish nëpunësave të Shtetit qi paguhen nga Arka e Pensjoneve Civil ma tepër se nga 20 fr. ari në muej. Vertetimet dhe veprimet n'Arkën Shtetnore të kontribucjonevet të sipërpërmenduna, bahen si mbas dispozitave të nenevet 4, 5, e 6 të Dekret-Ligjës me datë 28 Korrik 1933 të sipër-permendun.

Neni 5.

Nga ndaljet e përmenduna në nenin 2 e 3, si dhe nga kontribucjoni i përmendun në nenin 4, përjashtohen:

a) gjith rrogat e nëpunësave të marrun me kontratë;

b) gjith alokacjonet e shpërblimet e përfaqësimet të jashtëme të personelit të Legatave e të Konsullatavet.

Neni 6.

Ndaljet dhe kontribucjonet të përmenduna në nenin 2, 3 e 4 bahen në tetë kiste të njinjishme, tue fillue me kompetencen e muejit Gusht 1933, e tue marrun fund në atë të muejit Mars 1934.

Neni 7.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1933-1934 të Ministris s'Ekonomis Kombëtare bahen këto shtesa:

Kap. 2. «Rrogë personeli me kontratë» i shtohet nji fond prej fr. ari 1.200 (njimijedyqind);

Kap. 7 «Shpenzime bujqësore gjithfarësh» i shtohet nji fond prej fr. ari 20.000 (njizetmijë);

Kap. 9 «Shpenzime gjithfarësh për mbajtjen e Stacionit Zooteknik në Xhafzotaj etj.» i shtohet nji fond prej fr. ari 40.000 (dyzetmijë-.

Krijohet Kap. 12 bis me emertim (fond per pagesen e bursave specializimi, shperblime specializimi nëpunësash e shpenzime këthimi» me nji fond prej fr. ari 28.190 (njizetetetëmijë e njiqindë e nandëdhjet).

Neni 8.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi qysh nga dita e shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare dhe, ka me i-u paraqitë Parlamentit për kthimin e sajë në Ligjë.

Neni 9.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

Kryeministri — P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis — V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme — XHAFER VILA

Ministri P. Mbrendshme e Zar.

Ministri i Ekonomis Kombëtare — MUSA JUKA

Ministri i Financavet — A. DIBRA

Ministri i Arësimit — Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore — S. SARAÇI

DKSH

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 92 datë 26-VIII-833 të Kryeministris.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 28-V-1933.

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi disa ndryshime në buxhetin preventiv t'ushtrimit financjar 1933-34.

Tiranë, me 28 Gush 1933. Z O G

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarvet

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës me datë 28-VIII-1933, t'aprovueme prej Parlamentit, dhe Urdhëron shtimin e tij në Kodet e Mbretnis si Ligjë.

Tiranë, me 13 Qershuer 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri P. Mbrendshme e Zav.
Ministri i Ekonomis Kombëtare
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Përmbledhje mbi Paksimet e fondeve në budgetin e ushtrimit financjar 1933 - 1934

D e g a :	Fond' i paksuem: fr. ari
Institutet e Nalta e Ministria e Financavet	301.767
Ministrija e Dretjësis	110.670
Ministrija e P. Mbrendëshme e Drejt. e P. e Shëndetsis	137.250
Ministrija e P. të Jashtëme	30.350
Ministrija e P. Botore Drejt. P. Postë-telegrafavet	234.045
Ministrija e Ekonomis Kombëtare	76.320
Ministrija e Arësimit	224.125
Komanda e P. e Gjindarmeris	161.321
Komanda e Mbrojtjes Kombëtare	2.318.859
S h u m a	3.694.707

Pasqyrëzë mbi paksime fondesh në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933 - 1934

Gjendja e parapamjevet të shpenzimevet të Ministri së Financavet

Kapitulli	Emertim	Fond i pakësuem fr. ari
	Pallat' i N. M. Saj Nanës Mbretneshë	
6	Rrogë personali e Meter Ceremonis	700
	Shtëpija Civile	
7	Rrogë personeli e alokcjan	3.120
8	Shpenzime udhëtimi e djete	1.000
9	Shpeinzime zyreje	1.350
	Inspektorija	
10	Rrogë personeli, alokacjon	4.520
11	Shpenzime udhëtimi e djete	5.000
12	Shpenzime Zyreje	300
	Adjudantura	
13	Rrogë personeli, alokacjon ushqim oficjerash	3.070
14	Shpenzime udhëtimi e djetë	1.250
15	Shpenzime Zyreje	3.000
	Shtëpija Ushtarake	
17	Shpenzime Zyreje	1.200
	Parlamenti	
19	Shpërblim Paris e Trupit të Deputetvet	38.640
20	Rrogë personeli	5.630
21	Shpenzime Zyreje	5.500
23	Shpenzime udhëtimi e djetë (zbriten 25% nga kompetencat personale)	4.500
	Kshilli i Shtetit	
24	Rrogë personeli e alokacjon	5.830
25	Shpenzime Zyreje	1.500
26	Shpenzime udhëtimit	250
	Kryeministrija	
27	Rrogë personeli e alokacjon	5.110
28	Shpenzime Zyreje	5.000
29	Shpenzime udhëtimi e djetë	200

Drejtorija Përgjithshme e Reformës Agrare

31	Rrogë personeli mbas kuadrit etj.	fr. ari 9 690
33	Shpenzime udhëtimi e djete	2.500
34	Shpenzime Zyreje	1.500
37	Blemje e mbajtje veglash teknike etj.	5.000
	Kshilli Kontrollues	
39	Rrogë personeli, alokacjon rrogë nëpunsash të mbetun jashta kuadrit	7 690
40	Shpenzime Zyreje	800
40-bis	Shpenzime udhëtimi e djetë	100
	Ngarkime të Shtetit	
41	Rrogë jetike dhe shpërblim për merita patriotike	5.000
	MINISTRIJA E FINANCAVET	
	Shpenzime të përgjithshme	
44	Rrogë personeli e zavendësije, në rasë dorëzim zyreje etj.	87.630
54	Laboratori Kimik blemje veglash barnash të vogla etj.	1.500
55	Shpenzime për mbajtjen e maseve e rifornimin e benzinës e voji	3.750
56	Kthim tatimesh tagrash e taksash të marruna tepër prej eksportimit të duhanit	2.000
57	Ndërtime e miratime në pasuni Shteti e blemje trojesh për ndërtesa Shtetnore	
62	Fond rezervë për plotësim fondesh e për shpenzime të pa parapame në budget	52.937
	Shuma	301.767

Pasqyrëzë mbi paksime fondesh në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933 - 34, të Ministris së Drejtësis

Kapitulli	Emertim	Fond i pakësuem fr. ari
1	Rrogë personeli mbi kuadri, rrogë zavendësije etj	80.260
2	Shpenzime udhëtimi e djete	4.500
3	Shpenzime Zyreje	14.500
5	Shpenzime hetimesh e dishmitarësh dhe për beneficin e vobeksis	8.500
9	Shpenzime për gjyqin e posaçmë për faje politike	2.910
	Shuma	110.670

BKSH

Pasqyrëzë mbi paksime fondesh në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-34 të Ministris së Punëve të Mbrendëshme, e të Drejoris Shëndetsis

TITULLI I. SHPENZIME TË RENDËSHME

Ministrija e P. të Mbrendëshme

Kapitulli	Emertim	Fond i pakësuem fr. ari
1	Rrogë personeli, zavendësije, në rasë dorëzim Zyreje për nëpunësa në udhëtim e jashta kuadrit, alokacjon e shpenzime përfaqësimi	67.810
2	Shpenzime udhëtimi e djete	5.000
3	Shpenzime Zyreje	11.250
8	Shpenzime për botimin e Fletores Zyrtare	3.000
11	Rrogë personeli, ushqim shperblime e shpenzime gjithfarësh, kançeleri, qira, shtypshkrime, zjarm e dritë të vogla, mirëmbajtje e mbathje e ushtarve e tje-ra për Kapitenerit e Porteve	13.220
	Administrata e Shëndetësis Botore	
12	Rrogë personeli zavendësije dhe në rasë dorëzim zyreje etj. etj.	27.470
13	Shpenzime udhëtimi e djete	3.000
14	Shpenzime Zyreje	2.000
20	Instituti qendruer higjenikë e Shkolla infermierve etj.	2.000
	TITULLI II. SHPENZIME TË PA-RENDËSHME	
	Administrata e P. të Mbrendëshme	
22	Subvencjon Shoq. «Grueja Shqiptare»	1.500
	Administrata e Shëndetsis Botore	
24	Tager doganuer për materialin e importuem për ngrehjen e spitalit «Turtulli» në Korçë	1.000
	Shuma	137.250

Pasqyrëzë mbi paksime fondesh në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933 - 1934 të Ministris së Punve të Jashme

Kapitulli	Emertim	Fond i pakësuem fr. ari
1	Rrogë personeli, alokacjon rrogë disponibiliteti e rrogë për nëpunësa të mbetun jashta kuadrit	22.850
3	Shpenzime Zyreje	7.500
	Shuma	30.350

Pasqyrëzë mbi paksime fondesh në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-34 të Ministris së P. Botore, e të Drejtoris së Përgjitshme të Post-Telegrafavet

Administrata e P. Botore

Kapitulli	Emertim	Fond i pakësuem fr. ari
1	Rrogë personeli, alokacjon etj.	26.330
3	Shpenzime udhëtimi e djete	8.750
4	Shpenzime Zyreje	5.000
7	Ndertime e miratime rrugash, urash, kanalesh, akuadukte, ndërtesa blemje e mbajtje mjetesh tranporti	94.390
8	Blemje veglash e material ravizimi	750
9	Shperblim puntorësh të vramë e të mbetun invalid në detyrë, si dhe barna për mjekim puntorësh	1.000
	Administrata e P. Telegrafavet	
10	Rrogë personeli zavendësije etj	60.825
13	Shpenzime Zyreje	7.000
15	Bartje postash të jasht-zakonëshme	5.000
16	Blemje material post-telegrafonik	4.000
17	Ngrefje e mbajtje linjesh telegrafike	5.000
18	Instalim e mirë-mbajtje radiosh	1.000
20	Taksa telegramash	15.000
	Shuma	234.045

Pasqyrëzë mbi paksime fondesh në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933 - 1934 të Ministris s'Ekonomis Kombëtare

Kapitulli	Emertim	Fond i pakësuem fr. ari
1	Rrogë personeli zavendësije, alokacjon etj.	38.640
3	Shpenzime udhëtimi e djete	10.000
4	Shpenzime Zyreje	6.000
10	Inkurajim për shtimin e prodhimeve kombëtare Zooteknike	2.500
11	Shpenzime gjithëfarësh për industrin e zukthavet	3.000
12	Shpenzime gjithfarësh për Shkollën e bujqësis Lushnje dhe fermen të sajë anekse	16.180
	Shuma	76.320

Pasqyrëzë mbi paksime fondesh në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1933 - 1934 të Ministris së 'Arësimit

Kapitulli	Emertim	Fond i pakësuem
		fr. ari
1	Rrogë personali, zavendësije, alokacjon etj.	210.125
3	Shpenzime udhëtimi e djete	5.000
4	Shpenzime Zyreje	8.000
10	Kërkime dokumentash historike e shpërblime për për-kthimin e tyne	1.000
	S h u m a	224.125

Gjendja e parapamjevet e shpenzimeve të Koman. së Mbrojtjes Kombëtare për ushtrimin 1933 - 1934 (Degë Ushtri)

TITULLI I. SHPENZIME TË RENDËSHME

K a t. I. SHPENZIME EFEKTIVE

Shpenzime për Komanden e Mbrojtjes Kombtare e Fuqinat Toksore

Kapitulli	Emertim	Fond i pakësuem
		fr. ari
1	Rrogë oficerash e nepunësash civila me perjashtim të personelit civil të Spitaleve, të Shkollave e Ofiçinave	1.603.663
2	Rrogë graduatësh e ushtarësh me rrogë rekruta, shperblim për Garden Mbretnore e për Rojen Mbretnore të Kufinit	1.686.489
3	Shpenzime e shperblime udhtimi e shperblime të posaçme	333.770
4	Shpenzime për mbajtjen e të sëmundëvet nder spitale e ndër infermerina Garnizonit, ushqim i posaçem për të shtruem, rrogë personeli civil të spitaleve, blemjeve e mirëmbajtje e shpërndamje barnash e materjal shëndetsuer, shpenzime të ndryshme shëndetsije, shpenzime nder Spitale civile të Shtetit, shpenzime për vorrime, shpenzime për oficera qi dergohen për shërim nder spitale të jashtme për smundje të marruna në sherbim	198.000

5	Shpenzime për mbajtjen e nxanësavet nder shkolla ushtarake, rrogë personelit civil të shkollavet, shpenzime për mbajtjen e funksjonimin e Shtypshkronjës Ushtarake, dhe humbje të rrjedhuna nga shkaqe të vertetueme të fuqis madhore	188.102
7	Blemje e persëritje e mirëmbajtje e vesh-mbathjes e pajimit të trupavet	72.220
8	Blemje e persëritje e mirëmbajtje e mobiljeve e materialit të kazermave, kashtë për shtresë ushtarësh, zjarm e dritë	151.321
9	Ushqim oficerash, nxanësash, graduatësh e ushtarësh	1.246.450
10	Hesë e kashtë për kafshë, rrogë personalit civil me sherbim të kafshëve, shpenzime për mjekim e vegla veterinarije spenzime të ndryshme për sherbimin ipik e veteriner, shpenzime për mathjen e kafsheve	265.677
11	Rrogë e shpenzime të ndryshme për fuqit civile e shpenzime për informacione (të mshefta)	178.200
	për t'u bartë	6.223.364
12	Blemje kafshësh, shpenz. për rekuizime kafshësh, shperblim oficerave për humbje kafshësh	990
13	Blemje e mirëmbajtje e materialit t'Artileris	43.262
14	Punime mirëmbajtje, permirësime e smadhime të ndertesave ushtarake, mirëmbajtje e persëritje e materialit të lujtëshem të Xhenios e t'artileris, ushtrim e mirëmbajtje të vijave télefonike ushtarake, funksjonim i oficinavet, shperblim damesh të bamuna pronsinave private prej ushtrimeve ushtarake, transport materiali ndertimi e shpenzime të ndryshme të Xhenjos	179.298
15	Shpenz. për tranportime ushtarake, blemje e mirëmbajtje automjetesh të ndryshme e të nevojshme për shërbimin e auto-transportimeve, për funksjonimin e auto-repartit e t'Ofiçinës s'automobilave, shpenzime për transportime me mjete private	110.000
16	Qirana ushtarake	178.200
17	Dhurata për ushtrime, gara e konkurse	1.980
		6.737.094

BKSH

Shpenzime për fuqinat Detare

18	Rrogë e shpenzime fikse e eventuale për personelin e Marinës, ushqim për personelin e shpenzime të ndryshme për funksjonimin e Marinës	59.628
		59.628

Shpenzime të ndryshme

19	Shpenzime të veçanta për Milicin Para-Ushtarake (Shpenzimet e zakonëshme janë parapa ndër kapituj të ndryshëm të Ushtris)	19.800
		19.800

Fonde të veçanta

20	Fonde rezervë për plotësim të kapitujve të ndryshme qi janë në mungesë	pro-memoria
21	Fond dispozicjoni si mbas art. 14 të Ligjës mbi Organizimin e Intendancës së Përgjithshme	72.300
		72.300

Shpenzime për Gjindarmeri

(Ndryshimet e bame në pjesën e Gjindarmaris tregohen në pasqyrzen Nr. 1)

TITULLI II. SHPENZIME TË PA-RENDËSHME

K a t. I. SHPENZIME EFEKTIVE

Shpenzime të ndryshme për Ushtri

36	Ndertime të reja ushtarake transformime të mbëdhaja të gjanave të pa-tundëshme në përdorim ushtarak, blemje e përmirësime të gjanvet të pa tundëshme në përdorim ushtarak, instalim vijash telefonike të perherëshme	28.548
		28.548

Përmbledhje e pejsës s'Ushtris

Shpenzime për Kom. e Mbrojtjes Kombëtare e Fuqinat Toksore	6.737.094
Shpenzime për Fuqinat Detare	59.628
Shpenzime të ndryshme	19.800
Fond të veçantë	72.300
Shpenzime të ndryshme për Ushtri (të pa-rendëshme)	28.548
S h u m a	6.917.370

BKSH

Pasqyrëzë mbi paksime fondesh në gjendjen e parapamjevet Komandës së Përgjithshme të Gjindarmeris

Kapitulli	Emertim	Fond i pakësuem fr. ari
22	Rrogë oficeri, personeli civil ushqim oficerash e ushqim kualsh e oficerash	42.041
23	Rrogë Graduatësh e Gjindarmësh	219.280
	Shuma	261.321

Nr. 100.

DEKRET-LIGJE, 9 Korrik 1934.

Mbi abrogimin e Art. 65 të Ligjës së Pensioneve Civil e Ushtarak me datë 20 Qershuer 1934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Korrik 1934, Nr. 40)

Art. 1.

Neni 65 i Ligjës mbi Pensionet Civil e Ushtarak, abrogohet.

Art. 2.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje, e cila hynë në fuqi prej shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 62/IV dt. 2-VII-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 27-VI-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi abrogimin e Art. 65 të Ligjës së Pensioneve Civil e Ushtarak me datë 20 Qershuer 1934.

Tiranë, me 9-VII-1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI — *Ministri P. të Jashtme* XHAFER VILA

Ministri i P. Mbrendëshme MUSA JUKA — *Ministri i Drejtësis* V. AVRAMI

Ministri i Arësimit Dr. MIRASH IVANAJ — *Ministri i Financavet* A. DIBRA

Ministri i Ekonomis Kombëtare D. BERATTI — *Ministri i P. Botore* S. SARAÇI

BKSH

Nr. 101.

DEKRET-SHTOJCË-RREGULLORE, 20 Qershuer 1934.

Mbi shtimin e një paragrafi në nenin 1, dhe zevendësimin e Nenit 15 të Rregullores mbi Tarifën e Barnave me datë 19 Qershuer 1933

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Korrik 1934, Nr. 40)

Neni 1.

Nenit të parë të Rregullores mbi tarifen e Barnave me datë 16-6-1933, i shtohet paragrafi qi vijon:

«Nga çmimet e barnave dhe nga dorë punimet e caktueme në tarifën q'i lidhet Rregullores farmaceutike të siper-shenueme, bahet nji zbritje 50% dhe prej specialiteteve 20%.

Neni 2.

Neni 15 i Rregullores mbi tarifen farmaceutike ndryshohet kështu:

Lihet e lirë hyrja e gjithë specialitetëve që nuk figurojnë në tarifë me kusht që t'interesuemit t'i paraqitin Drejtoris së P. të Shëndetësis nji kopje të fatkurës q'i kanë prezantue doganës për taksin. Kjo fakturë do të përmbajë vërtetimin e doganës se asht nji llojë me atë q'ajo ka marrun taksin e caktuem prej tarifës doganore, që kështu Drejtorija e P. e Shëndetësis të ketë bazë për caktimin e vleftës së shitjes tyre deri sa të pregatitet tarifa e ré.

Neni 3.

Çdo dispozitë në kundërshtim me ketë shtojcë, bije nga fuqija qysh prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 4.

Ministrija e P. të Mbrendëshme dhe ajo e Drejtësis ngarkohen me zbatimin e kësaj Shtojcë-Rregullore.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 793/I dt. 18-VI-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 12-VI-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret--Shtojcë-Rregullores mbi shtimin e nji paragrafi në Nenin 1 dhe, zavendësimin e nenit 15 të Rregullores mbi tarifen e barnave me datë 19 Qershuer 1933.

Tiranë, me 20 Qershuer 1934. Z O G

Kryeministri *Ministri i Drejtësis*

PANDELI EVANGJELI V. AVRAMI

Ministri i P. Mbrendëshme

MUSA JUKA

Nr. 102.

DEKRET-LIGJË, 9 Korrik 1934.

Mbi krijimin e Kap. 22-bis «Subvencion Klubit Turistik Automobilistik Mbretnuer» në budgetin e ushtrimit 1934 - 35, të Ministris së P. të Mbrendshme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 21 Korrik 1934, Nr. 41)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet të Ministris së P. të Mbrendshme për ushtrimin financjar 1934-35, krijohet Kap. 22-bis «Subvencjon Klubit Turistik automobilistik Mbretnuer» me nji fond prej fr. ari 5.000 (Pesmijë).

Art. 2.

Fondi prej fr. ari 5.000 (pesmijë) shtue kapitullit të shenjuem mbas art. 1 të kësaj Dekret-Ligjë, përballohet me pakësimin e fondit për ketë shumë nga Kap. 8 «Shpenzime gjithfarësh për Edukatën Fizike etj» të gjendjes së parapamjevet e shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1934-35, të Ministris s'Arësimit.

Art. 3.

Ministrija e P. të Mbrendshme autorizohet me shpenzue dhe fr. ar 25.000 (njizetëpesëmijë), për subvencion të klubit turistik automobilistik Mbretnuer përballim proporcionalisht nga t'ardhunat e Bashkive.

Art. 4.

Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 5.

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë ngarkohet Ministri i P. të Mbrendshme, Ministr' i Arsimit dhe aj i Financavet.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1038 d. 7-7-1934 të Kryeministriës,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 5-VII-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi krijimin e Kap. 22-bis «Subvencjon Klubit Turistik Automobilistik Mbretnuer» në budgetin e ushtrimit 1934-35, të Ministris P. Mbrendshme.

Tiranë, me 9 Korrik 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme MUSA JUKA

Ministri i Financavet A. DIBRA

Ministri i Arësimit Dr. MIRASH IVANAJ

Nr. 103.

SHTOJCË-DEKRET-LIGJE, 9 Korrik 1934.

Mbi Ligjën Organike të Ministris P. të Jashtme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 21 Korrik 1934, Nr. 41)

Neni 1.

Për të siguruar funksjonimin e Zyrave Konsullore të suprimueme me Ligjën budgetore t'ushtrimti financjar 1934-35, merren masat qi tregohen ma poshtë:

a) Kryekonsullata në Bukuresht e n'Aleksandri dhe Konsullata në Boston, Selanik e Janinë dotë kenë Titullarë të nderit dhe nga nji Sekretar të karierës;

b) Konsullata në Manastir do të drejtohet vetëm me nji Sekretar, të cillit do t'i ngarkohen gjithë veprimet e sotme të zyrës përkatëse.

Neni 2.

Shpenzimet e zyrave të nalt-përmenduna dhe rrogat e alokasjonet e nëpunësavet përkatës, caktohen si mbas radhorit të bashkëngjitun.

Neni 3.

Kjo Shtojcë-Dekret-Ligjë hynë në fuqi prej ditës së botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 4.

Ministrija e P. të Jashtëme dhe Ministrija e Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Shtojcë-Dekret-Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 879/I d. 16-6-1934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 13-VI-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Shtojcë-Dekret-Ligjës mbi Ligjën Organike të Ministris së P. të Jashtëme.

Tiranë, me 9 Korrik 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri P. të Jashtme XHAFER VILA

Ministri i Financavet A. DIBRA

RADHORI

	Në vjetë		
	Rrogë	alokacjon	Shpenz. Zyre
	fr. ari	fr. ari	fr.ari
Kryekonsullata			
Aleksandri Sekretar' i II.	3.600	1.800	3.600
Bukuresht Sekretar' i II.	3.600		1.200
Konsullata			
Boston Sekretar' i III.	3.000	3.600	—
Selanik Sekretar' i II.	3.600	2.400	3.600
Janinë Sekretar' i II.	3.600	1.200	2.450
Manastir Sekretar' i II.	3.600	1.200	3.000

BKSH

Nr. 104.

DEKRET-LIGJË, 14 Korrik 1934.

Mbi rregullimin e shperblimeve për Oficerat që lirohen për shkak zvogëlimi të kuadros si mbas budgetit 1934-35

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Korrik 1934, Nr. 42)

Neni 1.

Gjith Oficerave qi gjinden në shërbim të përhershëm ose në shërbim të përkohëshëm dhe, qi për shkak të zvogëlimit të kuadros (budgetit) 1934-35 qiten ose ri qiten në lirim, u paguhet nji rrogë ose shpërblim muejorë në masën e nën kushtet e posht-tregueme :

a) atyne qi kanë mbushun 10 vjet shërbim të vlefshëm për pensjon u jepet nji rrogë muejore baras me 40% të rrogës së plotë të gradës së tyne. Kjo rrogë paguhet me titullin «rrogë lirimi» dhe vazhdon deri në rregullimin definitiv të të drejtavet të tyne.

b) Atyne qi kanë ma pak se 10 vjet shërbim të vlefshëm për pensjon, u paguhet nji shpërblim mujuer baras me 40% të rrogës së plotë të gradës së tyne; kjo rrogë paguhet vetëm për aq muaj sa janë vjetët e sherbimit të vlefshem për pensjon por jo ma pak se katër muej.

c) Atyne qi kanë mbushun 15 vjet sherbim të vlefshëm për pensjon u likuidohet pensjoni në bazë të Ligjëve të Pensjoneve Civile e Ushtarake me datë 20-VI-1934.

ç) Për caktimin e vjetëve të shërbimit veprohet në bazë të dispozitave të Ligjës së Pensjoneve Civile e Ushtarake me datë 20-VI-1934.

d) Rrogat e përmenduna në paragrafin a) i shtrohen vetëm 8% ndaljes së pensjonit; dhe ato të përmenduna në paragrafin b) përjashtohen nga ç'do ndalje.

Neni 2.

Oficerat qi kanë qenë të pensjonuem dhe që janë ri-marrun përkohësisht në shërbim dhe, qi në rastin e zvogëlimit të kuadros 1934-35 (budgetit) ri-qiten në lirim, gëzojnë rishtaz të drejtat e pensjonit si mbas art. 8 të Ligjës së Pensjoneve Civile e Ushtarake me datë 20-VI-1934; dhe si pensjonet e tyne ashtu dhe ato të përmenduna në pargrafin c) të nenit 1 të kësaj Dekret-Ligjë, u-nenshtrohen ndaljeve të jasht-zakonëshme si mbas nenit 5 të Ligjës së budgetit 1934-35, dhe përqindjeve e ndaljeve të caktueme me Ligjën e Pensjoneve me datë 20-VI-1934.

Neni 3.

Rrogat dhe shpërblimet e përmenduna në paragrafin a) e b) të nenit 1 të kësaj Dekret-Ligjë, paguhen nga fond' i posaçëm i nëpunësavet të mbetun jashta kuadrit i krijuem në budgetin udhëtues të Ministris së Financavet.

Pagesa fillon qysh prej datës së largimit nga detyra.

Neni 4.

Oficjerave të qitun në lirim, deri sa largohen nga detyra të drejtat e tyne u paguhen në bazë të kuadrit t'ushtrimit financjar 1933-34, dhe nga budgeti udhëtues i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare tue, i-u shtruem ndaljeve të jasht-zakonëshme si mbas nenit 5 të Ligjës së budgetit 1934-35.

Neni 5.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë, e cila hynë në fuqi qysh prej ditës që shpallet në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1005/I d. 13-7-1934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Kshillit Ministruer me datë 11-VII-1934.

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi rregulimin e shperblimeve për Oficerat qi lirohen për shkak zvogëlimi të kuadros si mbas budgetit 1934-35.

Durrës, 14 Korrik 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Ekon. Kombëtare
D. BERATTI

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

BKSH

Nr. 105.

LIGJË, 23 Maj 1934.

Mbi shitjen e pasunive të pa-tundëshme shtetnore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 28 Korrik 1934, Nr. 43)

Art. 1.

Autorizohet Ministrija e Financavet me shitë pasunit e pa-tundëshme të Shtetit qi janë të shenueme në listën anekse të kësaj Ligjë, me anën e nji Komisioni i përbamë prej:

a) Nëpunsit të Financavet
b) Nëpunsit t'Ipotekavet
c) Nëpunsit të Bujqësis (n'asht se ka)
ç) Antarit të Këshillës Administratës
d) Antarit të Bashkis.

Tue qenë i kryesuem prej Nëpunsit të Financavet, dhe i survejuem prej Prefektit ose Nënprefektit.

Art. 2.

Anëtari i Këshilit t'Administratës, zgjidhet e emnohet me vendim t'atij Këshilli, dhe ay i Bashkis me vendim të Këshillit të sajë.

Art. 3.

Pasunia qi diftohet në listën anekse të kësaj Ligjë, shitet n'adjudikatë me anë të Komisionit qi përmendet n'art. 1.

Lista anekse përbahet prej 20 faqe të mbushuna, përmban numrin 96, vërtetimin e Ministris së Financavet, konformue në ç'do faqe me vulën e Dhomës së Deputetëve dhe me nënshkrimin e Kryetarit të sajë.

Art. 4.

Forma e ankandit mbi shitjen e pasunive në fjalë, do të bahet në bazë të Ligjës mbi administrimin e pasunis, dhe kontabilitetin e përgjithshëm të Shtetit, tue caktue mâ parë nga ana e Komisionit të përmendun n'art. 1, të kësaj Ligjë çmimi bazë i pasunis dhe mandej do t'ushtrohet ankanti.

Art. 5.

Ofertat pranohen mbasi ofertuesat të depozitojnë n'arkën financjare si depozitë në të holla 10% mbi shumën e caktueme prej Komisionit, dhe dy fish me garancien e pasunies së pa-tundëshme. Shpenzimet e kasnecit, të pullavet dhe të transkriptimit të zyrës së ipotekave, do të paguhen nga ana e blerësit.

BFSH

Art. 6.

Zyra Ipotekore ban të gjitha veprimet Ligjore për transferim të pasunis së shitun n'emën të blerësit tue, u bazue në notë transkriptimin që lëshon Financa me anën e Noterit.

Art. 7.

Tokat në qytet mbi të cilat janë ngrehun shtëpija prej privatvet ose janë ba përmirësime tue u mbjellun pemë e vneshta, dhe kështu vlefta e tyne kalon atë të tokës, dhe për të cillat toka këto, paguajnë nji qira (ixharei-zemin) ose të dhetë, nuk qiten n'ankand por u shiten atyne me vleftën e caktueme e cila paguhet në kiste mbrenda tre vjetëve.

Art. 8.

Të hollat prej shitjes në fjalë do të meren nga arkat financjare si depozitë, të cilat mandej do të dorëzohen Bankës Agrare si mbas nenit 2 të Ligjës mbi formimin e Bankës Agrare.

Art. 9.

Ministrija e Financavet asht e autorizueme me shkëmbye me Zonjën Qanie Selim Pashë Toptanit, nji copë tokë në katundin Sauk të Tiranës prej 7000 m², qi përfshijnë Nr. 96 të listës anekse në rast se, dhe ajo asht gati me i lëshue Shtetit nji copë tokë që pronson në akt njoftimin Nr. 177 të Gjykatës Tiranës me datë 30 Tetuer 1933, po n'atë katund me nji sipërfaqe prej 7000 m².

Art. 10.

Kjo Ligjë hynë në fuqi 15 dit prej datë së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 11.

Ministrija e Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi shitjen e Pasunive të patundëshme Shtetnore, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 212/I datë 17-IV-1934, të Kryesis së Tij.

Tiranë, me 23 Maj 1934. ZOG

Kryeministri — P. EVANGJELI

Ministri i Financavet — A. DIBRA

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
1	Vlonë	Martiraj	gorisht	Dyqan	gjith			Çmimi total i pesë copave asht fr. ari 518	D. T. Shtëpia e Abdurah. Shashkës, Majtas Shtëpia e të zotit, prapa shtëpia Hysen Shaskës para udha	Regjistrimi i transkriptimeve nga dhjetar Karafil Arapi	Volum Nr. 1 D. 1931 në Nr. 32
2	»	»	»	Haur	»				D. M. p. udha, prapa ara e Lelo Kapos	»	»
3	»	»	Dahije	Arë	1|4		24	518	L. J. udha, p. ara e Çeço Shuaipit, v. ara e Sehit Merxhanit	»	»
4	»	»	Qisha	»	1|3		6		L. kullat e të zotit, p. Nexhmije Mela, v. ara e të zotit, j. ara e Ismail Sulos	»	»
5	»	»	Zerla	Vneshtë	gjith		1		L. J. Çeço Shuhaipi, p. prroj, v. ullitë e të zotët	»	»
6	»	Tragjas	Lugu i Kaminave	Arë	gjith		12	1224 asht çmimi total prej Nr. 6 deri 11	L. ara e Hasan Selimit, v. Sherif Hasani, p. Sinan Ahmet, j. tokat e të zot	Nga Dhjetari i katundit Tragjas Z. Murat Tahirit	Regjistri i Transkriptimeve Volum Nr. 1 D. 1931 në Nr. 33
7	»	»	»	»	gjith		22		L. ara e Hasan Badas, Ali Çaushit, v. ara e të zot, p. Hasan Memishahu, j. kullota e të zot	»	»
8	»	»	»	kullota	gjith		350		L. bregu i qumbucarit, v. ara e të zotit, p Mane Xhaferi, j. tokat e Jakup Lahos	»	»
9	»	»	Kula	300 R. Valnidha	gjith		10		L. Liro Tiça, v. Muhamed Shabani, p. udha, j. arat e Serjan Aliut.	»	»

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
10	Vlonë	Tragjas	Reza e Çiraku	kullotje	gjith		1200		L. Mali, v. toka e Mete Aliut p. Gryka e Izvorit e toka e Bejo Selmanit, j. ara e Mehmet Sulejmanit	Nga dhjetari i katundit Tragjas, Z. Murat Tahirit	Regjistri i Transkriptimevn volum Nr. 1 D. 1931 në Nr. 33
11	»	»	proji i Huxhës	364 R. Valengjith	gjith		30		L. Valengjithat e Abdi Zenelit, v Valengj. e Ismail Hajredinit, j. Lumi i Izvorit, p. Valen. e Selim Marës	»	»
12	»	Ramicë	proji senkas	arë	5 15		25	1839 Asht çmimi total prej Nr. 12 deri në Nr. 17	L. Bregu, p. proji Shaskos, v. Hakan Myftari e Meçan Nurçe, j. tokat e Ibrahim Selfos e Shuhaip Koçiut	Nga dhjeta- i katundit Bremen, z. Zata Rakip	Regjistri i Transkriptimeve volum Nr. 1 D. 1931 në Nr. 34
13	»	»	Vreshtat	»	5|15		80		L. udha private, p. Haredin Meta e Lame Bejdo, j. udha private, v. udha	»	»
14	»	»	gjeshtsa	»	5|15		22		L. P. i zoti, j. udha private, v. bregu e udha private	»	»
15	»	»	Kurlo-perçi	»	5|15		25		Nga të katër anët i zoti	»	»
16	»	»	Qafa e malit	»	5|15		35		L. Isa Mustafa e Çize Muharremi, v. p. j. tokat e të zotit	»	»
17	»	»	»	»	5|15		40		Nga të katër anët i zoti	»	»

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M2	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
18	Vlonë	Tragjas	Qafa e udhës Dukat	arë	1|2		65	7,307 Asht çmimi total prej Nr. 18 deri Nr 30	L. proji i bardhë v. Miftar Sula, p. i zoti, j. proji i bardhë	Nga dhjetari i vjetit 1925 të katundeve Nartë Mifal z. Tahir Hoxha	Regjistri transkriptimeve volum 1 v. 1931 në Nr. 35
19	»	»	»	»	1|2		95		L. i zoti v. Miftar Sulo, p. Zeqir Hasani, j. Hasan Habili	»	»
20	»	»	Fusha e Duk. ktiut	»	1|2		295		L. i zoti, v. ujët e Izvorit, p. Halim Mehmeti e Ibrahim Ahmeti, j. Hasan Isufi e i zoti	»	»
21	»	»			1|2		48		L. Hasan Isufi v. i zoti, p. proji i bardhë j. tokat e Ali Metos	»	»
22	»	»	Fole	»	1|2		70		L. v. ujët e Izvorit, p. i zoti j. Halim Mehmeti e Ramadan Zejneli	»	»
23	»	»	»	»	1|2		12		L. Halim Mehmeti, v. p. i zoti, j. Elmas Rakipi	»	»
24	»	»	»	»	1|2		12		L. Ymer Mehmeti, v. Selim Hodua, p. Meto Hasani, j. Sulo Aliu	»	»
25	»	»	bregu i gurit	Kullotje me 115 R Valangjish	1|2		20		L. maje malit, v. Abdyl Hadua, p. Miftar Kapua, j. Xhezo Iljazi	»	»

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
26	Vlorës	Tragjas	skele e çirakut	kullotë	1|2		800		L. Maje e Mahit, v. Murat Tahiri, p. ujt e Izvorit, j. Abdul Hadua	Nga dhjetar i vitit 1925 të katundeve Nartë Mifol, z. Tahir Hoxha.	Regjistri transkriptimeve volumi 1, v. 1931 në Nr. 35
27	»	»	gjeshtra (veçan)	kullotë	1|2		300		L. Habil Mehmeti e Mulla Hamdiu e Mustafa Meto, V. Zejnel e Islam Sulejmani p. Xhafer Selami e Izeir Maça J. kullotë e Ahmet Imerit e Cane Selamit	»	»
28	»	»	»	kull. 230 R. valengj.	1|2		20		L.v.p. i zoti J. udha	»	»
29	»	»	proji i Hoxhës	kull. 1148 R. valengj.	1|2		10		L. Abdul Traqeja, v Murat Tahiri, p. Hasan Selimi J. Zejnel Martirajtë	»	»
30	»	Dukat	Luklura	kullotje	gjith		750	1500	L. Dervish Selmani v. Cane Miftari, J. Deti, p. Ibrahim Zeneli	Nga dhjetar i vitit 1926 të katundit Pishë z. Myslim Hadoja	Regjis. Vol. I i traeskrip. d. 1931 në Nr. 36
31	»	Kocul	drizat e gorishtit	arë	1|3		8	1879	L. Dine Mahili, p. prroji, v. udha J. Ymer Hamiti	Nga dhjetar i katundit Kocul z. Ferhat Shasko	Regjis. Vol. I i transkrip. d. 1931 në Nr. 37
32	»	»	mertiraj	shtëpi	1|3			Asht çmimi total prej Nr. 32 deri në Nr. 45	D.p. udha, M. Mb. shtëpia e Karafil Arapit.	»	»
33	»	Treblovë	topallti	arë	1|3		23		Nga të katër anët kullota e të zotit.	»	»
34	»	»	»	kullotë	1|3		450		L. udha, p. Qaf. e Shesheve, v. proji Ahmet Dervishi, J. proji	»	»
	»	»	»	arë	1|3		25		Nga të katër anët kullota e të zotir	»	»

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M²	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
36	Vlorës	Treblov	Razaki	Arë	1|3		8		L. proji, p. i zoti J. p.v. Sherif Cane	Nga dhjetari i katundit Kocul, z. F. Shasko	Regjis. Vol. I, i transkriptimeve d. 1931 Nr. 37.
37	»	»	»	»	1|3		37		L. i zoti, p. prroji i Haxhi Maliqi, J.v. ara e Sherif Canes	»	»
38	»	»	gjashtra	»	1|3		15		L i zoti, p. prroji, j. ara e Haxhi Maliqit, v. ara Sherif Canes	»	»
39	»	»	shukë	»	1|3		15		L. prroj, p. Nexhip Zagolli, j. prroji, v. arat e të zotit	»	»
40	»	»	»	kullotë	1|3		35		L. prroji, Nexhip Zagolli, j. i zoti, v. prroji	»	»
41	»	»	Veterik	»	1|3		450		L. Teli Musaj, p. Hajredin Danushi, j. udha, v. prroji.	»	»
42	»	»	»	arë	1|3		150		Nga të katër anët i zoti	»	»
43	»	»	»	»	1|3		35		»	»	»
44	»	»	»	Mulli mielli	1|3		—		D. i zoti, M. Man Aliu, Mb. vija e ujit, p. udha.	»	»
45	»	Gërnicë	Çesma	arë	gjith		20		L. Kufi i gorishtit, J. v. i zoti, p. udha	Nga dhjetari i katundit Koçul Sadik Shaska	Regjis. Vol. I, i transkriptimeve d. 1931 Nr. 38.
46	»	»	»	»	gjith		8	3648-30 Asht çmimi total prej Nr. 46 deri në Nr 59.	L. Kufi i gorishtit, J.v. udha i e proji, p. i zoti	»	»
47	»	»	»	»	gjith		30		L.V. Kufi i gorishtit e udha, p. Hodo Musaj, J. arat e Nurçe Kaposi	»	»

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja		Çmimi	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
						M2	Dynym	Fr. ar			
48	Vlonë	Gërnicë	Çesma	arë	gjith		20		L. pylli, p. j i zoti, v. prroji	Nga dhjetari i katundit Kocul, Sadik Abdurahman Shaskua	Regjistri transkriptimeve volum 1 v. 1931 në Nr. 38
49	»	»	»	»	gjith		10		L. Kufi i gorishtit, p. j. i zoti, v. Abdurahman Shaskus	»	»
50	»	»	Shule	»	gjith		20		L. Hodo Musaj, p. j. i v. Abdurahman Shaskos	»	»
51	»	»	»	»	gjith		35		»	»	»
52	»	»	hije	»	gjith		55		L. j. v. i zoti, p. shtëpia e Rapush Zenelit	»	»
53	»	Kaninë	Vreshtat e mëdha	Boçe 2 R. ullij	gjith		4		L. ullijt e Malo Yzeirit j. ullit e Amet Arapit, p. udha v. ullit e Fetah Agait	Nga dhjetari Sulo Muhameti nga Kanina	Rregjistri transkriptimeve volum 1 v. 1931 në Nr. 39
54	»	»	Kaninë	arë	1|3		35	1968	L. i zoti e Ali Metushi, v. j. i zoti, p. Lako e Muhamed Ramadani	Nga dhjetari Asim Kokoshi nga Vlora	Regjistri transkriptimeve volum 1 v. 1931 në Nr. 40
55	»	»	anë	»	1|3		12	Asht çmimi total prej Nr. 55 deri Nr 57	L. ullit e Tafil Asllanit e Neim Binas, v. toka e Metush Ismailit, p. Vreshta j. toka e Melush Ismailit	»	»
56	»	»	ara e detit	»	1|3		30		L. ullit e Takulla Binase i zoti, j. toka e Metush Ismailit, v. i zoti e Mehmet Ramadani p. Rrereshtme	»	»

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M	Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
57	Vlonë	Manicë	Feshat	Baçe 7 ullij	gjith		—	2.600	Mbrenda n'arën e Dervish Agas	Nga dhjetari Resui Sadiku nga katundi Amanicë	Regjistri i transkriptimeve volum 1 v. 1931 në Nr. 41
58	»	»	»	arë	»		10	Asht çmimi total prej Nr. 58 deri në Nr. 87	Dy anë udha, nji anë Dervishi, nji anë Ahmeti	»	»
59	»	»	Mentanë	Baçe 1 ullij	»		—		Mbrenda n'arën e Izehir Çelos	»	»
60	»	»	»	arë	»		7		Në nji anë Osmani në nji Yzeiri e në nji anë udha	»	»
61	»	»	»	»	»		3		Në nji anë shtëpia e tij, në nji anë Elmazi në dy anë Abdi Sula	»	»
62	»	»	Mando	Baçe 12 ullij	»		—		Mbrenda në vëneshtën e tij	»	»
63	»	»	Feshat	Baçe 2 ullij	»		—		Mbrenda në Baçen e Elmas Hajredinit	»	»
64	»	»	Dushkë	arë pa punue	»		650		L. prrua, p. udha, v. i zoti, j. toka e Osmanit	»	»
65	»	»	»	arë	»		60		L. prrua, në tre anë i zoti	»	»
66	»	»	»	»	»		60		»	»	»
67	»	»	»	Orman	»		320		L. prrua, p. v. i zoti j. Kahramani	»	»
68	»	»	»	Kullotë	»		136		L. p. i zoti, v. Ymer Metushi j. udha	»	»
69	»	»	»	arë	»		45		Nga të katër anët i zoti	»	»

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
70	Vlonë	Amanicë	Dushkë	arë	gjith		17		L. prrua, p. Ymer, v. j. Selimi	Nga dhjetari Resul Sadiku nga Amanica	Reglistri i transkriptimeve volum 1 d. 1931 në Nr. 41
71	»	»	Qikushta	»	gjith		185		L. p. i zoti, j. v. Tahiri Averi	»	»
72	»	»	»	Korije	gjith		30		L. p. i zoti j. v. Tahir Averi	»	»
73	»	»	»	»	gjith		35		L. i zoti, p. v. Bino Muço j. Osmani	»	»
74	»	Shkozë	Hode e buzë	Këshilla	2|3		85		L. Ali Dervishi, p. i zoti, v. j. peroj, Hundë e Buzë	Nga dhjetari i katundit Hysoverdhe, Idriz Mevlan Aliko	Regjistri i transkriptimeve volum 1 v. 1931 në Nr. 91
75	»	»	»	»	2|3		300		L. prrua, p. i zoti; v. Dervish Zeneli j. udha	»	»
76	»	»	»	arë	2|3		10		L. Mustafa Dervishi p. udha, v. prroji j. udha	»	»
77	»	»	»	»	2|3		50		L. Mustafa Dervishi. p. prrua, v. Abas Bilbili j. Rustemi	»	»
78	»	Mavrovë	Brusnjë	»	1|2		300	950	L. prroji i Kabasit p. Murat Hysa, v. Telo Xhelal, j. prroji Brashjet	Nga dhjetar Shaqo Emini nga Smokthina	Regjistri i transkriptimeve volum 1 v. 1931 në Nr. 92
79	»	»	»	»	1|2		200	Asht çmimi total prej Nr. 79 deri në Nr. 83	L. p. prrua, v. Murat Hysa, j. prrua	»	»
80	»	»	»	»	1|2		70		L. Telha Jaho, p. i zoti v. Xhelal Fire, j. prroji i Brusnjes	»	»
81	Shkodër	Tepe Ajasem	Fusha Bostan	tokë buke	gjith		200		Kodrat e Tepes e lagjeja Apsem, Kiri Kiri Kiri	Simbas vendimit gjyqit Diktimit Nr. 203 d. 12-IX-32	

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja M	Sypërfaqja Dynym	Çmimi Fr. ar	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
82	Shkodër	Dajçi	Djerrat	tokë buke	gjith		120		Rruga e Dukave, Mali Dukaj Tokat e Kat. Dajçi	Këto toka kanë qenë hali e në kohën e Qeverimit Austro-Ungar, kanë qenë çilë nga personat e ndryshëm me urdhnin e qeveris. Në vjetin 921-22 e këndej ja' në punue nga banorët e Dajçit tui i pague Shtetit të tretën	
83	Lushnje	Qytet		tokë për ndërtim	gjith		1	167	L. Ismail Ahmet, p. rruga v. Tafil Bajrami j. rruga e Fros. ka	Toka të Shtetit të dhanun me qira vjetore për ndërtime	
84	»	»		»			1|2	100	L. Mali e Vores; p. Hajdar Kruja, v. rruga Malit j. Abedin Sali	Toka e Shtetit të dhanuna me qira vjetore për ndërtime	
85	»	»		»			2	100	L. Hysen Islam, p. Tefik Miftari, v. vllazën Vokopola, j. rruga malit	»	
86	»	»		»			1	134	L. mali e vorez, p. rruga v. Mirteza Limani, j. Qani Hasani	»	
87	»	»		»			1	134	L. Qani Hasan, p. Tafil Hajdari, v. Sheget, p. Shteti, j. prroj	»	
88	»	»		»			2	200	L. Rexhep Ali, p. Shteti v. Koresh e Vokopoj, j. rruga e malit	»	
89	»	»		»			2	100	L. Ismail Ahmet, p. rruga v. Han Kruja j. Abdyl Ruli	»	

BKSH

Nr. rend.	Prefektura ose Nënpref.	Katundi ose Lagja	Vëndi (pozicjoni)	Lloji	Sa pjesë ka Shteti	Sypërfaqja		Çmimi	KUFIJT	Rrjedhja e pronësis së Shtetit	Vrejtje
						M	Dynym	Fr. ar			
90	Lushnje	Qytet		Tokë për ndërtím			1	67	L. ullit e Din Kukës, p. Qerim Kavaja, v. Vokopola j. rruga malit	Toka të shtetit të dhanuna për ndërtim me qira vjetore	
91	»	»		»			3|4	50	L. rrugica, p. Qani Hasani, v. Et-hem Limani j. mali vorezë	»	
92	»	»		»			1	50	L. Cen Sufta, p. rruga, rruga malit	»	
93	»	»		»			1 1|2	50	L. Xhemal Kuka, p. procka e Brahim v. Brahim Demiri, j. procka	»	
94	»	»		»			1	134	L. Brahim Voreza, p. rruga procka, v. Abedin Sali, j. procka	»	
95	Tiranë	Sauk	Bahçe	Tokë e ndame			7	500	L. Selim Pash Toptani, v. pasuni shteti p. pusuni shteti j. Selim Pash Toptani	Prej konfiskimit të pasunis së Esat Topt.	Me mënyrë shkëmbimi me zonjën Qanije e bija e Selim Pashë Topt,

BKSH

Nr. 106.

DEKRET-LIGJË, 24 Korrik 1934.

Mbi të drejtën e Bashkis së Durrësit për marrjen e 10 (dhetë) qind. ari nga çdo kilowat dritë private në Durrës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Gusht 1934, Nr. 44)

Neni 1.

Autorizohet Bashkija e Durrësit me marrë 10 qind. ari për çdo kilowat drite elektriku të konsumueme prej privatve mbrenda juridiksionit të konçesionit, tue u respektue neni 108 i Ligjës së Bashkive.

Kjo taksë nxiret prej Shoqniës konçesjonare, së bashku me çmimin e kilowatteve të shitun privatve dhe, do t'i dorëzohet Bashkis në fund të çdo mueji, si mbas arktimeve të bame prej kësaj.

Neni 2.

Ministri i P. të Mbrendshme ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Neni 3.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 978 datë 20-VII-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 18-VII-1934,

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi të drejten e Bashkis së Durrësit për marrjen e 10 (dhetë) qind. ari nga çdo kilowatt dritë private në Durrës.

Tiranë, me 24 Korrik 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

BKSH

Nr. 107.

DEKRET-LIGJË, 24 Korrik 1934.

Mbi unifikimin dhe zbritjen e interesës së Huanave t'akordueme nga ish Arka e Pensioneve Bashkis së Kryeqytetit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Gusht 1934, Nr. 44)

Art. 1.

Ministria e Financavet autorizohet me unifikue Huanat e akordueme nder kohna dhe me kontrata të ndryshme, Bashkis Kryeqytetit nga ish Arka e Pensioneve Civile dhe zbritjen e interesës së tyne në 4%.

Art. 2.

Akti Noterial dhe veprimet e tjera q'i përkasin çashtjes, objekt i kësaj Dekret-Ligje, perjashtohen nga çdo taks shtetnore.

Art. 3.

Afati i pagesës të Huanave në fjalë caktohet në 15 vjet qysh nga data e hymjes në fuqi të kësaj Dekret-Ligje. Konditat e tjera janë po ato qi kanë qenë caktue në kontratat dhe vendimet e para.

Art. 4.

Ministri i Financavet dhe aj i P. të Mbrendshme, ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje, e cila hynë në fuqi qysh prej datës së shpalljes së saj në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1013/I dt. 24-8-934 të Kryeministriës.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 23-VII-1934,

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi unifikimin dhe zbritjen e interesës të Huanave të akordueme nga ish Arka e Pensioneve Bashkiës Kryeqytetit.

Tiranë, me 24 Korrik 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme MUSA JUKA

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 108

DEKRET-LIGJË, 3 Korrik 1934.

Mbi shtimin e ndryshimin e disa dispozitave në Ligjën mbi Organizimin Noterial

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 11 Gusht 1934, Nr. 46)

Neni 1.

Pargrafit të parë të nenit 3 të Ligjës mbi Organizimin Noterjal i shtohet paragrafi që vijon:

«Pranë Gjykatës së Shk. së I. të Tiranës mund t'emnohen deri në pesë Notera, por kur ndodhen në shërbim efektiv së paku tre Notera, nuk emnohen të tjerë pa u çfaqun nevoja prej Këshillit të Drejtësis, e aprovueme dhe me vendim të Këshillit t'Epërmë Gjyqsuer.

Neni 2.

Numri 6 i nenit 6 të Ligjës mbi Organizimin Noterjal modifikohet si vijon:

Noterët-Publik që do t'emnohen pranë Gjykatave të Shk. së I. Tiranë, Shkodër, Berat, Elbasan, Korçë, Gjinokastër dhe Vlonë dhe, pranë Gjykatës së Paqit të Durrësit duhet të jenë të diplomuem prej Fakultetit të Drejtësis; në vendet tjera, kur nuk paraqiten kanditatë të diplomuem, mund t'emnohen ata që kanë fitue provimin.

Të pa-diplomuemit prej Fakultetit të Drejtësis që kanë ushtrue detyrë gjyqtari ose ndihmësi për një kohë jo ma pak se tre vjet mbas hymjes në fuqi të Ligjës mbi Organizimin e Drejtësis me datë 19 Mars 1929, mund t'emnohen pa provim Noterë-Publik pranë Gjykatave të Paqit mbi propozimin e Ministris së Drejtësis dhe pas një vendimi favorabël të Këshilit t'Epërm Gjyqsuer.

Neni 3.

Nenit 80 të Ligjës mbi Organizimin Noterjal i shtohet paragrafi që vijon:

Noterët detyrohen të shenojnë në dëftesën që u dorëzojnë t'interesuemve hollësisht dhe në të dy pjesët e dublikatës shumat e marruna.

Noteri që nuk i lëshon dëftesë ose nuk konformohet me dispozitat e paragrafit të sipërmë, ndeshkohet disiplinisht me 20 deri 200 fr. ari gjobë të lehtë.

Neni 4.

Neni 83 i Ligjës mbi Organizimin Noterjal modifikohet si vijon:

Noteri që merr kundrejtë shperblimit, të drejtave aksesore dhe shpenzimeve një shumë ma të madhe se ajo që asht caktue ligjërisht, ndëshkohet disiplinisht posë kur eksiston lajthim i ndjesëshëm, me pesë fishin e shumës së marrun ma tepër, por jo ma pak se 50 dhe jo ma tepër se 500 fr. ari.

Gjithashtu po me ndëshkimet e paragrafit të sipërmë ndëshkohet edhe Noteri që mer ma pak taksa se ato të caktueme me Ligjë.

Ndëshkimet e parashikueme prej këtij neni, aplikohen pamvarësisht nga ndëshkimet e tjera penale që pas-sjellë vepra.

Neni 5.

Noterët detyrohen mbrenda pesë ditëve të para të ç'do mueji të derdhin n'arkën e financës t'ardhunat e muejit të kaluem. Noterët që nuk respektojnë kët afat, posë konsekuencavet të tjera penale, kur ka vend, ndeshkohen disiplinisht me gjobë të lehtë nga 50 deri në 200 fr. ari.

Neni 6.

Kur Noteri ndëshkohet disiplinisht në bazë të neneve 4 e 5 të kësaj Dekret-Ligjë, si dhe në bazë të nenit 105 të Ligjës mbi Organizimin Noterjal, posë kur ndëshkimi në bazë të këtij neni shkakton heqjen e Noterit nga puna, mund të deklarohet i transferueshëm.

I transferueshëm gjithashtu mund të deklarohet edhe Noteri që ndëshkohet disiplinisht në bazë të Ligjës mbi Organizimin Noterjal mbrenda vjetit dy herë me qortim dhe gjobë të lehtë, ose dy herë me njanin nga këto ndëshkime.

Noteri që ndëshkohet disiplinisht me pezullim, deklarohet i tranferueshëm.

Neni 7.

Noterët të dënuem me pezullim në bazë të Ligjës mbi Organizimin Noterial, ose të kësaj Ligje, në qoftë se brenda dy vjetve bajnë ndonji nga fajet e ndëshkueshme simbas këtyne ligjve pos atyne qi pas-sjellin ndeshkimin e verejtjes; dënohen me pezullim deri në nji vjet, por jo mâ pak se nji muej, ose pushohen.

Neni 8.

Paragrafi i dytë i nenit 108 të Ligjës mbi Organizimin Noterjal, abrogohet.

Neni 9.

Ndëshkimet disiplinore të vrejtjes, të qortimit, të gjobës së lehtë si dhe ndëshkimet e parashikueme prej neneve 3, 4 e 5 të kësaj Dekret-Ligjë, aplikohen prej Këshillit të Drejtësis i cili vendosë i mbledhun në këshillë.

Prokurori i komunikon Noterit akuzen, i cili detyrohet mbrenda pesë ditëve ç'prej datës së komuikimit t'i parashtrojë Këshillit mbrojtimet e veta.

Vendimet e Këshillit të Drejtësis i komunikohen Ministris së Drejtësis dhe Noterit.

Ministri kur nuk e shef të justifikuem vendimin e Këshillit ose, kur i interesuemi nuk i bindet atij vendimi, kanë të drejtë me e kundërshtue përpara Këshillit të Epërm Gjyqsuer, i cili vendosë definitivisht.

Afati i rekurimit asht 10 ditë.

Neni 10.

Kur Këshilli i Drejtësis ose Gjykata deklaron të transferueshëm një nga Noterët-Publik të diplomuem të qyteteve të përmendun në nenin 2 të kësaj Dekret-Ligjë, Ministrija e Drejtësis mbassi të marri edhe mendimin e Këshillit të Eperm Gjyqsuer, proponon transferimin në një nga qytetet e shenuem në nenin e nalipermedun, dhe kur Noteri asht i pa diplomuem, proponimi bahet për në një nga qytetet e tjerë ku ka ose mund të funksionojë zyrë noteriale.

Neni 11.

Neni 2 i Ligjës me datë 12-XII-1929 modifikohet në kët mënyrë:

Nga të gjitha shpërblimet ose të drejtat aksesore që i takojnë Noterëve-Publik, një pjesë kthehet në taksë simbas rregullave të caktueme ma poshtë:

Kur shuma muejore e t'ardhunave nga shperblimet e të drejtat aksesore pa asnjë përjashtim kalon të 200 fr. ari; por jo të 500 fr. ari, t'ardhuna të pa dliruеme (brutto), mbi çka kalon të 200 fr. ari merret taksë 15% dhe për çka kalon të 500 fr. ari 25%.

Neni 12.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi qyshë ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 13.

Ministrija e Drejtësis ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 943/I dt- 27-7-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 19-7-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi shtimin e ndryshimin e disa dipsozitave në ligjën mbi Organizimin Noterial.

Durrës, më 3 Korik 934.

ZOG

Kryeministri	*Ministri i Drejtësis*
P. EVANGJELI	V. AVRAMI

Nr. 109.

DEKRET-LIGJE, 30 Korrik 1934.

Mbi modifikimin e Ligjevet për rrogat jetike e shpërblimet për merita patriotike

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 11 Gusht 1934, Nr. 46)

Neni 1.

U paguhen rroga jetike vetëm personavet dhe familjeve të poshtë-shenueme në sasina të caktueme për sejcilin në këtë Dekret-Ligjë:

Emni e mbiemni	Rroga pjesore muejore Fr. ari	Rroga muejore Fr. ari
TIRANË		
Familja e Hoxha Kadris :		
Fatime, e shoqja	80	
Merjeme e bija	50	
Ali, i biri	50	180.—

Familja e Sadik Gostivarit :		
Fatime e shoqja	60	
Qazimi, djali	40	100.—
Familja e Sulejman Luzatit :		
Sabiha e shoqja	60	
Hedije e bija	35	
Nimet e bija	35	
Seadet e bija	35	
Ikbale e bija	35	200.—
Familja e Halim Derallës :		
Kadrije e shoqja	80	
Emine e bija	50	
Meleqe e bija	50	180.—
Familja e Halim Gostivarit :		
Gjylja e shoqja	45	
Skënderi i biri	25	
Manushi i biri	25	
Mid-hati i biri	25	120.—
Familja e Hajdar Hidit :		
Hava e shoqja	25	
Sabrije e bija	15	40.—
Familja e Sylejman Delvinës :		
Zyhra e shoqja	150	
Dilaviz e bija	90	240.—
Familja e Dervish Himës :		
Zejnepe e shoqja	150	
Afërdita e bija	90	240.—
Familja e Vasil Rusit :		
Marija e shoqja	30	
Ana e bija	15	
Lika e bija	15	60.—

BKSH

Familja e Namik Delvinës :		
Zemire e shoqja	80	
Mervet e bija	60	
Astrit i biri	60	200.—
Familja e Qamil Balës :		
Remzije e shoqja	70	
Tomori i biri	40	
Nimet e bija	40	150.—
Familja e Hil Mosit :		
Vitoria e shoqja	40	
Marija e bija	20	
Filja e bija	20	
Ana e bija	20	
Rina e bija	20	
Gjylja e bija	20	140.—
Familja e Mark Kapidanit :		
Gjystina e ama	30	
Roza e shoqja	60	
Gjystina e bija	30	
Marku i biri	30	150.—
Ismail Strazimiri		100.—
E veja Sotir Ollanit		40.—
Aliu i biri Abdyl Ypit		140.—
E veja e Mahmut Pilkut		80.—
Xhevrije e shoqja e Kamber Dishnicës		60.—
Hafiz Ibrahim Dalliu		150.—
Nazmije e Sabri Dibrës		80.—
Stefan Postenani		60.—
Vehbi Dibra		450.—
Hafiz Ali Korça		320.—
Dr. Rifat Frashëri		350.—
Dhimiter Ilo		200.—
Myhtar Axhani		80.—
Xhemal Prishitna		180.—
Hamdi Ohri		250.—
Myvedet e bija e Ismail Qemal Vlonës		100.—

KORÇË

Familja e Sotir Pecit :

Antigoni e shoqja	90	
Luize e bija	40	
Jani i biri	40	
Gaqi i biri	40	
Koço i biri	40	250.—

Familja e Dr. Haki Mborjes :

Mahmudije e ama	20	
Salushe e shoqja	80	
Skënderi i biri	30	
Drita e bija	30	
Lirija e bija	30	
Petriti i biri	30	
Shpresa e bija	30	250.—

Evdhoksija e shoqja e Themistokli Germenit	120.—
Eshoqja e angjel Gjika	40.—
Fetije e shoqja e Sh. Frashërit	50.—
Polikseni e shoqja e Nuçi Naçit	70.—
Donika Konstanca e bija e Pandeli Calit	120.—
Mynire e shoqja e Qani Dishnicës	150.—
Nikçe e shoqja e Mihal Gramenos	120.—
E veja e Osman Eminit	60.—
E veja e Dhimitri Malës	60.—
Cile Krastafilaku	40.—
Filona e veja e Spiro Naçit	80.—

POGRADEC

E veja Papakristo Negovanit	60.—

ERSEKË

Hasan Qinami	80.—
E veja e Vefik Leskovikut	50.—
Asllan Mehmet Starja	50.—

ELBASAN

Kleopatra e bija e Kristo Foridhit	100.—
Fejzulla Buranjaku	80.—

BKSH

SHKODER

Luçie e veja e Prenk Bib Dodës		120.—
E shoqja e Zef Shantojës		80.—
Prenda e ama e Nikoll Frrokut		40.—
Zoja Nore e shoqja e djalit të Ded Gjo Lulit		80.—
Dani i Simon Harapit		100.—

GJINOKASTER

Familja e Petro Haritos :		
Evanthija e bija	55	
Anastasija e bija	55	
Angalaja e bija	55	165.—
Zoja e Çerçis Topullit		120.—

DELVINË

Hafize e shoqja e Mehdi Borshit	30	
Xhije e bija e Mehdi Borshit	20	50.—
Aishja e Isa Borshit		60.—
Familja e Sheh Sabri Prevezës :		
Hajrije e shoqja	60	
Rahmi Habib i vllai (invalid)	40	100.—
Vesel Naili		200.—

TEPELENË

Familja e Selman Musas :		
Feliha e shoqja	60	
Çarçani i vëllai (i çmendur)	30	
Safe Dule e kunata	30	120.—

VLONË

Familja e Dr. Telha Hilmiut :		
Hyrije e shoqia	30	
Paqe e bija	12.50	
Merushe e bija	12.50	
Ballkeze e bija	12.50	
Mizerete e bija	12.50	80.—
Qerime Turhan Pasha (e shoqja)		200.—
Fatime e bija e Turhan Pashës		200.—

BKSH

Familja e Ibrahim Gjindit :

Mynever, e shoqja	60	
Mediha e bija	30	
Skënderi i biri	30	120.—

BERAT

Familja e Milto Tutulanit :

Kristina e shoqja	25	
Kristaqi i biri	15	
Efigjeni e bija	15	
Margarita e bija	15	
Dhimitri i biri	15	
Afërdita e bija	15	100.—

FIERI

Familja e Irfan Baçit :

Pembe e shoqja	30	
Tako i biri	12.50	
Manushaqe e bija	12.50	
Aferdita e bija	12.50	
Luani i biri	12.50	80.—
Shuma e Përgj.		8.460.—

Neni 2.

Rrogat jetike nuk janë të trashigueme.

Femnat qi martohen dhe mashkujt qi mbushin moshen 21 vjetësh, humbasin të drejtën e rrogës jetike dhe pjesa e tyne kalon në favorin e Arkës së Shtetit. Djelmëvet qi janë në studim e sipër, u vazhdon rroga deri në mbarimin e studimeve, por jo mbas moshës së 25 vjetëvet. Por kuer Kryetarja e familjes humbë të drejten e rrogës jetike, 50% të rrogës së sajë ndahet nder pjestarët e tjerë, në se ka, dhe pjesa tjetër shkon në favorin e Arkës së Shtetit.

Neni 3.

Zbritjet e caktueme në nenin 5 e 8 të Ligjës së budgetit t'ushtrimit financjar 1934-35, tue fillue prej ditës së hyemjes në fuqi të kësaj Dekret-ligje, nuk zbatohen per sa u përket rrogave jetike. Rrogat në fjalë i shtrohen vetëm nji ndaljeje prej 6% (gjashtë perqindë).

BKSH

Neni 4.

Të gjitha Ligjët qi flasin per rroga jetike e shpërblime për merita patriotike, abrogohen.

Neni 5.

Kjo Dekret-Ligjë zbatohet qysh prej datës 1 Qershuer 1934.

Neni 6.

Ministri i Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamë me shkresën Nr. 140-32 dt. 7-7-1934 të Kryeministris,

Si studjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 3-VII-1934,

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi modifikimin e Ligjëve për rroga jetike e shperblimet per merita patriotike.

Durrës, me 30 Korrik 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 110.

DEKRET-LIGJE, 7 Gusht 1934.

Për krijimin e Këshillit Ekonomik të Shtetit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Gusht 1934, Nr. 47)

Neni 1.

Krijohet nji Këshill Ekonomik pranë Ministris s'Ekonomis Kombëtare per me sherbye si organ, per me caktue drejtimet themelore të politikës ekonomike të Shtetit, edhe për me sigurue vazhdimin e pa nderprem dhe, me armonizue veprimet Qeveritare rreth zhvillimit dhe përmirësimit ekonomik të vendit.

Neni 2.

Këshilli Ekonomik mvaret prej Kryeministrit dhe punon nen Kryesin e Ministrit t'Ekonomis Kombëtare; në mungesën e këtij prej njanit nga Antarët e tjerë të Kabinetit.

Kryeministri kurdoherë qi të dojë me marrë pjesë në Mbledhjet e Këshillit, të cilin në këtë rast e Kryeson me votë deliberative.

Neni 3.

Këshilli Ekonomik formohet me antar të përhershëm (ex lege) dhe të zgjedhun.

Antarët e përhershëm janë: Ministri i Ekonomis Kombëtare si Kryetar, Ministri i Financavet ose përfaqësuesi tij, përfaqësuesi i Ministrit të Jashtëm, Shef' i Zyrës së Tregtis së Jashtme, Delegat' i Dhomavet Tregtare, i cili zgjidhet midis tre personave të proponuem prej Ministris s'Ekonomis Kombëtare, Komisar' i Qeveris pranë Bankës Kombëtare.

Antarët e zgjedhun do të jenë 5 (pesë) persona të pajuem me aftësi ekonomike dhe me eksperiencë. të cilët propozohen prej Këshillit Ministruer, dhe emnohen me Dekret-Mbretnuer. Këta zgjidhen midis Parlamentarëve, nepunsave të naltë ose midis tregtarëve dhe industrialëve të njoftun në vend.

Për sejcilin antar ka me u-lyp nji kompetencë e mjaftueshme në një nga degat e Ekonomis; Bujqësi, Blegtori, Industri, Tregti ose Financë.

Antarët e zgjedhun emnohen për dy vjet dhe janë të rizgjedhun me Vendim të Këshillit Ministruer.

Neni 4

Përveç antarve të treguem në nenin 3, në mbledhjet e Këshillit Ekonomik mund të marri pjesë me vota Këshilluese, çdo person kompetent i pranuem prej Kryetarit të Këshillit si ekspert për çeshtjen qi ka me u bisedue.

Neni 5.

Këshilli Ekonomik:

a) studjon dhe propozon drejtimet e përgjithshme të politikës ekonomike të Shtetit;

b) harton dhe propozon Projekt-Ligjë me karakter ekonomik ose financjar, tue, marrë parasysh nevojat ekonomike dhe financjar të vëndit;

c) shqyrton dhe çfaq mendimin e vet mbi çdo projekt me natyrë ekonomike ose financjare qi ka me i-u referue prej Qeveris;

d) çfaq mendimin udhëheqës për çdo marrëveshtje tregtare;

e) vezhgon veprimet e Zyrës së Tregtis së Jashtme dhe, çfaq mendimin e vet mbi çdo masë të adoptueme prej kësaj.

BKSH

Neni 6.

Këshilli Ekonomik mblidhet kurdoherë qi grishet prej Kryetarit; mbledhja asht e vlefshme kur ndodhen gati shumica e antarve dhe kryetari ose përfaqësuesi i tij.

Antarët e Këshillit përmbushin detyrën e tyne pa ndonji shpërblim. Antarët e emnuem qi mungojnë tri herë resht pa shkaqe të justifikueme, quhen dorëheqës.

Neni 7.

Këshilli Ekonomik bisedon vetëm çeshtjet e shenueme në rendin e ditës të pregatitun prej Kryetarit. Çdo propozim i ri qi bahet prej antarve dhe pranohet prej Kryetarit, vehet në rendin e ditës. mbasi të mirret mendimi i Zyrës kompetente, e cila detyrohet me çfaq mendimin e vet me ngutësi.

Neni 8.

Vendimet e Këshillit merren me shumicë votash të çilta dhe, kanë karakter këshilues, në raste që lénë nji divergjencë ndërmjet antarve qeveritar dhe të zgjedhunve, vendos definitivisht Kshilli Ministruer.

Neni 9.

Këshilli Ekonomik ka të drejtë të korespondojë drejt për së drejti me çdo zyrë, letrat nenshkruhen prej Kryetarit ose prej të deleguemit të tij.

Sekretarija e Këshillit i ngarkohet Zyrës së Tregtiës së Jashtme.

Neni 10.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi pesë ditë pas shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Neni 11.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1048-I datë 1-8-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit iMnistruer me datë 28-VII-1934

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi krijimin e Këshillit Ekonomik të Shtetit.

Durrës, me 7 Gusht 1934. ZOG

Kryeministri	*Ministri i Drejtësis*
P. EVANGJELI	V. AVRAMI
Ministri P. të Jashtme	*Ministri i P. Mbrendëshme*
XHAFER VILA	MUSA JUKA
Ministri i Financavet	*Ministri i Arësimit*
A. DIBRA	Dr. MIRASH IVANAJ
Ministri i P. Botore	*Ministri i Ekon. Kombëtare*
S. SARAÇI	D. BERATTI

Nr. 111.

DEKRET-RREGULLORE, 7 Gusht 1934.

Mbi pagesën e pensionevet dhe të shpërblimevet të njiherëshme Civile e Ushtarake që vehen në pension dhe atyne që heqin të drejtat prej këtyne

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Gusht 1934, Nr. 47)

KAPTINA I.

Dispozita të Përgjithëshme

Neni 1.

Pagesa e pensjoneve të nëpunësave civil e ushtarak dhe t'atyne që heqin të drejtat prej këtyne, në konformitet me Ligjen relative me datë 20 Qershuer 1934, bahet si mbas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Pagesa e shpërblimeve të njihershme bahet në formen e zakonëshme të mandat-pagesavet direkte në mveshje të kapitullit «pagesa e pensjonevet Civile e Ushtarake» të gjendjes së parapamjeve të shpenzimeve të Ministris së Financavet.

Neni 2.

Dekretet Mbretnore të daluna ma parë dhe ato që kanë me dalë si mbas paragraf. II të nenit 55 të Ligjës së Pensjoneve me datë 20 Qershuer 1934, relativ me autorizimin e pensjoneve formojnë titull eksklusiv në mbështetje të cillit Ministrija e Financavet.

1. — Çel një parti të veçantë në regjistrat e detës jetore;

2. — lishohen libreza që vlejnë për me marrë kistet muejore të pensjonit;

3. — lëshon një skede llogari-rrjedhëse (kompte kaurrente) për me ja çue Drejtoris së Financavet pranë së cillës gëzuesi i pensjonit dëshiron me marrë shpërblimin e vet.

Neni 3

Regjistrat dhe dokumentat e tregueme në nenin e ma sipërme, duhet të përmbajnë për çdo parti pensjoni:

1. — Emnin dhe mbi emnin e të pensjonuemit dhe t'atyne që gëzojnë të drejtat e tij;

2. — nëpunësinë që i interesuemi kishte n'administratë;

3. — Pensjonin vjetuer të pa dliruem, kestin muejuer të thjeshtë si dhe ndarjet e tjera që rezultojnë nga zbritjet ligjore 6%, si dhe nga ato të jashtë-zakonëshmet.

4. — Fillimin e pensjonit;

5. — Banesen e të pensjonuemit;

6. — Drejtorin financjare pranë së cillës asht çelun partia;

7. — Konditat të cilave u shtrohet pagesa kur pensjoni i takon atij që heq të drejtat prej të pensjonuemit, gjendjen e vejushës të pa-martueme, gjendjen e të mitunit dhe të fëmivet e të tjera (shif nenet 29, 31, 32 dhe 33 të Ligjës).

KAPTINA II.

Dispozita mbi librezat e pensjonit dhe skedat e llogaris rrjedhëse

Neni 4.

Libreza e përmendun në nenin 2 si edhe skeda e llogaris rrjedhëse formojnë dokumenta që vlejnë për pagimin e pensjoneve.

Mungesa e një dokumenti të tillë ndalon pagesen.

Neni 5.

Librezat e pensjonit duhet të kenë një numër dëftesash baras me këstet muejore. Kur mbarojnë këto, Ministrija e Financavet detyrohet me lëshue libreza të rea të cillat bashkë me skedat llogari-rrjedhëse, në paqëta të sigurueme, u dërgohen Drejtorinavet të Financave ku do të bahen pagesat. Drejtorit Financjare mbajnë skedat tue shenue mbi to pagesen dhe librezat ja u dorëzojnë të pensjonuemve ballë një dëftesës të cilen ja dërgojnë Ministris së Financavet për me e provue dorëzimin t'interesuemvet.

Neni 6.

Personat, emni i të cillëve ashtë shenue në librezen e pensjonit, njifen si kreditorë të vërtetë të Shtetit.

Librezat nuk mund të pengohen, as të cedohen as të depozitohen kurkujt. Cedimi, pengimi ose depozitimi i tyne, ndaj administratës financavet, nuk ka asnjë vleftë Ligjore. Administrata ka të drejtë të marrë masat e duhuna kundra mbajtësit të librezës, si dhe kundër të pensjonuemit për me e librue titullin.

Neni 7.

Libreza e pensjonit vlen titull për të pensjonuemit në nxjerrjen e kestevet të pensjonit.

Pagimi i pensjonit mund të bahet dhe në favor të personit të tretë i pajuemun me prokurë. Prokura duhet t'i paraqitet Ministris ose Drejtoris së Financave ku asht çel partia. Në të dy rastet Ministria autorizon pagimin e kesteve prokuratorit tue shenue këtë në skedë e në librezë.

Kur i pensjonuemi revokon prokuren, ketë, duhet me i njoftue Ministris ose Drejtoris për me u shenue ky revokim në librezë e në skedë.

Gjith' ashtu veprohet dhe në rast cedimi të pensjonit.

Neni 8.

Kur për çdo arësye shifet nevoja e modifikimevet mbi librezat e pensjonit dhe mbi skedat, këto do të bahen eksklusivisht prej Ministris së Financavet, e cila do të vendosë në se ashtë nevoja me ba modifikimet ose me i zavendësue me libreza ose skeda të tjera

Për këtë qëllim kur do herë që të paraqitet nevoja me ba modifikimet e librezës të pensjonit ose të skedes, Drejtorija Financjare detyrohet me i-a dergue si njanen ashtu dhe tjetrën Ministris së Financavet.

Neni 9.

Kur, per shkak ndrim banese të pensjonuemit, pagimi duhet të bahet në një qark tjetër, Zyra e Financës mbyll skeden e kont-korentit dhe i-a dërgon Ministris së Financavet për me i-a përcjellë Drejtoris Financjare pranë së cillës i pensjonuemi ka caktue banesen e tij të ré.

Neni 10.

Kurdoherë që për shkak vdekjeje të titullarit ose për arësye tjetër, një parti pensjoni duhet me u mbyllë, Zyra e Financës përkatëse ndalon pagimin, shenon në librezën dhe në skedë pagesat e bame deri atë ditë, mbasandej i-a paraqet Ministris së Financavet. Minisrija mbasi mbyll partinë, kur e lyp rasti, ban pagimin e kesteve të ngeluna atyne që kanë të drejtë. Në ketë rast ban likuidimin

e ri dhe lëshon skeden e llogaris rrjedhëse ashtu dhe ilbrezën e r.
të pensjonit.

Neni 11.

I pensjonuemi që humbë librezen e pensjonit, për me muejt e me pasë nji të ré duhet t'i bajë Drejtoris Financjare kompetente nje lutje të veçantë të cillës duhet t'i bashkojë edhe nji deklaratë të nenshkrueme prej tij dhe t'autentikueme prej Noterit me të cilen detyrohet me lirue Arken e Shtetit nga çdo dam që mund t'i rrjedhi kësaj nga humbja e librezës dhe me i-a dorëzue në rast se e gjenë përsëri.

Drejtorija Financjar ndalon pagesën e pensjonit dhe i dergon Ministris së Financavet lutjen e cila, mbasi të kenë ba formalitetet e parapame prej neneve 149 e 150 të Rregullores me datë 20 Fruer 1930, mbi administrimin e pasunis dhe të kontabilitetit të P. të Shtetit, përsa i përket titujve të shpenzimit të humbun, ban lëshimin e nji dublikate e cilla i dorëzohet t'interesuemit në bazë të dispozitave të caktueme prej nenit 5 paragraf. 2.

Në rast se libreza për të cilen qe kërkuë dublikata gjendet rishtas, kjo duhet t'i dërgohet Ministris së Financavet për anullim.

Neni 12.

Aktet e sekuestrimit e të pengut të pensjoneve të paraqitun në bazë të dispozitës së nenit 48 të Ligjës me datë 20 Qershuer 1934, janë t'ekzekutueshme prej Drejtorinave financjare, të cillat duhet t'i apin njoftim mbi to Ministris së Financavet.

KAPTINA III.

Pagesa të pensjonevet

Art. 13.

Pagimi i pensjonit bahet në paraqitjen e librezës të Drejtoris Financjare ku asht çelë partia. Drejtoria në fjalë shkëput prej librezës dëftesën që i përket muejit për t'u pague, sigurohet, në bazë të skedës së llogaris rrjedhëse, nëse kësti që kërkohet ashtë i papaguemun dhe që nuk ashtë paraqitë asnjë kundërshtim, vren në se gejndet deklarata e gjallnis t'interesuemit, lëshue në tre muaj një herë, prej Bashkis ose Komunes, mbush dëftesat me shënimet e nevojshme dhe i-a dorëzon Arkëtarit.

Kur pensjoni gëzohet prej atyne që kanë të drejtë, zyra financjare duhet të sigurohet mbi ekzistencën e konditave të lypuna prej nenit 3 të Lgjës së Pensjonevet, me anën e deklaratave të përmenduna si ma sipër.

Gjithë ndryshimet që vërtetohen në gjendjen civile ose ekonomike të personave prej të cilave rrjedhë syprimimi ose zbritja e pensjonit, duhet t'i njoftohen pikësëpari Drejtorinave Financjare kompetente prej Bashkive ose prej Komuneve, edhe mbasandej zyrat financjare i-a njoftojnë Ministris së Financavet për me marrë masat e duhuna.

Neni 14.

Arkëtari kërkon t'i jepet mbi dëftesa që ka marrë si mbas nenit ma sipër, kuitanca e marrësit të hollave si mbas dispozitave të nenit 123 të Rregullores datë 7 Fruer 1930 mbi administrimin e pasunis e të Kontabilitetit të Përgjithshëm të Shtetit, i paguen shumën t'interesuemit dhe mban dëftesën për justifikim të daljes s'arkës të cillën e llogarit në regjistrë ndër shpenzime të budgetit.

Për pagesën që bahet merr shënim me nji herë mbi skedën e kont-korentit.

Neni 15.

Këstet muejore të pensjonit duhet të paguhen tanësisht. Pagesat pjesore ashtu dhe paradhanjet mbi këstet e pa-skadueme të pensjonit janë të ndalueme.

Neni 16.

Llogaritarët e zyrave financjare janë përgjegjës për regullaritetin e kuponave të shkëputuna prej librezës; ashtu dhe arkëtarët janë përgjegjës për regullaritetin e kuitancave të lëshueme mbi kuponat e pagueme prej tyne.

Neni 17.

Kur një ose ma shumë kiste pensjoni paguhen gabimisht dhe nuk ka mjete rimborsimi të tjera, Ministrija e Financavet, ka tagër me ndaue pagimin e këstevе t'arthme deri sa të mbushet shuma e pagueme gabimisht, pa pasë nevojë për ndonjë akt-gjykim ose autorizim tjetër.

KAPTINA IV.

Llogaria e Pensjoneve

Neni 18.

Drejtorinat financjare japin llogari për pagesat e bame në llogari të pensjoneve me llogarinat e zakonëshme t'arkës si mbas nenit 201 të Regullores me datë 7 Fruer 1930, mbi Administrimin e Pasunis dhe Kontabilitetin e Përgjithshëm të Shtetit. Këtyne llogarinave i bashkangjitet nji listë në dy kopje që ka bashkëlidhje dëftesat e kuitancueme si mbas nenit 14.

Neni 19.

Drejtorija e Thesarit, po sa të ketë në dorë llogarinat e arkës, mban një eksemplar të listës së pregatitun në bazë të nenit ma sipërm dhe të dytin, së bashku me dëftesat, i-a dërgon Drejtoris së Pensjoneve për shqyrtim të rregullaritetit të pagesave të bame nga Drejtorinat Financjare dhe për të marrë shënim ndër rregjistrat e përmenduna në nenin 2 Nr. 1.

Dëftesat pastaj i kthehen Drejtoris së Thesarit për t'a bashkangjitun llogarive t'arkës të Drejtorinave financjare përkatëse, të cilat i-a dërgojnë Kshillit Kontrollues si mbas nenit 205 të Rregullores të Kontabilitetit.

Neni 20.

Shuma e përgjithshme e pensjoneve të pagueme për ç'do tremuejor i komunikohet prej Drejtoris së Thesarit Drejtoris së Kontabilitetit, për të bamun shënimet e duhuna në rregjistrat e budgetit.

Neni 21.

Pensjonet formojnë kompetencë për ushtrimin e vjetit financjar që janë pague efektivisht dhe sikur t'i përkasin ushtrimevet të maparëshme.

Pengimi merret në rastet e pagesave të kryeme.

KAPTINA V.

Dispozita Tranzitore dhe të fundit

Neni 22.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje aplikohen dhe për rrogat e disponibilitetit të caktueme si mbas nenit 64 të Ligjës së Pensjonevet me datë 20 Qershuer 1934.

Neni 23.

Ministri i Financavet ngarkohet me zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 24.

Abrogohet ç'do dispozitë në kundërshtim me këtë Rregullore, e cila hynë në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 62/9 dt. 2-VIII-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer në datë 1-8-1934.

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Rregullores mbi pagesën e pensjoneve të shpërblimeve të njihershme të nëpunësave Civil e Ushtarakë që vehen në pensjon dhe atyne që heqin të drejtat prej këtyne.

Durrës, më 7 Gusht 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Financavel A. DIBRA

Nr. 112.

DEKRET MBRETNUER, 7 Gusht 1934.

Mbi krijimin e Konsullatave Nderi në Zagreb (Jugosllavi) Bruksel (Belgjikë) dhe Trieste (Itali)

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 17 Gusht 1934, Nr. 47)

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shrkesën Nr. 1160 dt. 4-VIII-934, të Kryeministris,

Tue pamë dhe Vendimin Nr. 441 datë 3-VIII-1934 të Këshillit Ministruer,

D E K R E T O N :

Krijimin e nji Kryekonsullate Nderi të Shqipnis në Zagreb (Jugosllavië).

Durrës, me 7 Gush 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri P. të Jashtme XHAFER VILA

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1161 dt. 4-VIII-934 të Kryeministris,

Tue pamë dhe vendimin Nr. 443 datë 3-VIII-934 të Këshillit Ministruer,

D E K R E T O N :

Krijimin e nji Konsullate Nderi të Shqipnis në Bruksel (Belgjikë).

Durrës, me 7 Gush 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. të Jashtme XHAFER VILA

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptrvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1161 dt. 4-VIII-934 të Kryeministris,

Tue pamë dhe vendimin Nr. 443 datë 3-VIII-934 të Këshillit Ministruer,

D E K R E T O N :

Krijimin e nji Konsullatë Nderi të Shqipnis në Triest (Itali).

Durrës, me 7 Gush 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri P. të Jashtme XHAFER VILA

Nr. 113.

DEKRET-LIGJE, 7 Gusht 1934.

Mbi marrjen e taksës së ngarkim shkarkimit dhe prej Komuneve qi ndodhen në brigje deti e liqeni

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Gusht 1934, Nr. 48)

Neni 1.

Dispozita e Nenit 118 të Ligjës së Bashkivet, zbatohet edhe prej Komunevet qi ndodhen në breg deti ose liqeni.

Neni 2.

Për zbatimin e kësaj Dekret-Ligje ngarkohet Ministrija e P. të Mbrendëshme.

Neni 3.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi ç'prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1078 datë 1-8-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 28-VII-1934,

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligës mbi marrjen e taksës së ngarkim-shkarkimit dhe prej Komuneve qi ndodhen në brigje deti a liqeni,

Durrës, me 7 Gusht 1934.

ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 114.

DEKRET-LIGJË, 13 Gusht 1934.

Mbi klasifikimin e Gjykatës së Paqit të Durrësit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Gusht 1934, Nr. 48)

Neni 1.

Gjykata Paqtuese e Durrësit klasifikohet Gjykatë Paqtuese e Kl. II. me personelin që pason:

Një Gjyqtar Paqtues të Kl. II;
Një Ndihmës-Gjyqtar Paqtues;
Dy Sekretarë;
Një Ftues;
Një ftues-shërbtuer.

Neni 2.

Rrogat e personelit janë ato që caktohen në Ligjën mbi Organizimin e Drejtësis më zbritjet si mbas budgetit dhe, kanë me u përballue nga Kap. I. i budgetit të Ministris së Drejtësiës.

Neni 3.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi qyshë ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 4.

Ministrija e Drejtësiës ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

BKSH

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shrkesën Nr. 1087/I datë 2-8-934 të Kryeministriës,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi klasifikimin e Gjykatës së Paqit të Durrësit.

Durrës, më 13 Gusht 1934.

ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Nr. 115.

SHTOJCË-DEKRET-LIGJE, 7 Gusht 1934.

Mbi Aktet e Gjendjes Civile

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 22 Gusht 1934, Nr. 48)

Neni 1.

Nenit 132 të Ligjës mbi Aktet e Gjendjes Civile me datë 20 Prillë 1929, i shtohet paragrafi qi vijon:

«Kuer personat qi kërkojnë, prej zyravet përkatëse, letre-njoftimet e tyne dhe të familjes së tyne, vërtetojnë vobeksinë e plotë me deshminë e Pleqsis së lagjes ose të katundit, e vertetumun prej Këshillit bashkiak ose komunal, letre-njoftimet e nalt-përmenduna u epen gratis dhe pa pullë.

Neni 2.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi që prej ditës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Ministri i P. të Mbrendëshme dhe aj i Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1079 dt. 1-VIII-934 të Kryeministris;

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 28-VII-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Shtojcë-Dekret-Ligjës mbi aktet e Gjendjes Civile.

Durrës, me 7 Gusht 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme MUSA JUKA

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 116.

DEKRET-LIGJE, 13 Gusht 1934.

Për disa modifikime të Ligjës mbi Organizimin e Armës Gjindarmaris Mbretnore

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 27 Gusht 1934, Nr. 49)

Neni 1.

Neni 8 i Ligjës mbi Organizimin e Armës së Gjindarmeris Mbretnore me datë 18 Maj 1933 modifikohet si vijon:

Arma e Gjindarmeris Mbretnore përbahet prej Komandave të poshtë-shenueme:

a) Komanda e Përgjithshme;

b) Komanda e Shkollës së Gjindarmeris;—

c) 10 Komanda Qarqesh;

ç) 31 Komanda Rrethesh;

d) 253 Komanda Postash.

Neni 2.

Neni 9 i Ligjës ndryshohet kështu:

Komanda e P. e Armës përbahet prej këtyne Zyrave:

1) Zyra e Komandantit

2) Adjutantura Madhore (personel oficer, dhe ndihmon Komandantin e Përgjithshem në veprimet e)

3) Seksioni I. (Personel Nenoficer e Trupë)

4) Seksioni II. (Kontabilitet e materjal)

5) Seksioni III. (Sherbim) »

Neni 3.

Neni 10 i iLgjës zavendësohet kështu:

Adjutantura Madhnore drejtohet prej oficerit t'Armës që ka graden ma të naltë ose vjetërsinë ma të madhe n'atë gradë.

DPSH

Seksionet I, II, III, drejtohen prej Kapitenash të klas. I. ose prej oficerash eprorë.

Si Adjutantura Madhore ashtu edhe secili Seksion kanë me pasë në dispozicjon të tyne një sasië graduatësh e Gjindarmësh të nevojshem për rregullimin e shkresorisë Zyrtare.

Për veç oficerave të nalt-shenuem, pranë Komandës P. t'Armës janë edhe këta dy oficera:

a) Adjutanti i Komandantit të Përgjithshem t'Armës;
b) Ndihmës i Kontabilitetit.

Neni 4.

Nenit 11 të Ligjës i shtohet paragrafi që vijon:

«Përjashtohet nga ky pjestim personeli i nevojshëm për instruktora shkruesa, ordinanca e sherbime të ndryshme, të cilët formojnë Shtabin e Komandës së Shkollës.

Neni 5.

Mbas nenit 11 të Ligjës shtohet neni i vijuemi cilli merr numrrin 12:

Në bazë t'organizimit t'Armëve e trupave të tjera të fuqive t'armatosuna të Shtetit, Komanda e Shkollës e Qark Komandat, janë baras me nji Batalion; Rreth Komandat me nji okmpani dhe Post-Komandat me një Skuadrë.

Neni 6.

Mbas nenit 12 të sipërme vjen neni 13 që vijon:

Qark Komandat komandohen prej një oficerit epruer, e në mungesë t'oficerave eprorë, komandohen prej Oficerash me gradë ma t'ulët deri në Kapiten II. perfshim.

Seicili Qark Komandant ka në dispozicion të vetë në qendrën e Qarkut dy oficera, njani prej të cilëve asht ndihmës dhe tjetri Adjutantë.

Rreth Komandat komandohen prej oficeri depruer, i cili asht i ndihmuem prej nji oficeri subaltern që ka titullin Ndihmës i Rreth Komandës.

Post-Komandat komandohen prej një oficeri i cilli ndihmohet prej një graduati ose gjindarmi që ka titullin: Ndihmës i Post-Komandës.

Qark e Rreth Komandave u caktohet edhe një sasi graduatësh e Gjindarmësh të nevojshem për veprimet e Zyrave të tyne.

Neni 7.

Neni 12 i Ligjës, mbasi të marri numrin 14, ndryshohet si vijon:

«Çdo Komandë Qarkut i asht caktue një fuqi organike si mbas gjanësis e randësis së vendit, e cila përbahet prej kamsorësh kalorësash dhe eventualisht prej çiklistash.»

Neni 8.

Neni 13 i Ligjës mbasi të marrë numrin e 15, ndryshohet si vijon:

«Kuadri organik i oficerave t'Armës caktohet në pasqyrën Nr. 1 të kësaj Ligjë dhe, ay i personelit Nenoficer e Trupës për ç'do Qark e Rreth Komandë caktohen nga ana e oKmandës së P. t'Armës vit për vit si mbas buxhetit e nevojës për sejcilen Komandë.

Organika e oficeravet të parapamë prej këtij neni do të mbrihet gradualisht me Dekret-Mbretnuer mbi bazen e mundësis së buxhetit të çdo vjeti.

Neni 9.

Neni 14 i Ligjës modifikohet si vijon dhe merr numrin 16:

«Oficerat e Armës së Gjindarmerisë Mbretnore merren prej:

a) oficerave deprorë në sherbim të perherëshem t'Armës së kambësorisë qi kanë mbarue një akademi ushtarake;

b) Kapterave t'Armës Gjindarmeris Mbretnore.

Oficerët e përmendun në germën a) kanë me frekuentue nji kurs 6 mujorë për aftësimin e tyne si oficera të Gjindarmerisë, në perfundim të cilit, në se dalin me sukses, kalojnë definitivisht në Armen e Gjindarmerisë. Ritransferimi i tyne n'ushtri bahet në bazë të nenit 17 të Ligjës mbi gjendjen e Oficerave të Fuqive t'Armatosuna.

Kapterat e permendun në germen b) kanë me u zgjedhë midis atyne që kanë me kalue me sukses kursin e posaçem t'oficeravet pranë Shkollës së Gjindarmerisë, kur mos të kenë kalue moshën 33 vjeç. Në mbarim të kursit ata që gjykohen t'aftë për shërbim emnohen Nentogera.

Rekrutimi i personelit Nenoficer e Trupë bahet në bazë të Ligjës mbi detyrat e të drejtat e personelit Nenoficer e Trup t'Armës së Gjindarmerisë Mbretnore.

Neni 10.

Neni 15 i Ligjës pasi të marri numrin 17, ndryshohet si vijon:

«Komandanti i Përgjithshëm i Armës për veç detyrave dhe të

drejtave të tejra të permenduna në Ligjët e në Rregulloret e ndryshme:

a) proponon komandës supreme: emnin shenimin e tran sferimit e oficerave komandanta në bazë të pershkrimeve të nenit 182 të Statutit Themeltar;

b) çfaq mendimin e vet Komandës supreme në rastet e përshkrueme në Ligjën mbi gjendjen e oficerave të fuqive t'armatosuna, për oficerat e Armës së Kamsorisë, që dëshirojnë me u transferue n'Armën e Gjindarmerisë Mbretnore;

c) cakton numrin e oficerave të ndryshem që si mbas Ligjës përkatëse kanë të drejtë për gradim;

ç) ka kompetencë gradimi deri në graden ma të naltë të Nenoficerave;

d) mbledh këshillin disiplinuer për oficera e nenoficera dhe shfaq mendimin e tij mbi vendimet e marruna prej këshillit.

Neni 11.

Titulli i kaptinës V ndryshohet si vijon:

Detyrat e oficerave të ndryshëm t'Armës.

Neni 12.

Nenet 16 e 17 të Ligjës bashkohen dhe, marrin Nr. 18.

Neni 13.

Neni 18 i Ligjës merr Nr. 19.

Neni 14.

Nenet 19 e 20 të Ligjës mbasi të marrin Nr, 20, ndryshohen si vijon:

«Juridiksioni toksuer i Gjindarmerisë në Mbretnien Shqiptare asht baras atij t'Administratës Civile, dhe pjestohet në Qark-Komanda, Qark-Komandat në Rreth-Komanda, dhe Rreth-Komandat në Post-Komanda.

Normalisht të tilla Komanda duhet të gjenden të vendosuna rispektivisht nder qendrat e Prefekturave e të Nënprefekturave dhe të Katundarive.

Por në qoftë se nevoja e sherbimit ka për të lypë, në qendren e ndonji katundarisë me randësi mund të vendoset nji Rreth Komandë, nder katunde me randësi që nuk janë qendra katundariësh mund të vendosen Post-Komanda dhe, nder vende të tjera që janë shtigje me randësi, të cilat qofshin edhe të pa banueshme mund të vendosen Foj-Komanda.

Përveç sa u tha ma sipër, Qark-Komandantët kanë edhe nji Rreth direkt, në të cilin bajnë detyrën si nji Rreth-Komandant.

Neni 15.

Neni 25 i ligjës ndryshohet si vijon:

«Emnimi dhe transferimi i oficerave ndër detyra ma të vogla se ato të permendura në germën b) të nenit 15, i Nenoficerave Post-Komandanta dhe emnimi dhe transferimi i të gjith personelit tjetër Nenoficer e Trupe, prej nji Qarku në tjetrin, asht në kompetencen e Komandantit Përgjithshem t'Armës së Gjindarmerisë Mbretnore.

Transferimi i Nenoficerave jo me cilsi Post-Komandant dhe i personelit Trupe permbrenda nji Qarku ose nji Rrethi, asht në Kompetencen e Qark-Komandantave.

Neni 26 i Ligjës ndryshohet kështu:

Neni 16

Në rast nevoje Komandant' i Përgjithshëm mund t'urdhënojë zavendësime të përkohëshme dhe të shkurtëna t'oficerave me detyrë Rreth-Komandant e nalt.

Gjith po në ketë kompetencë janë të mveshun edhe Qark-Komandantët pr sa i prket zavêndësimit të Post-Komandave përmbrenda rajonit të Qarkut të tyne.

Neni 28 i Ligjës ndryshohet si vijon:

Neni 17.

Oficerat me detyrë të ndryshme pranë Komandës së Përgjithshme t'Armës dhe pranë Shkollës së Gjindarmerisë Mbretnore do të sherbejnë të paktën katër vjet në këto detyra.

Oficerat me detyra të ndryshme nder Qark e Rreth-Komanda, do të sherbejnë të paktën tri vjet në këto detyra.

Neni 18.

Nenit 29 i hiqet kryerreshti i parë dhe merrë këtë formë:

Për shkaqet e jashtë-zakonshme si shëndetësië, disiplinë, gradim etj. dhe mbas nevojës që të shifet, Komanda e Pergjithshme mundet me i transferue dhe ma parë tue veprue në bazë të dispozitave të kësaj Ligje. Transferimi i Oficerave t'Armës mund të vendoset edhe mbas kerkesës së tyne për shkaqet e sipër-tregueme.

Neni 19.

Neni 30 i Ligjës ndryshohet si vijon:

Nenoficerat Komandantat në nji Postë dhe personeli tjetër Ne-

noficer e Trupë i Armës, duhet të sherbejnë mbrenda rajonit të nji Rrethi ose të Qarku të pakten tre vjet, por për shkaqe Zyrtare ose private të jashtzakonshme e të justifikueme mund të transferohen edhe ma parë prej nji Poste, Rrethi ose Qarku në tjetrin.

Neni 20.

Neni 32 i Ligjës ndryshohet si vijon:

Arma e Gjindarmeris Mbretnore, si mbas Statutit Themeltar nga pikpamja ushtarake mvaret prej Komandës Supreme, për sa i përket mbajtjes së rregullit dhe sigurimit publik, mvaret nga Ministrija e P. Mbrendshme dhe, për sa i përket sherbimit të Policisë gjyqsore, mvaret nga Ministrija e Drejtësis.

Neni 21.

Neni 34 i Ligjës ndryshohet si vijon:

Ministri i P. të Mbrendshme në marëveshtje me Komandantin e Përgjithshem t'Armës dhe me pëlqimin e Komandës Supreme, ndër raste të ngutshme disponon që prej qarqeve të ndryshme, të mbështillet nji fuqi Gjindarmerije për t'a perdor nder ato vise ku të shifet nevoja.

Neni 22.

Neni 35 i Ligjës ndryshohet si vijon:

Prefektat në marrëveshtje me Komandantat e Qarqeve të vendit, në raste të ngutëshme mund të disponojnë mbledhjen e nji fuqije Gjindarmarije nga Rrethet për t'a përdorë mbrenda rajonit të Qarkut ku të shifet nevoja, duke u lajmerue mandej edhe Komanda e Përgjithshme e Gjindarmeris.

Neni 23.

Kjo Dekret-Ligjë, hynë në fuqi ç'prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare të Mbretnis.

Neni 24.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1067/II datë 11-VIII-1934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pelqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 8-VIII-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës për disa modifikime të Ligjës mbi Organizimin e Armës së Gjindarmeris.

Durrës, më 13 Gusht 1934. ZOG

Kryeministri PANDELI EVANGJELI — *Ministri i Drejtësis* V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme XHAFER VILA — *Ministri i P. Mbrendëshme* MUSA JUKA

Ministri i Financavet A. DIBRA — *Ministri i Arësimit* Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore S. SARAÇI — *Ministri i Ekonomis Kombëtare* D. BERATTI

PASQYRA Nr. 1.

Kuadri Organik i Oficerave të Gjindarmeris

Gjenerala	1
Kolonela	1
Nenkolonela	4
Kapitena I.	32
Kapitena II.	21
Togera, Nentogera e Aspiranta	21
Shuma	121

Nr. 117.

DEKRET-LIGJE, 13 Gusht 1934.

Mbi shtimin e një Architekti në kuadrin e Bashkis Durrësit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 27 Gusht 1934, Nr. 49)

Neni 1.

Në kuadron e personelit të Bashkis së Durrësit shtohet edhe nji Arshitekt me 500 fr. ari rrogë mujore.

Neni 2.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi qysh nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Ministrija e P. të Mbrendshme ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shrkesën Nr. 1142 datë 2-VIII-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 1-VIII-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi shtimin e nji Arshitekti në kuadrin e Bashkis së Durrësit.

Durrës, më 13 Gusht 1934. ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 118.

DEKRET-LIGJE, 13 Gusht 1934.

Mbi mënyrën e nxjerrjes së taksës së guroreve tue abrogue paragrafin 5 të Nenit 110 të Ligjës së Komuneve, dhe Nenit 117 të Ligjës së Bashkivet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 27 Gusht 1934, Nr. 49)

Neni 1.

Pargrafi 5 i nenit 110 i Ligjës së Komuneve, dhe neni 117 të Ligjës së Bashkivet, abrogohen, dhe zavendsohen me dispozitat që vijojn:

Neni 2.

Taksat e gurorëve dhe t'oxhaqeve të gelqeres, të tullave, të tjegullave e të tjera qi permenden në nenin 1 të Ligjës së gurorëve, në qarkun e Komuneve nxjerrjen prej Komuneve dhe në qarkun e qyteteve, ku ka Bashkis, prej Bashkivet.

Neni 3.

Ndër ato vende ku Komuna e Bashkija asht perqindruem në nji dorë administrimi, taksa e permendun prevetohet prej autoritetit qi drejton dy juridiskione së bashku.

Neni 4.

Taksa e nxjerrun në mënyrën e tregueme në nenin 3, do të perllogaritet prej Zyrës Komunale-Bashkiake, si mbas vendit ku

ndodhet gurorja ose oxhaku në qarkún e qytetit per llogari të këtij, e në rajonin e Katundeve të rrethit për llogari të Komunes.

Neni 5.

Për zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë ngarkohet Ministrija e P. të Mbrendshme.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shrkesën Nr. 1034 dt. 1-VIII-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 28-VII-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi mënyrën e nxjerrjes së taksës së gurorëve, tue abrogue paragr. 5 të nenit 110 të Ligjës së Komuneve dhe nenit 117 të Ligjës së Bashkivet.

Durrës, me 13 Gusht 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i P. të Mbrendshme MUSA JUKA

Nr. 119.

DEKRET-LIGJË, 28 Gusht 1934.

Mbi protokolin e zbatimit t'anekses C. (dispozita që i takojnë trafikut të kufinit) të Traktatit për tregti dhe lundrim midis Shqipnis dhe Jugosllavisë i nënshkruem në Belgrad me 22 Qershor 1926

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 8 Shtator 1934, Nr. 50)

Neni 1.

Pranohet protokoli i zbatimit t'anekses C, (Dispozita që i takojnë trafikut të kufinit) të tratkatit për tregtij dhe Lundrim midis Shqipnisë dhe Jugosllavisë, i nenshkruem në Belgradë me 22 Qershuer 1926.

Neni 2.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi si mbas kushteve të caktueme në protokollin e nalt-permendun i nenshkruem në Belgradë me 8 Majë 1934.

Neni 3.

Ministrija e Punve të Jashtme, Ministria e Punve të Mbrend-

shme, Ministria e Financavet dhe ajo e Ekonomis Kombëtare, ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shrkesën Nr. 411/I dt. 22-VIII-934 të Kryeministriës,

DEKRETON:

Aprovimin e Potokolit të nenshkruem në Begrad me 8 Majë 1934 mbi zbatimin e anekses C, (Dispozita qi i takojnë trafikut të kufinit) të Traktatit per tregtij dhe Lundrim midis Shqipnis dhe Jugosllavis, i nenshkruem në Belgrad me 22 Qersheur 1926, dhe Urdhunon zbatimin e tij.

Durrës, me 28 Gusht 1934.

ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. të Mbrendshme
MUSA JUKA

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Ekonomis Kombëtare
D. BERATTI

Nr. 120.

DEKRET-LIGJE, 11 Sthtator 1934.

Mbi pagesat e fondeve të ndryshme për Përfaqësinat e krijueme me Dekret Ligjen datë 9 Korrik 1934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 15 Shtator 1934, Nr. 51)

Neni 1.

Për përballimin e rrogavet e allokacionevet, si dhe shpenzimevet të caktueme për Përfaqësinat e krijueme me Dekret-Ligjen datë 9 Korrik 1934, shumat e nevojëshme prej fr. ari 18.200 për Kap 1 «Rrogë, alokasione», dhe fr. ari 8080 për Kap 5, do të paguhen po nga fondi i përgjithshem i kapitujvet në fjalë, tuej pasë kursim nder vende vakante të budgetit udhëtues.

Neni 2.

Ministrija e Financavet dhe ajo e Punvet të Jashtme, ngarkohen me zbatimin e këtij Dekret-Ligji, i cili hynë në fuqi diten e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

BKSH

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shrkesen Nr. 1215 dt. 14-VIII-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit iMnistruer me datë 13-VIII-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi pagesat e fondeve të ndryshme për Përfaqësinat e krijueme me Dekret-Ligjen datë 9 Korrik 1934.

Durrës, me 11 Shtatuer 1934. ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Financavet — A. DIBRA

Ministri P. të Jashtme — XHAFER VILA

Nr. 121.

DEKRET-LIGJË 15 Shtator 1934.

Mbi modifikimin e Ligjës mbi taksimin e miellit të grunit me datë 28 Prill 1934

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 15 Shtator 1934, Nr. 52)

Art. 1.

Paragrafi i parë i Art. 1 të Ligjës mbi taksimin e miellit të grunit me datë 28 Prillë 1934 modifikohet si vijon:

«Mjelli i grunit që fabrikohet në mullinjt e vendit qofshin me forcë motori ose me ujë, si dhe mjellnat e grunit që importohen nga jashtë i shtrohen nji takse konsumi si vijon:

Kualitet	Luks	3	Fr. ari	për	kuintal
»	«0»	2	»	»	»
»	«I»	1.50	»	»	»

» «II» dhe ato që janë ma poshtë se ky kalitet me nji fr. ari per kuintal.

Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse mjellnat e fabrikueme në mullinjt e vendit që nuk kanë instalime sitash, shoshash ose veglash për lamjen e pastrimin e grunit, dhe për kategorizimin e kaliteteve të mjellit».

BKSH

Përkundrazi i shtrohen taksës së nalt-përmendun edhe ato mjellna gruni që bluhen në mullinjt e permendun në paragrafin e sipërmë, kuer kalojnë nga instalime të veçanta të ngrehuna me qëllim të lajë, të pastrojë grunin dhe të ndajë kualitetet e mjellit.

Art. 2.

Kjo Dekret Ligjë hynë në fuqi 7 dit mbas shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Ministrija e Financavet dhe ajo e Drejtësis ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 360-IV datë 23-VIII-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 22-VIII-1934,

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi modifikimin e Ligjës mbi taksimin e miellit të grunit.

Durrës, me 15 Shtator 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis V. AVRAMI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 122.

DEKRET-LIGJE, 11 Shtator 1934.

Mbi premjen e drujve të Arrave

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 15 Shtator 1934, Nr. 52)

Art. 1.

Nuk lejohet të premit e drujve të arrave, si këto të formojnë pjesë pylli ose të jenë të shpërndame ndër ara e kopshtije, veç se:

a) kuer për shkak vjetërsije nuk apin ma fryt;

b) kuer të jenë të thamë krejtsisht për shkaqe të natyrshme, si vjetërsi, smundje, dame mateorike etj.

BKSH

Art. 2.

Asht e ndalueme të premit e degave, të gëdhendunit e trungut, të çveshunit e lvores, të shpuemit me turjelë (tryel), të premit e rrajve, të ndezunit e zjarmit për qark, si dhe të përdorunit të çdo mjeti a mënyre qi mund t'i sjellin dame drujve të arrave tue i shkaktue heret o vonë mos frytzimin ose të thamin e tyne pjesërisht ose krejtësisht.

Art. 3.

Kushdo qi don me pré druj arre, asht i detyruem, me i paraqit nji lutje zyrës së Pyjeve të qarkut, tue tregue në ketë: vendin ku ndodhen drujt, mënyrën e zotnimit, sasien e gjendjen e drujvet qi don me pré.

Zyra e Pyjeve, mbassi të gjejë lutjen në rregull e të vertetojë mënyrën e zotnimit, lutjen në fajlë i-a paraqet Agronomit të Prefekturës, i cilli shkon në vend për të konstatue në asht se gjendja e drunjve i përgjigjet plotsisht përshkrimeve t'artikujve ma sipër, dhe njiheri bën hetime të plota në se eventualisht janë përdorur mjete të ndryshme për me shkaktuë thamjen e drunjve ose mos shfrytzimin e tyne.

Drunjt e gjetur në rregull e qi mund të lejohet prerja, shenohen nga Aronomi me nji damkë të posaçme.

Mbi konstatimet dhe hetimet e bamuna në vend, Agronomipërpilon nji raport ë me shkoqitje, dhe i a paraqet Zyrës së Pyjevet, së bashku me lutjen përkatse.

Shpenzimet e udhtimit t'Agronomit parapaguhen nga lutsi, në bazë të së drejtës q'i përket, si mbas Ligjës relative.

Art. 4.

Në bazë të raportës s'Agronomit, Zyra e Pyjevet kryen formalitetet e lejes së premit simbas përshkrimeve të Ligjës së Pyjeve për drunjt e rregullt, tue marrë njiheri masat e rojes për drunj qi nuk duhet pré.

Për drunj e damkuem ose të thamë vullnetisht, personali i zyrës së pyjeve, tue pasë për' anë Plakun e Lagjes ose ndonji nëpunës të Komunes ose të Gjindarmaris, formon proçeset dhe i-a referon Gjyqit, tue kërkue dënimin e guximtarëve.

Art. 5.

Kushdo qi në pronën e tij ose të nji tjetrit guxon me pre nji ose ma shum dru arre pa pasë leje nga Zyra e Pyjeve, ose pa pasë **krye** plostisht formalitetet e përshkrueme në këtë Dekret-Ligjë. dënohet me gjoben e caktueme për drunj arre me paragrafin e fun-

dit të art. 151 të Ligjës së Pyjevet ose si mbas rase, në bazë të artikujve të tjerë të asajë Ligjë, gjithë herë me gjobë të trefishueme.

Po me këtë mënyrë dënohen dhe ata qi vullnetisht kan përdor çdo lloj mjeti direkt ose indirekt për me shkaktue mos frytzimin damtimin ose thamjen e drujve të arrave dhe sikurse në këtë rasë mos të vërtetohet qëllimi i përfitimit ose i shdukjes së pengimit të caktuem nga kjo Dekret-Ligjë.

Drujt' e arrave të preme pa leje, kudo qi të ndodhen, konfiskohen dhe shiten për dobi t'Arkës së Shtetit.

Për drujt arre të thamë vullnetisht ose të damtuem aq sa të jetë e pa-evitueshme të thamit, mbassi të marri fund gjyqi, lëshohet leje dhe nxierret taksa, si mbas Ligjës së Pyjeve.

Fajet për të prem të drujve të arrave pa leje ose për të damtuem e thamjen e tyne vullnetisht, kalojnë në parashikim mbas dy vjetësh, që prej datës s'ushtrimit të fajit.

Art. 6.

Agronomi qi për neglizhencë nuk vete në vend për konstatim të gjendjes së drujve të arave, ose qi vete e nuk kryen konstatimet e hetimet plotësisht si mbsa art. 3, tue raportue në bazë të informatave të marruna nga të tjerë, dënohet si mbas art. 203 të Kodit Penal.

Agronomi qi tue mos vajtë në vend ose tue vajtë për konstatim e hetim të drujve të arrave paraqet raporta false me qëllim të favorizoj t'interesuemin për m pasë lejen e të premit, ose me qëllim qi t'i mbulojnë ose t'i lehtësojnë ndonji kundraveprim t'ushtruem, si mbas kësaj Dekret-Ligje, dënohet si mbas art. 306 të Kodit Penal.

Kushdo qi tue dijtë prfiton ose ban ndonji vepër për me përfitue nga raportat false të Agronomit; edhe sikurse mos të kenë bashkëpunue në falsifikim, dënohet si mbas art. 311 të Kodit Penal.

Nëpunsat e Administratës së Pyjevet qi me rasë të damkimit ose të kryemit të formaliteteve të lejes, ometojnë me vrejtë n'asht se gjendja e drujve të arrave m'u pré i përgjegjet rapotimve të Agronomit, ose tue pasë vrejtë gjendjen, heshtin ose kerkojnë në çdo mënyrë me i mbulue fajin këtij, dënohen si bashkë-vepruesa të Agronomit.

Art. 7.

Zyrat Doganore janë të ndalueme me lejue eksportimin e drujve t'arrave qi nuk përmbajnë damken e nuk janë të përcjellun me diftesë të Zyrës së Pyjevet.

Art. 8.

Në modifikimin të paragrafit C, dhe, t'art. 1 të shtojcës së Ligjës së Pyjevet e Kullosave mbi përjashtimin e disa prodhimeve pyjore nga çmimi e taksa, dekretue me datë 24-4-1934, drujt e arrave si këto të nxjerret nga Pyjet private ose të jenë të shpërndame nder ara e kopshtije, i shtrohen pagesës së taksës si mbas dispotave të Ligjës së pyjevet.

Art. 9.

Për sa heshtë kjo Dekret-Ligjë, rrinë në fuqi Ligja e Pyjeve e Kullosave si edhe Shtojcat e saja.

Art. 10.

Ministrija Ekonomis Kombëtare, Ministrija e Financave si dhe ajo e Drejtësis ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje, e cilla hynë në fuqi me shpalljen e saj në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shrkesën Nr. 1235 dt. 20-VIII-934 të Kryeministrıs,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 14-VIII-1934,

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi premjen e drujve t'arrave.

Durrës, me 11 Shtatuer 1934. Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Ekonomis Kombëtare
D. BERATTI

Nr. 123.

DEKRET-LIGJË, 28 Gusht 1934.

Mbi modifikimin e Art. 2 të Dekret-Ligjës me datë 28 Korrik 1933 mbi taksimin e konsumit të Birrës

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Shtator 1934, Nr. 53)

Art. 1.

Taksa e konsumit për ç'do kilogram birrë si ner fuçija ashtu

edhe ner shishe, zbritet nga fr. ari 0.30 në fr. ari 0.20 (njizet santim ari).

Art. 2.

Ç'do sasi birre e ç'doganueme apo e deklarueme për çdoganim qi ndodhet depozitë në doganë, apo nder tregtarët, ashtu edhe ç'do sasi birre e cila për efekt të taksimit ka qenë vertetue e rregjistrueme prej Financës, qoftë e depozituem ner tregtarë apo në lokalet e fabrikës, konsiderohet si e konsumueme dhe, randohet me taksën e ma parëshme fr. ari 0.30 (tridhjet santim ari).

Art. 3.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi 7 ditë mbas shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e ksaj Dekret-Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1158/I datë 16-VIII-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 11-VIII-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi modifikimin e Art. 2 të Dekret-Ligjës me datë 28 Korrik 1933 mbi taksimin e Konsumit të Birrës.

Tiranë, me 28 Gusht 1934. ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i P. të Mbrendshme
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Ministri i Ekonomis Kombëtare
D. BERATTI

BKSH

Nr. 124.

SHTOJCË-DEKRET-LIGJË 11 Shtator 1934.

Mbi Llotarin e Kryqit të Kuq me datë 3 Maj 1930

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 24 Shtator 1934, Nr. 53)

Neni 1.

Shitja e biletave të llotarive të huaja, të çdo lloj qofshin mbrenda kufive të Mbretnis, asht e ndalueme.

Neni 2.

Fitimet e realizueme të llotaris qi rjedhin nga diferença midis vleftës reale të sendeve të vueme në llotari dhe të shumës së biletave, nuk mund të jenë ma tepër se 50%, nga të cilat gjysma do të ndahet gradualisht fituesave të numrave qi qëllojnë shpërblimin, gjysma tjetër mbetet në favor t'arkës së Kryqit të Kuq.

Neni 3.

Llotarit e vogla që hiqen nepër kafe si dhe ato që hiqen në vende publike dhe, që sherbejnë ma tepër për defrimin e publikut edhe që nuk marin ngjyren e bixhozit qi asht i ndaluem, këndej e mbas këndej detyrohen me marrë leje prej Zyrës së Kryqit Kuq të vendit, kundrejt një shpërblimi qi do të caktojë Këshilla Administrative e Kryqit të Kuq.

Neni 4.

Kush do qi shet biletat e llotarive të hueja si edhe ato qi vejnë në veprim llotarit e permenduna në nenin 3 pa lejen e Kryqit të Kuq, dënohen prej 100 deri 1000 fr. ari.

Neni 5.

Ata qi denoncojnë shitjen e biletave të ndalueme, si edhe luejtjen e llotarive të vogla, të përmenduna në nenin 3 pa lejen e Kryqit të Kuq, kanë të drejtë të marrin gjysmen e gjobes së vendueme nga Gjykata Penale përkatëse. Gjysma tjetër shkon në favor të Kryqit.

Neni 6.

Ministri i Drejtësis dhe aj i P. të Mbrendëshme, ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligje.

Neni 7.

Kjo Ligjë hynë në fuqi 15 ditë mbas shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 688/5 datë 20-8-934, të Kryeministris; si ndigjojë dhe pëlqej vendimin e Këshillit Ministruer me datë 7-8-934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Shtojcë-Dekret-Ligjës të Ligjit mbi llotarin e Kryqit Kuq me datë 3 Maj 1930.

Durrës, me 11-IX-1930.

ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Mbrendëshme
MUSA JUKA

Nr. 125.

DEKRET-LIGJË, 26 Shtator 1934.

Mbi Organikën e Arësimit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 28 Shtator 1934, Nr. 54)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.

Ministrija e Arsimit, si pjesë e Qeveris Qendrore të Shtetit, âsht e ngarkueme me përhapjen, drejtimin, rregullimin e kontrollimin e arsimit botuer dhe t'edukatës kombtare.

Me përjashtim t'institutevet ushtarake, të gjitha shkolat dhe institutet e mësimit, të punimit e t'edukatës fizike e artistike, çdo lloji qofshin, themelohen dhe administrohen prej saj.

Nën mbikyrjen e saj janë artet e bukura dhe vjetërsinat e vendit, dhe zhvillojnë veprimin e vet shoqnit e institutet e ndryshme sportive, kulturore e letrare.

Neni 2.

Arsimi botuer përfshin: arsimin filluer dhe arsimin e mesëm, të rrregulluem si mbas dispozitave të kësaj ligje.

Neni 3.

I tanë personeli i arsimit asht ekskluzivisht laik dhe i mbajtun me fondet e Ministris s'Arsimit.

PJESA E I.

MINISTRIJA E ARSIMIT

TITULLI I.

Organizim i Ministris

Kaptina e I.

Organet e Ministris

Neni 4.

Autoritetet e mbivume arsimit botuer janë: Ministri i Arsimit e Këshilli Qendruer i Arsimit.

Neni 5.

Ministri i Arsimit:

a) kujdeset, me anë shkollash e institutesh të tjera, për përhapjen e përparimin e edukatës kombtare dhe t'arsimit botuer në të gjitha degët;

b) u njofton organevet arsimore ligjët e rregulloret, tue dhanë udhëzime, kthiellime e urdhna, si mbas rastit.

c) ndryshon ase asgjason veprimet dhe vendimet e autoritetevet të varuna nësa nuk u përshtaten ligjëvet e rregullorevet;

ç) zbaton vendimet e Këshillit Qendruer t'Arsimit;

d) mban letër-shkëmbimin rezerval;

e) mbikqyr privatët nësa veprimi i tyne botuer, i shfaqun me çdo mjet, ka lidhje me edukatën dhe me çdo mësim jashtë shkolluer.

Neni 6.

Këshilli e Qendruer i Arsimit përbahet prej Ministrit, si kryetar. Sekretarit të Përgjithshëm dhe Shefavet të Seksjonevet, si antarë Detyrën e sekretarit të Këshillit e kryen njëni prej këtynve të fundit.

Neni 7.

Këshilli Qendruer i Arsimit merr vendime të preme mbi:

a) emnime, transferime, ndeshkime e pushime arsimtarësh e nëpunsish;

b) hapje e mbyllje shkollash t'arsimit filluer dhe konviktesh;

c) numër të bursavet të mbrendëshme e të jashtme;

ç) premje bursash të mbrendëshme e të jashtme.

Çdo vendim duhet të jetë i shkruem, i arsyetuem dhe i mbështetun në Ligjë.

Neni 8.

Kshilli Qendruer i Arsimit shfaq mendimin, mbas kërkesës së Ministrit, mbi:

a) Ligjë e rregullore arsimore;

b) sisteme e programe shkolore;

c) buxhetin e përgjithshëm të Ministris;

ç) zbatimin e mjetevet mâ të përshtatshme për qëllimet që ndjek Ministrija.

Kaptina e II.

Zyrat Qendrore të Ministris

Neni 9.

Zyrat Qendrore të Ministris janë:

a) Sekretarija e Përgjithshme;

b) Sekcjoni për arsimin filluer e normal;

c) Sekcjoni për arsimin e mesëm,

ç) Sekcjoni për edukatën Komtare «Djelmënija Shqiptare».

Neni 10.

Personeli i Sekretaris së Përgjithshme asht:

Sekretari i Përgjithshëm;

Sekretari i parë;

Llogaritari;

Ndihmës llogaritari

Neni 11.

Detyrët e Sekretaris së Përgjithëshme janë:

a) rregullimi i letër-shkëmbimit të hapët;

b) kontrollimi dhe mbikqyrja e veprimevet dhe e sejlljes së nëpunësvet e të personelit të Ministris;

c) statistika;

ç) protokoli, arkiva, biblioteka e magazina e Ministris;

d) e përkohshmja zyrtare dhe çdo botim tjetër zyrtar i Ministris;

dh) kontratat e ndryshme dhe çdo veprim financjar i Ministris,

e) ruejtja dhe mbikqyrja e pasunive të lanuna prej privatvet për arsimin botuer ase për edukatën komtare, artistike dhe fizike;

ë) ndërtesat shkollore;

f) higjenia shkollore;

g) jetëshkrimi i nëpunësvet dhe i arsimtarvet.

Art. 12.

Personeli i Sekcjonit për arsimin filluer e normal asht:

Shefi i Sekcjonit;

2 sekretarë.

Neni 13.

Detyrët e Sekcjonit për arsimin filluer e normal janë:

a) të gjitha çashtjet dhe veprimet, që u përkasin shkollavet foshnjore, fillore e normale, dhe personelit të tyne;

b) gjithçka u përket konviktevet fillore e normale;

c) të gjitha çashtjet dhe veprimet, që u përkasin kursevet për të rritun, kursevet praktike dhe përgjithësisht përhapjes s'arsimit në popull;

ç) studimi i reformavet n'arsimin filluer e normal, të zbatueme nepër shtetet e qytetnueme.

Neni 14.

Personeli i Sekcjonit për arsimin e mesëm âsht:

Shefi i Seksjonit;

1 arkeolog;

1 sekretar.

Neni 15.

Detyrët e Sekcjonit për arsimin e mesëm janë:

a) të gijtha çashtjet dhe veprimet, që u përkasin shkollave e instituteve t'arsimit të mesëm dhe personelit të tyne:

b) gjithçka u përket bursjervet të jashtëm dhe konviktevet të shkollavet të mesme;

c) mbikqyrja e gërmimeve arkeologjike dhe e monumentave komtarë;

ç) mbledhja e dokumentave historikë;

d) mbikqyrja e rregullimi i veprimit të shoqnive artistike:

dh) mbikqyrja e veprimevet të shoqnivet kulturore e letrare;

e) studimi i reformavet n'arsimin e mesëm të zbatueme nëpër shtetet e qytetnueme;

ë) bibliotekat botore:

Neni 16.

Personeli i Sekcjonit për edukatën komtare «Djelmënija Shqiptare» âsht:

Shefi i Sekcjonit;

1 serketar.

Neni 17.

Detyrët e Sekcjonit për edukatën komtare «Djelmënija Shqiptare» janë:

a) edukata patriotike, morale e fizike, nëpër shkollat e jashtë tyne;

b) mbikqyrja dhe rregullimi i veprimevet të shoqnive sportive.

Neni 18.

Përveç nëpunësvet të përmendun në nenet e sipërm, Ministrija ka: Protokolistin, Arkivistin, Speditorin dhe nji numër të mjaftë kopistash të caktuem me buxhet.

Neni 19.

Detyrët e nëpunësvet të Ministris caktohen hollsisht me Rregulloren.

Kaptina e III.

Cilsit e nëpunësvet të Ministris

Neni 20.

Për t'u emnue nëpunës i Ministris s'Arsimit, përveç cilsive të kërkueme prej Ligjës së nëpunësvet, duhen edhe këto:

a) Sekretari i Përgjithshëm duhet të ketë krye njenën nga shkollat e përmenduna mâ poshtë nën pikat b) e c), ase Fakultetin e Drejtësis;

b) Shefi i Sekcjonit për Arsimin filluer e Normal duhet të ketë krye shkollën e naltë pedagogjike me gradë Universiteti ase fakultetin e filosofis së thjeshtë;

c) Shefi i Sekcjonit për Arsimin e mesëm duhet të ketë krye njenin prej këtyne fakulteteve: filosofik, letrar, shkencuer;

ç) Shefi i Sekcjonit për edukatën kombtare «Djelmënija Shqiptare» duhet të ketë nji titull studimi ma të naltë se âsht ai i shkollës së mesme;

d) Sekretari i parë duhet të ketë krye njenën nga shkollat e përmenduna nën pikat a) b) e c) të këtij neni;

e) Llogaritari duhet të ketë krye mësimet e nji shkolle tregtare me gradë universiteti;

ë) Ndihmës llogaritari duhet të ketë krye mësimet së pakut të nji shkollë të plotë të mesme tregtare;

f) Sekretarët e Ministris duhet të kenë krye rregullisht nji gjimnaz ase nji normale të plotë.

Cilsit e nëpunësvet të tjerë të Ministris caktohen me Rregulloren.

Neni 21.

Personeli, për emnimin e të cilit âsht konditë e domosdoshme kryemja e njij fakulteti universitar ase e njij shkolle të naltë, duhet të vërtetojë se ka krye rregullisht dhe plotësisht edhe mësimet e mesme, të kërkueme prej fakultetit ase shkollës përkatëse.

K a p t i n a e IV.

Masat dishiplinore

Neni 22.

Masat dishiplinore, që u zbatohen nëpunësve të Ministris, kur u shmangen detyrëve, janë ato që caktohen me kët Ligjë.

Nji nëpunësi të Ministris, si masë ndëshkimore, mund t'i zbatohet transferimi në nji vend me rrogë e shkallë mâ t'ultë.

Transferohet ndër qarqe nëpunësi qi nuk mban harmonin me shokët e zyrës, ase që difton prirje ndërhymjeje ndër punët e Ministris në favor të nji privati.

TITULLI II.

Komisjonet e tekstevet

Neni 23.

Për të dhanë gjykimin e fundit mbi pranimin ase përmirësimin e tekstevet shkollore dhe për edukaten komtare, krijohen, me karakter të përkohshëm, pranë Ministris s'Arsimit, dy Komisjone teknike: Komisjoni i parë, për arsimin filluer e normal; Komisjoni i dytë, për arsimin e mesëm. Për tekste, që i përkasin edukatës komtare, fizike e artistike, këto dy Komisjone veprojnë së bashku si nji komisjon.

Këto Komisjone mund të mblidhen dy herë në vjet: prej 16 deri 31 të Kallndorit dhe prej 15 të Korrikut deri 15 të Gushtit.

Antarët e këtyne Komisjonevet zgjidhen prej Ministris s'Arsimit.

Numri i antarvet për secillin Komisjon nuk mund të jetë ma i vogël se tre as mâ i madh se dhetë, si mbas natyrës dhe sasis së dorëshkrimevet ase të tekstevet për t'u shqyrtue.

Nji dorëshkrim nuk mund të gjykohet prej mâ pak se tre vetve.

Me nji urdhën të Ministrit, këtyne Komisjoneve mund t'u shtohen nji ase mâ shumë nëpunës të Ministris.

Mënyra e veprimit të këtyre komisjoneve caktohen me Rregulloren.

PJESA E II.

ARSIMI FILLUER

Neni 24.

Arsimi filluer ka për qëllim të rrisi fëmijt me dishiplinë, moral e shpirt kombtar, t'u zhvillojë fuqit trupore e shpirtnore e t'i pajisi me njohunit e aftësit e nevojshme për jetën praktike, në mënyrë që të bahen njerz të mirë e antarë të dobishëm për shoqnin kombtare.

Neni 25.

Arsimi filluer jepet në: shkolla foshnjore e shkolla fillore.

N'arsimin filluer hyjnë dhe institutet për arsimin e popullit.

Neni 26.

Arsimi filluer jepet falas dhe âsht i detyrshëm si mbas përshkrimeve të kësaj Ligje.

Neni 27.

Çdo veprim, kërkese, akt, dëftesë ase dëshmi, që i përkasin arsimit filluer, janë të liruem prej çdo pagese ase takse.

TITULLI I.

Detyrim shkolluer

Neni 28.

Arsimi filluer âsht i detyrshëm për të gjithë fëmijt, mashkuj e femna, të shtetasve Shqiptarë, prej moshës katër e deri trembëdhetë vjetësh:

prej moshës katër të mbushuna e deri gjashtë: në shkollat foshnjore;

prej moshës gjashtë të mbushuna e përtej: në shkollat fillore.

Nëpër shkollat e katundeve detyrimi shkolluer nis me shkollen fillore, kur fëmijt kanë mbushë shtatë vjet.

Nnxanësi, që gjatë vjetit shkolluer, mbush trembëdhetë vjet, detyrohet me e ndjekë at klasë deri në mbarim t'atij vjeti.

Neni 29.

Për përmbushjen e detyrimit shkolluer të fëmijvet janë përgjegjës, për çdo efekt ligjuer: prindët, kujdestarët e fëmijvet si

si edhe ata, që kanë nën mbikqyrje e kujdesje fëmij jetima, shtetas Shqiptarë.

Përjashtohen prej këtij detyrimi:

a) fëmijt e atyne prindve e kujdestarve që nuk kanë banim të qëndrueshëm; me gjith ket, kur qindrojnë në nji vend të paktën dy muej, i shtrohen pa tjetër detyrimit shkolluer;

b) fëmijt e atyne prindve e kujdestarve ligjorë që familjarisht jetojnë jashtë Shtetit;

c) fëmijt që kanë ndonji gjymtim fizik a menduer, kur në vend banimin e tyne nuk gjinden institute fillore veçanërisht të ngrehuna për ta;

ç) fëmijt që vuejnë prej ndonji sëmundjeje ngjitëse të pa sherueshme.

Neni 30.

Fëmijt shëndetliq ase jo mirë të zhvilluem mendësisht, por t'edukueshëm, lejohen të fillojnë detyrimin shkolluer me nji moshë ma të shtyme se ajo e parapame në nenin 28, por nuk mund të mbahen në shkollë përtej moshës pesëmbëdhetë vjeçare.

Ky përjashtim vehet në zbatim vetëm me pëlqim të Ministris mbi propozim t'Ispektoris s'Arsimit.

Neni 31.

Çdo përjashtim prej detyrimit shkolluer si edhe çdo vonesë për fillimin e tij, të bamë jashtë konditavet të nenit 29 e 30, janë të pa ligjshëm. Mbas kërkesës s'organvet t'arsimit, fatjori ndeshkohet me gjobë prej 20 deri 50 fr. ari.

Neni 32.

Secili Komisjon shkolluer kujdeset për zbatimin e detyrimit arsimuer në rrethin e vet në ket mënyrë:

Në muejin maj të çdo vjeti Kryetari i Komisjonit shkolluer detyrohet me ba gati, me anë të Zyrës së Gjendjes Civile, dy lista emnore të fëmijvet që janë në moshën e detyrimit shkolluer; njena duhet të përmbajë emnat e fëmijvet, që, n'at vjet mbushin moshen 4 dhe 5 vjetësh; tjetra emnat e atyne që, po n'at vjet e mbushin moshën prej 6 deri 13 vjetësh.

Për shkollat e katundeve nxiret vetëm lista emnore e fëmijvet që n'at vjet mbushin moshen 7 vjetësh.

Nga nji kopje e këtyne listave ase e kësaj liste u dërgohet deri me 5 Qershuer Inspektoris s'Arsimit të Qarkut, Bashkivet, Komu-

nevet dhe shkollavet përkatëse. Kryetarët e Bashkivet dhe të Komuneve qysh me 15 Gusht detyrohen t'i shpallin popullit listat e marruna dhe të njoftojnë, me mjetet dhe organet e zakonshme, nji nga nji t'interesuemit, që në ditët 1 deri 5 të Shtatorit, duhet të nenshkruejnë fëmijt në shkollën, që âsht mâ afër banimit të tyne. Veç kësaj, shpallja përkatëse do të mbahet në derën e Bashkis ase të Komunes deri me 31 Gusht.

Ministrija e Arsimit, mbrenda muejit Maj, do t'u njoftojë Inspektorivet t'Arsimit vendet e qarkut në të cilat në vjetin e ardhshëm shkolluer do të jetë i mundun zbatimi i detyrimit të mësimit foshnjuer.

Neni 33.

Drejori i shkollës ase mësuesi në kohën prej 6 deri 8 të Shtatorit ban listen e atyne prindve a kujdestarve, që nuk i kanë nenshkrue fëmijt n'afatin e caktuem, dhe, deri me 10 t'atij mueji, i a paraqet Komisjonit shkolluer e Inspektoris s'Arsimit.

Kryetari i Komisjonit shkolluer n'afatin e 3 ditvet i lajmon prindët ase kujdestarët që t'i binden Ligjës.

Në qoftë se mbrenda nji jave këta nuk paraqiten për me justifikue me arsye shëndeti ase pengimesh të randa mungesën e fëmijve, ase nuk i nëshkruejnë në shkollë në ket kohë e sipër, Këshilli ndeshkon prindin ase kujdestarin me gjobë prej 5 fr. ari për çdo fëmij, të lanun pa nënshkrue, dhe urdhnon Drejtorin ase Mësuesin e shkollës të bajë nëshkrimin kryesisht.

Në qoftë se në nji vend veprojnë mâ shumë shkolla t'arsimit fillluer, Drejtorët e tyne, mbas njij kontrollimi të përbashkët të të nënshkruemvet në të gjitha shkollat e vendit, autorizojnë njenin nder ta të bajë, për të gjithë, veprimin e thanun në kryereshtin e parë të këtij neni, tue u ndihmue prej mësuesvet.

Neni 34.

Gjatë zhvillimit të mësimevet Drejtorët e shkollavet t'arsimit filluer dhe trupi mësimuer i këtyneve, detyrohen të shenojnë ditë për ditë në nji rregjister të posaçëm emnat e nxanësvet që mungojnë dhe arsyen e mungesës.

Prindët a kujdestarët munden me justifikue mungesat e fëmijvet nga mësimi në ket mënyrë:

a) për mungesë të vazhdueshme deri tri dit, justifikimi paraqitet n'afatin e dy ditve mbas të mbrames ditë të mungesës;

b) për mungesë të vazhdueshme përtej tri ditvet, justifikimi

paraqitet ditën e katërt ase të pestë dhe, mundësisht, thuhet se sa mund të vazhdojë mungesa.

Mungesat liogariten me gjysëm dite, cilido qoft numri i mësimeve të bame në gjysmen e ditës.

Tri vonesa të pa arsyeshme mbrenda nji jave llogariten për nji mungesë.

Neni 35.

Mungesa t'arsyeshme quhen: 1. sëmundja e nxanësit, 2. sëmundja e randë në familje të nxânësit, 3. sëmundja ngjitëse ase vdekje në familje, 4. pengimi i shkaktuem prej vështirsis së komunikacjonit.

Në qoftë se prindët ase kujdestarët e nxanësvet paraqesin shkaqe të tjera për justifikim, pranimi ase jo i këtyneve gjykohet prej Drejtoris së shokllës, e cila në këto raste ka me zanë, gjatë njij vjeti shkolluer, si t'arsyeshme të shumtën:

a) 60 mungesa për fëmijt e shkollës foshnjore;

b) 30 mungesa për fëmijt klasës së I-rë, e 20 mungesa për ata të klasëve të tjera të shkollës fillore.

Neni 36.

Në rast se prindët ase kujdestarët paraqesin, per justifikim të mungesës së fëmijvet të vet nga mësimi, shkaqe të pa-qena. ndeshkohen prej Komisjonit shkolluer me gjobë prej 5 fr. ari përveç gjobave të vume për mungesat e pa-arsyeshme, si mbas nenit 38.

Neni 37.

Të gjitha gjobat, q'u zbatohen prindvet a kujdestarvet të fëmijvet për shkak të shmangunit prej detyrimit shkolluer, shqyptohen, krye çdo 15 ditvet, nga Komisjoni shkolluer.

Neni 38.

Massi të fillojnë mësimet e rregullshme, Drejtori, Kryemësuesi i shkollës, krye çdo 15 ditve, i dërgon Komisjonit shkolluer listën e nxanësvet që, pa arsye, kanë ba deri 4 mungesa tue caktue edhe numrin e mungesavet.

Komisjoni shkolluer pa vonesë vepron në ket mënyrë:

Herën e parë i thrret prindët ase kujdestarët e këtyne fëmijve dhe u njofton se do të gjobiten në qoftë se nuk do t'i dërgojnë rregullisht fëmijt në shkollë.

Herën e dytë shqypton gjoben prej fr. ari 0.50 për çdo munge-

së të pa-arsyeshme. Përmbarimi i kësaj gjobe pezullohet deri në nji mungesë të ré të pa-arsyeshme, të bame gjatë atij vjeti shkolluer, në të cilin rast përmbarohet bashkë me gjobën e ré.

Herën e tretë gjoba asht 1 fr. ari për çdo mungesë të pa-arsyeshme, dhe përmbarohet me nji herë bashkë me gjobën e herës së dytë. Për çdo përsëritje tjetër mbas ksaj, gjoba për nji mungesë do të rritet nga 1 fr. ari mbi gjobën e përparshme, deri në nji maksimum prej 4 fr. ari për çdo mungesë.

Neni 39.

Organet policore të vendit ase të Shtetit janë të detyrueme me i përcjellë në shkollë fëmijt, që janë në moshen e detyrimit shkolluer dhe që shifen tue bredhë nepër rrugë ase jashtë, gjatë kohës së mësimit.

Në qoftë se nuk janë nëshkruem, u merren emnat dhe i njoftohen Komisjonit shkolluer, i cili i ndëshkon prindët a kujdestarët si mbas nenevet 33 e 38.

Neni 40.

Mbledhja e gjobavet të vume prej Komisjonit shkolluer, i ngarkohet policis ase gjindarmeris së vendit, e cila, posa të mbledhi të hollat, i a dorëzon Kryetarit të Komisjonit shkolluer ase raporton pamundësin e mbledhjes. Në qoftë se prindët ase kujdestarët nuk ndigjojnë me i pague gjobat, Komisjoni shkolluer vendimin e vet i a referon Prokuroris, dhe, ku nuk ka të tillë, gjyqtarit Paqtues, ase Kryetarit të Komunës, i cili mundet me e kthye gjoben në burgim, si mbas dispoiztave të Ligjëve ndeshkimore, por jo ma tepër se 5 dit në muej.

Burgimi mund të zbatohet, gjithnji mbas kërkesës së Komisjonit shoklluer, edhe kur shifet se gjobimi nuk ban efektin e dëshiruem.

Gjobat mblidhen vetem me anë dëftesash të veçanta, të shtypuna prej Ministris s'Arsimit.

Gjobat e mbledhuna përdoren prej Komisjonit shkolluer për këto nevojë: 1) për mjete, vegla e bibiloteka shkollore; 2) për libra e për tjera mjete mësimi për nxanësit e vobektë, ku nuk veprojnë patronazhet shkollore.

Komisjonet shokllore, në fund të çdo tremuejshi, i dërgojnë Inspetkoris s'Arsimit listat e gjobave të vume, të nxjerruna dhe diftojnë përdorimin e këtyne.

Neni 41.

Komisjoni shkolluer mundet me i kthye gjobat në punim të detyrshëm për krijimin ase përmirësimin e kopshteve shkollore dhe të fushave sportive; në rast se nuk shfaqet nevoja për të tilla punime, këto gjoba kthehen në punim të detyrshëm për punë botore.

Nji ditë pune llogaritet për dy fr. ari të gjobës.

Neni 42.

Drejtori, kryemësuesi ase Mësuesi i shkollës, që nuk vepron pikërisht simbas dispozitavet të nenevet 33, 34 e 38 ase, gjykon me butësi shpordoruese shkaqet e parashtrueme prej prindve ase kujdestarve për justifikim të mungesavet të parapame në nenin 35, ndeshkohet shkallë shkallë gjatë njij vjeti shkolluer, prej Ministrisë s'Arsimit me: qortim të shkruem; premje rroge 10 ditë, deri dy herë; pezullim nga detyra e rroga prej njij deri dy muej; pushim nga puna.

Kundra Kryetarit të Komisjonit shkolluer, që nuk i njofton me njiherë Inspektoris së qarkut ase Ministris s'Arsimit pa kujdesin e Drejtorit, të Kryemësuesit ase të mësuesit, në veprimet e urdhnueme me nenet e nalt-tregueme, zbatohen masa disiplinore si mbas rastit.

Neni 43.

Mbas kerkesës së Ministris s'Arsimit, Komisjoni shkolluer, që nuk kujdeset për vumjen e gjobave të parapame në nenet e mapërëshme, detyrohet me pague ai vetë shumën qi do t'u ngarkohej prindvet ase kujdestarvet.

Po ky ndeshkim i zbatohet Kryetarit të Komisjonit shkolluer që, pa ndonji shkak t'arsyeshëm, i len pa zbatue përtej njij mueji vendimet e Komisjonit mbi gjobat e caktueme.

Neni 44

Kundra organevet, të përmenduna në nenin 40, që nuk i përmbajnë mbarojnë vendimet e Komisjonit shkolluer n'afatin e 10 ditëvet, ase nuk vërtetojnë pamundësin e përmbarimit, veprohet prej autoriteteve përkatëse mbas kërkesës së Kryetarit të Komisjonit shkolluer. Përveç ndëshkimit në të holla, që nuk mund të jetë kurr ma i vogël se asht gjoba e pa përmbarueme, mund të ndeshkohen si mbas rastit, edhe me masa të tjera dishiplinore.

Neni 45.

Inspektorët e Arsimit detyrohen me kontrollue zbatimin e mirë të dispozitavet mbi detyrimin shkolluer. Në rast se konstatojnë mos zbatimin e tyne nga ana e Mësuesve, Drejtorëve a të Komisjoneve shkollore, njoftojnë me nji herë, si mbas rastit, Këshillin ársimuer ase Ministrin.

Neni 46.

Detyrimi shkolluer, sikurse asht caktue në ket ligë, zbatohet plotësisht në nji vend kur të vërtetohet prej Ministris se ndërtesa për shkollë dhe personeli mësimuer mjaftojnë për nxansit që janë në moshën shkollore.

Neni 47.

Prindët detyrohen me i pajisë fëmijt e vet me libra e landë të tjera të nevojshme për shkollë. Në mos e bafshin ket, fëmijt e tyne do të merren si me bâm mungesa të pa-arsyeshme. Në ket rast prindët kanë me u këshillue mâ parë, e pastaj kanë me u gjobitë, si mbas nenit 38.

Për fëmijt e prindvet të vobekë, vobeksija e të cilvet vërtetohet me dishmi të lëshueme prej Bashkis ase Komunës, kanë me u kujdesë Komisjonet ase Patronazhet shkollore për me u falë mjetet e nevojshme të mësimit.

TITULLI II.

Rregullimi didaktik e Administrativ i Instituteve t'Arsimit Fillucr

Kaptina e I.

Shkollat foshnjore

Neni 48.

Shkollat foshnjore janë të rregullueme në mënyrë që të lehtësojnë zhvillimin trupuer e menduer të fëmijës dhe t'a gatisin për mësimin e shkollës fillore.

Neni 49

Shkollat foshnjore janë të përzieme. Në to hyjnë fëmij prej tri ase katër vjetësh dhe vazhdojnë deri më 6 vjetësh plot, por ndjekja nuk asht e detyrëshme për moshën tri vjeçare.

Neni 50.

Mësimet në foshnjoret kanë karakter zbavitës.

Programa e tyne përmbledh:

a) ushtrime për me trajtue zakonet e para morale;

b) intuitë mbi të gjitha sendet që janë mâ afër jetës së foshnjes; me anë bisedimesh të përshtatëshme;

c) kallzime, vjersha të lehta, kangë, lodra gjimnastikore e lëvizje të përcjelluna me kangë;

ç) ushtrime të lehta punë-dore të ndryshme, si mbas moshës, vizatim i lirë, ushtrime për shtjellimin e ndijave, shetitje shkollore.

Neni 51.

Vjeti shkolluer vijon për 42 javë, me 20 deri me 24 orë mësimi në javë.

Në verë shkollat foshnjore konë dy gjysma dite pushim në javë.

Neni 52.

Shkollat foshnjore do të çilen nëpër qytete, ku të shifet ma shumë nevojë dhe ku numri i foshnjeve kapërxen 40.

Shteti merr përsipër vetëm personelin mësimuer.

Për sa u përket ndërtesave të nevojshme, mbajtjes dhe pajisjes së tyne me orendi e mjete mësimore, zjarmit e dritës, shpërblimit të mësuesve, zbatohen, edhe për foshnjoret, dispozitat e parapame për shkollat fillore.

Shkollat foshnjore, përveç sallave të klasës, do të kenë edhe nji sallë të madhe veç, nji oborr për defrim edhe nji tokë, sa do të vogël, për nji kopësht me lule e pemë.

Neni 53.

Shkollat foshnjore munden me pasë salla klase edhe me qenë në nji ndërtesë të fillores, por me kondità që të kenë nji oborr edhe nji hymje të veçantë. .

Në nji rast të tillë drejtimi i shkollës do t'i ngarkohet mësueses përkatëse..

Neni 54.

Mësimi dhe rregullimi i këtyne shkollave do t'u ngarkohet mësueseve, mundësisht atyneve që kanë aftësin e duhun për në foshnjore.

Neni 55.

Konditat, përsa i përket emnimit të personelit, të drejtave edhe detyrave të tyne, janë po ato të trupit arsimuer për shkollat fillore.

Neni 56.

Mënyra e funksjonimit e plani i shkoqitun i mësimit kanë me u caktue me Rregullore të veçantë.

Kaptina e II.
Shkollat Fillore

§ 1. PROGRAMA

Neni 57.

Shkolla fillore âsht për të gjithë fëmijt e shtetasvet Shqiptarë dhe përban themelin e të gjitha shkallëve të mësimit.

Neni 58.

Shkolla fillore ka pesë klasë ase vejtë mësimi.

Tri vjetët e para përbajnë periudhën e ulët dhe dy vjetët e fundit periudhën e naltë të shkollës fillore.

Neni 59.

Në shkollën fillore mësohen këto landë:

1) Njohuni morale e qytetare;

2) gjuhë shqipe (këndim, shkrim, drejtshkrim, diktat, hartim, gramatikë);

3) Arithmetikë dhe elemente të gjeometris;

4) Histori kombtare, gjografi;

5) mësime sendesh dhe elemente të shkencavet; njohuni mbi higjenën;

6) vizatim e bukurshkrim;

7) kangë;

8) punë dore;

9) lojna e edukatë fizike.

Në shkollat e vajzavet, qysh prej klasës së tretë, shtohen punët e gjylpanës dhe ekonomija shtëpijake; shkollat rurale për djelm shtohen punët bujqësore praktike tue fillue me klasën e katërtë.

Neni 60.

Programet e oraret e mësimeve si dhe instruksionet e duhuna për mësimin e landëve të ndryshme caktohen prej Ministris.

§ 2 THEMELIMI I SHKOLLAVE FILLORE

Neni 61.

Në çdo qytet themelohen aq shkolla fillore sa të mjaftojnë me

u dhanë mësimin filluer të gjithë fëmijve të të gjitha lagjeve.

Në çdo katund, me komunikim të lehtë shtëpijash, do të çilet nji shkollë në qoftë se nxier të patkën 30 fëmijë në moshë shkollore.

Në rast se dy a mâ shumë katunde janë afër deri 3 km. ndërmjet të tyne dhe kanë lehtësi komunikacjoni, themelohet nji shkollë e përbashkët, qendra e së cilës caktohet prej autoritetevet arsimore.

N'ato katunde, që nuk kanë shkolla në rrethin e 3 k.m. dhe nuk nxjerrin të patkën 30 fëmijê ase në vende me popullsi të shpërndame, mund të themelohen stacjone shkolore dhe shkolla me mësues shetitës.

Neni 62.

Stacjonet shkollore çilen në vende që janë afër shkollave të rregullta dhe në to ban mësim për tri herë në javë, nga gjysëm dite, mësuesi i shkollës së rregulltë ma të afërme.

Shkollat me mësues shetitës çilen në vende ku, nga shkaku i largësis, nuk mund të themelohet stasjon shkolluer.

Çdo mësuesi shoklle të rregulltë nuk mund t'i ngarkohet ma se nji stacjon shkolluer.

Çdo mësues shetitës mund të ngarkohet deri me tri shkolla.

Mësuesi qi sherben në nji stacjon shkolluer merr shpërblimin e parapamë me nenin 147. Mjetet e vajtje-ardhjes i sigurohen prej banorëve të stacjonit shkolluer.

Mënyra e veprimit të stacjoneve shkollore dhe të shkolave me mësues shetitës, si edhe programa e mësimeve të tyne, caktohet me Rregulloren.

Neni 63.

Në viset malsore, ku mungojnë konditat e mbara për çeljen e shkollave fillore, mund të themelohen internate me shkolla fillore përmbrenda, në të cilat pranohen fëmij të vobekë me bursë të Shtetit, si mbas dispozitave të kësaj Ligje.

§ 3. VEPRIMI DHE RREGULLIMI I SHKOLLAVE FILLORE

Neni 64.

Nji shkollë filolre, që ka 30 deri 60 nxanës ka nji mësues. Në qoftë se numri i tyne përfshihet midis 60 dhe 120, shtohet dhe nji mësues i dytë. Prej 120 e deri 160 nxanës shkolla ka tre mësues dhe për çdo 50 nxanës të tejrë nga nji mësues mâ tepër.

BKSH

Neni 65.

Rregullisht kur dy ase mâ shum klasë, kanë deri 60 nxânës mund të mblidhen së bashku në nji dhomë mësimi me nji mësues të vetëm.

Neni 66.

Në shkolla, sidomos të katundeve, ku numri i nxânësve kapërcen rregulisht 60, ase ku nji dhomë nuk i përmbledh të gijthë nxanësit që e ndjekin shkollën dhe konditat nuk lejojnë emnimin e njij mësuesi të dytë, mund të zbatohet sistema e mësimit gjysëm dite, tue i ndamë nxânësit në dy grupe mbas afrimit të klasëve. Në ket rasë të dy grupet i ngarkohen nji mësuesi të vetëm në orar të veçantë me nga 3 orë mësimi të paktën në ditë për çdo grup.

Me ket sistemë për nji mësues mund të llogariten deri 100 nxânës të shumtën.

Rregullimi i shkollave me mësime gjysëm dite caktohet në Rregullore.

Neni 67.

Çdo klasë e ré hapet vetëm me autorizim të Ministris mbi proponimin e Inspektorive t'Arsimit.

Neni 68.

Shkollat fillore janë veçan për djelm e veçan për vajza. Por kur e ku do t'a kërkojë nevoja mund të jenë edhe të përzieme.

Neni 69.

Në shkollat e përzieme me nji mësues, ky preferisht ka me qenë burrë.

Në shkollat e përzieme me shumë mësues, të paktën nji ka me qenë grue, e cila ka për të mësue dhe punën e dorës.

Në shkollat mashkullore mësuesit rregullisht do të jenë burra; në klasët e ulta mund të jenë edhe gra, por këto s'duhet të kapërxejnë 1/3 të personelit.

Në shkollat femnore i tanë personeli mësimuer mundësisht duhet të përbahet prej mësuesesh.

Neni 70.

Drejtues përgejgjës i shkollës fillore me nji mësues âsht mëvetë; me 2 deri 4 mësues, pa marrë parasysh numrin e klasëvet, kryemësuesi; me 5 ase mâ shumë mësues dhe kursin e plotë filluer Drejtori.

Drejtimi i shokllave të përzieme dhe i shkollave mashkullore i

ngarkohet nji mësuesi; ai i shkollave femnore mundësisht nji mësueseje.

Neni 71

Në shkollën fillore rregullisht të gjitha landët e mësimit të secilës klasë do të mësohen vetëm prej nji mësuesi.

Neni 72.

Për nxanës, që nuk janë të dishiplinuem dhe që mund të trazojnë mbarëvajtjen e mësimit, dhe për nxanës anormalë ase të dobët mendësisht, mund të krijohen klasa të posaçme me mësues të veçantë.

Neni 73.

Çdo shkollë fillore duhet të ketë pranë saj, ase mâ afër që të jetë e mundun, nji kopësht, që do të sherbejë për prova e zbatime mësimesh.

Në shkollat fillore rurale kopshti ka me qenë mâ i gjanë, ase ka me u sigurue nji copë tokë e veçantë për praktiken bujqësore të parashikueme prej programës.

§ 4. NËNËSHKRIMET E VJETIT SHKOLLUER

Neni 74.

Fëmiljt nënshkruhen në shkollë, përveç kur ndodh që shpërngulen prindët, vetëm në fillim të vjetit shkolluer.

Autoritetet shkollore të vendit munden me dhanë leje për me u nënshkrue ndonji nxanës, në rast nevoje, deri në fund të tremuejshit të parë të mësimeve.

Neni 75.

Çdo nxânës, që nënshkruhet së pari në shokllë, duhet të paraqesi nji dëshmi mjeksore mbi gjendjen e tij shëndetsore si edhe mbi të shenuemit a jo të lîs.

Neni 76.

Koha e mësimeve të vejtit shkolluer zgjat rregullisht 10 muej. Ditët e mësimit duhet të mos jenë mâ pak se 200.

Nënshkrimet fillojnë me 1 Shtatuer dhe mësimet me rregull në mes të tij.

Pushimet e mëdha zgjasin 2 muej. Gjatë kohës së mësimeve shkollat fillore kanë gjysëm dite pushim në javë, përveç ditëve të tjera të njoftuna si pushime zyrtare e shkollore, që caktohen veçanërisht në Rregulloren.

Neni 77.

Në shkollat e vendeve malsore, për arsye stine, koha e pushimeve të mëdha mund të ndryshohet.

Në katunde, ku nxanësit për nevojë të punëve bujqësore ase blegtorije të vendit, e lânë zakonisht shkollën për nji pjesë të vjetit, koha e mësimeve mund të ndryshohet si në rastin e parapam në kryrreshtin e sipërm, ase muejt e mësimit mund të paksohen, por numri i përgjithshëm i mësimeve duhet të jetë baras me 200 ditë mësimi.

Inspektori i Arsimit, në mbështetje të këtij neni, cakton, qysh para fillimit të vejtit, se për cilat shkolla nga të qarkut të vet âsht nevoja me e ndryshue kohën e pushimeve dhe për cilat me paksue muejt e mësimit, tue përpilue nji-kohësisht kalendarin shkolluer dhe orarin e tyne të posaçëm, që i komunikohen Ministris për pëlqim.

Inspektori, në përshtatjen e orareve me nevojët e vendit, mund të përdorë të gijtha ditët e javës si ditë pune, pa pushimn e gjysëm ditë të parapame në kryrresshtin e fundit të nenit 76.

§ 5. KLASIFIKIMI, KALIMI DHE PROVIMET

Neni 78.

Për punë të klasifikimit të nxanësvet koha e mësimeve të vjetit shkolluer ndahet në tremuejsh. Kalimi ase po i klasës, me përjashtim të klasës së pestë, varet prej përfundimit vjetuer të përparimit e të sjelljes së nxanësit, të çfaqun me nota.

Neni 79.

Notat që përdoren janë këto:

a)' për përparim:

shumë mirë: 1;
mirë 2;
kalueshëm: 3;
dobët: 4.

b) për sjellje:

shëmbëllore: 1;
e urtë: 2;
e durueshme: 3;
e keqe: 4,

BKSh

Për veç kësaj nxânësit klasifikohen edhe:

c) nga kujdesi, me këto nota:

i lavdueshëm:	1;
i mirë:	2;
i mjaftë:	3;
i pakët:	4;

ç) nga pastrija, me këto nota:

shëmbëllore:	1;
e pëlqyeshme:	2;
e mjaftë:	3;
e metë:	4.

Nota e kujdesit mund të merert parasysh në rast të posaçëm në përfundimin vjetuer të përparimit; ajo e pastris meret parasysh gjithnji në caktimin e notës së sejlljes.

Neni 80.

Kalojnë në klasën mâ të naltë nxanësit që, në përfundimin vjetuer, marrin në çdo landë mësimi të patkën notë përparimi «kalueshëm» dhe në sjellje notë «e durueshme».

Nxanësit e klasës së tretë e të katërtë, të cilët marrin në përfundimin vjetuer notën «dobët» në nji ase dy landë lejohen me iu shtrue provimit në atë ase në ato landë në kohën e nënshkrimeve, në fillim të vjetit të ri shkolluer.

Nxanësit, të cilët, në përfundimin vjetuer, marrin, në mâ se dy landë, notën «dobët» ase nuk fitojnë në provën e vjeshtës, përsrrisin klasën.

Nxanësit, që kanë në sejllje notën «e keqe» si dhe ata që kanë bâ mâ se 150 mungesa gjatë vjetit shkolluer, ase kanë mungue gjith tremuejshin e fundit, nuk mund të kalojnë pa provim, por duhet të provohen në të gjitha landët e mësimit në kohën e caktueme në kryerreshtin e dytë.

Nxanësit e klasës së parë e të dytë nuk kanë provime vjeshtore dhe, përsërisin klasën në rast se nga përparimi i përgjithshëm vjetuer nuk gjykohen të pjekun për klasën mâ të naltë.

Rregullisht nxanësit që mbesin për dy vjet në nji klasë transferohen në klasën mâ të naltë.

Neni 81.

Jashtëzakonisht, nxanësit që kanë kapërcye moshën mesatore të klasës në të cilën gjinden mund të kalojnë, mbas tremuejshit të

parë, në klasën mâ të naltë, po qe se kanë tregue, me anën e punës dhe të zotsis së tyne, se janë t'aftë me e ndjekë mësimin e kësaj klase. Nuk përfitojnë nga këjo dispozitë nxanësit e klasës së katërtë.

Neni 82.

Në fund të klasës së pesët nxanësit, të cilët kanë marrë të paknotën «e durueshme» në sjellje i shtrohen nji provimi para njij komisjoni për të fitue diftesën e lirimit prej detyrimit shkolluer.

Diftesa e lirimit u lëshohet vetëm atyne nxanësve që kanë marrë në të gjitha landët e provimit të lirimit së paku notën «kalueshëm».

Dëftesa e lirimit u jep të drejtë nxanësve që të hyjnë në degët e ndryshme t'arsimit mbifilluer.

Neni 83.

Vjet për vjet çdo nxânës merr nji librezë shkollore, në të cilën shenohen ndjekja e shkollës, përparimi, sjellja, kujdesi dhe pastrija gjatë vjetit shkolluer.

Neni 84.

Libreza shkollore, e mbushun dhe e nënshkrueme rregullisht. vlen për çdo efekt ligjuer.

Neni 85.

Hollsit mbi mënyrën e klasifikimit, mbi provimet e lirimit dhe mbi formimin e komisjoneve, caktohen në Rregulloren.

§ 6. NDESHKIMET DISHIPLINORE

Neni 86.

Kundrejt nxanësve që u mungojnë detyrave të tyne, përdoren. mbas rëndësis së fajit dhe moshës, masa ndeshkimore të përshtatëshme.

Masat ndëshkimore si edhe rregullat dishiplinore mbrenda e jashtë shkollës, caktohen hollësisht në Rregulloren.

Neni 87.

Ndeshkimi ma i randë âsht dbimi i nxanësit nga shkolla për vjetin shkalluer n'udhtim me përsëritje të klasës.

Neni 88.

Në rasë se fajet e njij nxanësi janë tepër të randa sa që ndej-

tja e tij në shkollë gjykohet e rrezikshme për moralin e fëmijve, ase aktet e pa-disiplinueme e të vazhdushme të tija rrjedhin prej anormalitetesh psikike, jashtëzakonisht mund të vendoset prjashtimi definitiv i tij nga shkolla.

Neni 89.

Masat e parapame në nenet 87 e 88 zbatohet vetëm me pëlqim të Ministris.

Neni 90.

Prindi ase çdo person tjetër që, mbrenda lokaleve shkollore, i drejton mësuesit qortime ase nxjerr, pa autorizim, nga shkolla nji nxanës, ndeshkohet prej Këshillit arsimuer, mbi proponim të Komisionit shkolluer, për herën e parë me gjobë prej 20 deri 30 fr. ari, e në rast përsëritjeje gjoba asht prej 50 deri 75 fr. ari, pa varsisht nga ndeshkimet e parapame në Kodin Penal.

Për nxjerrjen dhe përdorimin e kësaj gjobe zbatohen dispozitat e titullit II mbi detyrimin shkolluer.

Prindët dhe kujdestarët e fëmijve për çdo ankim, që mund të kenë kundra mësuesit, duhet t'u drejtohen autoritetevet arsimore.

TITULLI III.

Gjendja e juridike e mësuësvet

Kaptina e I.

Klasifikimi dhe emnimi i mësuësvet

Neni 91.

Trupi mësimuer i arsimit filluer përbahet prej:

a) mësuesisht të përkohshëm;

b) mësuesish definitivë.

Neni 92.

Janë mësues të përkohshëm:

1) ata që kanë krye nji shkollë normale dhe nuk e kanë dhanë provimin e stazhit;

2) të gjithë mësuesit e tjerë t'emnuem para hymjes në fuqi të kësaj Ligje, të cilët nuk u janë shtrue dispozitave të parashikueme prej Ligjës së kategorizimit d. 12-IV-1926, dhe shtojcave të saja me d. 14-V-1928, e 3-IV-1929, për sa i përket provimit t'aftësis pedagogjike.

BKSh

Neni 93.

Janë definitive:

1) ata që kanë krye nji shkollë normale dhe kanë kalue provimin e stazhit;

2) ata që kanë krye nji shkollë normale të perendimit dhe gjinden në sherbim para hymjes në fuqi të kësaj Ligje;

3) të gjithë ata që kanë plotsue konditat e parashikueme prej Ligjës e Shtojcave të saj, të përmendun në paragrafin e II të nenit të sipërme.

Neni 94.

Provimi i stazhit asht i detyrshem për të gjithë mësuesit e përkohshëm që kanë krye nji shkollë normale, dhe jepet mbas dy vjetve shërbimi efektiv.

Ata që, në ket kohë, nuk paraqiten në kët provim, pa nji arsye të randë, të pranueme prej Ministris, ase rrëzohen humbasin 10 fr. ari nga rroga bazë e tyne; ata që, mbas vjetit të tretë të shërbimit, nuk janë paraqitë ase rrëzohen përsëri, humbasin edhe 10 fr. ari nga rroga, dhe mund të mbesin në shërbim me rrogën e zbritun: koha për llogaritjen e shtesave fillon nga kjo datë. Provimi i stazhit nuk mund të jepet ma tepër se dy herë.

Puna e provimit të aftësis pedagogjike për mësuesit e përkohëshëm të pikës 2 të nenit 92 rregullohet prej pikës 6 të nenit 439.

Neni 95.

Të gjithë mësuesit e përkohshëm, që kapërcejnë provimin e stazhit ase t'aftësis pedagogjike, klasifikohen edhe dekretohen mësues definitivë, tue fitue njikohsisht të gjitha të drejtat që gëzojnë këta.

Neni 96.

Mbas hymjes në fuqi të kësaj Ligje do të emnohen mësues:

1) ata që kanë krye nji shkollë normale;

2) ata gjimnazistë e liceistë me diplomë, që kanë ba nji kurs pedagogjik dhe kanë fitue dëftesën e pjekunis së shkollës normale për mësuesi.

Neni 97.

Në qoftë se për nji vend mësuesi paraqiten ma tepër se nji kandidat, do t'emnohet ai që ka notat ma të mira në diplomë. Në rasë se gjinden në kondita të barabarta, bahet konkurs. Mënyra e konkursit caktohet në Rregulloren.

Neni 98.

Ata normalistë, që, mbrenda katër vjetve nga dita e kryemjes së mësimeve, nuk hyjnë në mësuesi, për t'u emnue mbas këtij afati, duhet t'i shtrohen përsëri provimit të pjekunis.

Neni 99.

Kryemësues emnohen ata mësues definitivë, që janë me stazhë dhe kanë të paktën 3 vjet shërbim efektiv. Në rasë nevoje këta mund t'emnohen edhe zavendës Drejtorë.

Neni 100.

Drejtorë emnohen mësuesit definitivë, që përmenden nen pikat 1 e 2 të nenit 93, mbas nji shërbimi 5 vjetësh si mësues dhe 2 vjetësh si Kryemësues.

Ndër dy ase ma shumë kandidatë me tituj studimi të barabrtë për Drejtuer, do të zgidhet ai që ka zotësi drejtimi ma të madhë.

Neni 101.

Mësuesit e shkollave ushtrimore zgjidhen midis mësuesve definitivë që kanë krye, me përfundim të shquem, shkollën normale pranë së cilës vepron ushtrimorja ase nji normale tjetër t'asaj sisteme dhe kanë zotësi didaktike të provueme.

Neni 102.

Kandidatët për mësues duhet të paraqesin në Ministrin e Arsimit, me anën e autoritetit shkolluer të qarkut, ku banojnë, këto dokumenta;

1) Diploma ase dëftesën shkollore origjinale ase kopjen e saj të vërtetueme prej autoritetit përkatës;

2) Letër dëshmin nga ana e Prokuroris së Shtetit;

3) Letër-njoftimin e gejndjes civile;

4) Nji dëshmi shëndetsore të lëshueme prej nji komisioni të përbamë prej 2 mjekësh zyrtarë të shënuem prej autoritetit arsimuer, me anën e së cilës të vërtetohet se s'ka ndonji sëmundje ase gjymtime fizike, që mund të pengojnë shërbimin e mirë në mësuesi;

5) Dëshmin e sherbimit, në rasë se ka shërbye ma parë në ndonji nëpunësi shtetnore a privatë.

Kaptina e II.

Shpërnguljet e mësuesvet

Neni 103.

Rregullisht mësuesit nuk mund të shperngulen pa pasë mbushë të pakten 2 vjet shërbimi në vendin ku emnohen.

Neni 104.

Mësuesit mund të shpërngulen mbas kërkesës së vet, ase prej Ministris vetë për arsye shërbimi a ndeshkimi dishiplinuer.

Neni 105.

Mësuesit, që dëshirojnë me u shpërngulë, duhet të paraqesin kërkesë me anën e Isnpektoris së vet, mbrenda muejit të Majit, tue kallzue dhe tue dokumentue arsyet. Inspektorija ia përcjell kërkesën Ministris, tue ba vrejtjet e veta mbi vërtetësin e arsyeve të çfaquna në te.

Nuk pranohet kërkesa e shpërngulijes s'atyne mësuesve, të cilët në të dy vjetët e fundit kanë marrë qoftë edhe nji herë vetëm, notë shërbimi ma t'ultë se «mirë», ase kanë pësue nji ndeshkim dishiplinuer ma të randë se «qortim».

Neni 106.

Për të shpërngulunit do të merren parasysh:

1) arsyet familjare;
2) arsyet shëndetësore.

Kur për nji vend ka ma shumë se nji kandidat merret parasysh merita e ma në fund vjetërsija.

Neni 107.

Rregullisht shpërnguljet, për çdo shkak qofshin, bahen në fillim të vejtit shkolluer, dhe u njoftohen t'interesuemve nji muej ma parë.

Por Ministrija, për arësye ndeshkimi, shërbimi dhe administrative të jashtëzakonshme, mundet me bamë shpërngulje edhe gjatë vjetit shkolluer, pa paralajmerimin e përmendun në kryerreshtin e sipërm.

Neni 108.

Kur mësuesi shpërngulet mbas kërkesës së vet, ase per shkak ndëshkimi, nuk ka të drejtë shepnzimesh udhtimi e djetë.

Kaptina e III.

Leje dhe Zavendsija e mësuesve

Neni 109.

Çdo leje jepet prej Ministris s'Arsimit; Inspektorët, dhe në mungesë të tyne Drejtorët, mund të japin leje deri më 5 ditë gjatë jetit, tue lajmue Ministrin.

Neni 110.

Mësuesit mund të marrin leje për këto arsye:

1) për sëmundje vehtijake të provueme mirë;

2) për vdekje, smundje të randë e nevojë të jashtëzakonshme në familje.

Neni 111.

Leja, që gjatë nji vejti shkolluer mund të jepet me të drejtë rroge, nuk mund të jetë ma se 10 ditë, përveç rastit të parashtruem me pikën 1 të nenit të sipërm; me gjith ket, atyne mësuesvet, që nuk kanë marrë asnji leje, gjatë tri vjetve vazhdimisht, mund t'u jepet leje deri 20 ditë.

Për leje, që kapërcejnë kufit e caktuem ma nalt, mësuesit nuk kanë të dretjë rroge. Sido qoftë mësuesi nuk mund të ketë kurrsesi pretendime për leje ma të gjatë se ate që gjen t'arsyeshme Ministrija.

Neni 112.

Për shkak sëmundjeje vehtijake mësuesit i jepen deri 3 ditë leje; në qoftë se sëmundja zgjatet ma tepër, duhet të paraqesë deshmi mjeku.

Mësuesi, që mungon nga detyra me leje për shkak sëmundjeje, quhet i mbajtun në punë dhe ka të drejtë të marri të tanë rrogen:

a) deri në nji muej, kur nuk e ka mbushë nji vjet shërbimi në kohen që fillon sëmundja;

b) deri në tre muej, kur ka nji shërbim prej 1 deri 5 vjet;

c) deri në kater muej, kur ka nji shërbim prej 5 deri 10 vejt.

ç) deri në gjashtë muej, kur ka nji shërbim prej 10 vjet e përpejtë.

Në qoftë se vazhdon sëmundja, mësuesit që gjindet në rastin e përshkruem në pikën a) i zgjatet leja edhe për 2 muej të tjerë atij që gjindet në rastin e pikës b) edhe për tre muej; atij që

gjindet në rastin e pikës c) edhe për 4 muej dhe atij që gjindet në rastin e fundit i zgjatet leja edhe për 6 muej të tjerë.

Për të gjitha këto zgjatime, mësuesi ka të drejtë të marri gjysmën e rrogës.

Dy ase ma shumë periudha lejeje për shkaqe sëmundjeje vetijake, të këputuna prej njij kohe shërbimi efektiv të ndërmjeme jo me të gjatë se katër muej mblidhen së bashku për efektet e caktimit të kufis maksimale të zgjatimit të lejes dhe të kufis së rrogës.

Po që se lëngimi vazhdon përtej kohës së parashikueme në kët nen, mëusesi, në bazë të raporteve të mjekve nxiret në pensjon, ase vehet në pritmeni, me të drejtë rimarrjeje në sherbim, po të ketë ase po të hapet vend dhe po të ketë kondilat e kërkueme prej neni 96.

Ministrija mundet me kërkue vërtetimin e sëmundjes së mësuesit me anë mjekësh të caktuem prej saj, si në rastin e paraqitjes së raporteve mjeksore, gjatë kohës së lejes.

Neni 113.

Mësuesevet shtatë-zanë u jepet lêje tri javë para dhe katër javë mbas lindjes. Koha e lindjes nuk llogaritet për efektet e rrogës në rast sëmundjeje vehtijake.

Neni 114.

Mësuesve që kanë kondital e duhuna dhe dëshriojnë me vazhdue studimet pedagogjike, Ministrija mund t'u japë leje për nji kohë të caktueme për këtë qëllim.

Gjatë kësaj kohe mësuesit marrin rrogen që kanë. Në fund të çdo sesjoni të provimeve dhe në mbarim të periudhës që u asht caktue, detyrohen të paraqesin dokumentat e duhuna shkollore, në mos u gjindshin në rregull, detyrohen me u kthye në sherbim dhe me e la me rrogat e veta shumën e shpenzueme gjatë kohës së studimeve të tyne. Në kët rastin e mbramë, koha e kalueme për studim nuk njifet për efektet e vjetërsis.

Neni 115.

Ministrija, njiherë në çdo 5 vjet sherbimi, mund t'u japë mësuesve, që i kanë konditat e duhuna, deri tre muej leje, gjatë vjetit shkolluer, me të drejtë rroge të plotë, me qëllim që të bajnë udhtime studimi jashtë Atdheut për me vizitue institute fillore moderne dhe, për me studjue në vend metoda të reja pedagogjike Këto udhtime studimi organizohen prej Ministris.

Neni 116.

Kondital e duhuna për lejet e përmenduna në nenet 114 e 115 dhe mënyra e zgjedhjes së mësuesve caktohet me rregullore të veçatntë.

Neni 117.

Koha e shkueme me leje për shkak sëmundje vetijake, lindjesh, studimesh të parapame në nenet 114 e 115, njifet për efektet e vjetërsis. Lejet për arsye të tejra, po të kapërcejnë nji muej mbrenda nji vjeti, shkaktojnë shtymjen e gradimit, për vjetërsi ase për meritë, për nji vjet.

Neni 118.

Kur mungon mësuesi në nji shkollë, mësimet e tij u ngarkohen mësuesve të tjerë të shkollës pa ndonji shpërlbim deri në dy muej mungesë; po qe se mungesa zgjatet ma tepër Ministrija dërgon kryesisht nji zavendës, i cili merë shpenzimet e udhtimit dhe nji shpërblim prej 4 frk ar në ditë prej datës që fillon e deri në ditën që shngarkohet nga detyra.

Në shkolla me nji mësues, po qe se mungesa zgjatet mâ shumë se nji muej, emnohet nji zavendës me shpërblimin e përmendun ma nalt. Po kështu mund të veprohet edhe në rast se mbeten vende vakante.

Mësues zâvendës mund t'emnohen edhe ata qi kanë krye klasen e fundit të Shkollës Normale pa provimin e pjekunis.

Mësuesit, që zavendsojnë Drejtorin, që asht me leje, nuk marrin shtesë drejtimi.

Kaptina e IV.

Të drejtat e detyrët e mësuesvet

Neni 119.

Mësuesi, porsa t'emnohet, detyrohet me u betue para autoritetit shkolluer të vendit në kët mënyrë:

«Betohem n'emnin e Perendis e në nderin t'im se kam me qenë besnik i N. M. T. Mbretit të Shqiptarvet ZOGU I. dhe se kam me i sherbye Atdheut t'im Shqipnis me besnikëri e ndërgjegje të pastër, tue vepruem si mbas Statutit, mbas Ligjëvet dhe Rregullorevet që janë në fuqi në Mbretnin Shqiptare, tue e kryem detyrën t'ime, që m'asht ngarkue, me zell e me dishiplinë».

Neni 120.

Mësuesi duhet të përpiqet që t'i arrijë qëllimit të misionit të vet edukativ me anën e mësimit, të shembëlles së mirë e të dishiplinës.

Çdo keqsjellje përkundrejt nxanësit e çdo ndeshkim trupuer janë rreptësisht të ndaluem.

Neni 121.

Mësuesi duhet t'i kushtojë gjithë aktivitetin shkollës së vet, tue mos u marrë me as nji gja tjetër që mund të pengojë kryemjen e detyrës, ase që të cenojë randësin e barrës që i ngarkohet. Me leje e autorizim të Ministris s'Arsimit, mësuesit mund të ngarkohen me detyrët e sekretarëve të Komuneve, kur e kanë sherbimin në qendrat e këtyneve.

Neni 122.

Çdo mësues asht i detyruem me marrë pjesë në konferencat shkollore të caktueme prej autoritetevet arsimore.

Neni 123.

Mësuesi duhet t'a ketë ndejtjen e vet në vendin, ku gjindet shkolla, në të cilen sherben. Në çdo rast, largësija e banimit të tij nga shkolla nuk duhet të jetë ma tepër se 5 km. dhe gjithnji me pëlqim t'Inspektoris s'Arsimit.

Neni 124.

Asnji mësues, që ka qenë bursist i Shtetit, nuk mundet as të japi dorëheqjen, as t'emnohet në tjetër nëpunësi pa mbushë detyrimin Ligjuer.

Neni 125.

Gjatë kohës së mësimeve çdo mësues,, që dishron të hiqet nga puna, detyrohet të lajmojë me shkresë autoritetin shkolluer të paktën nji muej ma parë. Me gjith ket, mësuesi dorëheqës mund të mbahet në sherbim deri në mbylljen e tremuejshit n'udhtim.

Neni 126.

Mësuesi, që ka ndërmend të mos shërbejë mâ për vjetin e ardhshëm shkolluer, duhet të japë dorëheqjen qysh në muej të Qershorit; n'e dhantë mâ vonë, tue u largue nga detyra para mbarimit të tremuejshit të parë të mësimeve, nuk ka të drejtën e rrogës së pushimit veruer.

Neni 127.

Mësuesit dorëheqës, që e len detyrën mâ parë se t'i njoftohet përgejgja e Ministris, i zbatohet pika ç) e nenit 137.

Neni 128.

Mësuesi definitiv, i cili asht largue prej shërbimit efektiv të mësuesis dhe prej varjes së drejtë të Ministrisë s'Arsimit, mund të rimerret në sherbim arsimuer, mbrenda katër vjetve mbas largimit, po të jetë se:

a) ka si titull studimi nji shkollë normale të kryeme;

b) në dy vjetët e fundit të detyrës në mësuesi ka pasë nji shërbim të cilsuem me notë së paku «mjaftueshëm»;

c) nuk ka kapërcye moshën 35 vjetësh në kohën kur kërkon riêmnimin.

Mësuesi definitiv, që ka konditat e naltpërmenduna, mund të rimerret në shërbim edhe mbas tri vjetëve të largimit të tij nga mësuesija, mbassi që t'i jetë shtrue përsëri provimit të stazhit.

Mësuesi i përkohshëm, që ka konditat e pikave *a* e *c*, mund të rimerret në shërbim vetëm mbrenda katër vjetve, por duhet që mbas njij vjeti prej riemnimit t'i shtrohet provimit të stazhit.

Mësuesi dorëheqës n'asnji rast nuk mund të rimerret në shërbim mbrenda vjetit shkolluer në të cilin asht largue.

Mësuesi, që asht largue nga arsimi, nuk mund të rimerret në sherbim të mësuesis mâ tepër se dy herë.

Neni 129.

Mësuesit janë të detyruem me punue efektivisht, si aktivitet didaktik, deri 30 orë maksimum në javë.

Kur orët e mësimeve të klasës që ka marrë nji mësues nuk arrijnë maksimumin, orët e pa plotësueme do të mbushen me orë mësimi në klasë të tjera, ase me detyrë shkollore të ndryshme.

Kryemësuesit kanë aqë orë sa të ketë klasa që do të marrin.

Drejtorët do të kenë prej 20 deri 22 orë.

Neni 130.

Mësuesit duhen të mbajnë në rregull rregjistrat shkollorë dhe të përmbushinë të gjitha detyrët e tjera, që caktohen hollsisht në Rregulloren.

Kaptina e V.

Masat disiplinore

Neni 131.

Kundër mësuesvet, që dëftehen të plogët e të pa kujdesëshëm për detyrat shkollore, që nuk i u binden Ligjëvet e Rregulloreve!, që veprojnë në mënyrë që t'i u dalin fjalë për sjelljen e ligë e për moralin e tyne, që nër nxanësit a në popull bajnë propagandë parimesh të kundërta me institucionet e Shtetit, mbas randësis së fajit, zbatohen këto ndeshkime:

1. vretje me gojë;
2. qortim;
3. gjobë me të premunit e rrogës prej 3 deri 20 ditë;
4. transferim;
5. pezullim nga detyra e rroga prej 1 deri 6 muej;
6. pushim.

Neni 132.

Vrejtja me gojë bâhet prej autoritetit epruer për mungesa të lehta në detyrë.

Neni 133.

Me qortim shfaqet moskënaqësija që autoriteti epruer i a drejton mësuesit, me shkresë, për njenin nga këto shkaqe:

a) kur pësëritet për të tretën herë t'ardhunit vonë në shkollë ase të hymit vonë në mësim;

b) kur shifet për të dytën herë nji parregullim në ditaret a në rregjistrat e klasës;

c) kur për të parën herë diktohet i pa bâmë gati për mësim;

ç) kur ndalon aktet pa veprim në zyrë për mâ shumë se dy dit;

d) kur mungon në detyrë nji ditë në muej pa leje.

Neni 134.

Gjobë me të premit e tri ditve rrogë i vihet mësuesit kur ka persërit fajet e numrueme në nenin e maparshëm.

Në qoftë se mësuesi vijon në ket udhë, ase e len detyrën deri 5 ditë, gjobitet gradualisht me të premit e rrogës prej gjashtë deri njizet dit gjatë njij mueji.

Për mos respektimin e urdhnit t'eprorit në detyrë e në çashtje zyrtare, si edhe kur vërtetohet se përzihet në çashtje lokale politi-

tike administrative ase në punë që nuk i përkasin, mësuesi ndëshkohet, për herën e parë, me premjen e rrogës të 20 ditvet.

Neni 135.

Mësuesi transferohet:

a) kur nuk shkon mirë me shokët dhe vërtetohet se âsht fajtuer ai vetë;

b) mbasi të jetë gjobitë me premje rroge të paktën dy herë gjatë njij vjeti shkolluer për fajet e përmenduna në nenin e maparshëm:

c) kur mungon, pa leje, nga detyra prej 6 deri 9 ditë gjatë njij mueji; bashkë me ket ndeshkim i zbatohet edhe gjoba me 9 ditë premje rroge;

ç) kur diktohet se i kanë dalë fjalë për sjellje jo të mirë dhe propagandë të pa-dëshrueme;

d) për mos-bindje urdhnit t'eprorit në detyrë e punë zyrtare, për herën e dytë

Neni 136.

Mësuesi ndeshkohet me pezullim nga detyra e rroga kur:

a) përsërit fajet të cilat kanë shkaktue mâ parë ndeshkimin e tij me tranferim, ase kur këto faje janë posaçërisht të randa.

b) provokon botime kritikash të pa drejta ase msheftasi kundra eprorit ase administratës së vet ase botënisht hap lajme qi dâmtojnë prestigjin e këtynve;

c) vepron me anësi ase duron abuzime të përsonelit të varun;

ç) nuk mban msheftësin zyrtare;

d) damton interesat e Shtetit me mos kujdesin në kryemjen e detyrës.

e) kërkon me krijue nji lëvizje midis mësuesvet ase nxanësvet me qëllim që t'ushtrojë presion në veprimet e eprorve ase t'u paksojë autoritetin;

ë) dehet në mëyrë që terheq vrejtjen e publikut;

f) lot bixhoz;

g) mungon pa lêje nga detyra 10 ditë gjatë njij mueji.

Në rasë vobeksije të madhe, grues dhe fëmijëve të miíun të mësuesit të pezulluem nga detyra dhe rroga, mund t'u akordohet nji shpërblim ushqimuer jo mâ shumë se nji e treta e rrogës së mësuesit.

Koha e pezullimit nuk llogaritet për efektet e vjetërsis.

Neni 137.

Mësuesi, pavarësisht nga çdo padi Penale, ndeshkohet me pushim nga puna:

a) për përsëritje të ndonji faji, për të cilin asht ndeshkue ma parë me pezullim nga nëpunësija e nga rroga;

b) për shperdorim të randë besimi;

c) kur nji 20 ditë mbas njoftimit t'emnimit, ase mâ se 10 ditë mbas shpërnguljes a të mbarimit të lejes, nuk paraqitet në krye të detyrës;

ç) kur largohet, pa leje, nga detyra për ma se 10 ditë rradhazi;

d) për vepra të randa mos bindjeje kundra administratës ase eprorve të bâme botënisht, tue shkelë, në mënyrë evidente, parimet mâ elementare të dishiplinës dhe t'autoritetit.

dh) për pa zotësi profesjonale;

e) për mungesa të randa kundra nderit dhe moralit, dhe për çdo mungesë tjetër, e cila zbulon nji të metë të ndjenjës morale ;

ë) për ofendim të përsonës së N.M. T. Mbretit, të Familjes Mbretnore, të Parlamentit ase për çfaqje botënisht të ndjenjave anmiqsore kundra Instituteve qi janë në veprim.

Ndeshkimi i pikës *dh* i zbatohet mësuesit që për tri vjet rresht ka marrë notë shërbimi «pa-mjaftueshëm» ase për dy vjet «dobët».

Neni 138.

Shkaktohet vetiu pushimi nga puna, pa qenë nevoja të çelet as nji procedim dishiplinuer, kur mësuesi dënohet prej gjyqit, me vendim që ka marrë fuqin e gjasë së gjykueme, për faje kundra zakoneve të mira ase për falsifikim, mashtrim, spekullim nëpunësije, dhuntim, mitë, vjedhje dhe keq-përdorim besimi.

Neni 139.

Mësuesi, i marrun në gjyq për delikt të rrjedhun nga detyra dhe për çdo tjetër delikt, që cenon dinjitetin e nëpunësis, mund të pezullohet nga detyra e rroga; mësuesi kundra të cillit gjyqi ka nxjerrë letër-ndalim të përhershëm ipsojure, konsiderohet i pezulluem nga detyra e rroga.

Kur procedimi ndeshkimuer mbaron me nji vendim definitiv, që mohon ekzistencen e faktit, që i ngarkohet mësuesit, ase vendimi në fajlë, me gjith që pranon fajin përjashton të marrmen pje-

së të mësuesit, pezullimi revokohet, dhe mësuesi rifiton të drejtat e tija për gjysmen e rrogave që nuk ka marrë.

Me gjith ket, kur administrata shef se nga procedimi ndeshkimuer shfaqen fakte dhe cirkonstanca, të cilat nxjerrin fajtuer mësuesin për ndeshkime dishiplinore, merren masa kësodore si mbas dispozitave përkatëse.

Kjo rregullë mbahet edhe në rast kur procedimi asht provokue mbi ankimin e nji privati dhe ky heq dorë nga padija.

Neni 140.

Ndeshkimet e përmenduna në nenet 132 e 133 vihen prej autoritetit kompetent ma të nalt, tue i njoftue me nji herë Ministris s'Arsimit; ato të nenevet 134 e 135 mund të proponohen bashkë me arsyet ma të shkoqituna dhe me provat, edhe prej Drejtoris e Inspektoris, por vihen prej Ministris. Për fajet e tjera masa merret drejt prej Ministris.

Për ndeshkime me premje rroge prej 10 dit e nalt dhe për të tjera mâ të randa duhet vendimi i Këshillit Qendruer të Ministris.

Neni 141.

Drejtuesvet të shkollae u zbatohen masat dishiplinore të kësaj kaptine, por përveç këtyne, ndeshkimi, si mbas fajit, mund të përfundojë edhe me shgarkimin nga drejtimi.

Neni 142.

Me përjashtim të vrejtjes, të gjitha ndeshkimet e parapame prej nenit 131 shenohen në biografin e mësuesit.

K a p t i n a e VI.

Gradimet e shperblimet e mësuesvet

Neni 143.

Gradimi i mësuesvet caktohet me shtesat e vjetërsis si mbas Ligjës së kategorizimit.

Neni 144.

Gradimi i mësuesve varet dhe nga zotsija ase pa zotësija didaktike dhe nga aktiviteti arsimuer i tyne.

Neni 145.

Nji mësues definitiv, i cili shquhet për aktivitetin e vet në sheshin shkolluer e arsimuer, mund të fitojë shtesat e vjetërsis,

për shenjë e cilësi merite, nji vit para plotësimit të kohës së shërbimit ligjuer për gradim.

Kondidat që përbajnë titull gradimi të parakohshëm janë:

1. a) me themelue nji klasë ase nji shkollë modele;

b) me botue shkrime me randësi didaktike ase me bâ studime të vlefshme mbi kulturën popullore e mbi folklorin etj;

c) me organizue shkolla për të rritun, e kurse për kulturë popullore e biblioteka shkollore;

2. mos me pasë ndeshkim mâ të randë se vrejtje;

3. me pasë për çdo vejt notë sherbimi të paktën «mirë».

Numri i gradimeve të parakohshme për meritë nuk mund të kapërcejë 1/10 të numrit t'atyne që gradohen në mbështetje të vjetërsis n'at vjet.

Gradimi i parakohshëm mund të bahet edhe vazhdimisht deri në tri herë.

Gradimet e parakohëshme gjykohen vetëm dhe vendosen kryesisht prej Ministris, me zgjedhje, në mbështetje të konditave të nalt-përmenduna.

Çdo gradim duhet të jetë i arsyetuem dhe i përshtatun në fakte reale.

Neni 146.

Gradimi për vjetërsi shtyhet:

a) për dy vjet po të jetë se, gjatë periudhës së kohës ligjore për gradim, mësuesi ka dhanë prova shërbimi pak të frytshem, tue mos tregue aktivitetin e duhun në punë;

b) për nji vjet, po të jetë se, gjatë kohës së nalt-përmendunn, ka pësue nji ndeshkim ma të randë se ai i parapam me nenin 134.

c) për nji vjet për arsyen e parapame në nenin 111.

Vendimi, me të cilin shtyhet gradimi për vjetërsi, duhet të mbështetet në fakte të dokumentueme mirë, të shtrueme shkoqitisht në vendim, nji kopje besnike e të cilit duhet t'i njoftohet t'interesuemit.

Neni 147.

Mësuesi i shkollës së rregulltë, që shërben edhe në nji stacjon shkolluer, simbas nenit 62, merr nji shpërblim prej 10 fr. ari në muej për kohën që zgjat aj shërbim.

Neni 148.

Mësuësit e shkollave që veprojnë si mbas sistemës së parapame në nenin 66 marrin nji shpërblim prej 20 fr. ari në muej për sa kohë vazhdojnë mësimet n'atë mënyrë.

Neni 149.

Mësuesit e shkollave ushtrimore, veç të drejtës së kategorizimit, kanë nji shtesë 20 fr. ari në muej, e cila iu hiqet, porsa të largohen prej kësaj detyre.

Kaptina e VII.

Përmirësimi teknik i mësuesve

Neni 150.

Trupi mësimuer e ka për detyrë që të përtrijë e të plotsojë njoftimet e veta të përgjithshme dhe profesjonale për interesë të vet dhe të shkollës, tue këndue rivista pedagogjike dhe tue bâ studime të veçanta.

Neni 151.

Për të përmirësue kulturen e mësuesve organizohen konferenca periodike dhe kurse mësimesh e ushtrimesh të posaçme.

Neni 152.

Konferencat bahen nepër qarqet shkollore dhe rregullimi i tyne caktohet veçanërisht.

Neni 153.

Kurset çelen prej Ministris si mbas nevojëve arsimore dhe mjeteve që ka në dispozicjon.

Llojet, programet dhe rregullimi i tyne caktohen prej saj.

TITULLI IV.

Mbajtja e shkollave fillore

(Ndërtesa, orendi elj.)

Neni 154.

Mbajtja e shkollavet fillore u ngarkohet Bashkive e Komuneve ase popullsis, dhe kryhet me anen e Komisjoneve shkollore.

Shteti merr përsipër vetëm pagesën e rrogave të përsonelit.

BKSH

Neni 155.

Mbajtja e shkollave përmbledh:

Të ngrehunit, të plotsuemit, të meremetuemit dhe qiran e ndertesavet shkollore, zjarmin e dritën, orendit, veglat e landët e nevojshme të shkollës e të mësimit, dhe bibliotekat shkollore.

Neni 156.

Çdo Bashki detyrohet me caktue në buxhet të vet të pakten 5% nga t'ardhunat e veta, të cilat vehen në dispozicjon të Komisjonit shkolluer, për shpenzimet e nevojëve të përmenduna në nenin e sipërm. Shtimi i kësap përqindjeje varet njikohësisht nga nevojët shkollore dhe nga fuqija e Bashkis.

Çdo katund ase grup katundesh, që kanë të drejtë me pasë nji shkollë si mbas nenit 61, duhet të sigurojnë nji ndertesë të posaçme, si mbas njij plani të caktuem prej autoritetit arsimuer, dhe orendit e nevojshme, me t'ardhunat e pasunivet kolektive, që kanë, ase me mënyrën e përshkrueme në nnin 163.

Katundet, që kanë nji shkollë të përbashkët, marrin pjesë në shpenzime proporcjonalisht mbas sasis së banorëvet të tyne. Komunet, me përjashtim ta'tyne qi lirohen me vendim të Këshillit Ministruer, janë të detyrueme me vue 5% nga tardhunat e tyne në dispozicion të Komisjoneve shkollore, të cilat i përdorin për nevojët e shkollavet të katundeve të rrethit të vet, tue marrë pjesë në shpenzimet që këto bajnë për mbajtjen e tyne.

N'ato Bashki ase Komune, ku sasija nga 5% âsht e mjaftueshme për të mbulue nevojët e nalt-përmenduna, teprica e kursimeve nga kjo do të depozitohet vjet për vjet, për me vjeftë si fond për ndërtimin e ndonjij godine arsimore në vend ase për çdo nevojë shokllore për vjetët e ma pastajme.

Neni 157.

Komisjoni shkolluer, me inicjativë të vet ase mbi proponim t'Inspektoris s'Arsimit, vendos, si mbas nevojës, ngrehjen, transformimin e meremetimin e ndërtesavet shkollore dhe pajisjen e tyne me orendi e vegla, tue sigurue fondet e duhuna.

Në mos e bâttë kët gjâ, Këshilli arsimuer, mbi kerkesë t'Inspektoris, ndërhyn dhe i a imponon vetë.

Neni 158.

Mbrenda 5 vjetvet nga hymja në fuqi e kësaj Ligje, të gjitha

ndërtesat shkollore që janë të pa përshtatëshme e të pa mjaftueshme duhet të përtrihen e të plotësohen.

Neni 159.

Plani i ndërtesavet të reja, ai i transformimit të lokaleve dhe modeli i orendivet për shkollat e qytetevet e të katundevet bâhen gati mbas njij sisteme të caktueme prej Ministris s'Arsimit, dhe Komisjonet shkolore detyrohen me i zbatue pikërisht.

Neni 160.

Meremetimet e lokaleve shkollore, meremetimet dhe plotësimi i orendive duhet të bâhen gjatë pushimeve të mëdha.

Neni 161.

Ndërtesa e shkollës duhet ngrehë, sa âsht e mundun, në mes të qytetit a të katundit, në nji vend thatësine e në mënyrë që mësimi të mos pengohet a të trazohet, as të mos rrezikohet shëndeti i nxânësve.

Neni 162.

Në qoftë se Bashkija ase katundi nuk e ka truellin në vendin e duhun si mbas përshkrimit të nenit të sipërm, për me ngrehë ndërtesën shkollore, Komisioni shkolluer ka të drejtë me shpronësue tokat e nevojshme në mbështetje të Ligjës së shpronësit, tue u konsiderue shkolla si nji institut për dobi botore.

Në ket mënyrë veprohet edhe për vendin e kopshtit të shkollës të përmendun në nenin 73.

Nuk mund të vehet dorë mbi tokën e shpronësueme pa marrë fund vendimi i shpronësimit dhe pa u pague çmimi.

Neni 163.

Në ato vise, ku t'ardhunat e Bashkive a të Komuneve dhe burimet e tjera të Komisjoneve shkollore ase t'ardhunat e katundeve nuk mjaftojnë për me përballue shpenzimet për nevojët e përmendura në nenin 157, banorët e viseve detyrohen me dhanë ndihma për ket qëllim.

Për pjestim të ndihmavet bâhet nji listë, në të cilen shenohet ndihma e secilit tue pasë parasysh këto :

1) vergjin;
2) taksën e xhelepit;
3) taksën e patentës;
4) pasunin e përgjithshme dhe t'ardhunat e ndryshme.

Listat bahen gati prej njij Komisjoni të posaçëm të caktuem prej Bashkis ase Komunes.

Listat e bâmuna gati në ket mënyrë i paraqiten Bashkis ase Komunes, e cila ua parashtron Komisjoneve shkollore për shqyrtim; mbassi shqyrtohen prej komisjoneve në fjalë, i dërgohen Këshillit arsimuer të Prefekturës, i cili, para se t'i vërtetojë definitivisht, mund të ndigjojë e të marri parasysh ndonji shqyrtim të fundit, tue u bazue n'ankime të justifikueme të banorve

Lista e vërtetueme prej Këshillit arsimuer janë definitive dhe ndihmat e caktueme në këto mblidhen prej Zyrave financjare të vendit, si mbas rregullores së taksave qeveritare.

Neni 164.

Pranë ndërtesavet të shkollav, mbrenda njij rrethi 100 metrash, nuk mund të hapen fabrika, mullij e magazina, as pijetore, hotele dhe stabilimente të tjera, që mund të trazojnë qetësin e shkollës, ase të damtojnë edukatën e rinis dhe higjenën shkollore.

Neni 165.

Dhomat e shkollës shërbejnë vetëm për mësim dhe nuk mund të përdoren për kurrgjâ tjetër, pa autorizimin e posaçëm t'autoriteteve arsimore.

Neni 166.

Çdo katund detyrohet me i sigurue mësuesit a mësuesvet banimin e duhun si edhe landën e nevojshme për zjarm; Bashkit e qyteteve detyrohen me i u dhanë mësuesve jo vendës nji indemnitet si mbas rrogës, atynve me familje 10% dhe të pa-familje 5%. Kur ndodh të jenë mësues e mësuese, burrë e grue, në nji vend, vetëm njeni do të marrë indemnitete 10%, ai të cilit i bie indemniteti ma i math. Ky indemnitet duhet të paguhet prej njij fond të posaçëm që çdo Bashki detyrohet me caktue në buxhetin e vet, e që nuk përzihet me fondin 5% të përmendun në nenin 156.

Quhen mësues jo vendës ata që nuk kanë banimin e rregulltë në vendin ku shërbejnë.

Neni 167.

Ndërtesat si edhe pasunit e tjera të shenueme, gjatë kohës së pushtimeve të hueja, për qëllime shkollore ase mësimi, bâhen pasuni e arsimit kombtar dhe përdoren vetëm për nevojët arsimore të vendit.

TITULLI V.

Veprat ndihmëse të shkollës

Kaptina e I.

Shërbimi mjeksuer i shkollave

Neni 168.

Çdo Bashki detyrohet me u kujdesë, me anën e mjekut të vet, për shërbimin e inspektimit mjeksuer të shkollave të qytetit.

Ky sherbim nepër katunde kryhet prej mjekve shetitës (qeveritarë).

Neni 169.

Detyrat e mjekut të shkollave janë:

a) të vizitojë së paku njiherë në muej çdo shkollë dhe të mbikqyrë konditat higjenike të lokaleve dhe gjendjen shëndetsore të fëmijëve;

b) të eksaminojë individualisht çdo nxanës nji herë kur hyn për herë të parë në shkollë, dhe nga njiherë tjetër gjatë çdo vjeti shkolluer;

c) të vizitojë sa ma shpesh ata nxanës që shef vetë se kanë ma nevojë për kujdesime të veçanta, ase ata qi ia shënon mësuesi,

ç) të lajmojë Drejtorin ase mësuesin e shkollës për të largue nga shkolla nxanësit që ka diktue se kanë sëmundje ngjitëse dhe të japë autorizimin e duhun për t'i pranue përsëri në klasë, mbas kalimit të sëmundjes;

d) të marrë masa profilaktike mbrenda shkollës në rasë se bie ndonji epidemi në vend, dhe të lajmojë pa vonesë Komisjonin shkolluer për mbylljen eventuale të shkollës a të shkollave.

Neni 170.

Kur nji nxanës hyn për herën e parë në nji shkollë, Drejtori ase mësuesi i saj cakton për të nji librezë shëndetësore, të përpilueme mbas njij modeli të posaçëm, në të cilën shënohen, vjet për vjet, përfundimet e vizitave të caktueme në pikën b të nenit të sipërm.

Libreza mbahet në shkollë dhe i dorëzohet nxanësit vetëm kur shkon në nji shkollë tjetër.

Neni 171.

Me rastin e vizitave, mjeku u shfaq mësuesve vrejtjet e veta mjeksore-pedagogjike, u jep nxanësve këshillet higjenike të përshtatëshme, ase porosit prindët, drejt për drejt ase me anën e më-

suesve, në qoftë se âsht nevoja, që fëmijt e tyne të konsultohen te nji mjek i posçaëm.

Neni 172.

Mbas çdo vizite të parashikueme në pikën *a* të nenit 169 mjeku i bân nji raport Kryetarit të Bashkis mbi nevojët e rastit; Kryetari transmeton, pa vonesë, kopje të këtij raporti Komisjonit shkolluer, Inspektoris s'Arsimit dhe shkollës përkatëse.

Neni 173.

Çdo Drejtuer a mësues, në rasë ngutësije, e sidomos kur shfaqen shenjat e ndonjij sëmundjeje të dyshimtë, duhet të lajmojë pa vonesë mjekun, i cili merr, me njiherë, masat e duhuna.

Neni 174.

Çdo herë që Drejtori ase mësuesi ven re se mjeku nuk kujdeset, âsht i detyruem me lajmue Komisjonin shkolluer dhe Inspektorin e Arsimit.

Neni 175.

Kur mjetet landore e lejojnë, emnohen, pranë Zyrës së shërbimit mjeksuer, infermiere, të cilat shoqnojnë mjekun në vizitat shkollore që bân dhe kujdesen për zbatimin e përshkrimeve mjeksore të caktueme prej tij, tue hetue e tue shkue edhe nepër shtëpijat e nxanësvet.

Neni 176.

Shërbimi mjeksuer bashkiak i shkollave lidhet me Drejtorin e Përgjithshme të Shëndetësis, së cilës i dërgohen tri herë në vjet, në Tetuer, Mars e Qershuer, nga nji raport. Drejtorija e Përgjithshme njikohësisht ven në dije, me nji raport të posaçëm, Ministrin e Arsimit mbi gjendjen shëndetësore e mbi aktivitetin mjeksuer në të gjitha shkollat e Mbretnis.

Neni 177.

Shkollat e katundeve duhet të vizitohen së paku dy herë në mot, përveç rastëve të sëmundjeve epidemike.

Kaptina e II.

Bibliotekat shkollore

Neni 178.

Nepër shkollat fillore të qyteteve, dhe ku âsht e mundun edhe të katundeve, themelohet biblioteka shkollore.

Biblioteka zên vend, me sa të jetë e mundun, në nji sallë të posaçme dhe ka orendit e duhuna.

Neni 179.

Në bibliotekë mbahen eksemplarë të teksteve shkollore dhe libra të tjera instruktive e morale.

Librat e bibliotekës janë për nxansit e shkollës e për prindët e tyne, dhe ase këndohen në vend, kur ka lokal e orendi, ase jepen hua në shtëpi, por me konditë që prindët dhe kujdestarët të marrin detyrimin me shkrim që librat të kthehen në gjendje të mirë ase të paguhet çmimi, në rasë prishjeje ase humbjeje.

Neni 180.

Çdo bibliotekë shkollore administrohet prej nji komisjoni të caktuem nga Komisjoni shkolluer, i cili zgjedh edhe kujdestarin e bibliotekës ndër mësuesit e vendit.

Neni 181.

Mësuesi kujdestar i bibliotekës duhet të mbaj regjistër të rregulltë për të gjitha librat si edhe për të gjitha veprimet e bibliotekës.

Burimet e biblotekave të shkollave fillore përbahen prej:

1) fondit që cakton Komisjoni shkolluer nga t'ardhunat e parapame prej nenit 40 dhe nga t'ardhuna të tjera;

2) ndihmavet që japin Bashkit e Komunet për përparimin e kulturës së vendit;

3) dhuratave në libra ase ndihmave në të holla që jep Ministrija e Arsimit;

4) ndihmave që mund të mblidhen me anë iniciativash të ndryshme, t'organizueme për ket qëllim.

Neni 182.

Përpara se të blehen ase të shtihen në përdorim, librat për bibliotekë duhet të jenë pëlqye prej Inspektoris s'Arsimit.

Kaptina e III.

Arkëzat shkollore

Neni 183.

Për të krijue në fëmij shpirtin e kursimit dhe për t'u bâ ballë nevojëve të klasëve, themelohet, në çdo shkollë, arkëza shkollore.

Neni 184.

Për ket qëllim nxanësit e secilësdo klasë mblidhen në shoqni dhe paguejnë, gjatë kohës së mësimeve, përveç të vobekëve, nga fr. ari 0.10 për çdo muej në qytete dhe fr. ar 0.05 në katunde.

Të hollat mblidhen prej mësuesit dh janë nën ruejtjen e përgjegjësin e tij e të Drejtuesit të shokllës.

Rregullimi i arkëzes shkollore caktohet veçanërisht.

Neni 185.

Të hollat e arkëzës përdoren: për libra të zgjedhuna, për mjete mësimi të nevojshme të klasës dhe për ndonji iniciativë që mund të jetë në dobi të shkollës e të nxanësve.

Kaptina e IV.

Patronazhi shkolluer

Neni 186.

Në çdo qytet, ase edhe nër qendra të Komuneve, me iniciativë të Këshillit të Bashkis ase të Komunës, mund të themelohet patronazhi shkolluer.

Neni 187.

Qëllimi kryesuer i patronazhit asht që të përkrahë e të lehtësojë ndjekjen e shkollës, tue u falë libra të dobishme nxanësve ma të zellshem, dhe tue ndihmue të vobektit me libra e lândë mësimi, me veshje e mbathje, dhe, mundësisht, me ushqime.

Përveç kësaj, patronazhi mund të kujdeset dhe për me themelue biblioteka popullore, me pajisë shkollat me vegla mekanike për ndriçim të mësimeve, me dërgue nxanës shendet liq nëpër koloni verore, dhe me plotësue, me mjetet ma të dobishme, veprën e shkollës.

Veprimi i patronazheve shokllore asht i kufizuem ekskluzivisht n'arsimin fillluer.

Patronazhi, n'arrijtjen e qëlimit të vet, bashkpunon me Komisjonin shkolluer të vendit.

Neni 188.

Veprimi dhe formimi i patronazhit caktohen në rregullore dhe në statutin e tij përkatës.

Ministrija e Arsimit pregatit statutin tip.

BKSH

Neni 189.

Statuti, si edhe çdo ndryshim i tij, i paraqiten, me anën e Kryesis së Bashkis, Këshillit arsimuer të Prefekturës për pëlqim

TITULLI I VI.

Administrata lokale e arsimit filluer

Nen 190.

Administrata lokale e arsimit filluer kryhet prej Komisjoneve shkollore, Këshilleve arsimore dhe Inspektorive t'arsimit.

Kaptina e I.

Komisjonet shkollore

Neni 191.

Komisjonet shkollore krijohen në qendër të çdo Bashkije e Komune dhe përbahen prej:

a) Kryetarit të Bashkis ase të Komunes, si kryetar;

b) Drejtorit, Kryemësuesit ase mësuesit të shkollës së vendit, dhe tre vetve, prindë ase kujdestarë fëmijësh, mundësisht midis atynve që tregojnë një interesim për nevojët e shkollave.

Këta të fundit zgjidhen prej Këshillit të Bashkis ase të Komunës për dy vjet dhe pëlqehen prej Këshillit arsimuer.

Komisjonet shkollore thrrasin në mbledhjet e veta edhe nji mjek zyrtar, për çashtje përkatësije.

Inspektori i Arsimit ka të drejtë të marrë pjesë në të gjithë Komisjonet shkollore të qarkut t'inspektimit.

Detyrën e sekretarit e kryen autoriteti shkolluer qi merr pjesë në Komisjon.

Neni 192.

Mbledhjet e zakonëshme të Komisjoneve shkollore bahen dyherë në muej; ato të jashtëzakonshme kur e kërkon Kryetari ase Inspektori i Arsimit.

Autoriteti shkolluer, që merr pjesë në Komisjon, detyrohet me ba gati, qysh ma parë, urdhnin e ditës me të gjitha çashtjet që do të rrahen, tue mbledhë edhe elementet e duhuna prej Kryetarit të Komisjonit.

Që të kenë vleftë vendimet e Komisjonit shkolluer, âsht e nevojshme thirrja e të gjithë antarëve dhe pranija e shumicës.

Nji kopje e vendimeve të Komisjonit shkolluer i dërgohet, mbrenda tri ditve, Inspektorit t'Arsimit nga ana e Kryetarit.

Neni 193.

Inspektori i Arsimit, prindët ase kujdestarët e fëmijve mund të kundershtojë vendimet e Komisjoneve shkollore, mbrenda nji afati 10 ditësh, me anën e nji shkrese të drejtueme Prefektit. Kundërshtimi i parashtrohet Këshillit arsimuer i cili vendos definitivisht.

Neni 194.

Detyrët e komisjonit shkolluer janë:

a) të kujdeset për zbatimin e detyrimit shkolluer dhe për të ndjekunit e rregullshem të shkollës si mbas përshkrimevet përkatëse të kësaj Ligje;

b) të kujdeset për çdo nevojë të ndertesavet shkollore dhe për mirëmbajtjen e tyne si edhe për veglat, mjetet mësimore e për biblioteken e shkollës;

c) të gjejë vendet e përshtatëshme për kopshtin e shkollës e për stërvitjet fizike të nxanësvet;

ç) të kujdeset për administrimin, mirëmbajtjen dhe shfrytzimin e t'ardhunavet të pasunive t'arsimit;

d) t'interesohet që nxanësit e vobekët të pajisen me mjetet e duhuna të mësimit, kur kët barrë nuk e kryen patronazhi shkolluer;

dh) të kujdeset që nëpër lokalet shkollore të mbahet pastërtija e duhun dhe t'interesohet për shëndetin e nxanësve;

e) të shfaqi mendimin mbi kohen e çeljen dhe të mbylljes së shkollave;

ë) të marrë vendim mbi mbylljen e shkollës ase të shkollavet në rasë epidemije.

Neni 195.

T'ardhunat e Komisjoneve shkollore janë:

a) prodhimet e pasunivet shkollore;

b) të paktën pesë përqind mbi t'ardhunat e Bashkive ase të Komuneve;

c) të hollat e nxjerruna nga gjobat si mbas nenit 40.

ç) të hollat e mbledhuna prej ndihmash simbas nenit 163 dhe kremtesh shkollore.

Neni 196.

Kur paraqitet nji çashtje me randësi që nuk mund të zgjidhet

definitivisht nga Komisjoni shkolluer, këjo i parashtrohet për vendim të premë Këshillit arsimuer.

Neni 197.

Komisjoni shkolluer, me anën e Kryetarit të vet, ka të drejtë mbikqyrjeje mbi gjendjen e lokaleve dhe t'orendive shkollore. mbi higjenën dhe mbi vijimin e fëmijve në shkollë.

Komisjoni shkolluer nuk mund të përzihet kurrë e kurrsesi në mësimet e në organizimin pedagogjik të shkollës.

Çdo veprim në kundershtim me dispozitat e sipërme âsht e pa-ligjshem dhe i ndëshkueshem dishiplinarisht.

Kaptina e II.

Këshilli arsimuer i Prefekturës

Neni 198.

Këshilli arsimuer e ka ndejen në qendren e Prefekturës dhe përbahet prej:

a) Prefektit, si kryetar;

b) Inspektorit t'Arsimit, që e ka zyren në qendren e Prefekturës;

c) nji Drejtori shkolle të mesme, ku ka t'atillë; po të ketë mâ shumë shkolla të mesme, Ministrija zgjedh Drejtorin që do të marrë pjesë;

ç) dy vetesh nga intelektualët e vendit, që zgjidhen prej Ministris s'Arsimit për dy vejt.

Detyrët e sekretarit i kryen nji nga perrsoneli i shkollavet i shenuem prej autoritetit arsimuer.

Neni 199.

Këshilli arsimuer mblidhet, si mbas nevojës, mbi kërkesë të kryetarit.

Neni 200.

Këshilli arsimuer, mbrenda qarkut të Prefekturës, ka këto detyrë:

a) të kujdeset për formimin e Komisjoneve shkollore dhe të kontrollojë veprimet e tyne;

b) të kujdesct që Bashkit ase Komunet të përmbushin detyrët që u ngarkohen prej Ligjës, kur u shmangen këtyneve;

c) të interesohet për nevojët lândore të shkollave;

ç) të vendosë mbi mos marrëveshjet që mund të lindin midis Bashkive a Komuneve, Komisjoneve shkollore dhe Inspektoris s'Arsimit;

d) të rregullojë inspektimin mjeksuer në të gjitha shkollat;

dh) të caktojë qendrat shkollore midis katundeve të parapame me nenin 61, mbassi të ketë marrë mendimin e Inspektoris përkatëse t'Arsimit;

e) të administrojë pasunit shkollore që janë lânë për mâ se nji komisjon shkolluer;

ë) të pëlqejë buxhetet e Komisjoneve shkollore;

f) të pëlqjë statutet dhe të kontrollojë veprimet e patronazheve shkollore;

g) të përfaqësojë përgjithësisht interesat shkollore të qarkut të vet.

Këshilli arsimuer, në kryemjen e kompetencave të veta, i sillet Ministris s'Arsimit për kthjellimet e rastit.

K a p t i n a e III.

Inspektorit e Arsimit filluer

§ 1. QARQET E INSPEKTIMIT

Neni 201.

Për të sigurue mbarëvajtjen e arsimit filluer, toka e Mbretnis ndahet në qarqe inspektimi.

Neni 202.

Çdo qark inspektimi përfshin nji sasi shkollash me 50 deri me 130 mësues. Caktimi lidhet me dëndësin e shkollave dhe me lehtësit e komunikacjonit.

Neni 203.

Numri i qarqeve dhe qendrat e tyne caktohen prej Ministris.

§ 2 RREGULLIMI I INSPEKTORIVE DHE DETYRET E PERSONELIT TË TYNE

Neni 205.

Në qendren e çdo qarku t'ispektimit krijohet nji Inspektori e Arsimit me nji Inspektuer në krye.

Çdo inspektori e Arsimit ka zyrë të vçantë me nji instruktor t'edukatës fizike, i cili zavendson inspektorin në mungesë të tij dhe e ndihmon në kryemjen e detyrve administrative.

Neni 206.

Kompetenca e Inspektorivt, mbrenda qarkut t'ispektimit, shtrihet mbi:

a) të gjitha institutet e arsimit filluer, me përjashtim të shkollave ushtrimore, që janë pranë shkollave normale, të cilat varen nga çdo pikpamje prej Drejtorive të këtyne instituteve;

b) çdo aktivitet sportiv jashtë-shkolluer.

Neni 207.

Inspektorit korrespondojnë drejt për së drejti me Ministrin e Arsimit.

Të gjitha institutet si dhe shoqnit sportive të qarkut t'inspektimit mbajnë lidhje të drejtë me Inspektorin e vet. Vetëm në raste tepër të ngutshëme mund të hyjnë në leter-shkëmbim me Ministrin, tue njoftue njikohësisht edhe Inspektorin.

Neni 208.

Detyrët e inspektorvet janë:

a) inspektimi i përgjithshem, teknik e administrativ, i instituteve t'arsimit filluer;

b) rregullimi didaktik e administrativ i tyne kryesisht dhe mbas dispozitavet të Ministris;

c) kontrollimi i pa këputun dhe i kujdesëshëm i veprimit dhe i sjelljes, në shkollë e jashtë saj, të personelit t'instituteve të nalt përmenduna;

ç) kqyrja e pëlqimi i orareve dhe i programeve të shkoqituna të shokllavet;

d) rregullimi i rrutllimit të mësuesve nëpër klaset e ndryshme të shkollavet fillore;

dh) kujdesimi për vazhdimin e mësimit në rast mungese mësuesish;

è) caktimi i komisjoneve për provimet e lirimit;

ë) mbikqyra e plotë mbi zbatimin e mirë të Ligjëvet, të rregulloreve arsimor dhe të urdhnave eprore;

f) letërshkëmbimi i përgjithshem me Ministrin e Arsimit për të gjitha institutet e arsimit filluer dhe shoqnit sportive;

g) mbikqyrja për zbatimin e Ligjëvet mbi detyrimin shkolluer, mbi vijimin e rregullshem të fëmijvet, mbi gjendjen e ndertesavet shkollore. Këtë mbikqyrje e ban drejt për së drejti ase me anë shkollash përkatëse dhe për çdo mungesë ndemjetëson për marrjen e masave të duhuna;

gj) kontrollimi i bibliotekave shkollore;

h) kontrollimi i arkëzave shkollore;

i) vertetimi i borderovet dhe i dëftesavet, për çdo marrje në financë, t'arsimtarvet të qarkut të tyne;

j) rregullimi e mbikqyrja e veprimit sportiv jashtëshkolluer si mbas dispozitave të kësaj Ligje.

Inspektorët e Arsimit duhet edhe:

a) të japin pëlqimin përmbi ndërtesat shkollore, që mirren me qira, tue u kujdesë qi këto t'i përmbushin, sa të jetë e mundun, kërkimet e shëndetësis e të pedagogjis;

b) të japin mëndimin mbi zgjedhjen e vendeve për ngrehjen e ndertsavet të reja shkollore;

c) të shfaqin kryesisht mendimin mbi çdo akt, proponim ase kërkesë të bame, me ndërmjetësin e tyne, Ministris së Arsimit, prej Komisjonevet shkollore, shkollavet, mësuesvet ase shoqnivet sportive;

ç) t'organizojnë konferenca periodike midis mësuesvet të qarkut të vet; të mbajnë konferenca me mësuesit e njij vendi, mbas inspektimeve, mbi të metat që kanë vu ré dhe mbi përmirësimet e nevojshme;

d) të forcojnë lidhjet dhe marrëdhanjet midis shkollës e familjes;

dh) të shfaqin kryesisht Ministris mendimin mbi çdo gjâ, që pengon, ase që mund të përmirësojë gjndjen e përgjithshme t'arsimit të qarkut e që ka lidhje;

1) me ndryshime Ligjësh, Rregulloresh e programesh;

2) me instruksjone ase urdhna të Ministris;

3) me mënyrën e përhapjes s'alfabetizmit e të nji kulture dhe edukate kombtare në popull;

4) me çelje shkollash të reja, me mbylljen e me mirëndamjen e shkollave që janë;

5) me gradime, transferime, ndeshkime dhe pushime mësuësish.

Neni 209.

Për çdo vjet në muejin Shtatuer Inspektorët mblidhen në Kryëqytet në këshillë, nën kryesin e shefit të sekcjonit për arsimin filluer e normal, të ftuem prej Ministris, për të shkëmbye e për të rrahun mendime mbi çashtje e mbi probleme didaktike e shkollore të ndryshme të kompetencës së tyne dhe për të caktue përgjithësisht nji uniformitet kriteresh pedagogjike-administrative.

Vendimet e marruna, bashkë me proces verbalet e mbledhjeve, i paraqiten Ministris për pëlqim.

Mbledhjet zgjasin deri 3 ditë.

Neni 210.

Inspektori i Arsimit duhet të ndjekë me kujdes botimet që kanë lidhje me idet e me metodat e shkollës së re, që lindin e që zbatohen në vendet e hueja, dhe të përpiqet që t'i shtjerë e t'i përhapë nëpër shkollat e veta, tue ua përshtatë nevojëve dhe gjendes së tyne.

Neni 211.

Inspektori mban:

a) nji protokol t'akteve dhe nji tjetër të veçantë dore, që përdoret në rast inspektimi;

b) nji dosar të veçantë, ku përmblidhen vendimet e Komisjoneve shkollore të qarkut;

c) nji katalog të shkollavet me shenime mbi numrin e mësuesve e të nxanësve, mbi ndertesat shkollore, mbi orendit e mjetet mësimore;

ç) nji katalog të përvjetëshëm t'arsimtarvet me vendin e sherbimit;

d) nji katalog t'arsimtarvet, në të cilën do të shenohen: vendi e data e lindjes, vendi i rregjistrimit, studimet e bâme, dokumentat shkollore, sherbimet e përparshme, emnimet, gradimet, ndeshkimet, lejet e shpërnguljet. Veçanërisht do të shenohen vrejtje mbi cilsi të përgjithshme, mbi zotësin profesjonale, mbi sjelljen shoqnore, zellin e tj. të çdo arsimtari.

Neni 212.

Kundra Inspektorve zbatohen masat dishiplinore të nenit 131.

Inspektori që pëson nji ndëshkim mâ të randë se «qortimi» bie nga detyra e inspektorit.

§ 3. INSPEKTIMET DHE CILSIMI I SHERBIMIT TË MËSUESVE

Neni 213.

Inspektimet e përmenduna në pikën *a* të nenit 208 bahen së paku:

a) katër herë në vjet për shkolla që gjinden në vendin e ndejes s'Inspektoris;

b) dy herë në vjet për shkolla që gjinden jashtë qendrës s'Inspektoris.

BKSH

Neni 214.

Inspektimet duhet të bahen pa paralajmim, që shkolla të gjindet në konditat e saj të përditëshme.

Neni 215.

Inspektimi duhet të vijojë për njij kohë të mjaftë për të formue kështu një ide të sigurtë mbi organizimin landuer të shkollës, mbi gjendjen e saj higjenike, mbi konditat e saja edukative, mbi zellin e aftësin e mësuesit dhe mbi përparimin e nxanësve. Inspektori, kur e gejn të nevojshme e të volitëshme, po gjithnji pa zvoglue ase lendue autoritetin e mësuesit, bân mësim vetë.

N'asnji mënyrë Ispektori nuk mund t'i heqë vrejtjen e t'i bâjë kritika mësuesit në klasë, në sy të nxanësvet.

Neni 216.

Mbas vizitës, Inspektori redakton verbalin e inspektimit tue plotësue pyetjet e «radhorit të inspektimeve», që gjendet në arkiven e çdo shkolle.

Ky verbal nënshkruhet prej Inspektorit, mësuesit dhe drejtuesit të shkollës.

Dy kopje identike të verbalit, të nënshkrueme rregullisht, i merr me vehte Inspektori. Njena prej këtyneve, mbrenda dy javësh, i dërgohet Ministris, e plotësueme me vrejtjet e posaçme, së bashku me listat e shpenzimeve t'udhtimit e të djetave; kopja tjetër mbetet në zyrën e Inspektoris.

Për mungesat e konstatueme në shkollë, Inspektori merr masat e duhuna.

Për çashtje me ngutësi i shkruhet Ministris pa vonesë.

Neni 217.

Përveç raporteve të veçanta, të shkaktueme rastësisht gjatë vjetit, dhe përveç atyneve të kërkueme posaçërisht, çdo Inspektuer detyrohet t'i paraqesi Ministris:

a) nji raport, që dërgohet mbrenda muejit të kallndorit, i cili duhet të përmbajë, në formë të përmbledhët e të qartë, të gjitha shenimet statistike dhe vrejtjet e nevojshme për me formue nji ide mbi gjendjen arsimore të qarkut;

b) nji raport të përgjithshëm, në fund të vjetit shkolluer, që përpilohet si mbas instruksionevet të Ministris.

Neni 218.

Në raportin e përmendun në pikën *b* të nenit të sipërm, Inspek-

tori cilson shërimin vjetuer të mësuesit me nji notë, e cila duhet t'i njoftohet edhe t'interesuemit.

Për cilsimin e shërbimit përdoren këto nota: «shumë mirë», «mirë», «mjaftueshëm», «pa mjaftushëm», «dobët».

Me notat «pa mjaftueshëm» dhe «dobët» cilësohet nji shërbim i pa kënaqshëm dhe i pa-frytshëm.

Caktimi i notës duhet të jetë prodhimi i njij gjykimi objektiv dhe kritik mbi gjith veprimin vjetuer të mësuesit.

Neni 219.

Mësuesi që nuk asht i kënaqun me përfundimet e verbalit t'inspektimit ase me notën vjetore të cilsimit të shërbimit, mund t'i drejtohet Ministris, mbrenda nji afati tri ditësh.

Në rast se vërtetohen konstatimet e Inspektorit, mësuesi ngarkohet me shpenzimet eventuale të inspektimit të ri, që âsht i pa apelueshëm.

Neni 220.

Kur vërtetohet dhe provohet se Inspektori, në raportimet e veta mbi arsimtarë, nuk i mbahet pikërisht së vërtetës dhe njij objektiviteti të këthjellët e skrupuloz degradohet.

§ 4. EMNIMI I PERSONELIT T'INSPEKTORIVE

Neni 221.

Inspektorë t'arsimit filluer mund t'emnohen:

a) ata që kanë krye, mbas nji shkolle normale ase gjimnazi, nji shkollë të naltë pedagogjike së paku dy vjeçore dhe kanë të paktën tri vjet sherbim në nji shkollë fillore, ase për aq kohë kanë dhanë mësime pedagogjike në nji shkollë normale;

b) ata që kanë krye nji shkollë normale dhe kanë së paku 6 vjetë shërbim, me notë të patkën «mirë», si mësues në shkollat ushtrimore, ase kanë ashtu prapë nji sherbim të tillë prej 12 vjetësh në shkollat e tjera fillore si mësues e drejtuer.

Neni 222.

Mbas hymjes në fuqi të kësaj Ligje nuk mund të emnohen Inspektorë ata që kanë kalue moshën 40 vejtsh.

Neni 223.

Përveç rasteve të jashtëzakonëshme, mësuesit ase Drejtorët nuk mund t'emnohen Inspektorë në qarqe mbrenda të cilave kanë shërbye në të dy vjetët e fundit.

Neni 224.

Instruktorë t'edukatës fizike emnohen ata që kanë krye nji shkollë normale dhe kanë ba nji kurs edukate fizike.

TITULLI I VII.

Arsimi i popullit

Neni 225.

Me qëllim që të përhapi në popull shkrimin dhe njohunit e para të dijes e të praktikës, tue ringjallë e përmirsue bujqësin e blegtorin si edhe artizanatin shtëpijak t'atdheut, Ministrija e Arsimit mundet me hapë, si mbas mundësis së buxhetit të vet, kurse për të rritun e kurse të posaçme praktike.

K a p t i n a e I.

Kurset për të rritun

§ 1. THEMELIMI E RREGULLIMI I KURSEVE PËR T Ë RRITUN

Neni 226.

Kurset për të rritun ndahen në dy aktegori;

a) kurse për të rritun analfabetë,

b) kurse plotësimi.

Neni 227.

Kurse për të rritun analfabetë janë për ata që s'dijnë as të shkruejnë as të këndojnë ase për gjysëm analfabetë, dhe kanë për qëllim t'u japin ktynve mjetet e para të ditunis dhe ato njoftime, që janë të domosdoshme për jetë.

Kurset e plotësimit janë për ata djelm, që s'e kanë mbarue shkollën fillore, dhe qëllimi i tyne âsht që t'u a plotësojnë mësimin filluer.

Neni 228.

Kurset për të rritun analfabetë çilen, vjet për vjet, prej Ministris s'Arsimit, në bazë të proponimit t'Inspektorive, në vendet, ku shfaqet mâ e madhe nevoja për me luftue analfabetizmën.

Kurset e plotësimit çilen, prap ashtu, n'ato vende, ku shkolla fillore ka pak klasë.

Nuk mund të hapet as njeni prej këtyne kurseve, po qe se nuk gjinden së paku 15 nxanës që t'a ndjekin.

BKSH

Neni 229.

Kurset për të rritun mund të jenë:

a) kurse nate;

b) kurse festive.

Neni 230.

Kurset e natës nepër katunde duhet të vazhdojnë për 4 muej në vjet, preferisht në dimën, me 8 orë mësimi në javë; ato nëpër qytete duhet të vazhdojnë për 6 muej në vjet me 8 orë mësimi në javë.

Kurset festive zgjasin 8 muej me 2 deri 3 orë mësimi në javë.

Neni 231.

Programa e kurseve për të rritun analfabetë do të përmbajë pikat kryesore, me mâ randësi praktike, të programës së shkollës fillore.

Programa e kurseve të plotësimit bahet në bazë të mësimevet që kanë marrë djelmoshat në shkollën fillore dhe rastësisht mund t'i jepet nji drejtim praktik.

Këto kurse janë nji ase dy vjeçore.

Nnxansit, në fund të kursit, provohen dhe marrin dëftesen përkatëse.

Programa analitike dhe mënyra e provimeve caktohen prej Ministris.

Neni 232.

Kurset për të rritun zânë vend në lokalet shkollore ase në ndertesa botore.

Neni 233.

Bashkit, Komunet ase katundet kanë mbi vedi lokalin dhe orendit e shkollës, kur nuk janë ato të shkollës së ditës, dritën, zjarmin dhe mjetet e nevojshëme të mësimit.

Personeli mësimuer mbahet prej Ministris s'Arsimit.

Neni 234.

Komanda e Mbrojtjes Kombtare dhe Ministrija e Mbrendshme, kjo e fundit në marrëveshtje me Ministrin e Arsimit, do të organizojnë kurse për në kazerma e në burgje: e para për ushtarë që s'dijnë të shkruejnë e të këndojnë, e dyta për të burgosun.

Personeli i kurseve për ushtarë përbahet prej oficerësh ase prej mësuesish të shkolave fillore; aj i kurseve për të burgosun prej mësuesish.

Mësuesit paguhe me fonde të Ministris s'Arsimit.

§ 2. DETYRIMI I KURSEVE PËR TË RRITUN

Neni 235.

Ndjekja e kurseve për të rritun asht e detyrëshme dhe falas, si ndër analfabetët e për gjysem analfabetët, ashtu dhe për ata që s'kanë krye arsimin filluer. Ky detyrim zen të gjithë djelmoshat prej 13 e deri 18 vjetësh plot. Përjashtohen ata që kanë mbarue klasen e III të fillores. Ata që gjinden në ket moshë detyrohen të ndjekin shkollen ma t'afërme, që gjindet deri më 2 k. m. nga vendi i sherbimit ase i banimit.

Neni 236.

Ministrija e Arsimit lajmon qysh në Qershuer Inspektorin e Arsimit se në cilat vende do të çelen kurse dhe të cilit lloj do të jenë.

Neni 237

Për detyrimin shkolluer të djelmoshave, që janë në gjendjen e përshkrueme në nenin 235, kujdeset Komisjoni shkolluer, i cili vepron në ket mënyrë, mbasi të ketë marrë njoftimin e përmendun në nenin 236.

Në muejin Korrik Zyra e Gjëndjes Civile dhe të zotët, që kanë në shërbim, në punë të ndryshme të tyne, djelmosha, duhet t'i dërgojnë Kryetarit të Komisjonit shkolluer emnat e atyne që i zen detyrimi. Kryetari i Komisionit, mbasi merr informatat e duhuna, ban gati listën përkatse deri me 15 Gusht. Nga nji kopje e kësaj liste i dërgohet me nji herë Bashkis e Komunes, Inspektoris s'Arsimit dhe shkollës së vendit.

Në bazë të kësaj liste, e kur t'a kërkojë autoriteti arsimuer, Kryetari i Bashkis ase i Komunes lajmon prindët, kujdestarët ase të zotët e të detyruemve ,q'i nënshkruejnë këta në kursiin e të rritunvet, në datën që do të caktohet prej rregullores.

Neni 238.

Prindët ase kujdestarët e të rritunvet, që nuk do të justifikojnë me arsye të forta mos nëshkrimin e këtynve të fundit në shkollë, ndeshkohen si mbas nenit 33. Të zotët, të cilët refuzojnë të japin listën e të rritunve që kanë në shërbim ase fshehin emnat e tyne, ndeshkohen me gjobë prej 10 deri 30 fr. ari.

Neni 239.

Si të jenë nëshkrue, djelmoshat duhet të vijojnë rregullisht kursin, deri sa të vazhdojë pa bâ asnji mungesë, pa nji shkak t'ar-

syeshem. Shkaqe t'arsyeshme janë ato të përshkrueme në nenin 35.

Neni 240.

Të zotët, që kanë të rritun në sherbim, janë të detyruem që t'i lejojnë këta n'orët e caktume për kurset.

Neni 241.

Ata që, drejt për së drejti ase tërthorazi, u a pengojnë puntorve të vet ndjekjen e kursevet, tue u a paksue rrogat, tue i shtërngue me plotësue kohën e shkume në shkollë me punë jashta orarit, ase që i largojnë nga sherbimi për shkak se ndjekin kurset. ndeshkohen me gjobë prej 50 deri 100 fr. ar.

Neni 242.

Listat e mungesave, krye çdo 15 ditë, i parqiten Komisjonit shkolluer dhe përmbarohen po në mënyrën e parashtrueme për mos plotësisimin e detyrimit t'arsimit filluer.

Neni 243.

Djelmoshat duhet të sillen mirë në shkollë, të mos bajnë zhurmë, t'u venë veshin mësimeve dhe të nderojnë trupin mësimuer. Masat dishiplinore caktohen në rregulloren.

§ 3. KURSET PËR GRA

Neni 244.

Në marrëveshtje me organizaten «Grueja Shqiptare» ase me çdo organizatë tjetër kësodore, ase me inicjativë të vet, Ministrija mund të çeli kurse edhe për gra.

Ndjekja e këtyne kurseve âsht fakultative.

Programa caktohet veçanërisht.

§ 4. PERSONELI MËSIMUER I KURSEVE PËR TË RRITUN

Neni 245.

Mësuesit e kurseve për të rritun dhe të kurseve për grà zgjidhne, mbi proponim t'Inspektorive t'Arsimit, respektivisht midis mësuesve e mësueseve të shkollave fillore.

Mësuesit janë të detyruem me mbajtë të gjitha regjistrat, që janë të përshkruem për shkollat e ditës.

Neni 246.

Rregullimi e mirëvajtja e kurseve për djelm âsht nën për-

gjegjsi të Drejtorit a të Kryemësuesit të shkollës së vendit, që merr pjesë në Komisjonin shkolluer, i cili duhet të vëzhgojë ndjekjen e nxanësve dhe zbatimin e Ligjës së detyrimit e t'i dërgojë Komisjonit listat e atyne që nuk vazhdojnë rregullisht.

Kur në nji vend nuk ka Drejtuer a Kryemësues, kët barrë e ka vetë mësuesi i shkollës për të rritun.

Për mirëvajtjen e kurseve për gra kujdeset drejtuesja e shkollës femnore, në të cilën mbahet kursi.

Për kët barrë nuk merret shpërblim.

Neni 247.

Shpërblimi i mësuesve, të ngarkuem me kurset për të rritun, llogaritet për çdo kurs globalisht në kët mënyrë:

a) për kursin gjashtë mujuer	fr. ar	100-120;
b) për kursin katër mujuer	»	80-100;
c) për kursin festiv tetëmujuer	»	50 - 50;

Shpërblimi maksimum paguhet për ato kurse të cilat ndiqen deri në mbylljen e kursit prej së paku 25 nxanës të rregulltë; ai minimum, në qoftë se numuri i nxanësve të rregulltë deri në mbylljen e kursit âsht në mes 15 e 25. Për kurse që mbyllen me nji numër mâ të vogël nxanësisht të rregulltë paguhet vetëm gjysma e shpërblimit minimum.

Neni 248.

Mësuesit e shkollavet fillore munden me çilë, me inisiativë të vet e me pëlqim t'inspektoris s'Arsimit, kurse për të rritun, çdo lloji qofshin, tue u konformue dispozitave Ligjore.

Këtyne mësuesve, në mbarim të kursit, u lëshohen prej Inspektorit t'Arsimit dëshmi sherbimi, të cilat mund të përbajnë titull merite për karieren e tyne të mësuesis.

Kaptina e II.

Kurset praktike

Neni 249.

Kurset praktike janë:

a) bujqësore për djelm;

b) shtëpijake e bujqësore për vajza.

Mësimet jan fakultative, por për ata, që nënshkruhen, ndjekja asht detyrshme.

Neni 250.

Kurset mund të themelohen si shkolla të veçanta, me ase pa internat, ase si pjesë e konvikteve filloresh.

Neni 251.

Mësimet mund të zgjasin deri dy vjet.

Neni 252.

Për me u pranue në kurset praktike duhet që:

a) mosha të jetë të patkën 14 vjetësh;
b) të jetë krye shkolla fillore.

Neni 253.

Programa e mësimeve caktohet prej ministris, por në këto kurse si edhe në çdo tjetër institut t'arsimit filluer nuk mund të mësohen gjuhë të hueja të parapame në nenin 277.

Neni 254.

Kurset praktike për vajza Ministrija mundet me i hapë edhe në marrëveshtje me organizatat e përmenduna në nenin 244.

Neni 255.

Në mbarim të kursit nxanësve u lëshohet nji diftesë.

Neni 256.

Për kurset praktike emnohen edhe mësues me specializim të veçant.

PJESA E III.

ARSIMI I MESËM

TITULLI I.

Rregullimi i shkollave të mesme

Kaptina e I.

Themelimi, llojet e qëllimi i shkollave të mesme

Neni 257.

Arsimi i mesem ka për qëllim me i a edukue, stërvitë dhe forcue brezit të ri shqiptar vullnetin e dishiplinen në punë; me i a zgjue ndiesin e detyrvet të pastajshme ndaj vehten, të vetët e Atdheun, tue i rranjosë besimin e patundshem në jetën e popullit Shqiptar, në bashkimin dhe përparimin e tij; dhe, tue e pajisë me

nji kulturë të përgjithshme, të veçantë e komtare, me i a zhvillue prirjet kah degët e dryshme të dijes ase t'artit, për me e gatue që të ndjeki universitetet e shkollat e nalta të tjera ase me i dhanë njohunit teorike dhe praktiken e nevojshme për ushtrimin e njij profesjoni të lirë.

Neni 258.

Arsimi i mesem jepet vetëm nëpër shkollat e mesme të themelueme e të mbajtuna pikërisht mbas përshkrimevet të kësaj Ligje.

Neni 259.

Shkollat e mesme janë:

a) gjimnazi,

b) shkolla normale,

c) instituti tregtar,

ç) shkolla profesjonale.

Në gjimnaz, pa ndonji specializim të veçantë, paraqiten parimet e kulturës së përgjithshme me drejtim letrar ase shkencuer. Gjimnazi me mësim në gjuhën frëgnjishte quhet Licé dhe rregullohet me nji rregullore të veçantë.

Qëllimi i shkollës normale âsht me gatue trupin mësimuer të shkollave fillore e foshnjore, tue i dhanë kulturen e përgjithshme dhe pregatitjen pedagogjike të nevojshme për ushtrimin e mësuesis.

Iinstituti tregtar ka për qëllim specializimin në landë tregtije dhe gatitjen për ndjekjen e mësimeve të këtilla në shkolla ma të nalta.

Qëllimi kryesuer i shkollave profesjonale âsht mësimi teorik e praktik i zejeve të ndryshme, i punimit të tokës dhe i punimeve shtëpijake.

Neni 260.

Çdo shkollë e mesme ka:

a) vulen zyrtare me shenjen shtetnore dhe emni e cilsuem të vet;

b) arkivën dhe regjistrat e tjerë administrativë;

c) mjetet dhe veglat mësimore si edhe nji bibliotekë ër mësues e nxanës.

Neni 261.

Ministrija e Arsimit cakton rregullat e të mbajtunit t'arkivës, t'administratës shkollore dhe të bibliotekës.

Në vende, në të cilat nuk gjindet nji bibliotekë botore, biblioteka e shkollës së mesme, me lèjen e Ministris, mund të përdoret si e tillë; biblioteka e shkollës normale, në çdo rasë âsht në dispozicjon të mësuesve t'arsimit filluer.

Neni 262.

Shkollat e mesme mbikqyren dhe inspektohen drejt për së drejti prej Ministris.

Inspektimi âsht:

a) administrativ, dhe shfaqet me kontrollimin e administrimit të shkollës përgjithsisht e veçanërisht të taksavet shkollore, të dokumentavet të pranimit të nxanësvet, të tekstevet, të protokolevet e të rregjistrave;

b) didakik, dhe shfaqet me kontrollimin e të tanë veprimit të mësuesve, të sasis dhe të mënyrës së zhvillimit të programës mësimore në përshtatje me programet, rregulloret dhe instrukcjonet e Ministris s'Arsimit.

Shkollat e mesme duhet të kontrollohen së paku dy herë në vjet gjatë kohës së zhvillimit të mësimevet. Heren e dytë kontrollimi mund të bâhet nga Përfaqsuesi i Ministris s'Arsimit për provimet e pjekunis, por para se të shpërndahen diftesat vjetore.

Neni 263.

Shkollat e mesme themelohen e mbyllen me Dekret Mbretnuer mbas proponimit të Ministris s'Arsimit e vendimit të Këshillit Ministruer.

Tue fillue me vjetin shkolluer 1934-35 mund të lejohen deri me kaq shkolla të mesme: tri gjimnaze mashêullore prej të cilave nji asht Lice; nji gjimnaz shkallë t'ulët; nji normale për djelm; nji institut tregtar; nji gjimnaz për vajza; nji normale për vajza; nji institut teknik; tetë shkolla qytetse.

Neni 264.

Ministrija e Arsimit mundet me kufizue numrin e pranimit të nxanësve në shkollat e mesme.

Neni 265.

Nji gjimnaz i plotë zbret në gjimnaz t'ulet, po qe se për tri vjet rresht numri i përgjithshëm i nxanësvet të shkallës së nalt asht ma i vogël se 80. Gjithashtu gjimnazi i ulët mbyllet po qe se

për katër vjet rresht numri i përgjithshëm i xanësvet âsht ma i vogël se 200.

Neni 266.

Krijimi i klasëve paralele në nji shkollë të mesme lêjohet, vjet për vjet, prej Ministris s'Arsimit, e cila mundet me e dhanë autorizimin vetëm në rast se të nënshkruemit në nji klasë të shkallës s'ulët e kalojnë numrin 50 e ata të nji klase të shkallës së naltë numrin 40.

Kaptina e II.

Programet e mësimevet

Neni 267.

Programet e mësimevet caktohen prej Ministris s'Arsimit.

Neni 268.

Me përjashtim t'edukatës fizike, t'arteve dhe të mësimevet praktike, nuk lejohet mësimi i përbashkët për nxanës klasësh të ndryshme.

Neni 269.

Mësimet në shkollat e mesme jepen mbas klasëvet.

Nji klasë, kur ndiqet rregullisht, nuk mund të kryhet për nji kohë ma të shkurtë se nji vjet shkolluer as mâ të gjatë se dy vjet shkollore.

Nuk mund të kalohet në nji klasë mâ të naltë pa pu pasë krye, si mbas përshkrimevet të kësaj Ligje, klasa përkatëse ma e ulët.

Nuk mund të ndiqen njikohësisht dy shkolla të ndryshme, qofshin edhe me orar të ndryshëm. Regjistrime të tilla janë si të mos ishin bâ për të dy shkollat, dhe, në rast se lëshohen dëftesat prej njenës ase prej të dy shkollavet, këto shvleftësohen në çdo kohë që të zbulohen.

Neni 270.

Mësimi i mesëm zgjatet:

a) tetë vjet për gjimnaz të plotë, të ndamë në dy shkallë; mësimet në licé zgjasin nandë vjetë, prej të cilave dy janë pregatitore.

b) katër vjet për shkollën normale;

c) katër vejt për institutin tregtar;

ç) deri tetë vjet për shkollën profesjonale, të ndame në dy shkallë.

Çdo vjet mësimi përban nji klasë.

Neni 271.

Katër vjetët e para të gjimnazit përbajnë shkallën e ulët, e katër vjetër e fundit shkallën e naltë të tij.

Shkalla e ulët e gjimnazit asht rrânja e të gjith shkollavet të mesme të tjera.

Neni 272.

Të dy shkallët e gjimnazit të plotë përbajnë nji tanësi të pandashme dhe qindrojnë nën nji drejtim.

Shkalla e naltë e gjimnazit nuk mund të hapet pa shkallën e ulët.

Mund të lejohet mbajtja e njij gjimnazi t'ulët.

Neni 273.

Në shkollën normale e institutin tregtar mësimi i të katër vjetve paraqitet si nji shkallë e vetme. Këto dy shkolla konsiderohen shkallë të naltë.

Neni 274.

Shkolla profesjonale ka dy shkallë: shkalla e ulët, e prfaqsueme prej shkollës qytetse; ajo e naltë, prej institutit teknik.

Shkolla qytetse asht shkollë me mësim katërvjeçuer të mbyllun, dhe shërben si shkollë pregatitore për institutin teknik në të cilin mësimet, si mbas degës, vazhdojnë dy, tri ase katër vjet.

Neni 275.

Në shkollat e mesme mund të hapen këto degë:

a) në gjimnaz: dega klasike e dega reale, tue fillue prej klasës së III-të;

b) në normalen femnore: dega për fillore e dega për foshnjore. Mësimi në degën për foshnjore, zgjatet gjithsejt dy vjet.

Pranë shkollave normale punojnë shkollat ushtrimore për praktikën pedagogjike të nxanësve në vjetët e fundit. Këto janë pjesë të pa ndame të shkollave normale;

c) në shkollën qytetse mund të hapen këto degë: tregtare, e punimit të hekurit, e blegtoris, e bujqësis dhe e ekonomis shtëpijake.

Ndamja e degëve fillon me klasën e tretë.

Neni 276.

Me përjashtim të gjimnazit femnuer e të normales fenmore, që mund të bashkëveprojnë si nji shkollë, nuk lejohet përziemja e shkollave të mesme lloji të ndryshëm.

Gjimnazi femnuer, që qindron i bashkuem me shkollën normale, quhet institut femnuer.

Neni 277.

Landërt dhe artet që detyrisht mësohen janë:

I. GJIMNAZ

a) të përbashkëta për të dy degët

1) Shqip,
2) Edukatë morale e qytetare,
3) Gjuhë e huej,
4) Histori,
5) Gjiografi,
6) Matematikë,
7) Histori natyre,
8) Fizikë,
9) Kimi,
10) Filozofi,
11) Drejtësi e ekonomi,
12) Histori e artit,
13) Edukatë fizike,
14) Mësime dhe stërvitje ushtarake.

b) vetëm për degën klasike

1) Latinisht,
2) Greqisht.

c) vetëm për degën reale

1) Gjuhë e dytë e huej,
2) Gjeometri deskriptive,
3) Teknologji kimike,
4) Vizatim.

II. SHKOLLË NORMALE

1) Moral dhe njoftime sociologjije të zbatueme në moral e n'edukatë,

2) Pedagogji (psikologji e zbaktueme n'edukatë; logjikë;

edukatë e didaktikë, metodikë; histori e pedagogjis; praktikë pedagogjike; Ligjë e rregullore t'arsimit filluer).

3) Shqip,
4) Gjuhë e huej,
5) Histori,
6) Gjeografi,
7) Matematikë e vizatim gjeometrik dhe njoftime kontabiliteti,
8) Histori natyre,
9) Higjene (për vajza edhe: puerikulturë),
10) Fizikë e kimi,
11) Vizatim me dorë të lirë,
12) Bukurshkrim,
13) Punë dore,
14) Muzikë e kangë,
15) Vegël muzikore,
16) Edukatë fizike,
17) Mësime e stërvitje ushtarake (për djelm),
18) Bujqësi teorike e praktike,
19) Ekonomi shtëpijake dhe punë amvise (për vajza).

Në degën normale femnore për mësuese foshnjoresh mësohen këto landë:

1) Moral e mësime qytetare,
2) Pedagogji foshnjore,
3) Shqip,
4) Gjuhë e huej,
5) Histori e gjeografi
6) Njoftime matematike,
7) Mësime natyre,
8) Higjenë (higjiene e përgjithshme dhe foshnjore),
9) Vizatim me dorë të lirë,
10) Punë dore,
11) Muzikë, kangë dhe gjimnastikë ritmike,
12) Vegël muzikore,
13) Edukatë fizike,
14) Ekonomi shtëpijake dhe punë amvise

III. INSTITUTI TREGTAR

1) Shqip,
2) Histori e përgjithshme e tregtare,

3) Gjeografi e përgjithshme dhe ekonomike,
4) Dy gjuhë të hueja,
5) Matematikë,
6) Fizikë,
7) Histori natyre,
8) Kimi,
9) Dituni sendesh,
10) Kontabilitet i përgjithshem e i zbatuem,
11) Dituni tregtare,
12) E drejtë tregtare e civile,
13) E drejtë konstitucjonale e administrative,
14) Ekonomi politike,
15) Shkencë financjare e statistike,
16) Bukurshkim,
17) Stenografi,
19) Edukatë fiizike,
20) Mësime dhe stervitje ushtarake.

IV. SHKOLLA PROFESIONALE

A. SHKOLLA QYTETSE

a) Landë të përbashkëta

1) Shqip,
3) Edukatë morale e qytetare,
3) Gjuhë e huej,
4) Histori,
5) Gjeografi,
6) Matematikë,
7) Histori natyre,
8) Vizatim,
9) Edukatë fizike,
10) Bukurshkrim,
11) Punë dore e ushtrime praktike,
12) Ekonomi shtëpijake e punë amvise (për vajza).

b) Landë të veçanta

1) Dituni natyre,
2) Njohuni kontabilitetit e tregtije,
3) Dituni sendesh,
4) Mësime bujqësore teorike e praktike,

5) Mësim praktik zejës së zgjedhun (për djelm),
6) Vizatim profesjonal (për djelm)

B. INSTITUTI TEKNIK

a) Për të gjitha degët

1) Shqip,
2) Higjenë,
3) Moral dhe edukatë profesjonale
4) Edukatë fizike.

b) Për degët me mësim katërvjeçuer

1) Mësime e stërvitje ushtarake.

Landët e veçanta, si edhe ato të përgjithshme të tjera, që kanë lidhje me mësimet specjale të profesjonit, caktohen në programet e posaçme për secilën degë.

Neni 278.

Mësimet dhe stërvitjet ushtarake jepen në vjetët e fundit të gjimnazt, të shkollës normale, t'institutit tregtar dhe të degëve me mësim katervjeçuer t'institutit teknik.

Prej këtij mësimi lirohen vetëm ata që, mbas nji shikimi të mjekvet ushtarake, rezultojnë fizikisht të pa aftë.

Provimi vjetuer i këtij mësimi ka vleftë për efektet e kalimit të klasës si çdo landë tjetër e detyrshme.

Nxanësit, që e kalojnë provimin e fundit të këtij mësimi, lirohen prej shërbimi ushtarak të zakonshëm dhe deklarohen aspirant oficerë plotësimi.

Gjithçka i përket këtij mësimi caktohet me Ligjë e rregullore të veçanta.

Neni 279

Për me kalue prej nji klase ma t'ulët në klasen ma të naltë duhet me u pasë, në mbarim të vejtit shkolluer, nota e kalimit, pa asnji përjashtim, si mbas nenit 317.

Neni 280.

Landët e artet që nuk janë të detyrshme janë:

I. GJIMNAZ

1) Teori e muzikës,
2) Vegël muzikore,
3) Bukurshkrim,
4) Vizatim i lirë, (për degen klasike).

Prej këtyne landëvet: teorija e muzikës, kanga dhe bukurshkrimi mësohen në dy klasët e para; vizatimi i lirë në katër klasët e para të gjimnazit klasik. Ndjekja e tyne asht e detyrshme për të gjithë nxanësit; por nota e përparimit nuk përban pengim për kalimin në klasën mâ të naltë.

Ndjekja e mësimit të kangës dhe të muzikës me vegla lêhet në vullnet të nxanësvet.

II. SHKOLLË NORMALE

Si landë e pa detyrshme mund të mësohet nji gjuhë e dytë e huej, e cila mund të jetë edhe latinishtja. Kjo landë, si të jetë zgjedhë prej nxanësit, mbahet si e detyrshme dhe duhet të ndiqet për sa kohë parashifet prej programës.

III. SHKOLLË PROFESJONALE

Në shkollën qytetse landë të pa detyrshme janë muzika e kanga. Në dy klaset e para ndjekja e tyne asht e detyrshme, por nota e përparimit nuk përban pengim për kalimin në klasën ma të naltë.

Neni 281.

Nxanësi, që ka ndonji të metë trupore, mbas raportit të mjekve ushtarakë, lirohet prej ushtrimeve t'edukatës fizike.

Neni 282.

Ora e mësimit për çdo landë âsht 50 minuta. Në mbarim të çdo orë mësimi pushimi âsht prej 10 minutash.

K a p t i n a e III.

V j e t i s h k o l l u e r

Neni 283.

Në të gjitha shkollat e mesme vjeti shkolluer, për çdo efekt ligjuer, fillon me 1 të tetorit dhe mbyllet me 30 të shtatorit të vjetit tjetër.

Mësimet në të gjitha klasët fillojnë me 1 të tetorit e mbarojnë me 20 të qershorit.

Përfundimi i mësimit vjetuer u kumtohet nxanësve me 30 të qershorit me shperndamjen e dëftesavet dhe të librit të veprimit shkolluer.

Mësimet e klasës së pjekunis në të gjitha shkollat e mesme

mbarojnë me 31 maj. Ato të klasës së IV të gjimnazit dhe të klasës së IV të shkollës qytetse mbarojnë me 10 të Qershorit. Nxanësve të këtyne klasëve u kumtohet përfundimi vjetuer mbrenda pesë ditëve mbas mbylljes së mësimeve.

Neni 284.

Koha e vjetit shkolluer, gjatë së cilës zhvillohen mësimet, ndahet në tremuejsh përsa i përket klasifikimit të përparimit dhe të sjelljes së nxanësit.

Neni 285.

Me përjashtim të provimit të pjekunis, mbas fillimit të mësimevet dhe gjatë zhvillimit të tyne, nuk mund të jepen provivme t'asnji kategorije.

Neni 286.

Pushimet e mëdha shkollore fillojnë me 1 të Korrikut dhe mbarojnë me 15 të Shtatorit.

Për institutin teknik pushimet e verës nuk mund të zgjasin mâ tepër se nji muej. Kët pushim nxanësit e bajnë me radhë në mënyrë që instituti të mos mbetet kurrë mbyllun.

Neni 287.

Gjatë mësimeve të rregullshme pushimet bâhen vetëm në ditët e njoftuna si festë zyrtare ase si pushim zyrtar. Për veç këtyneve çdo shkollë të mesme i lêhen në dispozicjon edhe 6 ditë tjera pushimi.

Kaptina e IV.

Dëftesat e dëshmit

Neni 288.

Mbas mbylljes mësimevet nxanësvet u jepet dëftesa vjetore e klasës me notat e përparimit për secilën landë dhe të sjelljes.

Neni 289.

Gjatë vjetit shkolluer, kur largohet nga shkolla për çfarëdo arsye nji nxanës, Drejtorija i a jep, mbas kërkesës, nji dëshmi ndjekjeje me arsyen e largimit edhe në qoftë këjo nji prej dëshkimevet të nenit 335. Në kët dëshmi duhet të shënohet edhe nota e sjelljes së nxanësit.

Nji dëshmi e tillë nxanësi mundet me e kërkue edhe pa u largue prej shkollës.

Neni 290.

Trajta e deshmive dhe e deftesave të ndryshme caktohet prj Ministris s'Arsimit. Botohen dhe administrohen prej Ministris së Financavet.

Neni 291.

Çmimi i dëshmive asht fr. ar 0.05, e i dëftesavet fr. ar 0.20.

Neni 292.

Çdo fallsifikim ase ndryshim i dëshmive e i dëftesave të shkollave të mesme ndeshkohet si mbas dispozitave të Kodit Penal.

Nxansi që falsifikon ase ndryshon dëftesën ase dëshmin shkollore përjashtohet nga të gjitha shkollat e Mbretnis.

Kaptina e V.

Taksat

Neni 293.

Për me u neshkrue në shkollat e mesme paguhet kjo taksë:

a) fr. ar 30, për nji klasë të shkallës s'ulët të gjimnazit dhe të shkollës qytetse.

b) fr. ar 20. për nji klasë t'institutit teknik;

c) fr. ar 60. për nji klasë të shkallës së naltë të gjimnazit dhe t'institutit tregtar.

Taksa e nëshkrimit paguhet në dy kiste vjetore: i pari përpara regjistrimit e i dyti mbrenda 15 të Frorit.

Taksat e pagueme nuk kthehen mbrapa për asnji arsye.

Prindët që kanë dy ase ma shumë fëmij në shkollat e mesme në të cilat paguhet taksa e nëshkrimit, paguejnë përsecilin nga gjysmen e taksës përkatëse.

Për nëshkrimet në shkollën normale dhe në degët praktike të shkollës qytetse nuk paguhet taksë.

Neni 294.

Lirohen prej pagesës së taksës shkollore të nenit të sipërmë ata nxanës që janë të vobekë dhe që kanë krye vjetin shkolluer të për parshem me së paku nota «mjaft mirë» në mësim, pa përjashtim të landëvet të pa detyrshme dhe me noten «shembëllore» në sjellje.

Neni 295.

Dëfetsës vjetore të shkollave të mesme i ngjitet nji pullë prej:

a) fr. ar 0.20. për çdo klasë të shkallës s'ulët të gjimnazit, të shkollës qytetse e t'institutit teknik. .

b) fr. ar 0.50. për çdo klasë të shakllës së naltë të gjimnazit e t'institutit tregtar.

Dëftesës së semimaturës dhe të lirimit të shkollës qytetse i ngjitet nji pullë prej fr. ari 1; asaj të pjekunis prej fr. ari 2.

Dëshmis së lëshueme si mbas nenit 289 i ngjitet nji pullë prej fr. ar 0,20.

Prej taksavet të këtij neni nuk mund të të lirohet asnji nxanës.

Dëftesat vjetore dhe të pjekunis së shkollës normale përjashtohen prej këtyne taksave.

Neni 296.

Çdo duplikati të dëftesës vjetore i gjitet nji pullë prej fr. ari 5 për nji klasë të shkollës qytetse e të shkallës s'ulët të gjimnazit, dhe prej fr. ari 10: për nji klasë të shkallës së naltë të gjimnazit dhe të shkollave të mesme të tjera, pa asnji përjashtim.

Për dublikatë dëftesash vjetore mund të përdoren vetëm dëftesa veçanërisht të shtypuna për ket qëllim.

Neni 297.

Dëftesat e semimaturës, të lirimit të shkollës qytetse dhe të pjekunis jepen vetëm nji herë. Në rast nevoje mund të lëshohen kopje të vertetueme e të shkrueme tanësisht me dorë nga Drejtorija e shkollës përkatse.

Kopjes i shenohet në krye fjala «duplikatë» dhe i ngjitet nji pullë prej fr. ari 10 për kopjen e dëftesës së semimaturës dhe të lirimit të shkollës qytetse e prej fr. ari 20 për ate të pjekunis të çdo shkolle të mesme.

Kopjet e këtyne dëftesavet, të lëshueme në ket mënyrë, mbasi të vertetohen prej Ministris s'Arsimit, kanë vleftën ligjore të plotë.

Neni 298.

Prej origjinalit të dëftesavet vjetore, t'atyne të semimaturës, të lirimit të shkollës qytetse e të pjekunis mund të lëshohet kopja prej Drejtoris së shkollës që ka lëshue origjinalin. Këto kopje vërtetohen vetëm me paraqitjen e dëftesës origjinale ase të duplikatit të nxjerrun si mbas nenevet 296 e 297, dhe taksohen me nji pullë:

a) për çdo dëftesë vjetore prej fr. ari 0.20.

b) për dëftesën e semimaturës e të lirimit të shkollës qytetse, prej fr. ari 0.50.

c) për dëftesën e pjekunis prej fr. ari 1.

Neni 299.

Për pranim në provimet e ndryshme në shkollat e mesme paguht këjo taksë:

a) për provimin e semimaturës dhe të lirimit të degës tregtare e shkollës qytetse fr. ari 10.

b) përp rovimin e pjekunis në gjimnaz e n'institutin tregtar fr. ari 20.

Prej kësaj takse lirohen ata nxanës të cilët e kanë krye klasën e vjetit shkolluer, në fund të të cilit u shtrohen këtyne provimeve, me notat: «shumë mirë» dhe «mirë» në përparim dhe «shembëllore» në sjellje, dhe janë të vobekë.

Për provimin e pjekunis në shkollën normale e n'institutin teknik për herën e parë, nuk paguhet asnji taksë.

Neni 300.

Taksa e nenit të sipërm paguhet edhe për çdo përsëritje të plotë të këtyne provimeve, pa përjasntim t'atyne të shkollës normale e t'institutit teknik.

Neni 301.

Ata, që, si të jashtëm, japin provim në shkolla të mesme, paguejnë, përveç taksës shkollore të nenit 293 për secilën klasë, edhe ket mbitaksë shkollore:

a) për çdo landë të detyrshme fr. ari 3.

b) për çdo landë të pa detyrshme fr. ari 1.

Këta për provimet e semimaturës dhe të pjekunis u shtrohen vetëm taksave të nenit 299, si nxanësit e rregullshëm.

Neni 302.

Çdo taksë shkollore paguhet n'arkat e financavet të Shtetit.

Neni 303.

Pullat, që u ngjiten deftesave dhe deshmive shkollore, kanë shenimin dallues: «taksë arsimore».

Neni 304.

Drejtori, që, në lëshimin e diftesavet e të dishmive shkollore, si edhe në pranim në provime, vepron në kundërshtim me përmbajtjen e nenevet të sipërme, ndeshkohet, përveç si mbas dispozitave të Ligjës së Pullave, edhe dishiplinarisht.

TITULLI II.
Nxanësit
Kaptina e I.
Nëshkrimet

Neni 305.

Në shkolla të mesme, të çdo lloji, pranohen vetëm nxanës të rregullshëm si mbas përshkrimevet të nenevet përkatëse. Nuk mund të pranohen, për asnji arsye, nxanës të pa rregullshëm ase nen titullin «ndigjues», as nxanës të martuem.

Neni 306.

Nënshkrimi në klasët e ndryshme bâhet në ditët e caktueme me paraqitjen personale të nxanësit. Vetëm në rast sëmundjeje ase pengimi, të pranueshëm prej Drejtorit, mund të bahet edhe me anë të nji persone tjetër.

Nëshkrimi bahet vetëm në bazë të dokumentit ligjuer të paraqitun n'origjinal ose duplikat.

Neni 307.

Mosha për me u pranue në kl. I të gjimnazit duhet të jetë jo mâ e vogël se 11 të mbushuna as mâ e madhe se 13 vjetësh, e në mes të 11 të mbushuna e 16 për klasën e I të shkollës qytetse.

Për nëshkrimin në klasën e V. të gjimnazit, në klasën e I të shkollës normale dhe në klasën e I t'Institutit Tregtar nxanësi duhet të ketë moshën në mes të 15 të mbushuna e 18 vjetvet. Për nëshkrim në degën për foshnjore të sthkollës normale femnore mosha duhet të jetë në mes të 16 e 20 vjetve.

Për nëshkrimin në klasën e I t'Institutit Profesjonal mosha nuk mund të jetë ma e vogël se 15 vjetësh.

Neni 308.

Në klasën e I të gjimnazit dhe të Shkollës Qytetse pranohen ata, të cilët kanë dëftesën e lirimit të shkollës fillore.

Në klasën e V të gjimnazit, në klasën e I-rë të shkollës normale e të degës për foshnjore dhe në klasën e I t'institutit tregtar pranohen ata që kanë krye shkollën qytetse ase të katër klasët e para të gjimnazit.

Dëftesa e lirimit të degës tregtare të shkollës qytetse jep të drejtën me vazhdue mësimet edhe në shkolla të tjera të mesme shkalle të naltë mbas modaliteteve të caktueme në rregulloren.

Neni 309.

Nëshkrimet në klasët e ndryshme kryhen prej 16 deri 25 të shtatorit.

Jashtëzakonisht nëshkrimet mund të pranohen deri me 30 inkl të shtatorit; por për të këtilla nëshkrime duhet pëlqimi i shkruem dhe i motivuem i trupit mësimuer të shkollës veçanëisht për çdo nxanës. Mbas kësaj date e ederi me 5 të tetorit nëshkrimi mund të bahet vetëm me pëlqim të Ministris s'Arsimit, në qoftë se këjo e pranon arsyen e vonesës.

Për institutin profesjonal nëshkrimet në klasën e I për çdo degë mund të bahen prej Drejtorit edhe pa vendim të veçantë të trupit mësimuer, deri me 15 tetorit.

Neni 310.

Nxanësit, që nëshkruhen në klasën e parë, si edhe ata që për herën e parë nëshkruhen në çdo klasë të shkollës së mesme, në bazë të mësimevet të ndjekuna në nji tjetër shkollë, duhet të paraqesin n'afatin e treguem në nenin e sipërm:

a) kërkesën me shkrim të drejtueme Drejtoris së shkollës së mesme për pranimni në klasën përkatëse;

b) dëftesën e lirimit të shkollës fillore ase dëftesën e shkollës së mesme të ndjekun mâ parë;

c) dëshmin e zyrës së Gjendjes Civile.

Këta tre dokumenta ruhen n'arkivën e shkollës. Në rasë shpërnguljeje në nji tjetër shkollë, dy dokumentat e fundit, mbas kërkesës së shkollës në fajlë, i dërgohen kësaj dhe në vend të tyne ruhet kërkesa.

Pranimi në klasën e parë të shkollës normale bâhet në bazë të nji konkursi, modalitetet e të cilit caktohen në rregulloren. Por çdo nxanës mâ parë i shtrohet shiqimit shëndetësuer nga ana e nji komisjoni të përbam prej së paku dy mjekësh të caktuem prej Ministris s'Arsimit. Në rast se vërtetohet ndonji sëmundje ase paraqitet ndonji e metë fizike ase anomali, që mund të pengojnë ushtrimin e mirë të mësuesis ase të rrezikojnë autoritetin që nji edukues duhet të ketë në sy të nxanësve, kandidati nuk pranohet në konkurs. Smundjet, të metat fizike e anomalit të cilat përjashtojnë pranimin në shkollën normale, caktohen në rregulloren.

Neni 311.

Ditën e fillimit të mësimevet të rregullshme Drejtorija e shkollës i njofton telegrafisht Ministris s'Arsimit:

a) numrin e përgjithshëm të të nëshkruemvet;
b) numrin e të nëshkruemvet të rij.

Ky njoftim do të përsëritet mâ vonë në raportin e fillimit të vjetit shkolluer, si mbas nji pasqyre të caktueme në rregulloren.

Raporti i përgjithshëm i fillimit të vjetit shkolluer duhet të mrrijë në Ministrin e Arsimit mbrenda muejit të tetorit.

Numri i fundit i Amzës së shkollës i njoftohet Ministris në raportin e përgjithshëm të mbylljes së mësimeve.

Kaptina e II.

Mungesat

Neni 312.

Mungesat e nxanësvet prej mësimevet shenohen veçanërisht për çdo orë mësimi.

Neni 313.

Nxansit, qi gjatë vjetit shkolluer bân mâ se 150 mungesa t'arsyeshme, i jepet, mbas mbylljes së mësimevet të rregullshme, e në rast se nuk i shtrohet provimit mbrenda qershorit, nji dëshmi ndjekjeje pa nota dhe me shprehje «nuk e ka krye klasën për shkak mungesash t'arsyeshme». Dëftesa vjetore dorëzohet mbas njij provimi të përgjithshëm të klasës përkatëse si mbas nenit 347. Për kët provim nuk paguhet taksa e nëshkrimit e nenit 293, në qoftë se janë pague të dy kistet, as mbi taksa e nenit 301, po qe se jepet në qershuer ase në shtatuer t'atij vjeti shkolluer.

Neni 314.

Nxanësit, që gjatë vjetit shkolluer, ban mâ se 30 mungesa të pa-arsyeshme i zbatohet pika *b* e nenit 335.

Nxânësit, që gjatë vjetit shkolluer, bân mâ pak se 30 mungesa të pa arsyeshme, i zbritet nota e sjelljes në nji shkallë ma t'ulët për çdo dhetë mungesa ase pjesë 10 mungesash, pavarsisht nga zbritjet e shkaktueme për faje dishiplinore.

Kaptina e III.

Klasifikimi

Neni 315.

Seicili mësues e ka për detyrë me pyetë me zâ sa mâ shpesh nxanësin e në çdo rast të paktën nji herë në muej.

Neni 316.

Në shkollat e mesme përdoren këto nota:

a. Përparim:		*b. Sjellje:*	
shumë mirë	1	shembëllore:	1
mirë:	2	e urtë:	2
majft mirë:	3	mjaft e urtë:	3
kalueshëm:	4	e durueshme:	4
dobët:	5	e pa pëlqyhsme:	5
shumë dobët:	6	e keqe:	6

Në dëftesat e ndryshme shenohet edhe numri i klasifikimit të nxansit, që kalon klasën, nder shokët e klasës së tij.

Hollësinat mbi mënyrën e caktimit të notave jepen me rregulloren.

Neni 317.

Kalojnë në klasën ma të naltë pa provim, ata nxanës, të cilët në të gjitha landët e detyrshme kanë diftue nji përfundim së paku të kalueshem (4).

Nxanësi, që në përfundimin vjetuer ka:

a) notën «dobët» në nji ase dy landë të detyrshme; ase

b) notën «shumë dobët» në nji landë të detyrshme, lejohet me i u shtrue riprovimit n'atë ase n'ato dy landë në vjeshtë. Mosfitimi në kët provim shkakton përsëritjen e klasës.

Nnxansi, që në përfundimin vjetuer, ka:

a) notën «dobët» në tri ase ma shumë landë të detyrshme, ase

b) notën «shumë dobët» në dy ase ma shumë landë të detyrshme, si edhe ai qi ka nji notë «dobët» e nji «shumë dobët» në landët e detyrshmë, e përsërit klasen.

Neni 318.

Nxanësi, qi në sjellje fiton notën e «durueshme» (4) nuk e kalon klasen si mbas nenit 317, por i shtrohet provimit të përgjithshëm në muejin e qershorit ase të shtatorit; nxanësi me notën «e pa pëlqyeshme» (5) në sjellje, i shtrohet këtij provimi vetëm në vjeshtë, ai me notën «e keqe» (6) në sjellje e përsërit klasen. Në të tri këto raste nxanësi, që prej ditës, në të cilën i asht zbatue në sjellje njena nga notat e sipërme, nuk klasifikohet mâ në përparim.

Si kandidat për klasen e parë të shkollës normale mund të paraqitet vetëm ai nxanës që, në vjetin shkolluer të mbram, ka pasë

BKSH

në sjellje të pakten notën «e urtë» (2). Nxanësi i klasës I, II e III të shkollës normale, që ka në sjellje notën «e durueshme» (4) e përsërit klasën; nxanësi i klasës së IV të shkollës normale me ket notë në sjellje e humbet për at vjet të drejtën e provimit të pjekunis në shkollën normale dhe përjashtohet nga shkolla me nji herë; gjithashtu përjashtohet nga shkolla për at vjet nxanësi i çdo klase të skkollës normale që merr në sjellje notën «e pa-pëlqyeshme, (5) ase «e keqe» (6).

Neni 319.

Me nji herë mbas mbylljes së tremuejshit të dytë, Këshilli i shkollës, mbas proponimit të Këshillit të klasës, mundet me përjashtue për at vjet, nga shkolla nxanësin që ka notën «dobët» ase «shumë dobët» në mâ se 4 landë të detyrshme.

Këjo masë nuk zbatohet në shkollën qytetse e institutin teknik.

Neni 320.

Riprovimet e përmenduna në nenin 317 zhvillohen prej 16 deri 22 të shtatorit.

Kaptina e IV.

Provimet

Neni 321.

Gjatë vazhdimit të mësimevet në shkollën e mesme, nxanësit u shtrohen këtyne provimeve të veçanta:

1) provimit të lirimit të shkollës qytetse mbas mbarimit të klasës së katërtë;

2) provimet të semimaturës mbas mbarimit të klasës së katëtërtë të gjimnazit;

3) provimit të pjekunis në gjimnaz, në shkollën normale e n'institutin tregtar mbas mbarimit të klasës së fundit; vetëm dëftesa e këtij provimi jep të drejtë me vazhdue mësimet n'universitet e shkolla të nalta;

4) provimit të pjekunis në degët e ndryshme t'insitutit teknik mbas mbarimit të klasës së fundit. Ky provim quhet «provim i aftësis profesionale».

Provimi i pjekunis dhe ai i aftësis profesionale zhvillohet përpara të dërguemit ase të dërguemve të Ministris s'Arsimit.

Temat e provimevet me shkrim të pjekunis dhe t'aftësis profesjonale dërgohen prej Ministris.

Këto provime jepen në muejin e qershorit mbas mënyrës së caktueme me rregulloren.

Neni 322.

Nxanësit e klasëvet të IV të shkollës qytetse, të IV e të VIII të gjimnazit, të kl. IV të shkollës nomrale e t'institutit tregtar dhe të klasës së fundit të degëve t'institutit teknik, që mbas përfundimit vjetuer të klasës përkatëse, kanë mbetë për riprovim në vjeshtë u shtrohen në shtatuer provimet në të cilat kanë mbetë; qi të kenë marrë notat e kalimit në landët e riprovueme, atëherë mund të hyj-në në provimet e përmendua në nenin 321.

Neni 323.

Përsëritet provimi i semimaturës dhe i pjekunis në gjimnaz kur del përfundimi:

a) në gjuhën shqipe «shumë dobët»;
b) në çdo landë «shumë dobët»;
c) në nji landë «dobët» dhe në njj tjetër «shumë dobët»;
ç) në gjuhen shqipe dhe në nji tjetër landë «dobët».

Neni 324.

Përsëritet provimi i pjekunis n'institutin tregtar kur përfundimi në dy ase ma landë del «shumë dobët» ase në nji «shumë dobët» e në nji tjetër «dobët».

Neni 325.

Përsëritet provimi i pjekunis në shkollen normale kur paraqitet ndonji prej rasteve të nenit 323, ase kur përfundimi i provimit praktik ase i pedagogjis asht «shumë dobët», si edhe kur përfundimi i njenit prej këtyne dy provimeve bashkë me ate të nji tjetër lande âsht «dobët».

Neni 326.

Përsëritja e provimeve të naltpërmenduna nuk mund të bahet po n'atë vjetë shkolluer.

Neni 327.

Nxanësi ka të drejtën e riprovimit në njenin nga rastet e poshtëshenueme:

a) kur përfundimi i shqipes në semimaturë e në pjekuni të gjimnazit e të shkollës normale âsht «dobët»;

b) kur përfundimi i provimit praktik ase i pedagogjis në shokllën normale âsht «dobët»;

c) kur përfundimi i nji çdo lande âsht «shumë dobët», ase i të shumtën dy çdo landëve asht «dobët» me përjashtimet e parapame në nenet 323 e 325.

Riprovimet bahen në vjeshtë, me përjashtim t'atij të provës praktike që mund të jepet në kallnduer.

Neni 328.

Kondital e përsëritjes dhe të riprovimit të provimeve të lirimit të shkollës qytetse dhe t'aftësis profesjonale në degët e ndryshme t'institutit teknik caktohen: për të paren në rregulloren e për të dytën në programën e mësimeve t'institutit.

Neni 329.

Nxanësi që rrëzohet në provimin e pjekunis të normales, për t'u pranue, mbas nji vjeti përsëri në provim, duhet të paraqesi nji deshmi, me të cilen të vërtetojë se ka bâ nji praktikë mësuesije të vazhdueshme për nji tremuejsh të paktën në nji shkollë fillore. Shkollat në të cilat mund të bajnë praktiken e naltpërmendun caktohen prej Ministris.

Kaptina e V.

Ndrrimi i degëve ase i shkollave

Neni 330.

Nxanësit e shkollave të mesme të hueja dhe ata, që kalojnë prej nji shkolle të mesme në nji tjetër me qëllim e program të ndryshëm ase prej nji dege në nji tjetër, do t'u shtrohen provimeve plotsuese n'ato landë të detyrëshme, të cilat nuk i kanë mësue në shkollen e përparëshme ase i kanë mësue mbi nji tjetër bazë e nder kufi ma të ngushta.

Për plotësimin e çdo klase, pa marrë parasyshë numrin e landëve, paguhet tanësisht taksa shkollore si mbas nenit 293, në qoftë se nuk asht pague, ase pjesërisht në qoftë se asht pague ma parë në sasi ma të pakët për klasen përkatëse në nji shkollë Shqiptare; gjithashtu paguhet mbitaksa e provimit për çdo landë e për çdo klasë si mbas nenit 301.

Kaptina e VI.

Shpërngulja

Neni 331.

Gjatë vjetit shkolluer nji nxanës mund të shpërngulet prej nji shkolle të mesme në nji tjetër t'atij lloji vetëm kur paraqitet njena prej këtyne konditave:

a) kur ndrron vend banimin familja e tij;

b) kur âsht bursjer i Shtetit dhe shpërnguljen e tij e gjykon t'arsyeshme Ministrija e Arsimit;

c) kur prindi ase kujdestari ka arsye të randa për shpërnguljen.

Neni 332.

Pranimi në shkollen tjetër bahet mbas nji kërkese të shkrueme dhe në bazë të vërtetimit të njenës nga kondital e sipërme e të dëshmis së shkollës së maparëshme.

Ndërkoha ndërmjet të heqjes nga nji shkollë dhe të paraqitjes në shkollë tjetër nuk mund të jetë në çdo rast mâ se 5 dit, tue mos llogarit ditën e lëshimit të dëshmis.

Neni 333.

Dokumentat e tjerë të nxanësit të shpërngulun dhe, rastësisht, notat e fitueme deri në ditën e shpërnguljes, kërkohen prej shkollës, në të cilën pranohet nxanësi.

Neni 334.

Nxanësi, i larguem nji herë me vullnet të vet nga nji shkollë, nuk mut të ripranohet n'atë shkollë për at vjet shkolluar pa u pasë nëshkrue mâ parë në nji tjetër shkollë dhe pa u pasë riparaqitë ndonji konditë e nenit 321.

Kaptina e VII.

Ndeshkimet

Neni 335.

Nxanësit e shkollave të mesme duhet në çdo rast të tregohen të bindshëm e të njerzishëm.

Çdo sjellje jo e pëlqyeshme vepër e pa hijeshme dhe e pa përshtatëshme cilsis së nxanësit e në kundërshtim me ndonji nga qëllimet e shkollës së mesme, si edhe çdo mos bindje e mungesë nderimi shkakton, si mbas randësis, nji nga ndëshkimet që vijojnë:

a) rrëzimin e notës në sjellje;
b) dbimin nga shkolla për nji vjet;
c) dbimin nga shkolla për dy vjet;
ç) dbimi nga të gjtiha shkollat.

Neni 336.

Për sjellje kundra moralit, për të fyeme institutit që ndjek ase ndonji pjestari të trupit mësimuer, për shfaqje instinktesh kundra

BKSH

shoqnore. i zbatohen nxanësit dëshkimet e pikave *c* e *ç*, si mbas rethanave që mund të kenë shkaktue at faj.

Neni 337.

Ndëshkimin nën pikën *a* e shqypton, si mbas radhës së caktueme në rregulloren Drejtori, Këshilli i klasës e Këshilli i shkollës. Ato të pikave të tjera vetëm Këshilli i shkollës.

Ndeshkimet e pikave *c* e *ç* përmbarohen mbas pëlqimit të Ministris, por nxanësi, për kët kohë, pezullohet nga mësimi. Ndeshkimi i pikës *b* i njoftohet Ministris për dijeni.

Neni 338.

Nxanësi i ndeshkuem me nji nga deshkimet e pikave *b*, *c*, *ç*, mundet, mbrenda 10 ditëve mbas shpalljes së ndeshkimit, me i u sjellë Ministris s'Arsimit, e cila ka të drejtë nderhymjeje vetëm në këto raste:

1) me e lehtësue ndeshkimin, në qoftë se paraqiten nga ana e interesueme fakte të reja, që paksojnë ase asgjasojnë fajin e ndeshkuem; në kët rast urdhnon nji gjykim të ri nga Këshilli i shkollës, i cili asht definitiv;

2) me e kthye ndeshkimin e dhanun prej Këshillit të shkollës në nji ndeshkim ma të randë, në qoftë se prej raportit të Drejtoris shef se fajit nuk i asht dhanë ndeshkimi i përshtatëshem.

Neni 339.

Nxanësi, që ka pësue ndeshkimin e pikës *b*, nuk mundet për at vjet shkolluer të nëshkruhet ase t'i shtrohet provimit n'asnji shkollë; po kët ndalim shkakton për dy vjet shkollore ndeshkimi i pikës *c*.

Ndeshkimi i pikës *ç* bjen me vedi dbimin për gjithmonë, si për ndjekje ashtu për provime, nga shkolla e tij dhe për tri vjet shkollore nga të gjitha shkollat e Mbretnis, pa të drejtë provimi gjatë kësaj kohe.

Neni 340.

Masat e tjera dishiplinore caktohen në rregulloren.

Neni 341.

Në kohen e pushimevet të verës nxaësit janë të detyruem të mbajnë sjelljen e përshkrueme prej ligjëvet e rregullorevet arsimore. Çdo të shmangun nga detyrët e nxanësit dhe ga sjellja e

mirë i nenvehet ndeshkimevet të caktueme me nenin 335 ase me rregulloren.

Neni 342.

Nxanësit qi ndjekin mësimet e stërvitjet ushtarake gjatë periudhave fushore u shtrohen ndeshâimeve dishiplinore ushtarake, si mbas mënyrës që caktohet në Ligje e Rregullore të veçanta.

Neni 343.

Çdo ndeshkimi i zbatuem duhet t'i njoftohet prindit ase kujdestarit të nxanësit, dhe të shenjohet n'amzën e shkollës.

Neni 344.

Ndeshkimet në pikat *b*, *c*, *ç* të nenit 335 botohen, me emnin e të ndeshkuemit, në të përkohshmen zyrtare të Ministris dhe u njoftohen të gjitha shkollave të mesme.

Kaptina e VIII.

Provimet për të jashtmit

Neni 345.

Ata, që nuk i kanë fillue mësimet e mesme ase i kanë krye vetëm pjesërisht, munden të paraqiten në çdo shkollë, me përjashtim të shkollës normale, në muejin e qershorit për t'i u shtrue provimit për nji ase, të shumtën, dy klasë, në qoftë se kanë këto kondita :

1) të mos kenë ndjekë ata vjet shkolluer nji shkollë si nxanës të rregulishem;

2) të kenë moshën të paktën : 16 vjetësh për klasët e nji shkolle të mesme shkalle t'ulët, dhe 20 vjetësh për ato të nji shkolle shkalle të naltë.

Neni 346.

Për me u pranue në provimet e lejueme mbas nenit të sipërm, duhet të paraqiten :

1) për klasën e parë të shkollave të mesme shkallë t'ulët : dëftesa e lirimit e shkollës fillore; për vjetin e parë të nji shkolle shkallë të naltë : dokumenti ligjuer i parapam prej kësaj Ligje;

2) për klasët e tjera të çdo shkolle të mesme : dëftesa e klasës mâ t'ulët.

Neni 347.

Kalimi ase moskalimi në klasën mâ të naltë i nxanësvet, që provohen si të jashtëm, nxiret prej notave të provimit në bazë të rregullores.

TITULLI III.

Personeli i shkollavet të mesme

K a p t i n a e I.

Organet shkollore dhe detyrët e tyne

Neni 348.

Organet e shkolave të mesme janë:

a) Drejtori i shkollës.
b) Këshilli i shkollës,
c) Këshilli i klasës,
ç) Kryetari i klasës.

Neni 349.

Detyrët e Drejtorit janë:

a) me e drejtue dhe mbajtë shkollën mbas Ligjëvet, Rregullorevet e instrukcjonevet të Ministris s'Arsimit;

b) me u kujdesue për mësimin dhe edukimin e djelmënis, qi e ndjek istitutin e tij;

c) me kontrollue, me mënyrë të pëlqyeme prej Ministris, veprimet e trupit mësimuer, me qëllim që të mbikqyrë vazhdimisht për çdo profesuer ase mësues: paraqitjen e tij me kohë e rregull në mësime, mënyrën e mësimit dhe gatitjen e përditëshme, si edhe zhvillimin e programës të caktueme;

ç) me qortue dhe me ndreqë të metat e mësimit e të ndjekjes së profesorve dhe të mësuesve, tue dhanë këshillë, shpjegime dhe udhëzime të nevojshme;

d) me nënshkrue dëftesat dhe dëshmit e nxanësve si edhe çdo akt të shkollës.

Detyrët e tjera të Derjtorit caktohen në Rregulloren.

Neni 350.

Drejtori i nji shkolle të mesme nuk mundet në asnji kohë me dhanë mësime, me pagesë ase falë, në nji shkollë tjetër ase jashtë shkollës, nuk mundet me pranue asnji detyrë tjetër, çdo natyre qoftë, me pagesë.

Neni 351.

Këshillin e shkollës e përban trupi mësimuer. E kryeson Drejtori,, e, në mungesë të tij, profesori mâ i moçem në sherbim.

BKSH

Neni 352.

Këshilli i shkollës mblidhet me thirrje të shkrueme nga ana e Drejtorit në mbledhje të zakonshme:

1) në fillim e në mbarim të mësimevet,

2) në mbarim të tremuejshit të parë e të dytë.

Mbledhjet e jashtëzakonëshme mbahen si mbas nevojes së shfaqun.

Mbledhjet mbahen vetëm në kohen e lirë prej çdo mësimi dhe janë të ligjëshme vetëm me pranin e pesë të gjashtëvet të trupit mësimuer.

Neni 353.

Këshilli i shkollës merr vendime me shumicë votash; në mungesë të kësaj randon vota e kryetarit.

Vendimet nënshkruhen prej kryetarit dhe prej atyne që janë në mbledhje. Drejtori i zbaton dhe, si mbas rastit, i shpall.

Antari, që âsht në kunderhtim me vendimin e shumicës, duhet t'a shkruejë mendimin e vet në protokolin e mbledhjevet deri sa mbledhja âsht e hapun.

Nji çâshtje, për të cilën âsht marrë vendim, nuk mund të vehet prap në bisedim pa lejen e Ministris.

Neni 354.

Kur Drejtori gjykon se ndonji vendim i Këshillit të shkollës âsht në kundershtim me Ligjet ase rregulloret, ase kur mendon se nji vendim nuk asht përgjithsisht në dobi të shkollës, të mësimit dhe t'edukatës së nxanësve, atëherë, mâ parë se t'a zbatojë, duhet të lajmojë Ministrin e Arsimit, e cila vendos definitivisht. Në çdo rast, vendimet në kundërshtim me Ligjet ase rregulloret arsimore nuk mund të zbatohen; për ndryshe përgjegjsija âsht vetëm e Drejtorit.

Neni 355.

Këshilli i shkollës:

a) ndan landët ndër mësuesit, tue marrë parasysh degën e veçantë të secilit;

b) shfaq mendimin mbi hapjen e klasëve paralele;

c) ndigjon në mbarim të çdo tremuejshi raportet e kryetarvet të klasëvet mbi përfundimin e mësimit dhe të sejlljes së nxanësve, dhe cakton n'atë rast, ase mâ parë, në mbledhje të jashtëzakonëshme, masat për përmirësimin e mësimit dhe t'edukatës;

ç) cakton orarin e provimeve të çdo kategorije;

BKSH

d) cakton ditët e shetitjeve shkollore;

dh) cakton ditët e pushimit të lejuem me pjesën e fundit të nenit të 287;

e) cakton, si mbas kësaj Ligje dhe Rregullores përkatëse, ndeshkimet nxanësvet;

ë) jep vendime mbi blemjen e veglave shkollore, tue pasë gjithnji parasysh kredin e dhanun dhe nevojët që, nga këjo pikëpamje, shkallë më shkallë paraqiten;

f) paraqet Ministris s'Arsimit mendime mbi nevojët e ndrrimit të Ligjëvet e të Rregulloreve arsimore si edhe të programevet shkollore, tue u frymzue me qëllimet që ndjek në Shqipni shkolla e mesme;

g) vendos mbi çdo nevojë tjetër të parashtrueme prej ndonji Këshilli të Klasës ase prej Drejtorit, me përjashtim të çashtjevet administrative të shkollës, të cilat janë në kompetencë dhe përgjegjësi të Drejtorit.

Neni 356.

Prej veprimevet të Këshillit të shkollës i paraqiten Ministris s'Arsimit për pëlqim ase zgjidhje:

1) vendimi mbi ndamjen e landëvet ndër mësues dhe orari i përjavshëm i mësimit për çdo klasë;

2) vendimi mbi orarin e provimevet;

3) vendimet me të cilat Drejtori nuk bashkëzanon;

4) vendimet mbi ndeshkimin e nxanësve si mbas nenit 335

5) mendim mbi hapjen e kalsëvet paralele.

Neni 357.

Këshilli i klasës përbahet prej Kryetarit të klasës dhe të gjithë profesorvet dhe mësuesvet t'asaj klase. E kryeson Kryetari i klasës, kur nuk merr pjesë në mbledhje Drejtori.

Neni 358.

Këshilli i klasës mban mbledhje të zakonshme dhe të jashtzakonshme, mbas thirrjes me shkrim të Drejtorit. Mbledhja e Këshillit nuk âsht e ligjëshme kur në të mungon mâ shumë se nji antar.

Mbledhjet e zakonshme mbahen në fillim të vjetit shkolluer, në mes dhe në fund të çdo tremuejshi; të jashtzakonshmet si mbas nevojës.

Neni 359.

Këshilli i klasës në mbledhjet e zakonshme:

a) cakton masat për përfmirësimin e edukatës dhe të para-

qitjes së mësimit, tue kërkue nji rrugë bashkëzanimi në mësimin e gjithë landëvet dhe bashkpunimi për zgjimin dhe zhvillimin e ndiesive njerzore e atdhedashëse të nxanësve;

b) cakton radhën e punimit të detyrve shkollore me shkrim;

c) cakton sjelljen e nxanësve në fund të çdo tremuejshi dhe në mbarim të vjetit shkolluer;

ç) zbaton nxanësvet ndeshkimet mbas rregullores;

d) merr vendime të preme mbi kalimin e nxanësvet në klasën mâ të naltë, mbi përsëritjen e klasës dhe mbi provimet e prsritjes në vjeshtë.

Neni 360.

Të gjitha vendimet e Këshillit të klasës shenohen, radhë mbas radhe, në nji protokol të veçantë për secilën klasë.

Këshilli i klasës merr vendimet me shumicë votash t'antarve që marrin pjesë në mbledhje. Kur mungon shumica randon vota e kryetarit të Këshillit, përveç në rast të pikës d. të nenit 359, kur në mungesë të nji shumice, merret parasysh ana e profesorit të landës

Antari, që nuk âsht i nji mendimi me vendimin e Këshillit, duhet me e shkrue, ndersa mbledhja âsht e hapun, kundërshtimin e vet në protokolin e mbledhjevet.

Kryetari i klasës lajmon Drejtorin, në qoftë se ky nuk ka marrë pjesë në mbledhje, mbi vendimet e marruna prej Këshillit.

Drejtori, kur e gjyêon të pa zbatueshëm nji vendim të Këshillit të klasës, duhet, mbrenda dy ditvet, me e mbledhë Këshillin e shkollës, të cilit i a parashtron çashtjen.

Neni 361.

Çdo klasë e nji shkolle të mesme ka Kryetarin e vet të zgjedhun në mes të profesorve ase mësuesve të ngarkuem me mësime në tê.

Neni 362.

Kryetari i klasës ka për detyrë:

a) me u përkujdesë me ato mënyrë e ato mjete, që i gjykon, bashkë me Drejtorin, të përshtatëshme për edukimin e dishiplinen e nxanësve të klasës së vet;

b) me mbikqyrë, me vrejtjen ma të madhe, ndjekjen e mësimit nga ana e nxanësvet; me u kërkue këtynve për çdo mungesë nga mësimi justifikimin jo mâ vonë se ditën e dytë t'ardhjes në shkollë mbas mungesës së mbrame;

c) me mbledhë, me mâ të madhin kujdes, mungesat e nxanësvet në nji regjistër të veçantë muej për muej;

ç) me lajmue Drejtorin, me nji raport të veçantë, për shrregullim a ngjarje të papëlqyeshme të klasës së vet, si edhe kur mungesa e nxanësit zgjatet për mâ se 3 ditë pa ndonji paralajmim;

d) me kontrollue për ditë shenimet, që ban mësuesi mbi mësimin e përditshem, dhe me shenjue në regjistrin e veçantë çdo mungesë të mësuesit;

dh) me plotësue e me nënshkrue dëshmit e dëftesat e nxanësvet të klasës së vet.

Kaptina e II.

Personeli didaktik

Neni 363.

Trupin mësimuer të nji shkolle të mesme e përbajnë:

a) Drejtori,

b) Profesorët,

b) Mësuesit.

Neni 364.

Drejtori dhe profesorët duhet të kenë krye nji shkollë të mesme të plotë e të njoftun, dhe të kenë ndjekë si nxanës të rregullshem, nji degë të përshtatëshme Universiteti ase Shkolle të naltë, tue dhanë të gjitha provimet që kërkohen për nji gradë akademike të njoftun si mbas ligjëvet të Shtetit në të cilen gjindet Universiteti ase Shkolla e naltë.

Ata, që emnohen mbas hymjes në fuqi të kësaj Ligje për dy vjetët e parë të sherbimit quhen suplent.

Neni 365.

Janë profesorë shkollash të mesme edhe të gjithë ata që përfshihen prej kategoris I e II të nenit 11 të Ligjës mbi Kategorizimin datë 12-IV-1926, por t'emnuem para hymjes në fuqi të kësaj Ligje.

Neni 366.

Quhen mësues të gjithë ata që nuk i kanë cilsit e dy neneve të sipërme.

Neni 367.

Nji shkollë e mesme me së paku 300 xanës ka mjekun e vet të rregullshëm, i cili, përveç shërbimit mjeksuer për çdo nevojë shëndetësore të konviktorve e të nxanësve, detyrohet me mbajtë deri 8 konferenca higjenike në vjet për çdo klasë ase grup klasësh, si mbas programës që t'i paraqitet.

BKSH

Dy shkolla të mesme të nji qyteti mund të kenë nji mjek të përbashkët.

Shpërblimi i mjekut shkolluer âsht 100 deri 150 fr. ari në muej.

Hollësinat e detyrvet të mjekut shkolluer caktohen në rregulloren.

Neni 368.

Trupi mësimuer i nji shkolle të mesme ngarkohet me këto orë të përjavëshme mësimi:

a) Drejtori i Gjimnazit të plotë, i institutit tregtar, i institutit profesional, i shkollës normale me deri 8 orë;

b) Drejtori i shkollës qytetse e i gjimnazit të ulët me 12 deri 16 orë;

c) profesorët e mësuesit e landëvet me 18 deri 22 orë;

ç) mësuesit e artevet dhe t'edukatës fizike me 22 deri me 24 orë;

d) mësuesit e mësimeve praktike me 36 deri 42 orë prej të cilave nuk mund të jenë ma tepër se 12 orë, mësimi teorik.

Neni 369.

Për orët e tepërme, që mund t'i ngarkohen nji profesori ase nji mësuesi të shkollës së mesme, jepet nji shpërblim fr. ari 2.50 për çdo orë. Shpërblimi llogaritet mbas orëvet efektivisht të bamuna. Shërbimi vertetohet prej Drejtorit.

Kaptina e III.

Personeli administrativ

Neni 370.

Në shkollat e mesme shkalle t'ulët me numer nxanësish të nënshkruem ma të madh se 400, si edhe n'ato shkalle të naltë, emnohen nji sekretar i veçantë për përmbarimin e punvet administrative.

Sekretari duhet të ketë krye të pakten nji shkollë të mesme shkallë t'ulët. Rroga e tij asht 120 fr. ar në muej. Detyrët e sekretarit caktohen me rregullore.

Neni 371.

Në çdo rast tjetër Drejtori në fillim të vjetit shkolluer, me pëlqim të Ministris, zgjedh për sekretar nji nga trupi mësimuer. Ky ndihmon Drejtorin në përmbarimin e administrimit dhe në

rregullimin e arkivës shkollore, tue marrë minimumin e orëvet të mësimit dhe nji shpërblim prej 20 fr. ar në muej që prej fillimit të mësimevet deri me 15 të Korrikut.

Neni 373.

Në fillim të vjetit shkolluer Këshilli i shkollës zgjedh në mes të trupit mësimuer bibliotekarin. Ky rregullon bibliotekën e shkollës si mbas dispozitave përkatëse dhe asht përgjegjës për çdo humbje ase shrregullim.

Bibliotekari në vend të nji shpërblimi merr minimumin e orëvet të mësimit. Në rast se biblioteka shkollore përdoret si blibiotekë botore, merr nji shpërblim prej 20 fr. ar në muej që nga fillimi i mësimeve e deri me 30 të Qershorit.

Neni 372.

Në shkollat e mesme çdo përmbledhje veglash mësimore, si mbas degës asht në kujdesin e mësuesit ma të naltë me kategori të landës përkatëse.

Kaptina e IV.

Gjendja juridike e profesorëve dhe e mësuesve

Neni 374.

Me përjashtim të nenevet: 91 - 101, 114 - 116, 118, 128, 129, 144, 145, 147 - 153, profesorve dhe mësuesve të shkollave të mesme u zbatohen dispozitat e Titullit III të Pjesës II të kësaj Ligje.

Neni 375.

Drejtori, që merr nji ndeshkim ma të randë se «qortimi», degradohet dhe transferohet në nji shkollë tjetër.

Neni 376.

Profesorët e mësuesit e shkollavet të mesme nuk munden me dhanë mësime private nxanësvet që ndjekin shkollën në të cilen sherbejnë.

PJESA E IV.

EDUKATA KOMTARE

Neni 377.

Me qëllim që t'i arrijë edukatës së njejtë morale, atdhetare, fizike e artistike të djelmënis Shqiptare, Ministrija e Arsimit zhvillon nji veprim të përshtatshëm:

BKSH

a) mbi djelmënin shkollore, tue e organizue në nji të vetmen organizatë të detyrshme sportive me emen «Shqipja»; me vendim të këshillit Ministruer këjo organizatë mund të bahet e detyrshme edhe për djelmënin jashtëshkollore n'ato vende në të cilat mjaftojnë mjetet edhe personeli i aftë. Për ket detyrim zbatohen dispozitat e neneve 235-243.

b) mbi djelmënin jashtëshkollore me anë shoqnish sportive e artistike të njoftuna prej saj;

c) mbi djelmënin përgjithsisht, tue u kujdesue për edukimin e saj dhe për zgjimin e zhvillimin në të të ndjenjave morale, atdhetare e artistike, me qëllim që të çmohen, të ringjallen, të zhvillohen dhe të ruhet traditat burrnore të popullit Shqiptar dhe shfaqjet e ndryshme shpirtnore në lamen e kulturës komtare dhe t'artit populluer, si shtëpijak ashtu mjeshtruer;

ç) nëpër kolonit Shqiptare me anë shkollash kulture komtare;

d) tue mbikqyrë, mbledhë e ruejtë monumentat e dokumentat, çdo forme e lloji, të historis së vjetër e të re të Shqipnis, si mbas dispozitave ligjore përkatëse.

Neni 378.

Për nji ndjekje ma të frytshme të qëllimeve të përmenduna në në nenin e sipërm themelohen në Tiranë:

1. Patronazhi Sportiv Komtar,
2. Patronazhi Artistik Komtar.

Këto dy patronazhe janë ente morale e autonome me Statute e rregulore të veta.

Neni 379.

Mësimi i edukatës fizike për djelm, që kanë mbushë moshen 15 vjetësh, plotësohet me anë stërvitjesh paraushtarake, si mbas Ligjëve e Rregulloreve në fuqi.

Neni 380.

Ministrija e Arsimit ka me shpërnda, me anë të autoriteteve t'administratës, shoqnit e përmenduna në piken *b* të nenit 377 që nuk janë të njoftuna zyrtarisht, si edhe çdo mbledhje perjodike ase të vazhdueshme personash, të bame, pa leje, me qëllim argtimi, stervitjeje ase mësimi të djelmënis n'artet e bukura ase në sport.

Mënyra e themelimit, të rregullimit e të funkcjonimit të shoqnive caktohet në nji statut tip të pregatitun prej Ministris.

Neni 381.

Ministrija e Arsimit autorizohet: a) me mbajtë nji shkollë artesh të bukura me programë të caktueme në rregulloren; b) me ndihmue me fondet e buxhetit të vet shoqnit sportive, letrare e artistike; c) me ngrehë stadjume e fusha sportive.

TITULLI I.

Federata Sportive Shqiptare

Neni 382.

Për mbarëvajtjen, kontrollimin dhe rregullimin e sportit, krijohet pranë Ministris s'Arsimit Federata Sportive Shqiptare e përbame prej Ministrit t'Arsimit, si Kryetar, Shefit të Seksjonit «Djelmënija Shqiptare» si nënkryetar dhe prej nji përfaqsuesi të çdo shoqnije sportive të përemnduna në pikën *b* të nenit 377, si antarë.

Neni 383.

Federata Sportive Shqiptare mblidhet në mbledhje të zakonshme njiherë në vjet, mbas thirrjes së Ministris.

Vendimet e saj i zbaton Kryetari.

Neni 384.

Detyrët e Federatës Sportive Shqiptare si edhe mënyra e veprimit të saj, caktohen në Statutin, që do të pëlqehet në mbledhjen e parë.

Neni 385.

Bashkit e Komunet japin si ndihmë vjetore 4% prej t'ardhunave efektive të veta në favor te'dukatës fizike.

Ky kontribut derdhet n'arken e Financës prej Miistris së P. të Mbrendshme në kater kiste: Prill, Korrik, Tetuer e Kallnduer të çdo vjeti.

Komunet, që nuk kanë t'ardhuna, mund të lirohen prej këtij kontributi me vendim të Këshillit Ministruer.

TITULLI II.

Shkolla shqpe jashtë Mbretnis

Neni 386.

Nëpër vende jashtë Mbretnis në të cilat qindron nji numer i math shtetasish Shqiptarë, Ministrija e Arsimit autorizohet me hapë shkolla të veçanta për mësimin e landëve të kulturës komtare.

Neni 387.

Këto shkolla mund të jenë:

a) për nxanës të shkolave fillore;

b) për nxanës të shkollave të mesme ase kategorije tjetër.

Neni 388.

Nxanësi me dëftesë shkolle të huej, që merr edhe dëftesën e shkollave të përmenduna në nenin e sipërm, i fiton të gjitha të drejtat mbi konkurs për bursa kombtare dhe nënpunsina, si t'i ikshte krye mësimet në Mbretni.

Neni 389.

Shërbimi i mësuesit nepër këto shkolla njifet si shërbim i bamun në Shqipni.

Neni 390.

Rregullimi i përgjithshëm i këtyne shkolave, dhe programa e mësimeve caktohet në rregulloren.

PJESA e V.

BURSAT E MËSIMIT DHE MËSIMI JASHTË MBRETNIËS

TITULLI I.

Bursat Kombtare

Neni 391.

Me qëllim që të përhapi arsimin filluer n'ato vende, në të cilat asht e mundun hapja e shkollave fillore, dhe të ndihmojë vazhdimin e mësimit nepër shkollat e mesme të nxanësve të pa mjete, Ministrija e Arsimit autorizohet me dhanë bursa mësimi, ndër kufi të fondeve buxhetore, tue pranue nxanës në konvikte shtetnore, si caktohet ma poshtë.

Neni 392.

Gjithashtu autorizohet Ministrija me dërgue, për vjet, me fonde të veta, nji sasi nxanësish në shtete të hueja me qëllim që të vijojnë mësimet në shkollat e nalta të ndryshme.

Neni 393.

Nuk mund të jepen dy bursa në nji familje.

Nuk mnud të mbahen konvikte private shkollash.

BKSH

Kaptina e I.

Bursat e mbrendëshme

§ 1. PËR ARSIMIN FILLUER

Neni 394.

Nepër konvikte fillore mund të mbahen me shpenzimet e Shtetit vetëm fëmij malsorësh e katundarësh prej vendeve në te cilat nuk veprojnë shkolla fillore.

Neni 395.

Zgjedhja e fëmijve, që do të gëzojnë bursen e mësimit, si mbas nenit të sipër, bahet në kët mënyrë:

Mot për mot, në muejin maj, Ministrija u cakton atyne Prefetkurave, në të cilat shkollat fillore janë ë numër mâ të pakët, sasin e bursave për vjetin e ri shkolluer. Ky numër caktohet mbas popullsis e nevojës arsimore të Prefekturës dhe fondeve të Ministris.

Këshilli administrativ i Prefekturës tue marrë parasysh edhe proponimet eventuale të Këshilleve të Nënprefekturave, zgjedh kandidatët. Vendimet e Këshillit i paraqiten, bashkë me raportin justifikues, Ministris, për pëlqim, jo ma vonë se me 15 të gushtit.

Fëmijt emigrant, familjet e të cilve nuk janë vendosun definitivisht në Mbretni, pranohen për konvikte fillore drejt prej Ministris.

Neni 396.

Në kursin njivjeçuer ase dyvjeçuer të parpam në nenin 249 mund të pranohen, si bursjerë edhe fëmij prej vendesh në të cilat ka shkolla fillore.

Zgjedhja e këtynve bahet si mbas nenit të sipërm.

Neni 397.

Bursat e dhanuna për mësimin filluer priten kur ata që i gëzojnë:

1) nuk e kalojnë klasën,
2) mbajnë nji sjellje të pa-pëlqyeshme,
3) e kryejnë plotësisht mësimin filluer.

Neni 398.

Konviktet fillore, si mbas caktimit të Ministris, duhet të kenë nji copë tokë edhe nji sasi kafshesh të ndryshme të nevojshme për mësime, ushtrime e punime bujqësije e blegtorije.

BKSh

Të gjitha prodhimet e tokës dhe të kafshëvet administrohen prej Këshillit të konviktit dhe përdoren për ushqimin dhe mbajtjen e konviktorve.

§ 2. PËR ARSIMIN E MESËM

Neni 399.

Për vazhdimin e mësimit të mesëm mund të jepen bursa për këto shkolla: gjimnaz, normale dhe institutin profesional.

Neni 400.

Bursa, që mund të jepen për çdo vjet shkolluer, nuk mund të kalojnë numrin:

a) 20 për klasët e shkallës s'ultë të të gjitha gjimnazeve mashkullore;

b) 10 për shkallën e ulët të gjimnazit femnuer;

c) 4 për klasët e shkallës së naltë të të gjitha gjimnazeve mashkullore;

ç) 2 për të gjitha klasët e shkallës së naltë të gjimnazit femnuer;

d) 40 për klasën e parë të shkollës normale mashkullore;

dh) 25 për klasën e parë të shkollës normale femnore

Numri i bursave, që çdo vjet mund të jepen për institutin teknik, caktohet prej Ministris, por nuk mund jetë ma i naltë se mesatarisht për çdo degë. Ministrija mundet me paksue numrin e bursave të nji dege të këtij istituti dhe për aq me i a shtue nji dege tjetër.

Në të gjitha klasët e degës bujqësore t'institutit profesjonal numri i bursjerve nuk mund të jetë ma i madh se njiqind.

Për shkollat qytetse e tregtare nuk jepen bursa shtetnore.

Neni 401.

Kandidatët për bursa shkollash të mesme duhet me paraqitë deri me 31 Korrik në Ministrin e Arsimit kërkesën, tue caktue shkollën dhe degën për të cilën kërkojnë bursën.

I bashkangjitet kërkesës:

a) raporti i lëshuem prej dy mjekvet mbi gjendjen shëndetësore të kandidatit, me të cilin duhet të vërtetohet se nuk ka ndonji të metë fizike ase ndonji sëmundje, edhe në mos qoftë ngjitëse;

b) dëshmija e Zyrës së Gjendjes Civile;

c) dëftesa shkollore e kandidatit;

BKSH

ç) dëshmija e Bashkis ase e Komunes mbi profesjonin e prindit;

d) dëshmija e vobeksis.

Fëmijt emigrantë, familja e të cilvet nuk asht vendosun definitivisht në Mbretnin, nuk janë të detyruem të paraqesin dokumentat nën pikat b, ç, d.

Neni 402.

Nuk merren parasysh:

a) përgjithsisht kërkesat e paraqituna pa ndonji prej dokumentave të nenit të sipër;

b) përgjithsisht kërkesat e paraqituna mbas 31 Korrikut;

c) kërkesat për bursë për gjimnaz, në qoftë se dëftesa shkollore e kandidatit nuk i ka notat «shumë mirë» e «mirë» në të gjitha landët e detyrshme, notën «shembullore» në sjellje dhe notat të paktën «mjaft mirë» në të gjitha landët e lira;

ç) kërkesat për bursë për çdo shkollë të mesme tjetër, në qoftë se dëftesa shkollore e kadidatit nuk i ka notat të paktën «kalueshëm» në të gjitha landët, të detyrshme dhe të lira, dhe notën «shembullore» në sjellje.

Neni 403.

Në qoftë se numri i kandidatve për bursë âsht mâ i madh se i bursave, i caktuem për at shkollë ase degë, bahet nji konkurs, mënyra e të cilit caktohet në rregulloren.

Neni 404.

Bursa e dhanun për mësimin në shkollat e mesme, me përjashtim t'institutit profesional, pritet:

1) me njiherë, kur bursjeri mer në sjellje notën «mjaft e urtë»;

2) në mbarim të tremuejshit të tretë kur bursjeri:

a) merr në dëftesën vjetore, qoftë edhe vetëm në nji landë të detyrshme, notën «mjaft mirë» për gjimnaz, notën «dobët» për shkollë normale;

b) mbaron klasën e fundit të shkollës për të cilën ka fitue bursën.

Neni 405.

Bursjerve t'institutit teknik u pritet bursa në rastet e parapame në pikat 1 e 2 b të nenit të sipërm, si edhe kur mbeten me përsërit klasën.

Neni 406.

Nxanësit, të cilve u âsht pre bursa për shkaqe mësimi ase sjelljeje, si mbas neneve të sipërme, mund të paraqiten si kandidatë për rifillimin e bursës vetëm mbassi të ketë kalue nji vjet shkolluer i tanë dhe t'i kenë të gjitha cilsit e lypuna prej neneve 401 e 402.

Neni 407.

Prodhimet, çdo natyre qofshin, të punës së bursjervet dhe të konviktorvet nepër konvikte përdoren për ushqim dhe mbajtje të bursjerve dhe administrohen prej Këshillit të Konviktit ase të shkollës.

Formimi dhe mënyra e veprimit të këtij Këshilli caktohen në rregulloren.

Neni 408.

Prodhimet e punës së nxanësve të shkollave profesjonale mund të shiten në treg, mabssi t'u jetë caktue çmimi prej Këshillit të konviktit ase të shkollës. Por në kët rast t'ardhunat mund të përdoren vetëm për blemjen e landës së parë të nevojshme për zeje të ndryshme, që mësohen n'atë shkollë. Teprica derdhet në Bankë dhe mund të jepet si hua, si mbas dispozitave të Rregullores përkatëse, nxanësvet, që marrin diplomën e mësimit për qëllimet e ushtrimit të zejes së tyne.

Neni 409.

Në konviktet fillore dhe n'ato të shkollave të mesme pranohen nxanës me pagesë , me të gjitha detyrët dhe të drejtat e bursjerve të caktueme në Rregulloren.

Sasija e pagesës caktohet vjet për vjet, mbas proponimit të Ministris s'Arsimit, prej Këshillit Ministruer.

Neni 410.

Ministrija e Arsimit, kur e shef në interesë të mësimit e t'edukatës, mund të detyrojë nji ase të gjithë nxanësit, që nuk kanë prindët në vendin e shkollës ase që nuk jetojnë me ndonji t'afërmin e vet, të hyjnë me pagesë në konvikt.

Neni 411.

Pagesa për konvikte asht vjetore, parapaguhet në tri kiste n'arkat e financave dhe, mbassi të jetë pague, nuk mund të kthehet.

Kisti i parë paguhet para hymjes në konvikt, i dyti prej 15 deri 31 të Dhetorit e i treti prej 15 deri 31 të Marsit.

Neni 412.

Nxanësi që hyn në konvikt mbas 15 të Nandorit, 15 të Frorit, 15 të Prillit paguan vetëm 1/2 e kistit përkatës.

Neni 413.

Nxansit e shkollave normale, mbas kryemjes së mësimeve, detyrohen me shërbye n'arsimin filluer kudo që të dërgohen prej Ministris:

a) dy herë aq vjet për sa kanë gëzue bursën në shkollat normale; vetëm ata që e kanë gëzue për nji vjet detyrohen me sherbye tri vjet;

b) dy vjet në qoftë se kanë mësue me shpenzimet e veta.

Po qe se nuk i shtrohen këtij detyrimi për afatin e naltëtreguem, detyrohen me pague arkës së financave të gjitha taksat shkollore të parapame për të katër klasët e shkallës së naltë të gjimnazit. Përveç kësaj, ai që ka gëzue bursen detyrohet me i a kthye Shtetit shpenzimet e bâme për mbajtjen e tij si bursjer. Këtyne detyrimeve u shtrohen edhe ata që, tue qenë në shërbim, shkaktojnë me qëllim pushimin e vet.

Neni 414.

Për përmbushjen e dispozitës të nenit të sipërm, prindi ase kujdesetari ligjuer i nxanësit paraqet në Ministrin e Arsimit, mbrenda tre muejve nga data e nënshkrimit në shkollën normale, nji letër-detyrim, që vërtetohet falas prej Zyrës Noterjale.

Formullari i letër-detyrimit caktohet në rregulloren.

K a p t i n a e II.

B u r s a t e j a s h t m e

Neni 415.

Ministrija e Arsimit çdo vjet në mes të muejit Korrik njofton, me anë të Fletores Zyrtare dhe të fletoreve tjera, numrin e bursave të jashtme, që do të akordohen për vjetin e ri shkolluer, dhe shkollat ase fakultetet për të cilat jepen.

Neni 416.

Kandidatët për bursa të jashtme deri me 15 të Gushtit duhet të paraqesin në Ministrin:

a) kërkesën për bursë, tue caktue shkollën ase degën për të cilën e kërkojnë;

b) dëftesën shkollore, me të cilën duhet të vërtetojnë se kanë krye në Shqipni mësimet e shkollës së mesme në Qershuer t'atij vjeti ase ma parë;

c) dëshmin e Zyrës së Gjendjes Civile;

ç) dëshmin e Bashkis ase të Komunes mbi profesjonin e prindit;

d) dëshmin e vobeksis.

Neni 417.

Në qoftë se numri i kandidatvet asht ma i madh se ai i bursave, atëhere bahet nji konkurs në ditët e para të Shtatorit, si mbas mënyrës së caktueme në rregulloren.

Përfundimi i konkursit shpallet jo mâ vonë se në mbarim të Shtatorit.

Neni 418.

Kandidati, që del fitues, duhet t'i paraqesi Ministris, përpara nisjes, nji letë-rdetyrim, me të cilin të garantojë se, mbassi të kryejë mësimet, do të kthehet në Shqipni dhe do t'i shërbejë Shtetit për 7 vjet rresht në degën e vet në çdo vend që të dërgohet.

Në rast se kandidati nuk e përmbush ndonjenën prej këtyne konditave, garanti i tij detyrohet me ia kthye Shtetit të gjitha shpenzimet e bame për mësimet e tij.

Gjithashtu, në qoftë se gjatë mësimeve bursjerit i pritet bursa për shkak të sjelljes ase mos kujdesit të tij në mësime, atëherë, si mbas detyrimit, duhet t'i kthehen Shtetit të gjitha shpenzimet e bâme për te deri në ditën e premjes.

Neni 419.

Letër-detyrimet vërtetohen falas në Zyrën Noterjale.

Neni 420.

Bursjeri detyrohet që vjet për vjet n'afatin e dy muejve mbas fillimit të vjetit shkolluer ase të semestrit, t'i dërgojë Ministris:

a) dokumentin e nënshkrimit të rregullshëm për vjetin shkolluer ase për semestrin përkatës;

b) nji raport, të nëshkruem prej tij vetë, mbi mësimet e detyrshme për at vjet ase për at semestër.

Neni 421.

I pritet bursa nji bursjeri të jashtëm:

a) kur, për shkak të pa arsyeshëm, nuk i kryen provimet e ushtrimet e ndryshme të vjetit shkolluer në muejin Qershuer ase Korrik; dhe në rasë se provimet nuk jepen për vjete (në mbarimin e mësimeve të rregullshme të nji vjeti shkolluer) atëherë i pritet, kur nuk i kryen n'ato kohë ligjorë që caktohen prej Ligjëve ase Statuteve të shkollës;

b) kur mban nji sjellje, që nuk pajtohet me Ligjët e Shtet:t e më doket e mira;

c) kur ban borxhe dhe i len pa pague;

ç) kur nuk paraqet dokumentin e nështkrimit n'afatin e caktuem;

d) kur ndrron, pa leje të Ministris, vendin e mësimit ase degën;

dh) kur i dërgon Ministris dokumenta jo të vërteta ase raporta e informacjone të pa qena mbi vehten e vet;

e) kur e kryen mësimin për të cilin i âsht dhanë bursa.

Neni 422.

Si shkak i arsyeshëm konsiderohet përgjithsisht sëmundje e randë e vërtetueme me dëshmi spitali jo privat të vendit ku mëson bursjeri.

Bursjerit, që vërteton kët shkak, i jepet lêja me i u shtrue provimeve në Vjeshtë ase në sesjonin ma të parë.

Bursjerit, që dy herë vazhdimisht paraqet si shkak sëmundjen e randë për mos dhanjen e provimeve, i pritet bursa definitivisht. Në kët rasë i zbatohet vetëm kryerreshti i parë i nenit 418 në qoftë se mbaron mësimet me shpenzimet e veta.

Neni 423.

Si shkak i arsyeshëm për mos dhanje provimi në Qershuer Korrik mund të konsiderohet edhe mosnjohtja e gjuhës së huej. Njohtja e këtij shkaku si t'arsyeshem âsht në kompetencë të Ministris dhe mund t'akordohet vetëm për vjetin e parë të studimeve.

Akordimin e këtij shkaku Ministrija i a jofton bursjerit përpara se të niset.

Nxansi, të cilit i njifet si i arsyeshëm ky shkak, âsht i detyruem me i plotësue provimet në Vjeshtë t'atij vjeti.

Neni 424.

Bursjerit, që i pritet bursa për cilëndo arsye të nenit 421, me përjashtim të pikave *b* e *d*, i jepet edhe bursa e muejit mbas atij në të cilen ka ndodhë shkaku i premjes.

TITULLI II.

Bursat e hueja

Neni 425.

Pa lejen e Ministris s'Arsimit nuk mund të pranohen nga Shtetet e hueja bursa mësimi për çdo shkollë qoftë.

Nxanësit, shtetas Shqiptarë, që ndjekin mësimet me bursa të shtetevet të hueja, pa autorizim të Ministris, dënohen, në kanë mbushë moshen 18 vjetësh, me dy muej burgim, dhe me përjashtim nga çdo nëpunësi shtetnore për 5 vjetë nga data e diplomës së tyne.

Për nxansit që nuk kanë mbushë moshen 18 vjetësh, për sa i përket përgjegjësis penale, ndeshkimi, i parapamë në kryerreshtin e dytë të këtij neni, i zbatohet prindit ase kujdestarit ligjuer të tyne.

Neni 426.

Prindët ase kujdestarët mund të dërgojnë, me shpenzime të veta, jashtë fëmijt e vet për mësime të mesme, profesjonale, të nalta ase artesh të bukura, por duhet mâ parë të kërkojnë lejen prej Ministris, tue paraqitë nji deklaratë, të vërtetueme falas prej zyrës noterjale, se fëmijt e tyne nuk gëzojnë as do të pranojnë ma vonë, pa leje të Ministrs, bursë mësimi prej nji shteti të huej. Për sa i përekt mësimit t'Arsimit filluer të fëmijve, shtetas Shqiptar, në shkollat e hueja, zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjës mbi ndalimin e nxanësve shqiptarë për shkollat e hueja me datë 22 Prill 1933.

Neni 427.

Prindët ase kujdestarët, që dërgojnë fëmijt në shkolla jashtë Mbretnis, pa e bâ deklaraten e nenit 426, ndeshkohen me gjobë prej 200 deri 500 fr. ari; ata që bâjnë deklaratë jo të vërtetë, përsa i përket bursës, si edhe ata, që ma vonë pranojnë bursa të hueja, ndeshkohen si mbas nenit 425.

Neni 428.

Nxansit, që mbahen me bursa të hueja, të pranueme me le-

je të Ministris, ase me shpenzime të veta, ndër shkolla të jashtme, janë të detyruem me qenë në lidhje me Ministrin e Arsimit, tue i dërgue kësaj rregullisht dokumentat që përmenden në nenin 420.

Ministrija e Arsimit për çdo shrregullim që veshtron në sjellje e në mësime të nji nxanësi të këtillë duhet të lajmojë prindin ase kujdestarin e tij.

Neni 429.

Nxanësit, që ndjekin shkollat jashtë Shtetit, mund të marrin pasaporten falas me clisin «student» ase «nxanës» vetëm me lejen e Ministris.

Neni 429.

Kur dalin vjetin e parë, pa qenë të nëshkruem, Ministrija, për me e dhanë autorizimin për ket cilsim, mundet me u kërkue prindvet ase kujdestarvet nji garanci për 200 fr. ari deri sa të paraqesin, mbrenda afatit të caktuem, dëshmin e nëshkrimit.

Ministrija mundet me i a mohue të drejtën e daljes jashtë nxanësit që nuk i âsht konformue dispozitës së nenit 420 ase që nuk paraqet dokumentin shkolluer të vjetit të kaluem.

PJESA E VI.

NJOHJA E DËFTESAVE SHKOLLORE TË HUEJA DHE E TITUJVE AKADEMIKË

Neni 430.

Ata, të cilët dishrojnë me vazhdue në shkolla jashtë Mbretnis, mund të nëshkruhen, mbas shqyrtimit të dokumentit përkatës nga ana e Ministris, por në çdo rast nuk mund të mbarojnë mësimet ma parë se t'i kishin vazhdue në shkollën e huej.

Ministrija, tue marrë parasysh programën e shkollës së ndjekun, mundet me lejue nëshkrimin mbas nji plotësimi, sidomos në landët e kulturës komtare, si mbas nenit 330.

Neni 431.

Çdo diplomë, që vërteton kryemjen e mësimeve të mesme ase të nalta jashtë Mbretnis, për me e pasë vleftën ligjore, duhet t'i paraqitet, bashkë me dy kopje në përkthim shqip, Ministris s'Arsimit, e cila, mbas t'i vërtetojë, njenen i a kthen t'interesuemit.

Neni 432.

Ata që pretendojnë se, në bazë të studimevet të nalta, kanë të

BKSH

drejtën e mbajtjes së nji titulli akademik, duhet të vërtetojnë në Ministrin e Arsimit në mënyrë të caktueme prej saj:

a) se Universiteti ase shkolla e naltë, që lëshojnë titullin, janë të njoftun në shtetin në të cilin gjinden;

b) se kanë krye, pa asnji të metë ase përjashtim, shkollën e mesme të domosdoshme për pranimin në shkollën e naltë, që lëshon titullin. Mësimet e mesme të bâme në shkolla të veçanta ase kurse speciale, me numër vjetësh mësimi të shkurtuem ase me përjashtim mësimesh të ndonji lande të detyrshme me Ligjë e programë të vendit, nuk përbajnë titull studimi shkolle të mesme;

c) se mësimet e nalta i kanë krye si mbas Ligjës ase Statutit, që rregullon shkollen përkatëse, pa shkurtim kohe dhe pa përjashtim landësh e provimesh, në kundershtim me Ligjët arsimore të vendit.

Neni 433.

Emnat e atyne, që e vërtetojnë të drejten e mbajtjes së titujve akademikë, botohen në të përkohëshmen zyrtare të Ministris s'Arsimit.

PJESA E VII.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 435.

Nëpër dhomat e mësimit të shkolave mbahet nga nji fytyrë e N. M. T. Mbretit dhe e Gjergj Kastriotit.

Përveç fytyrave të nalt përmenduna e të ndonji vehtije historike të Shqipnis, të vume me lejen e veçantë të Ministris, si edhe gjanave, që shërbejnë si mjet mësimi, ndalohet mbajtja nëpër rrugina e dhomat e shkollavet, të fytyrave, figurave dhe sendeve tjera.

Neni 436.

Në shkollat e Mbretnis nuk mund të shtihen tekste dhe mjete mësimi, përveç atyneve të pranueme ase t'autorizueme prej Ministris.

Neni 437.

Autorizohet Ministrija e Arsimit me urdhnue nji uniformë për nxânsit e nxânëset e të gjitha shkollave.

Neni 438.

Mbas hymjes në fuqi të kësaj Ligje vendet vakante të degës

s'Arsimit, mund të plotsohen vetëm me personel që ka cilsit e lypuna prej kësaj Ligje.

Neni 439.

Përveç ndryshimeve që rezultojnë nga dispozitat e mâ parshme të ksaj Ligje, Ligja mbi kategorizimin e arsimtarve datë 12-IV-1926 dhe Shtojcat e saj me d. 14-V-1928. dhe d. 3-IV-1929, ndryshohen si vijon:

1) shtesat mbi rrogë për vjetërsi bahen çdo pesë vjetë;

2) koha për shtesat pesëvjetore për mësuesit e arsimit filluer fillon mbas fitimit të stazhit; për personelin e shkollave të mesme mbas dy vjet shërbimi;

3) rroga themelore e mësuesve të mësimeve speciale të kategorisë zbresin në fr. ar 250;

4) shtesa inspektorije e arsimit filluer, asht fr. ar 40 në muej;

5) kryemësuesit i jepet shtesa e drejtimit kur drejton nji shkollë me tre mësues;

6) të gjithë mësuesit e përmendun në paragrafin 2 të nenit 2, detyrohen me i u shtrue provimit t'aftësis pedagogjike:

a) mbrenda tri vjetve shkollore ata që janë në shërbim prej katër ase ma shumë vjet para hymjes në fuqi të kësaj Ligje.

b) mbrenda katër vjetve shkollore ata që kanë nji shërbim ma të pakët.

Këto provime mund të jepen dy herë. Në rast fitimi efetket janë ato të parashtrueme në Ligjen mbi kategorizimin e arsimtarvet. Në rast mos paraqitjeje ase humbjeje përjashtohen nga shërbimi.

Në mes të këtyne mësuesve vetëm ata që janë emnue para 12-IV-1926 kanë të drejtën e shtesave pêsëvjetore. Për të tjerët në rast se fitojnë provimin e aftësis pedagogjike, koha e llogaritjes për shtesat pêsëvjetore fillon që me ditën e emnimit.

Mësuesit e përkohshëm, që kanë krye nji Gjimnas ase Licé si dhe, ata që kanë krye rregullisht mësimet e Normales, por pa provim pjekunije, nuk japin provimin e aftësis pedagogjike, por detyrohen me iu shtrue, mbrenda kohës së caktueme në kët nen, provimit të pjekunis së normales.

Në qoftë se këta mësues kanë mbushë katër vjet shërbimi në ditën që fitojnë pjekunin, dhania e këtij provimi, për çdo efekt, konsiderohet si stazhë.

Në rast mos paraqitjeje ase humbjeje, gjimnazistët përjash-

tohen nga shërbimi nomalistët mund të mbahen përkohësisht dhe shërbejnë me rrogë të zbritun.

7) Mësuesit e shkollavet të mesme me mësime universitare të pa kryeme, si mbas numrit të vjetvet që kanë ndjekë universitetin, kanë rrogë themelore prej 100 deri 200 fr. ari. Koha për shtesat pesvjetore fillon mbas dy vjetve sherbimi.

8) Shtesat pesvjetore të kategoris V t'arsimit filluer janë si ato të kategorive të tjera të përmenduna në nenin 7 të Ligjës së kategorizimit; ato të kategoris I. t'arsimit të mesëm janë të njejta me ato të kategorive të tjera po të këtij arsimi.

9) Syprimohen:

a) neni 15 i Ligjës mbi kategorizimin e arsimtarve datë 12-IV-1926;

b) kategorija e V e mësuesve t'arsimit filluer dhe e II t'arsimit të mesëm për ata që emnohen mbas hymjes në fuqi të kësaj Ligje;

c) neni 3 i Shtojcës së Ligjës mbi kategorizimin e arsimtarvet, datë 14-V-1928, por mësuesit e arsimit filluer mund të merren vetëm me pëlqilmi të tyne për mësime në shkollat e mseme.

Neni 440.

Shpërblimi i profesorve dhe i mësuesve për kurset e parapame me nenin 169, asht fr. ari 3 për orë mësimi dhe paguhet si mbas nenit 369.

Drejtori i këtyne kurseve caktohet prej Ministris dhe, si shpërblim drejtimi ka fr. ari 60 në muej.

Profesorët, mësuesët dhe Drejtori, që nuk janë në shërbim të zakonshëm në vendin ku mbahen këto kurse, kanë të drejten e banimit në konvikt, në qoftë se ka konvikt shtetnuer.

Mësuesët që djekin mësimet e këtyne kurseve mund të qindrojnë, me banim e ushqim në konviktin e shtetit tue pague aq sa u takon vetëm për shpenzimet e ushqimit.

Neni 441.

Për mësime speciale ndër shkolla të mesme mund të merren edhe mësues jo të karierës me nji shpërblim të pagueshëm mbas orëve të mësimit.

Shpërblimi i nji ore, si mbas landës mund të jetë fr. ari 2, 3, e 3.50.

Neni 442.

Çdo propagandë e bame me qëllim që të pengojë ase të kun-

dërshtojë veprimin e Ministris, të bazuem mbi dispozitat e kësaj Ligje, si edhe çdo inicjativë private që, pa leje, ndërhyn, me çdo mënyrë e nen çdo formë, në qëllime, që ndiqen ekskluzivisht prej Ministris ase me autorizimin e saj, ndeshkohet me burgim prej nji jave deri në gjashtë muej edhe me gjobë prej 50 deri 1000 fr. ari. Në rast përsritjeje bu̅rgimi asht prej tre muej deri në nji vjet dhe, gjoba prej 200 deri 3000 fr. ari ari.

DISPOZITA TRANSITORE

Neni 443.

Koha e sherbimit e caktueme në nenin 221, për në tri vjetët e para mbas hymjes në fuqi të kësaj Ligje, mund të zbritet, por ai që gjindet në këto konditat emnohet si inspektuer i përkohshëm dhe merr vetëm gjysmen e shpërblimit të caktuem për Inspektorët, deri sa të plotësohet koha e duhun.

Neni 444.

Nxanësit që në vjetin shkolluer 1934-35 kanë me ba vjetin e fundit të shkollave të mesme shkalle të naltë, kanë me vazhdue mësimet me sistemën dhe programen e përparëshme.

Neni 445.

Për vjetin shkolluer 1934-35 Ministrija e Arsimit autorizohet me hap në shkollën normale nji mësim trevjeçuer e nji dyvjeçuer. Në të parin pranohen ata që kanë krye klasen e pestë të gjimnazit, në të dytin ata që kanë krye të gjashten klasë të gjimnazit.

Numri i nxanësve, që pranohen si bursjerë të Shtetit mbas modaliteteve të kësaj Ligje, mund të jetë deri 30 për secilin mësim.

Neni 446.

Ligja organike e Ministris s'Arsimit me datë 27 Qershuer 1928, Ligja mbi ndertesat e shkollave fillore dhe t'orendive të tyne me datë 10 Maj 1929, si edhe çdo dispozitë ligjore tjetër në kundërshtim me kët Dekret-Ligjë, mbesin pa fuqi.

Neni 447.

Këjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi me 1 Tetuer 1934.

Neni 448.

Ministrija e Arsimit dhe ajo e P. të Mbrendshme, ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi prpoponimin e bamun me shkresën Nr. 1315 datë 10-9-1934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 10-9-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës Organike t'Arsimit.

Durrës, me 26 Shtatuer 1934.

ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. të Mbrendshme
MUSA JUKA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Nr. 126.

DEKRET-LIGJË, 11 Shtator 1934.

Mbi sistemimin e maredhanjevet kontabël që rrjedhin nga zbatimi i Ligjës me datë 21 Mars 1934 mbi kthimin e Entit Kombtar «Djelmënija Shqiptare» në nji seksion të Ministris s'Arësimit, i Ligjës së Bashkive me datë 30 Prill 1934, dhe i Ligjës me datë 28 Maj 1934 mbi krijimin e disa taksavet në favor të komunevet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 29 Shtator 1934, Nr. 55)

KAPITULLI I.

MBI TAKSAT DOGANORE NË FAVOR TË BASHKIVET DHE TË KOMUNEVE

Neni 1.

Shuma e përbashkët e perqindjes prej 15% mbi t'ardhunat doganore, për t'u shpernda në favor të Bashkive dhe të Komuneve në sasin e caktueme nga nenet 78 e 82 të Ligjës 30 Prill 1934 (Bashkina) e nga nenet 1 e 2 të Ligjës 23 Majë 1934 (Komune), versohet nga doganat së bashkut me t'ardhunat të tjera doganore, nder Drejtorinat e Nen-Drejtorinat Financjare përkatëse, të cillat lëshojnë kuitanca në mëveshje të nji kapitullit të posaçme për t'u krijue në gjendjen e parapamjevet t'ardhunavet t'ushtrimit financjar 1934-35

e të tjeravet ndjekëse si mbas mënyrave të caktueme nga Ligja dhe rregullorja për administrimin e pasunis e të kontabilitetit të Shtetit.

Neni 2.

Kontributi vjetuer i Bashkivet dhe i Komunevet caktue, si mbas dispozitave të nenit 6 të Ligjës datë 21 Mars 1934, me 4% të shumës së përgjithshme t'ardhunavet të tyne të budgetit, zavendësohet me 11% të shumës së përgjithëshme të mbitaksavet doganore të krijueme në favor të Bashkivet e të Komuneve, si mbas Ligjës datë 30 Prill 1934 (Bashkina) e Ligjës datë 23 Majë 1934 (Komune).

Shperndamja ndër Bashkit e Komunet të mbitaksavet doganore të përmenduna në nenin e sipërmë, duhet të bahet tue zbritun nga shuma e përgjithëshme e mbi-taksavet doganore të nxjerruna, të 15% (pesëmbëdhetperqindjet) qi mbeten në favor të Shtetit, e tue i-u dhanë Bashkive e Komunevet diferencen prej 85% (tetëdhet e pesë perqind) qi mbetet, në masen e caktueme në këtë nen.

Neni 3.

Pagesat për t'u ba në favor të Bashkive dhe të Komunevet në lidhje me shperndamjen e caktueme respektivisht në bazë të nenit 2 paragrafi 2-të të kësaj Dekret-Ligje, dhe të Ligjëvet të Bashkivete të Komunevet, bahet me mandate-direkte për t'i lëshue nga nji kapitull i veçantë qi do të krijohet në gjendjen vjetore të parapamjevet të shpenzimevet të Ministris P. Mbrendëshme.

Mandatet, si mbas rastit e nevojës, lëshohen në Arkën e Qendres ose nder ato të Drejtorinavet e N/Drejtorinavet Financjare të qarqevet.

Neni 4.

Krye tremuejsh, në lidhje me elementat që rilevohen nga llogarinat e Zyravet Doganore, Ministrija e Financavet me vendimin e ksajë, cakton fondet, në kapitullin e shpenzimit permendun në nenin 3 të kësaj Dekert-Ligje, efektivisht nxjerrun si titull mbitaksash në favor të Bashkivet dhe të Komuneve.

Neni 5.

Për me i sigurue Bashkivet dhe Komunevet të interesueme inkasimin e shpejtë dhe të rregulltë të mandat-pagesavet të permenduna në nenin 3, Drejtorinat e Nen-Drejtorinat Financjare detyrohen me depozitue në Bankën Kombëtare n'emën të Ministris së Financavet, shumat e përbashkta të pjesës prej 15% mbi t'ardhuna doganore të përmenduna në nenin 1.

Për Bashkinat dhe Komunet ku gjindet nji Drejtori o Nen-Drejtori Financjare, pagesa e mandatevet bahet tue i dorëzue të hollat funksjonarëvet të ngarkuem legalisht për nxjerrjen; për Bashkinat e Komunet ku nuk gjindet nji Drejtori o Nen-Drejtori Financjare, pagesa e mandatevet bahet me anë të mandat-postavet o në mungesë me anë të dërgesës materiale të hollave me letër të sigurueme, tue i ngarkue marrësit shpenzimet përkatëse.

Për justifikim të pagesës së bame, mandat-pagesavet i bashkangjiten duert e mandat-postavet ose të letrave të sigurueme, si ashtu edhe kuitancat që Bashkinat dhe Komunet marrëse janë të detyruem me i derguem zyravet financjare po sa të kenë marrun në dorë fondet që i përkasin këtyne.

KAPITULLI II.

MBI TAKSAT PREJ 30% MBI ALKOOL E PREJ 50% MBI CINGARET NË FAVOR TË BASHKIVET

Neni 6.

Mbi taksat prej 30% mbi alkool të thjeshtë, që shkon në favor të Bashkivet në bazë të nenit 86 të Ligjës datë 30 Prill 1934 (Bashkina), nxiret nga zyrat financjare së bashkut me taksat kryesore që i përkasin Shtetit.

Në mbarim të çdo tremujorit, në lidhje me përfundimin e llogarivet administrative të zyrave financjare, Ministrija e Financavet cakton sasinë e shumës që i përket Bashkivet.

Neni 7.

Në gjendjen vjetore të parapamjevet të shpenzimevet të Ministris së P. të Mbrendshme, krijohet nji kapitull i veçantë në të cilin me vendim të Ministris së Financavet, caktohet, në çdo tremujor, shuma e caktueme si mbas nenit 6 Paragr. 2 të kësaj Ligje.

Neni 8.

Pagesa e kistevet Bashkivet në sasin e caktueme si mbas nenit 78 të Ligjës datë 30 Prill 1934 (Bashkina) bahet me mandate direkte për t'i-u dergue zyravet financjare kompetente, të cillat janë të detyrueme me i-u shtrue pikërisht dispozitave të përmbajtuna në nenin 5 të kësaj Dekret-Ligje.

Neni 9.

Në gejndjen vjetore të parapamjevet t'ardhunavet krijohet nji kapitull i veçantë për të shënue në të nxjerrjet e bame prej z-

vet financjare për taksen prej 15% mbi cigare, e cila nxjeret me anë t'aplikimit të **bandrolëve të veçanta**, si mbas dispozitës së nenit 85 të Ligjës d. 30 Prill 1934 (Bashkina).

Me vendim të Ministris së Financavet, shuma e nxjerrjeve të vertetueme si ma sipër, caktohet krye tremujsh me nji kapitull të veçantë të shpenzimevet qi, do të krijohen në gjendjen vjetore të parapamjeve të Ministris së Punve të Mbrendshme.

Neni 10.

Pagesa e përqindjevet q'i përkasin Bashkivet nga mbi-taksa e cigarevet bahet, në mënyrën e caktueme në nenin 8 të kësaj Dekret-Ligje.

KAPITULLI III.

MBI TAKSA PREJ 10% MBI TATIM-FITIMIN DHE MBI TAKSEN NOTERIALE, GJYQËSORE E IPOTEKORE

Neni 11.

Mbi taksa prej 10% mbi tatim-fitimin si edhe mbi-taksat noteriale, gjyqësore e ipotekore në favor të Komunevet, caktue në nenin 3 të Ligjës datë 23 Majë 1934 (Komune), nxiret dhe paguhet si mbas mënyrave të parapame në nenin 5 të Ligjës së vet.

Neni 12.

Mbi-taksa si mbas nenit ma sipër e cila randon mbi taksen noteriale, gjyqësore dhe ipotekore, llogaritet mbi bazën e taksavet origjinale, tue i shtumun 50% caktue me Ligjen datë 21 Nanduer 1933.

Neni 13.

Në rast që për efekt të shtesës 10% mbi-taksat noteriale, gjyqësore e ipotekore, nuk asht e mundun, me pullat qi janë sot në qarkullim, me formue shumën e taksës së duhun, do t'aplikohen aqë pulla sa me i a arrijtun kufinit ma t'afërmë të kësaj takse, por me një mënyrë që pullat e aplikueme nuk do të jenë kurrë ma pak se taksa e duhun.

KAPITULLI IV.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14.

Kontribucjoni i permendun n'art 2 të kësaj Dekret-Ligje, për sa i përket Komuneve, zbatohet dhe nxjerret vetem mbas nji vendimi favorabel të Këshillit Ministruer.

Neni 15.

Ç'do dispozitë ligjore në kundërshtim me ketë Ligjë abrogohet.

Neni 16.

Ky eDkret-Ligjë hynë në fuqi 15 ditë mbas shpalljes së tij në Fletoren Zyrtare.

Neni 17.

Ministri i Mbrendshëm dhe ai i Financavet ngarkohen me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje. Sistemacjoni i gjendjes në ditën e hymjes në fuqi të kësaj Dekret-Ligje, do të bahet në marrëveshtje në mes të dy Ministrave në fjalë.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptrvet

Mbi proponimin e Kryeministris Nr. 1123/I d. 10-IX-1934.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 3-IX-1934,

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi sistemimin e marrëdhanjevet kotable të Ligjëvet të Bashkive e Komuneve.

Durrës, me 11 Shtatuer 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI — *Ministri i P. Mbrendëshme* MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Nr. 127.

RREGULLORE, 11 Shtator 1934.

Mbi zbatimin e Ligjës mbi pranimin e grunit e të misrit në natyrë për të dheta

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Tetuer 1934, Nr. 56)

KAPTINA I.

MBI PRANIMIN E GRUNIT E TË MISRIT

Art. 1.

Dhetarët detyruesa t'Arkës së Shtetit, janë të lirë me i shlye detat tanësisht apo pjesërisht në natyrë edhe pjesërisht në të holla,

si mbas dëshirës së tyne, tue respektue kistet e caktueme me dispozita e me Ligjët përkatëse.

Detat për të dheta t'ullijve, si për të mbrapambetunat ashtu për ushtrim, shlyhen në të holla.

Art. 2.

Sasit e grunit e të misrit që do të blehen prej Institutit dhe do të pranohen prej dhetarëve, do të jenë ekskluzivisht prodhimi i vjetit n'udhëtim (1934).

Gruni që ka m'u sjellë nga dhetarët për shlymjen e të mbrapambetunavet mund të jetë edhe grun' i vjetshëm.

Përjashtohen nga pranimi sasit e grunit e të misërit që paraqiten të përziëme me grunë të vjetër të kaluem e të këtij vjeti.

Gruni i sjellun nga dhetarët, qoftë ky nga të mbrapambetunat apo nga të dhjetat e simjetëshme, do të pranohet deri në fund të Tetorit; misri do të pranohet deri në fund të Prillit, tue fillue nga mueji Fruer.

Art. 3.

Sasit e grunit e të misrit që sjellin dhetarët nga depo t'infektueme nuk pranohen. Kjo dispozitë vlen edhe për grunin e misrin që blehet prej Institutit.

Gruni e misri që mund të blehet ose të sillet nga dhetarët, para pranimit duhet m'u kontrollue nga Agronomi, i cilli për çdo sasi të kontrollueme lëshon nji çertifikatë, të cilat ruhen n'arqivë si dokument në rasë kontrollimi.

Gruni e misri që nuk i përgjegjen cilsinave të parapme në Ligjën përkatëse, refuzohen.

Art. 4.

Përçdo sasi gruni dhe misri që mund të blehet ose të pranohet prej Institutit, do të bahet prova me anë të sendeve e të balancës për me caktue përqindjen e landës së huaj. Në qoftë se rezulton që gruni përmban jo ma tepër se 3% dhe misri jo ma tepër se 2% landë të huej, si urov, egjer, grozhel, gur, dhé, pluhun, kashtë etj. malli pranohet siç asht, mbasi të caktohet pesha specifike, dhe të bahen klasifikimet e caktueme në Ligjë. Në qoftë se, përkundrazi, gruni dhe misri kësodore përmbajnë nji përqindje ma të madhe lande të huaj sa cakton Ligja, gruni kalon në trior dhe misri në ventilator dhe pastaj procedohet në caktimin e peshës specifike e me klasifikimin e llojeve.

BKSH

Art. 5.

Gruni dhe misri pranohen në ditë të caktueme prej të deleguemve t'Institutit. .

Art. 6.

Veç grunit e misrit që sjellin dhetarët, depot do të pranojnë prej Financës së vendit edhe grunin e misrin nga të dhetat të mbetuna n'ekonomi për t'u ruejtun e administrue këto për llogari të Arkës së Financës.

Me përjashtim të peshës specifike gruni e misri ksodore dorëzohet nder depo t'Institutit dhe duhet të ketë të gjitha cilësinat e kërkueme prej Ligjës datë 15 Qershuer 1934, mbi pranimin e grunit e të misrit në pagesë.

Në qoftë se misri dhe gruni në fjalë asht i trazuem me gajna të hueja, atëherë kalohet në trior respektivisht në ventilator dhe ngarkohet Financa me shpenzimet e bame në këtë mënyrë.

Art. 7.

Dhetari detyrues, kur të dëshirojë me shlye detën e vet në natyrë, i a shfaq dëshirën Financës me shkrim ose verbalisht. Financa shqyrton llogarin e dhetarit për të mbrapambetuna, ban zbritje si mbas Ligjës mbi spastrimin e të mbrapambetunave, cakton shumën globale të detës, e llogarit këtë në grunë ose misër, në bazë të Ligjës dhe lëshon mbi depon nji urdhën marrje.

Urdhën-marrja ksodore shkputet prej nji bloku mod. I/J, i përbamë prej ame e dy bija, të cilën Drejtorija e Financës, e përmbush me shënimet e duhuna, amzën e mban vetën dhe dy bijat i a drejton depos. Kjo, mbasi merr grunin dhe misrin në dorëzim, i plotëson këto me shënimet përkatëse, e mban bijën e parë t'urdhën marrjes për justifikim të ngarkimit të sajë dhe i a kthen pjesën e dytë Financës.

Neni 8.

Pagesa definitive e detës bahet kundrejt nji dëftese mod. 2/J që i lëshon Financa dhetarit. Diftesa në fjalë do të përmbajë emnin e mbi emnin e paguesit, adresën e tij ekzakte, llojin e të dhetës dhe shumën e detës së shlyeme.

Art. 9.

Pikat kryesore t'urdhën-marrjes Mod. I/J dhe të diftesave Mod. 2/J, shenohen herë mbas here që lëshohen në librin e veçantë Mod. 4/J, nga i cili do të rilevohet: nga njena anë drithi i

dorëzuem depos dhe nga ana tjetër diftesat e lëshueme në favor t'interesuemve. Ky libër mbahet prej Financës dhe kopja e tij Mod. 6/J në fund të çdo mueji i dërgohet Qendrës s'Institutit së bashku me bijat e dyta t'urdhën-marrjeve.

Art. 10.

Amzat e diftesave Mod. 2/J ruhen prej Drejtorive të Financave për me shërbye në kohen e duhun me ba veprimet e anulimit nga llogarinat administrative të partinave që debitori ka shlye tue, dorëzue grunin ose misrin.

Art. 11.

Çdo sasi gruni ose misri që depoja merr në dorëzim në bazë të urdhën-marrjes, mbasi të ketë veprue si mbas art. 4 të kësajë Rregulloreje, shtihet, herë mbas here, në rregjistrin Mod 2/J. Ky rregister përbahet prej dy pjesave, hyrje e dalje, dhe mban numërin e datës e urdhën-marrjes ose t'urdhën-ndaljes, objektin (llojin e të dhetës) dhe sasit e llojeve të ndryshme të grunit ose misrit në kuintal. Kopja e kti rregistri Mod 5/J i dërgohet në fund të çdo mueji Qendrës s'Institutit.

KAPTINA II.

MBI MIRË-KONSERVIMIN E GRUNIT E TË MISËRIT DHE MIRË MBAJTJEN E DEPOVE

Art 12.

Gruni ose misri që hyn në depo dhe që nuk asht i thatë fare, do të shtrohet dhe do të manipulohet si mbas instruksioneve të dhanuna prej Qendrës s'Institutit.

Art. 13.

Agronomi dhe nëpunësi i Financës do t'a kontrollojë, herë mbas here dhe jo ma pak se dy herë në javë, grunin dhe misrin që ndodhet në depo dhe do të mbajnë në këtë rast proces-verbalet, kopje e të cillit do t'i përcjellet Qendrës s'Institutit. Në rasë se çfaqet ndonji rrezik për prishje, personat në fjalë do të marrin masat e duhuna, tue i shenue, këto, në proces-verbalin e mbajtun.

Në mungesë t'Argronomit kontrollimi bahet prej magazinjerit së bashku me nëpunësin e Financës.

Art. 14.

Të deleguemit e Institutit, së bashku me magazinjerin, janë

përgjegjës kolektivisht për çdo prishje të grunit e të misrit që shkaktohet nga pa kujdesija e tyne si dhe për çdo sasi gruni e misri që pranohet pa i u përgjegjun cilsinave të parapame në Ligjën përkatëse.

Art. 15.

Rregullimi i depos dhe mbajtja e sajë në gjendje që të sigurojë konservimin e grunit e të misrit i përket Agronomit dhe nëpunësit të Financës, të cilët bahen përgjegjës për kundrejt qendrës s'Institutit. Do të jetë në kujdesin e tyne p. sh. që hapja e dritoreve të bahet rregullisht, si mbas nevojës dhe të mënjanohet lagshtina, që çatija të mos pikojë, që nga dritoret të mos hyj shiu, që drithët të mos damtohet nga miu dhe nga insektet, që hedhja e grunit dhe e misrit të bahet si mbas instruksjoneve, dhe të marri masat e nevojshme për evitimin e dameve kësodore.

Asht e ndalueme me pi duhan në depo.

Art. 16.

Depoja rrin e kyçun me dy çilsa, prej të cillëve njenin e mban nëpunësi i Financës dhe tjetrin magazinjeri. Çelja e sajë bahet me marrëveshtje mjedis tyne.

Për çdo sasi gruni e misri që hyn ose del nga depoja pa dijen apo lejen e nëpunësit të Financës ash përgjegjës kryesisht magazijeri dhe për çdo sasi gruni ose misri që rezulton mangut nga depoja e që nuk mund të justifikohet, në radhën e parë asht përgjegjës magazinjeri dhe në radhën e dytë nëpunësi i Financës.

Magazinjeri asht i detyruem me lanë nji garanci prej fr. ari 2.000.

Art. 17.

Këshilli Administrativ i Institutit ushtron kontrollin e vet mbi depot me anë t'Agronomëve kontrollues dhe, eventualisht, t'Inspektorëve të Financës.

Agronomët, në rasë inspektimi, janë të detyruem të kontrollojnë imtish në se gjendja e depos siguron mirë konservimin e mallit dhe asht mbatjun si mbas instruksioneve dhe sidomos stoket e grunit e të misrit nga çdo pikpamje, sasin firon, lagështin, sëmundje, peshën specifike, landën e huej etj. dhe në përfundim t'Inspektimit të mbajnë proces-verbal, kopjen e të cillit i a referojnë qendrës s'Institutit.

Inspektimi do të bahet në prezencë t'Agronomit dhe të nëpunësit të Financës, të cillët nënshkruajë edhe proces verbalin.

BKSH

Inspektorat e Financës kontrollojnë kryesisht llogarinë, në se kjo asht mbajtun në rregull.

KAPTINA III.

MBI BLEMJEN E MISRIT E TË GRUNIT

Neni 18.

Blerjet e grunit dhe të misërit nga ana e depove t'Institutit bahet me marrveshtje private në bazë të çmimit e me sasina të njoftueme nga Qendra e Institútit si mbas art. 17 të Ligjës.

Art. 19.

Çmimet janë të vlefshme për mallna të dorëzuem në depo.

Art. 20

Në rasë se do të blehet grunë e misër këjo do të bahet ekskluzivisht dhe direkt prej prodhuesave bujqë, që me punimin e tyne personale e të familjes së tyne i kanë prodhue ndër tokët e veta ose ndër toka të marruna me të tretë.

KAPTINA IV.

TË NDRYSHEME

Art. 21.

Të hollat që i nevojiten depove të ndryshme t'Institutit prelevohen prej Agronomit dhe nënpunësit të Financës të deleguem në bazë t'autorizimeve të Qendrës s'Institutit. Kundrejt të hollave të prelevueme, Agronomi dhe nëpunësi i Financës i dorëzojnë Arkës Financës së vendit dokumentat justifikuese dhe këto, mbasi të rregullohen llogarinat mvarëse t'arkës, i sjellin në fund të çdo mueji si letrë me vleftë Institutit të Qendrës, i cili kryen veprimin si me Arkën e Qendrës.

Agronomi dhe nëpunësi i Financës janë përgjegjës kolektivisht për justifikimin e shumave të shpenzueme.

Art. 22.

Qendra e Institutit mund t'autorizojë me i dorëzue Ministsris s'Ekonomis Kombëtare nj'at sasi gruni që ka me u nevojit për farë me kondita që aty për aty të shndrrohet në natyrë me nji sasi të njinjishme. Gruni i shndrruem do të ketë cilësinat e parapame në Ligjën përkatëse.

BKSH

Art. 23.

Veglat dhe stoket e depozitueme në depo do të sigurohen prej komisionit për kundrejt rrezikut të zjarrit.

KAPTINA V.

BUDGETI PREVENTIV, SHPENZIMET, BUDGETI KONSUMTIV DHE INVENTARI

Art. 24.

Instituti, për të gjitha shpenzimet që parashef të domosdoshme për funksjonimin e tij, si blerje veglash, makinash, e thasësh qirana, ndërtime e meremetime, shpenzime udhëtimi e djete, shpenzime zyreje, transporte, rroga nëpunësish provizor, etj., pregatitë nji budget preventiv që do t'aprovohet prej Kshillit Ministruer.

Gjith'ashtu modifikimet që mund të shofi të nevojshme Instituti me ba mbi budgetin preventiv, në formë shtesa fondesh ose transferimesh, do t'aprovohen po prej Kshillit Ministruer.

Periudha për të cilën aprovohet budgeti preventiv asht 1 Qershuer 1934 deri 31 Maj 1935.

Në rasë se vendoset vazhdimi i Institutit mbi këtë kohë, hartohet dhe aprovohet nji budget preventiv i ri për aq kohë sa do të vazhdojë Instituti.

Art. 25.

Këshilli Administrativ i Institutit ka me ba pengimin e shpenzimin e fondeve të caktueme në budgetin preventiv mbrenda kufijve të caktueme në Kapitujt përkatës.

Të gjitha shpenzimet bahen me mareveshje private o me liçitasion privat, si mbas nevojës që do të shofi Kshilli Administrativ vetë.

Art. 26.

Për të gjitha shumat e parapame, të pengueme e të shpenzueme, Kshilli ka me urdhënue mbajtjen e nji llogarie të regullshme, të justifikueme me dokumenta që, kohë mbas kohe, do të mblidhen e do të ruhen në Qendrën e Institutit.

Art. 27.

Jo ma vonë se dy muaj mbas mbarimit t'ushtrimit budgetuer t'Institutit (d.m.th. deri me 31 Korrik 1935) Instituti ka me i

paraqit Kshillit Kontrollues budgetin konsumtiv të hartuem si vijon:

a) Shuma e parapame e t'aprovueme prej Kshilit Ministruer;

b) ndryshime të bame gjat ushtrimit t'aprovuem prej Kshillit Ministruer;

c) shuma të shpenzueme.

Shumat e shpenzueme si mbas paragrafit c) do të justifikohen edhe me dokumenta si mbas art. 20 të kësaj Rregullore.

Shumat e parapame e të ndryshueme si mbas paragrafeve a) e b) do të justifikohen me aprovimin e Kshillit Ministruer.

Art. 28.

Instituti ka me pregatitë deri me 31 Korrik 1935, edhe nji Inventar të mbyllun për 31 Maj 1935 prej të cilit të shifen:

n'aktiv, të gjith pasunit e Institutit, si: pare, grunë, misër, makina e vegla punimi, ndertesa, mobilje, debitorët, antiçipacjonet aktive etj.;

në passiv të gjitha borxhet e Institutit.

Invenari i pregaitun në këtë mënyrë ka me u shkoqitë me nji raportë mbi lëvizjet kryesore që do të rezultojnë nga skontrat e mbajtun nga depot për grunë e misër të hyem e të dalun.

Nga nji pjesë e inventarit bashkë me raportën e pregatitun si sypri i dërgohet për njoftim Ministris së Financavet e Kshillit Kontrollues.

Vleftësimi i pasunis së tundëshme e të pa tundëshme për hartimin e Inventarit, ka me u ba tue ju konformue dispozitave të Kodit Tregtar mbi çmimet e tregut dhe t'amortizimit.

Art. 29.

Dispozitat e ksajë Rregullore janë të vlefshme për të gjithë kohën që funksjonojnë depot konformë me Dekret-Ligjën datë 15 Qershuer 1934.

Art. 30.

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 31.

Qeverija asht e ngarkueme me zbatimin e ksajë Rregullore.

BKSH

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shrkesën Nr. 426/XIII datë 20-IX-1934 të Kryeminisrtis,

Si ndigjojë dhe pëlqejë Vendimin e Këshillit Ministruer me datë 15-IX-1934.

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Rregullores mbi zbatimin e Ligjës me datë 15 Qershuer 1934, për parnimin e grunit e të misrit në natyrë për të dheta.

Durrës, me 26 Shtatuer 1934.

ZOG

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i Drejtësis
V. AVRAMI

Ministri i P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Arësimit
Dr. MIRASH IVANAJ

Ministri i P. Botore
S. SARAÇI

Ministri i Ekon. Kombëtare
D. BERATTI

Nr. 128.

DEKRET-LIGJË, 11 Shtatuer 1934.

Mbi zbatimin e Protokollit Shqiptaro-Grek, që rregullon mënyrën e bartjes të mallnave në mes të dy vendeve, nenshkrue në Selanik me datë 12 Prill 1934.

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Tetuer 1934, Nr. 56)

Neni 1.

Qeverija Mbretnore autorizohet të vejë në zbatim Protokollin Shqiptaro-Grek mbi formalitetet doganore që duhen plotësue për transportimin e mallnave prej Greqije në Shqipëri e anasjelltas nëpër rrugën Follorinë-Krustalopigji, Kapeshticë-Korçë, nënshkrue në Selanik me datë 12 Prill 1934.

Neni 2.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi maksimum 40 ditë mbas shkëmbimit të notave të ratifikimit ndërmjet dy Qeverive respektive.

ZOGU I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 99-XIV datë 10-IX-1934 të Kryeministrisë,

Si ndigjojë dhe pëlqej vendimin e Këshillit Ministruer me datë 8-9-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Derket-Ligjës mbi zbatimin e Protokollit Shqiptaro-Grek, që rregullon mënyrën e bartjes të mallnave në mes të dy vendeve, nënshkrue në Selanik me datë 12 Prill 1934.

Durrës, me 11 Shtatuer 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri P. të Jashtme XHAFER VILA

Ministri i Financavet A. DIBRA

PROTOKOLL

Mbi formalitetet Doganore që do të përmbushen për bartjen e mallnave nga Florina-Krustalopigji (Greqi) në Korçë (Shqipni) dhe anasjelltas

Tue marrë parasysh artikullin 6 t'akordit tregtar të përkohëshëm në mes të Shqipnis dhe Greqisë, i nënshkruem n'Athinë me 24 Qershor 1933, me anën e të cillit Qeverinat e të dy shteteve dekllarohen gadi për me fillue bisedimet për të vendosun kushtet ma të mira të mundëshme, me të cillat mund të kryhet transiti i mallnave që, nga zona e lirë e Selanikut, drejtohen për në Shqipni.

Të dy qeverinat emnuan për këtë qëllim delegatët të vijojnë:

Qeverija Mbretnore e Shqipnis, Zoti Dr. Sokrat Dodbiba, Drejtor' i t'Ardhunavet në Ministrin e Financavet, Zotin Qemal Kacaruha Shef Kontrollor i Doganavet n'atë Ministri dhe, Zotin Pjerin Jubani, Drejtor' i Doganës në Kapeshticë.

Qeverija e Republikës Helenike Zotin Anton Peppas Drejtor' i Doganave në Selanik, Zotin Kostantin Streftaris, Inspektor' i Financavet dhe Zoti Gjorgj Mantzaris, Drejtor' i Doganës në Florinë.

Të cillët mbasi i komunikuan njeni tjetrit letrat fuqiplote të tyne që u gjëndën të mira e në formën e duhun, u kuptuan mbi urdhnimet që vijojnë:

BKSH

Art. 1.

Mallnat me prej-ardhje nga zona e lirë e Selanikut dhe përgjithësisht nga toka Helenike të destinueme për Shqipni me anë të rrugës Florinë-Krustalopigji-Kapeshticë do të transportohen direkt në Korçë dhe do të dorëzohen e çdoganohen në Doganën e ktij qyteti.

Art. 2.

Mallnat me prej-ardhje Shqiptare t'importueme në Greqi me anë të rrugës Korçë-Kapshticë-Krustalopigji, do të zhdoganohen qoftë në Krustalapogji (përveç kur këjo nuk lejohet nga Ligjët në fuqi) qoftë në Florinë ose në Selanik, si mbas tregimeve që ka për të bërë shoferi në manifestën e importimit.

Art. 3.

Bartja e mallnave që bahet n'artikujt e ma-parëshem do të kryhet vetëm me automobila të mbylluna, përveç t'atyne mallnave që për shkak të natyrës së tyne, bartja n'atë mënyrë nuk asht e mundun (p. sh. landë ndërteset, vija hekuri, putra e putrela, shufra hekuri, makina të randa, voza boshe etj.)

Këto të fundit do të mund të transportohen me automobila të hapta.

Urdhnimet e kij artikulli nuk i u aplikohen shtazve të gjalla, të cillat mund t'importohen o t'eksportohen në kambë.

Art. 4.

Çdo automobil që transporton mall me anë të rrugës së përmendun duhet të jetë i pajosun me nji buletin shoqënimi i bamun në katër eksemplare me Nr. renduer i lëshuem respektivisht nga Dogana dërguese (e ekspedicionit) dhe i përpiluem konform me modelin që i aneksohet këtij protokolli. Në ketë buletin do të shkruhet e gjithë ngarkesa e automobilit.

Amza e buletinit do të mbetet në doganën dërguese; fleta e parë do të mbahet prej shrebimit doganor në kufi; e dyta dhe e treta fletë (për mallnat e eksportueme nga toka Helenike në Shqipni) do të vistohen nga organet doganore të kufinit të dy shteteve, do të përcjellin mallnat deri në Korçë dhe do t'i dorëzohen doganës të këtij qyteti.

Po sa mallnat të kenë mrritun, dogana e Korçës do të mbajë fletën e dytë dhe të tretën do t'ja kthejë doganës së ekspedicjonit dyke vërtetuar marrjen në dorëzim të mallnave me të gjitha vrejtjet eventuale.

Për mallnat e dërgueme nga toka Shqiptare në Greqi, fleta e dytë dhe e tretë e buletinit, mbassi të jenë vizue prej shërbimit doganor të kufinit të të dy shteteve, do t'i dorëzohen doganës së Krustalopigjis ose të Florinës si mbas destinacionit të mallnave.

Doganat Helenike do të mbajnë fletën e dytë ndërsa të tretën do t'ja dërgojnë doganës dërguese dyke vërtetuar marrjen në dorëzim të mallnave me të gjitha vrejtjet eventuale.

Në rasë se po mbi nji automobil duhet të ngarkohen mallna për të cillat regullat doganore në fuqi kërkojnë lëshimin e shum buletineve të shoqërimit, dogana e ekspedicjonit përveç atyne buletineve, do të lëshojë nji buletin të përgjithshëm konform me modelin e aneksuem në të cillin do të bahet fjalë mbi të gjithë ngarkesën dhe mbi buletinet speciale.

Mbi këto të fundit do të shkruhet Nr. renduer i buletinit të përgjithshem.

Art. 5.

Çdo automobil do të plumboset nga dogana e ekspedicjonit dhe nga sherbimi doganor i kufinit të Shtetit të destinacjonit. Për plumbosjen do të bahet fjalë në buletinin e shoqënimit.

Për sa i përket mallnave të transportueme nga automobila të hapët si mbas art. 3, plumbat do t'ju vihen kolive. Në asht se plumbosja e kolive asht e pa-mundun, dogana e ekspedicionit do të bëjë në buletin çdo tjetër përshkrim që të sigurojë identifikimin dhe integritetin e mallnave (p sh. sasin, copat, peshën, markat, çifrat numerike, dimensjonet etj.).

Art. 6.

Të drejtat doganore të duhura do të sigurohen me nji garanci personale. Përveç kësaj, shërbimi doganor mund t'urdhnojë — në se e gjykon të nevojshme — shoqërimin e automobilave. Ky sherbim (shoqërimi) do të bahet darovisht. Garancia e sipër-përmendun nuk do të shuhet veç mbassi të jetë vërtetue mrritja e mallnave në doganën e destinacionit që bahet në fletën e tretë të buletinit të shoqërimit.

Art. 7.

Shoferat me kombësi të dy shteteve kontraktuesa do të gëzojnë të drejtën për të transportuar mallna mbi rrugën Florinë-Krustalopigji, Kapeshticë-Korçë nga toka Helenike në tokën Shqiptare deri në Korçë, e anasjelltas nga toka Shqiptare në tokën Hellenike deri në Florinë.

Art. 8.

Ngarkimi i malnave mund të bahet në të gjitha orët e shërbimit normal të doganës, qoftë para dite qoftë mbas dite, me kondite që automobilat të kalojnë po n'atë ditë kufinin dhe para perendimit atë diellit. Në rasë të kundert, automobilat do të jenë të detyruem të mbesin natën nën mbikqyrjen e doganës të Shtetit të ekspedicjonit.

Sherbimi doganor i të dy shteteve kontraktuese mund të lejojë që ngarkimi të bahet edhe jasht orarit normal si mbas indemnizacjonit të parapam për kët shërbim nga Ligjët respetive.

Art. 9.

Urdhënimet e këtij protokolli nuk sjellin paragjykime për protokollin adisjonel të trafikut të zonës limitrofe i aneksuem në traktatin të tregtis e të lundrimit Shqiptaro-Grek i nënshkruar në Athinë me 13 Tetor 1926.

Art. 10.

Ky protokoll do të ratifikohet dhe ratifikimet do të shkëmbehen në Tiranë.

Do të hyjë në fuqi mbrenda 40 ditve të shumtën mbas shkëmbimit të ratifikimeve dhe do të mbetet i zbatueshëm aqë sa traktati i tregtis dhe i lundrimit Shqiptaro-Grek i nënshkruar në Athinë me 13 Tetor 1926.

Me këtë besë delegatët respektiv duhësisht t'autorizuem për kët qëllim e nënshkruan këtë protokoll dhe i vunë vulat e tyne.

I bamun në dy eksemplare në Selanik me dymbëdhjet Prill viti njimijnandëqindetridhjetekater (12 Prill 1934).

(nënshkrue) *A. peppas* (Nënshkrue) *Dr. Dodbiba*
(nënshkrue) *Streftaris* (nënshkrue) *Kemal Kassoruho*
(nënshkrue) *Gjorgj Mantzaris* (nënshkrue) *P. Jubani.*

PROTOCOLE

Concernant les formalités douanières à remplis pour le transport des marchandises de Florina-Kroustolopiyi (Grece) à Korça (Albanie) et vice-versa

Vu l'article 6 de l'accord provisoire de Commerce entre l'Albanie et la Greèce, signé à Athènes le 24 juin 1933, par lequel les Gouvernements des deux Pays se déclarent prêts à entamer des négociations pour établir les meilleurs conditions possibles dans

BKSH

lesquelles pourra s'effectuer le transit des marchandises qui, par la zone franche de Salonique, sont acheminées vers l'Albanie.

Les deux Gouvernements ont nommé à cet effet délégués, a savoir :

Le Gouvernement du Royaume d'Albanie, Monsieur le Dr. Socrat Dobbiba, Directeur des Contributions au Ministère des Finances, Monsieur Kemal Kassoruho, Contrôleur en Chef des Douanes audit Ministère et Monsieur Pierrin Jubani, Directeur de la Douane de Kapeshtica.

Le Gouvernement de la République Hellénique, Monsieur Antoine Peppas, Directeur des Douanes de Salonique, Monsieur Constantin Streftaris, Inspecteur des Finances et Monsieur Georges Mantzaris, Directeur de la Douane de Florina.

Lesquels, après s'être communiqués leurs pleins-pou-voirs trouvés en bonne et dûe forme, ont convenu des dispositions suivantes :

Article 1.

Les marchandises provenant de la zone franche de Salonique et en général du territoire hellénique, destinées pour l'Albanie, par voie Florina-Kroustalopiyi Kapeshtica, seront transportées directement à Korça et seront consignées et dédouanées à la Douane de cette même ville.

Article 2.

Les marchandises de provenance albanaise, importées en Grèce par la voie Korça-Kapeshtica-Kroustalopiyi, seront dédouanées soit à Kroustalopiyi (sauf si cela n'est pas permis par les lois en vigueur) soit à Florina ou à Salonique, selon l'indication qui sera faite par le chauffeur au maniffeste d'importation.

Article 3.

Le transport des marchandises, dont mention est faite par les articles précédents, sera effectué exclusivement par des automobiles fermées, exception est faite pour les marchandises dont, par raisons de leur nature, le transport ne peut pas s'effectuer de cette façon, (p. ex. bois de construction, rials, poutres, poutrelles, barrees en fer, machines lourdes, barils vides etc.).

Ces dernières pourront être transportées par des automobiles ouvertes.

Les dispositions du présent article ne s'appliquent pas aux

animaux vivants, lesquels peuvent être importés ou exportés à pied.

Article 4.

Chaque automobile transportant des marchandises par ladite voie doit être munie d'un bulletin d'escorte fait en quatre exemplaires et en numéro d'ordre, délivré respectivement par la douane d'expédition et rédigé conformément au modèle annexé au présent protocole. Dans ce bulletin sera inscrite toute la cargaison de l'automobile.

La souche du bulletin restera à la douane d'expédition; le premier volet sera retenu par le service douanier à la frontière; le deuxième et le trosième volet (pour les marchandises exportées du territoire hellénique en Albanie) seront visées par les services douaniers de la frontière des deux pays, escoteront les marchandises jusqu'à Korça et ils seront remis à la douane de cette ville.

Une fois les marchandises arrivées, la douane de Korça retiendra le deuxième volet et enverra le troisième à la douane d'expédition en certifiant la réception des marchandises avec toute observation eventuelle.

Pour les marchandises expédiées du territoire albanais en Grèece, le deuxième et le troisième volet du bulletin, après être visés par le service douanier de la frontière des deux pays, seront remis à la douane de Kroustalopiyi ou de Florina, selon la destination des marchandises.

Les douanes helléniques retiendront le deuxième et enverront le troisième volet à la douane d'expédition, certifiant la réception des marchandises avec observation eventuelle.

Si sur une même automobile doivent être chargées des marchandises pour lesquelles le règlement douanier en vigueur exige l'emisson de plusieurs bulletins d'escorte, la douane d'expédition, outre ces bulletins, émettra un bulletin général, conforme au modèle annexé, dans lequel sera fait mention ed la cargaison entière et des bulletins spéciaux.

Sur ces derniers serà inscrit le numéro d'ordre du bulletin général.

Article 5.

Chaque automoblie sera plombée par la douane d'expéditon et par le service douanier de la frontière du pays de destination. Du plombage sera faite mention dans le bulletin d'escorte.

Quant aux marchandises transportées par auotmobile ouverte selon l'article 3, les plombs seront apposés aux colis. Si le plombage des colis est impossibile, la douane d'expédition fera dans les bulletins toute autre mention, qui assurera l'identification de l'intégrilé des marchandises. (p. ex. le nombre, pièces, poids, marque, chiffre numérique, dimension etc.).

Article 6.

Les droits de douane dûs seront assurés par une garantie personnelle. En outre, le service douanier peut ordonner — s'il le juge nécessaire — l'escorte des automobiles. Ce service (l'escorte) sera fait gratuitement. La susdite garantie ne sera acquittée qu'apres l'attestation de l'arrivée des marchandises à la douane de destination faite au troisième volet du buletin d'escorte.

Article 7.

Les chauffeurs de nationalité des deux pays contractants jouiront du droit de transporter sur la voie Florina-Kroustalopiyi-Capeshtica-Korça, des marchandises du territoire hellénique au territoire albanais jusqu'à Korça, et vice versa du territoire albanais au territoire hellénique jusqu'à Florina.

Article 8.

Le chargement des marchandises pourra avoir lieu à toute heure de service normal de douane, tant avant qu'après midi, à la condition que les automobiles traversent le jour même la frontière avant le coucher du soleil. Dans le cas contraire, les automobiles seront obligéss de rester la nuit sous la surveillance da la douane du pays d'expédition.

Les services douaniers des deux pays contractans peuvent permettre que le chargement soit effectué même hors de l'horaire normal, d'après l'indemnisation prévue pour ce service par les lois respectives.

Article 9.

Les dispositions de ce protocole ne portent pas préjudice à celles du protocole additionnel du trafic de la zone limitrophe, annexé au Traité de Commerce et de Navigation, Greco-Albanais signé à Athènes le 13 octobre 1926.

Article 10.

Le presént prootcole sera ratifié et les ratifications en seront échangées à Tirana.

Il entrera en vigueur dans quarante jours au maximum, après l'échange des ratifications et restera exécutoire autant que le Traité de Commerce et de Navigation Greco Albanais signé à Athènes le 13 octobre 1926.

En foi de quoi, les délégués respectifs dûment autorisés à cet effet ont signé le présent protocole et l'ont revêtu de leurs cachets.

Fait en double exemplaire à Salonique le douze avril mille neuf cent trente quatre (12 Avril 1934).

(Signé) *A. Peppas* (Signé) *Dr. Dodbiba*
(Signé) *Streftaris* (Signé) *Kemal Kassoruho*
(Signé) *Georges Matzaris* (Signé) *P. Jubani.*

Nr. 129.

DEKRET-LIGJË, 26 Shtator 1934.

Mbi mënyrën e përdorimit të taksës së lulëzimit të përmendun në Nenin 80 të Ligjës së Bashkivet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 10 Tetuer 1934, Nr. 56)

Neni 1.

Nga t'ardhunat e taksës 1% e lulzimit qi përmendet në nenin 80 të Ligjës së Bashkivet, gjymsa përdoret eksklusivisht për lagjen Tirana e ré, dhe gjymsa tjetër lehet në dispozicion të Bashkis së Kryeqytetit, për t'a përdorë për qëllime tjera përmirësimi të vendit.

Neni 2.

Kjo Ligjë hyn në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Neni 3.

Ministria e P. të Mbrendëshme ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

Mbi proponimin e bamun me shrkesën Nr. 1316 datë 18-9-1934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimni e Këshillit Ministruer me datë 13-IX-1934,

D E K R E T O N :

Aproimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi mënyrën e përdo-

BKSh

rimit të taksës së lulzimit të përmendun në nenin 80 të Ligjës së Bashkivet.

Durës, me 26 Shtatuer 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri i P. të Mbrendshme
MUSA JUKA

Nr. 130.

DEKRET-LIGJË, 28 Gusht 1934.

Mbi protokollin e zbatimit t'aneksës C, (dipsozita që i takojnë trafikut të kufinit) të Traktatit për tregti dhe lundrim midis Shqiprisë dhe Jugosllavisë i nënshkruem në Belgrad me 22 Qershuer 1926

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 13 Tetuer 1934, Nr. 57)

Neni 1.

Pranohet protokolli i zbatimit t'aneksës C, (dispozita që i takojnë trafikut të kufinit) të traktatit për tregtij dhe lundrim midis Shqipnisë dhe Jugosllavisë i nënshkruem në Belgrad me 22 Qershor 1926.

Neni 2.

Kjo Dekret-Ligjë hyn në fuqi si mbas kushteve të caktueme në protokollin e nalt-përmendun i nënshkruem në Belgradë me 8 Maj 1934,.

Neni 3.

Ministrija e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Mbrendëshme Ministria e Financavet dhe ajo e Ekonomisë Kombëtare ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi proponimin e bamun me shrkesën Nr. 411/I datë 22-VIII-1934, të Kryeministriës,

D E K R E T O N :

Aprovimin e protokollit të nënshkruem në Belgradë me 8 Maj 1934 mbi zbatimin e aneksës C, (Dispozita që i takojnë trafikut të kufinit) të traktatit për tregëtij dhe lundrim midis Shqipniës dhe

Jugosllaivës i nënshkruem në Belgradë me 22 Qershor 1926, dhe Urdhënon zbatimin e tij.

Durrës, me 28 Gusht 1934.

Z O G

Kryeministri
P. EVANGJELI

Ministri P. të Jashtme
XHAFER VILA

Ministri i P. Mbrendëshme
MUSA JUKA

Ministri i Financavet
A. DIBRA

Ministri i Ekonomis Kombëtare
D. BERATTI

P Ë R M B A J T J A

I. Trafiku i kufinit

Ad neni 1 . . . . Pika N° 1 gjer më 4
Ad neni 2 . . . . Pika N° 5 gjer më 7
Ad neni 3 . . . . Pika N° 8 gjer më 10
Ad neni 4 . . . . Pika N° 11 gjer më 15
Ad neni 5 . . . . Pika N° 16 gjer më 17
Ad neni 6 . . . . (————)

II. Pronarë përtej Kufinit dhe Pronat-tokësore të tyne

Ad neni 7 . . . . Pika N° 18 gjer më 38

III. Kope që çohen në kullotje dhe në dimërim

Ad neni 8 . . . . Pika N° 39 gjer më 44

IV. Përdorimi i ujnave të kufinit

Ad neni 9 . . . . (————)

V. Karta kufini, kalimi i kufinit, qendrimet pertej kufinit

Ad neni 10 . . . . Pika N° 45 gjer më 53
Ad neni 11 . . . . Pika N° 54 gjer më 57

VI. Mjekë, veterinarë, mami, zejtarë, puntorë, që merren me transportim

Ad neni 12 . . . . Pika N° 58 gjer më 60
Ad neni 13 . . . . Pika N° 61

VII. Zona, rrugë, vise kalimi

Ad neni 14 . . . . Pika N° 62 gjer më 65

VIII. Ngushtime dhe suprimime të trafikut të kufinit

Ad neni 15 . . . . Pika N° 66
Ad neni 16 . . . . (————)

IX. Moskuptime dhe mënyra ndjekjeje

Ad neni 17 . . . . Pika N° 67

X. Modifikimet e aneksës C të këtij Protokoli si dhe afati i tyne

Ad neni 18 . . . . Pika N° 68 gjer më 69
Ad neni 19 . . . . (————)

XI. Pjesat e shtueme

Pjesa e shtuëme N° 1 . . . (Kufitë e mbrendëshem të zonës shqiptare).

Pjesa e shtuëme N° 2 . . . (Kufitë e mbrendëshem të zonës jugosllave).

Pjesa e shtuëme N° 3 . . . (Sektorë, vise, rruga, vise kalimi dhe tregje).

Pjesa e shtuëme N° 4 . . . (Lista e produkteve prej provenience shqiptare që duhet të përfitojnë nga hyrjet e lira dhe ngä privilegjët e parashikuar në nenin 2 të Aneksës C)

Pjesa e shtuëme N° 5 . . . (Lista e produkteve prej provenience jugosllave që duhet të përfitojnë nga hyrja e lirë dhe nga privilegjet e parashikuar në nenin 3 të Aneksës C).

Pjesa e shtuëme N° 6 . . . (zbatimi i Akordit Plotsuër t'Aneksës C që i përket trafikut të kufinit relativisht me tregun e Shkodrës).

XII. Aneksat e këti protokoli

Aneksa A . . . (Model i Kartës së Kufinit).
Aneksa B . . . (Model i Kartës Kufinit për pronar)
Aneksa C . . . (Model i vertetimit pronarije).

BKSH

Aneksa D . . . (Model i Listës përmbldhëse për kalimin e baktive për në kullotje ose dimërim).

Aneksa E . . . (Model i Lejës Kalimi).

Protokoll nenëshkrimi i hartave gjeografike dhe i skicavet

S h ë n i m : Hartat gjeografike gjënden veç.

PROTOKOLL ZBATIMI I ANEKSËS C.

(Dispozita që i përkasin Trafikut të Kufinit) të Traktatit Tregëtije dhe Lundrimi midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë

Të frymëzuar po me ate bindje për nevojën e të favorizuarit të marrëdhënieve të përbashkëta të një fqinjësie të mirë dhe të lehtësuarit të marrëdhenieve tregëtare midis banorëve të zonave kufizore.

Duke dashur të plotësojnë Aneksën C të Traktatit Tregëtije dhe Lundrimi midis të dy Shteteve, nënëshkruar më 22 Qershor 1926, dhe veçanërisht nenin 14 të Aneksës në fjalë.

Me qëllim që të caktohen, si mbas natyrës së vëndit dhe pozitës gjeografike, kufit' e mbrëndëshme të zonave të kufirit, si dhe rrugët për banorët e zonave të kufirit, dhe për pronarët përtej kufirit, dhe duke dashur të caktohen në marrëveshje të përbashkët dispozitat që i pëkasin interpretimit dhe zbaimit të avantazhëve dhe lehtësinave të parashikuar prej marrëveshjes së naltpërmëndur.

Qeveria e Mbetënisë Shqiptare dhe Qeverija e Mbretënisë Jugosllave emëruan, për ketë qëllim, si Delegat të tyre:

Qeverija e Mbretnisë Shqiptare :

S. T. Zotin Rauf Fico i Derguem i Jashtëzakonshem e Ministër Fuqiplotë i Nalt Madhnis Tij Mbretit të Shqiptarve.

S. T. Zotin Dhimitër *Beratti*, Ministër Fuqiplotë, Sekretar' i Përgjithëshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme,

Qeverija e Mbretnisë Jugosllave :

S. T. Zotin Dr. Bojidar Pouritch i Dërguar i Jashtëzakonëshëm dhe Minister Fuqiplotë, Nën Minister në Ministrinë Mbretnore të Punëvet të Jashtme;

Zotin Dr. Ivan *Soubbotitch*, Këshilltar në Ministrinë Mbretnore të Punëve të Jashtëme, me kalitet delegatë,

Të cilët, pasi shkëmbyen letrat fuqiplote të tyre, që u gjëndnë në formë të mirë dhe të duhur,, u muarr vesht për sa që pason :

1. — TRAFIKU I KUFINIT

Ad Neni 1 i Aneksës C.

Pika Nr. 1. — Është e ditur se me fjalët «zona kufizore», si mbas nenit 1 të Aneksës C, duhet kuptuar zona kufizore Shqiptare ashtu si është përshkruar në Pjesën e Shtueme Nr. 1 të këtij Protokoli.

Pika Nr. 2. — Me fjalët «banuësa të zonës kufizore», si mbas nenit 1 të aneksës C, duhen kuptuar shtetasit shqiptarë ose jugosllavë që kanë qëndrimin e tyre në zonën kufizore shqiptare të naltpërmendur.

Pika Nr. 3 — Në konformitet me Pjesën Shtuese Nr. 3, zona kufizore shqiptare është e ndarë në nântë (9) sektorë. Po nate pjesë Shtuëse janë caktuar gjithë vëndet që përfshin çdo sektor, si dhe tregjet jugosllave që korespondojnë cilitdo prej këtyre sektorëve.

Tregjet jugosllave në fajlë janë këta që pasojnë :

Rezani,
Manastiri i Shën - Naumit,
Ohria,
Struga,
Dibra,
Prizreni,
Vranishta,
Gjakova,
Gusinja,
Tuzi, ose Podgorica,
Ulqini.

Është e ditur se banorët e çdo prej këtyre sektorëve të zonës kufizore Shqiptare do të mundin. në konformitet me nenet 1, 2 dhe 3 të neksës C, të shkojnë në tregun jugosllav që korespondon me sektorin e tyre.

Të dy Qeveritë do të mundin, në marëveshje të përbashkët, të shtojnë dhe vise jugosllave të tjera që mund të shërbejnë si tregje për banorët e zonës kufizore Shqiptare

Pika Nr. 4. — Rrugët si dhe viset e kalimit të kufirit, me anën e të cilavet do të mundin këta banorë të shkojnë në tregjet ju-

gosllave koresponduës, janë po ashtu të shënuar në Pjesën Shtuese Nr. 3.

Ad Neni 2 i Aneksës C.

PIKA NR. 5. — Me fjalët «produkte të industrisë shtëpiake Shqiptare», që figurojnë në pikën 2 të nenit 2 të Aneksës C, duhen kuptuar gjithë sendet që produktohen në shtëpit e banorëvet shqiptarë, dhe jo ata që produktohen nëpër fabrikat.

PIKA NR. 6. — Përjashtimi nga gjithë taskat e importimit dhe të eksportimit përfshin përjashtimin nga gjithë të drejtat e doganës, taksat doganore, taksën e pullës mbi dëftesën e doganës, gjithë taksat e Shtetit mbi importimin dhe eksportimin dhe gjithë taksat bashkiake importimi dhe eksportimi cilido qoftë emëri i tyre, si dhe nga gjithë taksat e tjera që u përkasin formaliteteve doganore ose statistikore.

Me gjith ketë, përjashtimi i parashikuar në paragrafin e mëparshëm nuk përfshin përjashtimin e oktrovës (trosarina) për të cilën produktet shqiptare t'importuar do të trajtohen në mënyrë të njëllojëshme me produktet jugosllave (Shifni Nenin 6 të Aneksës C dhe Protokolin e fundshëm të tij).

Mbajtësit e sendeve të përmendura në këtë nen, duke kaluar kufirin, duhet t'i deklarojnë me gojë dhe, mbi kërkimin që mund t'u bâhet, janë të detyruar t'ia tregojnë oragnëve të kontrollit doganor.

PIKA NR. 7. — Me qëllim që të sigurohet zbatimi i mirë i dispozitave të nenit 2 të Aneksës C, asht hartuar një listë e produkteve prej provenience shqiptare që duhet të përfitojnë nga përjashtimet dhe privilegjet e parashëkuar në nenin në fjalë.

Këjo listë formon *Pjesën Shtuese Nr. 4* q'âsht nji copë e këtij Protokolli. Lista në fjalë mund, në u çfaqtë nevoja, të plotësohet ose të ndryshohet mbas nji marrëveshjeje të përbashkët midis të dy Qeverivet.

Ad Neni 3 i Aneksës C

PIKA NR. 8. — Përjashtimi nga gjithë taksat e imoprtimit dhe t'eksportimit përfshin përjashtimin nga gijthë të drejtat e doganës, taksat doganore, taksën e pullës mbi dëftesën e doganës, gjithë taksat e Shtetit mbi importim dhe eksportim dhe gjithë taksat bashkiake importimi dhe ekpsortimi cilido qoftë emëri i tyre,

si dhe nga gjithë taksat e tjera që u përkasin formaliteteve doganore ose statistike.

Pika Nr. 9. — Mbjatësit e sendeve të përmendura në ketë nen, duke kaluar kufinin, duhet t'i deklarojnë me gojë dhe, mbi kërkimin që mund t'u bâhet, janë të detyruar t'i a u tregojnë organëve të kontrollit doganuer.

Pika Nr. 10. — Me qëlim që të sigurohet zbatimi i mirë i dispozitave të nenit 3 të Aneksës C, âsht bërë një listë e produkteve prej provenience jugosllave që duhet të përfitojë nga përjashtimet dhe privilegjet e parashëkuar në nenin në fjalë.

Këjo listë formon *Pjesën Shtuese Nr.* 5 q'âsht nji copë e këtij Protokolli. Lista në fjalë mund, në u shfaqtë nevoja, të plotësohet ose të ndryshohet mbas një marrëveshje të përbashkët midis të dy Qeverivet.

Ad Neni 4 i Aneksës C

Pika Nr. 11. — Zonat kufizore të përmendura në nenin 4 të Aneksës C janë ato që përshkruhen në Pjesët Shtuese Nr. 1 e Nr. 2 të këtij Protokolli.

Pika Nr. 12 — Me fjalët «banuesa të zonës kufizore», si mbas kuptimit të nenit 4 të Aneksës C, duhen kuptuar shtetasit shqiptarë ose jugosllav që kanë qëndrimin e tyre në zonën kufizore Shqiptare, ashtu siç âsht përshkruar këjo zonë në Pjesën Shtuese Nr. 1 të këtij Protokolli.

Pika Nr. 13 — Me qëllim që sendet e përmëndura në nenin 4 të Aneksës C të mund të pëfitojnë nga përjashtimet dhe beneficët, mbajtësit e tyre duhet, në kalimin e kufirit, t'i deklarojnë me gojë dhe, mbi kërkimin që mund t'u formulohet, janë të detyruar t'i a u tregojnë organëve të kontrollit doganor të cilët duhet të plotësojnë formalitetet doganore pa kërkuar ndonjë shpërblim.

Formalitetet doganore do të bâhen në mënyrë që të mos sjellin as ndonjë vonim ose veshtirsi në trafikun e kufinit. Është e ditur se, deri sa sasia e produktëve të importuar kësisoj në mënyrë të përkohëshme, nuk do të kalojë atë të shënuar në listë (Pjesa Shtuese Nr. 4), s'âshtë për t'u kërkuar ndonji garanci personale ose garanci të hollash.

Pika Nr. 14 — Afati i kthimit të sendeve të importueme në mënyrë të përkohëshme do të caktohet prej autoritetëve doganore kompetente; sido qoftë, ky afat nuk mund të aklojë të tre muajt.

M'anë tjetër, këta sende duhet të kthehen, po m'atë rrugë dhe n'atë portë kalimi, në vëndin nga ku kanë qenë eksportuar që të mundin autoritetet doagnore të plotësojnë formalitetet që i përkasin kthimit të tyre.

Pika Nr. 15 — Për transformimet e lândëve të para (Matières) premières) caktohet përqindja që vijon:

a) për grurin: 65-80% miell,
b) elbin dhe tërshërën: 70-80% miell,
c) misrin: 70-80% miell,
d) produktët vojnore: 25-30% vaj,
e) drurin: 70-75% drasa,
f) trupa lisash: 60-70% shtylla drunjsh.

Pika Nr. 16 — Për gjithë mjetet e transportit, veç automobilavet, autoritetet doganore kompetente duhet të aplikojnë formalitetet e caktuara për sendet e përmenduna në nenin 4 të Aneksës C.

Duke bërë këta formalitete, autoritetet doganore do të lëshojnë dokumentin e nevojshëm i cili ka për të qenë i vlefshëm gjashtë muaj. Këta formalitete do të bëhen për kafshët-heqëse e kafshët-ngarkese si dhe për gjithë mjetet e tejra transoprti, në çastin e kalimit të parë të kufinit. Per sa u përekt enëve dhe ambalazhave, formalitetet doganore do të bâhen për çdo kalim.

Pika Nr. 17 — Për sa i përket kontrollit të gjendjes shëndetësore të kafshëve që transportojnë mallna nder tregje, âsht e marrun vesht që ky kontroll do të bëhet si mbas dispozitave të Pikës Nr. 27 të këtij Protokolli.

Ad Neni 6 i Aneksës C

(As një vëretje)

II. — PRONARË PERTEJ KUFINIT DHE PRONAT TOKSORE TË TYRE

Ad Neni 7 i Aneksës C.

Pika Nr. 18 — Zonat kufizore Shqiptare dhe jugoslave, të parashikueme në nenin 7 të Aneksës C, janë përshkruar në Pjesë Shtuese Nr. 1 dhe Nr. 2 të këtij Protokolli.

Pika Nr. 19 — Duhen konsideruar si prona-toksore përtej kufinit, si mbas kuptimit të nenit 7 të Aneksës C, pasunit' e patundëshme që vijojnë: arat për t'u mbejllë, vreshtat, kopshtet. bostanet, kopshtet pemësh, livadhet, kullotat, pyjet dhe tokat e tje-

ra për bujqësijë, si dhe mullinjtë e ndertuar, shtëpitë dhe çdo ndërtesë banimi, vathat stanet dhe çdo ndërtesë tjatër që shërben për ruajtjen e bagëtivet ose për punimin dhe transformimin e produktëve të këtyre të fundit, sharat, e vogla, derstilat (valjenice).

Pika Nr. 20 — Shtetasit e njerës nga të dy Palët Kontraktuese, që zotnojnë pronat-tokësore në zonën kufizore të Palës tjetër, që të mund të konsiderohen si pronarë përtej kufirit që gëzojnë favorët e nenit 7 të Aneksës C, duhet të jenë banuës të zonës kufizore. .

Pika Nr. 21 — Çdo pronar tejkufinuer që të mund të përfitojë nga favoret e nenit 7 të Aneksës C, duhet me pasë kartën identiteti të posaçme, të parashëkuar në nenin në fjalë. Këjo kartë do të quhet «*Kartë-kufini për Pronar*» (Dvovlasnicka-karta); do të ketë formën e një libreti me mbulesë të kuqe, si mbas modelit të bashkangjitun në këtë Protokoll (Aneksa B), dhe do të jete e shtypun në gjuhët Shqipe dhe jugosllave.

Pika Nr. 22 — Asht vendosun se «Karta-kufini për pronar» s'ka nevojë për fotografin e titullarit as për ato të personave të tjera që janë shënuar në të, por vetëm për nënëshkrimin e titullarit. Nënshkrimin do t'a zevendësojë shënja e gjishtit në rast se titullari âsht analfabet.

Pika Nr. 23 - 24 — Për të kaluar kufinin, personat e tjera të shënueme në «Kartën-kufini për Pronar», duhet të kenë dhe ato «Kartën-kufini» të tyre.

Pika Nr. 25 — «Karta-kufini për pronar», duhet, si mbas nenit 7 të Aneksës C, të lëshohen e të vizohen prej autoritetevet doganore. Me gjith këte, tue marrë parasysh oragnizimin administratuer të Shqipërisë, këto karta do të lëshohen dhe vizohen, në Shqipëri, prej Prefetkurave dhe Nën-Prefekturave dhe, në Jugosllavi, prej zyrave të doganës.

Pra, autoritetet kompetente për lëshimin dhe vizimin e këtyre Kartave do të jenë:

a) Në Jugosllavi: Zyrat e doganës; këto zyra janë tani ato të Manastirit, Strugës, Ohrisë, Dibrës, Prizrenit, Gjakovës, Podgoricës dhe Tivarit;

b) Në Shqipëri; Prefekturat dhe Nën-Prefekurat që lë-

shojnë «Karta-kufini»; këto Prefektura dhe Nenprefektura janë tani ato të Korçës (Pref.), Pogradecit (Nën-pref), Elbasanit (Pref.) Zerqanit (Nën-pref.), Peshkopisë (Pref.), Bicajit (Nën-Pref), Kukësit (Pref.), Tropojës (Nën-pref.) Kodrës-Shëngjergjit (Nën-pref.), Koplikut (Nën-pref.) dhe Shkodrës (Pref.).

Pika Nr. 26 — Për të marrë «Kartën-kufini për pronar», i interesuemi duhet të paraqitë një *vërtetim-pronarije* (Uverenje o imonju) që të provojë pronarinë e tij dhe të lëshuar prej Komunës pertej-kufinit ku gjëndet prona-toksore. Ky vërtetim do të ketë formën e modelit të bashkangjitur në ketë Protokoll (Aneksa C); do të jetë i shtypur në gjuhët shqipe dhe jugosllave dhe mbushun po ashtu, në është e mundur, në të dy gjuhët.

Gjithë formalitetet përkatëse me lëshimin e këtij vërtetimi bâhet darovisht.

Asht e ditun se ky vërtetim nuk formon përpara drejtësisë, në u paraqitë rasti, një provë definitive të pronësisë së titullarit, por âsht i lëshuem vetëm e vetëm për të lehtësuar zbatimin e dispozitavet të këtij Protokolli.

I interesuemi që nuk bindet me vëndimin e Komunës, ka të drejtë t'i drejtohet autoritetit administruer të naltë.

Pika Nr. 27 — Për të lehtësuar kalimin e kafshëve të punës dhe të bagëtive që dërgohen për kullotje mbi pronat-tokësore përtej kufinit, të dy Palët Kontraktuëse, në vënd që të kërkojnë zbatimin e plotë të dispozitave të paragrafit të para-fundit dhe të fundit të nenit 7 të Aneksës C, u muarr vesht që prova e gjendjes shëndetsore të këtyre kafshëve të bâhet në ketë mënyrë:

Nën-prefektët dhe Prefektët Shqiptarë të viseve Shqiptarë do të informojnë muaj për muaj Nën-prefektët jugosllavë përtej-kufinit mbi gjendjen shëndetësore të kafshëve e të bagëtive në qarkun e tyre. Në rast se ky qark âsht i lidhun me dy ose shumë Nënprefektura juosllave, atëherë komunikimi do t'i bâhet seicilës.

Gjith ky lloj komunikimi do t'u bâhet muaj për muaj, prej Nën-prefektave jugosllave, Prefektave ose Nën-prefektave Shqiptarë pertej kufinit.

Ky komunikim i gjendjes shëndetësore do të lajmojë, nëse në qarkun në fjalë kanë ngjarë, gjatë 30 ditëve të fundit, raste sëmundjesh ngjitëse, dhe, në qoftë se po, ç'lloj sëmundjeje, në cilën komunë dhe sa ka qënë numri i kafshëve të sëmura.

Komnikikimi i gjendjes shëndetsore duhet të bâhet gjatë të tre ditëve të para të çdo muaji.

Në rast që rezulton prej këtij komunikimi se nuk ka pasun sëmndje ngjitëse, as ndonjë vërtetim shëndetësie nuk do të kërkohet.

Seicila nga të dy Palët Kontraktuese rezervon të drejtën të kërkojë, eventualisht dhe në u paraqitet rasti, zbatimin e dispozitave të nenit 7 t'Aneksës C, paragrafi i para-fundit dhe i fundit, qoftë në një ose shumë sektorë, qoftë në tërë zonën kufizore.

Pika Nr. 28 — Procedura për lëshimin e «*Kartavet-kufini për* Pronarë» âsht këjo që pason:

a) Lëshimi i «Kartëve-kufini për Pronarë» prej autoritetit shqipëtar:

I interesuemi paraqitet në Prefekturën ose Nënprefekturën shqiptare të vëndit ku ka banesën e vet, dhe i dorëzon «Kartën-kufini» dhe «Vërtetimin pronarije», ky i fundit i lëshuar prej Komunës jugosllave.

Prefektura ose Nën-prefektura në fjalë pregatit «Kartën-kufini *për Pronar*» dhe e dergon, të shoqëruar prej dy dokumentave të naltpërmendur, ex-officio dhe drejt për së drejti në Nen-prefekturën jugosllave përtej kufinit. Këjo e fundit ngarkohet t'i-a dërgojë pliken pa vonesë zyrës së doganës jugosllave të vëndit ku gjëndet prona-tokësore me qëlim që këjo zyrë t'akordojë vizën. Mbasi akordohet viza, Karta dhe të dy dokumentat që e shoqërojnë i kthehen, po m'atë rugë, autoritetit shqipëtar që i kish dërguar, për t'i-a dorëzuar të interesuemit.

Në rast se âsht kërkuar të shënohen dhe persona të tjera (shërbëtorë, barinj, far' e fis) mbi «*Kartën-kufini për Pronar*», Kartat kufini të këtyre personave do t'i dorëzohen gjith ashtu Nën-Prefektit ose Prefektit shqipëtar, për të shoqëruar të dy dokumentat e përmendura këtu nalt. Për far' e fisin këjo gjâ do të bâhet vetëm atëherë kur këta nuk do të jenë shënuar mbi *Kartën kufini* të pronarit. Shënimi do të bëhet mbi këto Karta-kufini në konformitet me Pikën 53 të këtij Protokolli.

b) Lëshilmi i «Kartave kufini për pronarë» prej autoritetit jugosllav:

Me «Kartën-kufini», që do t'i ketë më parë lëshuar Nën-prefektura jugosllave, dhe me «*vërtetimin pronarije*», të lshuar prej

Komunës shqiptare, i interesuëmi paraqitet në zyrën e doganës jugosllave të vëndit ku ka banimin.

Zyra e doganës në fjalë pregatit «*Kartën-kufini për Pronar*», dhe i-a dërgon, të shoqëruar prej të dy dokumentave në fjalë, Nenprefektit jugosllav. Nën-prefekti në fjalë vizon Kartën dhe i-a dërgon, të shoqëruar prej të dy dokumentave në fjalë, ex-officio dhe drej për së drejti Prefekturës ose Nënprefekturës shqiptare të vëndit ku gjëndet prona-tokësore, me qëllim që këjo e fundit të akordojë vizën. Mbassi akordohet viza, Karta dhe të dy dokumentat që e shoqëronin i kthehen gjith m'atë rugë zyrës doganore jugosllave. Prefektura ose Nën-prefektura shqiptare në fjalë do t'informojë njëkohësisht zyrën e doganës shqiptare për akordimin e vizës.

Në rast se âshtë kërkuar të shënohen dhe persona të tjera (shërbëtorë, barinj, far' e fis) mbi «Kartën kufini për pronar», kartat-kufini të këtyre personave do t'i dorëzohen gjith ashtu zyrës së doganës jugoslave për shoqërim të dy dokumentave të naltpërmendur. Për far' e fisin këjo gjë do të ngjasë vetëm atëherë kur ky nuk do të jetë shënuar mbi Kartën-kufini të pronarit. Shënimi do të bâhet mbi këto «Karta-kufini» në konformitet me Pikën 53 të këtij Protokolli.

Pika Nr. 29 — Përveç se po të ketë arësye të posaçme, viza do të lëshohet prej autoritetit pertej kufinit mbrënda një afati prej 10 ditsh. Në rast refuzimi të vizës, duhen shpjeguar arësyet e tij duke kthyer njëkohësisht Kartën dhe dokumentat që e shoqëronin.

Pika Nr. 30 — «Karta-kufini për pronar» është e vlefshme për një vjet, d. m. thânë që më 1 Prill deri më 31 Mars. Mbas kësaj date duhet të përsëritet.

Pika Nr. 31 — Çdo ndreqje, ndryshim ose anullim mbi Kartën në fajlë. Po ashtu dhe për vizat.

Këto ndreqje, ndryshime ose anullime duhet t'i komunikohen ex-officio drejt për së drejti autoritetit kompetent pertej kufinit.

Shënime suplimentare nuk mund t shkruhen mbi Kartën veç se prej organëve të kontrollit ose prej autoritetit që ka lëshuar Kartën ose ka dhânë vizën.

Çdo shkatërrim ose humbje e «Kartës kufini për pronar» duhet t'i komunikohet autoritetit që e ka lëshuar.

Pika Nr. 32 — Me «Kartën kufini për pronar» mund të ka-

lohet kufini vetëm me anën e rugëve dhe viseve kalimi që shënohen në Kartën në fjalë.

Eshtë e ndalueme për pronarët tejkufinore dhe për personat që shënohen mbi «Kartat e tyre të kufinit për pronar» të largohen nga pronat-tokësore të tyre. Bâhet përjashtim vetëm ndër raste nevoje urgejnte dhe reale, por atëhere janë të detyruem të kenë një autorizim të mëparëshëm nga autoriteti kompetent lokal ose na ay i kufinit. Në rast nevoje me rândësi të ngutëshme (force majeure), kur ky autorizim s'ka qenë e mundur që të merret, këta persona janë të detyruem të lajmërojnë ma pas autoritetin në fjalë.

Mund të shkohet në pronat-tokësore përtej kufinit çdo ditë, qoftë dhe ditë feste.

Pika Nr. 33 — Bagëtitë e pronarit përtej kufinit që çohen për kullotë në pronat-tokësore përtej kuifnit, duhet të kthehen po atë ditë para se të perëndojë djelli.

Kafshët punimi, si dhe veglat e ndryshme, maqinat pyjore dhe bujqësore të shënueme në Kartën kufini për pronar, duhet po ashtu të kthehen prapë nga pronat-tokësore, gjith atë ditë dhe përpara se të perëndojë djelli. Me gjith këtë, në rast nevoje, dhe mâ tepër gjatë punimëve të korrjes, mund të qëndrojnë në pronën-tokësore mâ tepër se një ditë dhe, në këtë rast, duhet veprruar në konformitet me tregimet e nenit 11 të Aneksës C, si dhe me shpjegimet e dhânë në ketë Protokoll, me rastin e interpretimit po të këtij neni.

Pika Nr. 34 — Personat e shënueme në «Kartën kufini për pronar» mund të transportojnë lirisht dhe nën kondital e parashëkueme në nenin 7 të Aneksës C, kafshët, sendet dhe produktet e përmendun në të. Për zbatmin e këtyre dispozitavet u muarr vesht se:

1. — Kafshët punimi dhe bagëtitë që shpien në kullotje, do të shënohen në «Kartën kufini për pronar».

2. — Në «Kartën kufini për pronar» do të shënohen vetëm veglat e mëdha ose maqinat e mëdha pyjore ose bujqësore, si për shëmbëll: veturat, shoshat, qeret etj. veglat e vogëla, si kosët, drapërët, shatat, lopatat kazmat, lesat (trinat), qerkat, pulverizatorët (maqina spërkatëse), etj. nuk âsht nevoja që të shënohen në Kartën.

3. — Farnat do të pranohen në bazë të sasisë së nevojësh-

me për mbjelljen e tokës. Plehu natural pranohet në bazë të nevojës s'arës

Asht marrun vesht se pulverizatorët dhe çdo send që shërben për luftimin e sëmundjeve të bimëvet, do t'asimilohen me polverizatorët dhe me çdo send që shërben për të luftuar insektët e dâmëshme.

4. — Personat në fjalë kanë të drejtën të transportojnë në shtëpitë dhe çifligjet e tyre produktet e korrun ose të produktueme në pronat-tokësore të tyre pertej kufinit, si për shëmbëll: produktet bujqësore, pyjesh, të pulavet, të qumështit, të apikulturës si dhe sëndet që shërbejnë për transportimin dhe ambalazhin e tyre. Asht e marrun vesht se kanë të drejtë të transportojnë rrusht e vreshtave të tyre qofshin në gejndjen e tyre naturale, qofshin të shtypun ose të transformueme në lânk.

5. — Këta persona kanë të drejtë të transportojnë ushqimin e nevojëshëm për vehten e tyne si dhe për bagëtitë e tyne, për tërë kohën që kanë për të kaluar në pronat-tokësore të tyne, si dhe njëzet gram duhan për çdo duhan-pirës.

Pika Nr. 35 — Pronari përtej kufinit dhe gjithë personat e shënueme mi Kartën, duhet t'u shtrohen Ligjëvet dhe Rregulloreve të vendit, në tokën e të cilit gjënden.

Pika Nr. 36 — Pronari përtej kufinit asht përgjigjës, me të holla, për çdo delikt doganor të bërë prej personave të shënueme në Kartën e tij.

Pika Nr. 37 — a) Me fjalët «Pronarë të tanishëm të pasunivet-tokësore» (shifni paragrafin 10 të nenit 7 të Aneksës C) duhen kuptuar personat që ishin pronarë të posunivet-tokësore ditën e hyrjes në fuqi të Traktatit Tregëtie dhe Lundrimi, do-më-thënë më 17 Maj 1929.

b) Me gjith këtë të dy Palët e Nalta Kontraktuëse rezervojnë fakultetin për të ardhur në marrëveshje që kaliteti i pronarit pertej kufinit t'u njfet, individualisht, edhe banorëve të zonës kufizore që, duke mos patun qenë pronarë më 17 Maj 1929, u bânë në datën e nënëshkrimit të këtij Protokolli. Këjo gjâ me konditë që personat në fjalë të kenë hyrë në zotënim të pronës-tokësore, mbrënda këtij afati, me anë blerjeje të regullshme nga një pronar që, në kohën e shitjes, ka patun kalitetin e pronarit përtej kufinit.

Këjo marrëveshje duhet të bëhet individualisht do-më-thënë për çdo rast konkret.

Me një qëllim të tillë Palët e Nalta Kontraktuëse do t'i komunikojnë reciprokisht njëra tjetrës, me rrugën diplomatike, mbrënda një afati prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, listën e këtyre rasteve. Këjo listë do të përmbajë gjithë informatat e nevojëshme (si, për shëmbëll: mbiemënin, banesën e tanishme të interesuëmit; banesën në kohën e blerjes; vëndin, llojin dhe madhërinë aproksimative të pronës-tokësore; mibemërin, banesën dhe shtetësinë e pronarit të vjetër në kohën e shitjes, si dhe në çastin e hyrjes në fuqij të Traktatit Tregëtije do-më-thênë më 17 Maj 1929; provat e shitjes). As një kërkesë nuk do mund të paraqitet mas kalimit të këtij afati. Por, âsht e ditun se, njoftja e pronarit përtej kufinit âsht vetëm një akt administruer që nuk krijon përpara drejtësisë një provë definitive të pronarisë, por që âsht bërë me qëllim që të lejojë zbatimin e dispozitavet të Aneksës C të këtij Protokolli.

Pika Nr. 38. — Përveç pronarit që ka tokë përtej kufinit, «Karta kufini për pronar» mund t'i lëshohet dhe qira-marrësit ose bujkut të pronës-tokësore të tij përtej-kufinit, që ka marrë më parë autorizimin nga autoritetet kompetente (në konformitet me paragrafin 3 të nenit7, të Aneksës C. Në një rast të tillë pronari humb të drejtën të ketë «Kartën-kufini për pronar» për tërë kohën e dhënies me qira ose të ortakllëkut.

Procedura për lëshimin e këtyre Kartavet âsht gjith ajo që u caktua dhe për Kartën e pronarit. Autoriteti përtej kufinit që lëshon vizën e Kartës, ka për të vendosur mbi autorizimin e parashëkuar në paragrafin 8 të nenit 7 të Aneksës C.

III. BAGËTITË QË ÇOHEN NË KULLOTJE OSE DIMËRIM

Ad Neni 8 i Aneksës C.

Pika Nr. 39. — Me fajlët «Autoritete policore» të përmënduna në pikën 2 të nenit 8 të Aneksës C, duhen kuptuar autoritetet administrative (Prefekturat e Nen-prefekturat në Shqipri, dhe Nënprefekturat në Jugosllavi).

Pika Nr. 40. — Lista përmbledhëse e përmendun në pikat 3 e 4 të nenit 8 të Aneksës C duhet të bëhet si mbas modelit të bashkëngjitur në ketë Protokoll *(Aneksa D)*.

Pika Nr. 41 — *(ad paragrafi 7 i nenit 8 të Aneksës C)*. — Përpara se të lerë vëndin e kullotjes ose të dimërimit, konduktori

i kafshëve âsht i detyruem të shkojë te autoriteti Bashkiak i komunës ku gjendet kullota për të marrë prapë ekzemplarin e listës përmbledhëse që i âsht dorëzuar bashkisë në fjalë, në kohën e arritjes së bagëtive.

Mbasi të tërhiqet ky ekzemplar i listës, konduktori shpie bagëtitë në kufi dhe paraqitet para zyrës së doganës për t'i transmetuar ekzemplarin e listës që ka në dorë. Nëpunësi i doganës mbasi të kontrollojë numurin e kafshëvet, në bazë të listave dhe dokumentave të tjera (si për shëmbëll vërtetimi i parashëkuar në pikën 42 të këtij Protokolli), i kthen prapë ekzemplarin e listës që âsht mbajtun në zyrën e doganës dhe le të lirë konduktorin dhe bagëtit' e tija të kalojnë kufirin.

Kur konduktori arrin në doganën e vëndit të tij, nga e cila kanë dalë bagëtitë, nëpunësi i doganës i-a merr ekzemplarin e listës që ka në dorë dhe, mbasi kontrollon numurin e bagëtive, e le të lirë konduktorin të shkojë në shtëpin e vet bashkë me bagëtitë.

Pika Nr. 42 — *(ad paragrafi VIII i nenit 8 të Aneksës C).*

a) Për bagëtitë e ngordhura ose të theruna prej nevoje ose për shkak sëmundjeje, gjatë kohës së dimërimit ose të kullotjes, pronari i bagtive ose ay që e zëvëndëson asht i detyruar të marrë një certifikatë të lëshuem prej Komunës kompetente për të vërtetuar numurin e bagëtive të ngordhuna ose të theruna si dhe arësyet e kësaj humbjeje.

Në kthimin, kjo certifikatë duhet t'i paraiqtet autoritetit doganuer kompetent, për të marrë shënim në listë. Në mungesë të ksaj certifikate, konduktori i bagëtive asht i detyruar të paguajë taksat doganore dhe gjith taksat e tjera për numurin e bagëtive në fjalë.

b) për sa u përket bagëtive të shitura gjatë kohës së kullotjes ose të dimërimit, duhet, me rastin e kthimit, të bahet një deklaratë me gojë zyrës së doganës që të mundë të marrë taksat përkatëse.

Pika Nr. 43 — Kullotja e bagëtivet dhe i kopevet të pronarëve tejkufinuer, mbi pronat-tokësore të tyne që ndodhen pertej kufinit:

a) Kalimi i bagëtivet të pronarit q'i çon në pronën-tokësore të tij përtej kufinit (të gjëndur mbrënda zonës) me qëllim që të kullosin ditën e të kthehen në mbramje, bahet në konformitet me

formalitetet e caktueme në nenin 7 të Aneksës C dhe me pikat e këtij Protokolli që interpertojnë dispozitat përkatëse të nenit në fajlë. Për sa i përket veçanërisht provës shëndetësije të bagëtivet, do të bahet në konformitet me dispozitat e Pikës 27 të këtij Protokolli.

b) Kalimi i bagëtivet të pronarit që çon në pronën-tokësore të tij përtej kufinit (të gjëndun mbrënda zonës) për të qëndruar mâ tepër se 3 ditë për verimin ose dimërimin, bahet në konformitet me dispozitat e nenit 8 të Aneksës C dhe të pikave Nr. 39 deri më 42 të këtij Protokolli. Këto bagëtij duhet të kenë veçanërisht vërtetimin e caktuem prej paragrafit 3 të nenit 8 në fajlë.

Pika Nr. 44 — Pronari i kopesë, në kalimin e kufinit, duhet të ketë pasaportë të regulshme në tre rastet që vijojnë:

a) Kur asht banor i zonës kufizore të njerës Palë Kontraktuese dhe kullota e tij gjëndet në zonën kufizore të Palës tjetër Kontraktuëse;

b) Kur banon jashtë zonës kufizore të njerës Palë Konstraktuëse dhe kullota e tij gjëndet në zonën kufizore të Palës tjetër Kontraktuëse; dhe

c) Kur banon jashtë zonës kufizore të njerës Palë Kontraktuëse dhe kullota e tij gjëndet jasht zonës kufizore të Palës tjetër Kontraktuese.

IV. — PËRDORIMI I UJNAVE TË KUFINIT

Ad Neni 9 i Aneksës C.

(As një vërejtje)

V. KARTA KUFINI, KALIMI I KUFINIT, QENDRIME PËRTEJ KUFINIT

Ad Neni 10 i Aneksës C.

Pika. Nr 45 — Ndër rastët e kalimit të kufinit të parashikuem prej Aneksës C, banorët e zonës kufizore duhet të kenë një «*Kartë-kufini*».

Rastet në fjalë të parashëkuem prej Aneksës C janë këta që pasojnë:

1. — Kalimi për të shkuar në treg (neni 1 deri më 3 i Aneksës C),

2. — Kalimi për të shkuar në mulli, etj. (neni 4 i Aneksës C),

3. — Kalimi i pronarit që shkon në pronën toksore të tij pertej kufinit (neni 7 i Aneksës C),

4. — Kalimi i shërbëtorit të një pronari përtej kufini që shkon në pronën-tokësore të zotit (neni 7 i Aneksës C),

5. — Kalimi i pronarit ose i konduktorit të bagëtive që shkon në kullotën (neni 8, paragrafi 12, i Aneksës C,

6. — Kalimi i mjekut, i veterinarit, i mjekut-pjelljesh ose i mamisë (neni 12 i Aneksës C),

7. — Kalimi i zejtarit ose i punëtorit (neni 12 i Aneksës C) dhe;

8. — Kalimi i banorit të zonës kufizore që merert me transportimin e udhëtarëvet ose të mallnavet (neni 13 i Aneksës C).

Pika Nr. 46 — «*Karta-kufini*» do të ketë formën e një libreti të vogël si mbas modelit të bashkangjitur në këtë Protokoll (*Aneksa A*) Do të jetë e shtypun në gjuhët shqipe e jugosllave dhe do të ketë një mbulesë të verdhë.

Pika Nr. 47. — Në rast se pejsëtarët e familjes së titullarit të një Kartë-kufini nuk do të kenë personalisht Karta-kufini, emëri dhe mosha e tyne duhet të jenë të shënueme në Kartën-kufini të **titullarit**

Në këtë Kartë duhet po ashtu të jenë shënuar edhe emërat e mosha e fëmijëve nënë 12 vjetsh.

Asht tepër e dëshëruëshme që Karta-kufini të përmbajë fotografinë e pronarit dhe të pjesëtarëve të mëdhenj të familjes së tij (përmbi 25 vjetsh);

Veç kësaj, Karta-kufini duhet të përmbajë nënshkrimin e titullarit ose shënjën e gjishtit, në rast se asht analfabet, si dhe pjesëtarët e mëdhenj të familjes së tij të shënuem në Kartën.

Pika Nr. 48 — Autoritetet policore, të përmendura në paragrafin 4 të nenit 10 të Aneksës C, janë në Shqipëri Prefektët dhe Nënprefektët, dhe në Jugosllavi Nën-prefektët.

Kartat-kufini të lëshueme prej Prefektit ose Nën-prefektit shqiptar do t'i komunikohet ex-officio drejt për së drejti Nën-prefektit jugosllav për të dhanë vizën. Ky i fundit, mbasi ti' vizojë, do t'i a kthejë ex-officio drejt për së drejti Prefektit ose Nën-prefektit shqipëtar që i-a ka dërguar.

Procedura në rugë të kundërt do të ndiqet për Kartat-kufini të lëshueme prej Nën-prefektave jugosllavë.

Kartat-kufini do t'u lëshohen dhe do t'u vizohen vetëm personave që kanë qëndrimin e tyre në zonën dhe që kanë një sjellje të

mirë. Përveç se po të ketë arësye të posaçme, viza do të lëshohet mbrenda 10 ditëve.

Pika Nr. 49 — Karta-kufini, regullisht e vizueme, do të jetë e vlefshme për një vjet, nga data e lëshimit. Gjith ajo Kartë mund të zgjatet për një vjet tjetër prej autoritetit që e ka lëshuar, me konditë gjithëmonë që t'i jetë dhanë një vizë e ré prej autoritetit kompetent përtej kufinit, të gjitha këto në konformitet me dispozitat e naltshënueme.

Pika Nr. 50 — Çdo korrigjim, ndryshim ose anullim në Kartën-kufini nuk mund të bahet veç se me lejen e autoritetit që e ka lëshuar Kartën. Po ashtu dhe për vizën.

Këta korigjime, ndryshime ose anullime duhet t'i komunikohen ex-officio drejt për së drejti autoritetit të nalt-përmendun përtej kufinit.

Pika Nr. 51 — Çdo formalitet q'u takon Kartave të kufinit asht i përjashtuem nga çdo taksë.

Pika Nr. 52 — Titullari i Kartës-kufini mund të shkojë vetëm në viset (treg, pronë-tokësore etj.) dhe vetëm me anën e rugëve dhe visëvet kalimi që janë caktuar në Kartë.

Në rast se titullari i kësaj Karte ka nevojë të shkojë në një vënd që gjëndet jashtë atij qi asht caktuar në të, por mbrënda zonës dhe po n'atë sektor, asht i detyruem të marrë mâ parë një autorizim nga autoriteti i vëndit ose nga ay i kufinit. Ky autorizim duhet të shënohet në Kartën-kufini të tij.

Pika Nr. 53 — Asht e marrë vesht se paragrafi i fundit i nenit 10 të Aneksës C do të ketë zbatimin që vijon:

Shërbëtorët e pronarit përtej kufinit, si dhe shërbëtorët e pjesëtarëve të familjes së tij që nuk janë të shënuem në Kartën-kufini, që shkojnë në pronën-tokësore përtej kufinit të zotit të tyre ose të far' e fisit duhet të kenë dhe ata «Kartën-kufini» të tyre. Mbi këtë Kartë-kufini do të jetë bërë shënimi që vijon:

«Titullari i kësaj Kartë-kufini âsht i autorizuem të shkojë në pronën-tokësore të Z.......................... që gjëndet në.........................., komuna e.........................., i cili zotëron «Kartën kufini për pronar Nr.................., të lëshuem prej.......................... Mund të kalojë kufinin në vend-kalimin..........................».

Ky shënim do të bahet prej autoritetit që i ka lëshuar të zotit

«Kartën përtej kufini për pronar» dhe do të vizohet prej autoritetit kompetent përtej kufinit.

Ad Neni 11 i Aneksës C.

Pika Nr. 54 — Titullari i një Karte-kufini, që vjen në tregun e Palës tjetër Kontraktuese, asht i detyruem të kthehet po atë ditë dhe përpara se të perëndojë djelli.

Në rast nevoje, mund të qëndrojë mâ tepër se një ditë por, në një rast të tillë, duhet mâ parë të marrë lejen e autoritetëve të vëndit ose t'atyre të kufinit. Ky autorizim do të shënohet në Kartën kufini të tij.

Gjith këjo procedurë do të zbatohet edhe kur âsht puna për lejet kalimi dhe titullarët e tyre.

Pika Nr. 55 — Për sa u përket pronave-toksore përtej kufinit, qëndrimi mund të zgjatet jashtëzakonisht mâ tepër se një ditë vetëm kur asht fjala për punime bujqësore që nuk lejojnë shtyrjen për mâ vonë (korrja), dhe në një rast të tillë ësht e nevojëshme të merret mâ parë autorizimi i autoritetve të vëndit ose i atyre të kufinit (doganë, organi i kontrollit financiar, gjëndarmeria). Ky autorizim duhet të shënohet në Kartën kufini.

Pika Nr. 56 — Me gjith këtë, zotëruësit e Kartave-kufini, për pronar dhe i Lejëve-kalimi nuk mund të qëndrojnë në tokën e Palës tjetër kontraktuëse mâ tepër se tre dit.

Pika Nr. 57 — Pronarët dhe konduktorët e kopevet dhe barinjt për të cilët flet Pika Nr. 43-b i këtij Protokolli, nuk mund të qendrojnë ndër male dhe fusha, për kullotjen e bagëtive të tyre, mâ tepër se gjashtë muaj.

VI. MJEKË, VETERINARË, MJEKË LINDJESH, ZEJTARË, PUNTORË, PERSONA QË MERREN ME TRANSPORTIM

Ad Neni 12 i Aneksës C.

Pika Nr. 58 — Mjekët, mjekët lindjesh, mamitë e veterinarët si dhe zejtarët e punëtorët, për të marrë leje kalimin, duhet t'u drejtohen autoritetëve administrative kompetente tue patun Kartën kufini të tyre dhe dokumentat që vërtetojnë mjeshtërinë ose zejën e tyre.

Me paraqitjen e këtyre Kartave dhe dokumentave, autoriteti

kompetent ka për të pregatitun leje kalimin dhe ka për të vepëruar masandaj simbas caktimevet të këtij neni.

Autoritetet kompetente për lëshimin dhe vizimin e lejëve-kalimi janë po ato që lëshojnë dhe vizojnë Kartat kufini.

Pika Nr. 59. — Fraza « pa qenë të detyruem me u paraqitë autoritetëve të kufinit», që figuron në nenin 12 të Aneksës C, nuk do të thotë se përsonat e naltpërmenduna janë të përjashtueme nga vizita doganore dhe nga kontrolli i identitetit të tyre, por se këto formalitete duhet të bahen në një mënyrë që të mos sjellin as ndonjë vonesë ose vështirsi për kalimin e kufinit.

Për sa u përket mjeteve transportimi dhe veglave të personave në fjalë, do të veprohet në konformitet me shpjegimet e dhanë me rastin e interpretimit të nenit 5 të Aneksës C.

Pika Nr. 60 — Leja-kalimi do të ketë formën e modelit të bashkangjitur tekstit të Aneksës C. («Model ad neni 12»). Me gjith ketë është marë vesht që të shuhet nga ky model fraza që gjindet në fund të tij dhe që asht shkrojtun në këtë mënyrë: «Kjo leje i meret titullarit në kthimin e tij e vihet në vëndin vet, në librin e modelëvet». Pra, forma definitive e «*Lejes-Kalimi*» asht ajo që caktohet në *Aneksën E* të këtij Protokolli.

Do të jetë e vjefshme për një vjet.

Ad Neni 13 i Aneksës C.

Pika Nr. 61 — Mjetët transportimi të udhëtarëve dhe të mallnave (dyke përfshirë edhe kafshët-tërheqëse, kafshët-ngarkimi dhe aksesorët e tjerë) do t'u shtrohen. me rastin e kalimit të tyre të parë të kufinit, po atyne formalitetëve që janë shënuar në nenin 5 të Aneksës C dhe në shpjegimet e dhânë në këtë Protokoll në ad neni 5.

Për sa u përket automobilave, mbeten jashtë parashikimeve të këtij neni dhe formalitetet përkatëse rregullohen prej nenit 6 të Marrëveshtjes Shtuëse të Traktatit Tregëtije dhe Lundrimi, nënëshkruar në Belgrad më 20 Dhjetor 1933.

VII. ZONA, RRUGA, VISE KALIMI

Ad Neni 14 i Aneksës C

Pika Nr. 62 — Kufitë e mbrendëshme të zonës kufizore shqiptare janë caktuar në *Pjesën shtuese Nr. 1.*

Kufitë e mbrëndëshme të zonës kufizore jugosllave janë caktuar në *Pjesën shtuese Nr. 2.*

Sektorët, viset, rrugët, viset kalimi dhe tregjet janë caktuar në *Pjesën Shtuese Nr. 3.*

Këto Pjesë Shtuëse janë pjesë të plottë të këtij Protokolli.

Pika Nr. 63 — Pjesë pa zona. — Tue marrë para sysh se qarku kufizor në verij të Dibrës nga piramidha Nr. 12 (Deli Selenica) e deri në piramidhën Nr. 22 (Kalabak), si dhe qarku kufizor në veri-perëndim të Jakovës, nga piramidha Nr. 2 (Maja e zezë) e deri në piramidhën Nr. 23 (Qafa e Vranicës), janë vise malësore, të gjâna, fare pak të popullueme dhe po thuej se të pa kalueshme, âsht e marrë vesht që të mos krjiohen, hë-për-hë, zona kufizore. Me gjith këtë, tue marrë parasysh se mund që disa banorë të këtyre dy qarqëve të zotërojnë kullota përtej kufinit, u pranua që t'autorizohen autoritetet e vëndit, administrative dhe doganore, e të dy Palëve Kontraktuese, t'u caktojnë, në u paraqitë rasti, rrugët dhe viset kalimi me anën e të cilëvet do të mundin këta banorë të çojnë bagëtitë e tyre në kullotat në fjalë. Dhe këjo gjâ me kondite që banimi i këtyre banorëve, si dhe kullotat e tyre përtej kufinit, të mos gjënden ma lark se 15 km. nga kufini. Personave në fjalë do t'u lëshohen Karta-kufini.

Për sa u përket banorëve që kanë banimin e tyre ose kulloten përtej kufinit ma lark se 15 km. prej kufinit, do të mundin të kalojnë kufirin, së bashku me bagëtitë e tyre, vetëm me pasaporta të regullshme.

Pika Nr. 64 — Qeveritë e të dy Palëve Kontraktuëse rezervojnë të drejtën të ndryshojnë, në marëveshje të përbashkëtë dhe mbas eksperiencës që do të kenë fituar, vijën e kufivet të mbrëndshme të dy zonavet, si dhe sektorët, viset, rrugët, viset e kalimit dhe tregjet e shënuem në Pjesët Shtuëse të nalt-përmenduna. Kjo marrëveshje do të bâhet, si mbas rastit, me anë komisioni ose me rrugën diplomatike dhe do tu komunikohet autoritetëve të vëndit për t'u zbatuar.

Pika Nr. 65 — Zotërimi i çdo lloji kartash ose lejësh Kalimi parashëkueme prej Aneksës C dhe prej këtij Protokolli autorizon qarkullimin vetëm mbrënda sektorit për në vënd dhe me anën e rrugëve dhe visëve kalimi për të cilat karta ose leja ka qenë lëshuar, përveç rastëve të veçantë të përmendun në këtë Protokoll.

VIII. RESTRIKSIONET DHE SUPRIMIMI I TRAFIKUT TË KUFINIT

Ad Neni 15 i Aneksës C.

Pika Nr. 66 — Të dy Palët Kontraktuese rezervojnë të drejtën të anullojnë vizën e dhânë në çdo lloj Kartash si dhe në lejëtkalimi kur asht fjala për ndonjë person sjellja e të cilët duket të jetë e dyshimtë ose e paudhë. Në një rast të tillë, autoritetet e të dy Palëve Kontraktuëse janë të detyrueme të informojnë njëra tjetrën dhe të tërheqin Kartën ose Lejen në fajlë.

Ad Neni 16 i Aneksës C.

(As ndonjë vërejtje)

IX. KONFLIKTET DHE MËNYRAT E NDJEKJEVE

Ad Neni 17 i Aneksës C.

Pika Nr. 67 — Kur qarja kundër një nënëpunësi të vogël të Shtetit ose të Komunës, e bërë prej banorit të zonës kufizore të Palës tjetër të Naltë Kontraktuëse té superiori hierarqik i të parit, nuk meret para sysh prej këtij të fundit, ky banor mund të informojë drejt për së drejti Nën-prefektin ose Prefektin e Shtetit të nëpunësit në fjalë me qëllim që ky i fundit të bajë shka duhet për t'i dhanë me një herë vazhdim qarjes· Këjo ndjekje te Prefekti ose Nënprefekti nuk e ndalon t'interesuemin nga e drejta që ka të informojë qeverinë e vet.

X. NDRYSHIMET E ANEKSËS C DHE TË KËTIJ PROTOKOLLI, SI DHE AFATET E TYRE

Ad Neni 18 i Aneksës C.

Pika Nr. 68 — (Shifni Pikat Nr. 3, paragrafi i fundit Nr. 7. paragrafi i fundit, Nr. 10 e Nr. 64 të këtij Protokolli).

Pika Nr. 69 — Mbasi u plotësua Aneksa C e Traktatit të Tregëtis e të Lundrimit me një Akord Plotësuer q'i takon trafikut të kufinit *për tregun e Shkodrës*, i nënshkruar në Belgrad më 5 Maj 1934, dispozitat përkatëse u pranuan me kupëtim të bashkët midis përfaqësuesve të dy Qeverinave që firmuan ketë Protokoll dhe u shenuan në *Pjesën Plotësuese Nr. 6*, që formon trup me ketë Protokoll.

Ad Neni 19 i Aneksës C.

(As një vërejtje)

Ky Protokoll, për të hyrë në fuqi, duhet mâ parë t'aprovohet

prej të dy Qeverivet. Aprovimi do të konstatohet me anën e një shkëmbimi notash që do të bâhet në Tiranë.

Protokolli ka për të hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë dit mbas këtij shkëmbimi notash.

Me ketë besë, Delegatët e të dy Palëve të Nalta Kontraktuëse e nënëshkruan ketë Protokoll dhe e vulosën me vulat e tyre.

Bërë në Belgrad, në dy origjinale, frëngjisht, më 8 Maj 1934.

Për Mbretninë Jugosllave	Për Mbretninë Shqiptare
Bolidar Pouritch	*R. Fico*
Dr. J. Saubbotitch	*D. Beratti*

PJESË E SHTUEME Nr. 1.

KUFITË E MBRENDËSHME TË ZONËS SHQIPTARE

Referohuni hartës shqiptare prej 1:200.000, të gatitur në bazë të marrjes së planëve të bâme gjatë luftës prej Austriakëve dhe të marrjes së planëve të bâme me urdhër të Qeverisë Shqipatre prej Dr. Herbert Louis

Kufia e mbrëndëshme e zonës kufizore Shqiptare është caktuar prej vijës që pason:

Tue filluar prej cakut Nr. F-20, mbi buzën e liqenit të Prespës, në krye vazhdon buzën e liqenit deri në lindje të Kotës 1100, dhe mbasandaj kthehet në lindje me anën e Kotave 1100-2262 1088-969-1292 tue lânë jashtë zonës katundet Alarup, Çarava, Leshnicë, Stropckë dhe Bragojde.

Që prej kotës 1292 drejtohet në veri me anën e kotave 1340-1485 mbi majën e malit të Mokrës. Mbasandaj vija ndjek, në drejtim veri-perendim, lumin e vogël që ka burimin e vetë në malin e Mokrës deri në grykën e tij në veri-perëndim të katundit Radokal, tue lënë jashtë zonës katundet: Potgojan, Malinë, Kriçkovë, Selca e poshtme. Mbasandaj shkon nga tokat 720-758 në Perëndim të Katundit Pishkash mbi Gurin e Pishkashit (1376) tue lânë jashtë zonës Katundet Monastreci e Mokrës, Rashtanë, vazhdon tue kaluar nga Korça 643, në fushën e Bushtricës, Mali i Shebenikut (2180), Kota 2010 — Mali Letmit-Studnë-Koçuli-Kota 1205, tue lânë jashtë zonës Katundet Zabzun e Selbishte. Mbasandaj shkon nga Mali i Ravnogorit (1187) — Kota 925 drejtohet në veri-perëndim, shkon nga kota 605, dhe mb'anën jugë-perëndim të katundit Strikshan deri te Kota 485 (në veri të këtij katundi), tue lânë jashtë

zonës katundet Kosovec dhe Libolesh. Mbasandaj drejtohet në veri për t'arrijtun Drinin e zi (bryllin në veri të katundit Okshatina), tue lânë jashtë zonës katundet Sopot, Soferçan, Kovaçisht dhe Topjan. Mbasandaj ndjek Drinin e Zi deri në bryllin në jugë të katundit Dovlan, Kalon Kotën 630 — bornën Nr. 10 të vijës kufizore (në jugë të Velivanit 2374), tue lânë jashtë zonës katundet Maxhice, Dovlan dhe Erebarë

Qysh prej bornës Nr. E 10 deri në bornën Nr. D. 22 mbi Kalabakun (2172) vija ndjek vijën kufizore të Shtetit, tue lânë jashtë zonës gjithë katundet që ndodhen në perëndim të saj

Prej bornës Nr. 22 vija shkon nga vija e kurrizit të degës perëndimore të Kalabakut (Kota 2174) arrin anën e veriut të katundit Matragje, i cili mbetet jashtë zonës, pret Kotat 1980-2100, vazhdon drejt në jugë me anën e fushës së lumit të vogël deri në grykën në lindje të katundit Radomir, shkon mbasandaj në jugë të këtij fshati, kthen në drejtim të perëndimit me anën e fushës së lumit të vogël pa emër deri te ura, kotë 655, mbasandaj në perëndim të katundëve Cerë, Ploshtan dhe Vasiaj mbi Kotën 1390, tue lënë jashtë zonës Katundet Velshë, Xhendaj, Bushtricë dhe Gjedaj.

Mbasandaj bashkon, nga maja e Tejas dhe nga kota 2305, majën e Xhalicës së Lumës (Kota 2484) tue lânë jashtë zonës katundet Lusen, Koleshan, Bicaj dhe Nangë.

Prej Xhalicës së Lumës vija shkon nga Kota 376 (në perëndim të Katundit Shtiqen), vete në veri-perëndim, arrin buzën e këtij lumi deri në vëndin e bashkimit me Drinin e Bardhë, mbasandaj shkon nga Shakall' e Mundeksit (1170 — Kotën 543 deri në Mj. e Plashit, 1040), tue lânë katundet Mundek, Sefoe, Zaharisht e Prole jashtë zonës.

Mbasandaj shkon nga kotat 466 (në jugë të katundit Zogaj) — Kota 848, ana e jugës e klundit Bityç mbi Dober dhe Bitysit (1729), tue lânë jashtë zonës katundet Kam e Çoraj, shkon atëherë nga Q. e Luxhës (956) — Mj. e Riadës (1269) — Kodra e Luxhës (1234), kota 743, tue lânë katundet Luxhë dhe Roganë jashtë zonës.

Prej Kotës 743 vija drejtohet në veri deri në grykën e Lumit të Tropojës në jugë të Katundit Ahmetaj — ndjek ketë lumë në veri deri te vija, në jugë të shtëpive çobane Stan' i Grudës Tropojës për të arrijtur kufirin në bornën Nr. 2 lark 1,5 km. nga veriu i kotës 1930, tue lânë katundin Tropojë mbrenda zonës dhe katundet Ahmetaj, Babinë, Kërvicë, dhe Mohaçan jashtë zonës.

Që prej bornës Nr. 2 deri në bornën Nr. 23 (Qafa e Vranicës),

vija ndjek kufirin e Shtetit, tue lânë jashtë zonës gjithë katundet që gjënden në perëndim të saj dhe mbrenda zonës bornën Nr. 23 si dhe Qafën e Vranicës.

Prej bornës Nr. 23 vija kalon nga majat Q. e Markofçës (2040) Mj. e Rupës — ndjek vijën e kurizit në drejtimin jugë, masandaj jugë-lindje dhe, për të përfshirë mbrënda zonës katundin Valbonë që nuk figuron mbi hartën Shqiptare, pershkon fushën e Valbonës në perëndim të Katundit Shoshan — kthehet në perëndim nga maja deri te Mj. e hekurave (Mj. e Marocës - 2600), tue përfshirë mbrënda zonës vetëm Katundet Serem dhe Valbonë. Për sa u përket katundëve të tjerë që gjënden afër këtyre dy katundëve dhe të perfshirë po ashtu prej vijës kufizore të zonës shqiptare q'asht hequn që më parë mbi hartën por banuesit e të cilëve s'kanë bërë as ndonjë reklamim deri tani që të përfshihen mbrënda zonës, këta katunde duhet të konsiderohen si vise jashtë zonës. Me gjith këtë, në rast nevoje, banuësit e tyre mund t'i drejtohen Qeverisë Shqiptare në Konformitet me dispozitën IV ad nenit 14 të këtij Protokolli. Mbasandaj ,vija kalon nga Q. e Drovës (2110) - Mj. e Brezës - M. Jezercës (2580) - Q. e Pejës (1709) përfshime — Mj. e Pejës (2215) — Mj. e Radohinës (2460) — Kota 2300 — Mj. i Ligut Kualit (2221) — Mj. Kolace (1842) — M. e Kregës (1009) — Kota 1082 deri në Kurilë (1850) tue lânë katundin Ducaj jashtë zonës.

Nga Kurila (1850) vija drejtohet në jugë-perëndim mbi M. Lobçe (575), dhe mbasandaj në lindje deri në lumin e vogël Rioli — kalon katundın Grixhe në veri-lindje dhe zbret në fushën e Kirit në vëndin e bashkimit me një degë të lumit në veri-perëndim të katundit Drishte, tue lânë jashtë zonës katundet Lohja, Prelnikaj, Veiipa, Kuzë, Udzukaj, Egiç Vajush, Dugë, Kurtë, Blıshtë, Domni dhe Drishte.

Q'andej, vija kalon nga kota 79 (në jugë të Katundit Bardhaj) — Kryqi i kotuar 18 — kota 166 (në jugë të Shkodrës) deri në Mj. Zefnjanës (241), tue lânë katundet Renc, Gur' i Zi, Vukatan, Beltojë, Ashtë, Melgush jashtë zonës.

Nga Mj. Zefnjanës (241) vija pret kotat 105 - 133 - 7 (afër katundit Mebi Suk) dhe përfundon në grykën e Bunës, tue lânë jashtë zonës katundet Bushat, Ranzë, Kulladji, Gjanat, Mebi, Suk, Jushit, Çeret e Zef.

PJESA E SHTUEME Nr. 2.

KUFIT E MBRENDËSHME TË ZONËS JUGOSLLAVE

Referohuni hartës jugosllave prej 1:100.000 Resnjë-Krushovë, Ohri, Dibrë, Prizren, Pejë, Kolashin, Shkodër, Cetinjë.

Vija tue u nisun prej cakut Nr. F. 20 në buzën e gjolit të Prespës, në veri të kotës 1127, ndjek në fillim buzën e gjolit deri në 1 km. në veri-lindje të Sirçi-Hanit dhe kthehet në veri-lindje dhe mbasandaj në lindje dhe në veri të katundit Pokervenik deri në Picilinë (1421), tue lânë jashtë zonës katundin Preliublje.

Nga Picilina drejtohet në jugë-perëndim mbi Tumbën (1627), kalon nga Voda K. (1675), — vija e Kurizit — Kota 1420 deri në cakun Nr. F 12 (2075). Prej andej, kalon nga kotat 1553 — 1931 — 1421 — Visok K — Crnovo deri në ndamjen në lindje të stasjonit të Ohrisë, tue lânë jashtë zonës katundet Olshani, Konsko e Shipokno.

Mbasandaj kaperxen në veri vijën e hekurt deri në vëndin e bashkimit me lumin Koceljska të cilën e ndjek deri në grykën e saj në gjolin e Ohrisë, tue lânë katundet Kocelj dhe Orman jashtë zonës. Prej këtij vëndi vija ndjek në fillim anën veriore të liqenit të Ohrisë deri më 2 km. në lindje të Strugës, drejtohet mbasandaj në verij perëndim dhe arrin Drinin e Zi në lindje të katundit Vranisht, tue lânë jashtë zonës katundin Misleçervo.

Atëherë vija ndjek ketë lumë në veri deri në perëndim të kotës 593 (mbi anën e djathtë të Drinit) dhe 1 km. lark në jugëperëndim të katundit: të Z. Papradnikut. S'andejmi shkon në lindje nga kota 593 deri në veri të katundit Mah Vapa që mbetet jashtë zonës.

Mbasandaj shkon në drejtimin veri-perëndim në lindje të katundëve të V. dhe M. Papradnikut dhe bashkon lumin Radika 1 km. lark nga veriu i grykës së saj në Drinin e Zi, tue lânë katundet Provaljenik, Jitinjiani dhe Balanci jashtë zonës.

Prej këtij vëndi ndjek lumin Radika së prapi deri më 2 km. lark grykës së saj në Drin, q'andej drejtohet në veri drejt për së drejti deri më 1 km. në jugë të Dibrës dhe mbasandaj në drejtimin e përgjithëshëm veri-lindje shkon mb'anë të katundëve Rajçiça dhe Tatar Elevci që mbeten jashtë zonës, pret kotën 733 për të arritjun Radikan në jugë të katundit Kosovrasht.

S'andejmi, vija ndjek Radikan dhe, dyke prerë kotat 795 — 1925, arrin te vija kufizore e Shtetit në cakun Nr. 12 mbi majën e Deli Senicës (2255).

Që andej, ndjek me anën e kreshtës të Deshatit e të Korabit vijën kufizore të Shtetit deri në cakun Nr. 18 mbi malin Terasisko bredo (Jasika), tue lânë jashtë zonës gjithë katundet që gjënden në lindje të Kufinit.

Prej cakut Nr. 18 mbi malin Terasisko bredo, vija drejtohet mâ parë në veri-lindje, mbasandaj në veri tue kaluar prej kotave 1246, 961, 938 (në veri-lindje të katundit Vranishtë) ndjek në lindje rugën automobilash Vranishtë-Prizren, tue lanë jashtë zonës katundet Mlike, Kukoljane, Lebovishte, Shajnovec, Rence, Zjume dhe Leskovac. Atëherë vija shkon në lindje dhe mbasandaj drejtohet në perëndim me anën e kotave 356 (në veri-lindje të katundit Vlanja) — 487 — 443 — 549 — 445 ku arrin Drinin e Bardhë, tue lanë katundet të Dobrushtës mbrënda zonës — ndjek Drinin deri në Delina — shkon 1 km. lark veri-lindjes të kotës 645 dhe arrin në vijën kufizore të Shtetit afër cakut Nr. 6 (752) tue lanë katundet e Malijes jashtë zonës.

Prej cakut Nr. 6 vija ndjek kufirin e Shtetit deri në Pashtrik (1983), dhe shkon mbasandaj nga kotat 1796 — Lugi Borce (1402) — 1220 deri te kota 842.

Prej andej, bashkon në drejtim të lindjes lumin e vogël Doshtzica të cilën e ndjek deri në bryllin në lindje të katundit Kushin, kthenet mabsandaj në veri dhe përfundon, me anën e kotës 387, në një vënd në veri lindje të katundit Uiz, tue lanë katundet Kabash, Dedaj dhe Murosh jashtë zonës.

Nga katundi Uiz vija drejtohet në jugë-perëndim me kotat 434 — 477 (në veri të katundit Lupoveca) — 565 (në veri të katundit Zulfaj); mbasandaj, në veri deri në vëndin e bashkimit të lumenjvet, 1 km. lark nga veriu i katundit Jupë — ndjek lumin Bogovicë deri në vëndin e bashkimit të tij me Drinin e Bardhë. Mbasandaj shkon në jugë-lindje midis katundëve Moglicë dhe Raçe, dhe, tue bërë një kurbë rotull këtij katundi, arrin në drejtimin veri-perëndim të lumit Erenik në vendin e bashkimit me Trakaniçën, kapërxen këtë lumë, rethon qytetin Jakovë në lindje, veri e perëndim dhe bashkon kotën 436, në perëndim të Jakovës, tue lanë jashtë zonës katundet Fshaj, Smaç, Kushavec, Çurdinos, Firza, Moglicë, Kosara, Zide, Salih - Age, Qerime dhe Osek Pasha.

Prej kotës 436, vija drejtohet nga ana e perndimit në veri të rugës automobilash Gjakovë - Korenicë, arrin lumin Ribnik (Erenik) te ura në lindje të katundit Popovac dhe ndjek lumin Ribnik (Erenik) deri në lindje të katundit Nonoshvac. Atje kapërcen këtë

lumë dhe kalon nga Planiku (536), kota 501 (në perëndim të katundit Bravinë) — 689 — në lindje dhe në veri të katundit Bashusha ku kthehet nga ana e veri-perëndimit për të arrijtur me anën e kotave 732 - 1695 kufirin e Shtetit te caku Nr. 2 mbi majën e M. Zez (1917).

Prej andej, ndjek vijën-kufizore të Shtetit deri te Qafa e Vranicës (caku Nr. 23 i përjashtuar), dhe drejtohet mbasandaj në veri nga kotat 1202 - 1924 - 1485 për të arijtur kotën 1826 (Kopiliaça në veri të katundit Hoti). Prej andej, kthehet në perëndim me kotat 1540 - 1130 tue lanë katundin Xhuriçka Reka mbrënda zonës. Mbasandaj drejtohet nga ana e jugë-perëndimit nga maja e Karaulas (1658), kotat 2060 - 1470 - 1720, kalon në perndim të katundeve Kolenaviçe, Dasuxhe e Zagraxhe dhe në lindje të qytetit Gusinjë, tue lënë jashtë zonës katundet Gogajçe, Vojno Selo, Budejovica, Vishnievo, Krushovë, Kolenoviçe, Dosuxhe dhe Zagraxhe.

Mbasandaj, vija kthehet nga ana e veri-lindjes me kotën 1945 lark 1 km. në veri të kotës 2210 (mbi Vizitorin Pl.) — Mramorie (2015), mbasandej në perëndim deri te kota 1862, ndjek majën (1 km. në veri të Grebënit 2190), pret kotën 1906 — Tatarien (1764) — Rogovin (2125), kotën 2033 dhe, arrin nga maja e Zeletinës kotën 1261, tue lenë jashtë zonës katundet Martinoviç, Gropa, Smajleva dhe Brezovicë.

Prej kotës 1261 shkon midis katundëve Bojnoviçe dhe Grabovice nga majat e malit Lokoviçko (1271) — Veli Krch-it (1443). ndjek majën e Pehes dhe përfundon me anën e Kotës 1628 dhe majën e Cmilicës (1829) mbi majën e Kom Vasojeviçakit (2460), tue lënë jashtë zonës katundet Bojoviçe, Andjelate, Bojiçe, Vietroshevice dhe Oblo berdo.

Prej Kom. Vasoijeviçskit vija shkon nga kotat 1442 - 1360 dhe arin te kufini i Shtetit në Maja e Zabelit (2130), tue lanë jashtë zonës viset Katun. Carine, Luke dhe Bindja.

Prej Majës Zabelit, ndjek vijën kufizore të Shtetit deri në Suka e Milcitës (1432) tue kaluar qafën e Shkalës Rikavec dhe Greçës.

Atëherë vija shkon nga kotat 1399 - 1650, Kajenik (1586) - 1141 - 1027 - Xhuteza (1130) — M. Sievik (1149), tue lanë jashtë zonës katundet Korita, Pograd, Koçi dhe Katun. Radovac.

Mbasandaj vija pret kotat 1212 (Suka Grudska) - 971 - 629, për të arritjur te maja e Tsrnit Vrh (312), tue lanë jashtë zonës katundet Lopar dhe Permiçi.

Prej majës së Tsrnit zbret te brylli i Cievnas (Cem) në jugë-

perëndim të katudnit Dinoshë, ndjek këtë lumë deri te ura e kotuar 62, tue kaluar prej Shipçanskas G. (136 në veri të katundit Tuzi) dhe arrin te kota 76 (në jugë të Dushicës), tue lanë jashtë zonës katundet Shipçanik dhe Dushiç.

Prej kotës 76 vija kthehet nga ana e perëndimit, kalon në veri të katundit Vladnia, mbasandaj në jugë të Sv. Nikolas, më në fund në veri të katundit Mojanoviçi dhe, tue kapërcyer vijën e hekurt te Posti i Gjindarmerisë, arrin lumin Moraça në veri të katundit Goriçan, tue lanë jashtë zonës katundin Mahalë. Prej këtij vëndi ndjek Moraçan deri te katundi i vogël Acové Vrbé; që andej, shkon midis katundëve Bistricë dhe Berislavicë që mbetet mbrënda zonës, dhe kthethet mbasandaj nga ana e perëndimit deri te vija Tara, kalon anët perëndim dhe jugë të katundit Kurila për të arijtur nga kota 5 liqenin e Shkodrës 500 m. lark nga perëndimi i grykës së Plavnicës tue lanë jashtë zonës katundet G. dhe D. Vukovcit, Kuriocit dhe Bistricës.

Prej andej, kapërcen në vijë të drejtë liqenin e Shkodrës, arrin hundën Petrova Ponta dhe ndjek buzën e liqenit deri më 1 km. në jugë-lindjen të katundit të vogël Markoviçi, i cili së bashku me katundin Krnjice mbetet jashtë zonës. Prej këtij vëndi kthehet nga ana e perëndimit dhe arin, nga maja e Dobrunës (495), majën e Golikut (997). Masandaj mer drejtimin e pergjithëshëm të jugë-lindjes, tue kaluar prej majëve të Kunjit (872), Ostrovicës (992), Kunorës (1018), Bijela Skalës (978), Çugagolinës (1325), Rumijës (1593), Brisanit (1434) — prej kotës 1424 deri te Mali i Canit (1256), tue lanë jashtë zonës katundet Pepiçi, Tuxhemili, M. Mikuliçi, G. D. e V. Mikuliçi, Kabeta dhe Mexhureç. Prej majës së Malit Can vija vazhdon të shkojë në drejtim të jugës, prej majëve të Liponiakut (1228), Rastiçit (793), Vranië Gnezdos (634), Çok Pelinkoviçit (308), Narbunges (293), kotës (261), Kobilicës (622), kotës 160 M. Kruçishës (378), Mavrianit (386) Biela Goras (289), kotës 164, dhe arrin në drejtim të jugës, në vijë të drejtë, buzën e detit Adriatik të cilën e ndjek deri te vija kufizore e Shtetit (në gryka e Bunës), tue lânë jashtë zonës katundet Mali Kaliman, Leskovac, Vukiçi, Mala, Mala Gorana, Salç dhe Kruta.

PJESA E SHTUEME Nr. 3

SEKTORË, VISE, RRUGË, VENDE KALIMI, DHE TREGJE

Dyke marë në konsiderim pozitën gjeografike si dhe natyrën e tokës dhe më tepër nevojat dhe tërheqjet ekonomike të qarqëve

të ndryshmë të kufinit, të dy Delegacionet kanë ardhur në marrëveshje që të ndajnë tërë zonën kufizore në sektorë kështu si vijon:

1. — Sektori i Prèspes

Ky sektor përfshin:

A. V i s e t:

a) në zonën jugosllave:

Konsko, Stenjë, Leskovec, Oteshevo, Sirçi Han, Shurlinci, Vukoderi dhe Prokrvenik.

b) në zonën Shqiptare:

Bezmishtin, Goricën, Gllomboçin, Goricën e Sipërme.

B. T r e g j e t:

Resnjë, në Jugosllavi.

C. R u g ë t dh e v i s e t k a l i m i:

Ruga Stenje — Goricë — Sirçi Han me vënd-kalimi afër rojave kufizore të të dy Shtetëvet, për çdo lloj qarkullimi të pranuar.

2) Sektori i Ohrisë - Pogradecit

Ky sektor përfshinë:

A V i s e t:

a) në zonën jugosllave:

Manastiri i Shën-Naumit, Lubanishta, Trepezica, Gorica, Shën Stefani, Shen Naumi, Peçani dhe qyteti i Ohrisë.

b) në zonën Shqiptare: Peshkopinë, Zagorçanin, Starovën, Tushemishtin, Zervaskën, Remenin, Verdovën, Pogradecin, Memlishtën, Çervenakun, Hudenishtin.

B. T r e g j e t:

Manastiri i Shën-Naumit dhe qyteti i Ohrisë në Jugosllavi.

C. R u g e t d h e v i s e t k a l i m i:

a) Ruga Lubanishtë Peshkopi me vend kalimi afër cakut Nr. 7, vetëm për pronarët pertej kufinit.

b) ruga nga Ohria - Peshtani - Lubanishta - Manastir' i Shen Naumit për në Tushëmisht me vend-kalimi afer cakut Nr. 1 pranë liqenit dhe rojave kufizore të të dy Shtetëvet, për çdo lloj qarkullimi të pranuem.

c) me anë vaporësh të çdo lloji mbi liqenin e Ohrisë për çdo lloj qarkullimi të pranuem.

BQSH

Për sa u përket *vaporëve* të çdo lloji *që qarkullojnë mbi liqenin*, mund t'u afrohen vetëm visëve të caktueme për debarkimin dhe imbarkimin, në viset qi vijojnë: Ohria, Peçani, Shën Naumi, Struga, Pogradeci dhe Lini.

3) Sektori i Strugës — Qafës së Thanës

Ky sektor përfshinë:

A. V i s e t:

a) në zonën jugosllave: qytetin e Strugës, katundet Radojda, Mali Vlaj, Frrnugovo, Kalishte, Radolishte, G. dhe D. Zagraçan, Vishnjë, Vranishtë, D. Belica, G. Belica, Oktisi, Veleshtë, Vehçane, Dodovjani, Podgoraci, Lbunishtë, Borovec, Piskupshtina, Lakavica, Jablanica, Bezevo dhe Nerezi;

b) në zonën Shqiptare: Homeshin, Radokalin, Peshkupatin, Linin, Uraken, Kododeshin, Kaqelin,, Prenjësin, Pishkashin, Likinin, Rajcën, Çarishtën.

B. T r e g j e t: qytetin e Strugës në Jugosllavi.

C. R u g ë t d h e v i s e t k a l i m i:

a) ruga Radojda - Lin, afër liqenit, me vënd kalimi afër cakut Nr. 449, vetem për pronarët pertej kufinit për çdo lloj qarkullimi të pranuëm;

b) ruga Strugë - Mali Vlaj - Qafa e Thanës me vend kalimi afër cakut Nr. 44, për çdo lloj qarkullimi të pranuem;

c) ruga Mali Vlaj-Rajcë me vënd kalimi midis caqëve Nr. 42 e 43, afër rojave kufizore të të dy Shteteve, vetëm për pronarët pertej kufinit;

d) ruga Strugë - G. Belicë - Carishtë me vënd kalimi afër cakut Nr. 34, për çdo lloj qarkullimi të pranuëm; dhe

e) me anë vaporësh mbi liqenin për çdo lloj qarkullimi të pranuem.

4) Sektori i Dibrës

Ky sektor përfshinë:

A. V i s e t:

a) në zonën jugosllave: G. dhe D. Lukova Modriçi, Drenoku, Xhepiçi, Otishani, M. e V. Papradniku, Egleniku, Mireshi, Banova, Konareja, qytet' i Dibrës, Selokuçi, Krivci, G. e D. Kosovrasti Spasi, Améja, Bani e Shteja dhe Reshani;

b) në zonën shqiptare: Stebleva. Borava, Kleni, Xhinaveci, Trebishta, Ostren' i Vogël, Ostren' i Madh, Verbenica, Rado-

BKSH

veshi, Vladimirica, Serpetova, Velcishta, Strikçani, Çeraneci Gorica, Çapënzi, Buçeva, Homeshi, Okshatina, Blat' e sipërme, Alaj Begaj, Majtareja, Klobuçishti, Kerçisti, Pocesti, Hoboku, Pesiaku, Çanka, Vojniku, Maqelari, Popinava, Herbeli, Pasinegi, Zabori, Mireshi, Golovishti, Terbaçi, Tuçepi, Reshani, Blat' e poshtme, Cermeneja, Gradjani.

B. T r e g j e t : qyteti i Dibrës në Jugosllavi.

C. R u g ë t d h e v i s e t k a l i m i :

a) ruga me anën e fushës së Çevenicës për në Trebishtë me vënd kalimi afër cakut Nr. 23 ku gjenden rojat kufizore të të dy Shtetëve, për çdo lloj qarkullimi të pranuem;

b) ruga Holishani-Tuçep me vënd kalimi afër cakut Nr. 19, vetëm për pronarët përtej kufinit;

c) ruga Dibër-Shpinia-Miresh me vënd kalimi nga ura, në lindjen e katundit Miresh, dhe 1 km. larg jugës së cakut Nr. 17, për çdo lloj qarkullimi të pranuem;

d) ruga prej Reshanit jugoslav në Reshanin shqipëtar me vënd kalimi afër cakut Nr. 16 vetëm për pronarët përtej kufinit;

e) ruga Dibër-Blat' e sipërme me vend kalimi afër cakut Nr. 15, për çdo lloj qarkullimi të pranuëm; dhe

f) ruga Dibër-Kolbuçishte me vënd kalimi afër cakut Nr. 14, vetëm për pronarët përtej kufinit.

5) *Sektori i Prizrenit — Kukësit*

Ky sektor përfshinë:

A. V i s e t :

a) në zonën jugosllave: Globoçicën, Orçushan, Vranishtin, V. e M. Krëstacin, G. e D. Rapçën, Plavën, Buçën, Bresan, Lopushkihanin, Zhurin, Verbnicën, Shkozën, Biliushën, Gorozhupën, Dobrushtën, Poslishten, Oça, Zagradshkën, Vlashnien, Kushninin dhe qytetin e Prizrenit;

b) në zonën shqiptare: Radormirin, Çeren, Shulanin, Ploshtanin, Vasajajin, Çajin, Sheçinakun, Fshatin, Buzmasin, Shtrezën, Topojanin, Shishtevecin, Novo Selon, Borien, Orgostën, Shtiçën, Gostilen, Kukësin, Podbregun, Xhahen, Ademin, Borzocen, Morinuën, Domnin, Xhinajin, Shalçinin, Pogajin, Gorozhupin, Leshin, Çemin, Kishajin, Mujin, Dacin, Aurulen, Davkën, Nifçen, Brekinijan, Kolovazin, Loiman, Oreshkën, Belan, Orshiklen, Çernolevon, Zabadën, Pakishin, Kosharishtin.

B. T r e g j e t : Pizreni dhe Vranishti në Jugosllavi.

C. R u g ë t d h e v i s e t k a l i m i :

a) ruga Prizren-Vranisht-Globoçiça-Borie, me vend kalimi afër cakut Nr. 17, për çdo lloj qarkulimi të pranuem;

b) ruga Krësiac-Kosharisht, me vend kalimi afër cakut Nr. 15, vetëm për pronarët përtej kufinit;

c) ruga Prizren-Zhur-Kukës, me vend kalimi afër cakut Nr. 10, për çdo lloj qarkullimi të pranuem; dhe

d) ruga Gorozhupë jugosllave-Gorozhupë shqiptare, me vend kalimi në jugë të cakut Nr. 7, vetëm për pronarët përtej kufinit.

6) Sektori i Jakovës — Tropojës

Ky sektor përfshinë:

A. V i s e t :

a) në zonën jugosllave: Kushninën, Godenin, Gerçinën, Zulfajin, Lupovicin, Uizen, Çeratin, Devan, Zhupën, Vogovën, Babajboksiu, Guskën, Brekocin, Raçën, Shishman Boksin, Korenicën, qytetin e Jakovës, Popovacin, Shishman Ravnin, Morinën, Nonoshevacin, Kosharishin, Batushën, Kamenicën dhe Damianin.

b) në zonën Shqiptare: Mah e epërmen, Rafshën, Krumën, Vranishtin, Pekën, Vlahenën, Nikolicën, Golajin, Lushin, Çarin, Dobrunën, Zulfajin, Perolin, Zogajin, Mjekëren e Bardhë, Mahallën e epërme, Zogajin, Kapenekun, Lejsisin, Letajin, Stoberdën, Biticin, Vliadin, Mejdanin, Visidolin, Tropojën, Koçajin, Koldatën, Kamenicën, Lushajin, Pacin, Jerkun, Sigicin, Rezxhexhën, Padeshin dhe Çerën.

B. T r e g j e t : qyteti i Jakovës në Jugosllavi.

C. R u g ë t d h e v i s e t k a l i m i :

a) ruga Kushninë-Qafa e Mularecit-Vlania, me vënd kalimi afër cakut Nr. 4 vetëm për pronarët përtej kufinit;

b) ruga Godeni-Qafa e Dobrunës-Dobrunës, me vënd kalimi afër cakut Nr. 1, vetëm për pronarët përtej kufinit;

c) ruga Jakovë-Zhupë-Qafa e Prushit-Letaj me vënd kalimi afër cakut Nr. 14, për çdo lloj qarkulimi të pranuëm;

d) ruga Zherk-Qafa e Stobercës-Çerapi me vënd kalimi afër cakut Nr. 10, vetëm për pronarët përtej kufinit;

e) ruga Jakovë-Korenicë-Nonoshevac-Qafa e Morinës-Tropojë, me vënd kalimi afër cakut Nr. 5, për çdo lloj qarkulilmi të pranuëm; dhe

f) ruga Kosharish-Qafa e Glavës-Padesh me vënd kalimi afër cakut Nr. 3, vetëm për pronarët përtej kufinit.

7) Sektori i Gusinjes — Vermoshit

Ky sektor përfshinë:

A. V i s e t:

a) në zonën jugosllave: Qafa e Vranicës, Zabeli, Hoti, Xhuriçka Reka, M. Sapicës, Beliçi, Zarunica, Maja e Borit, Vusanja, Xhenbaliçi, Tiosoviçi, Gusinja, Lipovica, Grebeni, Visitor pl., Goleshki Katun, Goleshi, Valushnica, Popadia, Xhuroviçi, Gerani, Vezirova Brada, Trojani, Doli, Budaji, Lazi, Grënçari, Grebeni, Kuti, Nënshkamja e Duldoshit, Obzoviku, Cecuneja, Stolaku, Jari, Halieja, Mimiçeja, Çeçeva, Xhuliça, Joshanica, Koniuha, Jasikovaci, Kërnisça, Karishta, Cervliaku, Dulipolia, Brodi, Savrdaku, Koshutiça, Xhonca, Mulinoveci, Orbanica, Lishteni-Krestac, Zastan, Glavica, Krushka, Mojani, Qafa e Gjelit, Buni, Radetina, Bishtina, Zeletina (Vatexhelrudita), Zeletina (Cecuni), Bjeshka e Keçës, Qafa e Boritës, Podkobila (në komunën e Vojno Selos), Bori Zeletini në perëndim të Goleshit, Zeletini në veri të Zagraxhës, Bistraçiça, Vajusha, Vukoçia, Kroja, Bridashia, Jezerca, Ceranici, Katuni.

b) në zonën shqiptare: Valbona (Katundi), Çerema, Nikçi, Berisdoli, Lipushi, Koprishti, Hani i Gropës, Budaci, Buna e Grebenit, Vermoshi, Liesnica, Mreku, Oshrica, Selci, Vukli, Kërnçari, Bishtina, Mojani, Smuti, Rogu, Lumebraja, Cerna Gora, Stoçiça, Hani i Vermoshit, Vani, Selimaji, Dragobija dhe Këlcyra.

B. T r e g j e t : qyteti i Gusinjës në Jugoslavi.

C. R u g ë t d h e v i s e t k a l i m i :

a) ruga Hoti-Qafa e Vranicës-Çeremi me vënd kalimi afër cakut Nr. 23, vetëm për pronarët përtej kufinit;

b) ruga Vusanie-Qafa e Boritës-Çerenë me vënd kalimi afër cakut Nr. 19, vetëm për pronarët përtej kufinit;

c) ruga Gusinjë — nga fusha e Briës — Liqeni Krestac — Qafa e Pejisit me vënd kalimi afër cakut Nr. 16 për çdo lloj qarkullimi të pranuëm.

d) ruga prej Qafës së Predelecit deri në vëndi ku Vajusha ka burimin e saj me vënd kalimi pranë rojës kufizore jugoslave afër kotës 1614, 1 km. në jugë të Mojës së Popadiës, vetëm për pronarët përtej kufinit;

e) ruga prej Qafës së Predelecit deri në vëndin ku Bistrica ka burimin e saj me vënd kalimi Qafën e Gorikulit, vetëm për pronarët përtej kufinit;

f) ruga Gusinjë - Gërnçari - Vietarniku - nga fusha e Elpushit - Qafa e Predelecit me vënd kalimi midis caqëve Nr. 12 e 13 për çdo lloj qarkullimi të pranuem;

g) ruga Ploçina Bishtinë me vënd kalimi afër cakut Nr. 8, vetëm për pronarët përtej kufinit;

h) ruga Xhuliçe - Shtavinë Do - Bishtinë me vënd kalimi afër cakut Nr. 7 vetëm për pronarët përtej kufinit;

i) ruga e Koniuhës, nga fusha e Perushicës - Smutie Rogë, me vënd kalimi nga kota 2114 (në veri të Mojanës) afër rojës kufizore jugoslave, vetëm për pronarët përtej kufinit;

Që nga Maja e Zabelit (caku Nr. 6) deri te Suka e Milcit (caku Nr. 19) nuk ekizston zonë mbi tokën jugosllave. Por për të lehtësuar kalimin e pronarëve të pronave-tokësore dhe të kullotave të komunës së G. D. Kuçit dhe Zatriebaçit, këta lihen të lirë të kalojnë prej këtyre dy kalimëve:

1) Kalimi i quajtur Skala e Rikavacit afër cakut Nr. 1;

2) vëndi i quajtur Greça me vënd kalimi afër cakut Nr. 21.

Këto të dy vënd kalimet mund t'i përdorin edhe banorët të zonës kufizore shqiptare të sektorit Gusinjë-Vermoshit që kanë ose mund të kenë kullota në qarkun jugosllav që gjëndet midis të dy cakëve të nalt-përmendur.

8) Sektori i Tuzit — Hotit

Ky sektor përfshinë:

A. V i s e t:

a) në zonën jugosllave: Budzën, Stiepovën, Popratin, Deljanin, Nikmarashin, Benkanin,, Rudinën, Mujeçkën, Dinoshën, Selishtën, Çemerin, Pikalen, Pirftin, Lofkën, Traboj Starin, Acajin, G. dhe D. Mileshin, Kërshevën, Nabomën, Vuleviçin, Kurecin, Heimicën, Pashkalën, Arzën, Skoraçin, Maçajin, Barlajin, Rudinën, Xhokajin, Spilien, Rolen, Qafën e Prosekut, Vuksan-Lekiçin, Prekalën, Kreinzën, San Martinën, Dreshevicin, Drumën, Bojaj Samoborin, Vitojën, Nenhelnin, Mileshin, Tuzin, Kodrabudën, Jarin, Grabovnicën (mbi buzën veri të liqenit të Shkodrës), Shevën (në jugë të majës Deçiç), Bukovikun, Firkuçën, Sukruçin, Dacajin, dhe Kërshevan;

b) në zonën shqiptare: Kalejin Borjën, Xhevicën, Hanin

e Grabonit, Rahovicën, Kopitën, Kapën e Brojës, Jugomirin, Stafën, Rapshin, Trabojën, Brixhën, Mihajin, Selajin, Narkajin, Kolcegajin, Dakçajin, Bratoshën, Kurtajin, Budishën, Gorajin, Rangsën e Veshit, Skaçën, Moksetën, Kocajin, Ivanajin, Gradecin, Kolajin, Lekoçajin, Lashajin, Flakën, Kosanën, Alljajin, Bardhajin, Bilatursën, Jagodën, Bariajin, Maçke Cemin, Rapshicën, Bukovikun, Kushën, Bumlimesin, Bjeshkazitën, Brushtulin, Pshtiresin, Fushën e Kushës, Vajzën, Vukpolajin, Hanin e Kastratit, Hanin e Hotit dhe Pepuranën.

B. T r e g j e t : Tuzi në Jugosllavi :

C. R u g ë t d h e v i s e t k a l i m i :

a) ruga nga fusha e Cemit me vënd kalimi afër cakut Nr. 14 e 15 për çdo lloj qarkullimi të pranuëm;

b) ruga Traboinë Stari-Brixhë me vënd kalimi afër cakut Nr. 9 vetëm për pronarët pertej kufinit;

c) ruga prej katundit Barlaji jugosllav deri te Barlaji shqiptar me vënd kalimi afër cakut Nr. 6, vetëm për pronarët përtej kufinit;

d) ruga Tuzi-Podhumë-Hani i Hotit me vënd kalimi afër cakut Nr. 11 për çdo lloj qarkullimi të pranuëm;

e) nga liqeni i Shkodrës me të drejtë imbarkimi dhe debarkimi në Sinisinë e Grabovnicës dhe në rethet e katundit Flakë, vetëm për pronarët përtej kufinit.

9) Sektori i Shkodrës — Plavnicës — Ulqinjes

Ky sektor përfshinë :

A. V i s e t :

a) në zonën jugosllave : Mojanoviçin, Goluboviçin, Vladnian, Dubravën, Goriçanin, Balabanin, Mataguzhin, Vranjën, Goshicin, Shushunian, Bielopollen, Kurilën, Berislavcin, Gostilien, Plavnicën, Vuçedabiçin, Marstiepoviçin, Draçevicën, G. e D. Karanikiçin, Dediçin, Xhuravcin, Lukiçin, Barejiçin, Gurazën, Shestanin, G. e D. Muriçin, Repazën, Bapsulën, Becen, Pinçiçin, Livarin, G. e D. Briskën, Blacën, Bobovishtën, Tijanën, Dragoviçin. Runiën, Sierçën, Martishin, Çurianën, Alibrajmoviçin, Ramushen, Kostanjën, M. e V. Ostrocën, Verliçin, D. Curoviçin, Kanaçin, Mashuriçin, Madngushën, Xhenashin, Berjashin' Xhencin, Boleviçin, Rastishën, Midën, Bojkën, Veliji-Kalimanin, Kosiçin, Sumën, Krutën, Sverzigaçen, Brajshën, Vladimirin, Selitën, Pelinkoviçin, Velian, Goranën, G. e D. Kleznën, Shasën, Brivska Gorën, Lish-

niani Mahalën, Kolomzën, Pistulën, Zoganien, Braticën, Darzën, Ulcinjën, G. e D. Shtojën, Demiroviçin, Ljubonoviçin, Ceklën, Popoviçin, Arbaneshin, Kovaçin, Xheçbetrishin, Lekperin, Dodiçin. Shtegvashi Mahalën, Çapre Mahallën, G. e D. Kravarin, Draginnjën, Sukobinën, Bukmirin, Fraskanjelin, Borën, Lisnën, Shtodrën, Reçin, Adën (ishulla), Ambulën, Goricën, Sv. Diorxhën, Çurkën, Zogaisko Blatën, Sv. Nikollan afër Bunës;

b) në zonën shqiptare: Bogën, Veleçikun, Raznën, Brihetin, Vrizin, Berzhetën, Vuçin, Dedajin Shkrelin, Zagorajin, Marshajin, Gradishtën, Pjtroshën, Dragovojin, Koplikun e sipërmë. Mehalin, Lazanën, Bolevarin, Gruan e mirë të çesmës, Podgorën, Lebeçin, Keçarin, Grizhën, Mushterin, Demirajin, Dobren, Gërçarin, Kaldrunin, Sterbicën e sipërme e të poshtme, Lubicën, Kamicën, Bujzanitën, Koplikun e poshtmë, Egerçen, Gjormën, Ketoshën, Grudën, Kru' të mirë, Linajin, Postriben, Vorfën e poshtme e të sipërme, Rashën e Vorfës, Rashën e vogël, Vrakën, Omarin. Grilin, Boriçin, Hamidien, Rashimën, Kodrën e Bokshit, Dragoçin, Mesën, Muselimën, Golemin, qytetin e Shkodrës, Barzajin, Tepen, Kuçin, Shirokun, Zogajin, Babatin, Valoshin, Muriçanin, Zusën, Shetufin, Goricën, Oblikën e cafret dhe të poshtme, Berdicën e mesme të poshtme e të epërme, Kishën e Shirshit, Shirçin, Samrishin, Dajiçin, Samrishin e poshtme, Seregun,, Obotin, Gramshin, Mujanin, Skordulin, Belajin, Rushkullin, Pëntarin, Prekalin, Kroçin, Trushin e poshtme, Trushin e sipërme, Reçin, Malin e Reçit, Luarzën, Bajraktarin, Bregenatën, Kamën e Pushit, Pulajin, Krenashëdolin, Velipojin, Vilgarin, Zoganien, Daragjatin, Sukadajçitin, Kazenan, Dobraçën, Kulin, Veleçikun dhe Leporoshin.

B. T r g j e t : Ultisinja në Jugosllavi.

C. R u g ë t d h e v i s e t k a l i m i :

a) nga liqeni i Shkodrës me të drejtë debarkimi dhe imbarkimi me viset që vijojnë në Jugoslavi, Ckla dhe Plavnica, dhe në Shqipëri: Shkodra, Shiroku dhe Zogaj, për çdo lloj qarkullimi të pranuëm.

VREJTJE : — Pronarët përtej kufini të Omarës që zotërojnë prona tokësore në Komunën e Shestanit, munden edhe ata të përdorin rrugen e liqenit me të drejtë debarkimi dhe imbarkimi në viset më të afërme të pronave tokësore tyre;

b) ruga Ckla-Zogaj me vënd kalimi afër cakut Nr. 9 për çdo lloj qarkullimi të pranuëm;

c) ruga Shtegvash-Vilgari me vënd kalimi afër cakut Nr. 5 vetëm për pronarët përtej kufinit;

d) ruga Kravari-Shtufë me vënd kalimi nga ura që gjëndet në katundin e D. Kravarit, vetëm për pronarët përtej kufinit;

e) ruga Ultsinjë - Kunie - Vukiç - Vladimir - Sukobin - Shkodër me vend kalimi nga ura në lindje të Sukobinës mbi kufinin e Shtetit, për çdo lloj qarkullimi të pranuem;

f) ruga Sukobin - Goricë me vend kalimi nga ura, $1^1/_2$ km. larg nga jugë-lindja e Sukobinës, vetëm për pronarët përtej kufinit.

Ruga me anën e lumit Bunë, vetëm për pronarët përtej kufinit me të drejtë debarkimi dhe imbarkimi në viset që vijojnë:

VREJTJE: Banorët e katundeve jugosllave: Ambula, D. Shtoj, Zoganje dhe Reç që zotërojnë toka me kullota nè Selç dhe në Vermosh, të cilat gjënden në sektorin Gusinjë - Vermosh, janë të autorizuar të çojnë bagëtit' e tyre në viset e përmendur dyke kaluar nga sektori i Shkodrës; banorët e katundit jugosllav D. Shtoj, që zotërojnë toka në Rapshë (shqip: Hoti) do të kenë gjith atë autorizim për të çuar bagëtit' e tyre në viset që gjënden në sektorin Tuzi Hoti.

g) Kalim nga lumi Bunë midis Fraskanjelit dhe Belajt, vetëm për pronarët përtej kufinit;

h) Kalim nga lumi Bunë midis Sv. Xhorxhës dhe Prekalit, vetem për pronarët përtej kufinit;

i) Kalim nga lumi Bunë midis Reçit dhe Luarecit, vetëm për pronarët përtej kufinit;

j) kalim nga lumi Bunë midis P. Nikollës dhe Pulajt, vetëm për pronarët përtej kufinit.

PJESA E SHTUEME Nr. 4

Lista e produkteve prej provenience shqiptare që përfitojnë nga hyrja e lirë dhe nga privilegjet e parashikuar në nenin 2 të Aneksës C, me caktim të sasivet, që mund të importohen në Jugoslavi.

(Shifni pikën Nr. 7 të këtij protokolli)

PJESA E SHTUEME Nr. 5.

Lista e produkteve prej provenience jugosllave që përfitojnë nga hyrja e lirë dhe nga privilegjët të parashëkuar në nenin 3 të Aneksës C, me caktim të sasivet që mund të importohen në Shqipëri.

(Shifni Pikën Nr. 10 të këtij Protokolli)

PJESA E SHTUEME Nr. 6.

Zbatimi i Akordit Plotësuer i Aneksës C, i nënshkruem me 5 Maj 1934, mbi trafikun kufizor q'i përket tregut të Shkodrës.

TRAFIKU KUFIZOR QË I PËRKET TREGUT TË SHKODRËS

§ 1

Banorët e katundeve të zonës kufizore jugosllave të sektorit të Shkodrës - Plavnicë - Ulqinë të njehura ma poshtë munden me shkue ditët e pazarit në Shkodër për të shitë atje prodhimet e tyne dhe, të blejnë aq sa u duhet për nevojat e tyne kryesore.

Katundet janë këto që vijojnë: Cekla, Zjubanovici, Demirovici, Mali i Veliki Ostros, Curjan, Martici, Curovici, Sijerca, Runja, Bobovista, Blaca, Briska, Tijana, Dragovici, Alibrajmovici, Arbnes, Djenasi, Berijasi, Djencici, Djerbici, Lebberi, Kovaci, Dodici, Madgus, Boljevici, Capre-Mahala, Stegvasi-Mahala, Gornji i Dona Kravari, Draginja, Rastis, Brajso, Gorica, Sukobin, Saiita, Vladimir, Gornja i Donja Klezna, Bukmir, Lisna, Bora, stodra, Sas, Ambula, Fraskanjeli, Nisarnirs, Sidenjuca, Ramuvha, Kostapi, Donji Djurarvici, Mazutici, Irovici, Djperi, Krute, Svirzigace, Kalimani, Suma, Kosic, Bojka, Mide.

§ 2

Tue shkue në tregun e Shkodrës banorët e katundeve të njehuna ma nalt munden me importue në Shqipni, tue gëzue nga lirimet dhe privilegjët e parapame n'artikullin 2 t'Aneksës C dhe të këtij Protokolli zbatues, prodhimet e tyne dhe sasinat e tregueme në *Pjesën e Shtueme Nr. 4.* të këtij Protokolli.

§ 3

Për nevojat kryesore, këta banorë, munden të blejnë në tregun e Shkodrës dhe t'importojnë në Jugosllavi tue gëzue lirime dhe privilegje të parapaëm n'atrt. 3 t'Aneksës C dhe këtij Protokolli, prodhimet dhe sasinat e tregueme në *Pjesën e Shtueme Nr.* 5 të këtij Protokolli.

§ 4

Për kalimin e kufinit, banorët e këtyne katundeve, duhet të kenë me vehte nji kartë-kufini modeli i së cilës asht përshkrue n'Aneksën C të këtij Protokolli.

Kushtet dhe procedura për lëshimin e kësaj karte-kufini janë ato të caktueme në pikat Nr. 45 deri 57 të këtij Protokolli.

§ 5

Trafiku i kufinit do të bahet mbi udhat dhe vendet e kalimit dhe në orët e parapame për banorët e sektorit shqiptar përballë

(correspondant) që shkojnë në tregjet jugosllave (shifni *Pjesën e Shtueme Nr. 3* të këtij Protokolli, pika 9).

§ 6

Kuptohet mirë se listat e prodhimeve dhe sasinat e shenueme këtu nalt në paragrafët 2 dhe 3, kanë nji karakter të përkohëshëm.

ANEKSA «A»

MODEL KARTE - KUFINIT

Ad pikën 45 të ktij Protokoli

(Ky model zavëndëson modelin të ngjitun Aneksës C me datë 22 Qershuer 1926)

(Faqje e jashtme e mbulesës së verdhë)

S t e m a   e   S h t e t i t

K A R T Ë — K U F I N I

(dhanë pershtat Aneksës C të Traktatit të Treglis Shqiptaro-Jugosllav dhe të Protokollit të zbatimit të kësaj Anekse)

(Verso i faqes së mbulesës së verdhë)

L A J M I M

Kjo Kartë asht e vlefshme vetem për njerzit që janë nëshkrue n'ate dhe për të cilat ka dhanë vizen autoriteti i Mbretnis tjetër.

Me ket Kartë nuk kalohet kufini veç se nder viset qi janë shënue mbrenda dhe nuk mundet me shkue në tokë të Shtetit tjetër veç se ndër rrugët qi tregohen mbrenda dhe vetem gjer te vendi që asht caktue.

I zoti i kësaj Karte duhet të këthehet në vendin e vet mbrenda ditës dhe gjithmonë në rrugen prej kah ardhi. Mund të qëndrojë ma shumë në token e Shtetit tjetër vetem në pastë një leje të posaçme të dhanun prej autoritetit të Kufinit ose të vendit të Shtetit tjetër.

Karta ka vleftë deri në diten q'asht shënue në faqet 1 ose 7.

Vetem nëpunësit përkatës dhe kurkush tjetër nuk ka të drejtë me shkrue udhëheqje ose shënime të tjera në Kartën e Kufinit.

BKSH

1.

Mbretnija . . . .
Nënprefektura (ose Prefektura) . . . .

(Stema e Shtetit)

KARTË — KUFINI

(1) Emen e peremen . . . .
(2) Banuës në . . . .
Nënprefektura . . . .
Ka leje me kalue kufinin në . . . .
Për me shkue në . . . .
Nga rruga e . . . .
Kjo Kartë vlen deri me . . . .
Nr. i Kartës . . . .

Nënprfeekti (ose Prefekti)
. . . .
Dhânë me . . . . 193 . .
(Vula)

2.



(1) Emene e mbiemën . . . .
(2) Mosha . . . . (7) Sy . . . . . .
(5) Shtati . . . . (8) Mustaqe . . . .
(6) Flokët . . . . (8) Mjekër . . . . .
(9) Shenja të veçanta

Nënshkrimi i titullarit ose shënja e gishtit të tij:

BKSH

3.

Antarët e familjes qi janë shënue këtu poshtë kanë të drejtë me përdorue ket kartë

Emën e mbiemën	Moshë	Kushërini	Viza e autoritetit tejkufinuer *)

Vula   Nënprefekti (ose Prefekti)

. . . . . 193 . .   . .

*) Nënprefekti tej kufinit ka me vue, në ket shtyllë, vulen e vet, për çdo njeri të nenshkrojtun në ket radhua, në vendin e vizës.

4.

Faqe e rezervueme për fotografinat dhe nënshkrimet e personave të lejueme me përdorue ket Kartë



BKSH

5 — 14

Faqe e rezervueme për shënimet qi bajnë autoritetet *)

*) Bje fjala: leje për banim ma se nji ditë deri më tri dit; leje për me shkue në nji vend tjetër, veç atij të shënuem në faqen e parë etj.

15.

Faqe e rezervueme për vizen e kësaj Karte të lëshueme nga autoriteti kompetent i Shtetit tjetër

(Vula)

Me. . . . . . 193 . .
. . . . *193* . .

Nënprefekti (ose Prefekti)

BKSH

16.

Vleftësija e kësaj Karte zgjatet deri me . . . . . .

. . . . *193* . .

(Vula)

Nënprefekti (a Prefekti)

Vend për vizen e autoritetit kompetent të Shtetit tjetër, për zgjatimin q'âsht dhanë këtu sipër.

. . . . 193 . .

(Vula)

Nënprefekti (a Prefekti)

. . . .

Kjo Kartë - kufini përmban 16 faqe dhe një mbulesë.

(Mbulesë)

(Faq' e mbrendëshme e fletës së fundit)

Udhëheqje për autoritetet që lëshojnë ose vizojnë këtë Kartë

(1) Shkruhet emni dhe mbiemni me letra shtypi majuskule.

(2) Shkruhet emni i katundit dhe, në mos qoftë ky katund qender komuneje, atëhere shënohet dhe komuna prej nga mvaret. Katundi duhet të gjindet mbrenda zonës kufinore.

(3) Vula e Nënëprefekturës (ose e Prefekturës) që lëshon Kart Kufinin.

(4) Vula e Nënprefekturës (ose e Prefekturës) që vizon Kart-Kufinin.

(5) Tregohet në se titullari e ka shtatin të vogël, të mesëm a të math.

(6) Tregohet në se titullari s'ka flokë në krye ose ika të verdha, bojë gështenjë, të zeza, të thinjuna ose të bardha.

(7) Tregohet ngjyra e syve.

(8) Tregohet nëse ka mustaqe e mjekër, ose i ka të rrojtuna.

(9) Kur titullari të jetë i vengër, kurris-dalë, doraç, i çalë, ose të ketë një tjatër të metë të jashtme që duket lehtësisht.

(10) Në mos pastë vent në këte faqe per të gjitha fotografitë, disa mund të vihen dhe në faqen që pason.

(11) Njeriu i shënuem mâ nalt, do t'a venë këtu nënshkrimin e vet; në mos din me shkrue, autoriteti ka me shënue emnin e tij dhe ay vetë ven gishtin.

Çdo shënim në këtë Kartë do të shkruhet në mënyrë të kjartë.

ANEKSA «B»

MODEL KARTE-KUFINI PËR PRONAT TEJKUFINUER

Ad pikën 21 të ktij Protokolli

(Ky model zavendëson modelin e ngjitun Aneksës C me datë 22 Qershuer 1926)

Mbulesë e kuqe, fletë e parë, faqe e jashtme
Stema e Shtetit përkatës

KARTË KUFINI PËR PRONAT TEJKUFINUER

(E lëshueme përshtatë Aneksës C të Traktatit të Tregtis shqiptaro-jugosllav dhe të Protokollit të zbatimit t'asaj Anekse C).

Faqe e mbrendëshme e fletës së parë të mbulesës

LAJMIM

1. — Personat të nshkrueme në këtë Kartë kanë leje me kalue kufinin në vendin që tregohet në faqen e parë për të punue tokat të diftueme ndër faqet 3 dhe 4 të kësaj Karte.

2. — Mund të bartin me vehte sendet e nevojshme për punimin e tokës. Mund të çojnë me vehte kafshët të shënueme ndër faqet 6 dhe 7 per t'u kullotun a për t'i ngarkue. Kanë të drejtë të marrin prodhimet e nxjerruna prej tokës që thamë.

3. — Kanë të drejtë me kalue kufinin vetëm në vendin e shënuem në Kartë. Në tokën e Shtetit tjatër nuk kanë të drejtë me qarkullue veç se nëpër rrugët që diftohen në Kartë dhe vetem deri në vendin të caktuem në të. Në mos paçin nji leje të posaçme të lëshueme prej autoriteteve kufinore ose lokale të Shtetit tjatër, njerëzija duhet të kthehen mbrenda ditës dhe gjithmonë nëpër ato rruge.

4. — Vetëm nëpunësit kompetentë kanë të drejtë të shkruejnë shenime mbi ketë Kartë.

1.

Mbretnija . . . . Zyra doganore e . . . .

Nënprefektura ose Prefektura e . . . . **)

Me . . . 193 . . (Stema e Shtetit) Nr . . . . .

KARTË - KUFINI PËR PRONAR TEKUFINUER

1) Emen e mbiemen . . . .

2) banues në . . . .

Nënprefektura . . . .

Ky, sikunder dhe personat e shënueme në këtë Kartë, kanë leje të shkojnë nder tokat tejkufinore që diftohen

nder faqet 3 dhe 4 të kësaj Karte, të cilat ndodhen
në . . . .
Komuna . . . .
Nënprefektura . . . .
tue kalue kufinin nëpër . . . .
Kryenëpunësi i Zyrës Doganore *)
(Vula)
Nënprefekti ose Prefekti **)
. . . .

*) Për Kartat e lëshueme nga autoriteti jugosllav.
**) Për Kartat e lëshueme nga autoriteti shqiptar.

2.

Nënshkrimi i titullarit të Kartës ose shenja e gishtit të tij:
. . . .

Vend i caktuem për vizën e Nënprefektit Jugosllav *)
U pa në Nënprefekturë të . . . .
Me . . . . . 193 . .
(Vula) Nënprefekti
. . . .

Vend i catkuem për vizën e autoritetit të Shtetit tjatër.

Për Kartat të lëshueme nga autoriteti jugosllav.

3

Pershkrimi i pronës tejkufinore

Personat e diftueme në faqen e mâparshme ka ([3])
. . . . prona në zonen kufinore dhe të cilat janë këto:

1.
Në vendin . . . .
Komuna . . . .
Gjindet ([4]) . . . .
E gjanë, po thuej . . . .

2.
Në vendin . . . .
Komuna . . . .
Gjindet (4) . . . .
E gjanë, po thuej . . . .

3.
Në vendin . . . .
Komuna . . . .
Gjindet (4) . . . .
E gjanë, po thuej . . . .

4.
Në vendin . . . .
Komuna . . . .
Gjindet (4) . . . .
E gjanë, po thuej . . . .

5.
Në vendin . . . .
Komuna . . . .
Gjindet (4) . . . .
E gjanë, po thuej . . . .

6.
Në vendin . . . .
Komuna . . . .
Gjindet (4) . . . .
E gjanë, po thuej . . . .

7.
Në vendin . . . .
Komuna . . . .
Gjindet (4) . . . .
E gjanë, po thuej . . . .

Kjo vërtetohet nga dishmit të lëshueme prej komunes . . . . me datë . . . . dhe me numer . . . .

BKSH

5.

Personat e shënueme ma poshtë munden me përdorue këtë Kartë

Emën e mbiemën	Moshë	Afërsija ose shërbimi	Viza e Nënprefekturës tej kufinore*)

. . . . . 193 . . Nënprefekti ose (Prefekti)

---

*) Nënprefekti ose Prefekti tejkufinuer do të venë, në ket shtyllë, në vent të vizës, vulen e vet, domethanë për çdo personë një vulë.

6.

Lloji e numëri i kafshëve që çohen në pronën tejkufinore

Kuaj . . . .

. . . .

. . . .

. . . .

Dhen e desh . . . .

. . . .

. . . .

. . . .

. . . .

---

*) Nënshkrimin e parë e bân autoriteti që lëshon Karten. Ndryshimet e pastajme ka me i shënue këtu autoriteti i kufinit.

BKSH

7

Gomarë a mushka . . . .

. . . .

. . . .

. . . .

Dhij e sqep . . . .

. . . .

. . . .

. . . .

Qe, lopë, buej . . . .

. . . .

. . . .

. . . .

8.

Mjete për bartje dhe vegla të mëdhaja bujqësore ose të çueme nder pronat tejkufinore *)

Qerre . . . .

. . . .

. . . .

. . . .

Parmenda . . . .

. . . .

. . . .

. . . .

. . . .

. . . .

. . . .

. . . .

*) Nëshkrimin e parë e ban autoriteti që lëshon Karten. Ndryshimet e pastajme do të shkruhen këtu prej autoritetit të kufinit.

BKSH

9 — 14.

Vend i reezrvuem për shënimet që bajnë autoritetet *)

*) Për shembull: Leja për të ndenjun mâ shum se një ditë; Leja për të shkue në nji vend tjatër, veç atij të caktuem në faqen 1, etj.

15

Vletësija e kësaj Karte zgjatohet deri me . . . . .

Nr. . . . . .

. . . . 19 . .

(Vula)

Nënshkrimi i autoritetit

. . . .

Vend për vizën e autoritetit të Shtetit tjatër për zgjatimin e vleftësis së kësaj Karte

BKSH

16

Vend për vizimin e kësaj Karte nga autoriteti i Shtetit tjatër

---

Kjo Kartë kufini permban 16 faqe dhe një mbulesë.

Mbulesë. Faqja e mbrendshme e fletës së fundit.

Udhëheqje për autoritetet që lëshojnë ose vizojnë këtë Kartë.

1. — Shkruhet emni e mbiemni me letër shtypi majuskule.
2. — Shkruhet emni i katundit dhe, në mos qoftë ky katund qender komuneje, atëherë tregohet komuna prej nga mvaret. Katundi duhet të ndodhet mbrenda zonës kufinore.
3. — Tregohet numuri i pronave.
4. — Diftohet lloji i pronave,, për shembull: luadh, arë, pyllë, vneshtë, mullij, etj.
5. — Nënshkruhet, bje fjala: bir, nânë, barij, karocaxhij, sherbëtuer, etj.

Gjith shënimet në këtë kartë do të bâhen me shkrim të këndueshëm.

BKSH

ANEKSA «C»

MODEL VËRTETIMI PRONARIJE

Ad pikën 26 të ktij Protokolli

VERTETIM PRONARIJE

Komuna e . . . .
Komuna e . . . .
Prefekturë (ose Nënprefekturë) . . . .
e Mbretënis . . . .
verteton se Z. . . . .
banues në (katundin) . . . .
të qarkut (Prefektura ose Nënprefetkura) . . . . .
e Mbretnis . . . .
zotnon në rethin e kësaj komune mbrenda zonës kufinore . . . .
nji prone, të cilen e punon ay vet (a të lëshueme me qira a gjysmatarij Z. . . . .
banues (në katundin) në zonen . . . .

Kjo pronë permban:

Lloji i pronës	Katundi a vendi ku ndodhet prona	Sipërfaqe	
Ara			
Luadhe*)			
Vneshta*)			
Bostane*)			
Vatha*)			
Kullota*)			

Pronat që diftohen ma nalt zotënohen prej titullarit qyshë prej . . . . **)
dhe kjo në themel të. . . . . ***)
Nr. . . . .
me . . . . . . 193 . .
(Vula) Nënshkrimi i autoritetit komunuer:

*) Këta diftime shënohen vetëm si shëmbuj.
**) Diftohet data.
***) Diftohet në themel të ç'titulli (b. f. blerje, dhuratë shkëmbim, trashëgim u ba intestat (ligjuer) testament etj. u ba pronar.

ANEKSA «D»

MODEL I LISTËS PËRMBLEDHËSE TË KAFSHVE TË ÇUEME NË KULLOTË, VERIM OSE DIMNIM PËRTEJ KUFINIT

(Ad pikën 40 të ktij Protokolli)

Komuna e . . . .
Qarku i . . . .

LISTA E KAFSHVE

. . . . (emni ose emnat e pronarve),,
. . . . banues në . . . . . .
qarku . . . . të çueme në kullotë,
dimnim ose verim në . . . .

---

1) Emni e mbiemni i prisit dhe i barive, sikunder dhe diftimi i dokumentave t'identitetit të tyne:

---

2) Vendi i kullotës dhe diftimi i dokumentave qi vertetojnë pronarijn ose marrjen me qira të kullotës;

---

3) Lloji edhe numuri i kafshve:
Dhen . . . .
Desh . . . .
Dhij . . . .
Skjep (cap) . . . .
Kuaj të bardhë . . . .
Kuaj të murmë . . . .
Kuaj të zi . . . .
Kuaj . . . .
Lopë . . . .
Qé . . . .
Buej . . . .
Gomarë . . . .
Mushka . . . .

(Vula) Nenshkrimi i autoritetit

Më . . . . 193 . .

BKSH

4) Viza e autoritetit doganuer të daljes (domethanë të Shtetit prej nga del bagëtija për me shkue në kullotë):

---

5) Viza e autoritetit doganuer të hymjes (domethanë të Shtetit ku shkon bagëtija për kullotje)

---

6) Viza e Komunes ku gjindet kullota, qi vêhet kur mrri-në bagëtija.

---

7) Viza e Komunes ku gjindet kullota, qi vêhet në çastin e largimit të bagëtis.

---

8) Viza e autoritetit doganuer të daljes (domethanë e Shtetit prej ku largohet bagëtija mbas kullotjes):

---

9) Viza e hymjes qi lëshohet prej auoritetit doganuer të Shtetit prej nga asht bagëtija, në çastin kur hynë në kufinin e vet.

---

10) Shënime të takueshme:

DKSH

ANEKSA «E»

MODEL LEJE-KALIMI

(«Leje-Kalimi»)

Ad pikën 60 të ktij Protokolli

(Ky model zëvendëson modelin e ngjitun Aneksës C me datë 22 Qershuer 1926)

Mbretnija *) . . . .
Nenprefektura (ose Prefektura) *) . . . .

LEJE - KALIMI

Z. . . . . banues në . . . .
qarku i . . . . . . cili zotënon një Kartë - Kufini të lëshueme prej . . . . . . nën numur . . . .
Prej zanati asht . . . .

Asht i lejuem me ushtrue kët zanat në vendin e vet dhe me kalue kufinin për t'a ushtrue në Sektorin e zonës kufinore në ballë, si mbas kërkesës të një banuesi t'atij Sektori.

Prap se prap; në zonë nuk mund të qendrojë mâ shumë se 48 orë.

Mund t'a kalojë kufinin nëpër rrugë të . . . . .

Kjo Leje asht e vlefshme për disa të shkueme deri

me . . . .

Nr. . . . .

Nënprefekti (ose Prefekti)

Më . . . 193. . (Vula) . . . .

---

*) Viza e Nënprefekturës (ose e Prefekturës) tejkufinore e Sheit tjetër.

BKSH

PROTOKOLL

PËR NËNSHKRIMIN E HARTAVE GJEOGRAFIKE DHE TË KROQIVE

Sot me 8 Maj 1934, në çastin kur u nënshkrue protokoll' i zbatimit t'Aneksës C. (Dispozita q'i takojnë trafikut të kufinit) të Traktatit për tregëti e lundrim midis Shqipnis e Jugosllavis. Delegatët e të dy Palëve të Nalta Kontraktuese që diftohen këtu ma posht u parafuen në Tiranë në Mars 1934:

Nga ana e Qeveris së Mbretnis Shqiptare prej:

S.T. Z. Xhafer *Villa*, Ministër i P. të Jashtme (parafë D. V.)

S.T. Z. Dhimitër *Beratti*, Ministër Fuqiplotë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Ministris së P. të Jashtme (parafë D. B.)

Dhe nga ana e Qeveris të Mbretnis së Jugollave prej:

S.T. Z. Jovan Djonovitch, i Derguemi i Jashtzakonshëm e Ministër Fuqiplotë pranë Nalt Madhënis së Tij Mbretit të Shqiptarvet; (parafë *J. Dj.*)

Z. Dr. Ivan Saubbotitch, Këshilltar Legate, Shef Seksioni në Ministrin e P. të Jashtme ((parafë *Soub.*).

Fuqiplotët këtu poshtë të nënshkruem deklarojnë se i konsiderojnë, me nënshkrimin e këtij protokoli, se këo harta janë të firmueme vleftësisht:

1) Harta me shkallën 1:200000 botim' i «Kartografisches, frueher Militaergeografisches-Institut in Wien» (e hartueme prej Dr. Herbert Louis) . . . . (me dy fletë) mbi të cilat u nënshkruan kufijt e mbrendshëm të zonës kufinore Shqiptare si edhe kufijt e Sektorve të kësaj zone edhe viset e kalimit të kufinit.

2) Harta me shkallën 1:100000, e botueme prej «Vojno geografski-Institut» i Mbretnis Jugosllave (8 fletë) mbi të cilat u nënshkruen kufit e mbrendshëm ë zonës Jugosllave, si edhe kufit e sektorve të kësajë zone, vendet e kalimit të kufinit si edhe tregjet. Me gjith këtë shënojmë se vendet e kalimit mbi lumin e Bunës nuk janë shenue në këto harta por mbi ato të diftueme këtu nalt sub 1)

3) Gjasht kroqi të sektorve kufinorë e të dy zonave qi përmbajnë hollsinat e hartave të tregueme ma nalt.

Kroqit në fjalë janë këto:

I pari kroqi: I Sektor i Prespës dhe i dyti Sektor Ohër-Pogradec;

I dyti kroqi: Sektor' i V Prizren-Kukës:
IV Dibra;

I treti kroqi : Sektor' i V Prizren-Kukës;

I katërti kroqi : Sektor' i VI. Jakovë-Tropojë;

I pesti kroqi: Sektor' i VII. Gusin - Vermosh;

I gjashti kroqi : Sektor' VIII. Tuz - Hot dhe Sektor' i IX. Shkodër - Plavë - Ulqin.

Gjith këto harta e kroqi u banë dhe u nënshkruen dy fish, kështu qi, nji eksemplar ju dorzue Delegatit Shqiptar dhe tjetra ju dorzue Delegatit Jugosllav.

U ba në Belgrad me 8 Maj 1934 me dy eksemplar.

Delegatët e Mbretnis Shqiptare
R. Fico
D. Beratti

Delegatët e Mbretnis Jugoslave
Bojidar Pouritch
Dr. J. V. Soubbotitch

NOTAT E ÇKËMBYEME

LEGATA MBRETNORE SHQIPTARE
B E L G R A D
Nr. 315/III
Nr. 9891 Belgrad, me 8 maj 1934

Zoti Ministër,

Në çastin e nënshkrimit të Traktatit mbi aplikimin e Aneksës C të Traktatit të Tregtisë dhe të Lundrimit, në fuqi në mes të dy Shteteve, kam nderin me i njoftue Shkelqesis s'Uegj se asht marrun vesht qi prodhimet, të përmenduna në § 3 të Pjesës së Shtuëme Nr. 6 të Protokollit në fjalë, me të cilat banuësit e katundeve të shënuëme në 'te, do të mundin të blejnë aq sa u duhet për nevojat e tyne të ngushta, duhet të jenë prodhime Shqiptare ose prodhime të nacionalizueme në Shqipni, d.m.th prodhime që janë çdoganue rregullisht në Shqipni.

Ju lutem pranoni, Zoti Ministër, sigurimet e konsideratës s'ime të naltë.

Rauf Fico

Shkëlqesis së Tij *Z. Bogoljub Jevtitch*
Ministër i Punve të Jashtme të Mbretnis Jugoslave
në B e l g r a d

MINISTRIJA E PUNVE TË JASHTME
E MBRETNIS JUGOSLLAVE

Nr. 9891 Belgrad, me 8 maj 1934

Zoti Ministër,

Në çastin e nënshkrimit të Traktatit mbi aplikimin e Aneksës C të Traktatit të Tregtisë dhe të Lundrimit, në fuqij në mes të dy Shteteve, kam nderin me i njoftue Shkëlqesis s'Uej se asht marrun vesht që prodhimet, të përmenduna në § 3 të Pjesës së Shtuëme Nr. 6 të Protokollit në fajlë, me të cilat banuësit e katundeve të shënuëme në 'te do të mundin të blejnë aq sa u duhet për nevojat e tyne të ngushta, duhet të jenë prodhime Shqiptare ose prodhime të nacionalizueme në Shqipni, d.m.th. prodhime që janë çdoganue rregullisht në Shqipni.

Ju lutem pranoni, Zoti Minister, sigurimet e konsideratës s'ime të naltë.

Me autorizim të Ministrit,
Ministri Fuqiplotë
Bojdar Puritch

Shkëlqesis së Tij Z. *Rauf Fico*
I Dërguem i Jashtëzakonshëm e Ministër Fuqiplotë
i N. M. Tij Mbretit të Shqiptarve
në B e l g r a d

Nr. 131

LIGJË, 24 Nanduer 1934.

Mbi bartje fondesh prej fr. ari 8000 në buxhetin e ushtërimit 1934-935 të Ministris P. Botore (Dega Post-Telegrafë)

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 30 Nanduer 1934, Nr, 62)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet të ushtrimit financjar 1934-35 të Ministris së P. Botore, Degë «Post-Telegrafë», paksohen nga Kap. 10 Rrogë personeli etj. Fr. ari 4000
Nga Kap. 14 «Qira» » 4000

G j i t h s e j t Fr. ari 8000

Art. 2.

Prej fondit fr. ari 8000 (tetmijë) paksue si mbas art. 1 të kësaj Ligje, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1934-35 të Ministris së P. Botore, Degë «Post-Telegrafë» nen:

Kap. 12 «Shpenzime udhtimi e djete»	Fr. ari 5500
Kap. 19 «Taksa nderkombëtare»	» 2500
	Fr. ari 8000

Art. 3.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 4.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Ministri P. Botore.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartje fondesh prej fr. ari 8000 në buxhetin e ushtrimit financjar 1934-35 të Ministris së P. Botore (Degë Post-Telegraf), e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 15/I datë 19-XI-1934 të Kryesis së Tij.

Durrës, me 24 Nanduer 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI *Ministri i P. Botore* S. SARAÇI

Nr. 132.

LIGJE, 24 Nanduer 1934.

Mbi bartje fondi prej fr. ari 40.000 prej buxhetit t'ushtërimit 1934-935 të Komandës së P. të Gjindarmeris në atë të Ministris P. Mbrendëshme

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Dhetuer 1934, Nr. 63)

Art. 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit 1934-1935 të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare dhe të Gjindarmeris, degë «Gjindarmeri», pakësohet nji fond prej fr. ari 40.000 (dyzetmij) nga Kap. 23 «Rrogë graduatësh e Gjindarmësh».

Art. 2.

Fondi prej fr. ari 40.000 (dyzetmij) paksue si mbas Art. 1 të kësaj Ligje, i shtohet gejndjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1934-1935 të Ministris së P. të Mbrendshme nen Kap. 10 «Shpenzime të mëshefta».

Art. 3.

Me zbatimin e kësaj Ligje ngarkohet Trupi Ministruer.

Art. 4.

Kjo Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëve

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi bartje fondi prej fr. ari 40.000 prej buxhetit t'ushtrimit 1934-1935 të Komandës së P. të Gjindarmeris n'atë të Ministris së P. të Mbrendshme, e votueme prej Parlamentit si mbas shrkesës Nr. 8/I datë 10-XI-934 të Kryesis së Tij.

Durrës, me 24 Nanduer 1934. ZOG

Kryeministri — P. EVANGJELI

Ministri i P. Mbrendëshme — MUSA JUKA

Ministri i Financavet — A. DIBRA

Nr. 133.

LIGJE, 24 Nanduer 1934.

Mbi ndryshimin e Art. 3 të Ligjës mbi krijimin e Letrave me vleftë prej fr. ari 1, 2, 5 për dobinë e Kryqit të Kuq Shqiptar

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 3 Dhetuer 1934, Nr. 63)

Art. 1.

Artikulli 3 i Ligjës mbi krijimin e letrave me vleftë prej fr. ari 1, 2, 5 për dobinë e Kryqit të Kuq Shqiptar me datë 12 Fruer 1929, ndryshohet në këtë mënyrë:

«Këto letra do të jenë të bardha dhe do të kenë dimensionin

31 gjatësije dhe 21 santim gjanësie dhe, secila do të ketë nji shenjë të shtypun lithografisht. Shenja do të jetë e rrumbullakët me madhsijë prej katër santimeshë, e cila do të mbajë amblemin e Kryqit të Kuq me nji infirmjere nacionale tue sherue nji kalamaj të vorfën edhe do të permbajë germat K.K.Sh. gjith ashtu dhe vleftën përkatëse».

Art. 2.

Kjo Ligjë hynë në fuqi ç'prej datës së shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art. 3.

Ministrija e Drejtësis, ajo e P. të Mbrendshme dhe e Financavet, ngarkohen me zbatimin e kësaj Ligjë.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarëve

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi ndryshimin e Art. 3 të Ligjës mbi krijimin e letrave me vleftë prej fr. ari 1, 2, 5 për dobinë e Kryqit të Kuq Shqiptar, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 12/I datë 19-XI-1934 të Kryesis së Tij.

Durrës, me 24 Nanduer 1934. ZOG

Kryeministri — P. EVANGJELI
Ministri i Drejtësis — V. AVRAMI
Ministri i P. të Mbrendshme — MUSA JUKA
Ministri i Financavet — A. DIBRA

Nr. 134.

LIGJË, 24 Nanduer 1934.

Mbi shtimin e nji Arshitekti në Kuadrin e Bashkis Durrësit

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 12 Dretuer 1934, Nr. 64)

Neni 1.

Në kuadrin e personelit të Bashkiës së Durrësit shtohet edhe nji arshitekt me 400 (katerqind) fr. ari rrogë mujore.

Neni 2.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi nga data e shpalljes në Fletoren **Zyrtare.**

Neni 3.

Ministrija e P. të Mbrendëshme ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje.

ZOGU I.

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi proponimin e bamun me shrkesen Nr. 1142 datë 2-VII-934 të Kryeministris,

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 1-8-1934,

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Derket-Ligjës mbi shtimin e nji arshitekti në kuadrin e Bashkiës së Durrësit.

Durrës, me 24 Nanduer 1934. ZOG

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

ZOGU I.

Mbreti i Shqipëtarëvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës me datë 13 Gusht 1934, i aprovuem prej Parlamentit, dhe Urdhënon shtimin e tij në Kodet e Mbretnis si Ligjë.

Durrës, me 24 Nanduer 1934, ZOG

Nr. 135.

DEKRET-RREGULLORE, 24 Nanduer 1934.

Mbi gjestionin e gjanavet me vleftë nga ana e nëpunësit kujdestar të magazinës qendrore pranë Ministris së Financavet dhe e Arkëtarëve të Zyrave Financjare

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 31 Dhetuer 1934, Nr. 65)

KAP. I.

FORNITURA DHE DORËZIME, MAGAZINËS QENDRORE E GJANAVET ME VLEFTË

Neni 1.

Për forniturën e gjanavet me vleftë të çdo natyre, përkujdeset

BQSH

Ministrija e Financavet në bazë të dispozitave të Ligjës datë 28 Maj 1929 mbi administrimin e pasunis e të kontabilitetit të Shtetit, dhe të Rregullores përkatëse datë 7 Fruer 1930.

Nga adjudikata e forniturës përjashtohen firmat që nuk janë të pajosuna me makinat dhe veglat që mund të japin garancin ma të plotë mbi sasin e gjanave me vleftë të përmbajtuna ndër pakeia të dorëzueme.

Neni 2.

Ndër kontrata që do të lidhen për forniturën e gjanavet me vleftë duhet, të caktohet detyra e firmës adjudikatare që të dorëzojnë franko, në dam dhe për rrezik të sajën, në Magazinën qendrore të gjanavet me vleftë pranë Ministris së Financavet, sasinat e kërkueme. Me gjith këtë Ministrija e Financavet autorizohet me marrë masat e duhuna herë pas here, në mënyrë që transportimi nga qendra e firmës në magazinën qendrore të bahet në mënyrë që të ndalohet çdo humbje ose vjedhje.

Prapë Ministrija e Financavet, kur gjanat me vleftë fornizohen nga firma të jashtme që nuk mund të bajnë dorëzimin në magazinën qendrore të gjanavet me vleftë, asht e autorizueme me konvenue marjen në dorëzim edhe gjetiu, tue marrë njikohësisht masat e duhuna, kështu që transportimi nga qendra e firmës deri në Magazinën Qendrore të bahet në mënyrë që të ndalohet çdo humbje ose vjedhje.

Neni 3.

Sasinat e gjanavet me vleftë që shtihen në magazinën qendrore kontrollohen prej nji komisjonit të përbamë prej Drejtorit të Thesarit, prej Shefit të Seksionit të Monopolevet, ose nga nji i deleguem i tyne, dhe prej Nëpunsit kujdestar të magazinës qendrore.

Nëpunsi kujdestar ka të drejtën e pakundërshtueshme të kërkojë që, të bahet numrimi dhe të kërkojë ç'do gja tjetër që t'i japi sigurime ma të plota mbi sasin e ngarkimit që merr përsipër.

Në rasë se vërtetimi nuk mund të bahet mbrënda nji ditës së vetme, Komisjoni duhet të ketë kujdes me da me njenën anë sasinat e kontrollueme nga ato që do të kontrollohen dhe, veprimin do t'a vazhdojë në ditën ose ndër ditët të tjera, deri sa të marrin fund vërtetimi i gjith partis.

Funkcjonartë që kan marrë pjesë ndër veprimet e marrjes në dorëzim janë bashkarisht përgjegjës për përfundimin e numrimit të tyne.

Neni 4.

Për vertetimin e bamë si mbas nenit 3 mbahet nji proces-verbal i veçantë në të cillin shënohen sasinat, lloji dhe çmimi i gjanavet me vleftë, diferencat që mund të kenë dalë në mes t'akteve-dërgimi të Firmës fornuese dhe, të përfundimit të numrimit materjal dhe të ngarkimit definitiv që merret përsipër nga nëpunsi kujdestar.

Verbali i përpiluem në tri kopje dhe i nënshkruem prej fonksjonarvet që marrin pjesë në vërtetim, përmban dokumentimin e ngarkimit për nëpunsin kujdestar të Magazinës qendrore.

Dy kopje të verbalit mbahen nga nëpunsi kujdestar dhe, e treta i dorëzohet Ministris së Financavet e cilla urdhnon që të ruhet ndër aktet reservate të zyrës.

Neni 5.

Po të njajtat veprime, sikurse u caktue ndër nenet ma sipër bahen në rasë se, në Magazinën qendrore, shtihen gjana me vleftë të kthyeme nga Drejtorinat Financjare ose nga zyrat të tjera pse kalojnë nevojat e shërbimit ose pse janë vue jashta përdorimit, si ashtu edhe gjanat me vleftë që për urdhën të Ministris të Financavet duhen të ruhen përherësisht ose përkohësisht në magazinën e sipër-tregueme.

KAP. II.

MBI MAGAZINËN QENDRORE TË GJANAVET, ME VLEFTË, NËNPUNSIN KUJDESTAR DHE TË ZËVENDËSIT TË TIJ, ARKËTARËT E ZYRAVET FINANCJARE

Neni 6.

Ministri i Financavet urdhnon që për magazinën qëndrore të gjanavet me vleftë të destinohet nji lokal i gjanë, ndër dritësore të ketë hekra të fortë dhe, të ketë rafte të mjaftueshme për me mbajtë në rregull dhe të dallueme si mbas llojit dhe çmimit gjanat me vleftë.

Nji derë e vetme hymjeje në magazinën duhet të ketë tri çelsa të cillët duhen të kenë nji mbyllje të ndryshme njanin prej tjetrit; çelsa dhe brava këto që duhet të kenë përhera nji funkcjonim të mirë dhe të regullt.

Çelsat e tri bravavet mbahen respektivisht nën përgejgjësin e tyne, nji nga Drejtori i Thesarit nji nga Shefi i Seksionit të Monopoleve, ose nga delegatët e tyne dhe, nji nga Nëpunsi kujdestar i magazinës. Shkëmbimi i çelsavet, edhe për nji kohë të shkurtë, në mes të funkcjonarvet përgjegjës, asht rreptësisht i ndaluem.

Ministri i Financavet ka të drejtë me caktue që nji ekzemplar i dytë i tri çelsave të ruhet n'arkën e hekurit të Ministris së Financavet më nji pliko të mbyllun me dyll të kuq, në mënyrë që mos të jetë i mundur përdorimi i tyne.

Në rasë humbjeje, nga ana e nji ndër funkcjonarët, të çelsit në dorë të tij, Ministri i Financavet mbasi të ketë urdhnue që të jenë ba vërtetimet e duhuna, dhe pos veprimit kundra përgjegjësvet, urdhnon që të përdoret ezemplari i dytë i çelsit të humbun që asht ruejtun n'arkën e hekurit të Ministris.

Neni 7.

Detyrat e Nëpunsit kujdestar të magazinës qendrore i ngarkohen nji funkcjonarit të veçantë që asht në shërbim, i cili caktohet në këtë Zyrë me vendim të Ministrit të Financavet dhe do t'i shtrohet dhanies së garancis së caktueme në tabelën e bashkalidhun Ligjës datë 22 Dhetuer 1931.

Nëpunsi kujdestar asht përgjegjës ndaj Administratës për tërhekjen, mbi kqyrjen, shpërndarjen dhe dërgesën e gjanavet me vleftë dhe, duhet t'i shtroeht të gjitha detyrave të caktueme prej Ligjës dhe Rregullores për administrimin e pasunis dhe të kontabilitetit të Shtetit, baras sikurse agjentat kontable.

Në rasë mungese ose ndalese të përkohëshme Nëpunsi kujdestar zëvendësohet prej nji funkcjonari të pëlqyem prej tij, caktue prej Ministrit të Financavet, për vepirme të cilit Nëpunsi kujdestar vetë përgjegjet personalisht.

Neni 8.

Në rasë ndrimi Zyreje ose pushimi nga puna, Nëpunsi kujdestar pushues përkujdeset, së bashku me atë që merr përsipër shërbimin për mbylljen e llogarinavet, për shqyrtimin e gjanavet me vleftë dhe, për vërtetimin e barazimit në mes të tepricave të regjistrueme dhe të tepricavet efektive.

Ndër këto veprime marrin pjesë edhe funksjonartë e tregueme ndër nenet 3 e 6.

Në kjoftë se gjatë veprimeve të dorëzimi dalin diferenca në mes të rregjistrimeve dhe të qënmenis, funksjonarët që marrin pjesë ndër këto veprime, mbasi të kenë ba hetimet e duhuna, caktojnë që tepricat të merren përsipër dhe për mungesat lajmërojnë me njiherë Ministrin e Financavet për të marrun masat e duhuna.

Për veprimet e bame pregatitet nji proces-verbal në të cilin mund të shënohen të gjitha vrejtjet dhe reservat që si nëpunësi

kujdestar pushues sa dhe aj që merr përsipër shërbimin, i shofin t'arsyeshme të bajnë për të mbrojtur përgjegjësin e tyne.

Proces-verbali mbassi të nënshkruhet prej të gjithë atyne që muerën pjesë në dorzim, përpillohet në tri kopje, nji ndër të cilla! i bashkangjitet llogaris judicjale që do të paraqitet prej Nëpunsit kujdestar pushues, e dyta mbahet prej Nëpunsit kujdestar që merr përsipër shërbimin, dhe e treta i paraqitet Ministrit të Financavet.

Neni 9.

Pranë Zyrave financjare mbi këqyrja, shitja, shpërndarja dhe dërgesa e gjanavet me vleftë i ngarkohen Arkëtarit nën përgejgjësin eksklusive personale të tija.

Neni 10.

Çedimi i gjanavet me vleftë, nga ana e Arkëtarit të Zyravet Financjare, bahet eksklusivisht tue, nxjerrun njikohësisht çmimin e gjanavet me vleftë.

Ndalohen pa tjetër dorëzim besimi, me përjashtim të Kryesekretarëve të Gjyqeve të Shkallës së parë dhe të Zyravet së Përmbarimi, të Kryesekretarëve të Gjyqit të Paqit dhe të Sekretarëve të Gjyqevet vetë të mveshun në funkcjonet e Kryesekrtarit, në konformitet me dispozitat që do të caktohen prej Ministrit të Financavet në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësis.

Për shkeljen e dispozitave si ma sipër janë personalisht përgjegjës Arkëtarët në ngarkim të cilëvet vehet shuma e përgjithëshme e gjanavet me vleftë të dorëzueme abuzivisht, pa marrë pastaj parasysh edhe masat dishiplinore të Ministrit të Financavet.

Neni 11.

Në rasë mungese të përkohëshme ose ndalese të justifikueme. Arkëtari zevendësohet prej nji funkcjonari të pëlqyem prej tij dhe të caktuem prej Kryetarit të Zyrës Financjare, për veprën e të cillit Arkëtari vetë asht përgjegjës personalisht.

Për zëvendësimin e përkohëshëm Kryetari Zyrës Financjare, asht i detyruem me lajmërue Ministrin e Financavet.

Neni 12.

Në rasë ndrrimi zyreje ose të pushimit nga puna t'Arkëtarit veprohet baras sikurse asht caktue në nenin 8 të kësaj Rregulloreje.

KAP. III.

MBI PULLA-SHITSIT

Neni 13.

Pullat e monopolit përveç arkave financjare, mund të shitet edhe nëpër magazina që tregtojnë sende të tejra ose n'ato që hapen posaçërisht për me shitë vetëm pulla.

Neni 14.

Ministrija e Financavet me ndërmjetsin e oragneve të saja, në çdo qytet, dhe qendër komune do, të caktojë në cillën rrugë sa dyqane do të shesin pulla monopoli.

Ministrija e Financavet, me hyemjen në fuqi të kësajë Rregulloreje, me nji shpallje të posaçme, do të kërkojë tregtarë që tregtojnë ose që mund të çelin magazinë në rrugët e shënuara për me u shitë pulla dhe kur dëshruesit kalojnë sasinë e lypun, hiqet short.

Neni 15.

Tregtarit që fiton të drejtën me shitë pulla, i jepet nji leje e posaçme nga Ministrija, Drejtorija ose Zyra Financjare dhe ky, si të marri lejen, detyrohet me varë në portën e dyqanit nji tabellë me këtë shkrim:

«Këtu shiten pulla monopoli.»

Tregtarit që meret me shit-blerjen e pullave të monopolit, i pagohet nji shpërblim 5%.

Shitsit e pullave, janë të detyruem t'a kenë dyqanin të çelun çdo ditë që funksjonojnë Zyrat.

Neni 16.

Shitësit e pullave të monopolit, kurdoherë qi të kenë nevojë, por jo ma pak se 50 franga ari kanë të drejtë të blejnë nga arkat sa e çdo lloji pullash që do të duan, tue pague vleftën ligjore me nji herë dhe tue, u zbrit nga kjo vleftë shpërblimi qi i takon nga pullat e bleme. Për arsye të justifikueme kur shitësi kthen pullat, shpërblimi përkatës i kthehet financës.

Neni 17.

Shitësit e pullavet detyrohen të mbajnë nji regjistër mbi sasin e pullave qi kanë blemun nga arka e financave dhe, t'u shtrohen ç'far do kontrollimi qi duenë të bajnë nëpunsat kompetentë të financave.

Neni 18.

Ministrija ose Drejtorija e Financavet pa arsye justifikuese që shkaktojnë penalitete ligjore nuk mund të tërheqi lejen e pullë-shitësit dhe, nuk mundë të japi pulla personavet të tjerë që nuk kanë leje.

KAP. IV.

VEPRIMET E SHPËRNDARJES DHE TË DËRGESËS SË GJANAVET ME VLEFTË

Neni 19.

Kërkesa e riferimit të gajnavet me vleftë, nga ana e Zyrave të Financës, duhet të bahet mbrënda muejvet Kallnuer e Korrik rispektivisht për nevojat e të parit dhe të dytit gjashtmuejor të ushtrimit financjar.

Në kërkesën, e cilla do të përpilohet me anë të nji modelit të veçantë të shtypun, shënohen, në shifra dhe në fjalë, sasinat e llojevet dhe të vleftave të ndryshme të gjanavet me vleftë që nevojtien.

Në rasë nji nevoje të ngushtë, mund të bahen kërkesa pjestore.

Neni 20.

Nëpunsi kujdestar i Magazinës qendrore, në lidhje me disponibilitetet që ka dhe të nevojave të tregueme prej Zyrave të ndryshme, ka të drejtë me zbritun kërkesat që i janë komunikue.

Mbasi të caktohen sasinat për t'u dërgue, Nëpunsi kujdestar i kërkon Ministrit të Financavet mbledhjen e Komisjonit të përmendun në nenin 3 dhe, në të njajtat formalitete të parapame për hyemjen e gajnavet me vleftë në magazinë, i jep udhë kërkesavet tue pregatitë paketat të cilat, të konfekcjonueme dhe të vulosuna me dyll të kuq në mënyrë që mos të vërtetohen humbje ose vjedhje, duhet t'i dërgohen seicillës zyrë financjare.

Për nxjerrjen nga Magazina qendrore merret shënim në nji buletë e cilla ban pjesë të nji buletarit të përbamë prej amzës dhe tri bijavet të cillat nënshkruhen prej pjestarvet të Komisjonit.

Tri bijat i bashkangjiten paketavet të cillat dërgohen me nji herë me anë të postës dhe të sigurueme.

Komisjoni ka për detyrë me i dhanë udhë kërkesavet jo ma vonë se ditës 5 të çdo muejvet Mars e Shtatuer.

Neni 21.

Kryetarët e Zyravet Financjare, po sa të marrin paketat e sigu-

rueme, duhet të vërtetojnë piksëpari mos prishjen e dyllit të kuq dhe të imbalazhit dhe, së bashku me Llogaritarin dhe Arkëtarin duhet të bajnë çeljen e tyne dhe vërtetimin e përmbajtjes, në bazë të biletavet bija bashkangjitun paketavet.

Në rasë se nuk del as nji diferencë, duhet të jepet njoftim të marrjes në dorëzim të gjanavet me vleftë me anë të nji deklaratës që do të bahet në shpinë të buletavet bija, të nënshkrueme prej Kryetarit të Zyrës financjare, prej Llogaritarit dhe prej Arkëtarit.

Bija e parë vyen si dokument ngarkimi për Arkëtarin i cilli merr në dorëzim, nën përgjegjësin e tij, gjanat me vleftë që kanë arritun; dy bijat e tjera i a këthen Nëpunsit kujdestar të magazinës qendrore, i cilli i ruen për me justifikue shgarkimin nga rregijstrat e tija dhe dorëzimin e bamë të gjanavet me vleftë të dërgueme.

Neni 22.

Në rasë diferencash në mes të sasis së gjanavet me vleftë të shënueme ndër buletat dhe asajë që rezulton nga numrimi materjal; përpilohet nji proces-verbal i veçantë i cili mbassi të nënshkruhet prej Kryetarit të Zyrës Financjare, Llogaritarit e Arkëtarit, e cilla urdhnon të bahen hetimet dhe merrë masat e duhuna për me shkoqitun këtë fakt dhe si për rregullimin e rregijstravet si ashtu edhe për vërtetimin e përgjegjësis.

Me gjith këtë Arkëtari e ka për detyrë me marrë përsipër me nji herë sasinat e gjanavet me vleftë të marruna efektivisht.

Neni 23.

Mbas urdhnit të Ministris së Financavet, Arkëtari mund i'autorizohet me i dërgue ndonji tjetrës Zyrë Financjare disa sasina të gjanavet me vleftë.

Në këtë rasë, veprimet e tërhekjes nga arka, e numrimit, e pregatitjes së paketave të mbylluna me dyll të kuq dhe, e dërgimit të tyne me postë të sigurueme, bahen prej Arkëtarit me pjesëmarrjen e Kryetarit të Zyrës Financjare dhe të Llogaritarit.

Gjanat me vleftë që do të dërgohen i bashkangjitet nji buletë e përbame prej tri pjesëve të njajta të nënëshkrueme prej tri personavet që kanë marrë pjesë ndër veprime, në të cillën shënohen për llojë dhe vleftë, sasinat e gjanavet me vleftë e dërgueme.

Zyra financjare që merr gjanat me vleftë vepron baras sikurse ashtë catkue në nenin 21. Mbassi të ketë ba vërtetimin, dhe mos të kenë të bajnë ndonji vrejtje, mban nji buletë bijë për me dokumentue ngarkimin, nji i a këthen zyrës financjare dërguese dhe, të tre-

tën i a dërgon Ministris së Financavet që t'urdhnojnë veprimet e duhuna të transferimit të gajnavet me vleftë nga llogarija e zyrës dërguese në llogarinë e zyrës marrëse.

Neni 24.

Në mënyrën e tregueme në nenin 23 të sipërm, veprohet dhe për gjanat me vleftë që zyrat financjare autorizohen me i kthye magazinës qendrore, për çdo arsye.

KAP. V.

MBI REGJISTRAT DHE LLOGARINAT ADMINISTRATIVE E JUDICJALE TË NËPUNSIT KUJDESTAR TË MAGAZINËS QENDRORE DHE TË ARKËTARVE TË ZYRAVE FINANCJARE

Neni 25.

Nëpunsi kujdestar i Magazinës qendrore duhet të mbajë, në nji trup të veçantë rregijstrash, gjendjen e të gjith veprimeve të ngarkimit dhe të shkarkimit të gjanavet me vleftë, si ashtu edhe atë të veprimeve të transferimit prej nji zyre financjare në tjetrën, që asht urdhnue prej Ministris së Financavet si mbas dispozitave të nenit 23.

REGJISTRAT PERBAHEN:

1) Prej nji rregjistrit dituer, i ndamë n'aq seksjone sa janë llojet e gjanavet me vleftë, në të cillin shënohen kronologjik'sht veprimet e hyemejevet dhe të daljevet;

2) Prej nji rregjistri (partitar) në të cillin për çdo zyrë financjare, mbahet n'evidencë ngarkimi i cili, përbahet prej llojve të ndryshme të gjanavet me vleftë dërgue këtyne nga magazina qendrore ose nga zyra të tjera, dhe shgarkimi i cillit përbahet nga shitjet dhe nga transferimet ndër zyra të tjera.

Neni 26.

Mbrenda muejvet Tetuer e Prill Nëpunsi kujdestar i Magazinës qendrore i paraqet Drejtoris së Kontabilitetit llogarinë administrative të veprimeve të bame, gjatë gjashtëmuejorit të kaluem.

Kësaj Llogarije i bashkangjiten:

a) përsa i përket ngarkimit, nji eksemplar i proces-verbaleve të hymjevet të bame si mbas dispozitës së nenevet 4 e 21.

b) përsa i përket shgarkimit, nji eksemplar të buletavet bija që vërtetojnë dërgesën e gjanavet me vleftë zyravet financjare.

Llogaris së gjashtëmuejorit të dytë t'ushtrimit financjar, i bashkangjitet edhe proces-verbali si mbas nenit 31.

Neni 27.

Mbrenda datës 5 të muejvet Tetuer dhe Prill, Arkëtarët e zyrave financjare duhet t'i dërgojnë Magazinës qendrore nji llogari analoge me atë të nenit 26, tue i bashkangjitun ngarkimit duert e gjanavet me vleftë që kanë marrë në dorëzim.

Llogaris së dytit gjashtëmujuer i bashkangjitet edhe nji ekzemplar i proces-verbalit të rishiiqmit si mbas nenit 31.

Neni 28.

Llogarinat e përmenduna ndër nenet 26, 27, të pregatituna në nji eksemplar të vetëm, për të parin gjashtëmuejor të ushtrimit, dhe në dy ekzemplar, për të dytin gjashtmujuer t'ushtrimit, i dërgohen nga ana e Nëpunsit kujdestar të Magazinës qendrore, Drejtoris së Kontabilitetit për veprimet e vërtetimit.

I dyti ekzemplar i llogarivet që do të paraqitet për të dytin gjashtë mujor t'ushtrimit, përmban llogarin judicjale e cila, së bashku me dokumentat justifikuese të ngarkimit dhe të shgarkimit për të gjith ushtrimin, i dërgohen, nga ana e Drejtoris së Kontabilitetit, Këshillit Kontrollues për të lëshue deklaratën e regullaritetit caktue në nenin 22 të Ligjës datë 23 Prill 1929, mbi krijimin e tij.

Neni 29.

Rregjistrat e Nëpunsit kujdestar të Magazinës qendrore të gjanavet me vleftë dhe t'Arkëtarëve të Zyrave financjare, si ashtu edhe llogarinat administrative dhe judicjale që këto janë të detyrueme me paraqitun, duhet të vênë në evidencë vetëm sasinat e gjanavet me vleftë.

Neni 30.

Modelet e rregjistravet dhe të llogarivet administrative dhe judicjale, të caktuem në këtë kapitlul, aprovohen me vendim të Ministrit të Financavet, mbasi të ketë marrë pëlqimin prej Këshillit Kontrollues përsa i përket llogaris judicjale, si mbas dispozitës së nenit 233 të Rregullores datë 7 Fruer 1930 mbi administrimin e pasunis e të kontabilitetit të përgjithshëm të Shtetit.

KAP. VI.

VËRTETIME DHE INSPEKTIME NË MAGAZINËN QENDRORE DHE PRANË ARKËTARËVE TË ZYRAVET FINANCJARE

Neni 31.

Në mbarim t'ushtrimit financjar Komisjoni i përmendun në nenin 3 ka për detyrë me ba rishikimin e ganjavet me vleftë për me u sigurue për barasin në mes të gejndjes, dhe të tepricavet të rregjistrueme.

Mbi përfundimin e veprimit bahet nji proces verbal të cillit i jepet udhë baras si kurse asht caktue në nenin 4.

Nji i njajtë vertetim bahet prej Kryetarit të Zyrës financjare, prej Arkëtarit dhe prej Llogaritarit përsa i përket gjanavet me vleftë që gjinden pranë zyravet financjare. Nji ekzemplar i proces-verbalit të vertetimit i bashkangjitet Llogaris së gjashtëmuejorit të dytë t'ushtrimit si mbas nenit 27, eksemplari i dytë i dërgohet Ministris së Financavet dhe i treti mbahet prej Arkëtarit.

Neni 32.

Ministri i Financavet ka të drejtë, gjith sa herë që t'a shofë të nevojshëm, me urdhnue inspektime në magazinën qendrore me anë të funksionarëve të deleguem prej tij.

Inspektimet kanë për objekt rishikimin e nji pjesës ose të gjith sasis së gjanavet me vleftë, shqyrtimin e regjistravet dhe të barasis në mes të tepricavet efektive të gjanavet me vleftë të gjetuna me saldet e regjistravet. Duhet pastaj të vertetojnë nëse shërbimi shvillohet në konformitet me dispozitat të kësajë Rregulloreje, dhe në se janë mbatjun mirë gjanat me vleftë.

Ndër inspektime duhet të marrin pjesë gjithëherë pjesëmarrësit e Komisionit të caktuem në nenin 3.

Funkcjonarët e ngarkuem me inspektimet duhet t'i riferojnë Ministrit të Financavet, përfundimin e tyne, me anë të nji raporiës së veçantë.

KAP. VII.

DISPOZITA TË PËRKOHËSHME

Neni 33.

Mbrenda nji kohës së shkurtë dhe si do kjoftë jo ma vonë se me datë 31 Dhetuer 1934 duhet të caktohet, me ânë të Komisjonit të përmendun në nenin 3, gjendja efektive, për seicillin lloj dhe

vleftë, e gajnavet me vleftë që gjinden në Magazinen qëndrore për me mujtë me dijtë saktësisht gjendjen kontable.

Për këtë efekt kanë me u regjistrue, për të gjith sasinë e tregueme prej Firmës, formuese, paketat që nuk janë çilë faret dhe që kan vulat e Firmës vet të pa prekuna.

Sa për gjanat me vjeftë të shpërndame dhe, ato ndër paketa të çeluna këto nuk kan me u rregjistrue ndër regjistra të magazinas. Këto kan me u vendosun dhe me u radhue ndër arka të veçanta në mënyrë që të jenë i lehtë identifikimi i tyne për kuer të jenë rasti me i nxjerrun. Prandaj, mbi kapak të sejcillës arkë duhet të shenjohet përmbajtja e gajnavet me vleftë dhe po kje e mundun edhe lloji dhe vlefta e tyne.

Arkat duhet të mbyllen mirë dhe të vulosen në mënyrë që mos të jenë i mundun prevetimi i tyne pa nderhymjen e pjesmarrësve të Komisjonit.

Neni 34.

Për dërgesat që janë ma të pakta se nji paketë dhe për sasinat e frankcjonueme që vyen për me përmbushun nji dërgesë, mund të merren deri sa të mbarohen, gjanat me vleftë e arkave të përmenduna në nenin ma sipër.

Në këtë rasë, Komisjoni ka me hjekë vulat, ka me nxjerrë prej tyne sasinat e nevojshme dhe, do të mbylli rishtas arkat po me të njajtat formalitete tregue në nenin 33 paragrafi i fundit.

Neni 35.

Për efekt të dispozitave të përmbajtuna në nenin 33, gjendja fillestare e Magazinës qendrore ka me u përba prej sasinave të përmbajtuna ndër paketa të vulosuna dhe prej atyne sasinave të tjera që Komisjoni ka pasë se si të numrojnë materjalisht. Kjo gjendje ka me u ndryshue herë pas here si mbas shtimjeve dhe të dërgesave të reja.

Neni 36.

Gjanat me vleftë të përdoruna për dërgesat e bame në bazë të nenit 34, do të vehen në ngarkim ndër rregjistra të Magazinës qendrore me anë të urdhnave të lëshueme në bazë të proces-verbaleve të veçanta, të nenshkrueme prej pjesmarrësve të Komisionit.

Çgarkimi ndër rregjistra i këtyne vleftave do të rezultojë nga llogarija e urdhën-çgarkimeve të lëshueme për dërgesen e vleftave, Zyravet që i kërkojnë.

Neni 37.

Ministri i Financavet autorizohet me dhanë instrukcionet e duhuna për zbatimin e kësaj Rregulloreje, e cila hynë në fuqi ditën e shpalljes së sajë në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.

Mbreti i Shqipëtarëve

Mbi proponimin e bamun me shkresën Nr. 1208/III datë 5-XI-1934 të Kryeministris.

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministruer me datë 25-10-1934.

D E K R E T O N :

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Rregullores mbi gjestionin e gjanave me vleftë nga ana e Nëpunsit kujdestar të Magazinës qendrore pranë Ministris së Financavet, dhe e Arkëtarëvet të zyrave financjare.

Durrës, me 24 Nanduer 1934. Z O G

Kryeministri P. EVANGJELI

Ministri i Financavet A. DIBRA

Nr. 136

LIGJE, 17 Dhetuer 1934.

Mbi shpërnguljen e Drejtoris Doganës nga Kapeshtica në Korçë

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 31 Dhetuer 1934, Nr. 65)

Art. 1.

Me hymjen në fuqi të kësaj Ligje, Drejtorija e Doganës së Kapështicës shpërngulet në Korçë nen emnin «Dogana e Korçës», dhe Dogana e Pako-Postave në Korçë suprimohet.

Të gjith kompetencat e Doganës për Pako--Posta qi suprimohet, i ngarkohen Drejtoris Doganës në Korçë.

Art. 2.

Për me krye veprimet qi i takojnë sherbimit t'udhëtarëve dhe për me vistue dokumentat doganore që shoqërojnë mallnat që hyjnë e dalin nepër atë portë, cak në kufi (piramide 28 sektor' i Kapshticës), krijohet nji postë doganore me nji të vetem nëpunës e me

BKSH

nji sherbëtor. Rroga e nëpunësit caktohet në 200 fr. ari dhe, ajo e shërbëtorit 60 fr. ari në muej. Si rrogat ashtu edhe shpenzimet e tjera të kësaj Zyre përballohen me fondet respektive të buxehtit udhëtues të Ministris së Financavet.

Hollësinat mbi kompetencat e postës Doganore në fjalë, do të catkohen prej Ministris së Financavet.

Art. 3.

Për automobilat qi do të transportojnë mallnat prej Greqije në Korçë me anë të rrugës: Follorinë-Krustalopigji (Greqi)-Kapshticë e anasjelltas, kaq për cilësitë e tyne, si edhe për dokumentat që duhet t'i shoqërojnë, vlejnë urdhnimet e parashikueme në «Protokollin Shqiptaro-Grek mbi formalitetet doganore qi duhen krye për transportimin e mallnave me automobila nga Follorina-Krustalopigji (Greqi),-Kapështicë-Korçë dhe anasjelltas» nenshkrue në Selanikë me datë 12 Prill 1934.

Art. 4.

Konduktorët e automobilave që transportojnë mallna nepër rrugën Follorinë-Korçë të përmendun në nenin 3, janë të detyruem të vazhdojnë rrugen nga kufini në Korçë direkt pa qëndrime dhe humbje kohe. Gjithë ashtu janë të detyruem që t'i dorëzojnë doganës së vendit mallin e ngarkuem me gjithë dokumentat e shoqërimit.

N'asht se gjatë rrugës ndodhë ndonji aksident shkaktue prej fuqisë madhore në mënyrë qi, vazhdimi deri në destinacjon po i atij automobili bahet i pa-mundun ose, kuer aksidenti mund të riparohet, por duhet nji kohë pak a shumë e gjatë, konduktori i automobilit, asht i detyruem të lajmërojë me nji herë dhe me mjetin ma të shkurten doganën ma t'afërme të Kufinit ose të Korçës, e cila doganë do të dergojë në vend nji organ të vetin. Pa ndërhyrjen e nji nëpunësit ose agjentit të doganës asht e ndalueme të bahet nga ana e konduktorit veprim çplumbosjeje, shkarkimi me qëllim transbordimi të mallit ose ri-ngarkim.

Përpara nji ndodhjes së tillë, automobili do të shoqërohet ma tjetër nga organi i doganës deri në doganen e destinacionit dhe, mbi ngjarjen do të mbahet proces-verbal i rregullt qi do të nënshkruhet dhe nga deshmitarët eventualë. Ky proces do t'i paraqitet doganës së bashku me dokumentat e tjera të ngarkesës dhe me mallin.

Art. 5.

Nëpunësat ose agjentat doganorë të ngarkuem me shoqërimin e automobilave, kan të drejtë t'udhtojnë me ato automobila gratis dhe konduktorët nuk mund të refuzojnë.

Art. 6.

Për fektet e kësaj Ligje konduktorët e automobilave që transportojnë mallna nëpër rrugen e përmendun në Art. 3, ndaj doganës, kan të gjitha detyrat e kapidanve t'anijave; për konsekuencë, si mbas rastit, i-u aplikohen po ato ndeshkime dhe gjoba në rast se, nuk përmbushin detyrat që i-u atribuojnë Ligjët dhe Rregulloret doganore në veprim, dhe këto pa perjudice të fajeve kondrabande të cilat janë të ndeshkueshme në bazë të Ligjës mbi ndalimin e kondrabandave me datë 17 Qershuer 1928.

Për çdo kontravajtje të shoferave me dispozitat të Protokollit Shqiptaro-Grek të sipër-përmendun, si edhe n'ato të kësaj Ligje për të cillat Ligjët dhe Rregulloret doganore të përgjithshme dhe të veçanata nuk parashofin nji ndeshkim të ndryeshem, ose kuer në to nuk bahet fjalë fare, Drejtori i Doganës në Korçë ka të drejtë të vendosi, si mbas randësis së fajit ndeshkimin e kontravajtësit me nji gjobë të pagueshme me nji herë jo ma pak se 30 fr. ari dhe, as ma shumë se fr. ari 300, gjobë e cila në përsëritje të fajit dyfishohet.

Vendimi i Drejorit të Doganës i dhanë në dy rastet e sipërshenuara ekzekutohet me nji herë, por i interesuemi ka të drejtë kundërshtimi në Gjykatën Paqtuese të vendit mbrenda 10 ditëve prej së nesërmes të komunikimit të vendimit, me konditë qi të ketë parapaguarë gjoben e caktueme.

Art. 7.

Me qëllim qi të sigurohen të drejtat e duhuna në bazë të Ligjëve doganore në fuqi, personat qi importojnë mallna nga Greqija nepër rrugen Kapshticë si u tha sipër, janë të detyrue të depozitojnë ma parë në Drejtorin e Doganës në Korçë nji akt-detyrim personal të legalizuar në Noteri për pagimin e gjithë të drejtave (tagra, taksa, gjoba), po qé se malli i tyne rregullisht i ngarkuar në Greqi dhe qi ka kalue kufinin e Mbretnis, nuk i dorëzohet doganës për ku destinohet nga ana e konduktorëve e pikërisht si mbas boletinit të lëshuem nga dogana e ekspedicionit që i shoqërojnë.

Forma e akt-detyrimit të dhanun caktohet nga Ministrija e Financavet.

Të tilla akt-detyrime mund të jenë edhe kolektive.

Art. 8.

Plumbosja nga ana e autoritetit doganor sa e automobilave, kaqë edhe mallnave që hyjnë e dalin nga toka e Mbretnis, bahet pa shpërblim.

Art. 9.

Ministrija e Financavet, po t'a shofij të nevojshme asht e autorizueme t'elaboroj dhe nji Rregullore për zbatimin e kësaj Ligje.

Art. 10.

Ministri Financavet autorizohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Art. 11.

Kjo Ligjë hynë fuqi 40 dit mbas shkembimit të notave të ratifikimit të Protokolit Shqiptaro-Grek të përmendun në nenin 3 të kësaj Ligje.

ZOGU I.
Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON:

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjit mbi shperngulljen e Drejtoris së Doganës nga Kapshtica në Korçë, e votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 9/1 datë 22-XI-1934 Kryesis së Tij.

Tiranë, me 17 Dhetuer 1934. ZOG

Kryeministri	*Ministri i Financavet*
P. EVANGJELI	A. DIBRA

Nr. 137.

LIGJE, 17 Dhetuer 1934.

Mbi bartje fondesh në buxhetin e ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së Financavet

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 31 Dhetuer 1934, Nr. 65)

Neni 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së Financavet, pakësohen fondet për kapituj si vijon:

BKSH

Kap. 50 Qira	Fr. ari	11.310
Kap. 51 Vertetim tatimesh e taksash	»	5.400
Kap. 53. Shtypje pullashe	»	1.400
Kap. 57. Ndertime e miratime	»	1.500
Kap. 58. Shpenzime Gjyqi	»	11.000
		30.610

Neni 2.

Fondet e paksueme si mbas nenit 1 të kësaj Dekret-Ligjë, i shtohen gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet t'ushtrimit financjar 1933-934 të Ministris së Financavet ndër kapitujt si vijon:

Kap. 17. Shpenz. Zyreje «Shtëpija Ushtarake»	Fr. ari	310
Kap. 41. Rrogë jetike e shperblime për merita patriotike	»	23.100
Kap. 44. Rrogë personeli	»	1.200
Kap. 47. Shpenzime udhtimi e djete	»	3.500
Kap. 52. Skonto pullash	»	2.500
		30.610

Neni 3.

Me zbatimin e kësaj Derket-Ligjë, ngarkohet Ministri i Financavet.

Neni 4.

Kjo Dekret-Ligjë hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Z O G U I.
Mbreti i Shqipëtarëvet

